



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË UNIVERSITETIN E
MJEKËSISË, TIRANË.**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI, I
PËRPUTHSHMËRISE, I USHTRUAR
NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË,
TIRANË**

Tiranë, dhjetor, 2023

Përmbajtja:

I- PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	4
1- Përshkrimi i shkurtër i projektit të auditimit.....	4
2- Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	5
3- Konkluzion i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	17
II- HYRJA (të dhëna mbi Projektin e auditimit).....	20
OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.....	20
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....	23
1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI SUBJEKTIN NËN AUDITIM.....	23
2. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT.	24
2.1 Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të MFK.....	24
2.2 Mbi zbatimin e ligjshmërisë së veprimtarisë së AB.....	38
2.3 Mbi organizimin dhe funksionimin e strukturës organizative dhe administrative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore të punës.....	49
2.4 Zbatimi i ligjshmërisë gjatë procesit të punësimit të personelit me kohë të plotë dhe të pjesshme, punësimi i personelit të strukturave shëndetësore të UMT si dhe ndjekja e procedurave të largimit të punonjësve nga puna. Vendimet gjyqësore.....	49
2.5 Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e organeve dhe strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.....	59
2.6 Mbi hartimin, shqyrtimin, miratimin dhe zbatimin e buxhetit; sipas kategorive: granti i politikave të zhvillimit të arsimit të lartë; granti i mësimdhënies dhe granti i punës kërkimore shkencore dhe i veprimtarive krijuese.....	74
2.7 Të ardhurat dhe përdorimi i tyre (të ardhurat nga pagesat e studentëve për arsimimin e shërbime të tjera; të ardhura të krijuara; të ardhura të krijuara nga marrëdhëniet me palët e tjera; të ardhura nga veprimtari kërkimore shkencore si dhe të ardhura nga donacionet, sponsorizimet dhe burime të tjera të ligjshme financimi.....	84
2.8 Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet arkës, bankës në lekë dhe në valutë, blerjet e vogla për periudhën objekt auditimi (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime, etj.).	92
2.9 Zbatimi i dispozitave për dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare.	104
2.10 Nxjerrja e bilancit kontabël në afat, plotësimi i pasqyrave financiare sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj., ndaj buxhetit të shtetit.	110
2.11 Mbi menaxhimin e burimeve financiare të programeve të specializimeve afatgjata.	125
2.12 Mbi menaxhimin e projekteve kërkimore shkencore me financim krejtësisht të mbuluar nga donatorët, projektet me bashkëfinancim dhe projektet e financuara plotësisht nga fondet e Universitetit.	131
2.13 Mbi administrimin e pronës shtetërore.	141
2.14 Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen dhe zbatimin e kontratave deri në marrjen në dorëzim.....	144
2.14/1- Mbi zbatimin e kontratave.	206
2.15 Të tjera të dala nga auditimi.....	215
- Mbi përlllogaritjen e tarifave të shkollimit në UMT.....	215
III. KONKLUZIONI I PËRGJITHSHËM DHE OPINIONI I AUDITIMIT.	227
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET.....	229

SHKURTIME

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
AKKSHI	Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor
VKM	Vendimi i Këshillit të Ministrave
UKM	Udhëzim i Këshillit të Ministrave
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
LPP	Ligji i prokurimit publik
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
PBA	Projekt buxheti afatmesëm
AK	Autoritet kontraktor
NA	Nëpunës autorizues
NZ	Nëpunës zbatues
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i brendshëm
BOE	Bashkimi i operatorëve ekonomik
OE	Operator ekonomik
KVO	Komisioni i vlerësimit të ofertave
BVV	Blerje me vlerë të vogël
NJHDT	Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit
PF	Pasqyra financiare
UMT	Universiteti i Mjekësisë, Tiranë
FM	FM
FMD	FMD
FSHMT	FSHMT
KSHA	Komisioni i shqyrtimit të ankesave
BND	Banka të nivelit të dytë

I- PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1- Përshkrimi i shkurtër i projektit të auditimit.

Nga auditimi i përputhshmërisë të kryer në UMT , rezultoi sa më poshtë vijon

- UMT, për tarifatat e programeve të studimit, nuk ka kryer një metodologji për llogaritjen e tyre deri në shtator 2023. Tarifatat e aplikuara nga UMT dalin mbi bazën e një reference në lidhje me shpenzimet hipotetike të vitit koherent, duke marrë për bazë shpenzimet e vitit të mëparshëm. rezulton pa pajtueshmëri me legjislacionin specifik për arsimin e lartë. Institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri, zhvillojnë/kryejnë veprimtarinë e tyre në përputhje me ligjin specifik nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH” dhe akteve nënligjore në fuqi të dalë në zbatim të tij.

- Nga auditimi i sistemeve të MFK në UMT, rezultoi se, nuk janë implementuar si duhet kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

- Veprimtaria e NJAB ka qenë në mos përputhje të plotë me kuadrin rregullator në fuqi.

- Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, ka pasur dhe vazhdon të ketë mungesë të theksuar të stafit akademik.

- Rektori, rezulton të jetë i punësuar me orar të plotë, në pozicionin e pedagogut në Departamentin e Kirurgjisë, të Fakultetit të Mjekësisë, të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

Rektori, është staf administrativ i Rektoratit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe jo staf akademik siç figuron në listë pagesat dhe listë prezencat e FM të Universitetit të Mjekësisë Tiranë.

- Prezenca e anëtareve të Bordit të Administrimit, është e konfirmuar me një shkresë të vetme në fund të çdo muaji, pa datë, pa numër protokollit dhe pa listë prezencat me datat përkatëse për çdo mbledhje të zhvilluar.

- Pedagogët e kontraktuar me vonesë nga Rektorati, rezultojnë ligjërisht të kenë dhënë orë mësimi dhe të kenë kryer vlerësimet respektive për orët e mësimdhënies të zhvilluara, pa patur më parë një kontratë punësimi me Universitetin Mjekësor të Tiranës. Pedagogët e jashtëm, të kontraktuar nga UMT, kanë kryer punën e pedagogut dhe njëkohësisht kanë certifikuar studentët për lëndët mësimore të dhëna ndaj tyre, pa patur marrëdhënie pune ligjore.

- U konstatua se nuk është bërë një analizë e mirë strukturuar për planifikimin e nevojave buxhetore, është i pranishëm risku i kryerjes së parashikimeve të pabazuara nga ana e departamentit të menaxhimit të programeve, që figurojnë me përqindje të ulët realizueshmërie në disa raste.

- Përdorimi i të ardhurave është me mosrealizime, janë trashëguar të ardhurat nga viti 2019 në vitin 2020 në shumën **711,593,504** lekë, nga viti 2020 në vitin 2021 në shumën **704,162,196** lekë dhe nga viti 2021 në vitin 2022 në shumën **802,513,792** lekë, ndërkohë që në ligjin nr. 80/2015, neni 118 “Institucionet publike të pavarura të arsimit të lartë”, në pikën 5, është përcaktuar se: “IALPP-të nuk kanë qëllim fitimin dhe të ardhurat e përfituara nga veprimtaria dhe pasuritë e tyre përdoren për realizimin e misionit të institucionit”.

- Në FSHMT, të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, në shumicën e rasteve nuk ka dokumentacion të plotë justifikues lidhur me evidentimin e shpenzimeve të karburantit.

- Në pasqyrat financiare të konsoliduar të Univeritetit të Mjekësisë, Tiranë, për **Fakultetin e Mjekësisë** vlera e llogarisë nën rubrika “Gjendje e inventarit qarkullues” llogaria 31 “Materiale”, si dhe nën rubrika “Aktive afat gjata materiale”, llogaria 214 “Instalime elektrike, makineri e pajisje si dhe llogaria 218 “Inventar ekonomik,” vlera neto kontabël e tyre

është e pa rakorduar me vlerën fizike. Si UMT për periudhën nga viti 2013 e në vazhdim, veprimet për ndryshimet e gjendjeve të këtyre llogarive janë të rakorduar, për hyrje daljet, por gjendja fillestare në çelje në fillim të vitit 2013 (vit i bashkimit), nuk ka një listë të artikujve gjendje, nuk vërtetohet gjendja kontabël me atë fizike.

- Nga ana e UMT-së, nuk janë regjistruar pronësia dhe kufijtë e pasurive të paluajtshme si dhe nuk janë dokumentuar aktet e fitimit të pronësisë për çdo rast

- Parregullsi në zbatimin e kontratave;

- Në Autoritetin Kontraktor UMT, gjatë periudhës objekt auditimi rezulton se ka 24 anulime procedurash të cilat shkojnë deri në tre herë anulim, në vlerën 216,010,127.35 lekë, duke sjellë mospërdorim të fondeve si nga buxheti ashtu dhe nga të ardhurat e veta, me ndikim në realizimin e misionit të kësaj IAL.

- Në përgjithësi kriteret e vecanta për kualifikim nuk janë të argumentuara dhe në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP si dhe ka raste të vlerësimit të gabuar nga ana e KVO.

- U konstatua dëm ekonomik në një rast në shumën **513,552 lekë si dhe përdorim pa efektivitet të fondeve në tre raste në shumën 35,145,120 lekë.**

2- Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raportim përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
1	Nga auditimi rezultoi se për vitet 2020, 2021 dhe 2022, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, ka pasur dhe vazhdon të ketë mungesë të theksuar të stafit akademik. Koncretisht për vitin 2020, UMT ka mosplotësim organike për 71 nëpunës (punonjës akademike dhe ndihmës) ose 13% më pak se plani, për vitin 2021 ka 53 punonjës më pak ose 10% më pak dhe për vitin 2022 ka 73 punonjës më pak ose 13%, në kundërshtim me strukturën organike të miratuar. Kjo mangësi në stafin akademik dhe ndihmës akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, në vlerësim të grupit të auditimit, mund të ketë sjellë pasoja në zhvillimin me kohë të plotë të orëve mësimore sipas programeve studimore me rezultat mosarritjen e pritshmërive në mësimdhënie.	50 -61	E lartë	Nga ana e UMT, të merren masa për plotësimin e strukturës me qëllim pakësimin e stafit akademik të kontraktuar me kohë të pjesshme, për rritjen e pritshmërive në mësimdhënie.
2	Nga auditimi në Universitetin e Mjekësisë Tiranë, të listprezencave dhe listpagesave për periudhën e auditimit, rezultoi se Rektori, figuron në Fakultetin	50 -61	E lartë	Rektorati i Universitetit të Mjekësisë, Bordi i Administrimit, Senati Akademik, Drejtorja e Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore, të marrin masat që Rektori, të

	<p>e Mjekësisë, Departamentin e Kirurgjisë, si staf akademik me kohë të plotë.</p> <p>Nga auditimi i listprezencës së ndodhur në dosjet respektive të pagave për Fakultetin e Mjekësisë dhe për stafin administrativ të Rektoratit të Universitetit të Mjekësisë Tiranë, për periudhën objekt auditimi, u konstatua se në listprezencat e stafit të Rektoratit, është paraqitur si prezent në punë me orar me kohë të plotë Rektori. Nuk ka asnjë mundësi fizike që Rektori, pjesë e stafit administrativ të Universitetit Mjekësor të Tiranës, në pozicionin si drejtues i IAL-së publike, të jetë prezent në detyrat e tij të ngarkuara me ligj sipas pozicionit të emërimit, në të njëjtën kohë që është angazhuar me kohë të plotë në mësimdhënie në departamentin përkatës të fakultetit. Ligji për arsimin e lartë, i ngarkon Rektorit, të kryejë detyrat në funksion të miradministrimit të institucionit të UMT-së. Rektori kryen në realitet, detyrat e pedagogut dhe jo detyrat që i janë ngarkuar me ligj. Nga sa është konstatuar nga grupi i auditimit, rezulton se Autoritetet Drejtuese të Universitetit të Mjekësisë Tiranë, paguhen për funksione dytësore dhe jo për funksione parësore ndërkohë që ligji i ka ngarkuar përmbushjen e detyrave në funksionet parësore, kjo edhe për vetë rëndësinë në nivel kombëtar që ka Universiteti i Mjekësisë në Shqipëri, i cili obligon një nivel menaxhimi me kohë të plotë sipas kërkesave të ligjit. Angazhimi i Stafit Drejtues administrativ të UMT-së, në mësimdhënie, me kohë të plotë, në gjykim të grupit të auditimit ka krijuar/mund të ketë krijuar pasoja në miradministrimin e detyrave që ligji i ngarkon këtyre pozicioneve.</p>			<p>angazhohet me kohë të plotë në detyrat e tij parësore, të ngarkuara nga ligji dhe në mësimdhënie, si detyrë dytësore.</p>
3	<p>Pedagogët e jashtëm të kontraktuar nga Fakultetet përkatëse, kanë dhënë mësim tek studentët përkatës sipas cikleve të studimit dhe njëkohësisht janë likuiduar për këto orë mësimi, pa pasur në fillim një kontratë pune me Fakultetin përkatës. Miratimi dhe vendimi i shpalljes së</p>	143 -146	E lartë	<p>Rektorati i Universitetit të Mjekësisë, Senati Akademik, Bordi i Administrimit, Drejtoria e Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore në UMT, të marrin masat që në të ardhmen, kontratat individuale të punës, të nënshkruhen brenda afateve ligjore me qëllim, eliminimin e problemeve juridike,</p>

	<p>fituesve për vendet vakante për pedagogë me kohë të pjesshme, është bërë në Muajin Maj 2020 kur pedagogët kanë qenë të domosdoshëm në Tetor 2019. Pra logjikisht, pedagogët e kontraktuar me vonesë nga Rektorati, rezultojnë ligjërisht të kenë dhënë orë mësimi dhe të kenë kryer vlerësimet respektive për orët e mësimdhënies të zhvilluara, pa patur më parë një kontratë punësimi me Universitetin Mjekësores të Tiranës. Pedagogët e jashtëm, të kontraktuar nga UMT, kanë kryer punën e pedagogut dhe njëkohësisht kanë certifikuar studentët për lëndët mësimore të dhëna ndaj tyre, pa patur marrëdhënie pune ligjore (pasi kontratat rezultojnë të nënshkruara pas kryerjes së mësimdhënies me efekt prapaveprues) me UMT. Kjo gjë, përveç faktit që sjell parregullsi të karakterit ekonomiko-administrativ në Universitetin e Mjekësisë, njëkohësisht, mund të krijojë dhe probleme juridike në të ardhmen, lidhur me vlefshmërinë e shërbimit të mësimdhënies. Gjithashtu, ky shërbim, i ligjëruar pas kryerjes së tij, e bën të pamundur kontrollin konform legjislacionit në fuqi për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin si nga Auditimi i Brendshëm ashtu edhe nga ai i Jashtëm, në kohën e ofrimit të këtij shërbimi.</p>			<p>lidhur me vlefshmërinë e shërbimit të mësimdhënies.</p>
4	<p>Në pasqyrat financiare të konsoliduar të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, për Fakultetin e Mjekësisë vlera e llogarisë nën rubrika “Gjendje e inventarit qarkullues” llogaria 31 “Materiale”, si dhe nën rubrika “Aktive afat gjata materiale”, llogaria 214 “Instalime elektrike, makineri e pajisje si dhe llogaria 218 “Inventar ekonomik,” vlera neto kontabël e tyre është e pa rakorduar me vlerën fizike. Si UMT për periudhën nga viti 2013 e në vazhdim, veprimet për ndryshimet e gjendjeve të këtyre llogarive janë të rakorduar, për hyrje daljet, por gjendja fillestare në çelje në fillim të vitit 2013 (vit i bashkimit), nuk ka një listë të artikujve gjendje, nuk vërtetohet gjendja kontabël me atë fizike.</p>	112 -127	E lartë	<p>Nga ana e Administratorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, të merren masa për ngritjen e një grupi pune për vlerësimin kontabël dhe fizik të nën rubrikave “Gjendje e inventarit qarkullues” llogaria 31 “Materiale”, nën rubrika “Aktive afat gjata materiale”, llogaria 214 “Instalime elektrike, makineri e pajisje si dhe llogaria 218 “Inventar ekonomik,” dhe zgjidhjen e situatës për sistemimin e llogarive.</p>

5	<p>Nga auditimi konstatohet se janë dërguar akte administrative shkresore nga UMT-ja drejtë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe anasjelltas, por pa finalizuar këtë proces me miratimin e listës së pronave dhe procedimin për regjistrimin e tyre pranë Agjencisë së Kadastrës. Konstatohet se ka mosveprim nga ana e strukturave përgjegjëse pranë dy institucioneve respektive të ngarkuara nga ligji. Sa më sipër, në kushtet që nga ana e UMT-së, nuk janë regjistruar pronësia dhe kufijtë e pasurive të paluajtshme si dhe nuk janë dokumentuar aktet e fitimit të pronësisë për çdo rast, është vepruar në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, i ndryshuar, ligjit nr. 33/2010 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, nenit 2, pika 10, nenit 24 të Kodit Civil “Regjistrimi fillestar” si dhe në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe me dispozitat e çdo akti që përcakton pronësinë ose të drejta të tjera reale që ekzistojnë për pasuritë e paluajtshme, si nenit 45/1 dhe nenit 46/1.</p>			<p>Administratori i Universitetit të Mjekësisë Tiranë, të marrë masat për të ngritur një grup pune, me qëllim pasqyrimin e dinamikës dhe lëvizjet e objekteve respektive në administrim të Universitetit, të ndërtojë gjurmën e auditimit për mënyrën e sigurimit të këtyre pasurive, duke saktësuar origjinën dhe administruar dokumentacionin e nevojshëm, në bashkëpunim dhe me MAS, dhe pas saktësimit të listës përfundimtare, duke reflektuar efektet e vendimeve të Këshillit të Ministrave për transferimin e pronave që ky Universitet ka administruar, të ndërmerren veprimet e nevojshme ligjore me qëllim pasqyrimin e situatës së duhur në pasqyrat financiare të institucionit.</p> <p>Nga Universiteti i Mjekësisë Tiranë, të ri aplikohet pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, për vazhdimin e procedurave për regjistrimin e pronave që UMT ka në administrim, pasi të jenë kryer korrigjimet e duhura duke rakorduar gjendjen e këtyre pasurive me listën analitike të aktiveve, në pasqyrat financiare të vitit 2023.</p>
6	<p>Në Autoritetin Kontraktor UMT, gjatë periudhës objekt auditimi rezulton se ka 24 anulime procedurash të cilat shkojnë deri në tre herë anulim, në vlerën 216,010,127.35 lekë, duke sjellë mospërdorim të fondeve si nga buxheti ashtu dhe nga të ardhurat e veta, me ndikim në realizimin e misionit të kësaj IAL.</p> <p>Në përgjithësi kriteret e veçanta për kualifikim nuk janë të argumentuara dhe në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, dhe më të theksuara në procedurat e prokurimit: “Furnizim - vendosje dritare dhe dyer per Dekanatin e FM”; “Blerje të pajisjeve mjekësore laboratorit për Fakultetin e Mjekësisë, Tiranë”; “Rikonstruksion i tarracës së godinës “Galileo Galilei” brenda QSU “Nene Tereza”; “Vlerësimi i protezave fikse metal qeramikë të mbështetura mbi implante, për FMD”; “Blerje pajisje</p>	146 -212	E lartë	<p>Nga Autoritetin Kontraktor, të merren masat e duhura që të analizohet situata në drejtim të realizimit të investimeve, në drejtim të hartimit të saktë të preventivave, në drejtim të përcaktimit në lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit të kërkesave të veçanta për kualifikim, në shpalljen e fituesve, në marrjen në dorëzim të punëve, mallrave dhe shërbimeve si dhe në zbatimin e urdhrave nga nëpunësit për pjesëmarrje në komisione.</p>

	<p>stomatologjike për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”;</p> <p>- “Rikonstrukcion i sallave të Rektoratit dhe çatisë së UMT”; “Furnizim vendosje kondicionerësh për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”.</p> <p>Janë konstatuar në disa raste vonesa në lidhjen e kontratës nga Fakulteti i Mjekësisë; në disa raste që raporti përmbledhës mban datë përpara procesverbalit të vlerësimit të dokumentacionit të OE fitues;</p> <p>Gjithashtu u konstatua neglizhencë e nëpunësve të caktuar për zbatimin e procedurave të prokurimit apo për marrjen në dorëzim të mallrave, punëve apo shërbimeve, nëpërmjet dorëheqjeve nga komisionet përkatëse duke shkaktuar zgjatje të procedurave.</p> <p>Në shumë raste u konstatua se nga asistenca teknike e APP kërkohet rishikim i kriterëve, e cila nuk është bërë sipas kësaj asistence.</p>			
7	<p>Autoriteti Kontraktor, UMT, gjatë vitit 2022 ka zhvilluar disa procedura prokurimi në rolin e Autoritetit Kontraktor qendror blerës, për të cilat i është deleguar e drejta për prokurim nga 3 fakultete që janë pjesë e UMT: FM, FMD dhe FSHMT. Theksojmë se nuk ka dokument ku nga ana e këtyre njërive shpenzuese të delegohet e drejta për zhvillimin e procedurave të prokurimit, jo vetëm për këto raste por edhe për raste të tjera të trajtuara. Nga auditimi rezulton se këto fakultete janë njësi shpenzuese (autoritete kontraktore) më vetë, të pajisura me llogari personale për prokurimin elektronik, si dhe fondet buxhetore për realizimin e procedurave të prokurimit menaxhohen nga ana e tyre (likuidimet për çdo blerje malli, realizim shërbimi, kryerje pune realizohen nga vetë fakultetet). Pas miratimit të buxhetit të vitit 2022, fakultetet kanë përcjellë regjistrat e parashikimeve për miratim nga Administratori i UMT.</p> <p>Rezulton se pasi është publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik njoftimi</p>	146 -212	E lartë	<p>Nga ana e Autoritetit Kontraktor, UMT, për zgjidhjen e situatës, të merren masa të bashkëpunojnë me APP, e cila jep këshilla dhe asistencë në fushën e prokurimit publik, me qëllim mirë zbatimin e kuadrit ligjor për prokurimin publik; verifikon zbatimin e ligjshmërisë së procedurave të prokurimit publik, pas fazës së nënshkrimit të kontratës së prokurimit ose anulimit të procedurës, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore; monitoron nëse zbatimi i kontratave është bërë në përputhje me kushtet e prokuruar bazuar në raportet periodike të autoriteteve ose enteve kontraktore.</p>

	<p>i fituesit (në përfundim të afateve të ankimit), nga ana e administratorit të mëparshëm është proceduar me nënshkrimin e kontratës për të gjitha njësitë në total (Rektorati dhe 3 fakultetet), duke cituar në kontratë fondet respektive të secilës njësi. Nga administratori i UMT është ngritur Komisioni i Marrjes në Dorëzim të Mallrave për të gjitha njësitë në total (Rektorati dhe 3 fakultetet), të ndara sipas secilës njësi. Nga ana e Administratorit të UMT, S.S, nuk është bërë autorizim për lidhje kontrate për tre fakultetet për pjesën takuese të tyre, por kontrata për çdo procedurë (4) është lidhur nga AK, UMT, në kushtet kur fondet në dispozicion nuk janë të vetat por të tre AK të tjera, të cilët i kanë deleguar të drejtën për prokurim UMT.</p> <p>Kontrata nga Administratori i UMT, është nënshkruar në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, nenet: 4 Përkufizime, pika 9, neni 14. “Kontratat publike”, neni 33. “Organ qendror blerës”, Neni 21, “Autoriteti ose enti kontraktor”, Neni 53, “Blerja e përqendruar” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pika 7, neni 67, “Prokurimi i përqendruar dhe delegimi i prokurimit”, pikën 4, neni 106, “Kohëzgjatja e kontratës”.</p>			
8	<p>Nga auditimi i kontrata së lidhur midis “K” SHPK dhe Fakultetit të Mjekësisë, Tiranë, me nr. 1392/4 Prot., datë 26.10.2018, me objekt “Blerje materialesh laboratorit farmacie dhe mikrobiologjike”, me afat 30 ditë kalendarike nga dita e nënshkrimit ose me datë përfundimi datën 24.11.2018, me vlera 2,054,205.6 lekë me TVSH, rezultoi se procesverbali i marrjes në dorëzim të pajisjeve, është me nr. 1392/12 Prot., datë 04.01.2019. Tek ky procesverbal, cilësohet se materialet janë dorëzuar në dy data të ndryshme dhe konkretisht në datën 06.11.2018 sipas faturës nr. 18905</p>	212 -221	E lartë	<p>Nga FM të Universitetit të Tiranës, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 513,552 lekë, nga “K” SHPK, si vlerë që i përket penaltetit që duhej mbajtur për arsye të ekzekutimit të kontratës jashtë afateve të përcaktuara.</p>

	<p>dhe në datën 19.11.2018 sipas faturës nr. 18B004.</p> <p>Komisioni i marrjes në dorëzim të materialeve, duhej të propozonte mbajtjen e penalitetit nga kontraktori “K” SHPK, për dorëzimin e materialeve jashtë afateve të përcaktuara, në referencë të pikës 24.1, të nenit 24 “Likuidimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar”, të kontratës nr.1392/4 Prot., datë 26.10.2018 ku cilësohet se “Për kontratat me periudhë zbatimi jo me shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës”. Meqenëse nuk është e dokumentuar se është vepruar konform pikës 36, pikës 37 “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve”, dhe pikës 44 “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara”, kontraktorit “K” SHPK, duhej ti mbahej penaliteti nga FM në vlerën 2,054,206 lekë / 4 = 513,552 lekë.</p>			
9	<p>Nga auditimi i projektit: “Identifikimi i teknikës optimale intraoperatore të kardiomioplastikës qelizore në mënyrë simulante me rivaskularizimin kirurgjikal tek zemrat humane të infarktuara nëpërmjet implantimit të qelizave staminale autologe në rrugë të ndryshme, një studim eksperimental”, rezultoi se: Për këtë projekt fondet e miratuara për vitin 2019, janë mbështetur në kontratën nr.2179/2 prot., datë 16.09.2019, të lidhur ndërmjet UMT-së dhe AKKSHI-së, si dhe planit financiar shoqërues, dhe do të përdoren për blerje aparaturash për zhvillimin e projektit, ndërkohë këto fonde janë detajuar në llogarinë 602 “Mallra dhe shërbime” nga AKKSHI dhe jo sipas kontratës së lidhur në llogarinë investime.</p> <p>Nga auditimi rezulton se pajisja është blerë në vlerë totale 8,304,000 lekë, është bërë hyrje në Fakultetin e Mjekësisë nëpërmjet fletë-hyrjes nr.7 datë 16.10.2020 dhe është likuiduar pranë Degës së Thesarit në datën 12.11.2020</p>	133 -143	E lartë	<p>Nga ana e UMT të analizohet situata e krijuar, të nxirren përgjegjësitë si dhe të merren masa të menjëhershme për vënien në funksion të pajisjeve mjekësore.</p>

	<p>nëpërmjet urdhër-shpenzimit nr.164, në llogarinë e të ardhurave të institucionit dhe jo në llogarinë përkatëse të projektit, pra duke përdorur si burim financimi të ardhurat e institucionit në buxhetin e vitit 2020, ndërkohë që kjo pagesë duhet të ishte kryer në llogarinë përkatëse të projektit.</p> <p>Për këtë projekt vetëm sa janë blerë pajisjet, në shumën 8,3 milion lekë që në datë 16.10.2020 dhe deri në përfundimin e auditimit në terren, pajisjet nuk janë vënë në punë, për një periudhë 3 vjet, duke kaluar të gjitha afatet e garancive dhe mirëmbajtjes. Gjithashtu nuk është vazhduar me procedurat e tjera për shpenzimet për mallra që duhen për vënien në punë të tyre, duke sjellë mos efektivitet në përdorimin e fondeve në shumën 8,304,000 lekë.</p>			
10	<p>Nga auditimi i zbatimit të procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i sallave të Rektoratit dhe çatisë së UMT”, të zhvilluar sipas urdhër prokurimit nr.307, datë 30.12.2022, me fond limit 18,059,998.7 lekë rezultoi se: Kjo procedurë prokurimi është anuluar 3 herë datat 14.10.2021 dhe 10.12.21, 11.05.2022. Herën e tretë është anuluar me vendim të KPP nr.404/2022, me nr. 713/6, datë 29.04.2022.</p> <p>Në të tre herët, si dhe në procedurën me Urdhër Prokurimi nr. 307, datë 30.12.22, në asnjë rast nuk është kryer oponenca teknike për projektin që do të prokurohet, në kundërshtim me: ligjin nr. 120/2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, Neni 2. Nisur nga fakti që objekti ku do të bëhet investimi është monument i kategorisë së të II-të, në dosje nuk ka asnjë dokumentacion që të vërtetojë zbatimin e ligjit nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.</p> <p>Preventivi i hartuar paraqitet si përmbledhje e tre preventivave Nuk ka një dokument që të vërtetojë se çfarë</p>	146 -212	E lartë	<p>Autoriteti Kontraktor, Universiteti i Mjekësisë Tiranë, të analizojë situatën e krijuar dhe të ndërmarre masat e duhura për zbatimin e procedurave të prokurimit publik, në të gjitha fazat që nga planifikimi e lidhjen e kontratës.</p>

<p>zërash janë hequr nga preventivat e zbatimit të punimeve të tenderuar më parë, për të cilët është bërë dhe pagesa, me efekt negativ, pasi detyrat e projektimit të prokuruar kanë dalë pa efektivitet në shumën totale 915,000 lekë. Nuk ka asnjë urdhër Titullari për bashkimin e këtyre preventivave, për zërat e hequr apo të shtuar. Për projektin dhe preventivin për punimet e h/izolim tarrace dhe punime rrufepritësi, rezulton të jenë kryer nga Drejtoria e shërbimeve. Nga auditimi rezulton se projekti nuk shoqërohet nga licencat e projektuesve me kategoritë përkatëse, në kundërshtim me VKM nr. 759, datë 12.11.2014, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”. Nuk ka dokument se kush ja ka dhënë njësisë së prokurimit dokumentacionin. Në procesverbalin e argumentimit të kriterëve për kualifikim është kërkuar paraqitja e dokumentacionit ligjor administrativ dhe jo me vet deklaram, kërkesë kjo e ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, neni 82, “Formulari përmbledhës i vetë deklaramit”. NJHDT nuk i ka argumentuar kriterë të cilat janë të paargumentuara dhe jo në lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit, në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 4.</p> <p>Në fazën e vlerësimit KVO ka shpallur fitues BOE “I” SHPK & “K” SHPK & “S” SHPK me ofertë ekonomike 18,037,348.8 lekë, dhe ka s`kualifikuar me të padrejtë OE “2” SHPK me vlerë të ofertës 14,610,929 lekë, me një diferencë 3,426,419.80 lekë, duke mos konstatuar faktin se NJHDT nuk ka kërkuar vetëdeklarime por dokumentacion në kundërshtim me VKM nr. 285, datë</p>			
---	--	--	--

	<p>19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 75, “Komisioni i vlerësimit të ofertave”, pika 4. KVO, nuk ka zbatuar aktet ligjore e nënligjore të prokurimit publik, duke mos i njohur ato.</p> <p>Nga veprimet dhe mosveprimet e NJHDT dhe KVO është shpallur fitues BOE I’ SHPK “K” SHPK, “S” SHPK, me vlerë të ofertës 18,037,348.8 lekë në kushtet kur nuk plotëson kriteret dhe është s’kualifikuar OE “2” SHPK, me ofertë 14,610,929 lekë ose 3,426,419.80 lekë më pak, në kushtet kur NJHDT i ka kërkuar në kundërshtim me LPP vërtetimin e kriterëve dhe KVO ka vlerësuar pa njohur aktet ligjore dhe nënligjore të LPP, duke shkaktuar dëm me efekt negativ në shumën 3,426,419.8 lekë.</p>			
11	<p>UMT, për tarifatat e programeve të studimit, nuk ka kryer një metodologji për llogaritjen e tyre deri në shtator 2023 (periudhë e përfundimit të auditimit në terren). Bazuar në VKM nr. 288, datë 23.07.2018, i cili parashikon një tavan kufi për tarifatat e ciklit të parë dhe të dytë të integruar të studimit, UMT-ja, mjaftohet duke vendosur në kufijtë e këtij tavani, tarifatat për program studimi, pa i nxjerrë ato mbi bazën e një analize profesionale tekniko-ekonomike. Sipas parashikimeve të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”, Bordi i Administrimit duhet të vendosi tarifatat e shkollimit pasi të ketë ndjekur një metodologji të llogaritjes së tyre, duke respektuar kufirin maksimal të përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave. Tarifatat e aplikuar nga UMT dalin mbi bazën e një reference në lidhje me shpenzimet hipotetike të vitit koherent, duke marrë për bazë shpenzimet e vitit të mëparshëm. Këto tarifa në asnjë rast nuk janë rishikuar pas përfundimit të vitit akademik, nëse ato bazohen në një</p>	221 -233	E lartë	<p>Universiteti i Mjekësisë Tiranë dhe Bordi i Administrimit të tij, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, të marrin masa për rishikimin e tarifës së studimit për ta hartuar atë mbi bazën e një analize profesionale tekniko-ekonomike, duke pasur parasysh rritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj studentëve, të përcaktojnë tarifatat e studimit referuar kostove reale, pa përfshirë koston e studentëve ekselencë, e cila duhet të paguhet nga buxheti i shtetit.</p> <p>Universiteti i Mjekësisë Tiranë dhe Bordi i Administrimit të tij, të marrin masat për dërgimin e propozimeve të nevojshme ligjore tek MAS, lidhur me tarifimin e studentëve për cdo vit akademik, pasi viti akademik të ketë përfunduar, me qëllim që tarifa që do të paguajnë studentët të jetë në përpjestim të drejtë me shpenzimet reale të kryera gjatë vitit akademik.</p>

	<p>analizë reale të vitit koherent. Aktualisht me miratimin e VKM nr. 527, datë 07.09.2023 “Për caktimin e metodologjisë së kostos së studimeve për programin e integruar të studimit të ciklit të dytë ‘Mjekësi e përgjithshme’ në institucionet publike të arsimit të lartë dhe çdo mbështetje tjetër për studentët e këtij programi studimi”, është dërguar dhe lista e zërave të përfshira në analizën e kostos, ku një nga zërat është dhe zëri “Shpenzime për bursa”. Vlen të theksohet fakti se, vendosja e kësaj vlere në tabelën e kalkulimit të kostove direkte, rrit riskun për një llogaritje jo reale të saj.</p>			
12	<p>Nga auditimi rezulton pa pajtueshmëri me legjislacionin specifik për arsimin e lartë. Institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri, zhvillojnë/kryejnë veprimtarinë e tyre në përputhje me ligjin specifik nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH” dhe akteve nënligjore në fuqi të dalë në zbatim të tij.</p> <p>Në këtë ligj, në nenin 91 “Lëshimi i diplomave, certifikatave dhe suplementi i diplomës”, në pikën 1, është përcaktuar se “Në përfundim të programit të studimit, studenti pajiset me diplomën ose certifikatën përkatëse. Elementet përbërëse, forma e diplomës dhe procedurat për regjistrimin përcaktohen nga ministria përgjegjëse për arsimin”. Nga ku rezulton se nuk është parashikuar si e drejtë e studentit pajisja me diplomë nga institucion tjetër përveç IAL në të cilën studenti ka përfunduar studimet.</p> <p>Në ligjin nr.60/2023 “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme”, në nenin 1, “Objekti”, është përcaktuar se “Ky ligj përcakton rregulla të veçanta për trajtimin e studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë</p>	221 -233	E lartë	<p>Universiteti i Mjekësisë Tiranë dhe organet kolegjiale të tij, të marrin masat për dërgimin e propozimeve të nevojshme ligjore tek Ministria e Arsimit Sporteve, për shmangien e konfliktit ligjor të krijuar nga dy ligje për të njëjtin qëllim.</p>

	<p>sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë”.</p> <p>Në nenin 4 të ligjit nr.60/2023, “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme”, përcaktohet se kandidati "pranon kalimin zyrtarisht të diplomës përkatëse të arsimit të lartë nga institucioni publik i arsimit të lartë, ku ka përfunduar studimet, në institucionin shëndetësor ku punësohet deri në shlyerjen e detyrimeve për punësim sipas afatit 5/3/2- vjeçar, me të drejtën që pas përmbushjes së detyrimit të punësimit të tërheqë diplomën universitare”.</p> <p>Në përfundim të sa më lart, konstatojmë se neni 4, i ligjit 60/2023, është në kundërshtim me nenin 91, pika 1, të ligjit 80/2015.</p>			
13	<p>Nga auditimi për zbatimin e ligjit nr.60/2023, “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme”, i cili është miratuar në datë 21.07.2023, botuar në Fletoren Zyrtare nr.123, datë 16.08.2023 rezulton se ai në zbatim të nenit 11 të tij, hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare (datë 31.08.2023). Të gjitha detyrimet e studentëve që regjistroheshin për herë të parë në mjekësi të përgjithshme, duhet të fillojnë me nënshkrimin e një deklaratë (neni 4, pika 1/a ligji 60/2023) para zhvillimit të testimit të informatizuar. Testimi i informatizuar është zhvilluar në datat 14-23 gusht 2023 (burimi i të dhënës: njoftimi në faqet zyrtare të QSHA dhe UMT), para datës së hyrjes në fuqi të ligjit 60/2023 (31 gusht 2023, neni 11 i ligjit). Para zhvillimit të testimit të informatizuar për pranimin në programin “Mjekësi e Përgjithshme” maturanët nuk kanë nënshkruar deklaratën sipas nenit 4, pika 1/a, e për pasojë dhe plotësimin e pikave b (marrëveshja) dhe c (kalimi i diplomës një institucioni tjetër) të këtij neni. Konstatojmë se regjistrimi i</p>	221 -233	E lartë	<p>Universiteti i Mjekësisë Tiranë dhe organet kolegjiale të tij, të marrin masat për dërgimin e propozimeve të nevojshme ligjore tek Ministria e Arsimit Sporteve, për hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore për maturanët fitues në programin e mjekësisë, të cilët kanë përfunduar procedurat përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr.60/2023, i cili është miratuar në datë 21.07.2023 “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme”.</p>

<p>maturantëve fitues në programin Mjekësisë ka filluar që në datën 29 gusht 2023, sipas akteve nënligjore të MAS dhe institucioneve të varësisë të saj (deri me 30 gusht janë regjistruar 95% të studentëve fitues në mjekësi).</p>			
--	--	--	--

3- Konkluzion i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.

Referuar punës audituese, rezultateve të auditimit, manualeve dhe standarte, jepet opinionin i auditimit:

A. OPINIONI I AUDITIMIT

I. Opinion mbi auditimin e përputhshmërisë¹:

Ne kemi audituar zbatueshmërinë e akteve ligjore dhe nën ligjore, gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga ana e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, në lidhje me planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, të ardhurat si dhe realizimin e shpenzimeve me ekonomikitet dhe efektivitet; veprimtarinë e MFK dhe Auditit të brendshëm, vendimet e Bordit të Administrimit dhe të Senatit, strukturën organizative, procesin e rekrutimit e largimit nga puna, projektet kërkimore shkencore, specializimet afatgjata, pasqyrat financiare, qarkullimin e vlerave materiale e monetare, zbatimin e procedurave të prokurimit publik, përcaktimin e tarifave të studentëve.

Opinion i modifikuar/ i kualifikuar.

Sipas opinionit tonë, përveç rasteve të cilësuar në paragrafin e “Baza për opinionin për opinionin e modifikuar” subjekti i audituar, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, përgjithësisht ka vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit të nxjerra nga aktet ligjore dhe nënligjore, mbi të cilën ka ushtruar veprimtarinë e tij.

Baza për opinionin e modifikuar/ kualifikuar:

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për përputhshmërinë.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme, e plotë, e saktë dhe e përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. Opinioni e dhënë e mbështesim në faktin se, Drejtoria e Përgjithshme (DP) e FSDKSH në përgjithësi kanë vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit. Mangësitë e evidentuara në disa çështje të audituara sipas përshkrimit të mëposhtëm, **nuk janë të përhapura, por janë materiale** dhe për këtë arsye kemi dhënë **opinion të modifikuar të kualifikuar.**

Përshkrimi i çështjeve:

- UMT, për tarifën e programeve të studimit, nuk ka kryer një metodologji për llogaritjen e tyre deri në shtator 2023. Tarifën e aplikuar nga UMT dalin mbi bazën e një reference në lidhje me shpenzimet hipotetike të vitit koherent, duke marrë për bazë shpenzimet e vitit të mëparshëm. rezultun pa pajtueshmëri me legjislacionin specifik për arsimin e lartë. Institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri, zhvillojnë/kryejnë veprimtarinë e tyre në përputhje me ligjin specifik

¹ ISSAI 4000-23: Objektivi kryesor i auditimit të përputhshmërisë është t'i sigurojë përdoruesit të synuar informacione nëse entitetet publike të audituara ndjekin vendimet parlamentare, ligjet, aktet legjislative, politikat, kode të përcaktuara dhe terma të dakordësuar

nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH” dhe akteve nënligjore në fuqi të dalë në zbatim të tij.

- Nga auditimi i sistemeve të MFK në UMT, rezultoi se, nuk janë implementuar si duhet kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

- Veprimtaria e NJAB ka qenë në mos përputhje të plotë me kuadrin rregullator në fuqi.

- Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, ka pasur dhe vazhdon të ketë mungesë të theksuar të stafit akademik.

- Rektori, rezulton të jetë i punësuar me orar të plotë, në pozicionin e pedagogut në Departamentin e Kirurgjisë, të Fakultetit të Mjekësisë, të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

Rektori, është staf administrativ i Rektoratit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe jo staf akademik siç figuron në listë pagesat dhe listë prezencat e FM të Universitetit të Mjekësisë Tiranë.

- Prezenca e anëtareve të Bordit të Administrimit, është e konfirmuar me një shkresë të vetme në fund të çdo muaji, pa datë, pa numër protokollit dhe pa listë prezencat me datat përkatëse për çdo mbledhje të zhvilluar.

- Pedagogët e kontraktuar me vonesë nga Rektorati, rezultojnë ligjërisht të kenë dhënë orë mësimi dhe të kenë kryer vlerësimet respektive për orët e mësimdhënies të zhvilluara, pa patur më parë një kontratë punësimi me Universitetin Mjekësor të Tiranës. Pedagogët e jashtëm, të kontraktuar nga UMT, kanë kryer punën e pedagogut dhe njëkohësisht kanë certifikuar studentët për lëndët mësimore të dhëna ndaj tyre, pa patur marrëdhënie pune ligjore.

- U konstatua se nuk është bërë një analizë e mirë strukturuar për planifikimin e nevojave buxhetore, është i pranishëm risku i kryerjes së parashikimeve të pabazuara nga ana e departamentit të menaxhimit të programeve, që figurojnë me përqindje të ulët realizueshmërie në disa raste.

- Përdorimi i të ardhurave është me mosrealizime, janë trashëguar të ardhurat nga viti 2019 në vitin 2020 në shumën **711,593,504** lekë, nga viti 2020 në vitin 2021 në shumën **704,162,196** lekë dhe nga viti 2021 në vitin 2022 në shumën **802,513,792** lekë, ndërkohë që në ligjin nr. 80/2015, neni 118 “Institucionet publike të pavarura të arsimit të lartë”, në pikën 5, është përcaktuar se: “IALPP-të nuk kanë qëllim fitimin dhe të ardhurat e përfituara nga veprimtaria dhe pasuritë e tyre përdoren për realizimin e misionit të institucionit”.

- Në FSHMT, të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, në shumicën e rasteve nuk ka dokumentacion të plotë justifikues lidhur me evidentimin e shpenzimeve të karburantit.

- Në pasqyrat financiare të konsoliduar të Univeritetit të Mjekësisë, Tiranë, për **Fakultetin e Mjekësisë** vlera e llogarisë nën rubrika “Gjendje e inventarit qarkullues” llogaria 31 “Materiale”, si dhe nën rubrika “Aktive afat gjata materiale”, llogaria 214 “Instalime elektrike, makineri e pajisje si dhe llogaria 218 “Inventar ekonomik,” vlera neto kontabël e tyre është e pa rakorduar me vlerën fizike. Si UMT për periudhën nga viti 2013 e në vazhdim, veprimet për ndryshimet e gjendjeve të këtyre llogarive janë të rakorduar, për hyrje daljet, por gjendja fillestare në çelje në fillim të vitit 2013 (vit i bashkimit), nuk ka një listë të artikujve gjendje, nuk vërtetohet gjendja kontabël me atë fizike.

- Nga ana e UMT-së, nuk janë regjistruar pronësit dhe kufijtë e pasurive të paluajshme si dhe nuk janë dokumentuar aktet e fitimit të pronësisë për çdo rast.

- Parregullsi në zbatimin e kontratave;

- Në Autoritetin Kontraktor UMT, gjatë periudhës objekt auditimi rezulton se ka 24 anulime procedurash të cilat shkojnë deri në tre herë anulim, në vlerën 216,010,127.35 lekë, duke sjellë mospërdorim të fondeve si nga buxheti ashtu dhe nga të ardhurat e veta, me ndikim në realizimin e misionit të kësaj IAL.

- Në përgjithësi kriteret e vecanta për kualifikim nuk janë të argumentuara dhe në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP si dhe ka raste të vlerësimit të gabuar nga ana e KVO.

- U konstatua dëm ekonomik në një rast në shumën **513,552 lekë si dhe përdorim pa efektivitet të fondeve në tre raste në shumën 35,145,120 lekë.**

Përgjegjësitë e Drejtuesve të UMT:

Strukturat drejtuese të UMT, janë përgjegjëse për hartimin e politikave në përdorimin me efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet të fondeve publike, në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit).

Gjithashtu, strukturat drejtuese të UMT janë përgjegjëse për funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, hartimin e procedurave, aktiviteteve të kontrollit, gjurmës së auditimit për të aktivitet kryesore të saj.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi, që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me zbatueshmërinë e kriterëve të vlerësimit, kuadrin ligjor dhe rregullator nga ana e subjektit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim, që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II- HYRJA (të dhëna mbi Projektin e auditimit).

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të projektit dhe programit të auditimit, të miratuar nga Kryetari i KLSH, nr. 401/2, datë 05.02.2023, dhe shtesës së programit të auditimit nr. 409/4, datë 20.07.2023, nga data 06.06.2023 deri më datë 29.09.2023, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për periudhën nga data 01.01.2020 deri më datë 31.12.2022, u krye auditimi “Përputhshmërisë” nga grupi i auditimit me përbërje:

1. **L.B, Përgjegjës grupi;**
2. **A.T, Auditues;**
3. **M.K, Auditues;**
4. **K.S, Auditues.**

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.

- **Objekti i auditimit:** Objektivi kryesor i grupit të auditimit të KLSH, është dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, termave dhe kushteve, në përputhje me ligjin e buxhetit të shtetit, me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe kornizës ligjore të prokurimit publik, si dhe argumentimin e shpenzimeve të kryera në funksion të veprimtarisë së Institucionit.

-**Qëllimi i auditimit:** Auditimi ka për qëllim *promovimin e transparencës*, duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar, siç kërkohet në aktet ligjore. Gjithashtu, raporti i auditimit ka për qëllim *promovimin e përgjegjshmërisë*, ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre. Auditimi i përputhshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik, duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë (*sipas ISSAI 400, p 18*).

- **Identifikimi i çështjes:** UMT duhet të ketë organizimin e duhur, për të funksionuar duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për rritjen e cilësisë së shërbimit, duke patur në konsideratë shpenzimin e fondeve me ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet.

-**Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar** lidhur me çështjen nën auditim: Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës. Strukturat drejtuese janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësive të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, për të menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe eficientë. Institucioni brenda caqeve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, kryen çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj.

Drejtimi dhe Administrimi i UMT realizohet nga:

o **Senati Akademik** është organ më i lartë drejtues akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë. Ai përbëhet nga 21 anëtarë, personel akademik dhe studentë, të cilët zgjidhen drejtpërdrejt nga grupet përkatëse të anëtarëve të institucionit. Anëtarët e Senatit që përfaqësojnë personelin mësimor shkencor duhet të gëzojnë kategorinë “Profesor” ose të kenë gradën shkencore “Doktor” (PHD), të fituar pranë Universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së.

○ **Bordi i Administrimit** është organ kolegjal vendimmarrës që mbikqyr dhe kontrollon veprimtarinë e UMT-së në aspektet administrative, financiare dhe ekonomike, si dhe në ushtrimin e mbrojtjes së drejtave të pronësisë publike të UMT-së

- Përgjegjësitë e audituesve: Audituesit e KLSH janë përgjegjës për dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuarat si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj.; shpreh nëpërmjet opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, si dhe kodin e etikës me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e opinionit, në mënyrë që të merren veprime korigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

- **Kriteret dhe standartet e vlerësimit:**

○ Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t.

○ Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) IFAC

○ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

○ Ligji nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

○ Manualët e Auditimit, Rregullat, Udhëzimet e KLSH.

○ Ligji nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”;

○ Ligji nr. 25, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”;

○ Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ndryshuar;

○ Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”;

○ Ligji nr.7961, datë 12.07.1995, “Kodi i punës i republikës së Shqipërisë

○ Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar

○ Ligji nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, ndryshuar”;

○ Ligji nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, i ndryshuar;

○ Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar;

○ Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar;

○ Ligji nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”;

○ Ligji nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar;

○ Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe ligje të tjera të fushës së ndërtimit;

○ Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”;

○ Ligji nr. “114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

○ VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar;

○ VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar;

○ VKM nr. 354, datë 11.05.2016, “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim, projektim mbikëqyrje dhe kolaudim”.

○ VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar;

○ VKM nr.329, datë 12.04.2017, “Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik”;

Etj.

- Udhëzime të MFE për MFK, Auditin e Brendshëm, për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore si dhe të programit buxhetor afatmesëm, etj.
 - Statusi i Universitetit, rregulloret, vendimet e Bordit të Administrimit dhe të Senatit Akademik;
 - Akte të tjera ligjore apo nënligjore që do të jenë të nevojshme gjatë auditimit.
- **Metodat e auditimit:** Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave të kërkuara dhe të vëna në dispozicion, intervistave, takimeve dhe konsultave me nëpunësit e UMT, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kriterëve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit, të gjykimeve, të përfundimeve të arritura, programin e auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, të finalizuar me akt konstatimet, akt verifikime dhe komente të subjektit të audituar, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij dokumenti.
- **Dokumentimi i auditimit:** Është kryer bazuar në kërkesat e manualit të auditimit të përputhshmërisë, në standardet ndërkombëtare të auditimit (ISAI), për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë. Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit Projekt Raporti i Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI SUBJEKTIN NËN AUDITIM.

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë është themeluar më datë 23.01.2013, me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 48, “Për krijimin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë (UMT)”. Në kuadër të riorganizimit të Universitetit, nga Universiteti i Tiranës shkëputen dhe integrohen në strukturën e UMT-së **njësitë kryesore**: FM; Fakulteti i Infermierisë.

Struktura e UMT-së - Në strukturën e UMT-së përfshihen njësitë kryesore, si më poshtë vijon: FM; FMD ; Fakulteti i Farmacisë; FSHMT; Fakulteti i Shëndetit Publik.

Sipas kësaj VKM, financimi i UMT-së, për vitin 2013, përbëhet nga: buxheti i Universitetit të Tiranës, i planifikuar për Fakultetin e Mjekësisë dhe Fakultetin e Infermierisë dhe b) burime të tjera të ligjshme.

UMT-së i kalojnë të gjitha asetet e luajtshme dhe të paluajtshme që zotërojnë dhe disponojnë FM dhe Fakulteti i Infermierisë, të Universitetit të Tiranës.

UMT-ja e ka selinë në Tiranë, në godinën e Fakultetit të Mjekësisë, të Universitetit të Tiranës. UMT-ja e ka filluar veprimtarinë e saj në vitin akademik 2012 - 2013.

Veprimtaria ekonomike rregullohet sipas dispozitave ligjore: ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 10276, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; Statuti i UMT, të miratuar me Vendimin nr.36, datë 11.09.2018 të Bordit të Administrimit dhe me Vendimin nr.11, datë 11.02.2019 të Senatit Akademik, VKM nr.75, datë 12.02.2018, “Për miratimin e modelit të financimit të buxhetit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, VKM nr.431, datë 22.06.22, “Për disa ndryshime në VKM nr.75, datë 12.02.2018, “Për miratimin e modelit të financimit të buxhetit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, legjislacioni tatimor e fiskal në fuqi; si dhe marrëveshjeve ndërkombëtare.

Objekti i veprimtarisë së UMT është formimi i profesionistëve të shëndetit, të aftë për të përballuar sfidat e zhvillimit në fushat e shkencave mjeksore.

Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit është përputhshmëria e operacioneve financiare të subjektit për periudhën nga 01.01.2020 deri më datë 31.12.2022.

Është audituar aktiviteti i shoqërisë për periudhën e auditimit, fokusuar kryesisht në operacione financiare, por jo vetëm. Konkretisht janë audituar shpenzime për investime, shpenzimet operative, shpërblimet dhe pagat, pasqyrat financiare, procedurat e prokurimit, lidhja dhe zbatimi i kontratave për punë, mallra e shërbime, etj. Është audituar vendimmarrja e organeve drejtuese, si dhe menaxhimi financiar dhe kontrolli.

2. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT.

2.1 Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të MFK.

Mbi auditimin e zbatimit të ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të Menaxhimi Financiar dhe Kontrollit (MFK):

Universiteti i Mjekësisë Tiranë (UMT) është krijuar me VKM nr. 48 datë 23.01.2013 “Për krijimin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”. UMT përbëhet nga Rektorati dhe nga tre Njësi Kryesore si: FM (FM), FSHMT dhe FMD (FMD), të cilat veprojnë si njësi ekonomiko-financiare të pa varura. UMT ushtron funksione akademike dhe funksione administrative.

Ky auditim u krye në zbatim të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, si dhe aktet ligjore e nënligjore të dala në zbatim të tij. Auditimi u realizua me qëllim për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjisllacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e UMT-së., si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorëve të plotësuar nga ky institucion për periudhën e auditimit, më poshtë rendisim punën e bërë, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët e MFK në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

Sipas Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar me Ligjin Nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” Në nenin 19 të Kreun III “Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit” citohet se: “Titullarët e njësisë publike zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet këtyre komponentëve të ndërlidhur me njëri-tjetrin”: Mjedisi i kontrollit; Menaxhimi i riskut; Veprimtaritë e kontrollit; Informacioni dhe komunikimi dhe Monitorimi.

Nga auditimi në lidhje me vlerësimin sipas komponentëve të mësipërm të menaxhimit financiar dhe kontrollit (MFK) rezultoi se:

1. Në lidhje me Komponentin “Mjedisi i kontrollit” në zbatim nenit 20, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, nga auditimi i zhvilluar referuar dhe në pyetësorët e vetëvlerësimit të plotësuar nga UMT për periudhën objekt auditimi (vitet 2020,2021 dhe 2022), rezulton se:

-UMT ka miratuar Rregulloren e Brendshme të UMT të miratuar me Vendimin nr. 48, datë 26.11.2014 të Senatit Akademik dhe nga UMT është miratuar Rregullorja e Brendshme më e fundit me Vendimin nr.59, datë 29.06.2022 të Senatit Akademik.

- UMT ka të miratuar dhe Rregulloren e Funksionimit të Këshillit të Etikës në UMT e cila është e miratuar me Vendimin nr.81, datë 19.11.2021 të Senatit Akademik.

Kodi i Etikës së UMT-së është miratuar me Vendimin e Senatit Akademik me nr.49, datë 26.11.2014 e cila është shfuqizuar me Kodin e ri të Etikës të miratuar nga Senati Akademik i UMT-së me Vendimin nr.33, datë 07.04.2022 e cila është në fuqi.

-Nga UMT në lidhje me parandalimin e konfliktit të interesit zbatohen drejtpërdrejtë rregullat e parimet në zbatim të ligjit nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e konfliktit të interesit”. Në bazë të ligjit të sipërcituar si dhe ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH” është ngritur me Urdhërin e Rektorit të UMT-së nr.41, datë 15.10.2014, i cili është shfuqizuar duke u ngritur autoriteti përgjegjës i ri për parandalimin e konfliktit të interesit, me Urdhërin e përbashkët të Rektorit e Administratorit të UMT-së me nr.20, datë 23.03.2021 i cili është në fuqi.

Njohjen e stafit me rregulloret dhe bazën ligjore në fuqi kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike sipas fushës dhe strukturave përkatëse nga Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore.

- Nga ana e Senatit Akademik të UMT me Vendimin nr.39, datë 02.05.2018 me nr. 955/3 Prot., datë 02.05.2018 është Miratuar Rregullorja e Brendshme për Hetimin Administrativ të Sinjalizimit dhe Mbrojtjen e Konfidentalitetit në UMT.

Ndërsa për ndëshkimin e rasteve ndiqen procedurat e masave disiplinore të parashikuara në legjislacionin për Kodin e Procedurave Administrative, Kodin e Punës dhe Legjislacionin për Arsimin e Lartë në RSH.

- Nga UMT për periudhën e auditimit nuk ka programe të trajnimit për integritetin dhe sjelljen.

Në lidhje me ankesat për korrupsion rezulton se kushdo është i lirë të shkruaje dhe të dorëzojë ankesë verbalisht ose shkresërisht pranë organeve drejtuese të UMT-së. Ankesat mund të bëhen edhe nëpërmjet adresës elektronike në faqen e Webit.

Nga auditimi rezulton se, në fund të çdo viti për të gjithë punonjësit e UMT-së sipas varësisë drejtoria përkatëse plotëson dhe dorëzon në Sektorin e Burimeve Njerëzore formularin e performancës për të gjithë punonjësit, në të cilat janë dhe vlerësimi i sjelljeve në përputhje me kodin e etikës.

Nëpunësi Autorizues (NA) i institucionit (UMT-së) mbikëqyre të gjithë funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, kjo realizohet nëpërmjet: 1.Hartimit të planit strategjik afat mesëm. Hartimi i planeve të punës për çdo sektor në përputhje me detyrat e çdo vendi pune. 3. Kontrollin e zbatimit të detyrave nëpërmjet kontrollit horizontal dhe vertikal, sipas hierarkisë së përcaktuar në strukturën e UMT-së. Pjesë e kontrollit shërben dhe sistemi i raportimit me shkrim por edhe verbal i dokumentuar në procesverbalin e mbledhjeve të organizuara.

-Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.

-Nga ana e UMT-së është miratuar Rregullorja e Brendshme të miratuar me Vendimin nr. 48, datë 26.11.2014 të Senatit Akademik dhe Rregullorja e Brendshme më e fundit me Vendimin e Senatit Akademik nr.59, datë 29.06.2022 (të pasqyruara dhe në trajtimin më lart).Rregullore të cilat janë dhe në adresën zyrtare elektronike te UMT-së.

Nga auditimi sipas pyetësorëve rezulton se, Deklarata e misionit të UMT-së është pika 1 e Planit strategjik " miratuar me vendim të Senatit Akademik nr. 18, datë 24.02.2017 dhe Vendim Rektorati nr.3, datë 19.06.2019, si dhe deklarata e Politikës së PBA-së 2022-2024 e UMT. Vendimin e GMS (Grupi i Menaxhimit Strategjik) me nr.2 datë 30.06.2021 Nr.1314/14 prot., datë 30.06.2021 për miratimin e kësaj deklarate. Si dhe PBA-së 2023-2025 të UMT dhe Vendimin e GMS me nr.1 datë 20.06.2022 Nr.1516/8 prot., datë 20.06.2022 “Për miratimin e deklaratës së politikës si dhe taveve të shpenzimeve për projekt buxhetin afatmesëm të UMT”.

Nga ana e UMT për periudhën e auditimit është hartuar plani strategjik për treguesit e performancës.

- Sipas kontakteve të bëra me menaxhimin dhe pyetësorëve, në hartimin e planit strategjik, konfirmohet se kanë marrë pjesë menaxherët e programeve, për të cilat nuk u vunë në dispozicion procesverbale të takimeve të tyre, apo procesverbale të tryezave të rumbullakta me palët e treta.

Nga ana e UMT-së janë bërë përcaktimet e treguesve të performancës për çdo program dhe i janë dërguar menaxherëve për plotësim tabelat përmbledhëse të treguesve të performancës për PBA.

- Për periudhën objekt auditimi është miratuar struktura organizative në përputhje me madhësinë dhe aktivitetet e UMT-së. Është e miratuar me Vendimin e Bordit të Administrimit nr.40 datë 04.07.2019 me nr.1911/5 prot., datë 04.07.2019, “Për miratimin e numrit të personelit të UMT në të gjitha nivelet” i ndryshuar me Vendimin e BA nr.47 datë 30.07.2019. kjo strukturë dhe numri korenspondues gjenden të publikuara dhe në faqen elektronike të UMT-së. Personeli i UMT përbëhet nga tre nëngrupe e konkretisht nga Personel Akademik për të tre Fakultetet e varësisë , Personel ndihmës akademik për Rektoratin dhe tre Fakultetet e varësisë si dhe personel administrativ për Rektoratin dhe tre Fakultetet e varësisë. Tre Fakultet e varësisë së UMT-së janë, FM (FM); FSHMT si dhe FMD (FMD).

- Në faqen e saj zyrtare në internet të UMT janë të paraqitura ndër të tjera dhe rregulloret organi grama struktura si dhe kuadri rregullator i veprimtarisë së UMT.

- Vlerësimin e punës së strukturës organike, UMT-së e kryen nëpërmjet plotësimit të vetëvlerësimit, nëpërmjet raporteve të auditimit të jashtëm apo të brendshëm,

Theksojmë faktin se, në UMT për periudhën e auditimit 2020;2021 dhe 2022 nuk ka raporte auditimi të përfunduara nga NJAB për arsye të problematikave në punën e kësaj njësie e të trajtuara më hollësisht në materialin për auditimin e veprimtarisë së NjAB të UMT-së.

-Nga UMT relatohet në Pyetësorin e vetëvlerësimit se; Në rregullore dhe në kontratën e lidhur me çdo punonjës përcaktohet përshkrimi i punës. Sipas ligjit për arsimin e lartë për punonjësit administrativ Bordi i Administrimit ka miratuar dhe kriteret e punësimit dhe përshkrimin e pozicioneve të punës. Por nga auditimi rezulton se përshkrimi i punës nuk është i plotë për të gjithë stafin e Rektoratit. Ndërsa për pjesën tjetër të personelit ndihmës akademik me karakter administrativ dhe mësimor, përshkrimi i punës është shtojce e bashkëlidhur në kontratën individuale të punës për secilin punonjës, përshkrim dhe detyra funksionale këto të vendosura që në publikimin e pozicionit vakant.

Nga institucioni pretendohet se, nga titullari i institucionit, Rektori me urdhrin e tij nr. 103 datë 18.07.2023 ka ngritur grupin e punës përkatës i cili është duke punuar me Draft-Rregulloren e organizimit dhe funksionimit të administratës së Rektoratit në të cilat do të jenë të përfshira dhe përshkrimi i punës për secilin punonjës.

Në fund të çdo viti për të gjithë punonjësit e UMT-së sipas varësisë plotësohet dhe dorëzohet në Sektorin e Burimeve Njerëzore formulari i performancës, Vlerësimi fillestar në formular jepet nga menaxheri direkt nga i cili punonjësi varet dhe pastaj nga të gjithë menaxherët sipas varësisë. Në kriteret e përcaktuara përpara fillimit të rekrutimit janë përcaktuar kushtet që kandidati duhet të plotësojë që ti përgjigjet nevojave të institucionit.

Nga auditimi rezulton se, Trajnimet e personelit janë ofruar kryesisht nga projektet me financim të huaj që zbatohen në UMT, MFE etj. Nga UMT për periudhën e auditimit nuk ka trajnime mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe nuk ka as një evidencë të mbajtur për trajnimet e personelit.

-Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime, pra nga vetë UMT-së nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme.

Nga UMT janë miratuar drejtuesit e programeve buxhetore; Drejtuesit e EMP-së janë në varësi direkte administrative nga NA. (drejtuesit e njërive dhe nëpunësi zbatues).

Bazuar dhe në ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” në UMT nuk ka Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

- Në zbatim të ligjit organik të buxhetit, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” nga UMT me Vendimin e Bordit të Administrimit (BA) nr.3 datë 22.02.2018 është ngritur dhe funksionon Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) të UMT-së , Vendim i ndryshuar me Vendimin e BA nr.26, datë 04.06.2020.

Nga verifikimi i veprimtarisë së Grupi të Menaxhimit Strategjik (GMS) rezultoi se:

Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të UMT-së në të cilin të përfshihej Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij, por që pretendohet se këto do të përfshihen në Draft-Rregulloren e organizimit dhe funksionimit të Rektoratit të UMT-së që është duke u punuar nga institucioni.

2. Në lidhje me Komponentin “Menaxhimi i riskut” sipas nenit 21 të Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar përcaktohet se :

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

Me qëllim për t’i zbatuar veprimtaritë e mësipërme kërkohet që nga, titullari i njësisë publike të miratohet një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nëpunësi autorizues duhet të analizojë dhe përditësojë kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit.

Me qëllim për të minimizuar riskun e mashtrimit dhe të parregullive, nëpunësit autorizues të njësisë publike duhet të regjistrojnë dhe raportojnë masat e marra për parandalimin e mashtrimit dhe të parregullive. (Kërkesa këto të përcaktuara në pikën 2 dhe 3 të nenit 21 të ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” (i ndryshuar)

Nga auditimi i zhvilluar referuar dhe në pyetësorët e vetëvlerësimit të plotësuar nga UMT për periudhën objekt auditimi (vitet 2020,2021 dhe 2022) rezulton se:

Nga ana e UMT-së Objektivat hartohen në përputhje me kuadrin parashikues të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, plotësimin e rekomandimeve të Raportit të Akreditimit Institucional, si dhe në funksion të përmbushjes së objektivave të përcaktuar për realizimin e politikave dhe misionit të UMT-së. Hartimi i PBA nga ana e UMT bazohet duke patur për bazë planin strategjik të UMT-së dhe objektivat institucional të UMT publikohen dhe në faqen elektronike të institucionit.

Me urdher nr.21, datë 06.03.2018 është ngritur Ekipi i Menaxhimit të Riskut (EMR) dhe është përcaktuar koordinatori i deleguar i riskut. Ky grup ka ndryshuar me Urdhrin nr.41, datë 21.05.2020 po ashtu nga UMT-së, me urdhrin nr.37, date 25.03.2022 është ngritur Ekipi i Menaxhimit të Riskut (EMR) dhe është përcaktuar koordinatori i deleguar i riskut. Po ashtu nga UMT hartohet Regjistri i Riskut duke u diskutuar si në GMS ashtu dhe në EMR .

Në këtë institucion për gjithë periudhën e auditimit nuk ka përfunduar ndonjë mision Auditimi nga Njësia e Auditimit të Brendshëm ku trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut. Nga auditimi rezulton se, krahas vlerësimit të riskut ,ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike ekspozimin e institucionit ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e UMT-së si institucion me gjithë njësitë e varësisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit. Nga institucioni është mjaftuar me Rregulloren e Brendshme për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjes së konfidentalitetit në UMT të miratuar me Vendimin e Senatit Akademik të UMT-së nr.39 datë 02.05.2018 si dhe me Kodin Etik të UMT-së. Nga UMT relatohet në pyetësor se nuk ka raste të identifikimit të mashtrimit, ryshfetit, korrupsionit etj.

Nga ana e UMT-së në politikën dhe procedurat e veprimtarisë së saj rezulton se, sipas rastit janë marrë në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni, apo nga ndryshimet në menaxhim, duke marrë masa për t'i paraqitur rregullat e nevojshme në përputhje me ndryshimet në rregulloret e brendshme dhe duke përcaktuar detyrat në personat zëvendësues përgjegjës për realizimin e funksioneve të ndryshuara, siç është dhe rasti i rishikimeve të Rregulloreve të Brendshme të këtij institucioni.

3.Në lidhje me Komponentin “Veprimtaritë e Kontrollit” në zbatim të nenit 22 të Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar nga auditimi konstatohet se, në këtë institucion për gjithë periudhën e auditimit nuk ka përfunduar ndonjë mision Auditimi nga Njësia e Auditimit të Brendshëm ku trajtohet ndonjë auditim në lidhje me kërkesat e pikës 3 të nenit 22 të Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, të cituar si më sipër.

Nga auditimi i zhvilluar referuar dhe në pyetësorët e vetëvlerësimit të plotësuar nga UMT për periudhën objekt auditimi (vitet 2020,2021 dhe 2022) rezulton se:

- Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë janë përcaktuar krahas detyrave janë identifikuar pak a shumë dhe proceset e punës. Ekzistojnë procedura të brendshme për proceset e punës, të cilat i referohen edhe hartës së proceseve të punës të përcaktuara në dispozitat ligjore (si procedurat standarte të zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, për arkivat, kodit të procedurave administrative, etj).

- Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga Nëpunësi Autorizues (NA) dhe Nëpunësi Zbatues (NZ), pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

- Për prokurimet nga NA kanë dalë urdhrat e krijimit dhe funksionimit komisionit të llogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i pranimit të mallit.

- Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planifikimit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhurnohet sa herë kur ka ndryshime fondesh. Ekzistojnë dosjet e procedurave të prokurimeve, ku gjurmën e auditimit e vërteton ekzistenca e evidencave të prokurimeve në këto dosje dhe evidencave financiare si urdhër-shpenzimeve të shoqëruar me dokumente autorizues, vërtetues dhe justifikues si kontrata, fatura, situacionet akt-marrjet në dorëzim, fletë-hyrjet etj. të vulosura nga dega e Thesarit.

- Për Aktivet UMT ka miratuar rregulloren “Për administrimin financiar, kontabilitetin dhe kontrollin në UMT” si dhe Udhëzimin nr.141, datë 31.07.2018 “Për menaxhimin e Aktiveve”

duke zbatuar Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e Aktiveve në njësitë e Sektorit Publik” i ndryshuar.

Nga auditimi në lidhje me inventarizimin e asetëve të, Universitetit të Mjekësisë Tiranë (Rektorati) për periudhën e auditimit rezultojë si më poshtë :

Mbështetur në ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” I ndryshuar , Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” i ndryshuar , Kapitulli 4 “Inventarizimi i aktiveve” si dhe bazuar në kuadrin ligjor rregullator të Universitetit të Mjekësisë e konkretisht Ligjin nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë neni 51 dhe 52; Rregulloren e Brendshme për Administrimin Financiar, Kontabilitetin dhe Kontrollin në Universitetin e Mjekësisë, miratuar me Vendimin e Bordit të Administrimit të UMT **me nr.52 datë 26.12.2018** Kreu V, neni 27 deri 31 Dhe në Rregulloren e Brendshme për Administrimin Financiar, Kontabilitetin dhe Kontrollin në Universitetin e Mjekësisë, miratuar me Vendimin e Bordit të Administrimit të UMT **me nr.16 datë 25.02.2020** Kreu V, neni 27 deri 31 e cila është në fuqi aktualisht nga ana e administratorit të UMT (Rektoratit) për secilin vit të periudhës së auditimit janë nxjerrë Urdhrat e brendshëm për ngritjen e komisioneve përkatëse me qëllim inventarizimin dhe vlerësimin e përdorimit të vlerave materiale të institucionit si në ngarkim të punonjësve dhe ato të magazinës, më konkretisht si më poshtë:

Viti 2020 : -Në lidhje me inventarizimin e materialeve në ngarkim të punonjësve, nga ana e administratorit të UMT (Rektorati) A.M, është nxjerrë urdhri i brendshëm Nr. 203, datë 28.12.2020, “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të aktiveve Afatgjata Materiale të Rektoratit të UMT”.

Nga ana e Komisionit të ngarkuar për këtë qëllim në përfundim të punës është hartuar “Raporti për kryerjen e inventarizimit të aktiveve Afatgjata Materiale të Rektoratit të UMT” me nr. 207/1 prot. datë 25.01.2021.

-Në lidhje me materialet në Magazinën e Rektoratit të UMT është nxjerrë Urdhri i brendshëm Nr. 204, datë 28.12.2020, “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të aktiveve në magazinën e Rektoratit të UMT”.

Nga ana e Komisionit të ngarkuar për këtë qëllim në përfundim të punës është hartuar “Raporti për kryerjen e inventarizimit të aktiveve në Magazinën e Rektoratit të UMT” me nr. 206/1 prot. datë 25.01.2021.

Viti 2021 : -Në lidhje me materialet në ngarkim të punonjësve, nga ana e administratorit të UMT (Rektorati), B.C është nxjerrë Urdhri i brendshëm Nr. 218, datë 29.12.2020, “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të aktiveve Afatgjata Materiale të Rektoratit të UMT”.

Nga ana e Komisionit të ngarkuar për këtë qëllim në përfundim të punës është hartuar “Raporti për kryerjen e inventarizimit të aktiveve Afatgjata Materiale të Rektoratit të UMT” me nr. 173/3 prot. datë 24.01.2022.

-Në lidhje me materialet në Magazinën e Rektoratit të UMT sipas Urdhrit të brendshëm Nr. 219, datë 29.12.2020, “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të aktiveve në magazinën e Rektoratit të UMT”.

Nga ana e Komisionit të ngarkuar për këtë qëllim në përfundim të punës është hartuar “Raporti për kryerjen e inventarizimit të aktiveve në Magazinën e Rektoratit të UMT” me nr. 173/2 prot. datë 24.01.2022.

Viti 2022: -Në lidhje me materialet në ngarkim të punonjësve, nga ana e administratorit të UMT (Rektorati), S.S është nxjerrë Urdhri i brendshëm Nr. 284, datë 13.12.2022, “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të aktiveve Afatgjata Materiale të Rektoratit të UMT”.

Nga ana e Komisionit të ngarkuar për këtë qëllim në përfundim të punës është hartuar “Raporti për kryerjen e inventarizimit të aktiveve Afatgjata Materiale të Rektoratit të UMT” me nr. 4418/2 prot. datë 30.01.2023.

-Në lidhje me materialet në Magazinën e Rektoratit të UMT sipas Urdhrit të brendshëm Nr. 286, datë 13.12.2022, “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të aktiveve në magazinën e Rektoratit të UMT”.

Nga ana e komisionit të ngarkuar për këtë qëllim në përfundim të punës është hartuar “Raporti për kryerjen e inventarizimit të aktiveve në Magazinën e Rektoratit të UMT” me nr. 4419/1 prot. datë 30.01.2023.

Nga auditimi në lidhje me inventarizimin e aseteve të, FSHMT për periudhën e auditimit rezultojë si më poshtë :

Viti 2020: -Për FSHMT nga ana e Administratorit A.M, është nxjerrë Urdhër i brendshëm nr.42 datë 25.11.2020 me nr.prot.1582 datë 25.11.2020 “Për ngritjen e komisionit për inventarizimin dhe vlerësimin e përdorimit të vlerave materiale dhe magazinës së institucionit”.

Në përfundim të punës nga ana e komisionit të ngritur sipas Urdhrit të mësipërm janë hartuar dhe dy relacione për administratorin e FSHMT me nr. 1582/1 prot datë 24.12.2020 dhe nr.1582 prot, datë 24.12.2020 ku nuk kanë rezultuar problematika të rëndësishme.

Viti 2021: -Për FSHMT nga ana e Administratorit B.C është nxjerrë Urdhër i brendshëm nr.68 datë 05.11.2021 me nr.prot.1381 datë 05.11.2021 “Për ngritjen e komisionit për inventarizimin dhe vlerësimin e përdorimit të vlerave materiale dhe magazinës së institucionit për vitin kalendarik 2021”.

Në përfundim të punës nga ana e komisionit të ngritur sipas Urdhrit të mësipërm është hartuar dhe relacioni për administratorin e FSHMT me nr. 1381/1 prot datë 31.12.2021 ku nuk kanë rezultuar problematika të rëndësishme.

Viti 2022: -Për FSHMT nga ana e Administratorit A.M është nxjerrë Urdhër i brendshëm nr.66 datë 05.12.2022 me nr.prot.1647 datë 05.12.2022 “Për ngritjen e komisionit për inventarizimin dhe vlerësimin e përdorimit të vlerave materiale dhe magazinës së institucionit për vitin kalendarik 2022”.

Në përfundim të punës nga ana e komisionit të ngritur sipas Urdhrit të mësipërm është hartuar dhe relacioni për administratorin e FSHMT me nr. 1647/1 prot datë 30.12.2022 ku nuk kanë rezultuar problematika të rëndësishme.

Nga auditimi në lidhje me inventarizimin e aseteve të, FM për periudhën e auditimit rezultojë si më poshtë :

Viti 2020:- Për Fakultetin e Mjekësisë (FM) nga ana e Administratorit Z.D është nxjerrë Urdhri i brendshëm me nr. 2059 prot., datë 13.10.2020 “ Për inventarizimin e Aktiveve të Qëndrueshme”, si dhe Urdhër i brendshëm me nr.2059/1 prot. datë 13.10.2020 “Për ngritjen e komisionit për inventarizimin dhe vlerësimin e përdorimit të vlerave materiale dhe magazinës së institucionit për vitin kalendarik 2020”.

Në përfundim të punës nga ana e komisionit të ngritur sipas Urdhrit të mësipërm është hartuar dhe relacioni për administratorin e FM me nr. 2059/2 prot datë 30.12.2020 ku nuk kanë rezultuar problematika të rëndësishme. Si dhe për Aktivitetet e Qëndrueshme është hartuar Procesverbali dhe Raporti përfundimtar i Komisionit të Inventarizimit me nr.2059/3 prot., datë 30.12.2020

Viti 2021: -Për Fakultetin e Mjekësisë Dentare (FM) nga ana e Administratorit Z.D është nxjerrë Urdhri i brendshëm me nr. 2522 prot., datë 09.11.2021 “ Për inventarizimin e Aktiveve të Qëndrueshme”, për Aktivet e Qëndrueshme është hartuar Procesverbali dhe Raporti përfundimtar i Komisionit të Inventarizimit me nr.2522/1 prot., datë 10.12.2021. Është nxjerrë Urdhër i brendshëm me nr.2521/1 prot., datë 09.11.2021 “Për ngritjen e komisionit për inventarizimin dhe vlerësimin e përdorimit të vlerave materiale dhe magazinës së institucionit për vitin kalendarik 2021”.

Në përfundim të punës nga ana e komisionit të ngritur sipas Urdhrit të mësipërm është hartuar dhe relacioni për administratorin e FM me nr. 2522/2 prot., datë 30.12.2021 ku nuk kanë rezultuar problematika të rëndësishme.

Viti 2022:- Për Fakultetin e Mjekësisë (FM) nga ana e Administratorit A.B është nxjerrë Urdhri i brendshëm me nr. 2686 prot., datë 16.12.2022 “ Për inventarizimin e Aktiveve të Qëndrueshme”, për Aktivet e Qëndrueshme është hartuar Procesverbali dhe Raporti përfundimtar i Komisionit të Inventarizimit me nr.41 prot., datë 12.01.2023. Është nxjerrë Urdhër i brendshëm me nr.2686/1 prot., datë 16.12.2022 “Për ngritjen e komisionit për inventarizimin dhe vlerësimin e përdorimit të vlerave materiale dhe magazinës së institucionit për vitin kalendarik 2022”.

Në përfundim të punës nga ana e komisionit të ngritur sipas Urdhrit të mësipërm është hartuar dhe relacioni për administratorin e FM me nr. 2886/2 prot., datë 28.12.2022 ku nuk kanë rezultuar problematika të rëndësishme.

Nga auditimi në lidhje me inventarizimin e aseteve të, FMD (FMD) për periudhën e auditimit rezultojë si më poshtë :

Viti 2020: -Për FMD nga ana e Administratorit A.T është nxjerrë Urdhri i brendshëm me nr. 526 prot., datë 24.11.2020 “Për ngritjen e komisionit për inventarizimin dhe vlerësimin e përdorimit të vlerave materiale dhe magazinës së institucionit për vitin kalendarik 2020” si dhe Urdhër i brendshëm me nr.525 prot. datë 24.11.2020“ Për inventarizimin e Aktiveve të Qëndrueshme”.

Në përfundim të punës nga ana e komisionit të ngritur sipas Urdhrit të mësipërm është hartuar relacioni dhe Raporti me nr.526/1prot., datë 24.12.2020 (për inventarizimin e magazinës) si dhe Relacioni me nr.525/2 datë 25.01.2021 për realizimin e inventarizimit Aktiveve të qëndrueshme në (FMD) (për inventarizimin e magazinës) ku nuk kanë rezultuar problematika të rëndësishme.

Viti 2021:- Për FMD nga ana e Administratorit A.T është nxjerrë Urdhri i brendshëm me nr.689 prot., datë 31.12.2021 “Për ngritjen e komisionit për inventarizimin dhe vlerësimin e përdorimit të vlerave materiale dhe magazinës së institucionit” për vitin 2021 si dhe Urdhri i Brendshëm me nr. 690 prot., datë 31.12.2021 “ Për inventarizimin e Aktiveve të Qëndrueshme”.

Në përfundim të punës nga ana e këtyre komisioneve të ngritur sipas Urdhrave të mësipërm është hartuar dhe relacioni për administratorin e FMD (FMD) me nr. 689/1 prot datë 10.01.2022 (për inventarin e magazinës), si dhe për Aktivet e Qëndrueshme është hartuar Procesverbali dhe Raporti përfundimtar i Komisionit të Inventarizimit me nr.690/1 prot., datë 31.01.2022.

Viti 2022:- Për FMD nga ana e Administratorit A.T është nxjerrë Urdhri i brendshëm me nr. 544 prot., datë 29.09.2022 “ Për inventarizimin e Aktiveve të Qëndrueshme”, si dhe Urdhër i brendshëm me nr.543 prot. datë 29.09.2022 “Për ngritjen e komisionit për inventarizimin dhe vlerësimin e përdorimit të vlerave materiale dhe magazinës së institucionit për vitin kalendarik 2022”.

Në përfundim të punës nga ana e komisionit të ngritur sipas Urdhrit të mësipërm është hartuar dhe relacioni për administratorin e FMD (FMD) me nr. 544/1 prot datë 30.11.2022 dhe nr. 543/1

prot., datë 20.10.2022 (për inventarizimin e Magazinës) ku nuk kanë rezultuar problematika të rëndësishme.

Në lidhje me përzgjedhjen dhe zhvillimin e aktiviteteve të kontrollit të teknologjisë rezulton se:

-Në UMT funksionon sistemi i sekretarive, i instaluar dhe i monitoruar nga RASH, siguria e të cilit është përcaktuar në një kontratë dypalëshe.

Për momentin nuk ka sistem back-up. Rash për sistemet e instaluar prej tij ka back-up e tij.

Serveri kryesor gjendet në RASH i cili menaxhon dhe mban përgjegjësi për të.

Domine i faqes zyrtare të UMT-së është e hostuar në AKSH dhe mirëmbahet nga një specialist IT i cili është në strukturën e Drejtorisë së Promovimit, kërkimit dhe komunikimit. Mirëmbajtja e hardwëare dhe softwëare bëhet nga një specialist në Drejtorinë e Administrimit Akademik dhe Kurrikulave, pozicion i cili është vakant për gjithë periudhën e auditimit. Aktualisht rezulton që këto detyra i ka realizuar specialisti IT web.

Në strukturën e njësive kryesore (fakultete) të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, për secilën njësi ka në strukturë një punonjës IT.

Ndarja dhe funksionimi është kryer nëpërmjet një procesi rregullash që është përcaktuar në rregulloren e institucionit.

- Konstatohet se, nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT.

Nga auditimi konstatohet se, në UMT-së janë përcaktuar qartazi përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit për drejtuesit dhe gjithë personelin në mënyrë të tillë që i njëjti person të mos kryejë dy detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar ose jo financiar (hartim, miratim, zbatim, monitorim). Për këtë qëllim përgjegjësitë e gjithsecilit për sistemin e kontrollit janë përcaktuar në rregulloret e brendshme, përshkrimet e punës për çdo nivel punonjësi sipas strukturës. Në zbatim të ligjit 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar , funksionojnë të gjitha organet e përcaktuara në këtë ligj.

Si kuadër rregullator i raportimit financiar të UMT-së (Udhëzime, ligje, etj) shërben Udhëzimi nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"; Udhëzimi nr.5 datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"; Udhëzim nr. 14 datë 28.12.2006;Udhëzim nr. 26 datë 27.12.2007;etj.,

Personat përgjegjës për hartimin e Pasqyrave Financiare (PF) si detyrë funksionale e ka specialisti i financës dhe këto pasqyra financiare vjetore nënshkruhen nga NA dhe NZ.

Çdo muaj kryhet kontrolli dhe akordimi me Degën e Thesarit i shpenzimeve dhe arkëtimeve. Të dhënat regjistrohen nga specialisti kontabilitetit dhe i të ardhurave, kontrollohen nga NA dhe NZ. Për periudhën e auditimit konstatohet se nuk ka ndonjë Opinion nga ndonjë Auditim i Jashtëm apo i brendshëm që të shërbejë si evidencë.

1. **Në lidhje me Komponentin “Informacioni dhe Komunikimi”** në zbatim të nenit 23 të Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar nga auditimi i zhvilluar referuar dhe në pyetësorët e vetëvlerësimit të plotësuar nga UMT për periudhën objekt auditimi (vitet 2020,2021 dhe 2022) rezulton se: Drejtuesit në UMT kanë identifikuar dhe përcaktuar informacionin e kërkuar nëpërmjet raportimit financiar dhe operacional, në nivelet përkatës dhe specifikat e duhura tek personeli i duhur.

Por sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj. Megjithëse kjo

pranohet dhe nga vetë UMT në pyetësorët e plotësuar (si të vitit 2021 ashtu dhe të vitit 2022) ku citohet: “Informacioni i marrë dhe i mbledhur siguron monitorimin por mendojmë që kjo është një nga fushat që duhet përmirësime si brenda përbrenda UMT-së ashtu dhe në raport me institucionet qendrore”. Përsëri konstatohet se, nuk ka ndonjë hap të ndërmarrë në këtë drejtim nga UMT.

-Nga UMT kryhen raportime mujore, katër mujore dhe vjetore sipas kalendarit të përcaktuar nga vet institucioni por edhe nga sistemi i raportimit në organe qendrore. Japin informacion të plotë mbi realizimin, %, angazhimet e marra etj. Duke garantuar menaxherët me informacionin mbi: Raportimin financiar dhe operacional mbi “realizimin e shpenzimeve sipas funksionit, klasifikimit ekonomik dhe nga kontigjencat- fakti kundrejt planit në % dhe vlerë absolute”; Raportim mbi “Realizimin e të ardhurave bruto, dhe sipas natyrës - fakti kundrejt planit në % dhe vlerë absolute” si dhe Raportim periodik “Mbi fondin total, angazhimet e marra, fondin e mbetur disponibël për angazhime të reja dhe planin e arkës. Jep periudhën në dispozicion që nga planifikimi deri në regjistrimin e angazhimeve në kontabilitet” etj.

Raportet periodike të buxhetit të UMT-së e monitorimit paraqiten në periudha katër mujore, por raportet për realizimin dhe sistemi e ngritur nga institucioni plotësohen në periudha mujore. Ato mbulojnë 4 njësitë e UMT-së.

- Drejtoria Ekonomike në UMT për mbajtjen e kontabilitetit operon me program excel dhe jo me program kontabiliteti, pa e dubluar programin SIFQ. Regjistrimi apo evidentimi në SIFQ i transaksioneve financiare së bashku me dokumenta shoqërues për vitet 2020-2022 është kryer nga specialistët e Degës së Thesarit Tiranë dhe jo nga UMT. Në bazë të këtij programi kontabiliteti me të cilin operohet, është mundësuar monitorimi i shpenzimeve dhe të ardhurave nga Drejtoria e Ekonomike dhe hartimi i pasqyrave financiare. Për çdo muaj dhe vit kryhen akt-rakordimet me Degën e Thesarit për të ardhurat dhe shpenzimet dhe raportohen në mënyrë periodike edhe mujore në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit si dhe MFE. Mbahen evidenca inventarizimi për aktivet (AAGJM) dhe lëvizjet e tyre dhe regjistri i tyre.

-Rezulton se, nga UMT është miratuar rregullorja e brendshme dhe, faqja e webe e sajë është aktive nëpërmjet saj merret informacioni i kërkuar, mbledhjet e menaxherëve dokumentohen me proces verbal.

Nga UMT përgatitet raporti vjetor i veprimtarisë akademike dhe financiare për çdo njësi si dhe në rang UMTsë.për performancën e institucionit në lidhje me shërbimet publike të ofruara publikut për të cilën shërben dhe faqja zyrtare elektronike e institucionit.

Rezulton se, për rialokimet në buxhet dërgohet informacion i menjëhershëm elektronik e më tej me shkresë zyrtare. Në UMT përdoret emali zyrtar për të gjithë punonjësit si format zyrtar komunikimit dhe raportimi.

UMT si institucion i arsimit të lartë aktorë kryesor ka studentët. Për të cilët është ngritur një sistem komunikimi për marrjen e informacionit dhe ankesave. Në faqen zyrtare të UMT-së ka informacione ku sigurohet qasja publike për :1. Dokumenti i Buxhetit vjetor të propozuar;

2. Buxheti i miratuar për njësinë; 3.Raportet periodike të zbatimit të buxhetit 4. Pasqyrat vjetore financiare dhe të buxhetit. 5. Plani/et vjetor(e) të prokurimit; proceset e hapura të prokurimit; kontratat e lidhura; statistika mbi prokurimet; Por në këtë pikë ka ende nevojë për përmirësim siç pohohet nga vetë institucioni.

Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e informimit dhe komunikimit, qarkullimit dhe mbajtjes së dokumentacionit brenda dhe jashtë institucionit.

Informacioni që sigurohet nga drejtuesit dhe përgjegjësit e sektorëve i transmetohet Titullarit vazhdimisht si dhe për çdo muaj, i cili informohet mbi shpenzimet aktuale dhe buxhetin e planifikuar. Informacioni prej drejtuesve dhe përgjegjësve të sektorëve dërgohen çdo muaj dhe nëpërmjet analizave të here pas hershme sigurohet informacion për arritjen e objektivave dhe dëmeve të mundshme.

Përdorimin e imailit zyrtar e kanë akses të gjithë punonjësit, komunikimi zyrtar mes punonjësve të UMT-së realizohet me komunikim verbal e shkresor, gjithashtu kryhet edhe nëpërmjet sistemit elektronik përmes postës elektronike personale. Për mbledhjet e ndryshme të stafit drejtues dhe menaxherëve me BA janë mbajtur procesverbale. Në faqen zyrtare në internet të UMT-së janë të publikuar dokumente si, broshura, projekte të brendshme dhe të huaja, bashkëpunime brenda vendit dhe jashtë vendit, aktivitete, struktura organike,

2. **Në lidhje me Komponentin “Monitorimi”** në zbatim të nenit 24 të Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, dhe manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit” i miratuar me Urdhrin nr. 108. Datë 17.11.2016 të Ministrisë të Financave në pikën **2.2.10. “Aktorë të tjerë Roli i Auditimit të Brendshëm”**, nga auditimi i zhvilluar referuar dhe në pyetësorët e vetëvlerësimit të plotësuar nga UMT për periudhën objekt auditimi (vitet 2020,2021 dhe 2022) rezulton se:

- Procedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e UMT-së, por mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produktit.

- Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili hartohet çdo 4 muaj .Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm lidhur me arritjen objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit e të efektivitetit. Për këtë fakt mungojnë raportet.

- UMT monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokument i cili është dërguar çdo vit pranë Drejtorisë Përgjithshme e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave ,

- Në bazë të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” nenin 19 dhe 29, dhe shkresave përkatëse të Ministrisë së Financave nga UMT është plotësuar dhe dërguar pranë Njësisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit pranë Ministrisë së Financave “ Pyetësorin e vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar” dhe “Deklarata për cilësinë e e sistemit të kontrollit të brendshëm të institucionit (UMT-së) dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm”, Rezulton se, për aktivet UMT ka miratuar rregulloren "Për administrimin financiare, kontabilitetin dhe kontrollin ne UMT", si dhe urdhra dhe udhëzime të ndryshme. Në kreun 3 të saj , përcaktohen rregullat, procedurat dhe përgjegjësitë për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

- Një nga drejtimet e monitorimit kanë të bëjë me aktivitetin e Auditimit të Brendshëm.

Auditi i brendshëm në periudhën objekt auditimi rezulton se, nuk ka realizuar asnjë mision auditimi i cili të jetë përfunduar me Raport Përfundimtar Auditimi e i cili do të mund të dilte me opinion në lidhje me MFK dhe aktivitete e UMT-së.

Megjithëse nga Njësia e Auditit të Brendshëm në UMT për periudhën objekt auditimi rezulton se, nuk është realizuar asnjë mision auditimi i cili të jetë përfunduar me Raport Përfundimtar Auditimi, nga ana e UMT në pyetësorët e plotësuar e dërguar shprehen sikur kanë Raporte auditimi të Brendshëm dhe të rezultoi se : *aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë në përputhje me burimet dhe të përshtatshme për të përmbushur qëllimet e tyre.*

Si dhe se, nga Auditimi i brendshëm kryen në mënyre të rregullt vlerësime specifike sipas planit të punës së miratuar nga Bordi i Administrimit . Apo se, ndërmerren rregullisht auditime për integritetin e sistemit të pagave të njësisë? (identifikimi i punonjësve fantazëm, mungesën e të dhënave të personelit, identifikimin e kontrolleve të pamjaftueshme apo të munguara, etj, me Raporte Auditimi. (Përgjigjet e pyetjeve: 95 dhe 96 viti 2021 dhe 107, 108 dhe 110 viti 2022.)

- Në UMT aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Raportet e Zbatimit për Planet e Menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të përfomancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave përshtatshmërisë dhe efektiviteti i shërbimeve publike e shoqëruar me analizë për shkaqet e mos realizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme.

-Këtij institucioni për periudhën e auditimit i kanë munguar misionet e Auditimit të Brendshëm apo ato të jashtëm nga KLSH e për pasojë niveli drejtues i njësisë publike nuk mund të monitorojë në mënyrë të plotë statusin e veprimeve korigjuese në mënyrë që ato të përfundojnë në kohën e duhur dhe të sjellin rezultatin e pritur kjo realizohet vetëm nëpërmjet planeve të veprimit nëpërmjet ushtrimit të kontrollit të brendshëm nga menaxherët e njësisë nëpërmjet raportimeve periodike të paracaktuara ndiqet realizimi dhe monitorimi i detyrave dhe përgjegjësi.

Por nga vetë institucioni pranohet se: *“Personeli raporton çështjet e kontrollit të brendshëm përmes linjave të raportimit siç është evidenca elektronike ose e shkruar porse ky sistem operon nëpërmjet linjave të raportimit individuale me përgjegjësit, të dokumentuara në procesverbale dhe se në këtë pikë mendojmë që ka vend për përmirësime, ku do të punohet për ngritjen e sistemit të regjistrimit të incidenteve dhe regjistrimit të përjashtimeve”.*

Megjithëse nga ana e UMT-së kjo ka tre vjet që thuhet nga auditimi nuk konstatohet ndonjë veprim në këtë drejtim.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues sipas periudhave të ushtrimit të detyrës prej tyre (për vitet 2020, 2021 dhe 2022) e konkretisht NA: z.A.M, znj. A.T, z.B.C dhe znj. S.S (të cilët nuk janë më në marrëdhënie punë me UMT) dhe NZ. Znj.A. B., M.F (të cilët nuk janë më në marrëdhënie punë me UMT) dhe znj.M.J, aktualisht me detyrë administrator i përkohshëm.

Titulli i gjetjes	Mos implementimi i një sistemi të përshtatshëm rregullash të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
Situata	<p>Nga auditimi i sistemeve të MFK në UMT, rezultoi se, nuk janë implementuar si duhet kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “<i>Për menaxhimin financiar dhe kontrollin</i>”, për arsye se nga auditimi sipas komponentëve të MFK ka rezultuar në gjetjet e mëposhtme:</p> <p>-Në lidhje me komponentin “Mjedisi i kontrollit” rezulton se: nuk ka programe të trajnimit për integritetin dhe sjelljen, mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Nga auditimi rezulton se përshkrimi i punës nuk është i plotë për të gjithë stafin e Rektoratit. Ndërsa për pjesën tjetër të personelit ndihmës akademik me karakter administrativ dhe mësimor, përshkrimi i punës është shtojce e bashkëlidhur në kontratën individuale të punës për secilin punonjës, përshkrim dhe detyra funksionale këto të vendosura që në publikimin e pozicionit vakant. Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime, pra nga vetë UMT-së nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme. Nga verifikimi i veprimtarisë së Grupi të Menaxhimit Strategjik (GMS) rezultoi se: Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të UMT-së në të cilin të përfshihej Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij, por që pretendohet se këto do të përfshihen në Draft-Rregulloren e organizimit dhe funksionimit të Rektoratit të UMT-së që është duke u punuar nga institucioni.</p> <p>-Në lidhje me komponentin “Menaxhimi i riskut”: Në këtë institucion për gjithë periudhën e auditimit nuk ka përfunduar ndonjë mision auditimi nga Njësia e Auditimit të Brendshëm ku trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut. Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike ekspozimin e institucionit ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e UMT-së si institucion me gjithë njësitë e varësisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit. Nga institucioni është mjaftuar me Rregulloren e Brendshme për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjes së konfidencialitetit në UMT të miratuar me Vendimin e Senatit Akademik të UMT-së nr.39 datë 02.05.2018 si dhe me Kodin Etik të UMT-së. Nga UMT raportohet në pyetësor se nuk ka raste të identifikimit të mashtrimit, ryshfetit, korrupsionit etj.</p> <p>-Në lidhje me Komponentin “Veprimtaritë e Kontrollit”: për gjithë periudhën e auditimit nuk ka përfunduar ndonjë mision Auditimi nga Njësia e Auditimit të Brendshëm ku trajtohet ndonjë auditim në lidhje me kërkesat e pikës 3 të nenit 22 të Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.</p>

	<p>Për momentin nuk ka sistem back-up, RASH për sistemet e instaluar prej tij ka back-up e tij. Serveri kryesor gjendet në RASH i cili menaxhon dhe mban përgjegjësi për të.</p> <p>Domine i faqes zyrtare të UMT-së është e hostuar në AKSH dhe mirëmbahet nga një specialist IT i cili është në strukturën e Drejtorisë së Promovimit, kërkimit dhe komunikimit. Mirëmbajtja e hardwëare dhe softwëare bëhet nga një specialist në Drejtorinë e Administrimit Akademik dhe Kurrikulave, pozicion i cili është vakant për gjithë periudhën e auditimit. Aktualisht rezulton që këto detyra i ka realizuar specialisti IT web. Konstatohet se, nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT.</p> <p>-Në lidhje me Komponentin “Informacioni dhe Komunikimi”: Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.</p> <p>-Në lidhje me Komponentin “Monitorimi”: Në procedurat periodike të raportimit mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produktit; mungojnë raportet e monitorimit të veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit e të efektivitetit. Një nga drejtimet e monitorimit kanë të bëjë me aktivitetin e Auditimit të Brendshëm, i cili nuk ka realizuar asnjë mision auditimi i cili të jetë përfunduar me Raport Përfundimtar Auditimi e i cili do të mund të dilte me opinion në lidhje me MFK dhe aktivitete të UMT-së. Këtij institucioni për periudhën e auditimit i kanë munguar misionet e Auditimit të Brendshëm apo ato të jashtëm nga KLSH e për pasojë niveli drejtues i njësisë publike nuk mund të monitorojë në mënyrë të plotë statusin e veprimeve korrigjuese në mënyrë që ato të përfundojnë në kohën e duhur dhe të sjellin rezultatin e pritur kjo realizohet vetëm nëpërmjet planeve të veprimit nëpërmjet ushtrimit të kontrollit të brendshëm nga menaxherët e njësisë nëpërmjet raportimeve periodike të paracaktuara ndiqet realizimi dhe monitorimi i detyrave dhe përgjegjësi.</p> <p>Megjithëse nga ana e UMT-së kjo ka tre vjet që thuhet nga auditimi nuk konstatohet ndonjë veprim në këtë drejtim.</p>
Kriteri	Ligji 10296, datë 08.07.2010 “ <i>Për menaxhimin financiar dhe kontrollin</i> ”, i ndryshuar dhe në aktet nënligjore e rregullatore në fuqi.
Ndikimi/Efekti	Mangësi në implementimin dhe respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “ <i>Për menaxhimin financiar dhe kontrollin</i> ” i ndryshuar si dhe në aktet nënligjore e rregullatore në fuqi.
Shkaku	Moszbatimi i bazës ligjore në fuqi, e cila rregullon proceset e punës në fushën e MFK-së.
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	Strukturat përgjegjëse të UMT-së, të marrin masa për plotësimin e mangësive të evidentuara si dhe implementimin e një sistemi të përshtatshëm rregullash të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, konform përcaktimeve të

ligjit të MFK-së dhe aktet në zbatim të tij, për ta bërë atë efektiv dhe në dobi të veprimtarisë institucionale.
--

2.2 Mbi zbatimin e ligjshmërisë së veprimtarisë së AB.

Organizimi dhe funksionimi : Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) e Universitetit të Mjekësisë Tiranë është ngritur dhe funksionon sipas strukturës së UMT të miratuar me Vendimin nr.1 datë 25.04.2013 të Këshillit të Administrimit të UMT si dhe bazuar në VKM nr. 83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e NJAB në sektorin publik”. Struktura e Njesisë së Auditit të Brendshëm pranë UMT është e përbërë nga tre punonjës nga të cilat një përgjegjës i njësisë së auditimit dhe dy specialist. Po ashtu në Vendimin e Bordit të Administrimit (VBA) të UMT-së me nr.40 datë 04.07.2019 “Për miratimin e numrit të personelit të UMT në të gjitha nivelet” rezulton se Sektori/Njësia e Auditit të Brendshëm përbëhet nga: 1(një) Përgjegjës/Drejtues i Njesisë së Auditimit dhe 2(dy) Specialist/Auditues i Brendshëm.

Në UMT nuk ka Komitet të Auditit të Brendshëm.

Senati Akademik i UMT me Vendimin nr.18, datë 24.02.2017 ka miratuar “Planin Strategjik 2017-2021 ku ka identifikuar sisteme/fusha për tu audituar .

Statuti i Universitetit të Mjekësisë është miratuar me Vendimin e Bordit të Administrimit të Universitetit të Mjekësisë me Vendimin nr.36, datë 11.09.2018 dhe Vendimin e Senatit Akademik me Vendimin nr. 11 datë 11.02.2019 . Në këtë dokument është e përcaktuar në nenin 24 pika 3 se “Organi më i lartë drejtues administrativ i Universitetit të Mjekësisë është Bordi i Administrimit”.

NJAB sipas Statutit të UMT-së pika 3 e nenit 90 është në varësi direkte të Bordit të Administrimit të UMT-së dhe në pikën 2 të nenit 53 të citohet se: *“Njësia e Auditimit të Brendshëm të UMT ka varësi organizative dhe funksionale nga Bordi i Administrimit dhe raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë tek ky i fundit bazuar në legjislacionin në fuqi për auditin e brendshëm publik”*.

Në funksionet e Bordit të Administrimit sipas nenit 51 të statutit të UMT përcaktohet se miraton kartën e auditimit të brendshëm të UMT, planin strategjik dhe vjetor të Auditit të Brendshëm, programet e angazhimit të auditimit dhe raportimet për çdo angazhim auditimi, gjithashtu Bordi **monitoron funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit nëpërmjet Njesisë së Auditimit të Brendshëm.** Bordi i Administrimit siguron që Administratori i UMT-së të informohet me raportet vjetore të Njesisë së auditimit të brendshëm mbi mënyrën e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e tij dhe hartimin e deklaratës vjetore për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Varësia direkte e Njesisë së Auditimit të brendshëm përsa i përket strukturës organizative e të raportimit tek Bordi i Administrimit si organi më i lartë drejtues i UMT është i bazuar dhe në Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë me nr. 27 datë 29.12.2017 e dalë në zbatim të Ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë” Duke siguruar kështu pavarësinë organizative të NJAB dhe krijuar kushtet për pavarësi funksionale nëpërmjet zhvillimit të veprimtarisë të NJAB bazuar në kuadrin rregullator ligjor në fuqi.

Veprimtaria e Universitetit të Mjekësisë Tiranë për periudhën objekt auditimi është zhvilluar në kuadrin e Rregullores së brendshme të miratuar me Vendimin nr. 44 datë 26.11.2014 dhe e

ndryshuar me Vendimin nr.10 datë 05.02.2015 të Senatit Akademik të Universitetit Mjekësisë Tiranë. Në vitin 2022 nga ana e Universitetit të Mjekësisë Tiranë është hartuar Rregullorja e re e cila është miratuar me Vendimin e Senatit Akademik me nr.59 datë 27.06.2022 e cila është në fuqi. Në të cilin në Kreun IV “Organizimi administrativ neni 34 “Funksionet e Bordit të Administrimit” janë përcaktuar dhe funksione në lidhje me përgjegjësinë e kësaj strukture për kriteret dhe procedurat e punësimit e miratimit të tyre në lidhje me personelin e NJAB të UMT. Ndërsa në lidhje me kompetencat dhe detyrat e Njësive së Auditimit të brendshëm në këtë rregullore gjendet vetëm neni 43 “Kontrolli dhe auditimi” **në të cilën nuk gjenden të përshkruara rregulla për funksionimin e auditimit të brendshëm** por mjaftohet me shprehjen se krijimi dhe funksionimi i Njësive të Auditimit të Brendshëm bëhen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe rregullat e brendshme të UMT dhe se , Auditimi i Brendshëm realizohet mbi bazën e programeve të miratuara nga Bordi i Administrimit. Edhe në rregulloren e mëparshme nuk ka patur **të përshkruara rregulla për funksionimin e auditimit të brendshëm.**

Struktura e NJAB dhe lëvizjet e stafit të kësaj njësie auditimi sipas pozicioneve të punës, arsimimi dhe certifikimi, për periudhën e auditimit, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Emër Mbiemër	Data e fillimit	Pozicioni	Urdhrat e lëvizjes apo dhe Data e largimit	Niveli i arsimit (Specifiko universitetin/institucionin përkatës)
B. S. (T.)	30.08.2013 Inspektore Auditi 28.09.2018 VBA datë 27.09.2018	Inspektore Auditi Përgjegjës i NJAB	15.09.2022 Urdhri 39 Nr. Prot.,2991/1 datë 15.04.2022 (Data e ndërprerjes nga dorëheqja datë 18.11.2021 miratuar me Vendimin BA nr.19 datë 09.03.22)	Universiteti i Tiranës Dega ekonomik (ekonomik i statistikave i aplikuar) 1996-2000 Lista notave 28.08.2003 Dëshmi e MF Nr.Regjistri 0046 datë 30.11.2007 titullin Auditues i brendshëm në Sektorin publik (Trajnim pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Auditimit periudha Qershor 2005 deri Nëntor 2005)
D.M.	01.07.2022	Përgjegjës i NJAB	Larguar 08.06.2023 (Urdhri Administratorit. nr.127 datë 07.06.2023 nr.prot., 1714/3 datë 07.06.2023) Dorëheqje me nr.1714 datë 22.05.2023 me Vendim BA nr.42 datë 26.05.2023 me këtë vendim miratohet dorëheqja e komandohet P/NJAB Rasimi)	Universiteti i Tiranës Fakulteti Ekonomik Dega Mercologjisë Profili Turizmi.1988-1993. Lista notave 09.05.1997 Dëshmi e MF Nr.Regjistri 0996 datë Qershor 2011 titullin Auditues i brendshëm në Sektorin publik (Trajnim pranë Njësive Qëndrore e Harmonizimit të AB) periudha Tetor 2010 deri Qershor 2011.
R.M.	20.10.2015 Inspektor Auditi 26.05.2023 Përgjegjës i NJAB	Inspektor Auditi Përgjegjës i NJAB	(Vendim BA nr.42 datë 26.05.2023 me këtë vendim miratohet dorëheqja e Dritan Mino e komandohet P/NJAB Rasim Metallari)	Universiteti i Tiranës Fakulteti Ekonomik Dega Financë. Titulli Ekonomist për Financë.1979-1983. Lista notave 09.07.1983 Dëshmi e MF Nr.Regjistri 0402 datë Qershor 2008 titullin Auditues i brendshëm në Sektorin publik (Trajnim pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Auditimit periudha Mars 2007 deri Qershor 2008)
M.Sh.	06.03.2019 deri 05.06.2019	Specialist	Kontratë me afat	Fakulteti Drejtësisë Universiteti i Tiranës Bachelor në Drejtësi viti 2011.çertifikatë notash 09.09.2011; Master i Shkencave E drejtë penale

	06.04.2021	Specialist	Urdhri i Rektorit të UMT nr.26 datë 02.04.2021 me nr. 702/3 prot., datë 02.04.2021 emërim M.Shkira specialist në NJAB me kontratë.	në Fakulteti Drejtësisë Universiteti i Tiranës 2013 vertetim notash 24.07.2013. Certifikim i Audituesit të Brendshëm në Sektorin Publik Nr. Regjistri 1900 datë 30.09.2017 Nga MFE. Avokat me nr. License 9493.
--	------------	------------	--	---

Për periudhën e Auditimit kjo strukturë nuk ka funksionuar e plotë kështu:

Për vitin 2020 NJAB ka funksionuar me një përgjegjës NJAB dhe një specialist e konkretisht znj.B. T. dhe z. R. M. të çertifikuar dhe me përvojë pune në auditim mbi 10 vite .

Për vitin 2021 NJAB ka patur në përbërje dhe dy specialist duke u shtuar z. M. Sh. por gjatë këtij viti ka dhënë dorëheqjen më datë 18.11.2021 znj.B. T.

Për vitin 2022 deri në datë 01.07.2022 ka funksionuar vetëm me dy specialist dhe më datë 01.07.2022 është caktuar z. D. M. në detyrën e P/NJAB i cili aktualisht është larguar me Dorëheqje me nr.1714 prot. datë 22.05.2023 me Vendim BA nr.42 datë 26.05.2023 është miratuar dorëheqja dhe është komanduar në pozicionin e P/NJAB z.R. M.

Karta e Auditimit të Brendshëm të UMT-së.

Karta e Auditit të Brendshëm (KAB) si dokument bazë që rregullon veprimtarinë e NJAB është miratuar me Vendimin Bordit të Administrimit të UMT-së nr. 18 datë 14.05.2018 por ky dokument nuk ju vendos në dispozicion grupit të auditimit.

Njëkohësisht konstatohet se është dërguar nga NJAB më datë 16.12.2022 rishikimi i Kartës së Auditit të Brendshëm për miratim nga BA i UMT-së. e cila me VBA nr. 67 datë 19.12.2022 me nr. 4487/3 prot. datë 19.12.2022 ka miratuar Kartën e Auditit të Brendshëm.

Plani strategjik dhe vjetor 2020-2022 për NJAB.

Nga drejtuesi i NJAB janë dërguar për miratim plani dhe relacioni shoqërues në Bordin e Administrimit me shkresën nr.2738 prot., datë 10.10.2019 “Dërgim për miratim të planit strategjik dhe vjetor 2020-2022 të NJAB” dhe nga ana e Bordit të Administrimit të UMT me Vendimin nr.51, datë 21.10.2019 është miratuar ky plan strategjik dhe vjetor për veprimtarinë e NJAB dhe njëkohësisht me shkresën nr.2619/1 prot., datë 30.10.2019 të Rektorit të UMT është përcjellë pranë MFE.

Nga auditimi në lidhje me Angazhimet e auditimit të zhvilluara nga kjo NJAB për periudhën e auditimit rezulton si më poshtë:

Për vitin 2020 NJAB ka funksionuar me një përgjegjës sektori B. T. dhe një specialist R. M. të dy me profesion ekonomist niveli diplomës MSC të certifikuar në vitin 2005 dhe 2008. Vjetërsia në punë 19 dhe 34 vite , vjetërsia në auditim 17 dhe 12 vite.

Për vitin 2020 nga NJAB është parashikuar për auditim 9 misione dhe është paraqitur për miratim në Bordin e Administrimit me shkresën nr.206 prot., datë 21.01.2020. Parashikuar misionet e auditimit si më poshtë:

- 1.Auditim në sistemin e pagesave në Rektorat
- 2.Auditim në sistemin e pagesave në Fakulteti Mjekësisë
- 3.Auditim në sistemin e pagesave në FSHMT
- 4.Auditim në sistemin e pagesave në FMD
- 5.Auditim në sistemin e burimeve njerëzore në UMT.
- 6.Auditim në sistemin e prokurimeve Rektorat.
- 7.Auditim në sistemin e prokurimeve në FSHMT.
- 8.Auditim në sistemin e prokurimeve në Fakultetin e Mjekësisë.

9. Auditim në sistemin e prokurimeve në Fakultetin e Mjekësisë Dentare.

Nga ana e Bordit të Administrimit të UMT nuk ka patur as vendimmarrje e as përgjigje megjithëse nga ana e NJAB i është drejtuar Bordit dhe me shkresën nr.206/1 prot. datë 18.05.2020 për kërkimin e konfirmimit dhe nuk ka patur përgjigje.

Nga ana e NJAB me shkresën 206/2 prot. datë 28.05.2020 është kërkuar miratimi i planit të punës duke e rishikuar tashmë me 5 angazhime. Nga Bordi Administrimit dhe për këtë kërkesë nuk ka patur përgjigje, i është ri kërkuar BA me shkresën e NJAB me nr.206/3 datë 23.06.2020 ku është kërkuar ndërhyrje për të zgjidhur këtë situatë njëkohësisht dhe kërkesë për plotësim strukture të NJAB konform VKM nr.83 datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit”.

Nga ana e Bordit të Administrimit me Vendimin nr.31 datës 29.06.2020 “Për miratimin e planit të punës, të ndryshuar, të njësisë së auditimit të brendshëm të vitit 2020” me shkresën nr.1414/7 prot. datë 30.07.2020 është kërkuar që të shtohet mision auditimi dhe mbi zbatimin e masave dhe procedurave në kuadër të pandemisë covid 19.

Në këto kusht është rishikuar Plani vjetor i punës për NJAB dhe është miratuar sipas VBA nr.31 datë 29.06.2020. Ky plan vjetor është parashikuar me pesë misione auditimi.

Nga NJAB është filluar misioni i auditimit në Rektorat për sistemin e pagesave por dhe ky mision auditim është ndërprerë pasi me shkresën nr. 1864/3 prot., datë 09.09.2020 nga administratori drejtuar Bordit të Administrimit dhe NJAB ka kërkuar përjashtimin e znj.B.T. si pjesë e grupit të auditimit duke pretenduar konflikt interesi duke mos lejuar kështu vazhdimin e angazhimit të këtij misioni auditimi. Nga NJAB i është drejtuar Bordit të Administrimit mbi bllokimin e angazhimit të auditimit dhe për vijueshmërinë e veprimtarisë, me shkresat 1864/5 datë 17.09.2020 dhe nr.1864/6 datë 23.10.2020 por nuk ka patur përgjigje nga ana e Bordit.

Nga auditimi rezulton se, për vitin 2020 nuk është përfunduar e evaduar asnjë mision auditimi.

Në lidhje me këtë periudhë auditimi të veprimtarisë së Njësisë së Auditimit të Brendshëm është realizuar dhe një vlerësim i jashtëm i cilësisë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm sipas Programit të Vlerësimit të jashtëm të cilësisë me nr. 567 prot datë 14.01.2021, në përfundim të të cilës është konkluduar me Raportin Përfundimtar të Marsit 2021 në të cilën **është konkluduar me opinionin e përgjithshëm të veprimtarisë së Njësisë së Auditimit të Brendshëm në mos përputhje të plotë me kuadrin rregullator në fuqi.**

Për vitin 2021 Me Vendimin e BA nr.2 datë 14.01.2021 (me nr.84/2 prot., datë 14.01.2021) është miratuar plani vjetor për vitin 2021 për veprimtarinë e NJAB të UMT-së. ku janë parashikuar 8 angazhime auditimi. Plani vjetor i punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2021 mban nr.44/1 prot., datë 14.01.2021. Në këto misione auditimi është parashikuar që të shtohet periudha e auditimit duke përfshirë dhe vitin 2020.

Në këtë plan pune është parashikuar që të auditohen për periudhën e aktivitetit 2018-2020 8 misione auditimi për “Sistemin e pagesave në: Rektorat, Fakultetin e Mjekësisë, FSHMT, Fakultetin e Mjekësisë Dentare, si dhe është parashikuar auditim për Sistemin e burimeve njerëzore në, UMT. Është parashikuar auditim mbi Sistemin e prokurimeve në: Fakultetin e Mjekësisë , FSHMT dhe Fakultetin e Mjekësisë Dentare.

Nga auditimi rezulton se, dhe për vitin 2021 nuk është përfunduar e evaduar asnjë mision auditimi.

Nga auditimi rezulton se, dhe sipas shkresës së z.Dritan Mino me nr. 2111 prot. datë 19.07.2022 drejtuar Bordit të Administrimit të UMT me të cilën relatohet ndër të tjera se: *“...sipas Planit strategjik dhe vjetor të veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm , në planin e vitit 2021 ishin parashikuar të kryheshin katër misione auditimi: Në Rektorat, Në Fakultetin e Mjekësisë, Në FSHMT dhe Në Fakultetin e Mjekësisë Dentare. Rezulton se është kryer vetëm një auditim përputhshmërie mbi Sistemin e Pagesave dhe është përgatitur vetëm Projekt Raporti i Auditimit duke mos qenë i evaduar”*.

Pra konkluzioni është se për vitin 2021 nuk ka asnjë auditim të përfunduar e të evaduar.

Njëkohësisht konstatohet se, mungon dokumentacioni i përgatitur nga NJAB dhe i miratuar nga BA “Raporti i veprimtarisë së NJAB për vitin 2021” i cili do të duhej ti dërgohej brenda datës 15.02.2022 Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Për vitin 2022 nga auditimi rezulton se, nga muaji Gusht i vitit 2021 deri në Shtator të 2022 nuk ka patur asnjë mision auditimi të realizuar dhe nuk ka patur të miratuar as plan pune nga Bordi Administrimit të UMT.

Nga z. D. M. i emëruar në Korrik si P/NJAB është bërë dhe paraqitur një plan pune në BA nisur nga koha e përgatitjes ky plan pune është konceptuar, prej tij, për periudhën e mbetur Shtator – Dhjetor 2022. Ky plan pune i NJAB është miratuar me VBA nr.53 datë 27.09.2022 (me nr. 2447/3 prot., datë 28.09.2022). Sipas këtij plani pune është parashikuar që të ushtrohen dy misione auditimi të tipit financiar të vlerësuar me risk të lartë në subjektet FM dhe FSHMT.

Nga NJAB është përgatitur Raporti i veprimtarisë së NJAB për vitin 2022 në të cilën rezulton se të dy angazhimet e filluara e të planifikuara në planin e punës janë ndërprerë për arsye se nga një auditues (z. M.Sh.) janë paraqitur pretendime gjetjesh për të cilat ka pretenduar element të veprës penale. Këto raste janë referuar të titullari (BA të UMT) dhe janë ndjekur nga ky organ.

Nga NjAB dhe Bordi Administrimit i UMT-së nuk është hartuar e miratuar : Plani strategjik 2022-2024. Plani vjetor i veprimtarisë së NJAB të vitit 2022. Raporti i veprimtarisë i NJAB të vitit 2021. Plani Strategjik i vitit 2023-25 është miratuar me VBA nr. 59 datë 19.10.2022 “Për miratimin e Planit Strategjik dhe vjetor 2023-2025 të veprimtarisë së NJAB të UMT”. Vendim i cili i është përcjellë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë NJQHAB me shkresën e Rektorit të UMT-së me nr. 2904/3 prot., datë 19.07.2022.

Nga auditimi konstatohet se sipas shkresës nr.934/1 prot., datë 16.09.2021 të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar drejtuar Rektorit të Universitetit të Mjekësisë Tiranë (protokolluar në UMT me nr.2239 datë 17.09.2021) citohet se : *“Më datë 15.09.2021 (një ditë më parë së kjo shkresë) audituesi i Njesisë së Auditimit, zoti M.Sh., ka paraqitur në Prokurorinë e Posaçme një material të të titulluar “Raport final i angazhimit të Auditimit” , në lidhje me auditimin e kryer në Rektoratin e Universitetit të Mjekësisë, me objekt “auditim i përputhshmërisë për sistemin e pagesave”. Në relacionin shpjegues pretendohet se znj.B.T., në cilësinë e Përgjegjëses së Njesisë së Auditimit të Brendshëm është bërë pengesë për të përfunduar procedurën e miratimit të gjetjeve të këtij Raporti Auditimi. Përsa më sipër ky problem nuk është në kompetencë të Prokurorisë së Posaçme dhe kërkojmë nga ana juaj ndërhyrjen për zgjidhjen e problematikës së konstatuar. Në qoftëse nga audituesit do të vlerësohet se janë konstatuar shkelje ligjore të cilat përmbajnë element të ndonjë vepre penale, atëherë materiali duhet paraqitur si kallëzim në prokurorinë kompetente “.*

Nga ana e Rektorit kësaj shkrese i është kthyer përgjigje me shkresën nr.2239/1 prot., datë 08.10.2021 ku e informon Prokurorinë ndër të tjera me faktin se nga Njësia e Auditimit të Brendshëm në Universitet bazuar në Programin e Auditimit të miratuar nga organi përkatës

(Bordi Administrimit të UMT) është kryer auditim lidhur me Sistemin e pagesave në Rektoratin e UMT, për të cilën nga audituesit një nga të cilët z.M. Sh. kanë përgatitur Raportin Paraprak të angazhimit të auditimit. Për këtë material ka patur shumë observacione nga subjektet e audituara dhe po ashtu dhe qëndrime të ndryshme dhe ndërmjet z.Sh dhe përgjegjëses së Njesisë së Auditimit e cila pretendon për mos respektimin nga audituesi z.Sh.të standarteve të Manualit të Auditimit të Brendshëm në kryerjen e këtij auditimi dhe përgatitjen e raportit paraprak.

Në lidhje me këtë situatë Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me urdhrin nr. 567/7 prot., datë 13.09.2021, ka ngritur një grup pune i cili do të kryhej vlerësimin e jashtëm të cilësisë pranë Universitetit të Mjekësisë Tiranë mbi procedurën e emërimit të këtij audituesi në punë. Nëse do të konstatohen fakte penale do tju njoftojmë. (citet në shkresën e Rektorit)

Nga auditimi rezulton se, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në përfundim të vlerësimit të veprimtarisë audituese në UMT në zbatim të Urdhrit 567/7 prot., datë 13.09.2021 “Mbi vlerësimin e procedurës së emërimit të punonjësit në strukturën e auditimit të brendshëm pranë UMT” është hartuar dhe dërguar Raporti Përfundimtar i Vlerësimit me shkresën nr.567/12 datë 02.11.2021 (Protokolluar në UMT me nr.121/5 datë 04.11.2021.)

Ky vlerësim i referohet periudhës Maj –Shtator të vitit 2021 pasi për vitin 2020 është Vlerësimi i veprimtarisë së NJAB pranë UMT është paraqitur në Raportin e Vlerësimit të Jashtëm të cilësisë, të Lëshuar nga Drejtorja e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE me nr. 567/4 datë 30.03.2021 e nëpërmjet të cilit është dhënë opinionin se: “**Vepimtarja e Njesisë së Auditimit të Brendshëm është në mos përputhje të plotë me kuadrin rregullator dhe me standartet ndërkombëtare për praktikat profesionale të auditimit të brendshëm dhe përmirësimi është i domosdoshëm në fushat ku janë adresuar rekomandime**”.

Në statut të UMT miratuar me Vendimin nr. 36, datë 11.09.2018 të Bordit të Administrimit dhe Vendimin nr. 11. Datë 11.02.2019 të Senatit Akademik gjendet neni 53 “Njësia e Auditit të Brendshëm në të cilën citohet:

1. *Auditimi i Brendshëm është një veprimtari e pavarur që jep siguri objektive dhe ofron këshillim për menaxhimin, e projektuar përmes një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike për të shtuar vlerë e për të përmirësuar veprimtarinë e UMT.*

2. *Njësia e Auditimit të Brendshëm të UMT ka varësi organizative dhe funksionale nga Bordi i Administrimit dhe Raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë tek ky i fundit, bazuar në legjislacionin në fuqi për auditin e brendshëm publik.*

3. *Statusi organizativ, qëllimi, misioni, objektivat e punës, përgjegjshmëria dhe përgjegjësitë e Njesisë së Auditit të Brendshëm përcaktohen në Kartën e Auditit të Universitetit të Mjekësisë Tiranë e cila miratohet nga Bordi i Administrimit.*

Në Rregulloren e UMT të vitit 2022(Miratuar me Vendimin Nr.59, datë 27.06.2022 të Senatit Akademik) Është parashikuar neni 62 “Procedura e punësimit të personelit të Njesisë së Auditit të Brendshëm të UMT”, në të cilën ndër të tjera është përcaktuar në pikën 1.j.: “*Administratori i UMT në cilësinë e përfaqësuesit, autoritetit ligjor kompetent, të Universitetit të Mjekësisë për të nënshkruar kontratën e punës pas autorizimit dhe miratimit të draft kontratës individuale të punës nga Bordi i Administrimit*”.

Në Rregulloren e mëparshme të UMT miratuar me Vendimin nr.44 datë 26.11.2014 të Senatit Akademik të UMT e ndryshuar, nuk parashikohej ndonjë nen për Njësinë e Auditit të Brendshëm. Gjë që është reflektuar dhe në konfliktin e krijuar në lidhje me nënshkrimin e

kontratës së punës për specialistin e rekrutuar në punë në Njësinë e auditimit z. Sh.Mosmarrëveshje ndërmjet Rektorit e Administratorit të UMT në lidhje me të drejtën e nënshkrimit të kontratës dhe vendimmarrjen e Bordit të Administrimit të UMT, për të cilën është investuar dhe Drejtoria e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për vlerësimin e rastit.

Nga auditimi rezulton se, me Vendimin e BA të UMT-së me nr. 16. Datë 14.02.2023 është vendosur që të kërkohet fillimi i inspektimit financiar të çështjeve të paraqitura nga audituesi z.M. Sh. e të vlerësuara prej tij si vepra penale për tre materiale Raporti Final i Auditimit të Sistemit të Pagesave në Rektoratin e UMT; Projekt Raporti i Auditimit të Sistemit të Pagesave në FSHMT dhe për Raportin Final të Auditimit të Sistemit të Pagesave të Fakultetit të Mjekësisë. Kërkesë e cila i është përcjellë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me shkresën e Rektorit të UMT me nr. 611/1 prot., datë 22.02.2023. Nga Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik pranë MFE me shkresën nr.3785/2 prot., datë 7.03.2023 të protokolluar në UMT me nr. 611/2 datë 08.03.2023 i është kthyer përgjigje UMT (Rektorit e BA) si dhe për dijeni Ministrisë së Arsimit, Sportit e Rinisë duke konkluduar se kërkesa e UMT nuk përmbush një sërë kërkesash për Inspektim financiar duke rekomanduar dhe veprime konkrete në kompetencë të UMT-së.

Konkluzioni: Nga auditimi rezulton se: Veprimtaria e Njësisë së Auditit të brendshëm të UMT për periudhën e auditimit vitet 2020,2021 dhe 2022 duke qenë në kushtet e gjëndjes së trajtuar si më sipër në këtë akt konstatim është në kundërshtim dhe në mos përmbushje si të misionit e të rolit të tijë konform kërkesave të Ligjit Nr. 114/2015 “Për Auditimin në Sektorin Publik” në nenet 2;5 dhe 6 të të cilit citohet.

Në nenin 2 Auditimi i brendshëm, citon se:

Auditimi i brendshëm është një veprimtari e pavarur që jep siguri objektive dhe ofron këshillim për menaxhimin e projektuar për të shtuar vlerën e për të përmirësuar veprimtarinë e njësisë publike. Auditimi i brendshëm ndihmon njësinë publike për të arritur objektivat, nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, për të vlerësuar e përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, si dhe proceset e kontrollit e të qeverisjes.

Në nenin 5 Misioni, citohet se: Misioni i auditimit të brendshëm është të japë siguri të arsyeshme për titullarin e njësisë së sektorit publik, në mënyrë të pavarur dhe objektive, si dhe këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë e sektorit publik.

Në neni 6 Roli i auditimit të brendshëm: Roli i auditimit të brendshëm është t'i japë mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave të njësisë:...

Veprimtaria e NJAB rregullohet nëpërmjet detyrave të drejtave e përgjegjësi të përcaktuara në legjislacion dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tijë. E konkretisht në Ligjin Nr. 114/2015 “Për Auditimin në Sektorin Publik” ndër të tjera në nenet 12 “***Përgjegjësitë e titullarëve të njësive publike***”; Neni 14 “***Përgjegjësitë e drejtuesit të njësisë së auditimit të brendshëm***” dhe neni 16 “***Përgjegjësitë e audituesve të brendshëm***” të të cilit citohen përgjegjësitë si të titullarëve të NJAB të Drejtuesit të Njësisë AB si dhe të audituesve të kësaj njësie.

Nga auditimi rezulton se: gjendja e veprimtarisë së NJAB në UMT është në kundërshtim dhe me vetë Statutin e UMT-së miratuar me Vendimin nr. 36, datë 11.09.2018 të Bordit të Administrimit dhe Vendimin nr. 11. Datë 11.02.2019 të Senatit Akademik gjendet neni 53 “Njësia e Auditit të Brendshëm në të cilën citohet:

1. *Auditimi i Brendshëm është një veprimtari e pavarur që jep siguri objektive dhe ofron këshillim për menaxhimin, e projektuar përmes një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike për të shtuar vlerë e për të përmirësuar veprimtarinë e UMT.*

2. *Njësia e Auditimit të Brendshëm të UMT ka varësi organizative dhe funksionale nga Bordi i Administrimit dhe Raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë tek ky i fundit, bazuar në legjislacionin në fuqi për auditin e brendshëm publik.*

3. *Statusi organizativ, qëllimi, misioni, objektivat e punës, përgjegjshmëria dhe përgjegjësitë e Njesisë së Auditit të Brendshëm përcaktohen në Kartën e Auditit të Universitetit të Mjekësisë Tiranë e cila miratohet nga Bordi i Administrimit.*

Gjendja aktuale e veprimtarisë së kësaj njësie është e pa pranueshme dhe kjo gjendje paraqitet e njëjtë dhe pas opinionit të dhënë në Raportin e Vlerësimit të Jashtëm të cilësisë, të Lëshuar nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE me nr. 567/4 datë 30.03.2021 e nëpërmjet të cilit është dhënë opinionin se: “Veprimtaria e Njesisë së Auditimit të Brendshëm është në mos përputhje të plotë me kuadrin rregullator dhe me standartet ndërkombëtare për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm”.

Në lidhje me këtë pikë të trajtuar në Projektraportin e Auditimit u paraqitën observacione nga ana e Bordit të Administrimit të UMT-së me shkresën me nr. 401/10 prot. Datë 18.10.2023 e cila është protokolluar në KLSH me nr. 2925/2 prot. Datë 17.10.2023. Ky observacion pavarësisht se nga observuesit i referohen aktkonstatimit nr.18, datë 29.09.2023 të mbajtur nga grupi i auditimit të KLSH gjatë misionit auditues në UMT-së, po trajtohet nga ana jonë si observacion mbi Projektraportin e auditimit për arsye të faktit se nuk është trajtuar në Projektraportin e auditimit.

Në observimin e bërë nga Bordi i Administrimit të UMT-së (i nënshkruar nga Kryetari dhe katër anëtarë të bordit nga shtatë gjithësej) pretendohet në mënyrë të përmbledhur se: “ përgjegjësia për periudhën para datës 22.11.2021 i përket Bordit të Administrimit i cili nuk ka qenë funksional. Ndërsa përsa i përket veprimtarisë për vitin 2022 nga ana e observuesve pretendohet se, nga ana e Bordit të Administrimit janë ushtruar të gjitha përgjegjësitë lidhur me mbikqyrjen dhe funksionimin e NJAB të UMT-së. Duke pretenduar se Bordi Administrimit që në mbledhjet e para të veprimtarisë së tijë ka kërkuar:

- Adresimin e rekomandimeve të lëna nga DP e Harmonizimit të KBFP në MFE.

-Ka kërkuar nga struktura e UMT-së të fillojë urgjentisht procedurat për plotësimin e vendit vakant të Përgjegjësit të NJAB-së përsa dy audituesit e tjerë nuk kryenin asnjë funksion në detyrë. (pohuar nga vetë observuesit)

-Procedurat e rekrutimit të përfunduara me sukses më 1 Korrik 2022 bënë të mundur që NJAB të jetë plotësisht funksionale duke përgatitur planin e punës për periudhën Shtator-Dhjetor 2022 (viti në vijim); Planin strategjik dhe vjetor 2023-2025 ; Kartën e Auditimit si dhe organizimin e dy misionëve audituesë përkatësisht në Fakultetin e Shkencave Mjekësore dhe Teknike dhe Fakultetin e Mjekësisë”.

Përsa më sipër shprehemi se: nga ana e grupit të auditimit të KLSH në materialin e auditimit është trajtuar e gjithë veprimtaria e NJAB-së të UMT si dhe veprimtaria e Bordit të Administrimit të UMT-së për periudhën e auditimit. Pretendimet e observuesve për veprimtarinë e BA përgjatë vitit 2022 qëndrojnë dhe janë trajtuar e paraqitur dhe në materjalin e

auditimit. Por ajo që konstatohet nga auditimi i KLSH dhe nuk kundërshtohet dhe nga observuesit është fakti se për gjithë periudhën e auditimit nga NJAB-së të UMT-së nuk ka asnjë mision auditimi të përfunduar e të evaduar në subjekt. Ndërsa përsa i përket masës së përgjegjësishë shprehemi se, Bordi i Administrimit është një organ kolegjal dhe nuk mund të ndahet përgjegjësia në anëtarë të veçantë dhe përveç faktit që kemi evidentuar veprimtarinë e BA për çdo vit nuk mund të konsiderojmë se veprimtaria e NJAB-së të UMT-së për vitin 2022 (por dhe për periudhën që vazhdonte e përfundoi auditimi në terren) të konsiderohet funksionale përse kohë që nuk ka asnjë mision auditimi të përfunduar e të evaduar me Raport Përfundimtar Auditimi e të dërguar subjektit.

Për këtë arsye observimi në lidhje me pretendimin e funksionimit të NJAB-së në UMT-së nuk qëndron dhe nuk merret parasysh nga ana jonë.

Titulli i gjetjes	Kapacitetet audituese të Njesisë së Auditimit të Brendshëm.
Situata	<p>Nga shqyrtimi i veprimtarisë së auditit të brendshëm në UMT, rezulton se: Struktura dhe organizimi i njesisë së auditit të brendshëm është e përbërë nga tre punonjës, nga të cilat një përgjegjës i njesisë së auditimit dhe dy specialist. Njësia e auditit të brendshëm sipas Statutit të UMT-së pika 3 e nenit 90 është në varësi direkte të Bordit të Administrimit të UMT-së dhe në pikën 2 të nenit 53 të citohet se: “Njësia e Auditimit të Brendshëm të UMT ka varësi organizative dhe funksionale nga Bordi i Administrimit dhe raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë tek ky i fundit bazuar në legjislacionin në fuqi për auditin e brendshëm publik”. Varësia direkte e Njesisë së Auditimit të brendshëm përse i përket strukturës organizative e të raportimit tek Bordi i Administrimit si organi më i lartë drejtues i UMT është i bazuar dhe në Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë me nr. 27, datë 29.12.2017 e dalë në zbatim të Ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë” Duke siguruar kështu pavarësinë organizative të NJAB dhe krijuar kushtet për pavarësi funksionale nëpërmjet zhvillimit të veprimtarisë të NJAB bazuar në kuadrin rregullator ligjor në fuqi.</p> <p>Për vitin 2020 njësia e auditit të brendshëm ka funksionuar me një përgjegjës dhe një specialist dhe për vitin 2021 ka patur në përbërje dy specialist, por gjatë këtij viti ka dhënë dorëheqjen përgjegjësja e kësaj njësie duke bërë që deri në datë 01.07.2022, kjo njësi të ketë patur vetëm dy specialistët dhe më datë 01.07.2022 është caktuar një përgjegjës i cili aktualisht është larguar me dorëheqje të datës 22.05.2023 e në këtë pozicion është komanduar një nga specialistët duke qenë aktualisht struktura e pa plotësuar që ndikon në funksionimin e njesisë së auditit të brendshëm.</p>
Kriteri	Vendimi i Bordit të Administrimit (VBA) të UMT-së me nr.40 datë 04.07.2019 “Për miratimin e numrit të personelit të UMT në të gjitha nivelet” .
Ndikimi/Efekti	Mungesë në organizimin mbikëqyrje raportim e në performancë, të veprimtarisë së Njesisë së Auditit të Brendshëm.

Shkaku	Ndër të tjera dhe mungesa e rekrutimit me qëllim plotësimin e strukturës së NJAB.
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	Bordi i Administrimit i Universitetit të Mjekësisë Tiranë në cilësinë e titullari të Njesisë së auditit të brendshëm të marrë masat e menjëhershme me qëllim plotësimin e strukturës me personelin e nevojshëm.

Titulli i gjetjes	Mosfunksionimi i Njesisë së Auditit të Brendshëm.
Situata	<p><i>Nga auditimi në UMT të veprimtarisë së Auditit të Brendshëm, rezultoi se, për vitin 2020 nuk është përfunduar e evaduar asnjë mision auditimi. Në lidhje me këtë periudhë, auditimi të veprimtarisë së Njesisë së Auditimit të Brendshëm është realizuar dhe një vlerësim i jashtëm i cilësisë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, sipas Programit të Vlerësimit të Jashtëm të Cilësisë, në përfundim të të cilës me Raportin Përfundimtar të Marsit 2021 në të cilën është konkluduar me opinionin e përgjithshëm të veprimtarisë së Njesisë së Auditimit të Brendshëm duke e cilësuar: “ se veprimtaria e NJAB ka qenë në mos përputhje të plotë me kuadrin rregullator në fuqi”.</i></p> <p>Për vitin 2021 megjithëse me Vendimin e Bordit të Administrimit nr.2 datë 14.01.2021 (me nr.84/2 prot., datë 14.01.2021) është miratuar plani vjetor për këtë vit, për veprimtarinë e NJAB të UMT, e ku janë parashikuar 8 angazhime auditimi, <u>rezulton se nuk është përfunduar e evaduar asnjë mision auditimi.</u></p> <p>Për vitin 2022 nga auditimi rezulton se, nga muaji Gusht i vitit 2021 deri në Shtator të 2022 nuk ka patur asnjë mision auditimi të realizuar dhe nuk ka patur të miratuar as plan pune nga Bordi Administrimit të UMT. Megjithëse nga P/NJAB z. D. M. i emëruar në korrik 2022 (tashmë i larguar me dorëheqje) është arritur të paraqitet e të miratohet një plan pune për periudhën e mbetur shtator –dhjetor 2022 i miratuar me VBA nr.53 datë 27.09.2022 ku janë që të ushtrohen dy misione auditimi të tipit financiar të vlerësuar me risk të lartë në subjektet FM dhe FSHMT rezulton se (edhe sipas Raportit të veprimtarisë së NJAB për vitin 2022): të dy angazhimet e filluara e të planifikuara në planin e punës janë ndërprerë duke mos patur një punë normale raportimi përfundimtar auditimi, duke bërë që kjo NJAB prej tre vjetësh nuk arrin të përfundojë asnjë mision auditimi dhe njëkohësisht nuk arrin as të përmbushë detyrat ligjore funksionale në përmbushje të misionit e qëllimit për të cilën është krijuar.</p>
Kriteri	<p>Ligji nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; Kuadri rregullator ligjor e nënligjorë në fuqi.</p> <p>Statutit të UMT-së pika 3 e nenit 90 ku përcaktohet se NJAB është në varësi direkte të Bordit të Administrimit të UMT-së dhe në pikën 2 të nenit 53 të citohet se: “Njësia e Auditimit të Brendshëm të UMT ka varësi organizative dhe funksionale nga Bordi i Administrimit dhe raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë tek ky i fundit bazuar në legjislacionin në fuqi për auditin e brendshëm publik”.</p>

Ndikimi/Efekti	Mosrealizimi plotë i asnjë misioni auditues nga NJAB për periudhën e Auditimit.
Shkaku	Mos përmbushje e detyrave funksionale ligjore nga ana e Bordit të Administrimit dhe NjAB.
Rëndësia	E lartë
Rekomandim	Bordi i Administrimit i Universitetit të Mjekësisë Tiranë në cilësinë e titullari të NJAB të marrë masat e menjëhershme me qëllim jo vetëm plotësimin e strukturës së NJAB me personelin e nevojshëm por dhe të vlerësimit pas një analizimi të thellë të gjendjes së veprimtarisë së kësaj Njësie Auditimi me qëllim zbatimin (si nga BA dhe nga NJAB) të detyrave funksionale ligjore në përmbushje të misionit e të qëllimit nëpërmjet realizimit të misioneve audituese të nisura, realizuara e të evaduar konform legjislacionit në fuqi.

2.3 Mbi organizimin dhe funksionimin e strukturës organizative dhe administrative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore të punës.

dhe

2.4 Zbatimi i ligjshmërisë gjatë procesit të punësimit të personelit me kohë të plotë dhe të pjesshme, punësimi i personelit të strukturave shëndetësore të UMT si dhe ndjekja e procedurave të largimit të punonjësve nga puna. Vendimet gjyqësore.

Për auditimin e këtyre pikave të Programit të Auditimit, Grupi i auditimit është bazuar në ligjin 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Ligjin nr.10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, Ligjin nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i republikës së Shqipërisë”, dhe ligjeve/rregullave specifike të institucionit që auditohet.

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, është person juridik publik, i njohur me ligj si i tillë. Ai organizohet dhe funksionon në përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor si edhe me rregullat e parashikuara në statut dhe në rregulloret e tij. Personalitet juridik gëzojnë edhe njësitë përbërëse, sipas kufijve të përcaktuar në legjislacionin në fuqi dhe statut.

1. Realizimi i pagave sipas fakulteteve për vitin 2020:

Realizimi i zërit paga dhe kontribute sipas njësive shpenzuese: në lekë.

Nr	Njësitë shpenzuese	Plan Paga	Fakt Paga	Realizimi në %	Plan Kontribute	Fakt Kontribute	Realizimi në %
1	Rektorati	48.588.232	29.273.885	60%	8.109.426	4.824.813	59%
2	FM	543.898.766	341.894.257	63%	68.140.894	50.278.639	74%
3	FMD	61.387.899	40.657.772	66%	9.563.163	6.174.797	65%
4	FSHMT	235.993.867	137.930.739	58%	27.260.823	18.717.524	69%
	TOTALI	889.868.764	549.756.653	61,78%	113.074.306	79.995.773	70,75%

Burimi UMT.

Krahasuar me planin vjetor, për paga dhe sigurime (grand i akorduar në vitin 2020 + i trashëguar+ të ardhurat dytësore) shihet se është shpenzuar 62,79 % e Buxhetit. Shpenzimet sipas zërave janë si më poshtë:

Shpenzimet e pagave janë realizuar në masën 61,78%. Sigurimet shoqërore janë realizuar në masën 70,75%. Shpenzimet e pagave dhe sigurimeve sipas njësive shpenzuese janë realizuar:

Rektorati: Shpenzimet e pagave për Rektoratin janë realizuar në masën 60% dhe zënë 5,3% të shpenzimeve për pagat në UMT. Shpenzimet e Sigurimeve për Rektoratin janë realizuar në masën 59% dhe zënë 6% të shpenzimeve për sigurime në UMT.

FM: Shpenzimet e pagave për Fakultetin e Mjekësisë janë realizuar në masën 63% dhe zënë 62,2% të shpenzimeve për paga në UMT. Shpenzimet e Sigurimeve për Fakultetin e Mjekësisë janë realizuar në masën 74% dhe zënë 62,9% të shpenzimeve për sigurime në UMT.

FMD: Shpenzimet e pagave për Fakultetin e Mjekësisë Dentare janë realizuar në masën 66% dhe zënë 7,4% të shpenzimeve për paga në UMT. Shpenzimet e Sigurimeve për Fakultetin e Mjekësisë Dentare janë realizuar në masën 65 % dhe zënë 7,7 % të shpenzimeve për sigurime në UMT.

FSHMT. Shpenzimet e pagave për FSHMT janë realizuar në masën 58% dhe zënë 25,1% të shpenzimeve për paga në UMT. Shpenzimet e Sigurimeve për FSHMT janë realizuar në masën 69 % dhe zënë 23,4% të shpenzimeve për sigurime në UMT.

2. Realizimi i pagave sipas fakulteteve për vitin 2021:

Realizimi i zërit paga dhe kontribute sipas njësive shpenzuese: në lekë)

Nr	Njësiti shpenzuese	Plan Paga	Fakt Paga	Realizimi në %	Plan Kontribute	Fakt Kontribute	Realizimi në %
1	Rektorati	51.799.235	35.608.546	69%	8.679.457	5.933.342	68%
2	FM	468.840.306	342.575.860	73%	54.977.830	53.417.767	97%
3	FMD	73.249.861	53.884.002	74%	9.837.639	7.057.707	72%
4	FSHMT	158.607.119	134.156.865	85%	27.942.756	19.984.183	72%
	TOTALI	752.496.521	566.225.273	75,25%	101.437.682	86.392.999	85,17%

Burimi UMT.

Krahasuar me planin vjetor, (grand i akorduar në vitin 2021+ i trashëguar + të ardhurat dytësore) shihet se është shpenzuar 76,42 % e Buxhetit. Shpenzimet sipas zërave janë si më poshtë:

Shpenzimet e pagave janë realizuar në masën 75,25%. Sigurimet shoqërore janë realizuar në masën 85,17%. Shpenzimet e pagave dhe sigurimeve sipas njësive shpenzuese janë realizuar:

Rektorati: Shpenzimet e pagave për Rektoratin janë realizuar në masën 69% dhe zënë 6,3% të shpenzimeve për paga në UMT. Shpenzimet e Sigurimeve për Rektoratin janë realizuar në masën 68% dhe zënë 7% të shpenzimeve për sigurime në UMT.

FM. Shpenzimet e pagave për Fakultetin e Mjekësisë janë realizuar në masën 73% dhe zënë 61% të shpenzimeve për pagat në UMT. Shpenzimet e Sigurimeve për Fakultetin e Mjekësisë janë realizuar në masën 97% dhe zënë 62% të shpenzimeve për sigurime në UMT.

FMD . Shpenzimet e pagave për Fakultetin e Mjekësisë Dentare janë realizuar në masën 74% dhe zënë 9,5% të shpenzimeve për paga në UMT. Shpenzimet e Sigurimeve për Fakultetin e Mjekësisë Dentare janë realizuar në masën 72% dhe zënë 8,2% të shpenzimeve për sigurime në UMT.

FSHMT. Shpenzimet e pagave për FSHMT janë realizuar në masën 85% dhe zënë 23,3% të shpenzimeve për paga në UMT. Shpenzimet e Sigurimeve për FSHMT janë realizuar në masën 72% dhe zënë 23,69% të shpenzimeve për sigurime në UMT.

3. Realizimi i pagave sipas fakulteteve për vitin 2022:

Realizimi i zërit paga dhe contribute nga granti buxhetor sipas njësive shpenzuese: (nëlekë)

Nr	Njësiti shpenzuese	Plan Paga	Fakt Paga	Realizimi në %	Plan Kontribute	Fakt Kontribute	Realizimi në %
1	Rektorati	51.960.689	36.526.249	70%	8.776.115	6.083.277	69%
2	FM	444.667.920	362.285.376	81%	64.205.552	56.199.652	88%
3	FMD	57.352.768	50.713.813	88%	8.812.272	7.788.747	88%
4	FSHMT	243.279.714	135.527.787	56%	25.276.909	18.560.204	73%
	TOTALI	797.261.091	585.053.225	73,38%	107.070.848	88.631.880	82,78%

Burimi UMT.

Krahasuar me planinvjetor, planin, (grand i akorduar në vitin 2022+ i trashëguar+ të ardhurat dytësore) shihet se është shpenzuar 74,49% e Buxhetit.

Shpenzimet sipas zërave janë si më poshtë: Shpenzimet e pagave janë realizuar në masën 73,38%; Sigurimet shoqërore janë realizuar në masën 82,78%.

Rektorati: Shpenzimet e pagave për Rektoratin janë realizuar në masën 70% dhe zënë 6 % të shpenzimeve për pagat në UMT. Shpenzimet e Sigurimeve për Rektoratin janë realizuar në masën 69% dhe zënë 7 % të shpenzimeve për sigurime në UMT.

FM: Shpenzimet e pagave për Fakultetin e Mjekësisë janë realizuar në masën 81% dhe zënë 61,9% të shpenzimeve për paga në UMT. Shpenzimet e Sigurimeve për Fakultetin e Mjekësisë janë realizuar në masën 88 % dhe zënë 63% të shpenzimeve për sigurime në UMT.

FMD: Shpenzimet e pagave për Fakultetin e Mjekësisë Dentare janë realizuar në masën 88 % dhe zënë 8,7 % të shpenzimeve për paga në UMT. Shpenzimet e Sigurimeve për Fakultetin e Mjekësisë Dentare janë realizuar në masën 88 % dhe zënë 9 % të shpenzimeve për sigurime në UMT.

FSHMT: Shpenzimet e pagave për FSHMT janë realizuar në masën 56% dhe zënë 23,2% të shpenzimeve për pagat në UMT. Shpenzimet e Sigurimeve për FSHMT janë realizuar në masën 73% dhe zënë 21% të shpenzimeve për sigurime në UMT.

Viti 2020							
Njësia	Numri i Punonjësve Efektivë				Numri i Punonjësve me kontratë		
	Plan	Faktderi 31.12.2020			Plan	Faktderi 31.12.2020	
	Punonjës Gjithsej	Punonjës Gjithsej	Punonjës Akademik	Punonjës Ndhimës Administrate	Punonjës Gjithsej	Punonjës Gjithsej	Pedagogë të Jashtëm
Rektorati	59	41	0	41	0	0	0
FMD	45	36	21	15	149	149	93
FMSHT	130	111	68	43	0	0	0
FM	314	259	196	63	268	266	266
Totali	548	447	285	162	417	415	359

Burimi UMT.

Viti 2021							
Njësia	Numri i Punonjësve Efektivë				Numri i Punonjësve me kontratë		
	Plan	Fakt deri 31.12.2021			Plan	Fakt deri 31.12.2021	
	Punonjës Gjithsej	Punonjës Gjithsej	Punonjës Akademik	Punonjës Ndhimës Administrate	Punonjës Gjithsej	Punonjës Gjithsej	Pedagogë të Jashtëm
Rektorati	59	45	0	45	0	0	0
FMD	45	41	22	19	160	160	100
FMSHT	130	107	68	39	0	0	0
FM	314	302	236	66	274	100	100
Totali	548	495	326	169	434	260	200

Burimi UMT.

Viti 2022							
Njësia	Numri i Punonjësve Efektivë				Numri i Punonjësve me kontratë		
	Plan	Fakt deri 31.12.2022			Plan	Fakt deri 31.12.2022	
	Punonjës Gjithsej	Punonjës Gjithsej	Punonjës Akademik	Punonjës Ndhimës Administrate	Punonjës Gjithsej	Punonjës Gjithsej	Pedagogë të Jashtëm
Rektorati	59	48	0	48	0	0	0
FMD	45	42	22	20	161	161	100
FMSHT	130	107	66	41	0	0	0
FM	314	278	203	75	264	54	54
Totali	548	475	291	184	425	215	154

Burimi UMT.

-Nga auditimi rezultoi se për vitet 2020, 2021 dhe 2022, Universiteti Mjekësor i Tiranës, ka pasur dhe vazhdon të ketë mungesë të theksuar të stafit akademik. Kjo mangësi në stafin akademik të Universitetit Mjekësor të Tiranës, në vlerësim të grupit të auditimit, mund të ketë sjellë pasoja në zhvillimin me kohë të plotë të orëve mësimore sipas programeve studimore me rezultat mosarritjen e pritshmërive në mësimdhënie.

-Lidhur me angazhimin e Rektorit dhe Zv/Rektorit të Universitetit të Mjekësisë në mësimdhënie.

-Nga auditimi i listpagesave të dorëzuara pranë grupit të auditimit, për periudhën e auditimit, rezultoi se Rektori i Universitetit të Mjekësisë z. A.G, figuron në listpagesat e FM tek Departamenti i Kirurgjisë si staf akademik me kohë të plotë. Referuar listprezencave përmbledhëse mujore të Fakultetit të Mjekësisë, të mbajtura si ato me nr. 17/288 Prot., datë 09.01.2020, nr. 371/2 Prot., datë 05.02.2020, nr. 782/2 Prot., datë 03.03.2020 e në vazhdim deri në këtë periudhë të auditimit, Rektori z. A.G, rezulton të jetë i punësuar me orar të plotë, në pozicionin e pedagogut në Departamentin e Kirurgjisë të FM të Universitetit Mjekësor të Tiranës. E njëjta situatë evidentohet edhe për Zv/Rektorët znj. A. B., znj. S. K. dhe znj. Alma I. për periudhën 2020 e në vazhdim. Znj. A. B., rezulton të jetë në listpagesat dhe listprezencat e FM në pozicionin pedagoge në Departamentin e Laboratorëve me orar të plotë në mësimdhënie. Znj. S. K. rezulton të jetë në listpagesat dhe listprezencat e FM në pozicionin pedagoge në Departamentin e Farmacisë me orar të plotë në mësimdhënie dhe znj. A.I. rezulton të jetë në listpagesat dhe listprezencat e FM në pozicionin pedagoge në Departamentin e Sëmundjeve të Brendëshme me orar të plotë në mësimdhënie. Stafi i mësipërm, është staf administrativ i Rektoratit të Universitetit të Mjekësisë dhe jo staf akademik siç figuron në listpagesat dhe listprezencat e FM të Universitetit të Mjekësisë Tiranë. Në të njëjtën kohë që ky staf është paraqitur në listprezencat e Fakultetit të Mjekësisë, për të gjithë periudhën e auditimit, u konstatua se Rektori dhe Zv/Rektorët e Rektoratit të Universitetit të Mjekësisë, janë edhe në listprezencat e Rektoratit por jo në listpagesat e Rektoratit. Listprezencat e Rektoratit ku evidentohet qartazi se Rektori dhe Zv/Rektorët janë konfirmuar si prezent me kohë të plotë në pozicionet në të cilat janë dekretuar ose emëruar, janë të nënshkruara (punuara) nga specialistja e burimeve njerëzore të Rektoratit znj. A. N.dhe (miratuara) nga Drejtori i Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore z. E.H. Nga auditimi i listprezencës së ndodhur në dosjet respektive të pagave për Fakultetin e Mjekësisë dhe për stafin administrativ të Rektoratit të Universitetit të Mjekësisë Tiranë për periudhën objekt auditimi, u konstatua se në listprezencat e stafit të Rektoratit, janë paraqitur si prezent në punë me orar me kohë të plotë edhe Rektori edhe Zv/Rektorët. Nuk ka asnjë mundësi fizike që personat e mësipërm, pjesë të stafit administrativ të Universitetit Mjekësor të Tiranës, në pozicionet drejtuese të IAL-ve publike, të jenë prezent në detyrat e tyre të ngarkuara me ligj sipas pozicioneve në emërimin e tyre, në të njëjtën kohë që janë të angazhuar me kohë të plotë në mësimdhënie në Departamentet përkatëse të Fakultetit. Ligji për arsimin e lartë, i ngarkon Rektorit dhe Zv/Rektorit, të kryejnë detyrat në funksion të mirëadministrimit të institucionit të UMT-së. Bazuar në listpagesat e vëna në dispozicion të grupit të auditimit, rezulton se Rektori dhe Zv/Rektori kryejnë detyrat e pedagogut dhe jo detyrat që u janë ngarkuar me ligj. Edhe sipas udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Kapitulli II, pika (5), “Për autoritetet drejtuese të IAL-ve publike, mësimdhënia vjetore në auditor është”: (a)-Rektori 50 orë mësimore, (b)-Zëvendës Rektori 60 orë mësimore, (c)-Dekani 70 orë mësimore, (d)-Zëvendës Dekani 90 orë mësimore dhe (e)-Përgjegjës Departamenti 90 orë mësimore. Pra mësimdhënia është e lejuar për orare të caktuara dhe jo me kohë të plotë (full-time). Pra, rezulton se Autoritetet Drejtuese të Universitetit të Mjekësisë Tiranë, paguhen për funksione dytësore dhe jo për funksione parësore ndërkohë që ligji i ka ngarkuar përmbushjen e detyrave në funksionet parësore, kjo edhe për vetë rëndësinë në nivel kombëtar që ka Universiteti i Mjekësisë në Shqipëri, i cila obligon një nivel menaxhimi me kohë të plotë sipas kërkesave të ligjit.

-Është për tu përmendur fakti se në listpagesat e stafit akademik, nuk ka asnjë të dhënë nëse ky staf akademik këtë punë pra të pedagogut, e ka punë parësore apo punë dytësore pasi në këto

listpagesa, të gjithë mjekët rezultojnë me kohë të plotë në angazhimet e tyre akademike në fakultetet përkatëse.

-Lidhur me largimet dhe rekrutimet në punë.

a) Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të personelit administrativ të Universitetit të Mjekësië Tiranë, u konstatuan parregullsi në mënyrën e ndjekjes së procedurave për largimin e punonjësve nga puna. Përsa i përket punonjësës L.L. në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Prokurimeve*”, u konstatua se është lidhur kontrata e punës me nr. 2560/11 Prot., datë 24.10.2022, midis punonjësës L.L dhe Universitetit Mjekësor të Tiranës përfaqësuar nga Administratori znj. S.S. Procedura e rekrutimit, është ndjekur me korrektësi por procedura e shkëputjes së kontratës së punës, ka mangësi. Konkretisht, në dosjen personale u evidentua se në datën 05.01.2023, në orën 12:52, nga punonjësja L. K. (Ll.), është dërguar një e-mail drejtuar Administratorit të UMT znj. S.S, zyrës së burimeve njerëzore të UMT, znj. S. P. me detyrë specialiste tek Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore dhe znj. N.D me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse të UMT. Me anë të këtij e-maili, punonjësja njofton UMT për hapat e ndjekur për dorëzimin e dorëheqjes në institucion dhe bashkangjitur ka dërguar edhe kërkesën për dorëheqje. Në vazhdim, i është komunikuar me e-mail nga znj. N.D që të paraqitet në punë për të ndjekur procedurat e dorëzimit të detyrës pas dorëheqjes së dhënë. Me shkresën nr. 1907/20 Prot., datë 06.01.2023, Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse të UMT-së, njofton Administratorin e UMT-së znj. S.S për dorëheqjen e dhënë nga punonjësja L.L dhe kërkesat që i janë adresuar për paraqitjen në punë. Me shkresën nr. 95 Prot., datë 12.01.2023, nga Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse znj. N.D, është dërguar një relacion tek Administratori i UMT-së lidhur me konstatimin e shkeljeve për punonjësën L.L. Me shkresën përcjellëse me datë 13.01.2023, Administratori znj. S.S, kërkon trajtimin e relacionit për shkeljet e punonjësës dhe hartimin e urdhrin për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës për specialisten znj. Ll., nga Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore. Nga ana e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore në UMT, në datën 17.01.2023 ora 12:46, është dërguar një e mail drejtuar Administratorit të UMT-së ku është bashkangjitur dhe një draft-urdhër për përfundimin e marrëdhënieve të punës të punonjësës. Në vazhdim, Administratori i UMT-së znj. S.S ka nxjerr urdhrin nr. 13 sipas shkresës me nr. 95/1 Prot., datë 17.01.2023, me anë të të cilit ka urdhëruar “*Zgjidhjen e menjëhershme të kontratës individuale të punës së punëmarrëses znj. L.L.....*” referuar edhe relacionit nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse me nr. 95 Prot., datë 12.01.2023. Vlen të theksohet fakti se draft-urdhri i dërguar nga Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore dhe urdhri i konceptuar dhe nënshkruar nga Administratori i UMT-së për lirimin nga puna të punonjësës, nuk përmendin faktin se punonjësja ka dhënë dorëheqjen nga puna dhe cdo veprim i mëvonshëm nga UMT pas dhënies së dorëheqjes së punonjësës (e cila nuk është marrë në konsideratë nga UMT), vetëm sa sjell pasoja negative për UMT-në. As e-maili dërguar nga Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore drejtuar Adminsitrorit të UMT-së, nuk cilëson në asnjë rresht se punonjësja ka dhënë dorëheqjen me e-mail drejtuar po të njëjtës Drejtori pra Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore. Si rezultat, edhe draft-urdhri i hartuar nga Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore, duhej të cilësonte datën dhe orën e e-mailit të dërguar për dorëheqje nga punonjësja dhe jo relacionin me shkeljet e konstatuara vetëm nga Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse të UMT-së, për më tepër që këto shkelje, punonjësës nuk i janë bërë me dije nga ana e UMT-së. Në dosjen personale të punonjësës, nuk u evidentua ndonjë korespondencë midis punonjësës dhe UMT-së përveç korespondencave të cilësuar më sipër. Drejtoria e Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore, nuk ka administruar me kujdes rastin e

mësipërm duke riskuar negativisht në buxhetin e UMT-së pasi nëse do ishte marrë në konsideratë dorëheqja e dhënë nga punonjësja (draft-urdhri i hartuar nëse do t'i referohej dorëheqjes), nuk do të kishim vendimin nga Administratori për shkëputje të menjëherëshme nga puna por thjesht ndërprerje të marrëdhënieve të punës me dëshirën e punëmarrësit. Në këto kushte, pas vënies në dijeni të këtyre fakteve, punonjësit të larguar në mënyrë jo korrekte, i lind e drejta për të kërkuar dëmshpërblimin nga institucionet përkatëse e për pasojë, nga ana e UMT-së, është rritur risku për një dëm të mundshëm ekonomik për të paktën 2 paga mujore ose në vlerën e afro 130,000 lekë (vetëm për mos respektim të procedurave për largim) duke dëmtuar në këtë mënyrë buxhetin e shtetit. Sa më sipër, mban përgjegjësi ish Administratori i UMT-së znj. S.S pa shmangur këtu edhe përgjegjësinë respektive të stafit të Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore por edhe të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse në UMT, për mosveprimet e tyre.

b) Lidhur me shkëputjen e marrëdhënieve të punës me punonjësen znj. A. H. Nga auditimi rezultoi se kontrata individuale e punës e nënshkruar midis punonjësës dhe UMT-së, është me nr. 271/1 Prot., datë 12.02.2018.

Me shkresën nr. 2183 Prot., datë 28.09.2020, punonjësja i ka kërkuar UMT-së, shtyrjen e lejes (1 muaj) pa të drejtë page.

Me e-mailin e datës 01.10.2020, ora 01:18, dërguar z. S.O me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore, z. E. H. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore dhe z. A.G me detyrë Rektor i UMT-së, punonjësja znj. A. H. cilëson se: *“Në vijim të miratimit bga Rektori të lejes vjetore që kam kryer gjatë kësaj periudhe, kam pasur një problem shëndetësor dhe kam paraqitur pranë jush një raport mjekësor për 5 ditë. Duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj dhe në bazë, ju lutem të më shtyhen ditët e raportit direct pas datës 29 që duhet të paraqitesha në punë. Gjithashtu nëpërmjet këtij e-maili, po në bazë të VKM nr.115, pika 10, paraqes zyrtarisht dhe kërkesën për leje (30 ditë) pa të drejtë page”*.

Në vijim me e-mailin e datës 02.10.2020, ora 07.34, z. S.O me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore, i dërgon përgjigje punonjësës së mësipërme dhe i cilëson se: *“Në vijim të e-mailit tuaj, bazuar në kodin e punës, ju informojmë se raporti dhe dita e festës zyrtare janë spostuar sipas procedurës ligjore dhe në datën 06.10.2020, ora 08:00, duhet të paraqitesh në punë. Kërkesën për leje pa të drejtë page pas diskutimit me drejtorin juridik dhe rektorin nuk miratohet pasi e-maili i dërguar nga ana juaj nuk plotëson kriteret conform parashikimit të kodit të punës (neni 96) Sipas diskutimit të bërë nga grupi i punës në qoftë se nuk paraqiteni në punë në datën 06.10.2020, do tju ndërpriten marrëdhëniet e punës.”*

Urdhri për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me punëmarrësin znj. A.H. dhe UMT-së, është me nr. 112, datë 26.10.2020 dhe shkresë nr. 2183 Prot., datë 26.10.2020.

Sa më sipër, nuk u evidentua në dosjen personale të punonjësës, ndonjë dokument ligjor tek i cili të cilësoheshin shkaqet lidhur me vendimin e marrë nga Rektori i UMT-së për ndërprerje të marrëdhënieve të punës ose ndërprerje të kontratës së punës me punëmarrësin. Tek vendimi për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me punonjësen, cilësohet korespodenca me e-mail midis punonjësës dhe UMT-së por tek kjo korespodencë nuk ka asnjë të dhënë që punonjësja të ketë kërkuar dorëheqjen ose që punonjësja nuk është paraqitur në punë. Fakti që Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore i cilëson se nëse nuk paraqitet në punë në datën 06.10.2020, punonjësës do ti ndërpriten marrëdhëniet e punës, nuk do të thotë se punonjësja nuk është paraqitur në vendin e punës. Rektori i UMT-së për të vërtetuar këtë fakt pra që punonjësja ka munguar për një periudhë të gjatë, duhej të përcaktonte një komision monitorimi nga i cili pasi të merrte një raport monitorimi ku të vërtetohej se punonjësja ka munguar, atëherë mund të nxirrte edhe

urdhrit/vendimin për shkëputje të marrëdhënieve të punës bazuar tek fakte dhe dokumenta ligjorë dhe jo vetëm tek cilësimet e njëanshme të një personi të vetëm sic janë ato të Përgjegjësit të Sektorit të Burimeve Njerëzore.

-Lidhur me zbatimin e ligjshmërisë gjatë procesit të punësimit të personelit me kohë të pjesëshme.

Nga auditimi i disa praktikave të ndjekura nga UMT për punësimin e personelit me kohë të pjesëshme, u konstatua:

-FM. Për vitin akademik 2020-2021, u vendosën në dispozicion të grupit të auditimit, kontratat me nr. 1795/3 dhe nr. 1795/4 Prot., datë 30.07.2021, midis FM dhe pedagogëve znj. B. A. dhe znj. D. L., për punësimin e tyre me kohë të pjesëshme (pedagogë të jashtëm për një vit akademik) në Departamentin e Laboratorëve. Për vitin akademik 2021-2022, kontratat me nr. 2238/10 dhe nr. 2238/13 Prot., datë 06.09.2022, midis FM dhe pedagogëve znj. J. K. dhe znj. A. K., për punësimin e tyre me kohë të pjesëshme (pedagogë të jashtëm për një vit akademik) në Departamentin e Kirurgjisë.

-Fakulteti Mjekësisë Dentare. Për vitin akademik 2020-2021, u vendosën në dispozicion të grupit të auditimit, kontratat me nr. 1945/54 dhe nr. 1945/52 Prot., datë 07.09.2021, midis FMD dhe pedagogëve znj. Z. B. dhe znj. K. Sh., për punësimin e tyre me kohë të pjesëshme (pedagogë të jashtëm për një vit akademik) në Departamentin e Lëndëve Biomjekësore. Për vitin akademik 2021-2022, kontratat me nr. 1948/1 dhe nr. 1948/2 Prot., datë 25.07.2022, midis FMD dhe pedagogëve z. B. S. dhe z. L. Xh., për punësimin e tyre me kohë të pjesëshme (pedagogë të jashtëm për një vit akademik) në Departamentin e Lëndëve Formuese.

-FSHMT. Për vitin akademik 2020-2021, u vendosën në dispozicion të grupit të auditimit, kontratat me nr. 2248/215 dhe nr. 2248/216 Prot., datë 04.10.2021, midis FSHMT dhe pedagogëve z. F.C. dhe znj. E. M., për punësimin e tyre me kohë të pjesëshme (pedagogë të jashtëm për një vit akademik) në Departamentin e Diagnostikës, Rehabilitimit Shëndetësor dhe Infermieristikave në Kirurgji dhe Infermieristikave në Obsetrik Gjinekologji. Për vitin akademik 2021-2022, kontratat me nr. 1658/233 dhe nr. 1658/235 Prot., datë 23.06.2022, midis FSHMT dhe pedagogëve z. I. T. dhe znj. H. G., për punësimin e tyre me kohë të pjesëshme (pedagogë të jashtëm për një vit akademik) në Departamentin e DLKPIISBP-së.

-Sa më sipër, konstatohet se kontratat e nënshkruara midis Universitetit të Mjekësisë dhe pedagogëve të shpallur fitues të procedurave të rekrutimit për vitet përkatëse akademike, janë nënshkruar pas përfundimit të vitit akademik. Pra, pedagogët e jashtëm të kontraktuar nga Fakultetet përkatëse, kanë dhënë mësim tek studentët përkatës sipas cikleve të studimit dhe njëkohësisht janë likujduar për këto orë mësimi, pa pasur në fillim një kontratë pune me Fakultetin përkatës.

-Pedagogët e jashtëm, kanë kryer punën e pedagogut dhe njëkohësisht kanë certifikuar studentët për lëndët mësimore të dhëna ndaj tyre, pa patur marrëdhënie pune ligjore (pasi kontratat rezultojnë të nënshkruara pas kryerjes së mësimdhënies me efekt prapaveprues) me UMT. Kjo gjë, përveç faktit që sjell parregullsi të karakterit ekonomik-administrativ në Universitetin e Mjekësisë, njëkohësisht, mund të krijojë dhe probleme juridike në të ardhmen, lidhur me vlefshmërinë e shërbimit të mësimdhënies. Gjithashtu, ky shërbim, i ligjësuar pas kryerjes së tij, e bën të pamundur kontrollin konform legjislacionit në fuqi për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin si nga Auditi i Brendshëm ashtu edhe nga ai i Jashtëm, në kohën e ofrimit të këtij shërbimi.

Titulli i Gjetjes:	Mosplotësim i organikës
Situata:	Nga auditimi rezultoi se për vitet 2020, 2021 dhe 2022, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, ka pasur dhe vazhdon të ketë mungesë të theksuar të stafit akademik. Konkretisht për vitin 2020, UMT ka mosplotësim organike për 71 nëpunës (punonjës akademike dhe ndihmës) ose 13% më pak se plani, për vitin 2021 ka 53 punonjës më pak ose 10% më pak dhe për vitin 2022 ka 73 punonjës më pak ose 13%, në kundërshtim me strukturën organike të miratuar. Kjo mangësi në stafin akademik dhe ndihmës akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, në vlerësim të grupit të auditimit, mund të ketë sjellë pasoja në zhvillimin me kohë të plotë të orëve mësimore sipas programeve studimore me rezultat mosarritjen e pritshmërive në mësimdhënie.
Kriteri:	Struktura organike e miratuar.
Ndikimi/Efekti:	Mund të ketë sjellë pasoja në zhvillimin me kohë të plotë të orëve mësimore sipas programeve studimore me rezultat mosarritjen e pritshmërive në mësimdhënie.
Shkaku:	Mosplotësimi i strukturës organike.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandim:	Nga ana e UMT të merren masa për plotësimin e strukturës me qëllim pakësimin e stafit akademik të kontraktuar me kohë të pjesshme, për rritjen e pritshmërive në mësimdhënie.

Titulli i Gjetjes:	Stafi Drejtues i Universitetit të Mjekësisë, nuk rezultoi të kryejë detyrat e tij funksionale sipas ligjeve dhe rregullave në fuqi.
Situata:	Nga auditimi në Universitetin e Mjekësisë Tiranë, të listprezencave dhe listpagesave për periudhën e auditimit, rezultoi se Rektori, figuron në Fakultetin e Mjekësisë, Departamentin e Kirurgjisë, si staf akademik me kohë të plotë. E njëjta situatë evidentohet edhe për zëvendës rektorët, për periudhën 2020 e në vazhdim. Stafi i mësipërm, është staf administrativ i Rektoratit të Universitetit të Mjekësisë Tiranë dhe jo staf akademik siç figuron në listpagesat dhe listprezencat e Fakultetit të Mjekësisë. Nga auditimi i listprezencës së ndodhur në dosjet respektive të pagave për Fakultetin e Mjekësisë dhe për stafin administrativ të Rektoratit të Universitetit të Mjekësisë Tiranë, për periudhën objekt auditimi, u konstatua se në listprezencat e stafit të Rektoratit, <u>janë paraqitur si prezent në punë me orar me kohë të plotë edhe Rektori edhe zëvendës rektorët</u> . Nuk ka asnjë mundësi fizike që personat e mësipërm, pjesë të stafit administrativ të Universitetit Mjekësor të Tiranës, në pozicionet drejtuese të IAL-ve publike, të jenë prezent në detyrat e tyre të ngarkuara me ligj sipas pozicioneve në emërimin e tyre, në të njëjtën kohë që janë të angazhuar me kohë të plotë në mësimdhënie në Departamentet përkatëse të Fakultetit. Ligji për arsimin e lartë, i ngarkon Rektorit dhe zëvendës rektorëve, të kryejnë detyrat në funksion të miradministrimit të institucionit të UMT-së. Rektori dhe zëvendës rektorët kryejnë në realitet, detyrat e pedagogut dhe jo detyrat që u janë ngarkuar me ligj. Nga sa është konstatuar nga grupi i auditimit, rezultoi se Autoritetet Drejtuese të Universitetit të Mjekësisë Tiranë, paguhen për funksione dytësore dhe jo për funksione parësore ndërkohë që ligji i

	ka ngarkuar përbushjen e detyrave në funksionet parësore, kjo edhe për vetë rëndësinë në nivel kombëtar që ka Universiteti i Mjekësisë në Shqipëri, i cili obligon një nivel menaxhimi me kohë të plotë sipas kërkesave të ligjit. Angazhimi i Stafit Drejtues administrativ të UMT-së, në mësimdhënie, me kohë të plotë, në gjykim të grupit të auditimit ka krijuar/mund të ketë krijuar pasoja në miradministrimin e detyrave që ligji i ngarkon këtyre pozicioneve.
Kriteri:	Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 39. Udhëzimi nr. 29, datë 10.09.2018 i MAS, Kapitulli II, pika (5). Ligji nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, kreu II, neni 8, “Përgjegjshmëria menaxheriale e Titullarit”.
Ndikimi/Efekti:	Mungesa vazhdimisht e Stafit Drejtues në Rektorat, në orarin zyrtar të punës, bëhet shkak për administrim në nivele të ulta të institucionit.
Shkaku:	Mospërbushje e detyrave të ngarkuara nga Ligji, nga stafi drejtues i institucionit.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandim:	Universiteti i Mjekësisë Tiranë, Drejtoria Ekonomike, Sektori i Financës, të marrin masat, që stafi drejtues i institucionit, të pasqyrohet në listpagesat e Rektoratit të Universitetit sipas pozicioneve të tyre ligjore dhe jo në listpagesat e fakulteteve të cilat janë në varësi të Universitetit.
Rekomandim:	Rektorati i Universitetit të Mjekësisë, Bordi i Administrimit, Senati Akademik, Drejtoria e Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore, të marrin masat që Rektori dhe zëvendës rektorët, të angazhohen me kohë të plotë në detyrat e tyre parësore, të ngarkuara nga ligji dhe në mësimdhënie, si detyrë dytësore.

Titulli i Gjetjes:	Shkëputje e kontratave të punës, pa respektuar hapat ligjor.
Situata:	Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të personelit administrativ të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, u konstatuan parregullsi në mënyrën e ndjekjes së procedurave për largimin e punonjësve nga puna. Në dy raste, nuk është vepruar sipas dispozitave të Kodit të Punës. Në të dy rastet, nuk u evidentua në dosjen personale të secilit punonjës, ndonjë dokument ligjor tek i cili të cilësoheshin shkaqet lidhur me vendimet e marra nga UMT për ndërprerje të marrëdhënieve të punës ose ndërprerje të kontratës së punës me punëmarrësit. Tek vendimet për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, cilësohet korrespondenca me e-mail midis punonjësve dhe UMT-së por tek kjo korrespondence nuk ka asnjë të dhënë që punonjësit të jenë njoftuar paraprakisht për shkëputje të marrëdhënieve të punës, konform Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë.
Kriteri:	Ligji nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, neni 144 “Procedura e zgjidhjes së kontratës së punës nga punëdhënësi”.
Ndikimi/Efekti:	Mund të shkaktojë dëme ekonomike në të ardhmen për buxhetin e shtetit.
Shkaku:	Mospërbushje e detyrave të ngarkuara nga Ligji, nga stafi drejtues i institucionit.
Rëndësia:	E Lartë

Rekomandim:	Universiteti i Mjekësisë Tiranë, Rektori, Administratori, Drejtorja e Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore, të marrin masat që në vazhdimësi, për shkëputje të marrëdhënieve të punës me punonjësit e Universitetit të Mjekësisë, të respektohen procedurat e duhura ligjore dhe hapat e nevojshëm për të shmangur çdo lloj dëmshpërblimi në dëm të buxhetit të shtetit, që punonjësit e larguar padrejtësisht, mund të kërkojnë.
--------------------	---

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 1421/31 Prot., datë 30.11.2023, (numri i komentit 1421/26 Prot., datë 24.11.2023) protokolluar në KLSH me shkresën nr. 401/16 Prot., datë 01.12.2023, nga A.G, ku në mënyrë të përmbledhur, cilësohet se:

1. *“Në faqen nr. 40 të Projekt Raportit tuaj, observoj si më poshtë..... Sa është rekomanduar më sipër, shprehem dakord me rekomandimin që Autoritetet Drejtuese të UMT-së,duhet të jenë në listprezencat dhe listpagesat e Rektoratit dhe jo në listpagesat e Fakultetit..... Por nuk shprehem dakord me gjetjen se stafi drejtues nuk rezulton të kryejë detyrat e tij funksionale , realizohet nga ASCAL-i, i cili pasi ka kryer procesin e vlerësimit për akreditimin e UMT-së dhe të programeve të studimit që ai ofron, ka marrë vendimin për akreditimin institucional të UMT-së në afatin maksimal 6 vjeçar”.*

2. *“Në faqen nr. 42 të Projekt Raportit (për të cilin është mbajtur Akt Konstatimi nr. 13), observoj si më poshtë..... Në rastin në fjalë, konkretisht për punonjësen A. H. personel ndihmës akademik, rezulton që ajo të mos jetë paraqitur në punë..... ”.*

3. *“Në faqen nr. 54 dhe 62 të Projekt Raportit (për të cilat është mbajtur Akt Konstatimi nr. 13), observoj si më poshtë..... Së pari, gjetjet bien në kundërshtim me njëra tjetrën pasi fillimisht thuhet se..... Së dyti sa i përket kësaj gjetje, rezulton se sekretarja e Senatit..... ”.*

4. *“Në faqen nr. 56 dhe nr. 57 të Projekt Raportit (për të cilat është mbajtur Akt Konstatimi nr. 13), observoj si më poshtë..... Lidhur me këtë gjetje, ky rekomandim do të mbahet parasysh që për çdo Aneks Marrëveshje..... ”.*

5. *“Në faqen nr. 56 dhe nr. 57 të Projekt Raportit (për të cilat është mbajtur Akt Konstatimi nr. 13), observoj si më poshtë..... Lidhur me këtë gjetje observoj se, punësimi i personelit akademik me kohë të pjesëshme në institucionet publike të arsimit të lartë, bëhet në përputhje mePunësimi i personelit akademik me kohë të pjesëshme bëhet i mundur vetëm pasi të ketë përfunduar procesi i regjistrimit të studentëve në ciklin e parë, në ciklin e dytë dhe të integruar të ciklit të dytë të studimeve, proces i cili përfundon rreth mesit të muajit Nëntor”.*

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Asnjë nga pretendimet tuaja nuk mund të merret në konsideratë në hartimin e këtij raporti auditimi. Gjetjet e grupit të auditimit janë të argumentuara dhe apsolutisht të gjitha të bazuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Dokumentacioni që keni sjellë bashkalidhur observacionit tuaj, është i njëjtë me atë që grupi i auditimit ka pasur në dispozicion dhe që e ka përshkruar në aktin e mbajtur. Me këtë observacion, nuk keni sjellë dokumenta dhe fakte shtesë. Lidhur me ASCAL-në, ju sqaroj se nuk ka mision auditimi e menaxhimit të fondeve publike por akreditimin e cikleve të studimit. Lutem lexoni misionin dhe veprimtarinë e ASCAL tek <https://ëëë.ascal.al/sq/rreth-nesh/misioni-dhe-veprimtaria> dhe <https://ëëë.ascal.al/sq/akreditimi/procedurat-e-vleresimit-dhe-akreditimit>. Nuk mund të krahasoni Kontrollin e Lartë të Shtetit, me asnjë institucion tjetër qoftë ky edhe me mision auditimi. KONTROLI I LARTË I SHTETIT, është KONTROLI I LARTË I SHTETIT. Lidhur me punësimin e personelit akademik me kohë të pjesëshme, lutem referojuni trajtimit të gjetjes tek i

cili cilësohet në mënyrë eksplicite se Vendimi i Emërimit të një punonjësi, nuk ka asnjë mundësi ligjore që të ketë fuqi prapavepruese. Lidhur me cilësimet tuaja se gjetjet bien në kundërshtim me njëra tjetrën, lutem referojuni ligjit nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, tek i cili do të surprizoheni kur të kuptoni se grupi i auditimit i referohet emërimit “Procesverbal i mbledhjes” në kuptimin e procesverbalit të mbajtur në momentin/orën e zhvillimit të mbledhjes dhe që ka të bëjë me prezencën e antarëve të organeve kolegjiale dhe me një përmbledhje se çfarë u diskutua. Kurse emërtimi “Procesverbal i zbardhur” është diçka tjetër dhe nuk ka lidhje me emërtimin e parë. Lidhur me observacionin e ardhur me nr. 1421/30 Prot., datë 30.11.2023 nga S.O dhe E.H, vlejné njësoj sqarimet si më lart ndaj nuk po cilësojmë observimin pasi janë cilësuar rast pas rasti të gjitha pretendimet.

2.5 Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e organeve dhe strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.

Universiteti i Mjekësisë Tiranë, është Institucion i Arsimit të Lartë i krijuar në përputhje me Ligjin Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në përbërje të së cilit janë 3 (tre) Njësi Kryesore e konkretisht Fakultetiti i Mjekësisë, FMD dhe FSHMT. Të tre fakultetet janë njësi kryesore të rregjistruara me NIPT më vete dhe përfitojnë të ardhura nga Buxheti i Shtetit dhe si të tilla ato planifikojnë dhe prokurime publike nga këto fonde për mallra, punë apo shërbime që i nevojiten atyre, duke u rregjistruar rregullisht në regjistrin elektronik të autoriteve kontraktore pranë APP-së sipas rregjistrave të parashikimeve në përputhje dhe me Ligjin 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe akteve nënligjore të dala për zbatim të tij. Sipas Ligjit Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Neni 18, “Universiteti”; Neni 51, “Administratori i institucionit të arsimit të lartë”; Neni 52, “Funksionet e administratorit”; Neni 53, “Administratori i njësisë kryesore”;

Lidhur me emërimet dhe funksionimin e organeve dhe strukturave drejtuese, nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit, u konstatua:

-Rektori i Universitetit të Mjekësisë, është Dekretuar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me Dekretin me nr. 9615, datë 26.05.2016, për një mandat 4 vjecar. Në vazhdim, është Dekretuar përsëri nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me Dekretin me nr. 11657, datë 24.08.2020, edhe për një mandat të dytë 4 vjecar.

-Zv/Rektori, për anën mësimore në UMT, znj. A.K, është emëruar me vendimin nr. 83, të Senatit Akademik, sipas shkresës me nr. 2249/3 Prot., datë 07.10.2020.

-Zv/Rektori, për anën shkencore dhe promovimit të personelit në UMT, znj. S.K., është emëruar me vendimin nr. 84 të Senatit Akademik, sipas shkresës me nr. 2249/4 Prot., datë 07.10.2020.

-Zv/Rektori për anën klinike, diagnostike dhe të projekteve në UMT, znj. A.I., është emëruar me vendimin nr. 85 të Senatit Akademik, sipas shkresës me nr. 2249/5 Prot., datë 07.10.2020.

-Senati Akademik, është emëruar me vendimin e konstituimit nr. 71, sipas shkresës me nr. 196/3 Prot., datë 09.09.2020, pas vendimit për shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve për antarët e Senatit Akademik. Në vazhdim është ndryshuar anëtari i Senatit Akademik (kategoria student) znj. F. H. me z. K.T sipas vendimit nr. 28, konform shkresës nr. 407/6 Prot., datë 30.03.2021.

Përbërja e Senatit Akademik është: z. A.G Kryetar, z. A.D, z. X.D, znj. E.P, z. E.P, z. A.B, z. A.D, z. S.X, znj. A.K, z. F.T, z. A.C, z. J.B dhe z. D.Tsi përfaqësues të Fakultetit të Mjekësisë, znj. F.K, z. E.P, znj. I.Z dhe znj. V.S si përfaqësues të Fakultetit të Shkencave Mjekësore, z. R.I dhe z. E.X si përfaqësues të FMD , z. A.Adhe z. K.T si përfaqësues të studentëve.

-Bordi i Administrimit, është emëruar me vendimin e konstituimit nr. 64, sipas shkresës me nr. 3042/1 Prot., datë 22.11.2021, pas vendimit për shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve për antarët e Bordit të Administrimit. Në vazhdim janë ndryshuar anëtarët e Bordit të Administrimit (përfaqësues të MASH) z. E.X, znj. R.D dhe znj. A.S me znj. A.G, z. A.T dhe znj. Z.G, sipas vendimit nr. 450, konform shkresës së MASH me nr. 6549 Prot., datë 16.11.2021. Bordi i Administrimit, është i përbërë nga: znj. M.F dhe znj. V.O si përfaqësues të Fakultetit të Mjekësisë, z. A.X si përfaqësues i Fakultetit të Shkencave Mjekësore dhe FMD , znj. A.G, z. A.T dhe znj. Z.G si përfaqësues të MASH (Kryetare) dhe z. E.Y si përfaqësues i studentëve.

-Vendimet e Bordit të Administrimit për vitet 2020, 2021 dhe 2022, jepen në aneksin nr.5, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Nga auditimi me zgjedhje i disa vendimeve të marra nga Bordi i Administrimit, për periudhën objekt auditimi, rezultoi si në vijim:

Lidhur me rregullshërinë e zhvillimit të mbledhjeve të Bordit të Administrimit.

-Nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit, u konstatua se deri në dhjetor të vitit 2022, Bordi i Administrimit, ka nënshkruar listprezencën në kohë reale, sa herë që është mbledhur për marrjen e vendimeve. Në vazhdim, pra në vitin koherent 2023, për muajin Prill, Bordi i Administrimit, të paktën nga praktika e vënë në dispozicion të grupit të auditimit, nuk ka nënshkruar listprezencën në kohë reale për cdo mbledhje të zhvilluar brenda këtij muaji. Konkretisht:

-Me shkresën nr. 1524 Prot., datë 08.05.2023, janë njoftuar nga Kryetarja e Bordit të Administrimit, të gjithë antarët për zhvillimin e mbledhjes në datën 09.05.2023, në orën 16:30 në sallën e Këshillit të Profesorëve në ambientet e Rektoratit të UMT-së.

-Me shkresën nr. 1531 Prot., datë 09.05.2023, mbahet procesverbali i zbardhjes së mbledhjes së zhvilluar në datën 09.05.2023. Procesverbali është i nënshkruar nga Sekretari Teknik përfaqësuar nga znj. A.G. dhe nga Kryetarja e Bordit të Administrimit znj. Z.G. Tek ky procesverbal, cilësohet se në mbledhje ishin të pranishëm 6 anëtarë dhe mungon antari i Bordit znj. A.G.

-Vendimi nr. 40, sipas shkresës me nr. 1524/1 Prot., datë 09.05.2023, është marrë për miratimin e ndryshimeve në planin e punës për vitin 2023 të njësisë së auditimit të brendshëm.

-Me shkresën nr 1524/2 Prot., datë 15.05.2023, është miratuar dhe plani i punës për auditin e brendshëm.

-Me shkresën nr. 1508/6 Prot., datë 10.05.2023, nga Kryetari i Bordit të Administrimit, kërkohet kryerjen e pagesës për Bordin e Administrimit për punën e kryer në muajin Prill 2023.

-Prezenca e antarëve të Bordit të Administrimit, është e konfirmuar me një shkresë të vetme pa datë, pa numër protokoll dhe pa listprezencat me datat përkatëse për cdo mbledhje të zhvilluar.

-Sa më sipër, nuk ka asnjë dokument që të vërtetojë prezencën në cdo mbledhje të Bordit të Administrimit, në kundërshtim me pikën 7. *“Shpenzimet për kryerjen e pagesës së punonjësve në përbërje të organeve kolegjiale, të cilat vërtetohen kundrejt dokumentit të pjesëmarrjes në mbledhje, si dhe çdo shpenzim tjetër i natyrës operative (jo shpërblim), të kryer për realizimin e detyrave të organeve kolegjiale.....”* të Vendimit nr. 656, datë 31.10.2018 *“Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të Këshillave, Bordeve ose Komisioneve të Përhershëm”*.

Gjithashtu, në dosjen e dorëzuar pranë grupit të auditimit nga Sekretari Teknik, nuk u konstatua ndonjë procesverbal i mbajtur për cdo mbledhje të zhvilluar, në kundërshtim me nenin 16, pika (1) dhe pika (2), të ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” ku cilësohet se “Në çdo mbledhje mbahet një procesverbal, ku bëhet një përmbledhje e gjithçkaje u tha në mbledhje, data dhe vendi i mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën, si dhe forma dhe rezultati i votimeve. Procesverbali mbahet nga sekretari dhe duhet t’u paraqitet për miratim të gjithë anëtarëve në fund të mbledhjes ose në fillim të mbledhjes pasardhëse. Pas miratimit procesverbali nënshkruhet së bashku nga kryetari dhe sekretari”.

Lidhur me vendimet e Bordit të Administrimit, për tarifatat e vitit akademik.

-Vendimi nr. 42, sipas shkresës me nr. 2460/6 Prot., datë 22.10.2020 me objekt “Tarifat e shkollimit për programet e ciklit të parë, të integruar të ciklit të dytë dhe të ciklit të dytë Master Profesional dhe Master i Shkencave në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2020-2021”. Ky vendim i Bordit të Administrimit, është i mbështetur në vendimin nr. 23, datë 17.03.2020 të Senatit Akademik dhe VKM nr. 288, datë 21.05.2018 “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”. Tabela bashkëgjitur këtij vendimi, është e ndarë në tre nëntabela dhe konkretisht “Nëntabela për Tarifatat për ciklin e parë të studimeve....”, “Nëntabela për Tarifatat për ciklin e dytë të studimeve Master Profesional....” dhe “Nëntabela për Tarifatat për ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave.....”. Nga verifikimi i tarifave për cdo cikël studimesh, u konstatua se tarifatat janë përcaktuar sipas kufirit maksimal të përcaktuar në VKM nr. 288, datë 21.05.2018 “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”.

-Vendimi nr. 54, sipas shkresës me nr. 1863/4 Prot., datë 23.07.2021 me objekt “Tarifat e shkollimit për programet e ciklit të parë, të integruar të ciklit të dytë dhe të ciklit të dytë Master Profesional dhe Master i Shkencave në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2021-2022”. Ky vendim i Bordit të Administrimit, është i mbështetur në vendimin nr. 22, datë 26.02.2021 të Senatit Akademik dhe VKM nr. 288, datë 21.05.2018 “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”. Tabela bashkëgjitur këtij vendimi, është e ndarë në tre nëntabela dhe konkretisht “Nëntabela për Tarifatat për ciklin e parë të studimeve....”, “Nëntabela për Tarifatat për ciklin e dytë të studimeve Master Profesional....” dhe “Nëntabela për Tarifatat për ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave...”.

Nga verifikimi i tarifave për cdo cikël studimesh, u konstatua se tarifatat janë përcaktuar sipas kufirit maksimal të përcaktuar në VKM nr. 288, datë 21.05.2018 “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”.

-Vendimi nr. 24, sipas shkresës me nr. 921/3 Prot., datë 30.03.2022 me objekt “*Tarifat e shkollimit për programet e ciklit të parë, të integruar të ciklit të dytë dhe të ciklit të dytë Master Profesional dhe Master i Shkencave në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2022-2023*”. Ky vendim i Bordit të Administrimit, është i mbështetur në vendimin nr. 23, datë 17.03.2022 të Senatit Akademik dhe VKM nr. 288, datë 21.05.2018 “*Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë*”. Tabela bashkëngjitur këtij vendimi, është e ndarë në tre nëntabela dhe konkretisht “*Nëntabela për Tarifat për ciklin e parë të studimeve....*”, “*Nëntabela për Tarifat për ciklin e dytë të studimeve Master Profesional....*” dhe “*Nëntabela për Tarifat për ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave.....*”. Nga verifikimi i tarifave për cdo cikël studimesh, u konstatua se tarifat janë përcaktuar sipas kufirit maksimal të përcaktuar në VKM nr. 288, datë 21.05.2018 “*Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë*”.

-Pra, Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit të Universitetit Mjekësor të Tiranës, kanë marrë vendim që tarifat sipas cikleve të studimit, të jenë fikse dhe të barabarta me kufijtë maksimal të tarifave që përcaktohen me VKM, si vlera tavan pra me përcaktimin “*Jo më shumë se...*”.

-Pika (1) e VKM nr. 288, datë 21.05.2018, cilëson: “*1. Kufiri maksimal i tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë, pasqyrohet në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij*”.

-Pika (2) e VKM nr. 288, datë 21.05.2018, cilëson: “*2. Institucionet publike të arsimit të lartë, brenda muajit prill, por, në çdo rast, jo më vonë se 90 (nëntëdhjetë) ditë para fillimit të vitit akademik, me vendim të organeve kolegjiale, miratojnë tarifën vjetore të shkollimit për çdo program studimi brenda kufirit maksimal të përcaktuar në këtë vendim. Tarifat vjetore të shkollimit, të miratuara me vendim të bordit të administrimit, bëhen publike në faqen zyrtare të institucioneve publike të arsimit të lartë*”.

-Gjatë auditimit lidhur me përcaktimin e tarifave të studimit për ciklet përkatëse të Univeristetit të Mjekësisë, u konstatua se UMT-ja, nuk përdor një metodologji kostimi për përcaktimin e kostove standarde të Univeristetit, në mënyrë që mbi bazën e këtyre kostove të vendosnin tarifat sipas cdo programi studimi. Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave atë me nr. 288, datë 23.07.2018, i cili parashikon një tavan kufi për tarifat e ciklit të parë dhe të dytë të integruar të studimit, UMT-ja, mjaftohet duke vendosur në kufijtë e këtij tavani tarifat për program studimi pa i nxjerrë ato mbi bazën e një analize profesionale tekniko-ekonomike. Sipas parashikimeve të Ligjit për Arsimin e Lartë, Bordi i Administrimit duhet të vendosi tarifat e shkollimit pasi të ketë ndjekur një metodologji të llogaritjes së tyre, duke respektuar kufirin maksimal të përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Të ardhurat që përfitohen nga tarifat e shkollimit, regjistrimit, konkurrimit dhe të shërbimeve të tjera studentore përbëjnë një të ardhur të rëndësishme për procesin mësimor, akademik, shkencor dhe administrativ të UMT-së.

Të ardhurat dytësore, përfitohen kryesisht nga tarifat e shkollimit dhe të shërbimeve ndaj studentëve, të cilat variojnë.

Ndërkohë që mungesa e nxjerrjes së akteve nënligjore nga ministria përgjegjëse për arsimin, mungesa e një metodologjie kostimi dhe kalkulimi me profesionalizëm të tarifave të studimit për ciklet përkatëse nga Bordi i Administrimit, si dhe nevoja për të zhvilluar një kulturë të orientuar drejt cilësisë së shërbimeve me efikasitet, ekonomicitet dhe efektivitet, duke rivlerësuar nevojën reale të dosmosdoshme për angazhimin e stafit akademik sipas kërkesave të programeve mësimore, por dhe menaxhimin me efektivitet të fondeve në dispozicion të UMT-së, me qëllim uljen e shpenzimeve dhe rritjen e cilësisë, nënvizon domosdoshmërinë e vlerësimit të burimeve dhe mekanizmave të përdorur, për realizimin e objektivave të institucionit të UMT-së për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve studentore.

Rritja e cilësisë së shërbimeve të ofruara nga UMT-ja dhe vlerësimi i tarifave mbi bazën e një analize kostoje reale, mund të ndikojnë pozitivisht në uljen e tarifave të studimit dhe rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të këtyre shërbimeve ndaj studentëve.

Lidhur me vendimet e Bordit të Administrimit, për marrje me qira ambienteve.

-Nga auditimi me zgjedhje të vendimeve të Bordit të Administrimit, u konstatua një vendim për marrjen me qira të ambienteve mësimore në një Universitet tjetër. Konkretisht:

Vendimi nr. 10, sipas shkresës me nr. 200/10 Prot., datë 26.10.2022, me objekt “*Miratimin e pagesës së qirasë mësimore, për Fakultetin e Mjekësisë Dentare, Tiranë, për vitin akademik 2019-2020*”. Në lidhje me këtë praktikë, u konstatua se Universiteti i Mjekësisë Tiranë përfaqësuar nga Rektori z. A.G dhe Universiteti i Tiranës përfaqësuar nga Rektori z. M.K., kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi. Marrëveshja është me nr. 1523/2 Prot., datë 01.08.2016 protokolluar në UMT dhe nr. 2172/3 Prot., datë 10.08.2016 protokolluar në UT.

-Në nenin 1 të marrëveshjes së nënshkruar, cilësohet se:

- “*Qëllimi i kësaj marrëveshje bashkëpunimi (më poshtë Marrëveshje) midis UT dhe UMT-së, do të përfshijë këto fusha bashkëpunimi:*

(a) *Shkëmbimin e personelit akademik për procesin mësimor;*

(b) *Shkëmbimin e stafit akademik të kërkuesve dhe të studentëve në kuadrin e veprimtarisë kërkimore shkencore;*

(c) *Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore dhe formuese;*

(d) *Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e veprimtarive të tjera shkencore (konferenca, seminare e botime në fusha me interes të dyanshëm);*

(e) *Shkëmbimin e literaturës shkencore;*

(f) *Shkëmbimin e përvojës lidhur me menaxhimin institucional”.*

-Në nenin 3 të marrëveshjes së nënshkruar, cilësohet se:

“Bashkëpunimet e mbështetura në këtë marrëveshje do të përcaktohen në detaje në anekse të vecanta. Këto anekse do të nënshkruhen nga Drejtuesit e Njësive Kryesore të secilës palë të cilët do të pajisen me autorizimin përkatës nga Titullari i institucionit, si dhe pasi Njësitë Kryesore përkatëse brenda universiteteve, të kenë përcaktuar detajet e tyre në praktikë”.

-Aneks Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Fakultetit të Shkencave të Natyrës së Universitetit të Tiranës dhe FMD të Universitetit të Mjekësisë, është me nr. 26/6 Prot., datë 30.06.2020, protokolluar pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës të Universitetit të Tiranës e nënshkruar nga Dekani z. S. D. dhe nr. 11/2 Prot., datë 30.06.2020, protokolluar pranë FMD të Universitetit të Mjekësisë e nënshkruar nga Dekani znj. E. Xh. Në këtë Aneks Marrëveshje, në mënyrë të përmbledhur, cilësohet ndër të tjera se: “*Në zbatim të Statutit të UT-së, neni 47, pika (k) si dhe*

nenit 3 të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Universitetit të Tiranës me nr. 2172/3 Prot., datë 10.08.2016 dhe Universitetit të Mjekësisë Tiranë me nr. 1523/2 Prot., datë 01.08.2016, lidhet ky Aneks Marrëveshjeje midis Fakultetit të Shkencave të Natyrës me adresë dhe FMD me adresë Neni 1. PAGESA QË DO TË KRYHET PËR QIRATË E AMBIENTEVE, SHPENZIMET LABORATORIKE DHE PAGA PËR PUNONJËSIT JO MËSIMORË DO TË JETË SI MË POSHTË:”.

-Përpara nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes, Dekani i FMD , ka dërguar kërkesat për vënie në dispozicion të një ambienti për mësimdhënie, tek FSHMT dhe tek FM nga të cilat, ka marrë përgjigje negative me justifikimin se këto Fakultete nuk disponojnë salla dhe laboratorë për zhvillimin e lëndës mësimore të Fizikës, të Kimisë së Përgjithëshme dhe Organike si dhe për zhvillimin e lëndës së Biologjisë. Kërkesat janë respektivisht me nr. 571 Prot., & 572 Prot., datë 31.10.2019. Nga Fakultetet, përgjigjet respektive janë kthyer me shkresat nr. 1540/1 Prot., datë 05.11.2019 dhe nr. 2021A/1 Prot., datë 30.12.2019.

-Sa më sipër, konstatohet se:

1-Aneks Marrëveshja nuk i referohet në përmbajtje Marrëveshjes Bazë të nënshkruar nga Rektori i Universitetit të Tiranës dhe Rektori i Universitetit të Mjekësisë pasi në Marrëveshjen Bazë, nuk bëhet fjalë për bashkëpunim në kuptimin e marrjes me qira ambientesh nga njëra palë me përfitim monetar vetëm të njëres palë por për bashkëpunim mbi bazën e shkëmbimit të personelit akademik. Pra Marrëveshja Bazë është një Marrëveshje e cila shpreh dy vullnete që përcaktojnë një sërë rregullash ose veprimesh që duhen respektuar dhe ekzekutuar nga palët për përfitim reciprok.

2-Aneks Marrëveshja e nënshkruar nga Dekani i Fakultetit të Shkencave të Natyrës së Universitetit të Tiranës dhe Dekani i FMD të Universitetit të Mjekësisë, është nënshkruar nga ky i fundit, pa pasur më parë një autorizim me shkrim nga Rektori i Universitetit të Mjekësisë, në kundërshtim me nenin 3 të Marrëveshjes Bazë me nr. 1523/2 Prot., datë 01.08.2016 protokolluar në Universitetin Mjekësor të Tiranës dhe nr. 2172/3 Prot., datë 10.08.2016 protokolluar në Universitetin e Tiranës. UMT-ja, duhet të nxirrte Autorizimin për Dekanin e FMD pasi ky i fundit të kishte detajuar zërat për shpenzime dhe jo të lejonte nënshkrimin nga palët të një Aneks Marrëveshjeje pa autorizimin përkatës. UMT-ja, ka qenë në dijeni të nënshkrimit të një Akt Marrëveshjeje midis FMD dhe Fakultetit të Shkencave të Natyrës pasi që prej vitit 2014 nëse i referohemi Marrëveshjes me nr. 2879/10 Prot., datë 05.02.2014 protokolluar në Universitetin e Tiranës dhe nr. 1278/4 Prot., datë 11.02.2014 protokolluar në Universitetin e Mjekësisë, ka pasur një bashkëpunim të njëjtë për të njëjtat lëndë. Pra Rektori nuk ka lëshuar autorizime për Dekanët e Fakulteteve respektive për nënshkrime të Aneks Marrëveshjeve të lidhura në vite midis UT dhe UMT-së, në kundërshtim me nenin 3 të Marrëveshjes Bazë.

3-Në praktikën e ndjekur nga FMD , nuk evidentohet mënyra e përzgjedhjes së ambienteve pikërisht në Fakultetin e Shkencave të Natyrës në të njëjtën kohë që Universiteti i Mjekësisë ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me shumë Universitete të tjerë publik dhe privat.

4-Në Akt Marrëveshjen bazë, nuk justifikohet dhe as bazohet në ndonjë ligj apo rregullore, pagesa e punonjësve jo mësimorë të Universitetit të Shkencave të Natyrës apo përcaktimi në Akt Marrëveshjeje i pagesës së këtyre punonjësve për punë jashtë orarit (neni 1 i Akt Marrëveshjes) në të njëjtën kohë që këta punonjës (jomësimorë) nuk janë pjesë e stafit të Universitetit Mjekësor të Tiranës por as nuk është kërkuar nga Fakultetet e Universitetit të Mjekësisë, staf ndihmës por vetëm ambiente dhe laboratorë.

5-Fakulteti i Mjekësisë, FMD dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore dhe Teknike, nuk kanë në përbërje të stafeve të tyre administrative, punonjës apo konsulent të jashtëm me profesion jurist e

si të tilla, nuk kanë kapacitetet e nevojshme për të zbatuar me rigorozitet ligjin dhe rregullat në fuqi. Është detyrë e Universitetit të Mjekësisë (Rektoratit) për të asistuar në konceptimin dhe hartimin e Akt Marrëveshjeve apo kontratave të ndryshme që mund të kenë nevojë të nënshkruajnë Fakultetet e Universitetit të Mjekësisë me palët e treta.

6-Aneks Marrëveshja e bashkëpunimit midis Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe FMD , është nënshkruar pas përfundimit të vitit akademik. Pra, Aneks Marrëveshja është nënshkruar në datën 30.06.2020, për detyrime të ndërsjellta që janë zbatuar në vitin akademik 2019-2020.

-Lidhur me zbatimin e Akt Marrëveshjes. Nga auditimi i praktikës së dorëzuar pranë grupit të auditimit lidhur me zbatimin e Akt Marrëveshjes nga FMD , që në fillimet e saj atë të procesit të rekrutimit të stafit pedagogjik me kohë të pjesëshme dhe zhvillimit të orëve mësimore për lëndët e fizikës, kimisë dhe biologjisë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës për vitin akademik 2019-2020 për llogari të studentëve të FMD në UMT, rezultoi si në vijim:

-Është miratuar Aneks Marrëveshja midis Fakultetit të Shkencave të Natyrës së Universitetit të Tiranës dhe FMD të Universitetit të Mjekësisë, me nr. 26/6 Prot., datë 30.06.2020, protokolluar pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës të Universitetit të Tiranës e nënshkruar nga Dekani z. S. D. dhe nr. 11/2 Prot., datë 30.06.2020, protokolluar pranë FMD të Universitetit të Mjekësisë e nënshkruar nga Dekani znj. E. Xh. Kjo Aneks Marrëveshje, është nënshkruar pasi:

-Dekani i FMD ka bërë publikimin e vendeve vakante për personel akademik me kohë të pjesëshme për lëndët formuese, sipas shkresës me nr. 372/11 Prot., datë 20.09.2019.

-Me shkresën nr. 372/18 Prot., datë 10.10.2019, Dekani i FMD , nxjerr urdhrin e brendshëm për ngritjen e komisionit Ad-Hoc për rekrutimin e personelit akademik pas shpalljes së vendeve vakante.

-Me shkresën nr. 372/22 Prot., datë 18.10.2019, komisioni Ad-Hoc, mban procesverbalin e shqyrtimit të dosjeve të aplikantëve për vendet vakante për personelin akademik me kohë të pjesëshme.

-Me shkresën nr. 372/26 Prot., datë 05.11.2019, komisioni Ad-Hoc, mban relacionin për tabelën përmbledhëse të parashikimit të ngarkesës mësimore për vitin akademik 2019-2020 dhe për ngarkesën mësimore nga cdo pedagogë me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme.

-Me shkresën nr. 372/28 Prot., datë 20.11.2019, Dekani i FMD , përcjell tek Rektorati i Universitetit të Mjekësisë, listën për miratim të personelit akademik me kohë të pjesëshme për vitin akademik 2019-2020. Deri në këtë moment, Fakulteti

-Me shkresën nr. 949/1 Prot., datë 17.04.2020, Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore në Universitetin e Mjekësisë, i kërkon FMD , plotësimin e të dhënave për pedagogët e shpallur fitues për punësimin me kohë të pjesëshme për vitin akademik 2019-2020.

-Me shkresën nr. 372/30 Prot., datë 28.04.2020, FMD , dërgon tek Rektorati i UMT-së, listën e plotësuar me të dhënat që mungonin për stafin akademik me kohë të pjesëshme.

-Me shkresën nr. 1024/8 Prot., datë 11.05.2020, Senati Akademik ka marrë vendimin nr. 43, për miratimin e personelit akademik me kohë të pjesëshme dhe të ftuar për vitin akademik 2019-2020 për Fakultetin e Mjekësisë.

-Kontratat individuale të punës për punonjësit me kohë të pjesëshme personel akademik, janë si në vijim dhe i referohen listës së atyre pedagogëve që kanë zhvilluar orët e mësimin në Fakultetin e Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës. Konkretisht:

Kontrata individuale			
Nr.	numër, datë	Nënshkruesit Rektori i UMT dhe	Objekti i kontratës për mësimdhënie

		pedagogut/ es	
1	949/10, datë 12.10.20	B. S.	4 orë punë në javë për mësimdhënie në Lëndët Formuese të FMD.
2	949/11, datë 12.10.20	K. Xh.	për 6 orë punë në javë Semestri-I dhe 2 orë punë në javë Semestri-II për Lëndët Formuese të FMD.
3	949/12, datë 12.10.20	Sh. A.	12.5 orë punë në javë në Departamentin e Higjenës dhe Teknikës Dentare në FMD.
4	949/13, datë 12.10.20	K. V.	2 orë punë në javë në lëndët formuese të FMD
5	949/14, datë 12.10.20	D.T.	3 orë punë në javë në lëndët formuese të FMD
6	949/15, datë 12.10.20	Th.K.	4 orë punë në javë në lëndët formuese të FMD.
7	949/16, datë 12.10.20	P. Dh.	6 orë punë në javë në Lëndët Formuese të FMD
8	949/17, datë 12.10.20	E. S.	4 orë punë në javë në Lëndët Formuese të FMD.
9	949/18, datë 12.10.20	E. N.	3 orë punë në javë në Lëndët Formuese të FMD.
10	949/19, datë 12.10.20	D.Xh.	6 orë punë në javë në Lëndët Formuese të FMD.
11	949/20, datë 12.10.20	R.N.	3 orë punë në javë në Lëndët Formuese të FMD.
12	949/21, datë 12.10.20	E.H.	2.5 orë punë në javë në Lëndët Formuese të FMD.
13	949/22, datë 12.10.20	E.P.	6 orë punë në javë në Lëndët Formuese të FMD.
14	949/23, datë 12.10.20	B.G.	4 orë punë në javë në Lëndët Formuese të FMD.
15	949/24, datë 12.10.20	E. H.	3 orë punë në javë në Lëndët Formuese të FMD.
16	949/25, datë 12.10.20	A.P.	3 orë punë në javë në Lëndët Formuese të FMD.
17	949/26, datë 11.06.20	E.B.	35 orë punë në javë në Lëndën e Informatikës së Aplikuar për Shkencat Mjekësore.
18	949/27, datë 12.10.2020	M.T.	3 orë punë në javë në Lëndët Formuese të FMD.

-Sa më sipër, konstatohet se kontratat e nënshkuara midis Universitetit të Mjekësisë dhe pedagogëve të shpallur fitues të procedurave të rekrutimit për vitet përkatëse akademike, janë nënshkuar pas përfundimit të vitit akademik. Pra, pedagogët e jashtëm të kontraktuar nga Fakultetet përkatëse, kanë dhënë mësim tek studentët përkatës sipas cikleve të studimit dhe njëkohësisht janë likujtuar për këto orë mësimi, pa pasur në fillim një kontratë pune me Fakultetin përkatës.

-Bordi i Administrimit, ka marrë vendimin nr. 10 sipas shkresës me nr. 200/10 Prot., datë 26.01.2022, për miratimin e pagesës së qirasë mësimore, për Fakultetin e Mjekësisë Dentare, për vitin akademik 2019-2020. Relacionet përkatëse të FMD , janë me nr. 11/4 Prot., datë 19.11.2021 dhe nr. 11/5 Prot., datë 25.11.2021. Me anë të këtyre relacioneve, FMD , vërteton realizimin e Aneks Marrëveshjes me Fakultetin e Shkencave të Natyrës. Në vazhdim, kërkesa drejtuar Administratorit të Universitetit të Mjekësisë Tiranë për pagesën e qirasë mësimore sipas Aneks Marrëveshjes, është me nr. 11/7 Prot., datë 15.12.2021. Vlera që kërkohet të likujdohet, është 364,059 lekë.

-Si rezultat, në dosjen e dorëzuar pranë grupit të auditimit, lidhur me praktikën e ndjekur për kryerjen e likujdimit sipas urdhër xhirimit me datë 11.05.2022, nuk u konstatua ndonjë relacion i detajuar për cdo zë të likujtuar. Referencat për vlerat e secilës kategori, janë të cilësuar në kërkesat e ardhura nga FMD por jo të detajuara pasi vlera për paisje laboratorit dhe burime njerëzore jepet në total dhe jo e ndarë sipas zërave.

-Senati Akademik, përpara marrjes së vendimit për miratimin e personelit akademik me kohë të pjesëshme dhe të ftuar për vitin akademik 2019-2020 për Fakultetin e Mjekësisë (me shkresën nr. 1024/8 Prot., datë 11.05.2020), duhej që të kishte në dispozicion relacionin përkatës nga Drejtoria e Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore në Rektorat, lidhur me rregullshmërinë ligjore të kontratave individuale të punës ose të procedurës së shpalljes së fituesve të vendeve

vakante, pasi miratimi dhe vendimi i shpalljes së fituesve për vendet vakante për pedagogë me kohë të pjesëshme, është bërë në Muajin Maj 2020 kur pedagogët kanë qenë të domosdoshëm në Tëtor 2019. Pra logjikisht, pedagogët e kontraktuar me vonesë nga Rektori, rezultojnë ligjërisht të kenë dhënë orë mësimi dhe të kenë kryer vlerësimet respektive për orët e mësimdhënies të zhvilluara, pa patur më parë një kontratë punësimi me Universitetin Mjekësor të Tiranës.

-Bordi i Administrimit, përpara marrjes së vendimit për miratimin e kryerjes së pagesës së qirasë për llogari të Fakultetit të Shkencave të Natyrës për shërbimet e kryera për Fakultetin e Mjekësisë Dentare, duhej të kërkonte (kishte paraprakisht) një relacion nga Drejtoria e Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore lidhur me rregullshmërinë ligjore të Akt Marrëveshjes së nënshkruar pra pa autorizimin përkatës nga Rektori për Dekanin e FMD , për rregullshmërinë ligjore të kontratave të nënshkruara pas kryerjes së punës (mësimdhënies) nga pedagogët e jashtëm, për rregullshmërinë ligjore të referencave lidhur me zërin qiramarrje pasi nuk cilësohet në asnjë Marrëveshje apo edhe PBA të UMT-së, që ky zë ka edhe nënëra si burime njerëzore apo paisje laboratorike. Qiramarrja nënkupton vetëm marrjen me qira të ambienteve dhe jo paisje apo labore dhe burime njerëzore edhe pse jomësimorë. Drejtoria e Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore në Universitetin e Tiranës, duhet të monitoronte edhe shkresat, Aneks Marrëveshjet apo cdo dokument të prodhuar nga Fakultetet përkatëse përpara se ato të nënshkruheshin nga Dekanët respektiv, për faktin se Fakultetet nuk disponojnë në stafin e tyre administrativ por as në strukturë, jurist ose konsulent të jashtëm të fushës juridike, e si të tilla, nuk kanë kapacitetet e duhura për të prodhuar ose nxjerrë akte të mirëfillta administrative pasi ju mungon përgatitja në këtë fushë.

-Si rezultat, Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit të Universitetit të Mjekësisë, kanë marrë vendime në mungesë të plotë të dokumentacionit ligjor (relacioneve përkatëse ligjore dhe ekonomike), vendime që nuk kanë dhe nuk mund të kenë, fuqi prapavepruese në njërin anë nga Senati Akademik por as nuk janë të mbështetura në dokumentacion të rregullt ligjor edhe për Bordin e Administrimit.

-Pedagogët e jashtëm sipas listës më sipër, kanë kryer punën e pedagogut dhe njëkohësisht kanë certifikuar studentët për lëndët mësimore të dhëna ndaj tyre, pa patur marrëdhënie pune ligjore (pasi kontratat rezultojnë të nënshkruara pas kryerjes së mësimdhënies me efekt prapaveprues) me UMT. Kjo gjë, përveç faktit që sjell parregullsi të karakterit ekonomiko-administrativ në Universitetin e Mjekësisë, njëkohësisht, mund të krijojë dhe probleme juridike në të ardhmen, lidhur me vlefshmërinë e shërbimit të mësimdhënies. Gjithashtu, ky shërbim, i ligjësuar pas kryerjes së tij, e bën të pamundur kontrollin konform legjislacionit në fuqi për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin si nga Auditi i Brendshëm ashtu edhe nga ai i Jashtëm, në kohën e ofrimit të këtij shërbimi.

-Vendimet e Senatit Akademik për vitet 2020, 2021 dhe 2022, jepen aneksin 5/1 bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

-Lidhur me rregullshmërinë e zhvillimit të mbledhjeve të Senatit Akademik të UMT-së.

-Nga auditimi me zgjedhje të praktikave të ndjekura nga Sekretari i Senatit Akademik, për periudhën objekt auditimi, nuk u konstatua ndonjë procesverbal i mbajtur në orarin e mbajtjes së mbledhjes. Procesverbalet e zbardhura të mbledhjeve të zhvilluara për periudhën objekt auditimi, janë të nënshkruara vetëm nga Kryetari i Senatit Akademik dhe Sekretari. Nuk dokumentohet nëse kanë qenë prezent në mbledhje, antarët e Senatit Akademik.

-Lidhur me rregulloren e brendëshme të UMT-së. Nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit lidhur me vendimet e marra nga Senati Akademik, u konstatua se:

-Për periudhën objekt auditimi institucioni ka përditësuar Statutin, sipas vendimit të Senatit Akademik me nr. 11, datë 11.02.2019. Gjithashtu është përditësuar dhe Rregullorja e Universitetit të Mjekësisë me vendimin nr. 59, datë 27.06.2022, të Senatit Akademik. Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me rregulloren e brendëshme, u konstatua se mungonin përshkrimet e punës dhe përgjegjësitë apo detyrat e Drejtorive dhe Sektorëve përkatës. Me vendimin nr. 63, datë 08.10.2021, Senati Akademik ka miratuar kriteret e punësimit të personelit administrativ të Universitetit të Mjekësisë me përshkrimet e punës & kriteret e punësimit për personelin administrativ të UMT-së, por këto nuk janë pjesë e rregullores së brendëshme të UMT-së. Nga auditimi i vendimit nr. 63, datë 08.10.2021 të Senatit Akademik, u konstatua se përshkrimet e punës & kriteret e punësimit për personelin administrativ të UMT-së, nuk janë bërë për të gjitha Drejtoritë apo Sektorët e Rektoratit por vetëm për një pjesë të Stafit Administrativ. Konkretisht, referuar Organigramës së UMT-së, janë miratuar përshkrimet e punës & kriteret e punësimit, për Drejtorinë Ekonomike dhe Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse në Universitetin e Tiranës por mungojnë këto përshkrime për Drejtorinë e Administrimit Akademik dhe Kurrikulës, për Drejtorinë e Kërkimit, Promovimit Akademik dhe Komunikimit dhe për Drejtorinë e Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore. Për rrjedhojë detyrat dhe të drejtat e personelit të stafit administrativ të UMT-së, nuk janë përcaktuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Mungesa e përshkrimeve të punës & kriteret e punësimit për personelin administrativ të UMT-së kufizon ndjeshëm nxjerrjen e përgjegjësiave të stafit në rast të mos përmbushjes së detyrave të ngarkuara. Nuk u konstatua të ketë rregullore të brendëshme ndonjë Fakultet i Universitetit të Mjekësisë në kuptim të ligjeve dhe rregullave respektive. Rregulloret e brendshme të fakulteteve, duhet të rishikohen për tu përshtatur kërkesave të kuadrit të ligjor, konkretisht ligjit 80/2015, datë 17.09.2015 *“Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”*.

Nga auditimi konstatohet se Rregullorja e Universitetit të Mjekësisë *“Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës”*, nuk ka asnjë dokument që të vërtetojë rishikimin, përditësimin apo dhe hartimin e një rregulloreje të re e cila të përmbajë të gjitha rregullat dhe normat për veprimtarinë e Universitetit të Mjekësisë.

Titulli Gjetjes:	Mungesa e dokumentacionit vërtetues për prezencën e antarëve në çdo mbledhje të zhvilluar nga Bordi i Administrimit dhe Senati Akademik.
Situata:	Nga auditimi me zgjedhje i disa praktikave lidhur me mbledhjet që ka zhvilluar Bordi i Administrimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, u konstatua se prezenca e anëtareve të Bordit të Administrimit, është e konfirmuar me një shkresë të vetme në fund të çdo muaji, pa datë, pa numër protokollit dhe pa listë prezencat me datat përkatëse për çdo mbledhje të zhvilluar. Nga auditimi, nuk rezultoi që sekretari i Bordit të Administrimit, të ketë mbajtur ndonjë procesverbal për listë prezencën ditore të zhvillimit të mbledhjes nga Bordi i Administrimit, por vetëm atë mujore duke mos respektuar nenin 16, pikën (1) dhe pikën (2), të ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 <i>“Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”</i> . Nga auditimi me zgjedhje i praktikave të ndjekura nga Sekretari i Senatit

	Akademik, për periudhën objekt auditimi, nuk u konstatua ndonjë procesverbal i mbajtur në orarin e mbajtjes së mbledhjes. Procesverbalet e zbardhura të mbledhjeve të zhvilluara për periudhën objekt auditimi, janë të nënshkruara vetëm nga Kryetari i Senatit Akademik dhe Sekretari. Nuk dokumentohet nëse kanë qenë prezent në mbledhje, anëtarët e Senatit Akademik. Gjithashtu, mungesa e dokumentacionit vërtetues për listë prezencën në çdo mbledhje të zhvilluar, nuk është në konformitet me pikën 7, të VKM nr. 656, datë 31.10.2018 <i>“Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të Këshillave, Bordeve ose Komisioneve të Përhershëm”</i> .
Kriteri:	Ligji nr. 8480, datë 27.5.1999 <i>“Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”</i> . Vendimi nr. 656, datë 31.10.2018 <i>“Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të Këshillave, Bordeve ose Komisioneve të Përhershëm”</i> .
Ndikimi/Efekti:	Rrit riskun e marrjes së vendimeve fiktive pa dakortësinë e shumicës.
Shkaku:	Mosveprim nga ana e Sekretarit të Bordit të Administrimit.
Rëndësia:	E Mesme
Rekomandim:	Sekretari i Bordit të Administrimit dhe i Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë Tiranë, të marrë masat që në të ardhmen, të dokumentohet prezenca e të gjithë antarëve pjesëmarrës në çdo mbledhje të zhvilluar nga Bordi i Administrimit, në respektim të ligjeve dhe rregullave në fuqi.

Titulli Gjetjes:	Nënshkrimi i Aneks-Marrëveshjeve me kritere në kundërshtim me Marrëveshjen Bazë.
Situata:	Nga auditimi me zgjedhje të vendimeve të Bordit të Administrimit, u konstatua një vendim për marrjen me qira të ambienteve mësimore në një universitet tjetër. Konkretisht: Vendimi nr. 10, (nr. 200/10 Prot., datë 26.10.2022), me objekt <i>“Miratimin e pagesës së qirasë mësimore, për Fakultetin e Mjekësisë Dentare, Tiranë, për vitin akademik 2019-2020”</i> . Në lidhje me këtë praktikë, u konstatua se Universiteti i Mjekësisë Tiranë dhe Universiteti i Tiranës, kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi. Në nenin 3 të marrëveshjes së nënshkruar, cilësohet se: <i>“Bashkëpunimet e mbështetura në këtë marrëveshje do të përcaktohen në detaje në anekse të vecanta. Këto anekse do të nënshkruhen nga Drejtuesit e Njësive Kryesore të secilës palë të cilët do të pajisen me autorizimin përkatës nga Titullari i institucionit, si dhe pasi Njësitë Kryesore përkatëse brenda universiteteve, të kenë përcaktuar detajet e tyre në praktikë”</i> . Aneks Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Fakultetit të Shkencave të Natyrës së Universitetit të Tiranës dhe FMD të Universitetit të Mjekësisë, është nënshkruar në datën 30.06.2020. Aneks Marrëveshja nuk i referohet në përmbajtje Marrëveshjes Bazë të nënshkruar nga Rektori i Universitetit të Tiranës dhe Rektori i Universitetit të Mjekësisë pasi në Marrëveshjen Bazë, nuk bëhet fjalë për bashkëpunim në kuptimin e marrjes me qira ambientesh nga njëra palë me përfitim monetar vetëm të njëjës palë por për bashkëpunim mbi bazën e shkëmbimit të personelit akademik. Pra Marrëveshja Bazë është një Marrëveshje e cila shpreh dy vullnete që përcaktojnë një sërë rregullash ose

	<p>veprimesh që duhen respektuar dhe ekzekutuar nga palët për përfitim reciprok. Aneks Marrëveshja, është nënshkruar nga Dekani i Fakultetit të Mjekësisë Dentare, pa pasur më parë një autorizim me shkrim nga Rektori i Universitetit të Mjekësisë, në kundërshtim me nenin 3 të Marrëveshjes Bazë. Në Akt Marrëveshjen bazë, nuk justifikohet dhe as bazohet në ndonjë ligj apo rregullore, pagesa e punonjësve jo mësimorë të Universitetit të Shkencave të Natyrës apo përcaktimi në Akt Marrëveshje i pagesës së këtyre punonjësve për punë jashtë orarit (neni 1 i Akt Marrëveshjes) në të njëjtën kohë që këta punonjës (jo mësimorë) nuk janë pjesë e stafit të Universitetit Mjekësor të Tiranës por as nuk është kërkuar nga Fakultetet e Universitetit të Mjekësisë, staf ndihmës por vetëm ambiente dhe laboratorë. FM, FMD dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore dhe Teknike, nuk kanë në përbërje të stafeve të tyre administrative, punonjës apo konsulent të jashtëm me profesion jurist e si të tilla, nuk kanë kapacitetet e nevojshme për të zbatuar me rigorozitet ligjin dhe rregullat në fuqi. Është detyrë e Universitetit të Mjekësisë (Rektoratit) për të asistuar në konceptimin dhe hartimin e Akt Marrëveshjeve apo kontratave të ndryshme që mund të kenë nevojë të nënshkruajnë Fakultetet e Universitetit të Mjekësisë me palët e treta.</p>
Kriteri:	Neni 3, i Marrëveshjes nr. 1523/2 Prot., datë 01.08.2016 protokolluar në UMT dhe nr. 2172/3 Prot., datë 10.08.2016 protokolluar në UT.
Ndikimi/Efekti:	Bëhet precedent në të ardhmen, për nënshkrimin e Aneks Marrëveshjeve me kritere jo në konformitet me kriteret e Marrëveshjes Bazë.
Shkaku:	Mosveprim nga ana e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore të Universitetit të Mjekësisë.
Rëndësia:	E Lartë.
Rekomandim:	Rektori i Universitetit të Mjekësisë, të marrë masat që në të ardhmen, të nënshkruajë autorizimet përkatëse për nënshkrimin nga Drejtuesit e Njësive Kryesore të Aneks Marrëveshjeve të bashkëpunimit me Universitetet e tjera publike ose private, të cilat ti referohen Marrëveshjes Bazë, objektit të Marrëveshjes dhe qëllimit, pasi Drejtuesit e Njësive Kryesore respektive, të kenë përcaktuar paraprakisht, detajet lidhur me nevojën e nënshkrimit të një Aneks Marrëveshjeje.
Rekomandim:	Drejtuesit e Njësive Kryesore të Universitetit të Mjekësisë, në të ardhmen, të nënshkruajnë Aneks Marrëveshje bashkëpunimi me Universitetet respektive, vetëm pasi të kenë marrë autorizimin përkatës nga Rektori i Universitetit të Mjekësisë dhe njëkohësisht, ti përmbahen me rigorozitet kushteve dhe kritereve të vendosura në Marrëveshjen Bazë për përfitime reciproke midis palëve nënshkruese.
Rekomandim:	Drejtorja e Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore në Universitetin e Mjekësisë, Sektori i Shërbimeve Juridike, të marrë masat që në të ardhmen, të konceptojnë Marrëveshjet, Aneks Marrëveshjet, Kontratat apo çdo akt administrativ që nxirret për të krijuar një marrëdhënie bashkëpunimi ose jo, midis Universitetit të Mjekësisë/Fakulteteve përkatëse dhe kujtdo institucioni tjetër publik ose privat, përpara nënshkrimit të këtyre akteve nga Rektori apo Drejtuesit e Njësive Kryesore të Universitetit të Mjekësisë.

Titulli i Gjetjes:	Nënshkrimi i kontratave individuale të punës, në kundërshtim me Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë.
Situata:	Nga auditimi i praktikës së dorëzuar pranë grupit të auditimit lidhur me zbatimin e Aneks Marrëveshjes nr. 26/6 Prot., datë 30.06.2020, nga Fakulteti i Mjekësisë Dentare, që në fillimet e saj, atë të procesit të rekrutimit të stafit pedagogjik me kohë të pjesëshme dhe zhvillimit të orëve mësimore për lëndët e fizikës, kimisë dhe biologjisë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës, për vitin akademik 2019-2020, rezultoi se kjo Aneks Marrëveshje, është nënshkruar pasi Dekani i FMD ka bërë publikimin e vendeve vakante për personel akademik me kohë të pjesëshme për lëndët formuese, në datën 20.09.2019. Senati Akademik ka marrë vendimin nr. 43, për miratimin e personelit akademik me kohë të pjesëshme dhe të ftuar për vitin akademik 2019-2020 për Fakultetin e Mjekësisë. Kontratat individuale të punës për punonjësit me kohë të pjesëshme personel akademik, në total 18 të tilla, janë me nr. 949/10 Prot., deri nr. 949/27 Prot., datë 12.10.2020. Sa më sipër, konstatohet se kontratat e nënshkruara midis Universitetit të Mjekësisë dhe pedagogëve të shpallur fitues të procedurave të rekrutimit për vitet përkatëse akademike, janë nënshkruar pas përfundimit të vitit akademik. Pra, pedagogët e jashtëm të kontraktuar nga Fakultetet përkatëse, kanë dhënë mësim tek studentët përkatës sipas cikleve të studimit dhe njëkohësisht janë likujduar për këto orë mësimi, pa pasur në fillim një kontratë pune me Fakultetin përkatës. Miratimi dhe vendimi i shpalljes së fituesve për vendet vakante për pedagogë me kohë të pjesëshme, është bërë në Muajin Maj 2020 kur pedagogët kanë qenë të domosdoshëm në Tetor 2019. Pra logjikisht, pedagogët e kontraktuar me vonesë nga Rektorati, rezultojnë ligjërisht të kenë dhënë orë mësimi dhe të kenë kryer vlerësimet respektive për orët e mësimdhënies të zhvilluara, pa patur më parë një kontratë punësimi me Universitetin Mjekësor të Tiranës. Pedagogët e jashtëm, të kontraktuar nga UMT, kanë kryer punën e pedagogut dhe njëkohësisht kanë certifikuar studentët për lëndët mësimore të dhëna ndaj tyre, pa patur marrëdhënie pune ligjore (pasi kontratat rezultojnë të nënshkruara pas kryerjes së mësimdhënies me efekt prapaveprues) me UMT. Kjo gjë, përveç faktit që sjell parregullsi të karakterit ekonomiko-administrativ në Universitetin e Mjekësisë, njëkohësisht, mund të krijojë dhe probleme juridike në të ardhmen, lidhur me vlefshmërinë e shërbimit të mësimdhënies. Gjithashtu, ky shërbim, i ligjësuar pas kryerjes së tij, e bën të pamundur kontrollin konform legjislacionit në fuqi për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin si nga Auditi i Brendshëm ashtu edhe nga ai i Jashtëm, në kohën e ofrimit të këtij shërbimi.
Kriteri:	Neni 21 “Forma e kontratës së punës”, pika 1, pika 2, pika 3, pika 4 dhe neni 202 “Gjoha”, pika 2, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”.
Ndikimi/Efekti:	Kufizime në kërkesat për të drejtat dhe detyrimet e palëve në kohë.
Shkaku:	Mosveprim nga ana e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore të Universitetit të Mjekësisë.

Rëndësia:	E Lartë
Rekomandim:	Rektorati i Universitetit të Mjekësisë, Senati Akdemik, Bordi i Administrimit, Drejtoria e Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore në UMT, të marrin masat që në të ardhmen, kontratat individuale të punës, të nënshkruhen brenda afateve ligjore me qëllim, eliminimin e problemeve juridike në të ardhmen, lidhur me vlefshmërinë e shërbimit të mësimdhënies si dhe mos shamngien e kontrollit konform legjislacionit në fuqi për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin si nga Auditi i Brendshëm ashtu edhe nga ai i Jashtëm, në kohën e ofrimit të këtij shërbimi.
Rekomandim:	Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, referuar shkeljeve të konstatuara nga auditimi në UMT, të marrë masa për shqyrtimin e kontratave individuale të punës për pedagogët me kohë të pjesshme, me qëllim marrjen e masave për nëpunësit me përgjegjësi administrative të UMT. (një kopje e Vendimit nga SHPSHSH, të dërgohet në Kontrollin e Lartë të Shtetit).
Titulli i Gjetjes:	Rregullorja e Brendëshme e Universitetit të Mjekësisë, nuk është rishikuar.
Situata:	Nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit të vënë në dispozicion lidhur me Rregulloren e Brendëshme të Universitetit të Mjekësisë dhe të fakulteteve respektive, u konstatua se institucioni ka përditësuar Statutin, sipas vendimit të Senatit Akademik me nr. 11, datë 11.02.2019 dhe rregulloren e brendëshme sipas vendimit nr. 59, datë 27.06.2022. Nga auditimi u konstatua se mungonin përshkrimet e punës dhe përgjegjësitë apo detyrat e Drejtorive dhe Sektorëve përkatës. Me vendimin nr. 63, datë 08.10.2021, Senati Akademik ka miratuar kriteret e punësimit të personelit administrativ të Universitetit të Mjekësisë me përshkrimet e punës & kriteret e punësimit për personelin administrativ të UMT-së, por këto nuk janë pjesë e rregullores së brendëshme të UMT-së. Nga auditimi i vendimit nr. 63, datë 08.10.2021 të Senatit Akademik, u konstatua se përshkrimet e punës & kriteret e punësimit për personelin administrativ të UMT-së, nuk janë bërë për të gjitha Drejtoritë apo sektorët e Rektoratit por vetëm për një pjesë të stafit administrativ. Konkretisht, referuar organigramës së UMT-së, janë miratuar përshkrimet e punës & kriteret e punësimit, për Drejtorinë Ekonomike dhe Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse në Universitetin e Tiranës, por mungojnë këto përshkrime për Drejtorinë e Administrimit Akademik dhe Kurrikulës, për Drejtorinë e Kërkimit, Promovimit Akademik dhe Komunikimit dhe për Drejtorinë e Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore. Për rrjedhojë detyrat dhe të drejtat e personelit të stafit administrativ të UMT-së, nuk janë përcaktuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Mungesa e përshkrimeve të punës & kriteret e punësimit për personelin administrativ të UMT-së kufizon ndjeshëm nxjerrjen e përgjegjësive të stafit në rast të mos përmbushjes së detyrave të ngarkuara. Nuk u konstatua të ketë rregullore të brendëshme ndonjë fakultet i Universitetit të Mjekësisë, në kuptim të ligjeve dhe rregullave respektive. Rregulloret e brendshme të fakulteteve, nuk janë rishikuar për tu përshtatur

	kërkesave të kuadrit të ligjor, konkretisht ligjit 80/2015, datë 17.09.2015 <i>“Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”</i> . Nga auditimi kostatohet se Rregullorja Universitetit të Mjekësisë <i>“Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës”</i> , nuk ka asnjë dokument që të vërtetojë rishikimin, përditësimin apo dhe hartimin e një rregulloreje të re e cila të përmbajë të gjitha rregullat dhe normat për veprimtarinë e Universitetit të Mjekësisë.
Kriteri:	Ligji 80/2015, datë 17.09.2015 <i>“Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”</i> . Rregullorja e Universitetit të Mjekësisë <i>“Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës”</i> .
Ndikimi/Efekti:	Kufizimi i nxjerrjes së përgjegjësive të stafit në rast të mos përmbushjes së detyrave të ngarkuara.
Shkaku:	Mosveprim nga ana e strukturave të Universitetit të Mjekësisë.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandim:	Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, në funksion të kryerjes së përgjegjësive ligjore dhe realizimit të objektivave, të marrë masa për të rishikuar dhe përmirësuar Rregulloren e Brendshme të Rektoratit, duke reflektuar ndryshimet e ndodhura në kuadrin ligjor dhe aktet e tjera nënligjore. Përmirësimet e strukturës organike dhe organigramës së funksionimit të institucionit, ti shërbejnë ndihmesës së punonjësve të institucionit që të kuptojnë marrëdhëniet ndërmjet strukturave administrative të veçanta, vendin që ato zënë në njësi, si dhe të njihen me te drejtat dhe detyrimet, të cilat i korrespondojnë pozicioneve të tyre të punësimit.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1421/31 Prot., datë 30.11.2023, (numri i komentit 1421/27 Prot., datë 24.11.2023) protokolluar në KLSH me shkresën nr. 401/16 Prot., datë 01.12.2023, nga A.G.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Asnjë nga pretendimet tuaja nuk mund të merret në konsideratë në hartimin e këtij raporti auditimi. Gjetjet e grupit të auditimit janë të argumentuara dhe absolutisht të gjitha të bazuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Dokumentacioni që keni sjellë bashkalidhur observacionit tuaj, është i njëjtë me atë që grupi i auditimit ka pasur në dispozicion dhe që e ka përshkruar në aktin e mbajtur. Me këtë observacion, nuk keni sjellë dokumenta dhe fakte shtesë të cilat edhe mund të merreshin në shqyrtim pavarësisht faktit sic pretendoni dhe ju, që gjatë auditimit jeni pyetur nga antarë të grupit të auditimit dhe keni dhënë përgjigjet mbi të cilat është hartuar dhe akti i konstatimit.

2.6 Mbi hartimin, shqyrtimin, miratimin dhe zbatimin e buxhetit; sipas kategorive: granti i politikave të zhvillimit të arsimit të lartë; granti i mësimdhënies dhe granti i punës kërkimore shkencore dhe i veprimtarive krijuese.

UMT organizohet dhe menaxhohet në zbatim të Statutit dhe Rregulloreve të tij. Organet kolegjiale dhe drejtuese të UMT-së funksionojnë bazuar në rregullore specifike e procedura, të miratuara sipas ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutit të UMT -së, si dhe në strategjinë e zhvillimit të institucionit.

Financimi i aktivitetit të UMT-së, sipas parashikimeve të përcaktuara në nenin 109 “Burimet e financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë”, të ligjit nr.80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” si çdo vit realizohet nëpërmjet tre burimeve:

- a) Granti i mësimdhëniesi detajuar për paga, sigurime shoqërore e shëndetësore, shpenzime materiale dhe shërbime, bursa (*Transferta e pakushtëzuar nga Buxheti i Shtetit*).
- b) Të ardhurat e kushtëzuara të institucionit (*për funksionim dhe investime*) nga të ardhurat e veta të UMT-së.
- c) Burime të tjera të ligjshme (*donacione, projekte*).

Fondet e buxhetit të shtetit për institucionet e arsimit të lartë shpërndahen në formën e grantit. Ky fond shpërndahet sipas kategorive: granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë, granti i mësimdhënies, granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese.

➤ **Programi afat mesëm i buxhetit:** UMT është i organizuar dhe funksionon si një strukturë e centralizuar, procedurat e prokurimit për mallra, punë dhe shërbime edhe për njësitë vartëse realizohen në mënyrë të përqëndruar nga Administrata e Rektoratit, me të njëjtin kod buxhetor. Programimi afat mesëm i buxhetit të Universitetit të Mjekësisë Tiranë është i lidhur me programimin buxhetor të të gjitha njësive vartëse të tij e cila përbëhet nga strukturat varësisë si: FM, FSHMT dhe FMD .

Tabela nr. 1: Zërat 600, 601, 602, 606, 231 sipas PBA, kod programi 09450, për vitet 2020-2022.

(në lekë)

Nr	Emërtimi	Viti 2020		Viti 2021		Viti 2022	
		Programuar	Çelur	Programuar	Çelur	Programuar	Çelur
1	Paga, art. (600)	628,627,000	591,241,340	599,499,000	594,423,559	607,790,000	560,288,908
2	Sigurimet shoq. dhe shëndetës., art. (601)	88,299,000	95,764,328	88,377,000	96,019,570	89,117,000	85,867,318
3	Shpenzimet operative, art. (602)		20,984,540		78,042,503		122,425,776
4	Bursa për studentët, art. (606)	126,061,000	160,658,244	137,821,000	140,432,189	150,644,000	168,229,396
5	Investime, art. (230)						
6	Investime, art. (231)	25,400,000	0				32,500,000
TOTAL BUXHETI		868,387,000	868,648,452	825,697,000	908,917,821	847,551,000	969,311,398

Burimi: UMT.

Referuar programit buxhetor afatmesëm sipas kod programit 09450, llogaria 600 “Pagat” është programuar për vlerën 628,627,000 lekë dhe çelur për 591,241,340 lekë për vitin 2020. Për vitin 2021 është programuar për vlerën 599,499,000 lekë dhe çelur për 594,423,559 lekë. Për vitin 2022 është programuar për vlerën 607,790,000 lekë dhe çelur për 560,288,908 lekë.

Referuar programit buxhetor afatmesëm sipas kod programit 09450, llogaria 601 “Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore” është programuar për vlerën 88,299,000 lekë dhe çelur për 95,764,328 lekë për vitin 2020. Për vitin 2021 është programuar për vlerën 88,377,000 lekë dhe

çelur për 96,019,570 lekë. Për vitin 2022 është programuar për vlerën 89,117,000 lekë dhe çelur për 85,867,318 lekë. Shuma prej 32,500,000 lekë i Projekt FMD “Aplikim i teknologjisë digjitale në stomatologji”, zëri “Investime”, art. (231) në vitin 2022 u tërhoq nga MAS-Akkshi në dhjetor 2022. Ndërsa shuma 25,400,000 lekë, zëri “Investime” art. (231) në vitin 2020 është programuar, por nuk është çelur.

Tabela nr. 2: Zërat 600, 601, 602, 606, 231 sipas PBA, kod programi 09770, për vitet 2020-2022.

(në lekë)

Nr	Emërtimi	Viti 2020		Viti 2021		Viti 2022	
		Programuar	Çelur	Programuar	Çelur	Programuar	Çelur
1	Paga, art. (600)	0	0	0	0	0	0
2	Sigurimet shoq. dhe shëndetës., art. (601)	0	0	0	0	0	0
3	Shpenzimet operative, art. (602)	0	8,500,000	0	2,614,500	0	5,314,500
4	Bursa për studentët, art. (606)	0	0	0	0	0	0
5	Investime, art. (230)	0	0	0	0	0	0
6	Investime, art. (231)	0	0	0	0	338,272	1,012,540
TOTAL BUXHETI		0	8,500,000	0	2,614,500	338,272	6,327,040

Burimi: UMT.

Referuar programit buxhetor afatmesëm sipas kod programit 09770, llogaria 602 “Shpenzime operative” është çelur në vlerën 8,500,000 lekë për vitin 2020, për 2,614,500 lekë për vitin 2021 dhe 5,314,500 lekë për vitin 2022. Ndërsa zëri 231 është programuar për vlerën 338,272 lekë dhe çelur për vlerën 1,012,540 lekë.

➤ **Zbatimi vjetor i buxhetit** Referuar Ligjit nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH”, Neni 52 “Funksionet e Administratorit”, pika 1/c, ku shprehet se:

“1. Administratori kryen këto funksione: c) ndjek dhe kontrollon zbatimin e buxhetit vjetor të institucionit të arsimit të lartë në strukturat e varësisë së tij”.

Më poshtë paraqiten të dhënat e zbatimit vjetor të buxhetit në UMT përgjatë periudhës së auditimit 2020-2022:

Tabela nr. 3: Zbatimi vjetor i buxhetit për vitet 2020-2022, kod programi 09450. (në lekë)

Nr	Emërtimi	Viti 2020			Viti 2021			Viti 2022		
		Plan	Fakt	Realizimi në %	Plan	Fakt	Realizimi në %	Plan	Fakt	Realizimi në %
1	Paga, art. (600)	591,241,340	490,130,958	82.90	594,423,559	531,464,303	89.41	560,288,908	524,669,263	93.64
2	Sigurimet shoq. dhe shëndetës. art. (601)	95,764,328	77,481,670	80.91	96,019,570	84,486,331	87.99	85,867,318	76,392,265	88.97
3	Shpenzimet operative. Art. (602)	20,984,540	11,532,252	54.96	78,042,500	28,799,724	36.90	122,425,776	52,870,785	43.19
4	Bursa për studentët, art. (606)+trf tjera	160,658,244	121,289,746	75.50	140,432,189	136,086,321	96.91	168,229,396	166,110,525	98.74
5	Investime, art. (230)	0	0	0	0	0	0	0	0	0
6	Investime, art. (231)	0	0	0	0	0	0	0	0	0
TOTAL BUXHETI		868,648,452	700,434,626	80.63	908,917,818	780,836,679	85.91	936,811,398	820,042,838	87.54

Burimi: UMT.

Tabela nr. 4: Zbatimi vjetor i buxhetit për vitet 2020-2022, kod programi 09770. (në lekë)

Nr	Emërtimi	Viti 2020			Viti 2021			Viti 2022		
		Plan	Fakt	Realizimi në %	Plan	Fakt	Realizimi në %	Plan	Fakt	Realizimi në %
1	Paga, art. (600)	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2	Sigurimet shoq. dhe shëndetës. art. (601)	0	0	0	0	0	0	0	0	0
3	Shpenzimet operative. Art. (602)	8,500,000	0	0	2,614,500	0	0	5,314,500	1,820,500	34.26
4	Bursa për studentët, art. (606)+trf tjera	0	0	0	0	0	0	0	0	0
5	Investime, art. (230)	0	0	0	0	0	0	0	0	0
6	Investime, art. (231)	6,240,000	6,240,000	100	0	0	0	1,012,540	1,012,540	100
TOTAL BUXHETI		14,740,000	6,240,000	42	2,614,500	0	0	6,327,040	2,833,040	45

Burimi: UMT.

Përsa i përket zbatimit të buxhetit, për vitin 2020 dhe 2022 sipas kod programit 09770, zëri 231 “Investime” është realizuar në masën 100%.

➤ **Llogaria e pagave dhe llogaria e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për Rektoratin dhe tre njësitë shpenzuese sipas viteve 2020-2022.**

Tabela nr. 5: Llogaritë 600 dhe 601 nga granti buxhetor (08) të planifikuara dhe të realizuara sipas njësjësive shpenzuese për vitin 2020: (në lekë)

Nr	Njësitë shpenzuese	Plan Paga (Ilog. 600)	Rialokimi Paga (Ilog. 600)	Fakt Paga (Ilog. 600)	Realizimi në % (Ilog. 600)	Plan Kontribute (Ilog. 601)	Rialokimi Kontribute (Ilog. 601)	Fakt Kontribute (Ilog. 601)	Realizimi në % (Ilog. 601)
1	Rektorati	48,670,232	48,588,232	28,765,531	59	8,109,426	8,109,426	4,824,813	59
2	Fakulteti i jekësisë	375,139,182	374,255,749	313,698,195	84	60,204,039	60,204,039	49,685,116	83
3	Fakulteti i MD	61,387,899	61,387,899	40,657,772	66	9,563,163	9,563,163	6,174,797	65
4	Fakulteti SHMT	107,112,300	107,009,460	107,009,460	100	17,887,700	17,887,700	16,796,944	94
	TOTALI	592,309,613	591,241,340	490,130,958	83	95,764,328	95,764,328	77,481,670	81

Burimi: UMT.

Tabela nr. 6: Llogaritë 600 dhe 601 nga granti buxhetor (08) të planifikuara dhe të realizuara sipas njësjësive shpenzuese për vitin 2021: (në lekë)

Nr	Njësitë shpenzuese	Plan Paga	Rialokimi Paga	Fakt Paga	Realizimi në %	Plan Kontribute	Fakt Kontribute	Realizimi në %
1	Rektorati	51,331,234	51,147,430	34,956,741	68.35	8,572,316	5,826,201	67.97
2	FM	342,819,622	342,301,744	322,936,513	94.34	54,977,830	53,114,064	96.61
3	FMD	73,365,208	73,249,861	53,884,002	73.56	9,837,639	7,057,707	71.74
4	FSHMT	127,897,439	127,724,524	119,687,047	93.71	22,631,785	18,488,359	81.69
	TOTALI	595,413,503	594,423,559	531,464,303	89.41	96,019,570	84,486,331	87.99

Burimi: UMT.

Tabela nr. 7: Llogaritë 600 dhe 601 nga granti buxhetor (08) të planifikuara dhe të realizuara sipas njësjësive shpenzuese për vitin 2022: (në lekë)

Nr	Njësitë shpenzuese	Plan Paga	Rialokimi Paga (Ilog. 600)	Fakt Paga	Realizimi në %	Plan Kontribute (Ilog. 601)	Rialokimi Kontribute (Ilog. 601)	Fakt Kontribute (Ilog. 601)	Realizimi në %
1	Rektorati	52,190,689	51,660,689	36,245,018	70.16	8,746,115	8,746,115	6,054,722	69.23
2	FM	342,051,411	331,667,920	329,670,703	99.40	46,091,526	46,713,078	46,091,526	98.67
3	FMD	59,360,313	56,952,768	50,409,391	88.51	8,700,408	8,762,272	7,738,747	88.32
4	FSHMT	120,182,706	120,007,531	108,410,341	90.34	21,450,853	21,645,853	16,507,270	76.26
	TOTALI	573,785,119	560,288,908	524,735,453	93.65	84,988,902	85,867,318	76,392,265	88.97

Burimi: UMT.

➤ **Granti buxhetor për Rektoratin dhe tre njësitë shpenzuese përgjatë periudhës së auditimit 2020-2022:**

Tabela nr. 8: Granti buxhetor viti 2020-2022, kod programi 09450. (në lekë)

Emërtimi	Granti buxhetor Kod programi 09450											
	Viti 2020				Viti 2021				Viti 2022			
	Granti fillestar i akorduar për vitin 2020	Granti i trashëguara nga viti 2019	Rialokime	Total Grant viti 2020	Granti fillestar i akorduar për vitin 2021	Granti i trashëguara nga viti 2020	Rialokime	Total Grant viti 2021	Granti fillestar i akorduar për vitin 2022	Granti i trashëguar nga viti 2021	Rialokime	Total Grant viti 2022
Rektorati	59,060,276	6,779,658		65,839,934	46,296,232	24,562,256		70,858,488	56,000,000	20,151,546	3,210,000	79,361,546
FM	440,941,126	73,694,174		514,635,300	402,311,142	95,867,489		498,178,631	458,208,584	57,635,817	4,343,417	520,187,818
FMD	94,394,390	5,285,995		99,680,385	77,838,243	37,114,008		114,952,251	72,852,628	29,349,925	7,405,309	109,607,862
FSHMT	169,577,587	18,915,246		188,492,833	205,758,376	19,170,072		224,928,448	205,347,656	20,943,851	1,362,665	227,654,172
TOTALI	763,973,379	104,675,073		868,648,452	732,203,993	176,713,825		908,917,818	792,408,868	128,081,139	16,321,391	936,811,398

Burimi: UMT.

Tabela nr. 9: Granti buxhetor viti 2020-2022, kod programi 09770. (në lekë)

Emërtimi	Granti buxhetor Kod programi 09770											
	Viti 2020				Viti 2021				Viti 2022			
	Grant fillestar i akorduar per	Grant i trashëguara nga viti 2019	Rialokime	Total Grant viti 2020	Grant fillestar i akorduar per	Grant i trashëguar nga	Rialokime	Total Grant viti 2021	Grant akorduar për vitin 2022	Grant i trashëguar nga viti 2021	Rialokime	Total Grant viti 2022
Rektorati		8,500,000	6,240,000	14,740,000		0	2,614,500	2,614,500	2,700,000	2,614,500	1,012,540	6,327,040
FM				0				0				0
FMD				0				0				0
FSHMT				0				0				0
TOTALI		8,500,000	6,240,000	14,740,000	0	0	2,614,500	2,614,500	2,700,000	2,614,500	1,012,540	6,327,040

Burimi: UMT.

Granti buxhetor i UMT sipas kod programi 09450, për vitin 2020 është 868,648,452 lekë, për vitin 2021 është 908,917,818 lekë dhe për vitin 2022 është 936,811,398 lekë. Ndërsa granti buxhetor I UMT sipas kod programi 09770, për vitin 2020 është 14,740,000 lekë, për vitin 2021 është 2,614,500 lekë dhe për vitin 2022 është 6,327,040 lekë.

➤ **Investimet në UMT që financohen nga pjesa e grantit**

Tabelë nr. 10: Investime në UMT që financohen nga pjesa e grantit, Projektet me Financim të Brendshëm. (në lekë)

Nr	Kodi i projektit	Emertimi	Programi	Llogaria ekonomik	Viti i fillimit te projektit	Plani	Fakti	Realizimi
1	18BD413	Vlerësimi i protezave fikse metal qeramikë dhe total qeramikë të mbështetura mbi implante Fakulteti i Mjeksisë Dentare_Universitetit të Mjekësisë Tiranë	9450	231	2022	200,000	180,000	90
2	18BD414	Aplikimi i teknologjisë dixhitale në stomatologji Fakulteti i Mjeksisë Dentare_Universitetit të Mjekësisë Tiranë.	9450	231	2022	22,100,000	21,504,000	97
3	20AB210	Projekti DigiCare4You " Nje zgjidhje inovative ndërsektoriale qe përfshin mjete DIGItal, fuqizimin e familjeve dhe integrimin e shërbimeve CARE ne komunitet dhe parandalimin dhe menaxhimin e diabetit te tipit 2 te hipertensionit	9450	231	2021	154,352	154,352	100
4	18CD236	TVSH-Universiteti Mjeksisë-Projekti "Quality development of internacional cooperation and project management (QUADIC)"	9770	231	2022	338,272	338,272	100
5	20AB209	TVSH-UMT-projekti "IDEA"	9770	231	2022	674,268	674,268	100
TOTALI						23,466,892	22,850,892	97

Burimi: UMT.

Lidhur me investimet e UMT, llogaria 231 preket vetëm nga projektet me financim të brendshëm, pasi investimet në UMT financohen vetëm nga të ardhurat. Përjashtim bëjnë vetëm projektet dhe TVSH-të e paraqitura në tabelën e mësipërme, të cilat financohen nga pjesa e grantit. Konkretisht, projekti i parë është “Vlerësimi i protezave fikse metal qeramikë dhe total qeramikë të mbështetura mbi implante Fakulteti i Mjeksisë Dentare_Universitetit të Mjekësisë Tiranë”, i cili është realizuar në masën 90%. Projekti i dytë është “Aplikimi i teknologjisë dixhitale në stomatologji Fakulteti i Mjeksisë Dentare_Universitetit të Mjekësisë Tiranë”, i cili ka filluar në vitin 2022 dhe është realizuar në masën 97%. “Projektit DigiCare4You "Një zgjidhje inovative ndërsektoriale që përfshin mjete DIGItal, fuqizimin e familjeve dhe integrimin e shërbimeve CARE në komunitet dhe parandalimin dhe menaxhimin e diabetit të tipit 2 të hipertensionit”, i cili ka nisur në vitin 2021 dhe është realizuar në masën 100%. Gjithashtu, TVSH për Projektin “Quality development of internacional cooperation and project management (QUADIC)” dhe TVSH për projektin “Idea” e cila është realizuar në masën 100%.

Nga auditimi u konstatua, mungesa e një analize të mirëstrukturuar për planifikimin e nevojave buxhetore të secilit departament.

Konstatohet ndryshim (transferim) i fondeve, pa patur një analizë të detajuar argumentuese të situatës apo arsyeve që çojnë në këtë vendimmarrje. Kjo dëshmon për një sistem të menaxhimit financiar jo të mirëkonsoliduar.

Titulli i gjetjes:	Nga auditimi në UMT u konstatua, mungesa e një analize të mirëstrukturuar për planifikimin e nevojave buxhetore të secilit departament.
Situata:	Nga auditimi në UMT u konstatua se nuk është bërë një analizë e mirë strukturuar për planifikimin e nevojave buxhetore. Nga auditimi konstatohet ndryshim (transferim) i fondeve, pa patur një analizë të detajuar argumentuese të situatës apo arsyeve që çojnë në këtë vendimmarrje. Kjo dëshmon për një sistem të menaxhimit financiar jo të mirë konsoliduar.
Kriteri:	- Ligji nr. 57 datë 02.06.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 3, pika 29. - Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 16, pika 2.
Ndikimi/Efekti:	Mos eficientë në arritjen e objektivave dhe politikave të miratuara për UMT.
Shkaku:	Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e mos vlerësimit sa dhe si duhet nga organet drejtuese.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Nga ana e Drejtorisë Ekonomike dhe personave përgjegjës të merren masa, për të kryer planifikimin e buxhetit të pritshëm për t’u akorduar nëpërmjet një analize konsoliduese të mirëstrukturuar të situatës faktike dhe nevojave të departamenteve.
Rekomandimi:	Nga ana e UMT të merren masa që strukturat që do të merren me programimin dhe planifikimin buxhetor, të kryejnë analiza të hollësishme të të gjithë treguesve të buxhetit referuar kuadrit rregullator ligjor përkatës, me qëllim eliminimin e ndryshimeve të konsiderueshme të buxhetit gjatë vitit ushtrimor.

Nga auditimi konstatohet se, është i pranishëm risku i kryerjes së parashikimeve të pabazuara nga ana e departamentit të menaxhimit të programeve, që figurojnë me përqindje të ulët realizueshmërie në disa raste.

Referuar zërave në buxhet, figurojnë me përqindje të ulët realizueshmërie në disa raste. Nga auditimi u konstatua se janë parashikuar zëra në llogarinë 602 “Shpenzime operative”, të cilat nuk janë realizuar siç është planifikuar. Prandaj, llogaria 602 në vitin 2020 është realizuar në masën 54.96%, në vitin 2021 është realizuar në masën 36.90% dhe në vitin 2022 në masën 43.19%. Zbatimi i buxhetit për vitin 2020 është realizuar në masën 81%, për vitin 2021 në masën 86% dhe për vitin 2022 në masën 87%.

Titulli i gjetjes:	Nga auditimi konstatohet se, është i pranishëm risku i kryerjes së parashikimeve të pabazuara nga ana e departamentit të menaxhimit të programeve, që figurojnë me përqindje të ulët realizueshmërie në disa raste.
Situata:	Në UMT u konstatua se është i pranishëm risku i kryerjes së parashikimeve të pabazuara nga ana e Departamentit të Menaxhimit të programeve që figurojnë me përqindje të ulët realizueshmërie në disa raste. Referuar zërave

	në buxhet, figurojnë me përqindje të ulët realizueshmërie në disa raste. Nga auditimi u konstatua se janë parashikuar zëra në llogarinë 602 “Shpenzime operative”, të cilat nuk janë realizuar siç është planifikuar. Prandaj, llogaria 602 në vitin 2020 është realizuar në masën 54.96%, në vitin 2021 është realizuar në masën 36.90% dhe në vitin 2022 në masën 43.19%. Zbatimi i buxhetit për vitin 2020 është realizuar në masën 81%, për vitin 2021 në masën 86% dhe për vitin 2022 në masën 87%.
Kriteri:	<u>Ligji nr.57 datë 02.06.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 3, pika 29.</u>
Ndikimi/Efekti:	Mos efikasitet në arritjen e objektivave dhe politikave të miratuara për UMT.
Shkaku:	Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e mos vlerësimit sa dhe si duhet nga organet drejtuese.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi	Nga ana e Drejtorisë Ekonomike dhe personave përgjegjës të bëhet programimi i buxhetit duke pasur parasysh nevojat reale gjatë vitit të pritshëm buxhetor dhe të shmangen programimet duke rritur bazën në një përqindje të caktuar. Gjatë vitit të angazhohen vetëm ato shpenzime të cilat janë planifikuar sipas llojit dhe të mos ndryshohet destinacioni i përdorimit të këtyre fondeve brenda artikujve buxhetorë.

Nga auditimi u konstatua se, programi Buxhetor Afatmesëm për vitet 2021-2023 dhe 2022-2024 nuk janë miratuar brenda afateve të përcaktuara. Konkretisht:

- PBA për vitin 2021-2023 është miratuar nga Senati Akademik me vendim nr. 96, datë 20.10.2020, i protokolluar me nr. 2401/3 prot., datë e cila është jashtë afatit të përcaktuar me një diferencë prej 92 ditë kalendarike. PBA për vitin 2021-2023 është miratuar nga GMS me vendim nr. 2, datë 12.10.2020, i protokolluar me nr. 1180/25 prot., datë e cila është jashtë afatit të përcaktuar me një diferencë prej 84 ditë kalendarike. Ky veprim është në mospërputhje me: *Nenin 44, pika 3 dhe 4 e “Rregullores për administrimin financiar, kontabilitetin dhe kontrollin në UMT”*; *Ligji nr.57 date 02.06.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar*; *UMF nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”*; *UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde për zbatimin e buxhetit”*.

- PBA për vitin 2021-2023 është miratuar nga Bordi i Administrimit me vendim nr. 52, datë 23.12.2020, i protokolluar me nr. 2946/6 prot., datë e cila është jashtë afatit të përcaktuar me një diferencë prej 146 ditë kalendarike. Ky veprim është në mospërputhje me: *Nenin 44, pika 1 e “Rregullores për administrimin financiar, kontabilitetin dhe kontrollin në UMT”*; *Ligji nr.57 date 02.06.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar*; *UMF nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”*; *UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde për zbatimin e buxhetit”*.

- Nuk u gjet shkresa ku dokumentohet se PBA e vitit 2021-2023 i është dërguar MAS.

- Ndërsa, PBA për vitin 2022-2024 është miratuar nga Senati Akademik me vendim nr.63, datë 28.07.2021, i protokolluar me nr. 1871/10 prot., datë e cila është jashtë afatit të përcaktuar me një diferencë prej 8 ditë kalendarike.

- Nuk u gjet shkresa e miratimit të PBA për vitin 2022-2024 nga Grupi i Menaxhimit Strategjik. Ky veprim është në mospërputhje me: *Nenin 44, pika 3 dhe 4 e “Rregullores për administrimin financiar, kontabilitetin dhe kontrollin në UMT”*; *Ligji nr.57 date 02.06.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; UMF nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”; UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde për zbatimin e buxhetit”*.

- PBA për vitin 2022-2024 është miratuar nga Bordi i Administrimit me vendim nr. 55, datë 06.08.2021, i protokolluar me nr. 1314/25 prot., datë e cila është jashtë afatit të përcaktuar me një diferencë prej 7 ditë kalendarike. Ky veprim është në mospërputhje me: *Nenin 44, pika 1 e “Rregullores për administrimin financiar, kontabilitetin dhe kontrollin në UMT”*; *Ligji nr.57 date 02.06.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; UMF nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”; UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde për zbatimin e buxhetit”*. Ndërsa, PBA-ja për vitin 2022-2024 është përcjellë në Ministrinë përgjegjëse për arsimin (MAS) me shkresën nr. 1314/26 prot., datë 06.08.2021, të miratuar nga Administratori B.C, e cila është dërguar brenda afatit të përcaktuar (datës 15 gusht).

Ky veprim është në mospërputhje me: *-Vendim i Bordit të Administrimit të UMT nr.16, datë 25.02.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme të ndryshuar “Për administrimin financiar, kontabilitetin dhe kontrollin në UMT”, Neni 44, pika 3 dhe 4, Nenin 44 të “Rregullores për administrimin financiar, kontabilitetin dhe kontrollin në UMT”, pika 1, Neni 45 “Faza e miratimit”, pika 4, e “Rregullores për administrimin financiar, kontabilitetin dhe kontrollin në UMT”, Ligji nr.57 date 02.06.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; - UMF nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”; - UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde për zbatimin e buxhetit”*.

Nga auditimi u konstatua se, miratimi i Programit Buxhetor Afatmesëm për vitet 2023-2025 është realizuar jashtë afatit të përcaktuar, si dhe është dërguar fillimisht në MAS, pa kaluar hapat për miratim sipas rradhës kronologjike të përcaktuar me ligj, duke kaluar si fillim në Senat, GMS, Bord Administrimi, e së fundmi në MAS. Nga grupi i auditimit u konstatua se: PBA për vitin 2023-2025 është përcjellë fillimisht në Ministrinë përgjegjëse për arsimin (MAS) me shkresën nr. 1516/26, datë 19.08.2022, e cila është dërguar përpara se të merret miratimi për PBA-në nga Bordi i Administrimit, datë e cila është jashtë afatit të përcaktuar me një diferencë prej 4 ditë kalendarike (pra pas datës 15 Gusht). Ky veprim është në mospërputhje me: *Nenin 45 “Faza e miratimit”, Pika 4, e “Rregullores për administrimin financiar, kontabilitetin dhe kontrollin në UMT”*; *Ligjin nr. 57, datë 02.06.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; UMF nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”; UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde për zbatimin e buxhetit” dhe Ligjin nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në*

Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH”, Neni 38 “Funksionet e Senatit Akademik”, pika 1/h dhe Neni 49 “Funksionet e Bordit të Administrimit”, pika 1/c.

Pas dërgimit në MAS, PBA për vitin 2023-2025 është miratuar nga Senati Akademik me vendim nr. 67, datë 30.09.2022, i protokolluar me nr. 2703/2 prot., datë e cila është jashtë afatit të përcaktuar me një diferencë prej 72 ditë kalendarike. Ndërsa, PBA për vitin 2023-2025 është miratuar nga GMS me vendim nr. 3, datë 26.09.2022, i protokolluar me nr. 1516/27 prot., datë e cila është jashtë afatit të përcaktuar me një diferencë prej 68 ditë kalendarike.

Më tej, PBA për vitin 2023-2025 është miratuar nga Bordi i Administrimit me vendim nr. 65, datë 19.12.2022, i protokolluar me nr. 4487/1 prot., datë e cila është jashtë afatit të përcaktuar me një diferencë prej 142 ditë kalendarike.

Veprime në mospërputhje me: Neni 44, pika 1, 3 dhe 4, neni 45, pika 4, e “Rregullores për administrimin financiar, kontabilitetin dhe kontrollin në UMT, *Nenin 44, pika 1 e “Rregullores për administrimin financiar, kontabilitetin dhe kontrollin në UMT”;*

- Ligji nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH”, Neni 38 “Funksionet e Senatit Akademik”, pika 1/h, dhe Neni 49 “Funksionet e Bordit të Administrimit”, pika 1/c,

-Ligji nr.57 date 02.06.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

-UMF nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”;

-UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde për zbatimin e buxhetit”.

Afatet e raportimit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për Raportet e monitorimit për 4-mujorin e parë, të dytë dhe të tretë përgjatë periudhës së auditimit janë respektuar përveç një rasti. Konkretisht është Raporti i monitorimit për 4-mujorin e parë të vitit 2020 i cili është miratuar me vonesë. Referuar shkresës së protokolluar me nr. 1149 prot., datë 04.06.2020, drejtuar MAS për dërgimin e raportit të monitorimit për 4-mujorin e parë të vitit 2020 të UMT, nga grupi i auditimit u konstatua se nuk është respektuar afati me një diferencë prej 5 ditë kalendarike.

Titulli i gjetjes:	Nga auditimi u konstatua se, Programi Buxhetor Afatmesëm për vitet 2021-2023 dhe vitet 2022-2024 nuk është miratuar brenda afateve të përcaktuara.
Situata:	Nga auditimi u konstatua se, Programi Buxhetor Afatmesëm për vitet 2021-2023; PBA për vitet 2022-2024 dhe PBA për vitet 2023-2024 nuk janë miratuar brenda afateve të përcaktuara. Ndërkohë, miratimi i Programit Buxhetor Afatmesëm për vitet 2023-2025 është realizuar jashtë afatit të përcaktuar, si dhe është dërguar fillimisht në MAS, pa kaluar hapat për miratim sipas rradhës kronologjike të përcaktuar me ligj, duke kaluar si fillim në Senat, GMS, Bord Administrimi, e së fundmi në MAS. - PBA për vitin 2021-2023 është miratuar nga Senati Akademik me vendim nr. 96, datë 20.10.2020, i protokolluar me nr. 2401/3 prot., datë e cila është jashtë afatit të përcaktuar me një diferencë prej 92 ditë kalendarike. PBA për vitin 2021-2023 është miratuar nga GMS me vendim nr. 2, datë 12.10.2020, i protokolluar me nr. 1180/25 prot., datë e cila është jashtë afatit të përcaktuar me një diferencë prej 84 ditë kalendarike. PBA për vitin 2021-2023 është miratuar nga Bordi i Administrimit me vendim nr. 52, datë 23.12.2020, i

	<p>protokolluar me nr. 2946/6 prot., datë e cila është jashtë afatit të përcaktuar me një diferencë prej 146 ditë kalendarike. Nuk u gjet shkresa ku dokumentohet se PBA e vitit 2021-2023 i është dërguar MAS.</p> <p>- Ndërsa, PBA për vitin 2022-2024 është miratuar nga Senati Akademik me vendim nr.63, datë 28.07.2021, i protokolluar me nr. 1871/10 prot., datë e cila është jashtë afatit të përcaktuar me një diferencë prej 8 ditë kalendarike. Nuk u gjet shkresa e miratimit të PBA për vitin 2022-2024 nga Grupi i Menaxhimit Strategjik. - PBA për vitin 2022-2024 është miratuar nga Bordi i Administrimit me vendim nr. 55, datë 06.08.2021, i protokolluar me nr. 1314/25 prot., datë e cila është jashtë afatit të përcaktuar me një diferencë prej 7 ditë kalendarike. Ndërsa, PBA-ja për vitin 2022-2024 është përcjellë në Ministrinë përgjegjëse për arsimin (MAS) me shkresën nr. 1314/26 prot., datë 06.08.2021, të miratuar nga Administratori B.C, e cila është dërguar brenda afatit të përcaktuar (datës 15 gusht).</p> <p>- PBA për vitin 2023-2025 është përcjellë fillimisht në Ministrinë përgjegjëse për arsimin (MAS) me shkresën nr. 1516/26, datë 19.08.2022, e cila është dërguar përpara se të merret miratimi për PBA-në nga Bordi i Administrimit, datë e cila është jashtë afatit të përcaktuar me një diferencë prej 4 ditë kalendarike (pra pas datës 15 Gusht). Pas dërgimit në MAS, PBA për vitin 2023-2025 është miratuar nga Senati Akademik me vendim nr. 67, datë 30.09.2022, i protokolluar me nr. 2703/2 prot., datë e cila është jashtë afatit të përcaktuar me një diferencë prej 72 ditë kalendarike. Ndërsa, PBA për vitin 2023-2025 është miratuar nga GMS me vendim nr. 3, datë 26.09.2022, i protokolluar me nr. 1516/27 prot., datë e cila është jashtë afatit të përcaktuar me një diferencë prej 68 ditë kalendarike.</p>
Kriteri:	<p>-Ligji nr.57 date 02.06.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;</p> <p>- Rregullorja për administrimin financiar, kontabilitetin dhe kontrollin në UMT, Neni 44, pikat 1, 3 dhe 4 (miratuar me Vendim të Bordit të Administrimit të UMT nr.16, datë 25.02.2020);</p> <p>- Udhëzimi i MFE nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”;</p> <p>- Udhëzimi i MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde për zbatimin e buxhetit”.</p>
Ndikimi/Efekti:	Mos efikasitet në arritjen e objektivave dhe politikave të miratuara për UMT.
Shkaku:	Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e mos vlerësimit sa dhe si duhet nga organet drejtuese.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Nga ana e Administratorit të UMT-së, Drejtorisë Ekonomike dhe personave përgjegjës të merren masa për miratimin e programit buxhetor afatmesëm brenda afateve të përcaktuara në mënyrë që të mos pengohen proceset e punës.
	Nga Organet Drejtuese të merren masa për miratimin e programit buxhetor afatmesëm brenda afateve të përcaktuara dhe respektimin e radhës kronologjike e hierarkike duke u miratuar fillimisht në Senat, GMS, Bord

	Administrimi, e së fundmi në MAS, në mënyrë që të mos pengohen proceset e punës në UMT.
--	---

Nga auditimi u konstatua se, nuk është respektuar afati për raportimin në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit të Raportit të monitorimit për 4-mujorin e parë të vitit 2020 të UMT sipas afatit të përcaktuar.

Referuar shkresës së protokolluar me nr. 1149 prot., datë 04.06.2020, drejtuar MAS për dërgimin e raportit të monitorimit për 4-mujorin e parë të vitit 2020 të UMT, nga grupi i auditimit u konstatua se nuk është respektuar afati me një diferencë prej 5 ditë kalendarike.

Ky veprim është në mospërputhje me: UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde për zbatimin e buxhetit”, kapitulli VI: Raportet e monitorimit, pika 270 dhe kapitulli I, pika 45.

Titulli i gjetjes:	Nga auditimi u konstatua se, nuk është respektuar afati për raportimin në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit të Raportit të monitorimit për 4-mujorin e parë të vitit 2020 të UMT sipas afatit të përcaktuar.
Situata:	Në UMT, u konstatua se Raporti i Monitorimit për 4-mujorin e parë të vitit 2020 është dërguar jashtë afatit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Referuar shkresës së protokolluar me nr.1149 prot., datë 04.06.2020, drejtuar MAS për dërgimin e raportit të monitorimit për 4-mujorin e parë të vitit 2020 të UMT, nga grupi i auditimit u konstatua se nuk është respektuar afati me një diferencë prej 5 ditë kalendarike.
Kriteri:	- Udhëzimi i MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde për zbatimin e buxhetit”, kapitulli VI, pika 270 dhe kapitulli I, pika 45.
Ndikimi/Efekti:	Mos efikasitet në arritjen e objektivave dhe politikave të miratuara për UMT.
Shkaku:	Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e mos vlerësimit sa dhe si duhet nga organet drejtuese.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Nga ana e Drejtorisë Ekonomike dhe personave përgjegjës të merren masa për respektimin e afateve për raportimin në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit brenda afateve të përcaktuara në mënyrë që të mos pengohen proceset e punës në UMT.

2.7 Të ardhurat dhe përdorimi i tyre (të ardhurat nga pagesat e studentëve për arsimimin e shërbime të tjera; të ardhura të krijuara; të ardhura të krijuara nga marrëdhëniet me palët e tjera; të ardhura nga veprimtari kërkimore shkencore si dhe të ardhura nga donacionet, sponsorizimet dhe burime të tjera të ligjshme financimi.

Auditimi mbi krijimin dhe përdorimin e të ardhurave që realizon institucioni u krye mbi bazën e të ardhurave që kanë si burim krijimi: tarifat e shkollimit dhe të regjistrimit të studentëve konform dispozitave ligjore në fuqi që burojnë nga ligji nr. 80/2015, datë 22.07.2015, të cilat përbëhen nga: tarifat e shkollimit; tarifat e regjistrimit; tarifa të tjera administrimi si: tarifa për vërtetime e konfirmime dokumentacione, librezat diploma etj.

UMT ka arkëtuar të ardhura edhe nga projektet, financime nga organizata të ndryshme të huaja, si UNICEF, AUF, etj.

Të ardhurat e realizuara përdoren 100 % nga Universiteti Mjekësisë Tiranë, bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 108, “Autonomia financiare e institucioneve të arsimit të lartë”, pika 3, ku është përcaktuar se: “Të gjitha të ardhurat e krijuara nga institucionet publike të arsimit të lartë përdoren prej tyre dhe pjesa e papërdorur e të ardhurave mbartet në vitin pasardhës”. Të ardhurat detajohen dhe miratohen nga Bordi i Administrimit, për financimin e zërave të shpenzimeve, e konkretisht me vendimet:

Për PBA:

- PBA për vitin 2021-2023 është miratuar nga Bordi i Administrimit me vendim nr. 52, datë 23.12.2020, i protokolluar me nr. 2946/6 prot.;
- PBA për vitin 2022-2024 është miratuar nga Bordi i Administrimit me vendim nr. 55, datë 06.08.2021, i protokolluar me nr. 1314/25 prot.;
- PBA për vitin 2023-2025 është miratuar nga Bordi i Administrimit me vendim nr. 65, datë 19.12.2022, i protokolluar me nr. 4487/1 prot.

Për buxhetin:

- Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 28, datë 22.06.2020;
- Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 33, datë 26.04.2021;
- Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 33, datë 13.04.2022.

Për përdorimin e të ardhurave në zbatim të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”:

- neni 49 “Funksionet e Bordit të Administrimit në institucionet e arsimit të lartë”, pika ë), ku është përcaktuar se: “ë- Bordit të Administrimit përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit”, dhe

-neni 109 “Burimet e financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë”, pika 3, ku është përcaktuar se: “Institucionet publike të arsimit të lartë rregullojnë në aktet e tyre të brendshme mënyrën e përdorimit të fondeve të krijuara nga të ardhurat e përcaktuara në këtë nen, me përjashtim të të ardhurave nga Buxheti i Shtetit”,

me Vendimin nr.16, datë 25.02.2020, është miratuar rregullorja, “Për administrimin financiar, kontabilitetin dhe kontrollin në UMT”, ku përdorimi i të ardhurave është përcaktuar në nenin 7, “Përdorimi i të ardhurave”.

Për periudhën objekt auditimi të ardhurat e realizuara paraqiten:

Në lekë.

Viti	Rektorat	FM	FMD	FSHMT	TOTALI	Të ardhurat neto/reale *
2022	40,754,662	135,810,881	17,453,436	70,561,195	264,580,174	234,186,889
2021	31,249,790.25	116,224,472	15,492,316	64,584,295	227,550,873.25	209,701,289.25
2020	22,685,021.16	99,064,331.00	15,095,432.00	80,919,280.00	217,764,064.16	198,345,571

Burimi i të dhënave UMT

*Shënim: pa përfshirë transfertat brenda sistemit të UMT (transferta ne Rektorat), të miratuara në vendimin e bordit të administrimit të treguesve të buxhetit vjetor.

Transfertat e brendëshme në Rektorat janë të miratuara me vendimet e bordit të administrimit për miratimin e buxhetit të çdo viti.

Të ardhurat e realizuara analitike sipas njësive shpenzuese sipas zërave për periudhën janar – dhjetor 2022, 2021 dhe 2020, paraqiten në aneksin nr. 7, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Të ardhurat kryesore të UMT-së sigurohen nga tarifat e shkollimit.

Tarifat e shkollimit për vitet 2020, 2021, 2022 janë të pa ndryshueshme. Të ardhurat e arkëtuara nga tarifat e shkollimit përfshijnë vlerën e tarifave me 50% të pagesës të studimeve për ciklin e parë dhe të integruar për studentët me notë mesatare 6-9, vlerën e plotë të pagesës për studentët me notë mesare 5-6 dhe vlerën e plotë të pagesës për ciklin e dytë dhe ciklin e tretë, duke u bazuar në VKM-të përkatëse, të miratuara dhe me vendime të Bordit të Administrimit.

Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave si UMT për vitet objekt auditimi paraqitet sipas tabelës sa më poshtë vijon:

Në 000 lekë

Emërtimi	Viti 2020			Viti 2021			Viti 2022		
	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
Tarifa regjistrimi	3,320	6,820,5	205	5,600	6,402	114.3	5,900	8,269,6	140
Tarifa shkollimi	250,051	182,118,5	73	219,564	184,1	83.8	199,263,8	209,600,8	105
Te tjera	5,425	7,492,4	138	5,600	7,633	136.3	5,800	7,814,1	135
Totali	258,796	196,431	76	230,764	15,600	85.8	210,963,8	225,684,5	107

Burimi i të dhënave UMT

Arsyet e mosrealizimit apo tejkallimit të të ardhurave:

- në zërin tarifa rregjistrimi janë: dhënie me qera ambientësh, sekuestime e cdëmtime dhe kthim detyrimi (bursë)
- në zërin tarifë rregjistrimi: rritja e kuotave

Realizimi i fondeve nga të ardhurat e planifikuara për përdorim dhe shpenzimi faktik sipas viteve dhe zërave të shpenzimeve si vijon: (UMT Total):


në 000/lekë

Emërtimi	Viti 2020			Viti 2021			Viti 2022		
	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
Paga, art. (600)	298,627	59,626	20	237,038	34,178	14	236,272	60,318	26
Sigurimet shoq. dhe shëndetës. art. (601)	17,310	2,514	15	5,403	1,842	34	21,124	12,240	58
Shpenz.operative (602)	141,460	54,647	39	101,416	44,915	44	65,660	28,444	43

Emërtimi	Viti 2020			Viti 2021			Viti 2022		
	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
Shpenzime transfertore korente të brendshme, art. (604)	26,663	19,518	73	24,019	18,400	77	30,394	30,493	100
Shpenzime transfertore korente të huaja, (605)	105	19	18	107	93	87	278	19	7
Bursa për studentët, art. (606)+trf tjera	1,500	1,034	69	3,530	1,410	40	1,955	309	16
Investime, art. (230+231)	230,022	87,769	38	175,003	15,698	9	185,787	17,247	9
Total nga të ardhurat	715,687	225,127	31	546,515	116,535	21	541,469	149,069	28
Projekt org nderk /600+601+602				12,664	12,664	100	8,502	8,497	100

Burimi i të dhënave UMT


Nga ku rezulton një realizim mesatar për të gjithë zërat në 39.8%, konkretisht grafiku sa më poshtë vijon:



Realizimi i fondeve nga të ardhurat (UMT total), për artikullin 602 “mallra dhe shërbime të tjera” për vitet 2022, 2021 dhe 2020.

Artikulli 602 “mallra dhe shërbime të tjera”	2022			2021			2020		
	Plani	Fakti	%	Plani	Fakti	%	Plani	Fakti	%
Totali	65,660	28,444	43.3	101,416	44,915	44.4	141,460	54,647	38.6

Nga ku rezulton se nga të ardhurat, për vitet 2022, 2021 dhe 2020, për artikullin 602 “mallra dhe shërbime të tjera”, ka një realizim mesatar vjetor 42.1%, ku % më e madhe e mosrealizimit është e vitit 2020, grafiksht sa vijon:



○ **Arsyet e mosrealizimit të përdorimit të të ardhurave në shpenzime operative dhe investime.**

● **Shpenzimet nga të ardhurat në shpenzime operative dhe investime.**

Për vitin 2020: për sa i përket shpenzimeve operative dhe investimeve janë shpenzime që lidhen me procedurat e prokurimit, realizimi i të cilave, sipas përcaktimit ligjor fillon pas miratimit të buxhetit të vitit aktual.

Miratimi i buxhetit për vitin 2020 është kryer në fund të muajit qershor, (*Vendimi i Bordit të Administrimit nr.28, datë 22.06.2020, “Mbi miratimin e buxhetit për vitin 2020*), gjithashtu mbas datës 15.10.2020 kanë vazhduar procedurat vetëm për ato prokurime që ishin në proces dhe nuk janë realizuar prokurime të reja.

Gjatë vitit ka pasur edhe procedura të pezulluara nga KPP-ja dhe është pritur përgjigja për vazhdimin e tyre.

Në procedurat e prokurimit (investime) është edhe hartimi i projektpreventiva për rikonstruksionin e godinave të FM të dëmtuara nga tërmeti.

Investimet e përfunduara, të realizuara në vitin 2020, janë të gjitha nga procedurat e prokurimit të nisura në vitin 2019 të cilat janë finalizuar në vitin 2020.

Për vitin 2021: Shpenzimet operative dhe investimet janë shpenzime që lidhen me procedurat e prokurimit, realizimi i të cilave, sipas përcaktimit ligjor fillon pas miratimit të buxhetit të vitit aktual. Miratimi i buxhetit për vitin 2021, u krye në muaji prill, (*Vendimi i Bordit të Administrimit nr.33, datë 13.04.2021, “Mbi miratimin e buxhetit për vitin 2021*), Gjithashtu mbas datës 15.10.2021 kanë vazhduar procedurat vetëm ato prokurime që ishin në proces dhe nuk janë realizuar prokurime të reja.

Në rregjistrin e parashikimit publik të vitit 2021, një pjesë e procedurave janë parashikuar të zhvillohen të përqëndruara dhe një pjesë nëpërmjet procedurave të prokurimit për blerjet e vogla nga njësitë shpenzuese të UMT-së. Për shkak të situatës së krijuar nga COVID 19 dhe kthimit në mësim online, procedurat e prokurimit nuk u realizuan. Gjatë vitit ka pasur edhe procedura të pezulluara nga KPP-ja dhe është pritur përgjigja për vazhdimin e tyre.

Për vitin 2022: Shpenzimet operative dhe investimet janë shpenzimet të cilat lidhen me procedurat e prokurimit, realizimi i të cilave, sipas përcaktimit ligjor fillon pas miratimit të buxhetit të vitit aktual. Miratimi i buxhetit për vitin 2022, u krye në muaji prill, (*Vendimi i Bordit të Administrimit nr.33, datë 13.04.2022 “Për miratimin e treguesve të buxhetit për vitin 2022, për Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”*).

Gjithashtu për disa shpenzime për blerje e shërbime, disa procedura prokurimi, janë realizuar në vitin 2022 dhe kontratat janë finalizuar në fund të vitit 2022 dhe fillim viti 2023, e rrjedhimisht likujdimet janë kryer në vitin pasardhës. Gjatë vitit ka pasur edhe procedura të pezulluara nga KPP-ja dhe është pritur përgjigja për vazhdimin e tyre.

Realizimi i zërit paga dhe kontribute nga të ardhurat sipas njësive shpenzuese: (në 000/lekë)

Njësitë shpenzuese	Viti 2022						Viti 2021						Viti 2020					
	Paga			Kontribute			Paga			Kontribute			Paga			Kontribute		
	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
Rektorati	300	281	93.7	30	28	95.2	652	653	100	107	107	100	508	508	100	0	0	0
FM	113,000	32,614	28.9	17,492	10,108	57.8	126,539	19,639	15.5	304	304	100	169,643	28,196	17	7,937	594	7.5

Njësitë shpenzuese	Viti 2022						Viti 2021						Viti 2020					
	Paga			Kontribute			Paga			Kontribute			Paga			Kontribute		
	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
FMD	400	304	76	50	50	100	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
FSH MT	123,272	27,117	22	3,631	2,053	56.5	110,182	14,470	46.8	5,311	1,496	28.2	128,984	30,921	24	9,373	1,921	20.5
Totali	236,272	60,317	25.5	21,124	12,240	57.7	237,372	34,761	14	5,418	1,907	35.2	298,627	59,626	20	17,310	2,514	14.5

Burimi i të dhënave UMT

***Shënim** Tek realizimi i zërit për paga dhe kontribute nga të ardhurat sipas njësive shpenzuese janë përfshirë edhe shpenzimet e pagave dhe sigurimeve për projektin.

Realizimi i fondeve nga të ardhurat (UMT total), për artikullin 602 “mallra dhe shërbime të tjera” sipas njësive shpenzuese për vitet 2022, 2021 dhe 2020 në mënyrë analitike paraqiten në aneksin 7/1 bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

○ **Arsyet e mosrealizimit të përdorimit të të ardhurave në shpenzimet e pagave.**

● **Shpenzimet nga të ardhurat në shpenzimet e pagave:**

Në lidhje me shpenzimet për paga dhe sigurime për vitet 2020, 2021 dhe 2022 ishin parashikuar të përballoheshin nga granti dhe të ardhurat.

Për vitin 2020: Për sa i përket shpenzimeve nga të ardhurat në shpenzimet e pagave në planin buxhetor të miratuar të vitit 2020, përveç shpenzimeve për pagesat për punonjesit efektiv, ishin parashikuar edhe pagesat e udhëheqësve dhe oponentëve për procesin e mbrojtjes së doktoraturave, orëve të mbingarkesës për stafin akademik të brendshëm si dhe pagesat për stafin të jashtëm. Diferencat në realizimin e shpenzimeve të planifikuara të pagave janë si rezultat i mungesave të stafit akademik dhe administrativ, **71 vënde vakante** Gjithashtu, zgjatja e vitit akademik në kushtet e pandemisë ka krijuar vonesa në dorëzimin e formularëve për ngarkesën mësimore të realizuar.

Për vitin 2021: Në shpenzimet e pagave në planin buxhetor të miratuar të vitit 2021, përveç shpenzimeve për pagesat për punonjesit efektive, ishin parashikuar edhe pagesat e orëve të mbingarkesës për stafin akademik të brendshëm e të jashtëm, shpenzimet për pagat për pedagoget me kontrate, pagesat e udhëheqësve dhe oponentëve për procesin e mbrojtjes së doktoraturave.

Diferencat në realizim e shpenzimeve të planifikuara të pagave janë si rezultat i mungesave në stafin akademik dhe stafin administrativ, **53 vënde vakante**. Gjithashtu nuk janë paguar të gjitha shpenzimet për ngarkesën mesimore pedagogë të brendshëm e të jashtëm, si dhe shpenzimet për pagat nga të ardhurat pedagoget me kontrate edhe për shkak të situatës së krijuar nga COVID 19

Për vitin 2022: Shpenzimet e pagave ishin parashikuar të përballoheshin nga granti dhe të ardhurat. Diferencat në realizim e shpenzimeve të planifikuara të pagave janë si rezultat i mungesave në stafin akademik dhe stafin administrativ, **73 vënde vakante** Gjithashtu nuk janë paguar të gjitha shpenzimet për ngarkesën mesimore pedagogë të brendshëm e të jashtëm. pagesat e udhëheqësve dhe oponentëve për procesin e mbrojtjes së doktoraturave.

Nga auditimi rezultoi se bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenet

108 “Autonomia financiare e institucioneve të arsimit të lartë”, pika 3, “Të gjitha të ardhurat e krijuara nga institucionet publike të arsimit të lartë përdoren prej tyre dhe pjesa e papërdorur e të ardhurave mbartet në vitin pasardhës”.

118 “Institucionet publike të pavarura të arsimit të lartë”, 5: “IALPP-të nuk kanë qëllim fitimin dhe të ardhurat e përfituara nga veprimtaria dhe pasuritë e tyre përdoren për realizimin e misionit të institucionit”.

Bazuar në këto akte, të ardhura të trashëguara në vitin pasardhës janë:

Viti	UMT		% e të ardhurave të trashëguara/vit ndaj të ardhurave /vit
	Të ardhurat neto/reale në total sipas viteve	Të ardhura të trashëguara në vitin pasardhës	
2022	234,186,889	802,513,792	342.7
2021	209,701,289.25	704,162,196	335.8
2020	198,345,571	711,593,504	358.8

Nga ku rezulton planifikim i pasaktë i përdorimit të të ardhurave.

Titulli i gjetjes	Mosvënie në përdorim të të ardhurave të realizuara nga UMT.
Situata	<p>Nga auditimi i planifikimit, realizimit dhe përdorimit të të ardhurave rezultoi se:</p> <p>1. Në zërat “tarifa rregjistrimi” dhe “të ardhura të tjera”, realizimi në vitet objekt auditimi është në kufijtë 114 – 205%, fakt që flet për një planifikim jo të saktë të të ardhurave. Ndërkohë që realizimi i fondeve nga të ardhurat e planifikuara për përdorim dhe shpenzimi faktik sipas viteve dhe zërave të shpenzimeve rezulton një realizim mesatar për të gjithë zërat në 39.8%. Për artikullin 602 “mallra dhe shërbime të tjera”, ka një realizim mesatar vjetor 42.1%, ku % më e madhe e mosrealizimit është e vitit 2020. Zëri i shpenzimit “Investime, art. (230+231)”, paraqitet me një nivel realizimi viti 2020 në 38% dhe vitet 2021 e 2022 përkatësisht me 9%, ku ka ndikuar shumë anulimi i procedurave të prokurimit apo zgjatja e procedurave të prokurimit. Në nivele të ulta paraqiten shpenzimeve nga të ardhurat në shpenzimet e pagave në planin buxhetor të miratuar të vitit 2020, 2021 e 2022. Një nga arsyet është mungesa stafit akademik dhe administrativ, 71 vënde vakante për vitin 2020, 53 vënde vakante për vitin 2021 dhe 73 vënde vakante. Gjithashtu nuk janë paguar të gjitha shpenzimet për ngarkesën mësimore pedagogë të brendshëm e të jashtëm, shpenzimet për pagat nga të ardhurat për pedagogët me kontratë, situata e krijuar nga COVID 19 (viti 2021) si dhe në vitin 2022 nuk janë paguar të gjitha shpenzimet për ngarkesën mesimore pedagogë të brendshëm e te jashtëm, pagesat e udhëheqësve dhe oponentëve për procesin e mbrojtjes së doktoraturave.</p> <p>2. Përdorimi i të ardhurave është me mosrealizime, janë trashëguar të ardhurat nga viti 2019 në vitin 2020 në shumën 711,593,504 lekë, nga viti 2020 në vitin 2021 në shumën 704,162,196 lekë dhe nga viti 2021 në vitin 2022 në shumën 802,513,792 lekë, ndërkohë që në ligjin nr. 80/2015, neni 118 “Institucionet publike të pavarura të arsimit të lartë”, në pikën 5, është përcaktuar se: “IALPP-të nuk kanë qëllim fitimin dhe të ardhurat e</p>

	<p>përfituara nga veprimtaria dhe pasuritë e tyre përdoren për realizimin e misionit të institucionit”.</p> <p>3. Nga auditimi i Marrëveshjeve të Bashkëpunimit midis UMT-së dhe Universiteteve të tjera publike ose private, u konstatua një Marrëveshje bashkëpunimi ,idis UMT-së dhe UT-së, për zhvillimin e lëndës mësimore të Fizikës, të Kimisë së Përgjithëshme dhe Organike si dhe për zhvillimin e lëndës së Biologjisë, marrëveshje e cila ka fillesat e saj nga viti 2014 enë vazhdim. Konkretisht, Marrëveshja me nr. 2879/10 Prot., datë 05.02.2014 protokolluar në Universitetin e Tiranës dhe nr. 1278/4 Prot., datë 11.02.2014 protokolluar në Universitetin e Mjekësisë, pasuar nga Marrëveshja me nr. 1523/2 Prot., datë 01.08.2016 protokolluar në Universitetin Mjekësor të Tiranës dhe nr. 2172/3 Prot., datë 10.08.2016 protokolluar në Universitetin e Tiranës. Për të dy këto Marrëveshje, Fakultetet përkatëse, kanë nënshkruar Aneks-Marrëveshje për marrjen me qira të ambienteve tek UT-ja për zhvillimin e orëve mësimore të lëndës së Fizikës, të Kimisë së Përgjithëshme dhe Organike si dhe për zhvillimin e lëndës së Biologjisë. Aneks-Marrëveshja e konstatuar nga grupi auditimit për marrje me qira ambientesh, është me nr. 26/6 Prot., datë 30.06.2020, protokolluar pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës të Universitetit të Tiranës dhe nr. 11/2 Prot., datë 30.06.2020, protokolluar pranë FMD , të Universitetit të Mjekësisë.</p> <p>Sa më sipër, UMT, ka pasur buxhet të trashëguar nga të ardhurat gjatë viteve, buxhet të cilin nuk e ka mirëadministruar për zhvillimin e misionit të saj, si krijimin e departamenteve të reja, duke pasur njëkohësisht mundësinë edhe të plotësimit me staf akademik dhe rritjen e investimeve në funksion të përmirësimit të shërbimit të mësimdhënies ndaj studentëve.</p>
Shkaku	Moskryerja e një analize ekonomike me qëllim shfrytëzimin e fondeve për nevojat e institucionit.
Efekti	Ngadalësimi i rritjes së cilësisë së shërbimeve të ofruara nga UMT, shërbime të cilat ndikojë në realizimin e misionit të institucionit
Kriteri	Ligji nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”
Rekomandimi	Nga ana e UMT, Drejtorisë Ekonomike dhe organeve kolegjale të merren masa për planifikimin e përdorimit të të ardhurave për nevojat institucionale në shërbim të mësimdhënies dhe rritjes së cilësisë së arsimit.
Rekomandimi	MAS, në bashkëpunim me UMT të marrin masat për të analizuar situatën me qëllim vënien në përdorim të fondeve të mbartuara për zhvillimin e mëtejshëm të UMT, duke u fokusuar në realizimin e misionit të institucionit, pse jo në hapjen e fakulteteve të reja në fushën e mjekësisë, si psh fakulteti i farmacisë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur komenti me shkresë nr. 1421/18, datë 21.11.23, e protokolluar në KLSH me nr. 401/16, datë 01.12.2023, “Komente mbi Projekt Raportin”, nga S.S.

Pretendimi i subjektit: Unë kam qenë 10 muaj ne tre vjetet e audituar. Kjo shumë është akumuluar ndër vite, nuk janë shqyrtuar shkresat e mia

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Ju sqarojmë se nuk është vendosur vetëm emri juaj në akt konstatim. Grupi i auditimit ka aduituar të gjitha praktikat e nevojshme në lidhje me këtë pikë të programit të auditimit. Ju, nuk jepni asnjë arsyetim për mosrealizimin e përdorimit të të ardhurave ku gjendja e papërdorur e të ardhurave më datë 31.12.2022 është në shumën 802,513,792 lekë.

2.8 Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet arkës, bankës në lekë dhe në valutë, blerjet e vogla për periudhën objekt auditimi (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime, etj.).

Dokumentacioni mbështetës i veprimeve dhe transaksioneve financiare:

Në lidhje me dokumentacionin e bankës u audituan me zgjedhje² dokumentat për periudhën objekt auditimi. Për kampionet e zgjedhura, urdhër shpenzimet përgjithësisht janë shoqëruar me dokumentacionin justifikues, janë të kontabilizuara në ditarin e bankës dhe ekstrakti i bankës rakordon me situacionet mujore të rakorduara nga dega e thesarit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit me përzgjedhje për shpenzimet e kryera me bankë në Rektorat për vitin 2022 konstatohet se:

- Me urdhër shpenzimin nr. 103, datë 16.06.2022 nëpërmjet bankës C është likujduar subjekti Eugen Islami për vlerën 120,000 lekë për blerje lule, fidanë (tapet bari). ; Proçesverbal i marrjes në dorëzim, datë 31.05.2022 nuk është protokolluar;

- Me urdhër shpenzimin nr. 113, datë 17.06.2022 “*Shpenzime udhëtimi brenda vendit për grupin e ekspertëve të projektit UNICEF*”, likujduar nëpërmjet bankës C në vlerën 33,000 lekë, dietat për 6 urdhër-shërbimet e punonjesve Z. E.R.dhe Z. E.T. (pedagogë në UMT). Dy faturat tatimore të hotelit për urdhër shpenzimet e datës 09.04.2022 të Z. E. R. dhe Z. E. T., nuk janë firmosur, në mospërputhje me: *UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar me nr. 20, datë 17.11.2014 pika 36 dhe 44.*

- Me urdhër shpenzimin nr.249, datë 22.12.2022 nëpërmjet bankës C është likujduar subjekti “S” SHPK për vlerën 345,000 lekë për blerje materiale laboratorike-reagentë për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël “Blerje kompletetesti laboratorik me metodë imunoenzimatike për matjen in vitro të antitropave IgG anti virus SARS-CoV-2 IgG në serum dhe plazëm me matje kuantitative” për realizimin e projektit: “Studimi i Përgjigjes imunitare ndaj infeksionit me virusin SARS-CoV-2 në popullatën shqiptare: Implikimet për fushatën e vaksinimit dhe planifikimin e masave për parandalimin dhe kufizimin e infeksionit COVID-19”, në zbatim të marrëveshjes me Agjencinë Universitare të Frankofonisë (AUF) ku konstatuam:

Kërkesa për mallra është e protokolluar me nr. 694/19 prot., datë 12.12.2022 nga Departamenti i Mjekesisë laboratorike (G.S), e cila është bërë dhe më parë datë 08.11.2022, me nr. 694/13 prot., i cili bashkëlidhur ka specifikimet teknike. Kërkesa për ndryshim rregjistri drejtuar Titullarit të Autoritetit Kontraktor është me nr.694/14 prot., datë 16.11.2022. Por nuk disponohet miratimi nga ana e tij për shtesë në rregjistër me objekt “Blerje reagent laboratorike”. Proçesverbali për përlllogaritjen e Fondit Limit i protokolluar me nr.694/20, datë 13.12.2022, ku u paraqitën 3 operatorë ekonomikë (A SHPK, S SHPK, B Albania), ku duke u bazuar në vlerën mesatare të 3 ofertave rezultoi në vlerën 289,168 lekë pa TVSH. Urdhër prokurimi me nr. 285, datë 13.12.2022, i protokolluar me nr. 694/21 prot., “Për blerje komplet reagentësh për matjen in vitro të antitropave IgG anti virus SARS-COV-2” gjithsej 5 kite, miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, Znj. S.S. Proçesverbali për hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për

²Auditimi me zgjedhje zhvillohet sipas ISA 530 (i rishikuar) “Kampioni i auditimit”, i cili tregon tipet e ndryshme të testeve që audituesi kryen. Përkufizimi i një kampioni të zgjedhur për auditim sipas ISA 530 është: “Aplikimi i procedurave të auditimit në më pak se 100% të artikujve brenda një grupi të caktuar të transaksioneve ose llogarive kontabël etj, në atë mënyrë që të gjithë kampionët të kenë të njëjtin shans për tu zgjedhur”.

kualifikim është i protokolluar me nr. 694/22, datë 13.12.2022 nuk i është përmbajtur kritereve të kërkuara nga Departamenti i Mjekësisë laboratorike në lidhje me pikën 3, ku thuhet se: “Në rast të paraqitjes së autorizimit nga distributor të vërtetohet lidhja midis prodhuesit dhe ditributorit”, por është kërkuar vetëm sa vijon: “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi/Distributori i Autorizuar”. Procedura është hapur datë 15.12.2022 në Sistemin e Prokurimit Publik (SPE) dhe protokolluar me nr. 694/25 prot., ku merr pjesë vetëm një OE, “S” SHPK, me vlerë 287,500 lekë. Marrja në dorëzim është realizuar me anë të Urdhrit të Brendshëm për ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të malli me nr. 294, datë 19.12.2022, datë 19.12.2022, i protokolluar me nr. 694/29 prot., ku është përcaktuar grupi me: znj. E.S (Kryetar), znj. M.K (Prifti) dhe znj. E.N (Anëtarë). Procesverbali për marrjen në dorëzim në datë 20.12.2022, i cili është protokolluar me nr. 694/32 prot., nuk ka të dhëna mbi faturën tatimore (numër datë vlerë), vlerën. Procesverbali i marrjes në dorëzim të kiteve nuk ka të përcaktuar datën e skadencës së kiteve. Nuk është përcaktuar skadencia e kiteve as në Procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike e kritereve për kualifikim. Nuk u gjet në dosje fatura elektronike ose faturë tatimore.

Nuk u gjetën në dosje gjithashtu: Urdhri i Titullarit për fletë-daljen e kiteve dhe destinacionin se ku do shkojnë, fletë-hyrje, fletë-dalje.

Veprime në mospërputhje me: *Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 36.* Nuk kemi dokumentacion justifikues lidhur me nënshkrimin e urdhërshpenzimit nga Drejtori i Drejtorisë dhe nga Administratori i UMT-së.

Titulli i gjetjes:	Parregullsi dhe mungesë dokumentash lidhur me procedurën e prokurimit me vlerë të vogël të Rektoratit të UMT: “Blerje kompletetestimi laboratorik me metodë imunoenzimatike për matjen in vitro të antitropave IgG anti virus SARS-CoV-2 IgG në serum dhe plazëm me matje kuantitative”.
Situata:	Nga auditimi u konstatua se, në procedurën e prokurimit me vlerë të vogël “Blerje kompletetestimi laboratorik me metodë imunoenzimatike për matjen in vitro të antitropave IgG anti virus SARS-CoV-2 IgG në serum dhe plazëm me matje kuantitative”, Procesverbali për marrjen në dorëzim të kiteve nuk ka të përcaktuar datën e skadencës së kiteve dhe nuk ka të dhëna mbi faturën tatimore (numër datë vlerë), vlerën. dhe mungesë dokumentesh. Ndërsa, Procesverbali për hartimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim është i protokolluar me nr. 694/22, datë 13.12.2022 nuk i është përmbajtur kritereve të kërkuara nga Departamenti i Mjekësisë laboratorike në lidhje me pikën 3. Urdhër prokurimi me nr. 285, datë 13.12.2022, i protokolluar me nr. 694/21 prot., “Për blerje komplet reagentësh për matjen in vitro të antitropave IgG anti virus SARS-COV-2” gjithsej 5 kite, miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, Znj. S.S. Procesverbali për hartimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim është i protokolluar me nr. 694/22, datë 13.12.2022 nuk i është përmbajtur kritereve të kërkuara nga Departamenti i Mjekësisë laboratorike në lidhje me pikën 3, ku thuhet se: “Në rast të paraqitjes së autorizimit nga distributor të vërtetohet lidhja midis prodhuesit dhe ditributorit”, por është kërkuar vetëm sa vijon: “Operatori

	<p>ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi/Distributori i Autorizuar”. Procedura është hapur datë 15.12.2022 në Sistemin e Prokurimit Publik (SPE) dhe protokolluar me nr. 694/25 prot., ku merr pjesë vetëm një OE, “S” SHPK, me vlerë 287,500 lekë. Marrja në dorëzim është realizuar me anë të Urdhrit të Brendshëm për ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të malli me nr. 294, datë 19.12.2022, datë 19.12.2022, i protokolluar me nr. 694/29 prot., ku është përcaktuar grupi me: znj. E.S (Kryetar), znj. M.K (Prifti) dhe znj. E.N (Anëtarë). Procesverbali për marrjen në dorëzim në datë 20.12.2022, i cili është protokolluar me nr. 694/32 prot., nuk ka të dhëna mbi faturën tatimore (numër datë vlerë), vlerën. Procesverbali i marrjes në dorëzim të kiteve nuk ka të përcaktuar datën e skadencës së kiteve. Nuk është përcaktuar skadencia e kiteve as në Procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike e kritereve për kualifikim. Nuk u gjet në dosje fatura elektronike ose faturë tatimore. Nuk u gjetën në dosje gjithashtu: Urdhri i Titullarit për fletë-daljen e kiteve dhe destinacionin se ku do shkojnë, fletë-hyrje, fletë-dalje.</p>
Kriteri:	UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 36.
Ndikimi/Efekti:	Mos eficientë në arritjen e objektivave dhe respektimin e afateve të skadencës së kiteve në momentin e marrjes në dorëzim.
Shkaku:	Neglizhencë në verifikimin e mallit të marrë në dorëzim, konkretisht skadencave të kiteve.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandimi:	Nga Komisioni i marrjes në dorëzim të merren masa për evidentimin e datave të skadencave të kiteve në procesverbalin e marrjes në dorëzim dhe plotësimin e të dhënave të faturave tatimore (numër, datë, vlerë), për të arritur objektivat dhe respektimin e afateve të skadencave të kiteve në përputhje me ligjin.
Rekomandimi:	Nga Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, Drejtoria Ekonomike dhe personat përgjegjës të merren masa për ndjekjen e mëtejshme të procedurës së prokurimit në mënyrë që të evidentohet arsyeja pse nuk janë kontrolluar datat e skadencave të kiteve dhe të plotësohet dosja me dokumentacionin e munguar.

Nga auditimi u konstatuan parregullsi dhe mungesë dokumentash lidhur me procedurën e prokurimit me vlerë të vogël të Rektoratit të UMT, konkretisht: për blerje laboratorike-reagentë “Blerje kite E antiNukleokapsid (NPC) SARS-COV” në zbatim të marrëveshjes me Agjencinë Universitare të Frankofonisë (AUF).

- Me urdhër shpenzimin nr. 185, datë 28.09.2022 nëpërmjet bankës R është likuaduar subjekti “S” SHPK për vlerën 1,002,240 lekë për blerje laboratorike-reagentë “Blerje kite E antiNukleokapsid (NPC) SARS-COV” në zbatim të marrëveshjes me Agjencinë Universitare të Frankofonisë (AUF), ku konstatuam:

Kërkesa për mallra është e protokolluar me nr. 694/1 prot., datë 28.06.2022 nga Departamenti i Mjekesisë laboratorike, Z. G.S, i cili ka bashkëlidhur specifikimet teknike për 16 kitet. Urdhri i

brendshëm për përlogaritjen e fondit limit me nr. 126, datë 21.07.2022, është i protokolluar me nr. 694/2 prot., me përbërje grupi: znj. L.K, z. F.Z dhe znj. D.S. Procesverbali për përlogaritjen e Fondit Limit është protokolluar me nr.694/3 prot., datë 22.07.2022 ku është përcaktuar vlera e fondit limit prej 836,000 lekë pa TVSH. Në formularin e deklaramit për konflikt interesi më datë 21.07.2022, znj. L.K nuk ka plotësuar që: nuk është në kushtet e konfliktit të interesit. Urdhër Prokurimi nr.163, datë 29.08.2022, me nr. 2363 prot., për blerje komplet reagentësh për përcaktimin e antitrapave të klasës IgG të drejtuar ndaj Proteinës SI të virusit SARS-COV-2 me metodë mikroimunoenzimatiqe semikuantitative të 16 kiteve, miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor S.S. Procesverbali për hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim është i protokolluar me nr. 2363/3, datë 02.09.2022. Ky procesverbal nuk i është përmbajtur kriterëve të kërkuara nga Departamenti i Mjekësisë laboratorike në lidhje me pikën 3, ku thuhet: Në rast të paraqitjes së autorizimit nga distributor të vërtetohet lidhja midis prodhuesit dhe ditributorit”, por është kërkuar vetëm sa vijon: “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi/Distributori i Autorizuar”. Procedura është hapur datë 06.09.2022 në orën 10:00 në Sistemin e Prokurimit Publik (SPE) dhe protokolluar me nr. 2363/6 prot., ku merr pjesë vetëm një OE, “S” SHPK. Marrja në dorëzim është realizuar me anë të Urdhrit të Brendshëm nr. 173, datë 12.09.2022, me nr. 2363/10 për ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të malli u përcaktuan: z. G. S. (Kryetar), znj. M.K (P.) dhe znj. E.N (Anëtarë). Procesverbali për marrjen në dorëzim të kiteve i protokolluar me nr.2363/11 prot., dhe datë 13.09.2022, nuk ka të përcaktuar datën e skadencës së kiteve. Fletë-hyrja në magazinë nr. 2, datë 13.09.2022 në të cilën është marrë malli në dorëzim. Fatura elektronike është me nr. 6332/2022, datë 13.09.2022, me vlerë 835,200 lekë pa TVSH dhe me vlerë 1,002,240 lekë me TVSH. Kjo faturë është likuajduar urdhër shpenzimin nr. 185, datë 28.09.2022 nëpërmjet bankës R përkundrejt subjektit “S” SHPK për vlerën 1,002,240 lekë. Veprime në mospërputhje me *Nenin 21, të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 36.*

Titulli i gjetjes:	Parregullsi dhe mungesë dokumentash lidhur me procedurën e prokurimit me vlerë të vogël të Rektoratit të UMT, konkretisht: për blerje laboratorike-reagentë “Blerje kite E antiNukleokapsid (NPC) SARS-COV” në zbatim të marrëveshjes me Agjencinë Universitare të Frankofonisë (AUF).
Situata:	Me urdhër shpenzimin nr. 185, datë 28.09.2022 nëpërmjet bankës R është likuajduar subjekti “S” SHPK për vlerën 1,002,240 lekë për blerje laboratorike-reagentë “Blerje kite E antiNukleokapsid (NPC) SARS-COV” në zbatim të marrëveshjes me Agjencinë Universitare të Frankofonisë (AUF), ku konstatoam: Në formularin e deklaramit për konflikt interesi më datë 21.07.2022, znj. L.K nuk ka plotësuar që: nuk është në kushtet e konfliktit të interesit. Procesverbali për hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim është i protokolluar me nr. 2363/3, datë 02.09.2022. Ky procesverbal nuk i është përmbajtur kriterëve të kërkuara nga Departamenti i Mjekësisë laboratorike në lidhje me pikën 3. Marrja në dorëzim është realizuar me anë të Urdhrit të Brendshëm nr. 173, datë 12.09.2022, me nr. 2363/10 për ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të malli u

	përcaktuan: z. G. S. (Kryetar), znj. M.K (P.) dhe znj. E.N (Anëtarë). Veprime në mospërputhje me <i>Nenin 21, të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 36.</i>
Kriteri:	- Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, Neni 21; - Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 36.
Ndikimi/Efekti:	Mos efiçencë në arritjen e objektivave dhe respektimin e afateve të skadencës së kiteve në momentin e marrjes në dorëzim.
Shkaku:	Neglizhencë në verifikimin e mallit të marrë në dorëzim, konkretisht skadencave të kiteve.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandimi:	Nga Komisioni i marrjes në dorëzim të merren masa për evidentimin e datave të skadencave të kiteve në procesverbalin e marrjes në dorëzim dhe plotësimin e të dhënave të faturave tatimore (numër, datë, vlerë), për të arritur objektivat dhe respektimin e afateve të skadencave të kiteve në përputhje me ligjin.
Rekomandimi:	Nga Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, Drejtoria Ekonomike dhe personat përgjegjës të merren masa për ndjekjen e mëtejshme të procedurës së prokurimit në mënyrë që të evidentohet arsyeja pse nuk janë kontrolluar datat e skadencave të kiteve dhe të plotësohet dosja me dokumentacionin e munguar.

Nga auditimi i prokurimeve me vlerë të vogël në Rektorat për vitin 2022 lidhur me procedurën “Blerje pajisje kompjuterike”, për realizimin e projektit DigiCare4You: “Një zgjidhje inovative ndërsektoriale që përfshin mjete digitale, fuqizimin e familjeve dhe integrimin e shërbimeve Care në komunitet dhe parandalimin dhe menaxhimin e diabetit tipi 2 të hipertensionit në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë” për blerje në vlerën 394,960 lekë pa TVSH, konstatohet se: Kërkesa për prokurim është e protokolluar me nr.549/7 prot., datë 27.09.2022 nga Koordinatori i Projektit, Z. F.T. Procesverbali për përlllogaritjen e Fondit Limit nr. 549/17, datë 11.10.2022, ku u miratua nga grupi i prokurimeve me vlerë të vogël: Znj. M.C (Kryetar), Znj. R.S dhe Z. P.L (Anëtarë) me fond limit në vlerë 789,826 lekë pa TVSH. Urdhri i prokurimit me nr. 200, është i protokolluar me nr. 549/9 prot, datë 05.10.2022. Procesverbali për hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim është protokolluar me nr. 549/21 prot., datë 17.10.2022. Ftesa për ofertë është protokolluar me nr. 549/22 prot., datë 17.10.2022. Procesverbali për përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë që do t’u dërgohet ftesë për ofertë në sistemin e prokurimit elektronik është i protokolluar me nr. 549/23 prot., datë 17.10.2022. Procedura është hapur në datën 19.10.2022, ora 12:00 në Sistemin e Prokurimit Publik (SPE) dhe protokolluar me nr. 549/22 prot. Procesverbali për vlerësimin e ofertave në procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me nr. 549/27 prot., datë 20.10.2022, ku fitues u përcaktua OE “L.S” SHPK. Marrja në dorëzim është realizuar me anë të Urdhrit të Brendshëm me nr. 234, datë 28.10.2022, me nr. 549/33 prot., për ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të mallit ku janë përcaktuar: z.

F.T (Kryetar), znj. X.S dhe znj. E.N (Anëtarë). Procesverbali për marrjen në dorëzim është protokolluar me nr. 549/35 prot., datë 31.10.2022, e cila nuk ka të dhëna mbi faturën tatimore (numër, datë, vlerë), vlerën dhe operatorin ekonomik. Fatura elektronike është me nr. 7/2022 prot., datë 31.10.2022 me vlerë 394,960 lekë pa TVSH dhe 473,952 lekë me TVSH. Likujdimi i kësaj fature është bërë me banka të nivelit të dytë dhe jo përmes Thesarit, pasi bëhet fjalë për projektin Digi Care. Konkretisht, likujdimi i faturës është realizuar me C Bank, referuar urdhër-transfertës së bankës datë 17.11.2022 në vlerën 394,960 lekë pa TVSH për përfitim të subjektit fitues “L.S” SHPK Veprime në mospërputhje me: *UMF nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 36.*

Titulli i gjetjes:	Parregullsi dhe mungesë dokumentash lidhur me procedurën “Blerje pajisje kompjuterike”, për realizimin e projektit DigiCare4You: “Një zgjidhje inovative ndërsektorale që përfshin mjete digitale, fuqizimin e familjeve dhe integrimin e shërbimeve Care në komunitet dhe parandalimin dhe menaxhimin e diabetit tipi 2 të hipertensionit në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”.
Situata:	Nga auditimi i prokurimeve me vlerë të vogël në Rektorat për vitin 2022 lidhur me procedurën “Blerje pajisje kompjuterike”, për realizimin e projektit DigiCare4You: “Një zgjidhje inovative ndërsektorale që përfshin mjete digitale, fuqizimin e familjeve dhe integrimin e shërbimeve Care në komunitet dhe parandalimin dhe menaxhimin e diabetit tipi 2 të hipertensionit në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë” për blerje në vlerën 394,960 lekë pa TVSH, konstatohet se: Marrja në dorëzim është realizuar me anë të Urdhrit të Brendshëm me nr. 234, datë 28.10.2022, me nr. 549/33 prot., për ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të mallit ku janë përcaktuar: z. F.T (Kryetar), znj. X.S dhe znj. E.N (Anëtarë). Procesverbali për marrjen në dorëzim është protokolluar me nr. 549/35 prot., datë 31.10.2022, e cila nuk ka të dhëna mbi faturën tatimore (numër, datë, vlerë), vlerën dhe operatorin ekonomik. Fatura elektronike është me nr. 7/2022 prot., datë 31.10.2022 me vlerë 394,960 lekë pa TVSH dhe 473,952 lekë me TVSH. Likujdimi i kësaj fature është bërë me banka të nivelit të dytë dhe jo përmes Thesarit, pasi bëhet fjalë për projektin Digi Care. Konkretisht, likujdimi i faturës është realizuar me C Bank, referuar urdhër-transfertës së bankës datë 17.11.2022 në vlerën 394,960 lekë pa TVSH për përfitim të subjektit fitues “L.S” SHPK
Kriteri:	- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 36.
Ndikimi/Efekti:	Mos efçencë në arritjen e objektivave.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e personave përgjegjës dhe menaxhimit të UMT-së.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandimi:	Nga Komisioni i marrjes në dorëzim të merren masa për evidentimin e datave të skadencave të kiteve në procesverbalin e marrjes në dorëzim dhe plotësimin e të dhënave të faturave tatimore (numër, datë, vlerë), për të arritur objektivat dhe respektimin e afateve të skadencave të kiteve në

	përputhje me ligjin.
Rekomandimi:	Nga Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, Drejtoria Ekonomike dhe personat përgjegjës të merren masa për ndjekjen e mëtejshme të procedurës së prokurimit në mënyrë që të evidentohet arsyeja pse nuk janë kontrolluar datat e skadencave të kiteve dhe të plotësohet dosja me dokumentacionin e munguar.

Nga auditimi u konstatua se, dosjet e procedurave prokuruese për blerjet me vlerë të vogël janë të painventarizuara në shumicën e rasteve.

-Në disa raste, Kërkesa për realizim prokurimi nuk është e protokolluar.

-Në disa raste ka dokumenta të fotokopjuara në dosje.

-Në disa raste procesverbali për marrjen në dorëzim të mallit nuk ka të dhëna mbi faturën tatimore (numër datë vlerë), vlerën.

Veprime në mospërputhje me: *Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”*; *Udhëzimi i Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.8.2005 “Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale”*; *UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 36.*

Titulli i gjetjes:	Nga auditimi në UMT u konstatua se, dosjet e procedurave prokuruese për blerjet me vlerë të vogël janë të painventarizuara në shumicën e rasteve.
Situata:	Nga auditimi u konstatua se, dosjet e procedurave prokuruese për blerjet me vlerë të vogël nuk janë të inventarizuara në shumicën e rasteve. Në disa raste, kërkesa për realizim prokurimi nuk është e protokolluar. Në disa raste ka dokumenta të fotokopjuara në dosje. Në disa raste procesverbali për marrjen në dorëzim të mallit nuk ka të dhëna mbi faturën tatimore (numër datë vlerë), vlerën.
Kriteri:	- Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”; - Udhëzimi i Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.8.2005 “Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale”; - UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 36.
Ndikimi/Efekti:	Mos efikasitet në arritjen e objektivave dhe politikave të miratuara për UMT.
Shkaku:	Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e mos vlerësimit sa dhe si duhet nga organet drejtuese.
Rëndësia:	E lartë.
4.1 Rekomandimi:	Nga Sektori i Prokurimeve të merren masa që të gjitha dosjet e procedurave prokuruese me vlerë të vogël të inventarizohen, në mënyrë që të ruhen të gjitha dokumentat e dosjes dhe për arritjen e objektivave në përputhje me ligjin.

➤ ***Fatura të likujduara me vonesë***

Nga auditimi i shpenzimeve të kryera me bankë në Fakultetin e Mjekësisë konstatohet se:

- Me urdhërshpenzimin nr.178, datë 21.12.2021 nëpërmjet bankës R është likujduar “FSHU” SHA për vlerën 395,087 lekë për likujdimin e faturave tatimore të energjisë elektrike, faturat tatimore të energjisë elektrike për muajt gusht-tetor 2021 nuk janë paguar brenda afatit 30 ditor.

- Me urdhër shpenzimin nr.179, datë 21.12.2021 nëpërmjet bankës B është likuajduar “Ujësjellës Kanalizime” SHA për vlerën 27,408 lekë për likuajdimin e faturave tatimore të ujit, faturat tatimore të ujit të pijshëm për muajt muajt tetor 2021 nuk janë paguar brenda afatit 30 ditor.

- Me urdhër shpenzimin nr.180, datë 21.12.2021 nëpërmjet bankës B është likuajduar “A.” SHA për vlerën 3,840 lekë për likuajdimin e faturës tatimore të shërbimit telefonik për muajin shtator 2021 (nga data 01.09.2021-30.09.2021). Në Fakultetin e Mjekësisë, faturat tatimore të shërbimit telefonik për muajin shtator 2021 (nga data 01.09.2021- 30.09.2021), nuk janë paguar brenda afatit 30 ditor.

- Me urdhër shpenzimin nr.191, datë 31.12.2021 nëpërmjet bankës B është likuajduar “A.” SHA për vlerën 743 lekë për likuajdimin e faturës tatimore për detyrimet e prapambetura të shërbimit telefonik për muajin dhjetor 2021. Për arsye se faturat tatimore të shërbimit telefonik, nuk janë paguar brenda afatit 30 ditor, është gjeneruar detyrim i prapambetur.

- Me urdhër shpenzimin nr.160, datë 28.12.2022 nëpërmjet bankës B është likuajduar “Ujësjellës Kanalizime Tiranë” SHA për vlerën 1,785,036 lekë për likuajdimin e faturave tatimore të ujit. Në Fakultetin e Mjekësisë, faturat tatimore të ujit të pijshëm për muajt shkurt 2022 deri në nëntor 2022 nuk janë paguar brenda afatit 30 ditor.

- Me urdhër shpenzimin nr.161, datë 28.12.2022 nëpërmjet bankës R është likuajduar “FSHU” SHA për vlerën 33,318 lekë për likuajdimin pjesor të faturave tatimore të energjisë elektrike. Në Fakultetin e Mjekësisë, fatura tatimore e energjisë elektrike për muajin shtator 2022 nuk është paguar brenda afatit 30 ditor.

- Me urdhër shpenzimin nr.176, datë 30.12.2022 nëpërmjet bankës R është likuajduar “FSHU” SHA për vlerën 487,304 lekë për likuajdimin e faturave tatimore të energjisë elektrike. Bashkëngjitur ndodhen procesverbalet për marrjen në dorëzim të shërbimit të firmosur nga grupi: E.L, H.B, I.M (magaziner). Në Fakultetin e Mjekësisë, faturat tatimore të energjisë elektrike nga shtator-nëntor 2022 nuk janë paguar brenda afatit 30 ditor.

- Me urdhër shpenzimin nr.177, datë 30.12.2022 nëpërmjet bankës B është likuajduar “Ujësjellës Kanalizime Tiranë” SHA për vlerën 465,808 lekë për likuajdimin e faturave tatimore të ujit. Në Fakultetin e Mjekësisë, faturat tatimore të ujit për muajt prill-dhjetor 2020; janar-dhjetor 2021 dhe janar-shkurt 2022, nuk janë paguar brenda afatit 30 ditor.

Fondet e buxhetit janë të ndara për 12 muaj dhe likuajdimi i faturave duhet të bëhet për çdo muaj sipas afatit të përcaktuar. Moslikuajdimi në kohë i tyre nuk nxjerr në pah realizimin e buxhetit mujor dhe ka premisa për lindjen e penalteteve, të cilat rëndojnë mbi buxhetin e shtetit.

Veprime në mospërputhje me: *Udhëzimin e Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.8.2005 “Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale; UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar me nr. 20, datë 17.11.2014 pika 36 dhe 44.*

Titulli i gjetjes:	Në Fakultetin e Mjekësisë, në disa raste likuajdimi i faturave tatimore nuk është bërë brenda afatit 30 ditor, konkretisht për faturat e energjisë elektrike, të ujit dhe të shërbimit telefonik.
Situata:	Në Fakultetin e Mjekësisë, në disa raste likuajdimi i faturave tatimore nuk është bërë brenda afatit 30 ditor, konkretisht për faturat e energjisë elektrike, të ujit dhe të shërbimit telefonik. Fondet e buxhetit janë të ndara për 12 muaj dhe likuajdimi i faturave duhet të bëhet për çdo muaj sipas afatit

	të përcaktuar. Mos likuidimi në kohë i tyre nuk nxjerr në pah realizimin e buxhetit mujor dhe K premisa për lindjen e penaliteteve, të cilat rëndojnë mbi buxhetin e shtetit.
Kriteri:	- Udhëzimi i Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005 “Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale; - Udhëzimi i MFE nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar me nr. 20, datë 17.11.2014 pika 36 dhe 44.
Ndikimi/Efekti:	Moslikuidimi në kohë i tyre nuk nxjerr në pah realizimin e buxhetit mujor dhe K premisa për lindjen e penaliteteve, të cilat rëndojnë mbi buxhetin e shtetit.
Shkaku:	Moslikuidimi në kohë i faturave tatimore.
Rëndësia:	I lartë.
5.1 Rekomandimi:	Nga Organet Drejtuese dhe Sektori i Financës të merren masa për likuidimin në kohë të faturave tatimore të energjisë elektike, ujit dhe shërbimit telefonik, pasi moslikuidimi në kohë i tyre nuk nxjerr në pah realizimin e buxhetit mujor dhe ka premisa për lindjen e penaliteteve, të cilat rëndojnë mbi buxhetin e shtetit.

➤ **Konsumi i karburantit**

Lidhur me furnizimin e kaldajave me karburant për ngrohjen e sallave të leksioneve, shpërndarja bëhet nga dy njësitë shpenzuese: *FSHMT* dhe *FM*.

Në *FSHMT*, gjatë auditimit me zgjedhje, u konstatua se nuk ka dokumentacion të plotë justifikues, lidhur me mbajtjen, dokumentimin dhe shpërndarjen e karburantit nëpër njësitë shpenzuese për ngrohjen e sallave të leksioneve me kaldajë. Nuk ka bashkëngjitur dokumentacionin e plotë justifikues, situacionin, kartelat për konsumin e karburantit dhe madje as normën e konsumit të karburantit për çdo orë ndezje të kaldajës, nuk ka informacion se sa orë është ndezur kaldaja apo se kush e ka ndezur atë përgjatë periudhës së auditimit. Nuk u gjet në dosje Urdhri i Transferimit për daljen e karburantit nga magazina dhe destinacionin se ku po shkon ky karburant.

-Nuk ka evidenca lidhur me periudhën e pandemisë gjatë së cilës supozohet që kaldajat mos të jenë ndezur për arsye të situatës së pandemisë COVID-19.

-Nuk kanë bërë një planifikim se sa karburant (sa litra) shpenzohet në vit për kaldajat, pasi vlerat e konsumuara sipas kontratave me kompaninë “R.E” sha janë të ndryshme. - Nuk kanë bërë planifikim të nevojave për shërbim/mirëmbajtje të sistemit të ngrohjes me kaldaja.

-Në datën 25.11.2019 është lidhur kontrata me nr.1601/1 me kompaninë R.E SHA për blerje karburanti në sasinë 8,341 litra për ngrohjen e sallave të leksioneve në *FSHMT*, përfaqësuar nga Nënpunësi Autorizues i përkohshëm, Administratori i UMT, Z. A.M. (marrë në dorëzim në datën 05.12.2019 në sasinë 6,187 litra dhe në datën 09.01.2020 në sasinë 3,504 litra). Vlera e kontratës është 1,575,000 lekë pa TVSH.

-Në datën 04.11.2021 është lidhur kontrata me nr. 1368 me kompaninë R.E SHA për blerje karburanti në sasinë 4,077 litra për ngrohjen e sallave të leksioneve në *FSHMT*, përfaqësuar nga Nënpunësi Autorizues i përkohshëm, Administratori i UMT, Z. B.C. Vlera e kontratës është 712,745 lekë pa TVSH.

-Në datën 12.12.2022 është lidhur kontrata me nr. 1588/1 prot., me kompaninë R.E SHA për blerje karburanti në sasinë 13,000 litra për ngrohjen esallave të leksioneve në FSHMT, përfaqësuar nga Nënpunësi Autorizues i përkohshëm, Administratori i UMT, Znj. A.M. Vlera e kontratës është 2,490,222 lekë pa TVSH. Në kushtet e kontratës citohet se furnizimi me lëndë djegëse do të bëhet me bot. Shpenzimet e transportit janë në ngarkim të kontraktorit. Kontraktori në momentin e furnizimit të mallit, do të lëshojë edhe faturën tatimore të shitjes, së bashku me përlogaritjen e çmimit sipas Bursës së fundit të karburanteve, përpara çdo furnizimi, i cili publikohet çdo të hënë në Buletinin e APP. Kontraktori shoqëron furnizimin vetëm me faturë tatimore dhe fletë-analizën e lëshuar nga laboratorit i ISHTI.

- Me urdhër shpenzimin nr. 94, datë 09.07.2020 nëpërmjet bankës B është likujduar subjekti “R.E” SHA për vlerën 692,917³⁹ lekë për “Blerje karburanti për ngrohjen e sallave të leksioneve 3,504 litra”. Nuk u gjet në dosje Urdhri i Brendshëm për marrjen në dorëzim të mallit/karburantit dhe për ngritjen e Komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave. Procesverbali për marrjen në dorëzim për “Blerje karburanti për ngrohjen e sallave të leksioneve të FSHMT” është i protokolluar me nr. 1710/1 prot., datë 09.01.2020 për blerjen e 3,504 litra karburant. Ky Procesverbal për marrjen në dorëzim datë 31.10.2022 nuk ka të dhëna mbi faturën tatimore (numër datë vlerë), vlerën. Fletë hyrja nr. 1, datë 09.01.2020, adresa nga vjen malli “R.E” SHA, dorëzuar në magazinën e FSHMT, gjithsej 3,504 litra gazoil në vlerën 692,917³⁹lekë, firmosur nga magazinieri Znj. D.R. Nuk u gjet në dosje Urdhri i Transferimit për daljen e karburantit nga magazina dhe destinacionin se ku po shkon ky karburant. Fletë dalja nr. 1, datë 09.01.2020, adresa ku shkon malli Z. R.C, vendi FSHMT, gjithsej 3,504 litra gazoil në vlerën 692,917³⁹lekë, firmosur nga magazinieri Znj. D.R dhe marrësi Z. R.C.

- Me urdhër shpenzimin nr. 216, datë 12.12.2019 nëpërmjet bankës B është likujduar subjekti “R.E” SHA për vlerën 1,196,485 lekë për “Blerje karburanti për ngrohjen e sallave të leksioneve”. Urdhri i Brendshëm për marrjen në dorëzim të mallit nr. 76, datë 03.12.2019 dhe me nr. 1609/5 prot., me komision të përbërë nga: Z. A.H (Kryetar), Z. R.C (Anëtar) dhe Znj. D.Rr. (Magazinier). Procesverbali për marrjen në dorëzim për “Blerje karburanti për ngrohjen e sallave të leksioneve të FSHMT” me nr. 1710 prot., datë 05.12.2019 për blerjen e 6,187 litra karburant. Ky Procesverbal për marrjen në dorëzim datë 05.12.2019 nuk ka të dhëna mbi faturën tatimore (numër datë vlerë), vlerën. Fletë hyrja nr. 14, datë 05.12.2019, adresa nga vjen malli “R.E” SHA, dorëzuar në magazinën e FSHMT, gjithsej 6,187 litra gazoil në vlerën 1,196,485lekë, firmosur nga magazinieri Znj. D.R. Nuk u gjet në dosje Urdhri i Transferimit për daljen e karburantit nga magazina dhe destinacionin se ku po shkon ky karburant. Fletë dalja me nr. 168, datë 05.12.2019, adresa ku shkon malli Z. R.C, vendi FSHMT, gjithsej 6,187 litra gazoil në vlerën 1,196,485lekë, firmosur nga magazinieri Znj. D.R dhe kontrolli Z. R.C.

- Me urdhër shpenzimin nr. 204, datë 18.11.2021 nëpërmjet bankës B është likujduar subjekti “R.E” SHA për vlerën 855,094 lekë për “Blerje karburanti për ngrohjen e sallave të leksioneve”. Bashkëlidhur është: Urdhri i Brendshëm me nr. 1368/2 prot., datë 05.11.2021 për marrjen në dorëzim të mallit, me komision të përbërë nga: Z. A.H (Kryetar), Z. R.C (Anëtar) dhe Znj. D.Rr.(Magazinier). Procesverbali për marrjen në dorëzim për “Blerje karburanti për ngrohjen e sallave të leksioneve të FSHMT” me nr. 1368/3 prot., datë 05.11.2021 për blerjen e 4,077 litra karburant. Ky Procesverbal për marrjen në dorëzim datë 05.11.2021 nuk ka të dhëna mbi faturën tatimore (numër datë vlerë), vlerën. Nuk u gjet në dosje fatura tatimore nga kompania “R.E” SHA. Nuk u gjet në dosje Urdhri i Transferimit për daljen e karburantit nga magazina dhe destinacionin se ku po shkon ky karburant. Fletë dalja nr. 151, datë 05.11.2021, adresa ku shkon

malli Z. R.C, vendi FSHMT, gjithsej 4,077 litra gazoil në vlerën 855,093⁶⁷² lekë, firmosur nga magazinieri Znj. D.R dhe kontrolli Z. R.C. Fletë hyrja nr. 6, datë 05.11.2021, adresa nga vjen malli “R.E” SHA, dorëzuar në magazinën e FSHMT, gjithsej 4,077 litra gazoil në vlerën 855,093⁶⁷² lekë, firmosur nga magazinieri Znj. D.R.

- Me urdhër shpenzimin nr. 234, datë 29.12.2022 nëpërmjet bankës B është likuaduar subjekti “R.E” SHA për vlerën 785,748 lekë për “Blerje karburanti për ngrohjen e sallave të leksioneve”. Bashkëlidhur është: Urdhri i Brendshëm me nr. 1588/4 prot., datë 14.12.2022 për marrjen në dorëzim të mallit, me komision të përbërë nga: Z. A.H (Kryetar), Z. R.C (Anëtar) dhe Znj. D. Rr. (Magaziner). Procesverbal për marrjen në dorëzim për “Blerje karburanti për ngrohjen e sallave të leksioneve të FSHMT” me nr. 1588/5 prot., datë 14.12.2022 për blerjen e 4,009 litra karburant. Ky Procesverbal për marrjen në dorëzim datë 14.12.2022 nuk ka të dhëna mbi faturën tatimore (numër, datë, vlerë), vlerën. Nuk ka të bashkëngjitur faturën tatimore nga kompania “R.E” SHA. Fletë hyrja nr. 7, datë 14.12.2022, adresa nga vjen malli “R.E” SHA, dorëzuar në magazinën e FSHMT, gjithsej 4,009 litra gazoil në vlerën 785,747⁹⁶⁴ lekë, firmosur nga magazinieri D.R. Fletë dalja nr. 168, datë 28.12.2022, adresa ku shkon malli Z. R.C, vendi FSHMT, gjithsej 1,080 litra gazoil në vlerën 211,675⁶⁸ lekë, firmosur nga magazinieri D.R dhe marrësi Z. R.C. Nuk u gjet në dosje Urdhri i Transferimit për daljen e karburantit nga magazina dhe destinacionin se ku po shkon ky karburant. Fletë dalja nr. 5, datë 30.01.2023, adresa ku shkon malli Z. R.C, vendi FSHMT, gjithsej 2,929 litra gazoil në vlerën 574,072²⁸⁴ lekë, firmosur nga magazinieri Znj. D.R dhe marrësi Z. R.C.

Veprime në mospërputhje me:- *UMF nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 36, Vendimin nr. 16, datë 25.02.2020 të Bordit të Administrimit “Për miratimin e rregullores së brendshme të ndryshuar për administrimin financiar, komntabilitetin dhe kontrollin në UMT”, Neni 20, pika 2.*

Titulli i gjetjes:	Në FSHMT në shumicën e rasteve nuk ka dokumentacion të plotë justifikues lidhur me shkarkimin e karburantit. Nuk kanë bërë planifikim të nevojave për shërbim/mirëmbajtje të sistemit të ngrohjes me kaldaja.
Situata:	Në FSHMT në shumicën e rasteve nuk ka dokumentacion të plotë justifikues lidhur me shkarkimin e karburantit. Nuk kanë bërë planifikim të nevojave për shërbim/mirëmbajtje të sistemit të ngrohjes me kaldaja. Në shumicën e rasteve, në dosje ka vetëm një fletë-dalje për shkarkimin e karburantit. Nuk ka bashkëngjitur dokumentacionin justifikues lidhur me situacionin, kartelat për konsumin e karburantit, normën e konsumit të karburantit për çdo orë ndezje të kaldajës, nuk ka informacion se sa orë është ndezur kaldaja apo se kush e ka ndezur atë përgjatë periudhës së auditimit. Nuk u gjet në dosje Urdhri i Transferimit për daljen e karburantit nga magazina dhe destinacionin se ku po shkon ky karburant. Nuk ka evidenca lidhur me periudhën e pandemisë gjatë së cilës supozohet që kaldajat mos të jenë ndezur për arsye të situatës së pandemisë COVID-19. Nuk kanë bërë një planifikim se sa karburant (sa litra) shpenzohet në vit për kaldajat, pasi vlerat e konsumuara sipas kontratave me kompaninë “R.E” sha janë të ndryshme. Nuk kanë bërë planifikim të nevojave për shërbim/mirëmbajtje të sistemit të ngrohjes me kaldaja. Lidhur me procesverbalet apo situacionet te FSHMT, për konsumin mujor të kaldajave

	të vitit 2022, konkretisht për muajt janar, shkurt dhe dhjetor 2022, ky dokument është i firmosur nga dy anëtarë të Komisionit për ndjekjen e kontratës dhe jo nga 3 anëtarë, veprime jo në përputhje me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar; Vendimin nr. 16, datë 25.02.2020 i Bordit të Administrimit “Për miratimin e rregullores së brendshme të ndryshuar për administrimin financiar, komntabilitetin dhe kontrollin në UMT”, Neni 20, pika 2.
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar; - Vendimi nr. 16, datë 25.02.2020 i Bordit të Administrimit “Për miratimin e rregullores së brendshme të ndryshuar për administrimin financiar, komntabilitetin dhe kontrollin në UMT”, Neni 20, pika 2, ku shprehet se: “Për çdo dalje të aktiveve materiale nga magazina pritjet fletë-dalja nga ana e magazinierit, duke u mbështetur në urdhërdorëzimin, fletëkërkesën, planin e shpërndarjes së kartelës limit, urdhrit të transferimit, autorizimi etj. (Fletëdaljet së magazinës i bashkëngjitet autorizimi/urdhërdorëzimi etj)”.
Ndikimi/Efekti:	Mos eficientë në arritjen e objektivave dhe politikave të miratuara.
Shkaku:	Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e mos vlerësimit sa dhe si duhet nga organet drejtuese.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandimi:	Nga ana e Organeve Drejtuese të lihet detyrë që të dokumentohet çdo veprim lidhur me shkarkimin e karburantit dhe të bëhet planifikimi i nevojave për shërbim/ mirëmbajtje të sistemit të ngrohjes me kalaja, pasi kjo sjell mungesën e evidentimit dhe transparencës lidhur me përdorimin e karburantit.

2.9 Zbatimi i dispozitave për dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare.

Saktësia dhe rregullueshmëria e veprimeve të kryera në magazinë

Ditari i magazinës është mbajtur dhe veprimet hidheshin periodikisht.

- U auditua me zgjedhje dokumentacioni i magazinës për vitet 2020-2022. Fletë daljet dhe fletë hyrjet e aktiveve janë të hartuara sipas rendit kronologjik dhe pa korrigjime. Fletë-hyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi është bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit, në përputhje me përcaktimet e paragrafit 37, kreu III, të udhëzimit të ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar. Kontabilizimet e fletë daljeve dhe fletë hyrjeve janë bërë në mbështetje të planit unik kontabël dhe në mënyrë kronologjike e sistematike në ditarët e magazinës. Dokumentacioni i magazinës përpilohet nga administratori i vlerave materiale, ndërsa kontabilizimi i veprimeve kryhet nga një specialiste e sektorit të financës.

Nga auditimi në lidhje me inventarizimin e aseteve të Rektoratit të Universitetit të Mjekësisë Tiranë për periudhën e auditimit rezultoi si më poshtë:

Viti 2020: -Lidhur me inventarizimin e materialeve në ngarkim të punonjësve, administratori i Rektoratit Z. A.M, ka nxjerrë urdhër të brendshëm nr. 203, datë 28.12.2020, “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të aktiveve Afatgjata Materiale të Rektoratit të UMT”.

Për këtë qëllim në përfundim të punës,nga ana e Komisionit të ngarkuar, me shkresën me nr.207/1 prot. datë 25.01.2021 është hartuar “Raporti për kryerjen e inventarizimit të aktiveve Afatgjata Materiale të Rektoratit të UMT”.

-Lidhur me materialet në Magazinën e Rektoratit të UMTka dalë Urdhër i brendshëm me nr.204, datë 28.12.2020 dhe protokolluar me nr. 2955/1 prot., datë 28.12.2020 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të aktiveve në magazinën e Rektoratit të UMT”.

Për këtë qëllim në përfundim të punës, nga ana e Komisionit të ngarkuar, me shkresën me nr.206/1 prot., datë 25.01.2021, është hartuar “Raporti për kryerjen e inventarizimit të aktiveve në Magazinën e Rektoratit të UMT”.

Viti 2021: -Lidhur me materialet në ngarkim të punonjësve, administratori i Rektoratit Z. B.Cka nxjerrë urdhër të brendshëm nr.218, datë 29.12.2021, “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të aktiveve Afatgjata Materiale të Rektoratit të UMT”.

Për këtë qëllim në përfundim të punës,nga ana e Komisionit të ngarkuar, me shkresën me nr.173/3 prot., datë 24.01.2022,është hartuar “Raporti për kryerjen e inventarizimit të aktiveve Afatgjata Materiale të Rektoratit të UMT”.

-Lidhur me materialet në Magazinën e Rektoratit të UMT ka dalë Urdhër i brendshëm me nr.219, datë 29.12.2021, “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të aktiveve në magazinën e Rektoratit të UMT”.

Për këtë qëllim në përfundim të punës, nga ana e Komisionit të ngarkuar,me shkresën me nr.173/2 prot., datë 24.01.2022 është hartuar “Raporti për kryerjen e inventarizimit të aktiveve në Magazinën e Rektoratit të UMT”.

Referuar raportit për kryerjen e inventarizimit të aktiveve afatgjata materiale të Rektoratit të UMT, me shkresën me nr. 173/3 prot., datë 24.01.2022, komisioni ka konstatuar se përsa i përket verifikimit të gjendjes së aktiveve, jo të gjitha aktivet janë në gjendje pune (funktionale),

përfshirë këtu: pajisje elektronike, mobilje zyre etj, si dhe ka sugjeruar ndjekjen e mëtejshme për situatën nga organet drejtuese, por nuk është marrë ndonjë masë konkretisht lidhur me asgjësimin e këtyre aseteve. Ky veprim është në mospërputhje me: *UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", Kapitulli IV Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 95-101.*

Viti 2022: -Lidhur me materialet në ngarkim të punonjësve, administratori i Rektoratit Znj. S.S ka nxjerrë urdhër të brendshëm nr.284, datë 13.12.2022, "Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të aktiveve Afatgjata Materiale të Rektoratit të UMT".

Për këtë qëllim në përfundim të punës, nga ana e Komisionit të ngarkuar, me shkresën nr.4418/2 prot., datë 30.01.2023, është hartuar "Raporti për kryerjen e inventarizimit të aktiveve Afatgjata Materjale të Rektoratit të UMT".

-Lidhur me materialet në Magazinën e Rektoratit të UMT ka dalë Urdhër i brendshëm me nr.286, datë 13.12.2022, "Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të aktiveve në magazinën e Rektoratit të UMT".

Për këtë qëllim në përfundim të punës, nga ana e komisionit të ngarkuar, me shkresën me nr.4419/1 prot. datë 30.01.2023, është hartuar "Raporti për kryerjen e inventarizimit të aktiveve në Magazinën e Rektoratit të UMT".

Nga auditimi i inventarëve të FM u konstatua se nuk ka kuadruar periudha përpara vitit 2013 ku vlera faktike me vlerën kontabël nuk ka rezultuar e njëjtë (trajtuar tek pika e pasqyrave financiare).

Nga auditimi në lidhje me inventarizimin e aseteve të FSHMT për periudhën e auditimit rezultoi si më poshtë:

Viti 2020: Për FSHMT, Administratori Z. A.M, ka nxjerrë Urdhër të brendshëm nr.42, datë 25.11.2020 të protokolluar me nr. 1582 prot., datë 25.11.2020 "Për ngritjen e komisionit për inventarizimin dhe vlerësimin e përdorimit të vlerave materiale dhe magazinës së institucionit".

Në përfundim të punës nga ana e komisionit të ngritur sipas Urdhërit të mësipërm, me shkresat e protokolluara me nr. 1582/1 prot., datë 24.12.2020 dhe me nr.1582 prot., datë 24.12.2020 janë hartuar dy relacione për administratorin e FSHMT.

Viti 2021: Për FSHMT, Administratori Z. B.C. ka nxjerrë Urdhër të brendshëm nr.68, datë 05.11.2021 të protokolluar me nr. 1381 prot., datë 05.11.2021 "Për ngritjen e komisionit për inventarizimin dhe vlerësimin e përdorimit të vlerave materiale dhe magazinës së institucionit për vitin kalendarik 2021".

Në përfundim të punës nga ana e komisionit të ngritur sipas Urdhërit të mësipërm, me shkresën me nr.1381/1 prot., datë 31.12.2021 është hartuar relacioni për administratorin e FSHMT.

Viti 2022: Për FSHMT, Administratori Znj. A.M ka nxjerrë Urdhër të brendshëm nr.66 datë 05.12.2022 të protokolluar me nr. 1647 prot., datë 05.12.2022 "Për ngritjen e komisionit për inventarizimin dhe vlerësimin e përdorimit të vlerave materiale dhe magazinës së institucionit për vitin kalendarik 2022".

Në përfundim të punës nga ana e komisionit të ngritur, sipas Urdhërit të mësipërm, me shkresën me nr.1647/1 prot., datë 30.12.2022 është hartuar dhe relacioni për administratorin e FSHMT. Në këtë relacion është evidentuar nga Komisioni një diferencë për moskuadrim të inventarit fillestar kontabël dhe atij fizik kontabël, por gjatë vitit janë zhdëmtuar artikujt e munguara për personat përgjegjës (Znj. V.S, Znj. N.R dhe Znj. D.T). Janë mbajtur procesverbalet përkatëse dhe janë lëshuar urdhër për pagesat e dëmit të shkaktuar për zhdëmtim, të cilat janë likuadruar. Në

relacion janë evidentuar nga specialistët e IT-së, pajisje elektronike të cilat nuk janë në gjendje funksionale, konkretisht 79 pajisje elektronike (bashkëngjitur është paraqitur lista e pajisjeve elektronike, firmosur nga Komisioni). Pajisjet elektronike të evidentuara jashtë funksionit nga Komisioni nuk janë nxjerrë jashtë përdorimi dhe nuk janë marrë masa konkrete lidhur me këtë. Ky veprim është në mospërputhje me: *UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitet e sektorit publik”, Kapitulli IV Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 95-101.*

-Gjatë analizimit të inventarëve të mësipërm u konstatua se, për vitet objekt auditimi nuk është nxjerrë jashtë përdorimit asnjë aset (produkt), edhe pse duke u nisur nga vitet dhe nga norma e amortizimit, ekzistojnë asete të cilat janë plotësisht të amortizuara dhe jashtë përdorimi. Ky veprim është në mospërputhje me: *UMF nr. 30, datë 27.12.2011.*

Nga auditimi në lidhje me inventarizimin e aseteve të FM për periudhën e auditimit rezultoi si më poshtë:

Viti 2020: Për FM, Administratori Znj. Z.D ka nxjerrë Urdhër të brendshëm të protokolluar me nr. 2059 prot., datë 13.10.2020 “Për inventarizimin e Aktiveve të Qëndrueshme”, si dhe Urdhër të brendshëm me nr. 2059/1 prot., datë 13.10.2020 “Për ngritjen e komisionit për inventarizimin dhe vlerësimin e përdorimit të vlerave materiale dhe magazinës së institucionit për vitin kalendarik 2020”.

Në përfundim të punës nga ana e komisionit të ngritur sipas Urdhrit të mësipërm është hartuar dhe relacioni për administratorin e FM me nr.2059/2 prot., datë 30.12.2020. Si dhe për Aktivët e Qëndrueshme është hartuar Procesverbali dhe Raporti përfundimtar i Komisionit të Inventarizimit i protokolluar me nr. 2059/3 prot., datë 30.12.2020.

Viti 2021: Për FM, Administratori Znj. Z.D ka nxjerrë Urdhër të brendshëm me nr. 2522 prot., datë 09.11.2021 “Për inventarizimin e Aktiveve të Qëndrueshme”, për Aktivët e Qëndrueshme është hartuar Procesverbali dhe Raporti përfundimtar i Komisionit të Inventarizimit me nr. 2522/1 prot., datë 10.12.2021. Gjithashtu, ka dalë Urdhër i brendshëm me nr. 2521/1 prot., datë 09.11.2021 “Për ngritjen e komisionit për inventarizimin dhe vlerësimin e përdorimit të vlerave materiale dhe magazinës së institucionit për vitin kalendarik 2021”.

Në përfundim të punës nga ana e komisionit të ngritur sipas Urdhrit të mësipërm është hartuar dhe relacioni për administratorin e FM me nr. 2522/2 prot., datë 30.12.2021.

Viti 2022: Për FM, Administratori Z. A.B ka nxjerrë Urdhër të brendshëm me nr. 2686 prot., datë 16.12.2022 “Për inventarizimin e Aktiveve të Qëndrueshme”. Për Aktivët e Qëndrueshme është hartuar Procesverbali dhe Raporti përfundimtar i Komisionit të Inventarizimit i protokolluar me nr. 41 prot., datë 12.01.2023. Gjithashtu, ka dalë Urdhër i brendshëm me nr. 2686/1 prot., datë 16.12.2022 “Për ngritjen e komisionit për inventarizimin dhe vlerësimin e përdorimit të vlerave materiale dhe magazinës së institucionit për vitin kalendarik 2022”.

Në përfundim të punës nga ana e komisionit të ngritur sipas Urdhrit të mësipërm është hartuar dhe relacioni për administratorin e FM me nr. 2886/2 prot., datë 28.12.2022.

Nga auditimi u konstatua, moskuadrimi i inventareve në vitin 2013, gjë e cila ndikon në dhënien e një opinioni të drejtë mbi PF. (cituar edhe tek pasqyrat financiare)

Nga auditimi në lidhje me inventarizimin e aseteve të FMD (FMD) për periudhën e auditimit rezultoi si më poshtë:

Viti 2020: Për FMD, Administratori Znj. A.T ka nxjerrë Urdhër të brendshëm me nr. 526 prot., datë 24.11.2020 “Për ngritjen e komisionit për inventarizimin dhe vlerësimin e përdorimit të

vlerave materiale dhe magazinës së institucionit për vitin kalendarik 2020”, si dhe Urdhër të brendshëm me nr.525 prot., datë 24.11.2020 “Për inventarizimin e Aktiveve të Qëndrueshme”. Në përfundim të punës nga ana e komisionit të ngritur sipas Urdhërit të mësipërm është hartuar relacioni dhe Raporti me nr. 526/1 prot., datë 24.12.2020 (për inventarizimin e magazinës), si dhe Relacioni me nr. 525/2, datë 25.01.2021 për realizimin e inventarizimit Aktiveve të qëndrueshme në FMD, (për inventarizimin e magazinës).

Viti 2021: Për FMD, Administratori Znj. A.T ka nxjerrë Urdhër të brendshëm me nr.689 prot., datë 31.12.2021 “Për ngritjen e komisionit për inventarizimin dhe vlerësimin e përdorimit të vlerave materiale dhe magazinës së institucionit” për vitin 2021 si dhe Urdhri i Brendshëm me nr. 690 prot., datë 31.12.2021 “Për inventarizimin e Aktiveve të Qëndrueshme”.

Në përfundim të punës nga ana e këtyrë komisioneve të ngritur sipas Urdhrave të mësipërm është hartuar dhe relacioni për administratorin e FMD me nr. 689/1 prot., datë 10.01.2022 (për inventarin e magazinës), si dhe për Aktivët e Qëndrueshme është hartuar Procesverbali dhe Raporti përfundimtar i Komisionit të Inventarizimit me nr.690/1 prot., datë 31.01.2022.

Viti 2022: Për FMD, Administratori Znj. A.T ka nxjerrë Urdhër të brendshëm me nr. 544 prot., datë 29.09.2022 “Për inventarizimin e Aktiveve të Qëndrueshme”, si dhe Urdhër të brendshëm me nr. 543 prot., datë 29.09.2022 “Për ngritjen e komisionit për inventarizimin dhe vlerësimin e përdorimit të vlerave materiale dhe magazinës së institucionit për vitin kalendarik 2022”.

Në përfundim të punës nga ana e komisionit të ngritur sipas Urdhrit të mësipërm, me shkresat me nr. 544/1 prot., datë 30.11.2022 dhe nr. 543/1 prot., datë 20.10.2022, është hartuar dhe relacioni për administratorin e FMD, (për inventarizimin e Magazinës).

Konstatime për procesin e inventarizimit të aktiveve materiale:

1. Procedurat e inventarizimit rezultojnë pjesërisht të finalizuara dhe nuk janë ndjekur plotësisht nga proceset e vlerësimit, të daljes jashtë përdorimit, si dhe asgjësimit për aktivët që nuk kanë destinacion tjetër, veprime këto në kundërshtim me *paragrafin* nr. 84, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011.

2. Procesi i inventarizimit nuk jep informacion aq të detajuar për të dhënat e aktiveve, siç përcaktohet në *paragrafin nr. 95, të Udhëzimit të MFE nr. 30, datë 27.12.2011*. Si mangësi në pamje të parë për realizimin e këtij inventarizimi rezulton se komisioni nuk ka pasqyruar një analizë për destinacionin përfundimtar, mundësinë e riparimit të pajisjeve, etj.

3. Nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e *paragrafit nr. 103, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*,

Nga auditimi, u konstatua se UMT nuk ka nxjerrë jashtë përdorimit asete, të cilat kanë përmbushur kushtet për nxjerrjen jashtë përdorimi.

- Nga ana e komisioneve të ngarkuara me kryerjen e inventarizimit fizik janë evidentuar aktive të qëndrueshme, aktive qarkulluese e gjendje inventari që janë *jashtë funksionit*, por nuk ka një analizë kosto/përfitim të tyre. Gjatë analizimit të inventarëve për vitet objekt auditimi rezultoi se, nuk është nxjerrë jashtë përdorimit asnjë aset (produkt), edhe pse duke u nisur nga vitet dhe nga norma e amortizimit, ekzistojnë asete të cilat janë plotësisht të amortizuara, referuar edhe relacioneve të komisionit.

- U konstatua se, në disa raste në fletë hyrjen e magazinës dhe në dokumentacionin e marrjes në dorëzim të mallrave, nuk regjistrohen numrat serial/identifikimit përkatës të mallrave, duke e bërë të vështirë identifikimin e tyre.

Ky veprim është në mospërputhje me: *UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kapitulli IV “Sistemi i kontrollit periodik te aktiveve”, pika 73 – 120.*

Regjistrimi i pasurisë së paluajtshme të Universitetit të Mjekësisë Tiranë në Agjencinë Shtetërore e Kadastrës.

Nga ana e Universitetit të Mjekësisë Tiranë, për periudhën objekt auditimi, në lidhje me inventarizimin dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme të UMT, nuk ka gjurmë mbi kryerjen e inventarizimit të pasurive të paluajtshme shtetërore, për pasojë informacioni mbi procedurat e ndjekura për inventarizimin e pasurive të paluajtshme është i pjesshëm, në kundërshtim kjo me pikën 74, të kapitullit IV *Sistemi i kontrollit periodik te aktiveve të UMF nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”* i cili specifikon se: “Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.”

Pronat e UMT janë të regjistruara në ZVRPP në emër të Bashkisë Tiranë dhe jo të UMT. Me përjashtim të shtesave të cilat janë në emër të UMT.

Nga auditimi, u konstatua se, FM nuk ka një regjistër të aktiveve të plotë për të gjithë zërat e aktiveve, në të cilin të evidentohet qartësisht data e hyrjes në institucion, amortizimi i akumuluar, amortizimi vjetor dhe vlera e mbetur për periudhën e auditimit, sipas formatit të rregjistrit të aktiveve, i cili hartohet në vartësi të llojit të tyre, si dhe grupit përkatës brenda llojit, por mbahen vetëm në excel. Ky veprim është në mospërputhje me: *UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kreu Rregjistri i aktiveve të njësisve të sektorit publik, pika 26, pika 28 dhe pika 30 si dhe Rregulloren e Brendshme të UMT, “Për administrimin financiar, kontabilitetin dhe kontrollin në UMT”, Neni 9, pika 3..*

Titulli i gjetjes:	Për vitet objekt auditimi në UMT nuk është nxjerrë jashtë përdorimit asnjë aset, i cili përmbushte kushtet për nxjerrjen jashtë përdorimi.
Situata:	Gjatë analizimit të inventarëve rezultoi se, për vitet objekt auditimi nuk është nxjerrë jashtë përdorimit asnjë aset (produkt), edhe pse duke u nisur nga vitet dhe nga norma e amortizimit, ekzistojnë asete të cilat janë plotësisht të amortizuara. Gjithashtu tek inventarët nuk janë përfshirë zërat (toka, ndërtesa, rikonstruksione), në mënyrë që të bëhet verifikimi i vlerës së aseteve, amortizimit të duhur të tyre duke përfshirë edhe shtesat, si dhe të ardhurat e gjeneruara nga përdorimi i tyre, nëse ka. Në fletë hyrjen e magazinës dhe në dokumentacionin e marrjes në dorëzim të mallrave, nuk regjistrohen numrat serial/identifikimit përkatës të mallrave, duke e bërë të vështirë identifikimin e tyre, veprime jo në përputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kapitulli IV “Sistemi i kontrollit periodik te aktiveve”, pika 73 – 120. Pronat e Universitetit të Mjekësisë Tiranë janë të regjistruara në ZVRPP në emër të Bashkisë Tiranë dhe jo të UMT-së, me përjashtim të shtesave të cilat janë në emër të UMT-së. Nga ana e Universitetit të Mjekësisë Tiranë, për periudhën objekt auditimi, në lidhje me inventarizimin dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme të UMT, nuk ka gjurmë mbi kryerjen e inventarizimit

	të pasurive të paluajtshme shtetërore, për pasojë informacioni mbi procedurat e ndjekura për inventarizimin e pasurive të paluajtshme është i pjesshëm. Pronat e UMT janë të regjistruara në ZVRPP në emër të Bashkisë Tiranë dhe jo të UMT.
Kriteri:	UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kapitulli IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve”, pika 73 – 120.
Ndikimi/Efekti:	Nuk bëhet i mundur identifikimi i vlerës reale të aseteve dhe nga ana tjetër kemi rritje të vlerës së amortizimit, si pasojë e mos nxjerrjes jashtë përdorimit.
Shkaku	Neglizhenca nga sektori i financës.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Nga Sektori i Financës të merren masat që në vijimësi, asetet plotësisht të amortizuara të nxirren jashtë përdorimit. Gjithashtu duhet të përfshihen në inventar zërat si: toka, ndërtesa, rikonstruksione dhe për secilin mall që merret në dorëzim nga institucioni, të përcaktohet dhe regjistrohet numri serial për të bërë të mundur identifikim e tyre.
Rekomandimi:	Nga Titullari, në bashkëpunim me Sektorin e Financës dhe atë Juridik, të merren masa për regjistrimin e pronave të UMT-së në ZVRPP në emër të saj, pasi ka vështirësi në evidentimin e plotë të aktiveve në pronësi dhe për llogaritjen e amortizimit vjetor.

Titulli i gjetjes:	Mungesa e një regjistri të plotë aktiveve në Fakultetin e Mjekësisë.
Situata:	Nga auditimi i regjistrave të aktiveve në UMT, u konstatua se në Fakultetin e Mjekësisë nuk ka një regjistër të plotë të aktiveve që zotëron apo ka në administrim, në të cilin të evidentohet qartësisht data e hyrjes në institucion, amortizimi i akumuluar, amortizimi vjetor dhe vlera e mbetur, sipas formatit të regjistrit të aktiveve. Nuk është trashëguar dokumentacioni nga punonjësi që është larguar, pasi ka ikur pa bërë dorëzimet.
Kriteri:	- UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Pikat 26, 28 dhe 30; - Rregullorja e Brendshme e UMT, e ndryshuar “Për administrimin financiar, kontabilitetin dhe kontrollin në UMT”, Neni 9, pika 3.
Ndikimi/Efekti:	Vështirësi në evidentimin e plotë të aktiveve në pronësi dhe llogaritjen e amortizimit vjetor.
Shkaku	Mungesa e nxjerrjes së një regjistri të plotë të aktiveve.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandimi:	Nga Drejtoria e Financës të merren masa për nxjerrjen e një regjistri të plotë të aktiveve që zotëron, sipas llojit, grupit dhe formatit të dispozitave ligjore në fuqi në funksion të evidentimit të jetëgjatësisë së përdorimit të aktiveve nga institucioni dhe monitorimit të llogaritjes së amortizimit vjetor.

2.10 Nxjerrja e bilancit kontabël në afat, plotësimi i pasqyrave financiare sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj., ndaj buxhetit të shtetit.

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë është themeluar më datë 23.01.2013, me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 48, “Për krijimin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë (UMT)”.

Në kuadër të riorganizimit të Universitetit, nga Universiteti i Tiranës shkëputen dhe integrohen në strukturën e UMT-së **njësitë kryesore:** FM dhe Fakulteti i Infermierisë.

Struktura e UMT-së: Në strukturën e UMT-së përfshihen njësitë kryesore, FM; FMD ; Fakulteti i Farmacisë; FSHMT; Fakulteti i Shëndetit Publik.

Programet e studimeve të UMT-së: Sipas kësaj VKM, financimi i UMT-së, për vitin 2013, përbëhet nga: buxheti i Universitetit të Tiranës, i planifikuar për Fakultetin e Mjekësisë dhe Fakultetin e Infermierisë; dhe b) burime të tjera të ligjshme.

UMT-së i kalojnë të gjitha asetet e luajtshme dhe të paluajtshme që zotërojnë dhe disponojnë FM dhe Fakulteti i Infermierisë, të Universitetit të Tiranës.

UMT-ja e ka selinë në Tiranë, në godinën e Fakultetit të Mjekësisë, të Universitetit të Tiranës.

UMT-ja e fillon veprimtarinë për vitin akademik 2012 - 2013.

Veprimtaria ekonomike rregullohet sipas dispozitave ligjore: ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 10276, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; Statuti i UMT, të miratuar me Vendimin nr.36, datë 11.09.2018 të Bordit të Administrimit dhe me Vendimin nr.11, datë 11.02.2019 të Senatit Akademik, VKM nr.75, datë 12.02.2018, “Për miratimin e modelit të financimit të buxhetit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, VKM nr.431, datë 22.06.22, “Për disa ndryshime në VKM nr.75, datë 12.02.2018, “Për miratimin e modelit të financimit të buxhetit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, legjislacioni tatimor e fiskal në fuqi; si dhe marrëveshjeve ndërkombëtare.

Objekti i veprimtarisë së UMT është formimi i profesionistëve të shëndetit, të aftë për të përballuar sfidat e zhvillimit në fushat e shkencave mjeksore.

Nga ana e fakulteteve janë paraqitur pasqyrat financiare në afat dhe pasqyra financiare e konsoliduar është hartuar në afat, konkretisht:

Njësia shpenzuese	Vitet		
	2020	2021	2022
Rektorati	nr. 763, datë 31.03.2021, depozituar ne thesar nr.2343, datë 31.03.2021,	nr. 945 prot., 31.03.2022, depozituar ne thesar nr.2378, datë 31.03.2022,	nr. 532/2, datë 31.03.2023, depozituar ne thesar nr.787/292, datë 31.03.2023,
FM	nr. 701, datë 30.03.2021, depozituar ne thesar nr.2143, datë 30.03.2021	nr.608, datë 31.03.2022, depozituar ne thesar nr.2373, datë 31.03.2022,	nr. 644, datë 28.03.2023, depozituar ne thesar nr.787/199, datë 29.03.2023
FMD	nr. 169, datë 26.03.2021, depozituar ne thesar nr.2196, datë 31.03.2021	nr. 186, datë 31.03.2022, depozituar ne thesar nr.2370, datë 31.03.2022	nr. 146/1, datë 15.03.2023, depozituar ne thesar nr.787/65, datë 15.03.2023.
FSHMT	nr. 233/1, datë 23.02.2021, depozituar ne thesar nr.1197, datë 24.02.2021	nr. 245, datë 28.02.2023, depozituar ne thesar nr.1366 datë 28.02.2022,	nr. 317, datë 27.02.2023, depozituar ne thesar nr.787/25 prot., datë 28.02.2023
I konsoliduari	nr. prot 763/1, datë	nr. 945/3, datë 31.03.2022	nr. prot 532/3, datë 31.03.2023

dërguar në MAS	31.03.2021		
----------------	------------	--	--

UMT operon me thesar dhe për projektet kërkimore shkencore operon me sistem thesari dhe për projektet me financime të huaja edhe me bankën e nivelit të dytë “C” sha.

Objekt i auditimit janë pasqyrat financiare të njësive shpenzuese dhe të konsoliduara, të cilat përfshijnë bilancin kontabël, pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrën e ndryshimit të kapitalit, fluksit të parave, pasqyrat statistikore të investimeve, gjëndjes dhe ndryshimit të aktiveve afatgjata (kosto historike/ neto) dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare. Auditimi është fokusuar vetëm në aspektet që kanë të bëjnë me *auditimin financiar*. Duke kryer verifikimin e vërtetësisë dhe të koordinimit të të dhënave origjinale, nëpërmjet kontrollit të dokumenteve të mbajtura nga administratorët; krahasimin e besueshmërisë së të dhënave të kontabilitetit dhe analizimin kritik të tyre me aftësinë e tyre për të dhënë informacion, nëpërmjet rishikimit sistematik të kontabilitetit dhe pasqyrave financiare; krahasimin e të dhënave të bilancit, shqyrtimin kritik të tij dhe krahasimin me parametra ligjor të përcaktuar. Regjistrimet kontabël janë të bazuara në dokumentacionin bazë, i cili është i autorizuar dhe i aprovuar nga personat e ngarkuar, me autoritetin që kanë në përputhje me rregullin e brendshëm. Çdo fakultet përgatit pasqyrat përkatëse të cilat konsolidohen nga Rektorati. Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e koston historike. Aktivitet monetare përfaqësojnë paratë në bankë dhe në arkë, të cilat janë vlerësuar dhe mbahen me vlerën e drejtë. Regjistrimet e transaksioneve në monedhë të huaj, janë regjistruar në kontabilitet me kursin e datës së kryerjes së transaksionit.

U shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Pasqyrat financiare të vitit 2020, 2021 dhe 2022 të shoqëruar me formatet 1-9;
- Dokumente kontabël si: ditarët e bankës, magazinës, pagave, të veprimeve të ndryshme, debitorëve, kreditorëve, furnitorëve, etj, centralizatori, bilanci vërtetues;
- Dokumentacioni i kryerjes së inventareve të aktiveve, libri i aktiveve;
- Akt-rakordimet me Degën e Thesarit në mbyllje të vitit buxhetor;
- Të tjera dokumente mbështetëse (databaze të ndryshme ne programet “excel”si: për vendimet gjyqësore, për investimet, per ditaret,shpenzimet te ardhurat, etj).

Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:

Për vitin 2020, 2021 dhe 2022 nga njësia shpenzuese për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar, Udhëzimet e MFE nr.8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 si dhe udhëzimin përkatës vjetor.

Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare: Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ.

Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit: Nga ana e UMT si dhe njësitë shpenzuese në varësi të saj, janë kryer rakordimet periodike me Thesarin si dhe raportimet periodike me institucionet e varësisë (MAS, MFE, etj.).

Nga verifikimi për çdo muaj i ditarit të bankës i mbajtur sipas natyrës dhe sipas destinacionit rezulton të jetë i rakorduar me akt rakordimin dhe dokumentin e nxjerrjes së llogarisë nga thesari

për çdo muaj (ekstrakt banke) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor dhe nuk ka diferenca.

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese dhe vërtetuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese dhe vërtetuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit : Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë institucion, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë manuale në program “Excel”. UMT, në sistemin kontabël që përdor për përcaktimin, marrjen në llogari, matjen, klasifikimin dhe paraqitjen e të dhënave financiare të veprimtarive të njësive ekonomike nuk përdor bartësit informatikë, duke shfaqur rritje të riskut të gabimeve si dhe të vështirësive për monitorim të sistemit, mungesën e të dhënave financiare në kohë reale për t'u reflektuar në vendim-marrjen e organeve drejtuese të shoqërisë. Ky fakt ndikon në mos kontroll për sigurinë dhe ruajtjen e të dhënave për të gjitha veprimet dhe ngjarjet ekonomike, mundësi për ndryshim të tyre nga përdoruesit dhe rezulton mos vlerësim sa dhe si duhet i programeve informatike bashkëkohore.

Konkluzion: Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët shpenzimeve të thesarit, bankës, të të ardhurave, magazinës, të pagave, ditari i veprimeve të ndryshme, etj.. Gjithashtu të hedhura këto në librin e madh/ centralizator.

- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë vërtetues e justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vertetesi veprimin ose ngjarjen, përmban te dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhenat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu, dokumentet vërtetues si urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve

drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet, etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listëpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

Baza e dhënies së opinionit të Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të të UMT – Rektorati, për aktivitetin ekonomik - financiar 01.01.2020 deri më datën 31.12.2022. Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Sektori i Financës. Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se, janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2020, 2021, 2022 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2019, 2020 dhe 2021. Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2020, 2021 e 2022 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjesë e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike; Totali i Aktivit për vitin 2020 është në vlerën 113,889,549 lekë, për vitin 2021 është 130,511,603 lekë dhe për vitin 2022, 160,672,498 lekë, i paraqitur në formatin 1 dhe i zbërthyer në llogari si më poshtë:

Pasqyrat financiare për vitet objekt auditimi për Rektoratin paraqiten sa vijon:

Referenca e llogarive	Emërtimi	Ushtrimi i mbyllur për vitet:		
		2020	2021	2022
A	AKTIVET	113,889,549	130,511,603	160,672,498
	I. Aktivët afatshkurtra	89,423,827	101,344,183	120,884,452
	1. Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	81,493,594	92,169,479	108,437,671
531	Mjete monetare në arkë			
51,256	Mjete monetare në bankë		2,404,593	8,818,526
520	Disponibilitete në thesar	81,493,594	89,764,886	99,619,145
	Gjendje më 31.12.2022	24,562,256	22,766,046	26,008,677
	Teprica për tu mbartur në vitin 2023	56,929,781	66,997,283	73,608,912
	Mjete në ruajtje	1,557	1,557	1,557
	2. Gjendje inventari qarkullues	3,647,840	3,196,518	3,668,774
31	Materiale	3,647,840	3,196,518	3,668,774
	3. Llogari të arkëtueshme	4,282,394	5,978,186	8,778,007
4,342	Operacione me shtetin (të drejta)	4,282,394	5,978,186	8,778,007
	II. Aktivët afatgjata	24,465,722	29,167,420	39,788,046
	1. Aktive afatgjata jomateriale	117,600	1,899,732	13,030,320
202	Studime dhe kërkime	117,600	1,899,732	13,030,320
	2. Aktive afatgjata materiale	24,348,122	27,267,688	26,757,726
212	Ndërtesa e konstruksione	2,414,105	2,293,400	2,178,730
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore			
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	9,475,868	13,518,494	10,907,526
218	Inventar ekonomik	12,458,149	11,455,794	13,671,470
	4. Investime	-		
230	Për aktive afatgjata jomateriale			
231	Për aktive afatgjata materiale			
B	PASIVET	4,283,951	5,979,743	8,779,564
	I. Pasivet afatshkurtra	4,283,951	5,979,743	8,779,564
	1. Llogari të pagueshme	4,283,951	5,979,743	8,779,564

401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	1,058,408	2,305,676	4,428,362
	Detyrime te dhjetorit qe do paguhen ne vitin pasardhes	49,487	1,799,772	4,349,370
	Disbursimi nga shteti	24,440	80,156	78,992
42	Detyrime ndaj personelit	2,191,453	2,488,528	2,766,519
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa	249,911	347,190	630,660
432	Tatime mbledhur për llogari të pushtetit lokal	219,587	233,373	264,972
433	Detyrime shteti për fatkeqësi natyrore	30,324	113,817	365,688
435	Sigurime shoqërore	685,697	732,854	836,393
436	Sigurime shëndetësore	96,925	103,938	116,073
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	1,557	1,557	1,557
C	AKTIVET NETO/FONDET NETO (A–B)	109,605,598	124,531,860	151,892,934
	FONDET NETO PËRBËHEN NGA:	109,605,599	124,531,861	151,892,934
101	Teprica (fondi i akumuluar)/deficiti i akumuluar	28,113,562	32,363,939	43,456,820
	Llogaria 101	19,081,382	28,113,562	32,363,939
		11,819,455	8,985,517	13,084,445
		(422,944)	(451,321)	472,255
		(2,364,331)	(4,283,819)	(2,463,819)
85	Rezultati i veprimtarisë ushtrimore	81,492,037	92,167,922	108,436,114
	Disponibilitete -Teprica për tu mbartur ne vitin pasardhes	24,562,256	2,404,593	8,818,526
		56,929,781	89,763,329	99,617,589

Analiza e llogarive më 31.12.2022 paraqitet më poshtë:

- Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar”:**

520	Disponibilitete në thesar	99,619,145	
	Gjendje më 31.12.2022	26,008,677	Nga Buxheti
	Teprica për tu mbartur ne vitin 2023	73,608,912	Nga Te ardhurat

- Nënrubrika "llogari te arkëtueshme":** Gjendja e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)” e cila përfaqëson detyrimet afatshkurtra për muajin dhjetor 2022, që trashëgohen në vitin 2023. Gjendja në fund të vitit kuadron me shumën e gjendjeve të llogarive në pasivin e bilancit: llog. 401-404 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, llog.42 “Detyrime ndaj personelit”, llog.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”, llog.435 “Sigurime shoqërore”, llog.436 “Sigurime shëndetësore” për vlerën 439,914 lekë, sipas tabelës sa më poshtë vijon:

Nr llog.	Emërtimi i llogarisë	Vlera
4342	Operacione me shtetin (të drejta)	8,778,007
	Analitike	
	Furnitorë e llogari të lidhura me to	4,428,362
	"P.K"SHPK, shpenzime organizim ceremoni 70-vjetori,faturë 405/2022 dt.19.12.2022	4,349,370
	"L.S" vlera e TVSH-se se pajisjeve të blera projekti "Digi Care 4 you FTE 07/31.10.2022	78,992
	Detyrime ndaj personelit	2,766,519
	Paga e punonjësve efektiv të muajit dhjetor 2022	2,766,519
	Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa	630,660
	Tatim page të muajit dhjetor 2022	264,972
	Tatim ne burim i muajit dhjetor 2022	365,688
	Sigurime shoqërore	836,393
	Sigurime shendetesore	116,073

- Nënrubrika "Aktive afatgjata", 31.12.2022:**

Për auditimin e aktiveve **afatgjata materiale**, u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme:

- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve **afatgjata materiale** në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;

- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhur ndonjë variacion anormal mbi aktivet **afatgjata materiale**;
- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;
- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuar dhe udhëzimeve përkatëse.
- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;
- U krahasuan investimet e realizuara gjate ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet.

- **Gjendja e llogarisë 202 "Studime dhe kërkime"** paraqitet e sa vijon ku është zbritur amostizimi i akumuluar. Kjo gjendje është e analizuar si vijon.

	Emërtimi i llogarisë	Vlera bruto (kosto historike)	Amortizimi i akumuluar	Vlera Neto
	Analiza e nënrubrikës " Aktive afatgjata jomateriale"			
212	Studime dhe kërkime	13,065,600	35,280	13,030,320
202	Studim e projektim me objekt: "Furnizim dhe vendosje të sistemit të sinjalizimit dhe mbrojtjes nga zjarri për godinën e UMT-së	117,600	35,280	82,320
202	Sherbim projektimi me objekt: "Hartim projektpreventiva zbatimi për rikonstruksionin e godinave të dëmtuara nga tërmeti: Godina e Farmacisë dhe Shëndetit Publik, Godina e Anatomisë dhe Salla e Leksioneve të godina e Paraklinikut" "Atelier 4" SHA	12,948,000		12,948,000
	Shuma Aktive afatgjata jomateriale	13,065,600	35,280	13,030,320
	Analiza e nënrubrikës " Aktive afatgjata materiale"			
212	Ndertime e konstruksione	2,763,854	585,124	2,178,730
	Ndertime e konstruksione/Hartimi i projekt prev per rikonstr çatie & 2 sallat e Rektoratit Arkonstruksion	797,400	113,729	683,671
	Krijim Fondi Biblioteke	1,966,454	471,395	1,495,059
214	Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune	13,621,938	2,714,411	10,907,527
	Paisje dhe shpenzimet instaluese te telekomunikacionit	187,200	35,614	151,586
	Paisje teknike laborator	10,136,838	2,016,378	8,120,459
	Paisje dhe instalimi i kondicionereve	1,072,800	315,007	757,793
	Paisje per mbrojtjen ndaj zjarrit	117,600	0	117,600
	Paisje per sistemin e sigurimit	750,900	223,226	527,674
	Paisje audio-vizuale	967,800	37,804	929,996
	Mjete dhe paisje te tjera teknike	388,800	86,383	302,417
218	Inventar ekonomik-TOTALI	27,565,563	13,894,093	13,671,470
	Inventar ekonomik/Mobilje e orendi zyre	9,741,592	5,469,974	4,271,618
	Inventar ekonomik/Elektronike	17,823,971	8,424,119	9,399,852
	Shuma Aktive afatgjata materiale	43,951,354	17,193,628	26,757,726
	Totali Aktive Afatgjata	57,016,954	17,228,908	39,788,046

- **"Gjëndje Inventari Qarkullues", Llogaria "Materiale"**

Nr	Përshkrimi	Data	Vlera lekë
1	Gj.inventarit Qarkullues ne fund te vitit	31.12.2020	3,647,840
2	Gj.inventarit Qarkullues ne fund te vitit	31.12.2021	3,196,518
3	Gj.inventarit Qarkullues ne fund te vitit	31.12.2022	3,668,774

- **Nënrubrika "Ilogari të pagueshme", 31.12.2022**

Nr.llog	Emërtimi i llogarisë	Vlera
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	4,428,362
401	"P.K" SHPK, shpenzime organizim ceremoni 70-vjetori faturë nr. 405/2022, datë.19.12.22	4,349,370
404	"L.S" vlera e TVSH-se se pajisjeve të blera projekti "Digi Care 4 you" faturë nr. 07/2022 datë.31.10.2022	78,992
421	Detyrime ndaj personelit	2,766,519

	Paga e punonjësve efektiv	2,766,519
431	Detyrime ndaj shtetit per tatim-taksa	630,660
	Tatim page	264,972
	Tatim në burim	365,688
435	Sigurime shoqërore	836,393
436	Sigurime shëndetësore	116,073
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	1,557
	Totali	8,779,564

Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve materiale dhe jomateriale për vitin 2020 e Pasqyrave Financiare te Rektoratit

-Për vitin 2020 –

Analiza e rubrikës: "Aktive afatgjata jomateriale":

Në vitin 2020 kjo rubrikë ka patur vetëm shtesa dhe konkretisht:

- Llog. 202- *Studime dhe kërkime* - Studim e projektim me objekt:"Furnizim dhe vendosje të sistemit të sinjalizimit dhe mbrojtjes nga zjarri për godinën) e UMT-së në vlerë 117,600 lekë.

Analiza e nënrubrikës "Aktive afatgjata materiale".

Në vitin 2020 kjo nënrubrikë është shtuar në vlerën 7,403,575 lekë në zërin :

- Llog.212.- Ndërtime e konstruksione nuk ka ndryshime;
- Llog.214.- Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune;

Zëri "Pajisje dhe instrumente laboratorike" është shtuar për vlerën e pajisjeve të Laboratorit të Immunologjisë të blera në kuadër të projektit "Aplikimi i imunocitometrisë me fluks në studimin e funksionit fagocitar dhe limfocitar si dhe në imunofenotipizimin qelizor të nyjeve limfatike" me vlerë 6,240,000 lekë "Aktive afatgjata materiale"

- Llog.218- "Inventar ekonomik",
- Llog.218.- "Inventar Ekonomik" është shtuar për vlerën 5,461,855 lekë,vlerë e pajisjeve të blera ku:

Zëri "Orendi zyre" është shtuar për vlerën 1,163,575 lekë, dhe

Zëri "Pajisje kompjuterike" është shtuar për vlerën 4,298,280 lekë

Gjithashtu për vitin 2020, nga ana e UMT-së për aktivet është llogaritur dhe amortizimi vjetor sipas UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes", i ndryshuar.

Të gjitha ndryshimet në aktivet e UMT-së, Rektorati janë pasqyruar edhe në Regjistrin e aktiveve

Per vitin 2021

Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve materiale dhe jomateriale për vitin 2021

Në vitin 2021 kjo rubrikë ka patur ndryshime si në shtesa dhe pakësime dhe konkretisht:

Analiza e nënrubrikës " Aktive afatgjata jomateriale"

Kjo nënrubrike është shtuar për vlerën 1,799,772 lekë dhe konkretisht në zërin :

- **Llog. 202- Studime dhe kërkime** – Shërbim projektimi me objekt: "Hartim projekt preventiva zbatimi për rikonstruksionin e godinave të dëmtuara nga tërmeti: Godina e Farmacisë dhe Shëndetit Publik, Godina e Anatomisë dhe Salla e Leksioneve, godina e Paraklinikut", në vlerë =1,799,772 lekë.

Analiza e nënrubrikës "Aktive afatgjata materiale"

Në vitin 2021 kjo nënrubrikë është shtuar për vlerën e aktiveve të transferuara të projekteve me financim të huaj me bankat e nivelit të dytë (BND) me vlerën fillestare 32,670,188 lekë & amortizim = 9,230,031 lekë dhe pakësuar po për këto aktive për vlerën e aktiveve të transferuara në shumën 25,484,443 & amortizimi në shumën 4,963,853 lekë si më poshtë :

- **Llog.212.- Ndertime e konstruksione** nuk ka ndryshime
- **Llog.214.- Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune**
 - **Llog.214.- Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune** për pajisjet në kuadër të projekteve me financim të huaj me BND, si më poshtë:

Përshkrimi	Shtesa		Pakësime	
	Vlera fillestare	Amortizimi	Vlera fillestare	Amortizimi
LLog.214- Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune				
Projekti Euscreen	26,485,074	4,419,440.1	21,846,485	3,448,781
AAM "QSUT", Tiranë			7,679,398.5	985,135.3
AAM Materniteti "Mbretëresha Geraldinë"			5,845,668	1,031,236.4
AAM Materniteti "Koço Gliozheni"			4,497,677	782,083.5
AAM Spitali "Distrofik"				
AAM Spitali Kukës				
AAM Spitali Pogradec			3,478,772	610,293.7
AAM FM			344,970	40,032.2
SHUMA Projekti "EUSCREEN"	26,485,074	4,419,440.1	21,846,485	3,448,781
Projekti "QUADIC"	848,160	0		0
TOTAL "Inst.tek, mak, pajisje e vegla pune" llog-214	27,333,234	4,419,440	21,846,485	3,448,781

- **Llog.218- "Inventar ekonomik"** Në mënyrë analitike sipas projekte dhe zerave shtesat dhe pakësimet për pajisjet në kuadër të projekteve me financim të huaj me BND, paraqiten si më poshtë: Zëri "Pajisje e Orendi zyre"

Përshkrimi	Shtesa		Pakesime	
	Vlera fillestare	Amortizimi	Vlera fillestare	Amortizimi
Projektet EUSCREEN				
AAM Materniteti "Mbretëresha Geraldinë"			169,280	88,664.3
AAM Materniteti "Koço Gliozheni"			30,900	16,397.6
AAM Spitali "Distrofik"				
AAM FM			1,071,300	324,865.8
Total Projekti EUSCREEN Shuma Inventar Ekonomik/Pajisje mobilje e orendi	1,299,380	444,733.3	1,271,480	429,927.7

Zëri "Pajisje kompjuterike"

Përshkrimi	Shtesa		Pakësime	
	Vlera fillestare	Amortizimi	Vlera fillestare	Amortizimi
Projektet EUSCREEN				
AAM FM			213,600	66,101.0
TOTAL Projekti EUSCREEN	213,600	66,101.0	213,600	66,101.0
Projekti GRADUA	2,642,542	1,273,418.1	2,152,878	1,019,043
FM			1,182,078.0	614,126.5
FMD			312,480.0	124,402.0
FSHMT			658,320.0	280,514.6
Projekti QUADIC	1,181,472	179,490.0		
Shuma Inventar ekonomik/P.Elektronike	4,037,574	1,519,009.1	2,366,478.0	1,085,144
TOTAL Inventar Ekonomik/Pajisje zyre+P.Elektronike-LLog 218	5,336,954	1,963,742.3	3,637,958	1,515,071.8

Pakësimi konsiston në transferimin e aktiveve të projekteve me financim të huaj, në bankat e nivelit të dytë vetëm për ato institucione të cilat kanë sjellë konfirmim që i kanë marrë në dorëzim dhe i kanë përfshirë në kontabilitetin e tyre. Konkretisht:

Për projektin Euscreen, bazuar në shkresën e Ministrisë së Shëndetësisë, Drejtorisë së Administrimit Spitalor, me nr.5202 prot., datë 13.10.2016, "Për bashkëpunim me projektin për

fushën e depistimit neonatal të dëgjimit dhe depistimit femënor të shikimit paragrafi i fundit citohet: “Në përfundim të këtij projekti aparaturat depistuese/diagnostikuese të vëna në dispozicion nga projekti, do të mbeten në administrimin e institucioneve pjesëmarrës në këtë projekt, në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë”.

Gjithashtu dhe në marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhur nëpërmjet Rektorit të UMT-së Prof. A.G dhe Drejtuesve të institucioneve pjesëmarrës në projekt, në nenin 7 “*Dhurimi i aparaturave*”, është përcaktuar që në përfundim të kësaj marrëveshje aparaturat diagnostikuese të vëna në dispozicion nga ky projekt do të dhurohen Institucionit.

Ndërsa për projektin “Gradua” transferimi është bërë brenda njëjësive të UMT-së sipas instalimit, vendndodhjes dhe përdorimit të tyre.

- Nuk janë transferuar vlerat e aktiveve të institucioneve që nuk kanë sjellë konfirmim institucionet në vitin 2021 e konkretisht e Spitalit "Distrofik" në vlerë fillestare 1,877,538 lekë & amortizimi në vlerë 401,848.6 lekë, si dhe spitalit Kukës në vlerë fillestare 2,788,951 lekë dhe amortizim 583,576 lekë

Nga ana e UMT-së për vitin 2021 për aktivet është llogaritur dhe amortizimi vjetor sipas UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes", i ndryshuar.

Të gjitha ndryshimet në aktivet e UMT-së, Rektorati janë pasqyruar edhe në Regjistrin e aktiveve

Viti 2022: Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve materiale dhe jomateriale për vitin 2022

Në vitin 2022 kjo rubrikë ka patur ndryshime si në shtesa dhe pakësime dhe konkretisht:

Analiza e nënrubrikës "Aktive afatgjata jomateriale"

Në vitin 2022 kjo nënrubrikë është shtuar për vlerën 11,148,228 lekë dhe konkretisht në zërin :

- **Llog.202- Studime dhe kërkime** - Sherbim projektimi me objekt: "Hartim projektpreventiva zbatimi për rikonstruksionin e godinave të dëmtuara nga tërmeti: Godina e Farmacisë dhe Shëndetit Publik, Godina e Anatomisë dhe Salla e Leksioneve të godina e Paraklinikut" në vlerë = 11,148,228 lekë

Analiza e nënrubrikës " Aktive afatgjata materiale"

Ne vitin 2022 kjo nënrubrikë është shtuar për vlerën 117,600 lekë, blerje pajisje kundra zjarrit si dhe pakësuar për transferimin, vlerën e aktiveve afatgjata të projektit Euscreen të Spitalit Kukës për vlerën fillestare 2,788,951 dhe amortizim në vlerën 583,576 lekë pas konfirmimit që i kanë marrë në dorëzim dhe i kanë përfshirë në kontabilitetin e tyre. :

- **Llog.214.- Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune**

- **Llog.212.- Ndertime e konstruksione** nuk ka ndryshime

- **Llog.214.- Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune** është shtuar për vlerën 117,600 lekë, vlerë e pajisjeve të blera për pajisje kundra zjarrit. si dhe është pakësuar vlera e aktiveve afatgjata të projektit Euscreen të Spitalit Kukës për vlerën fillestare 2,788,951 dhe amortizim në vlerën 583,576 lekë pas konfirmimit që i kanë marrë në dorëzim dhe i kanë përfshirë në kontabilitetin e tyre.

- **Llog.218- “Inventar ekonomik”** nuk ka ndryshime

Gjithashtu për vitin 2021, nga ana e UMT-së për aktivet është llogaritur dhe amortizimi sipas Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes", i ndryshuar.

Nga ana e UMT-së për vitin 2022, për aktivet është llogaritur dhe amortizimi vjetor sipas Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes", i ndryshuar.

Të gjitha ndryshimet në aktivet e UMT-së, Rektorati janë pasqyruar edhe në Regjistrin e aktiveve.

Titulli i Gjetjes: Mosrakordim i gjendjes kontabël me gjendjen fizike ndër vite	
Situata:	<p>Nga auditimi i llogarisë 2018 “Inventar ekonomik” rezultoi se pakësimi konsiston në transferimin e aktiveve të projekteve me financim të huaj, në bankat e nivelit të dytë vetëm për ato institucione të cilat kanë sjellë konfirmim që i kanë marrë në dorëzim dhe i kanë përfshirë në kontabilitetin e tyre. Konkretisht: Për projektin Euscreen, bazuar në shkresën e Ministrisë së Shëndetësisë, Drejtorisë së Administrimit Spitalor, me nr.5202 prot., datë 13.10.2016, “Për bashkëpunim me projektin për fushën e depistimit neonatal të dëgjimit dhe depistimit femënor të shikimit paragrafi i fundit citohet: <u>“Në përfundim të këtij projekti aparaturat depistuese/diagnostikuese të vëna në dispozicion nga projekti, do të mbeten në administrimin e institucioneve pjesëmarrës në këtë projekt, në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë”</u></p> <p>Gjithashtu dhe në marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhur nëpërmjet Rektorit të UMT-së Prof. A.G dhe Drejtuesve të institucioneve pjesëmarrës në projekt, në nenin 7 “<i>Dhurimi i aparaturave</i>”, është përcaktuar që në përfundim të kësaj marrëveshje aparaturat diagnostikuese të vëna në dispozicion nga ky projekt do ti dhurohen Institucionit.</p> <p>Ndërsa për projektin “Gradua” transferimi është bërë brenda njësive të UMT-së sipas instalimit, vendndodhjes dhe përdorimit të tyre.</p> <p>- Nuk janë transferuar vlerat e aktiveve të institucioneve që nuk kanë sjellë konfirmim institucionet në vitin 2021 e konkretisht e Spitalit "Distrofik" në vlerë fillestare 1,877,538 lekë & amortizimi në vlerë 401,848.6 lekë, si dhe spitalit Kukës në vlerë fillestare 2,788,951 lekë dhe amortizim 583,576 lekë.</p>
Ndikimi/Efekti:	Mosvënia në shfrytëzim të aparaturave të cilat të mbeten në kontabilitetin e institucioneve që shfrytëzjnë aparaturat.
Shkaku:	Moszbatimi i marrëveshjes.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	UMT-ja të marrë masa dhe të kryejë edhe transferimin e aktiveve të vëna në dispozicion në kuadër të zbatimit të projektit EUSCREEN, të spitalit “Qëndrës kombëtare të mirëritjes, zhvillimit dhe rehabilitimit të fëmijëve”Tiranë (DISTROFIK),dhe në zbatim të marrëveshjeve të lidhura ku “ <i>Dhurimi i aparaturave</i> ”, është përcaktuar që në përfundim të kësaj marrëveshje aparaturat diagnostikuese të vëna në dispozicion nga ky projekt do ti dhurohen Institucionit.

- **Inventarizimi i aktiveve për vitet 2020, 2021 dhe 2022:**

Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e procedurave të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese rezultoi se: Në bazë të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve në fund të çdo viti. Nga Titullari për kryerjen e procesit të inventarizimit për vitet 2020 dhe 2021 dhe 2022 janë nxjerrë urdhrat përkatës me nr.135, datë 11.12.2019 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit për vitin 2019”, nr. 145, datë 18.12.2020 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit për vitin 2020” dhe nr. 185, datë 14.12.2021.

Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit, rezultoi se komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventarëve me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara e të trupëzuara dhe gjendjen kontabël sipas llogarive. Fletët e inventarëve janë të konfirmuara nga komisioni dhe përgjegjësit material brenda muajit dhjetor të viteve.

➤ **Në lidhje me inventarizimet në FM, në vite gjendja e inventarit paraqitet:**

Në pasqyrat financiare të konsoliduara të UMT për **Fakultetin e Mjekësisë** vlera e llogarisë nën rubrika “Gjendje e inventarit qarkullues” llogaria 31 “Materiale”, si dhe nën rubrika “Aktive afat gjata materiale”, llogaria 214 “Instalime elektrike, makineri e paisje si dhe llogaria 218 “Inventar ekonomik,” **vlera neto kontabile e tyre është e pa rakorduar me vlerën fizike.**

Si UMT për periudhën nga viti 2013 e në vazhdim, veprimet për ndryshimet e gjendjeve të këtyre llogarive janë të rakorduar, për hyrje daljet, por gjendja fillestare në çelje në fillim të vitit 2013 (vit i bashkimit), nuk ka një listë të artikujve gjendje, nuk vërtetohet gjendja kontabel me atë fizike.

Nga ana e specialistëve të financës të FM nga viti 2014 e në vazhdim, është bërë punë inventarizuese ku janë saktësuar në mënyrë graduale lëvizjet e inventarit sipas punës së kryer nga viti në vit. Këto rezultate i janë vënë në dispozicion të gjithë kontrolleve të kryera në FM, duke filluar nga kontrolli i MASR-së i cili ka ardhur në UMT për verifikimin e materialit të auditimit për vitin 2013 të kryer në FM, të gjitha auditëve të brendëshme dhe shifrat e nxjerra janë përdorur nga auditit edhe në materialin për kontrollin e aseteve, material i cili i ka kaluar bordit të administrimit. Gjithashtu nga Bordi i Administrimit është kërkuar lista e aseteve e cila i është vënë në dispozicion me shënimin që lista është në përditësim, **për shkak të mungesës së saktë të inventarëve fizik.** Problemi i aseteve është shqyrtuar në mbledhje të veçanta të EMR-së dhe GMS, ku është rënë dakort për ngritjen e një grupi dhe marrjen e ekspertëve të jashtëm për mendim më të specializuar, **gjë e cila nuk është realizuar.**

Nga ana e FM kjo punë ka vazhduar duke hartuar kartelat e reja kontabile, ku të gjithë inventarët janë ndarë sipas llogarive (214, 218) për çdo punonjës, për çdo ambient dhe çdo department **duke sistemuar të gjitha inventaret e gjetur nga viti 2005.** Në mënyrë të veçantë për të gjitha hyrjet e reja të aseteve nga viti 2014 e në vazhdim, për të gjitha aktivet e bëra hyrje është hapur rregjistri i aktivive dhe është llogaritur amortizimi analitik.

Por mangësitë e konstatuara të inventarit fizik me atë kontabël nuk janë të reflektuara në pasqyrën financiare të FM në vitet e mëparshme, pasi ka diferenca midis inventarit kontabël me atë fizik, për gjetjet që kanë bërë specialistët e financës, të cilat nuk janë reflektuar, pasi nuk ka pasur vendimmarrje sa më poshtë vijon:

- Nga kryerja e inventarëve fizik të materialeve dhe krahasimin e tyre me të dhënat e bilancit të vitit 2014, ka rezultuar se për:

a- Llogaria “Materiale” në shumën 39,402,013 lekë- viti 2014: Inventarët që shoqërojnë bilancet nga viti 2005-2013, nuk kanë ndonjë ndryshim të madh nga inventari i kryer në vitin 2014. **Ndërsa krahasuar me bilancet në vite kjo shumë ndryshon.**

b- Llogaritë “Instalim teknike, makineri, paisje vegla”(214) dhe “Inventar ekonomik” (218).

Kontrolli kontabël. Duke ju referuar bilancit të vitit 2014 gjëndjes më 31.12.2014, në degën e financës ekzistonin kartela individuale dhe sipas departamenteve, për këto materialet që përfshihen në këto llogari. **Kartelat ishin mbartuar nga njëri punonjës tek tjetri pa u dorëzuar dhe kuadruar** kështu që vërtetësia ka rezultuar e dyshimtë në vitin 2014.

Sipas kartelave të departamenteve që gjëndeshin në degën e financës të cilat nuk ishin të ndara sipas llogarive, vlera e tyre ishte 220,867,260 lekë, **me një diferencë me kontabilitetin prej 156,633,588 lekë pa përfshirë fondin e librit. Për këtë arsye janë nxjerrë të gjitha dosjet e magazinës dhe janë kontrolluar të gjitha veprimet në kartela nga viti 2005 deri në vitin 2014, ku rezultoi se hedhjet ishin kryer në rregull në kartela.**

Nga krahasimi që i është bërë kartelave të departamenteve me llogaritë e bilancit të vitit 2005, (materiale të kartela fillonin nga kjo datë), ka rezultuar se diferenca midis shumës së kartelave për vitin 2005 me llogaritë (214,218) sipas bilancit 2005 është **-105,608,543 lekë, e cila është diferenca që i përket materialeve të llogarive 214 dhe 218 përpara vitit 2005.**

Në relacionin shoqërues të bilancit 2005, në paragrafet ku jepen shpjegime për këto 2 llogari rezulton se janë bërë dalje materjale jashtë përdorimit, si dhe sistemime për hyrje materiale bazuar në inventarin fizik të kryer. Këto sistemime janë pasqyruar edhe në bilancin e vitit 2005, pra rezulton që në këtë vit është kryer **inventar, dokumentacioni i të cilit nuk është.**

Në të gjitha kartelat nuk ishin kryer ndarjet sipas llogarive kontabel, makineri paisje, inventar ekonomik, materiale elektronike etj si dhe nuk kishte tabela për llogaritjen e amortizimit analitik. Kartelat personale në sektorin e financës nuk ishin të ndara sipas llogarive të mësipërme dhe grupimi sipas grupeve për të saktësuar normat e amortizimit, mbeti për një fazë të dytë.

Kontrolli fizik: Gjatë inventarizimit fizik janë konstatuar këto probleme:

- Për shkak të moskryerjes së inventarëve dhe lëvizjeve të vendndodhjes së departamenteve, nuk janë gjetur përputhje të plota me kartelat financiare, sidomos kjo për inventarin ekonomik dollap, karrige, tavolina etj.

- Disa persona sidomos të administratës kanë pasur në ngarkim materiale (kompjuter) të cilat aktualisht nuk i kanë (sipas tyre i kanë dorëzuar ose kthyer në magazinë) për të cilët specialistët e financës nuk kanë gjetur dokumente.

- Nga inventarizimi fizik specialistët e financës gjetën edhe materiale të cilat nuk janë në kartela si në sekretari 2 fotokopje, bibliotekë 7 kompjutera, departamenti i Morfologjisë 1 fotokopje, 1 frigorifer, 1 peshore. Materiale të auditorit të pediatrikë nuk janë bërë hyrje etj. Gjithashtu një pjesë e tavolinave dhe karrigeve në auditore dhe klasa nuk ishin përfshirë në kartela.

- Shumë persona të larguar, ose të dalë në pension nuk kanë dorëzuar inventarin që kanë në ngarkim si në administratë, qeveria studentore.

Inventarizimi i fondit të librit është kryer në vitin 1992. Nga ana e komisionit është kryer vetëm inventarizimi i materialeve në ngarkim të bibliotekës. Përsa i përket fondit të librit, i cili nuk është gjetur i detajuar analitikisht në kontabilitet, bashkëlidhur bilancit të vitit 2009, u gjetën të dhëna për fondin e librit në bibliotekë, ku ishte përcaktuar numri i titujve dhe vlera, ku: Gjatë inventarizimit të kryer në bibliotekë, nga ana e grupit u kërkua inventarizimi i librit në bibliotekë, ku ju vu në dispozicion inventari i fundit i viti 1992, i kryer nga grup kontrolli i specializuar, por që dhe ai ishte i kryer në grup titujsh. Vlera e librave dhe numri i titujve për çdo ambient dhe periodiku i është vënë në dispozicion nga biblioteka, por vlera është me çmimet e vjetra, për të cilat grupi mendon se është kryer rivlerësim, **por grupi i inventarizimit nuk ka gjetur dokumentacion.**

Vlera e materialeve sipas departamenteve është 242,237,206 lekë. Diferenca me kartelat është + **21,370,346 lekë**, sepse gjatë inventarizimit janë gjetur materiale të cilat nuk ishin në kartela. Gjatë inventarit fizik **nuk janë gjetur dy paisje me vlerë totale 21,307,140 lekë (EKO në sëmundjet e brendshme ngatërruar me QSUT vlera 9,437,000 lekë, (QSUT e kishte futur në**

inventarin e vet) dhe Eko në maternitetin e vjetër nuk ekziton (daton para vitit 2004) në vlerën 8,162,000,lekë.

Materiale të tjera që janë në kartelë por janë të pa inventarizuara sepse punonjësit janë larguar në shumën **3,708,140 lekë.**

Nga verifikimi i veprimeve financiare për vitet 2005-2013 ka rezultuar se Aktivët e Patrupëzuara (program arkive, financa 5, programe sekretarie apo informatizimi i sekretarive) **në vlerën totale 15,418,029 lekë nuk janë gjetur nëpër kartela dhe nuk janë kontabilizuar në postin e duhur në bilanc.**

Gjithashtu në llogaritë e mësipërme janë përfshirë dhe materiale me vlerë 1,082,040 lekë (lavamanë, transformatorë elektrik, vegla pune, stenda për njoftime etj) të cilat nuk ishin në kartela.

Sipas të dhënave të inventarit fizik dhe kontabilitetit në 31.12.2017 kanë rezultuar diferenca në shumën **151,245,296 lekë** (pa fondin e librit) (diferenca midis gjendjes kontabile 31.12.2017 me inventarin fizik 31.12.2017).

Llogaria 32 “Objekte inventari” e cila në fund të vitit 2014 është 8,402,695 lekë e cila duhej të ishte shoqëruar me kartela individuale të cilat në sektorin e financës nuk ekzistojnë.

➤ **Pasqyra e pozicionit financiar, njësia publike UMT (i konsoliduari)**

Ilog.	Emërtimi	Ushtrimi i mbyllur		
		Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
A	AKTIVET	1,783,834,882	1,775,652,266	1,843,594,055
	I. Aktivët afatshkurtra	1,027,337,061	1,060,364,314	1,168,535,764
	1. Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	881,039,680	935,777,583	1,039,540,649
51,256	Mjete monetare në bankë		2,404,593	8,818,526
520	Disponibilitete në thesar	881,039,680	933,372,991	1,030,722,123
	2. Gjendje inventari qarkullues	78,544,296	67,821,904	65,930,896
31	Materiale	68,853,613	58,261,781	56,349,273
32	Inventar i imët	9,690,683	9,560,123	9,581,623
	3. Llogari të arkëtueshme	67,753,085	56,764,826	63,064,219
468	Debitorë të ndryshëm	90,072	232,104	137,938
4342	Operacione me shtetin (të drejta)	67,663,013	56,532,722	62,926,281
	II. Aktivët afatgjata	756,497,821	715,287,952	675,058,291
	1. Aktive afatgjata jomateriale	1,884,900	3,555,782	14,495,120
202	Studime dhe kërkime	1,884,900	3,555,782	14,495,120
	2. Aktive afatgjata materiale	754,612,921	711,732,170	660,563,171
212	Ndërtesa e konstruksione	478,911,324	470,128,403	450,716,463
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	142,677,614	134,339,775	121,657,715
218	Inventar ekonomik	133,023,983	107,263,993	88,188,993
B	PASIVET	67,916,642	56,923,969	63,947,287
	I. Pasivët afatshkurtra	67,916,642	56,923,969	63,947,287
	1. Llogari të pagueshme	67,916,642	56,923,969	63,947,287
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	17,965,082	3,200,766	5,348,955
42	Detyrime ndaj personelit	31,130,923	31,501,206	36,262,493
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa	5,305,518	4,325,785	5,699,238
435	Sigurime shoqërore	10,752,698	11,477,502	13,318,729
436	Sigurime shëndetësore	1,600,479	1,412,150	1,798,473
44	Institucione të tjera publike	876,000	888,000	456,000
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	163,557	163,557	930,934
467	Kreditorë të ndryshëm	32,313	3,727,313	42,393
4341	Operacione me shtetin (detyrime)	90,072	227,690	90,072
C	AKTIVET NETO/FONDET NETO (A-B)	1,715,918,240	1,718,728,297	1,779,646,768
	FONDET NETO PËRBËHEN NGA:	1,715,918,240	1,718,728,297	1,779,646,768

101	Teprica (fondi i akumuluar)/deficiti i akumuluar	835,042,117	783,114,271	741,037,053
85	Rezultati i veprimtarisë ushtrimore	880,876,122	935,614,026	1,038,609,715

Në pasqyrat financiare **të njëjësive shpenzuese dhe të konsoliduara** të UMT për vitet 2020, 2021, 2022, u kontrolluan të gjitha pjesët përbërëse të **pasqyrave financiare, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar (bilanci), pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrën e ndryshimit të kapitalit, fluksit të parave, pasqyrat statistikore të investimeve, gjëndjes dhe ndryshimit të aktiveve afatgjata (kosto historike/ neto) dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare.**

Në hartimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara, UMT është bazuar në UMF nr.8, datë 09.03.2018 ‘Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme’, i ndryshuar, si dhe në specifikat e zhvillimit të veprimtarisë.

Nënrubrika: Gjendje inventari qarkullues”, llogaria 31 "Materiale" përfaqëson vlerën e materialeve, që janë gjendje në magazinë në 31.12.2022. Në Fakultetin e Mjekësisë vlera kontabile nuk përputhet me gjendjen fizike. Nënrubrika "Aktive Afatgjata Materiale" llogaria 214 "Instalime teknike, makineri e pajisje" dhe llogaria "Inventar Ekonomik", në FM, të cilat përfaqësojnë vlerën neto kontabile të këtyre aktiveve, nuk përputhet me gjendjen fizike.

Titulli i Gjetjes: Mosrakordim i gjendjes kontabël me gjendjen fizike ndër vite	
Situata:	Në pasqyrat financiare të konsoliduara të UMT për Fakultetin e Mjekësisë vlera e llogarisë nënrubrika “Gjendje e inventarit qarkullues” llogaria 31 “Materiale”, si dhe nënrubrika “Aktive afat gjata materiale”, llogaria 214 “Instalime elektrike, makineri e pajisje si dhe llogaria 218 “Inventar ekonomik,” vlera neto kontabile e tyre është e pa rakorduar me vlerën fizike. Si UMT për periudhën nga viti 2013 e në vazhdim, veprimet për ndryshimet e gjendjeve të këtyre llogarive janë të rakorduar, për hyrje daljet, por gjendja fillestare në çelje në fillim të vitit 2013 (vit i bashkimit), nuk ka një listë të artikujve gjendje, nuk vërtetohet gjendja kontabel me atë fizike.
Ndikimi/Efekti:	Ndikimi në rezultatin e pasqyrave financiare
Shkaku:	Mosrakordimi i gjendjes fizike me atë kontabël
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	Nga ana e UMT/ Rektorati të merren masa për ngritjen e një gupi pune për vlerësimin kontabël dhe zgjidhjen e situatës për sistemimin e llogarive.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur komenti me shkresë nr. 1421/18, datë 21.11.23, e protokolluar në KLSH me nr. 401/16, datë 01.12.2023, “Komente mbi Projekt Raportin”, nga **S.S.**

Pretendimi i subjektit: Është e paqartë se çfarë është kontrolluar dhe si është realizuar kontrolli për këto vite që janë jashtë objektit të programit të auditimit dhe gjithashtu është e paqartë lidhja e personave që përmenden në këtë akt me këto periudha kohore!”

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Ju sqarojmë se ju në cilësinë e Administratorit të UMT keni firmosur pasqyrat financiare të Rektoratit dhe të konsoliduarin. Ju sqarojmë se në fund të tij keni vënë shënimin: Në pasqyrat financiare **të njëjësive shpenzuese dhe të konsoliduara** të UMT për vitet 2020, 2021, 2022, **Nënrubrika: Gjendje inventari qarkullues”, llogaria 31 "Materiale"**

përfaqëson vlerën e materialeve, që janë gjendje në magazinë në 31.12.2022. Në Fakultetin e Mjekësisë vlera kontabile nuk përputhet me gjendjen fizike. Nën rubrika "Aktive Afatgjata Materiale" llogaria 214 "Instalime teknike, makineri e pajisje" dhe llogaria "Inventar Ekonomik", në FM, të cilat përfaqësojnë vlerën neto kontabile të këtyre aktiveve, nuk përputhet me gjendjen fizike.

Bazuar në këtë shënim grupi i auditimit kërkoi shpjegime dhe dokumentacion për tu sqaruar dhe konkluduar.

2.11 Mbi menaxhimin e burimeve financiare të programeve të specializimeve afatgjata.

Universiteti i Mjekësisë Tiranë (UMT), referuar ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenet 3, 25, 42 dhe 69 si dhe në zbatim të Statutit të UMT, nenet 12, 26, 42 dhe 89, Rregullores së UMT-së, dhe Rregullores së Studimeve të Specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, miratuar me Vendim të Senatit Akademik të UMT, ofron programe të ciklit të tretë specializime afatgjata (për me tej SPA) në fushën e mjekësisë.

Nga auditimi rezultoi se, sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, çdo vit akademik, bazuar në propozimet e dy njësisve kryesore, (FM dhe FMD), bëhet miratimi i kuotave të pranimit, si dhe tarifat e aplikimit dhe shkollimit për programet e ciklit të tretë në programet e specializimeve nga Senati Akademik i UMT, në përputhje me kapacitetin akademik dhe infrastrukturor për këto programe.

Vendimi i Senatit Akademik, mbi miratimin e kuotave të pranimit dhe tarifave përkatëse për programet e ciklit të tretë specializime afatgjata në fushën e mjekësisë (SPA) përcillet pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit **për certifikimin e kuotave në përputhje me standardet shtetërore të kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore**. Gjithashtu, ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit Akademik, për miratimin e tarifave të studimit për programet e ciklit të parë, të integruar të ciklit të dytë "Master Profesional" dhe "Master i Shkencave", i cili për çdo vit nxjerr vendimin përkatës.

Dokumentacioni i miratimit të kuotave të pranimit sipas viteve akademike:

Sipas viteve akademike miratimi i kuotave të pranimit është bërë me vendimet e Senatit Akademik të UMT.:

Viti akademik:		
2020-2021	2021-2022	2022-2023
Vendim nr.108, datë 29.12.2020 "Për miratimin e kuotave të pranimit në programet e ciklit të tretë të studimeve, specializime afatgjatë në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2020-2021, në UMT".	Vendimi nr. 100, 16.12.2021 "Për miratimin e kuotave të pranimit në programet e ciklit të tretë të studimeve, specializime afatgjatë në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2021-2022, në UMT".	Vendim nr. 98, datë 29.12.2022 "Për miratimin e kuotave të pranimit në programet e ciklit të tretë të studimeve, specializime afatgjata në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2022-2023, në UMT".
Vendimi nr. 23, datë 26.02.2021 "Për miratimin e shpërndarjes së kuotave të pranimit dhe tarifave të shkollimit në programet e ciklit të tretë të studimeve, specializime afatgjatë në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2020-2021, në UMT".	Vendimi Qarkullues nr. 7, datë 21.01.22 "Për një ndryshim në Vendimin nr. 100, datë 16.12.21 "Për miratimin e kuotave të pranimit në programet e ciklit të tretë të studimeve, specializime afatgjatë në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2021-2022, në UMT".	Vendim nr. 3, datë 10.02.2023 "Për miratimin e shpërndarjes së kuotave të pranimit dhe tarifave të shkollimit, në programet e ciklit të tretë të studimeve, specializimeve afatgjata, në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2022-2023, në UMT".
	Vendimi nr. 9, datë 04.02.2022 "Për miratimin e shpërndarjes së kuotave të pranimit dhe tarifave të shkollimit në programet e ciklit të tretë të studimeve, specializime afatgjatë në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2021-2022, në	Vendim Qarkullues nr. 12, 16.02.2023 "Për një ndryshim në vendimin nr. 3, datë 10.02.23 "Për miratimin e shpërndarjes së kuotave të pranimit dhe tarifave të shkollimit, në programet e ciklit të tretë të studimeve, specializimeve afatgjata,

	UMT”	<i>në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2022-2023, në UMT” .</i>
--	------	---

Kanë të drejtë të aplikojnë për programet e specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, kandidatët që:

a. Kanë përfunduar në Republikën e Shqipërisë me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse, në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave", si dhe kanë fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit në Republikën e Shqipërisë;

b. Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të integruar të ciklit të dytë "Master i Shkencave" ose ekuivalente me të, dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë institucionit përgjegjës, si dhe kanë fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit në Republikën e Shqipërisë.

Kuotat e miratuara për çdo program studimi, referuar rregullores së specializimeve afatgjata, neni 5, 6 dhe 8, i përcillen Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Brendshme (institucione të cilat kanë nevojë për specialitete), ku i kërkohet të shprehen mbi numrin e kuotave për çdo specialitet në plotësim të nevojave të këtyre institucioneve. Senati Akademik bën miratimin e shpërndarjes sipas institucioneve dhe i njofton ato.

Titullari i institucionit (Rektori) nxjerr udhëzimin “*Për procedurat e pranimit dhe regjistrimit në programet e specializimeve afatgjata...*”, i cili është i bërë publik në faqen zyrtare të UMT, si dhe i përcillet njërive kryesore të UMT-së, ministrive përkatëse dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA). QSHA si autoritet në varësi të MAS, kryen dhe zbaton procedurat për zhvillimin e provimeve të specializimit, përmes teknologjise digjitale.

Kandidatët aplikojnë pranë njërive kryesore që ofrojnë programe specializuese afatgjatë në fushën e mjekësisë, në UMT, në përputhje me kriteret, dokumentacionin dhe afatet e përcaktuar në Rregulloren e Specializimeve, Udhëzimin e Rektorit, si dhe Vendimin e Senatit Akademik për miratimin e shpërndarjes së kuotave për çdo program specializimi.

Kandidatët të cilët plotësojnë kriteret kualifikohen për procesin e përzgjedhjes së programeve. Renditja e kandidatëve bëhet bazuar në pikëzimin e secilit kandidat përkatësisht: Pikët bazuar në notën mesatare të ponderuar, dhe Pikët nga rezultatet e testit të informatizuar.

Njësia kryesore publikon listën paraprake përmbledhëse të kandidatëve me rezultatet kumulative të testimit të informatizuar dhe notës mesatare, duke renditur kandidatët sipas pikëve në rend zbritës (*pikët minimale që duhet të ketë një kandidat për të patur të drejtën e përzgjedhjes së një programi është ≥ 380 pikë*) Kjo listë merr formën përfundimtare pas përfundimit të procesit të ankimimit të kandidatëve. Përzgjedhja e programit të specializimit afatgjatë nga kandidatët, sipas rendit zbritës të pikëve në listën përfundimtare, të ndërtuar në bazë të pikëve të fituara nga çdo kandidat, bazuar në sistemin merite preferencë, në prani të Komisionit të Vlerësimit, dhe MSA e MSHMS, të cilët kanë rolin e vëzhguesve të procesit. (Rregullore SPA, neni 41). Regjistrimi përfundimtar i kandidatëve fitues, bëhet sipas afateve të përcaktuara në Udhëzimin e Rektorit të UMT-së. Specializantët që kanë përzgjedhur nga kuotat e mbuluara sipas ministrive, në momentin e regjistrimit paraqesin dhe kontratën midis specializantit dhe ministrisë përkatëse. Pas përfundimit të regjistrimeve, listat përfundimtare të të regjistruarve i dërgohen Ministrive përkatëse si dhe QSHA-së për pajisje me numër matrikullimi, sipas afateve të përcaktuara në Udhëzimin përkatës. Kandidati nuk mund të ndjekë njëkohësisht dy programe studimi në IAL publike dhe/ose private. QSHA pas verifikimit i kërkon UMT-së ta çregjistrojë atë.


Aktet ligjore, nënligjore dhe rregullative për procesin e pranimeve në programet e ciklit të tretë të specializimeve afatgjata, bëhen publike në faqen zyrtare web të UMT, për çdo vit akademik: <http://umed.edu.al/university-event/kerkimi-shkencor/specializimet/>

Miratimi i kuotave dhe realizimi i tyre sipas viteve akademike paraqitet sipas tabelës 11/1, sa më poshtë:

Viti akademik	2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	Miratimi i kuotave	Realizimi (%)	Miratimi i kuotave	Realizimi (%)	Miratimi i kuotave	Realizimi (%)
Kuota Total	285	66%	319	56%	325	73%
Kuota të mbuluara MSHMS	104	74%	125	59%	140	75%
Kuota MM	22	59%	0		0	
Kuota MD	9	33%	12	50%	15	67%
Kuota MB	0		0		4	75%
Kuota të lira	145	64%	179	53%	161	71%
Kuota për transferim	5	20%	3	100%	5	80%

Burimi i të dhënave: UMT

Ndërkohë trendi i realizimit të kuotave të specializimeve sipas ministrive dhe llojit të kuotave është sipas grafikut numër 11/2, sa vijon:



Burimi i të dhënave: UMT

Tabela “Planifikim dhe realizim kuota per transferim studimesh ne SPA 3 vitet e fundit”

Kuota për transferim	2020-2021			2021-2022			2022-2023		
	Të miratuara	Të realizuara	Realizimi (%)	Të miratuara	Të realizuara	Realizimi (%)	Të miratuara	Të realizuara	Realizimi (%)
Kuota transferim MSHMS	10	8	80%	10	10	100%	11*	11	100%

Burimi i të dhënave: UMT

Nga ku rezulton se miratimi dhe plotësimi i kuotave është në nivelet nga 59 -75%, me përjashtim të realizimit të kuotave për transferim, të cilat për vitet akademike 21 - 22 dhe 22 - 23 është përkatësisht 100% dhe 94%.

• **Mbi kontratat e specialistëve (kuotat e mbuluara dhe të lira).**

Titulli i Gjetjes:	Mbi kontratat e specialistëve (kuotat e mbuluara dhe të lira).
Situata:	<p><u>Mbi kuotat e mbuluara:</u> Specialisti i cili përzgjedh kuotë të mbuluara ka detyrimin që brenda 2 javëve të bëjë regjistrimin pranë fakultetit përkatës, ku duhet të paraqesë kontratën që lidh specialistin me ministrinë e cila mbulon kuotën përkatëse. Në këtë kontratë janë të parashkruara të drejtat dhe detyrimet e të dy palëve (evidencë: <i>Kontrata për ndjekjen e specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë pranë Universitetit të Mjekësisë, ndërmjet Ministrisë Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe specialistit</i>). Gjithashtu specialisti ka detyrimin e kryerjes së pagesës së tarifës së shkollimit për llogari të fakultetit përkatës (115.000 lekë, tarife e miratuar me Vendim të Bordit të Administrimit të UMT-së), si dhe ndjekjes së detyrimeve akademike të programit.</p> <p><u>Mbi kuotat e lira:</u> Specialisti i cili përzgjedh kuotë të lirë ka detyrimin e pagesës së tarifës së shkollimit për llogari të fakultetit përkatës (115.000 lekë, tarifë e miratuar me Vendim të Bordit të Administrimit të UMT-së), si dhe ndjekjes së detyrimeve akademike të programit, duke mos lidhur kontratë.</p>
Ndikimi/Efekti:	Mos përcaktimi i saktë kontratave të shërbimit me specialistët (të drejtat dhe detyrimet), mund të sjellë risk potencial në mosplotësimin e detyrimeve të përcaktuara në rregulloren përkatëse për specialistët.
Shkaku:	Moszbatimi i legjislacionit
Rëndësia:	E mesme
Kriteri	Vendim nr.824, date 24.12.2021 i KM “Për miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë”, shtojca 7, standardi II/6, kriteri 10; Statuti i UMT-së, neni 26; Rregullorja e studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë ³ , neni 6, neni 45.
Rekomandime:	UMT të marrë masa për hartimin e kontratës së shërbimit me specialistin pavarësisht llojit të kuotës.

• **Mbi mosrealizimet e kuotave të pranimit:**

Titulli i Gjetjes:	Mosrealizimi i kuotave të planifikuara
Situata:	<p>Nga të dhënat e përcjellë nga institucioni rezulton se realizimi i kuotave të planifikuara është miratuara për specializimet afatgjata është në masën 65% për tre vitet përkatësisht: 66% për vitin 2020-2021; 56% për vitin 2021-2022 dhe 73% për vitin 2022-2023.</p> <p>Referuar rregullores së specializimeve të UMT, neni 21, përcaktohet se: “Kandidati aplikon sipas formularit të aplikimit bashkëlidhur kësaj rregulloreje (shtojca nr. 2) dhe i nënshtrohet konkursit të pranimit për të testuar njohuritë në fushën përkatëse të studimit. Kriteret specifike shtesë për t'u pranuar në programin e specializimeve afatgjata janë kompetencë e UMT. Zgjedhja e programit specializues bëhet në bazë të renditjes së kandidatit sipas pikëve të përfituara (listës së meritës).</p>

³ Miratuar me Vendim nr.4, datë 28.1.2019 të Senatit Akademik të UMT-së

	<p>Në nenin 34 të Rregullores të specializimeve, përcaktohet se: “Vlerësimi i kandidatëve bëhet me sistem pikëzimi (maksimumi 1000 pikë), ku 30% e pikëve (300 pikë të konvertuara) përlllogariten bazuar në notën mesatare të ponderuar dhe 70% e pikëve (700 pikë të konvertuara nga testimi i informatizuar që zhvillohet pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore. Po në këtë nen është përcaktuar kriteri cilësor minimal nëpërmjet sistemit të pikëzimit për të patur mundësi për përzgjedhjen e programit. Konkretisht, <i>“kandidatët që kanë grumbulluar jo më pak se 380 pikë nga numri i pikëve totale të konvertuara (maksimumi 1000 pikë), kualifikohen për procesin e përzgjedhjes së programit të specializimit sipas sistemit të meritës”</i>. Kjo ka bërë skualifikimin e kandidatëve që nuk kanë arritur pragun e pikëve</p> <p>Gjithashtu në nenin 20, pika 4, është përcaktuar se <i>“Nuk mund të konkurrojnë kandidatët që janë duke kryer ose që kanë kryer një program specializimi afatgjatë”</i>, dhe ky është një tjetër kufizim që pavarësisht kalimit të pragut minimal të pikëve (380 pikë) kandidati tërhiqet në rastin kur nuk ka më kuota për programin që dëshiron.</p> <p>Janë këto kufizime që bëjnë mosrealizimin 100% të kuotave të pranimit.</p>
Ndikimi/Efekti:	Nuk sigurohen kapacitetet njerëzore profesionistë të specializuar në fushën e sektorit shëndetësor publik, si dhe nuk realizohen plotësisht të ardhurat dytësore të planifikuara për UMT nga kjo kategori. Në kontekstin e politikave të qeverisë e cila nëpërmjet ligjit 60/2023 ka përcaktuar detyrime për studentët e mjekësisë së përgjithshme për qëndrimin në vend, në plotësim të kërkesave të sektorit shëndetësor, dhe nuk mundëson mbulimin e kuotave të specializantëve për të garantuar shërbim shëndetësor të specializuar nëpërmjet specializantëve.
Shkaku:	Mos plotësim i nevojave të sektorit shëndetësor me specialistë përkatës në fushën e shëndetësisë.
Rëndësia:	E lartë
Kriteri	Ligji Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 25 pika 7, neni 38, neni 42, neni 69; Statuti i UMT-së, neni 26, neni 89, Rregullore e studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë në fushën e mjekësisë, neni 5-6; neni 38-47;
Rekomandime:	Me qëllim realizimin e plotë të kuotave të planifikuara, si dhe në kuadër të sigurimit dhe garantimit me burime njerëzore me profesionistë të specializuar në mjekësi, për kryerjen e shërbimeve të shëndetit publik në institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, të planifikohen në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë, si dhe me ministrinë e tjera vetëm kuota të mbuluara, ku të përcaktohet dhe periudha e shërbimit të diplomuarit në sistemin shëndetësor publik.
<ul style="list-style-type: none"> • Mbi kuotat e transferimeve: 	
Titulli i Gjetjes:	Mbi kuotat e transferimeve
Situata:	Nga të dhënat e marra në vendimet e Senatit Akademik, për miratimin e kuotave të pranimit për tri vitet në auditim rezultoi se UMT, ka miratuar 13 kuota për transferim nga IAL e tjera përkatësisht: 5 për vitin 2020-2021; 3

	<p>për vitin 2021-2022 dhe 5 për vitin 2022-2023. Nga 13 kuota janë realizuar 8 kuota (1; 3 dhe 4 kuota të realizuar sipas viteve).</p> <p>Në vendimet e Senatit Akademik janë miratuar dhe kuota për transferim studimesh të kërkuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale bazuar në nevojat e shërbimit shëndetësor për mjekë të specializuar. Këto kuota nuk janë përfshirë në numrin total të pranimeve të reja pasi për këto kuota aplikojnë specializantë të UMT që janë të regjistruar dhe kanë të përfunduar të paktën 1 vit akademik. Referuar Vendimeve përkatëse të Senatit Akademik janë miratuar 10 kuota për çdo vit akademik në auditim, si dhe një kuotë transferimi në vitin 2022-2023 në zbatim të Vendimit nr.50, datë 29.04.2022 të Senatit Akademik të UMT. Kuota të realizuara janë 28 nga 30 të miratuara.</p> <p>Kandidatët që aplikojnë për transferim studimesh në kuotat e MSHMS, janë specializantë të regjistruar në UMT dhe që kanë përfunduar të paktën vitin e parë. Këta specializantë (dy vitet e fundit kanë qenë më shumë se numri i kuotave) i janë nënshtruar dhe këta procesit të testimit të informatizuar dhe në bazë të listës së meritës bëhet regjistrimi i tyre.</p>
Ndikimi/Efekti:	Mosrespektimi i barazisë në përzgjedhjen e programit të studimit; Ulja e numrit të specializantëve (sipas kuotave për transferim studimesh të MShMS) të planifikuar për sektorin shëndetësor publik.
Shkaku:	Mosrregullimi në aktet e brendshme të institucionit
Rëndësia:	E lartë
Kriteri	Ligji Nr. 80/2015, <i>"Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"</i> , neni 89; Rregulloren studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë në fushën e mjekësisë neni 5, neni 59;
Rekomandime:	Kuota për transferim studimesh të propozuara nga MSHMS të planifikohen si kuota të mbuluara nga kjo ministri.

2.12 Mbi menaxhimin e projekteve kërkimore shkencore me financim krejtësisht të mbuluar nga donatorët, projektet me bashkëfinancim dhe projektet e financuara plotësisht nga fondet e Universitetit.

Nga ana e UMT, për vitet objekt auditimi janë zhvilluar projekte me financim të brendshëm dhe nga donator të huaj me sistem thesari (tek të ardhurat), të cilat në mënyrë të përmbledhur janë sipas tabelës sa më poshtë vijon:

Lloji i financimit	Vlera projektit Euro	Disbursimi nga fillimi i projektit Euro	Disbursimi nga fillimi i projektit Lekë	TVSH+kosto UMT	Lekë	Vlera e realizuar Lekë 30.06.2023	% e realizimit 30.06.2022
Me financim të brendshëm			74,510,601		74,510,601	56,406,265	
Me bankat e nivelit të dytë	208,000	159,467	18,341,600	154,352	18,495,952	8,775,289	

Burimi i të dhënave: UMT

Më hollësisht në nivel projekti kërkimor shkencor, këto projekte paraqiten në aneksin nr. 12/1 bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Nga auditimi rezulton se projektet nga ana financiare, nga burimi i financimit paraqiten:

a- Projektet me sistem thesari, akorduar në vitin 2022 (projekte kërkimore–shkencore) kod programi 09450.

Në vitin 2022 për UMT-në, nga buxheti i shtetit është akorduar grant për kërkimin shkencor (kod programi 09450) për “Projekte të përbashkëta në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit, për vitin akademik 2022-2023” në vlerën prej 10,183 mijë lekë, për dy projekte me kohëzgjatje 2 vjet:

- “Vlerësimi i protezave fikse metal qeramikë dhe total qeramikë të mbështetura mbi implante” në vlerë 9,483 mijë lekë, (projekt i FMD-së)

- “Aplikimi i Teknologjisë dixhitale në stomatologji” në vlerë 700 mijë lekë në (projekt i FMD-së)

Gjithashtu për këto dy projekte është akorduar edhe grant për blerje pajisje për projektin “Vlerësimi i protezave fikse metal qeramikë dhe total qeramikë të mbështetura mbi implante”, në shumën prej 200,000 lekë dhe “Aplikimi i Teknologjisë dixhitale në stomatologji”, në shumën 33,200,000, të cilat në dhjetor të vitit 2022 u tërhoqën për efekt të mospërdorimit brenda vitit.

- Të trashëguar nga viti 2019 është granti në vlerën prej 8,500 mijë lekë për projektin “Identifikimi i teknikës optimale intraoperatorë të kardiomioplastikës qelizore në mënyrë simulante me rivaskularizimin kirurgjikal tek zemrat humane të infarktuara nëpërmjet implantimit të qelizave staminale autologe në rrugë të ndryshme, një studim eksperimental”, projekt i Fakultetit të Mjekësisë.

Grant për kërkim shkencor (kod programi 9770),

- **Projekte me financim nga MAS (grant për kërkimin shkencor) (kod programi 9770).**

Në vitin 2022 MAS ka disbursuar shumën prej 1,013 mijë lekë, për rimbursimin e vlerës së TVSH-së së pajisjeve të blera, në kuadër të zbatimit të projekteve të huaj “Quadric” dhe “Idea”.

- **Projekte me financim nga AKKSHI (grant për kërkimin shkencor), me (kod programi 9770),**

Në vitin 2022, fondi grant për kërkimin shkencor (kod programi 9770), financuar nga AKKSHI përbëhet nga fondi grant i trashëguar nga viti i kaluar por edhe ai i disbursuar gjatë këtij viti, si më poshtë vijon:

Trashëguar nga viti 2021 grant për kërkimin shkencor, në vlerën prej 2,614 mijë lekë për dy projekte:

- “Sonda molekulare me bazë fluor për diagnostikimin e hershëm të Semundjeve Neurodegenerative nëpërmjet teknikave të rezonancës magnetike” në vlerë 614 mijë lekë.
- “Efektet afatmesme dhe afatgjata të infeksionit nga SARS-COV-2 në funksionin pulmonar tek moshat e reja post COVID-19 në Shqipëri. Determinimi i rolit të atopisë dhe sensitivizimit nga pneumoalergjenet, si tregues i mbizotërimit të inflamacionit TH2 në raport me severitetin klinik të COVID-19 në këtë popullatë” me vlerë 2.000 mijë lekë.

Akorduar gjatë vitit 2022 grant për kërkimin shkencor në vlerën prej 2,700 mijë lekë, për dy projekte:

- “Patogjenët e rinj dhe siguria transfuzionale” në vlerë 1,500 mijë lekë.(FM)
- “Krahasimi ndërmjet protezave totale të lëvizshme të konstruara me sistemin SR IVOCAP dhe sistemin tradicional” në vlerë 1,200 mijë lekë.(FMD)

b- Projekte nga donator të huaj me sistem thesari (tek të ardhurat)

- “Studimi i përgjigjes imunitare ndaj infeksionit nga virusi SARS-CoV-2 në popullatën shqiptare: Implikimet për fushatën e vaksinimit dhe planifikimin e masave për parandalimin dhe kufizimin e infeksionit COVID-19” me donator Agjensinë Universitare të Frankofonisë (AUF) disbursuar shuma me vlerë 2,399 mijë lekë.
- “Forcimi i parandalimit dhe kontrollit të Infeksioneve në godinat e kujdesit shëndetësor”, me donator UNICEF disbursuar shuma me vlerë 6,103 mijë lekë.

Nga auditimi i projekteve rezultoi:

Projekti: “Identifikimi i teknikës optimale intraoperatore të kardiomioplastikës qelizore në mënyrë simulante me rivaskularizimin kirurgjikal tek zemrat humane të infarktuara nëpërmjet implantimit të qelizave staminale autologe në rrugë të ndryshme, një studim eksperimental”. Bazuar në dokumentin e projektit për kërkim e zhvillim rezultoi se: Institucion kontraktues është UMT;

Përfitues direkt të projektit: Janë pacientët shqiptarë dhe jo vetëm që vuajnë nga sëmundjet iskemike kardiake, sidomos ai grup pacientësh të cilët si pasojë e infarktut akut të miokardit kanë humbur një pjesë të rëndësishme të funksionit të zemrës.

- **Shpallja fitues e projektit:** Në kuadër të thirrjes për PKKZH, është njoftuar UMT nga AKKSHI, (Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit), nëpërmjet shkresës nr.2179 prot., datë 05.08.2019 dhe nr.427/1, datë 01.08.2019, se ka fituar projektin “Identifikimi i teknikës optimale intraoperatore të kardiomioplastikës qelizore në mënyrë simulante me rivaskularizimin kirurgjikal tek zemrat humane të infarktuara nëpërmjet implantimit të qelizave staminale autologe në rrugë të ndryshme, një studim eksperimental”, projekt ky i propozuar nga UMT, me drejtues projektin z.E.P.

Ky projekt shtrihet në dy faza:

Burimet e financimit	Faza I, viti 2019	Faza e II, viti 2020	Vlera totale faza I + II	%
Vlera totale e projektit	19,617,500	9,120,000	28,737,500	100
Miratur nga AKKSHI	8,500,000	1,500,000	10,000,000	34.8

Financim nga UMT	1,800,000	1,500,000	3,300,000	11.5
Burime të tjera	9,317,500	6,120,000	15,437,500	53.7

Burimi i të dhënave: UMT

Ky projekt me kohëzgjatje 2019 -2020, do të kishte përfituesit direct, që janë pacientët shqiptar dhe jo vetëm që vuajnë nga sëmundje iskemike kardiake, sidomos ai grup pacientësh të cilët si pasojë e infarktut akut të miokardit kanë humbur një pjesë të rëndësishme të funksionit të zemrës. Bazuar në kontratën nr.2179/2, datë 16.09.19, të lidhur midis AKKSHI (Drejtor i Përgjithshëm M.M) dhe për përfituesin E.P (Drejtues projekti) e Rektori i UMT (A.G), si dhe planit financiar shoqërues, është përcaktuar që **fondet për fazën e parë** do të përdoren për **investime** për blerje aparaturash me qëllim zhvillimin e projektit, **pra llogaria 230 -231**. Në këtë kontratë në anekset bashkëlidhur saj (pasqyra e realizimit të financimit për vitin e parë), me nr. artikulli 231, me emërtim artikulli “Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzua”r, fonde në lekë të planifikuara nga AKKSHI janë 8,500,000 lekë.

- **Çelja e fondeve:** Nëpërmjet shkresës së MFE nr.15065/4 prot, datë 10.10.2019, me objekt “*Detajim i grantit të punës kërkimore shkencore dhe veprimtarive krijuese*”, ardhur me e-mail nga MAS, është dërguar detajimi i fondeve për kërkimin shkencor, pjesë e të cilave është edhe projekti i UMT-së, “*Identifikimi i teknikës optimale intraoperatore të kardiomioplastikës qelizore*”, me financim nga AKKSHI në vlerën 8,500,000 lekë, për vitin e parë, përcjellë pranë Fakultetit të Mjekësisë, nëpërmjet shkresës nr. 2793 prot., datë 16.10.2019, ku është kërkuar marrja e masave për plotësimin në kohë të kërkesave për projektin e miratuar.

Njoftimi për çeljen e fondeve të këtij projekti është dërguar edhe nga AKKSHI me shkresë 352, datë **21.10.19**, e prot.në UMT nr.2919 prot, datë 25.10.2019 me objekt “*Mbi kalimin e fondit të projektit “Identifikim i teknikës optimale intraoperatore të kardiomioplastikës qelizore ...”*”, me financim nga AKKSHI në vlerën 8,500,000 lekë për fazën e parë.

Sipas kësaj shkrese thuhet se: “ju vemë në dijeni se në kodin e institucionit tuaj, **në kapitullin 08**, ka kaluar fondi i projektit...”.

Nga auditimi rezulton se: Rimbursimi i financimit të këtij projekti **në llogarinë e thesarit nga AKKSHI, është bërë në llogarinë 602, “mallra e shërbime” dhe jo në llogarinë 230 -231, “Investime” sic e kërkon kontrata e lidhur.**

Meqënëse disbursimi në llogarinë e thesarit është kryer në llogarinë 602 “*Mallra dhe shërbime*” dhe jo në llogarinë “*Investime*”, nëpërmjet shkresës së Administratorit të UMT-së A.M, me nr.2179/5 datë 21.11.2019 dhe shkresës nr.2179/9 prot., datë **18.12.2019** me objekt: “*Mbi projektin “Identifikimi i teknikës optimale intraoperatore.....”*”, ku midis të tjerash citoj: “*nga kuadrimi i fondeve me Drejtorinë e Thesarit, Tiranë, rezulton se vlera 8,500,000 lekë është celur në kapitullin 08, artikulli 602 të FM, ndërkohë kur kontrata si akt administrative dhe juridik është nënshkruar midis AKKSHI dhe UMT. Administrimi i fondeve të projekteve kryhet në mënyrë të përqëndruar në Rektoratin e UMT. Gjithashtu po në këtë project rezulton se fondet e miratuara për vitin 2019, mbështetur dhe në kontratën nr 2179/2, datë 16.09.19 të lidhur midis AKKSHI dhe UMT dhe planit financiar shoqërues, do të përdoren për blerje aparaturash për zhvillimin e projektit, ndërkohë këto fonde janë detajuar në llogarinë 602 “Mallra dhe shërbime”. Sqarojmë se shuma prej 1,500,000 lekë, e detajuar për vitin 2020, e cila është e pa lëvruar është planifikuar në llogarinë 602, “Mallra dhe shërbime”.*

Në këtë shkresë kërkohet sistemimi nga AKKSHI, sa vijon:

Ent.Qev	Min. Linjës	Institucioni	Emri i Institucionit	Kap	Programi	Llog. Ekon.	TDO	Kodi Projektit	Pakësim	Shtesë
1	11	1011139	Fakulteti i Mjekësisë	8	9770	6020000	3535	91106AC	8500000	
1	11	1011139	Fakulteti i Mjekësisë	8	9770	231	3535	91106AC		8,500,000
			Totali						8,500,000	8,500,000

Burimi i të dhënave: UMT

Sistemim i cili nuk është bërë.

• **Lidhja e kontratës dhe marrja në dorëzim e paisjeve:** Pas zhvillimit të procedurës së prokurimit në UMT, është dërguar Autorizim për lidhje kontrate FM, me numër 630/32, datë 28.07.2020, e protokolluar në FM me numër **157, datë 28.07.2020**, për:

- Pajisje për terapi kardiokirurgjikale transmiokardiale me lazer TMR, 1 copë;
- Pajisje për ndarjen e qelizave staminale për seleksionimin e CDI33 1 copë.

Kontrata e lidhur midis OE fitues të procedurës “F” SHPK, dhe FM, Administratori Z.D, është lidhur me nr. 1571/1, datë 10.09.2020, me afat lëvrimi 60 ditë.

Në nenin 3, “Objekti, sasia dhe specifikimet e kontratës”, pika 3.7, është përcaktuar se: “Paisjet duhet të plotësojnë kushtet e garancisë sipas deklaratës mbi garancinë sjellë nga OE. *Garancia për paisjet e laboratorit do të jetë një vit, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin, mirëmbajtjen, shërbimin si dhe blerjen, zëvendësimin e pjesëve me difekt, me pjesë këmbimi të reja dhe origjinale, pa pagesë conform specifikimeve teknike.”*

Neni 18 “Çmimi i kontratës”, është përcaktuar: vlera 6,920,000 lekë pa TVSH dhe 8,304,000 me TVSH

- Pajisje për terapi kardiokirurgjikale transmiokardiale me lazer TMR, 1 copë, 4,020,000 lekë ;
- Pajisje për ndarjen e qelizave staminale për seleksionimin e CDI33 1 copë 2,900,000 lekë.

Për këto paisje me urdhërin nr.1571/4, datë 10.09.2020, të Administratorit Z.D, është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim përbërë nga E.P, S.B(M) dhe I.M.

Ky komision ka marrë në dorëzim mallin, me procesverbalin nr.1571/5, datë 16.10.2020.

Sipas këtij procesverbali citohet se bashkëlidhur procesverbalit janë fatura tatimore, deklarata e garancisë dhe Certifikata e instalimit, testimi dhe trainimi.

Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se:

Certifikata e instalimit, testimi dhe trajnimit, datë 16.10.2020 e subjektit “F” SHPK, e firmosur edhe nga grupi i marrjes në dorëzim, shkruan: “Unë i nënshkruari, O.S, në cilësinë e përfaqësuesit të OE “F” SHPK, **deklaroj se janë instaluar, testuar dhe është bërë trainimi i stafit përgjegjës për përdorimin e produkteve të ofertuar për prokurimin”.**

Ndërkohë në DST e procedurës përkatëse të prokurimit në lidhje me trainimin, flitet vetëm në kapacitetin teknik (pika 2.3/8) ku është përcaktuar se: 2.3/8: **Për kapacitetin teknik:** 8-Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar te pakten 2 inxhinier njëri prej tyre i diplomuar ne profilin Inxhinieri Klinike dhe tjetri **Inxhinier Elektronik\ Elektrik**, te cilët duhet të jenë përgjegjës për instalim dhe trajnim të stafit mjeksor.”.

Nuk ka asnjë të dhënë se kush do të trajnohet, sa ditë do të zgjasë ky trainim, për të cilën mban përgjegjësi Njësia e prokurimit e përbërë nga E.P, D.S dhe L.K.

Faktikisht rezulton se:

- nuk ka asnjë të dhënë nëse 2 paisjet janë instaluar pasi ato ndodhen në pavion, thuhet se nuk janë vënë në punë.
- **nuk ka asnjë dokument që të vërtetojë se kush staf është trainuar, sa ka zgjatur ky trainim.**

- vemë në dukje faktin se **procesverbali i marrjes në dorëzim, fletë hyrja e FM (nr.7, datë 16.10.2020, firmosur nga magazinieri I.M), fatura tatimore e kontraktorit (nr.460, datë 16.10.2020, e firmosur nga E.P, S. M dhe I.M) dhe certifikata e instalimit, testimi dhe trajnimit, mbajnë të njëjtën datë 16.10.2020**, ndërsa dalje i është bërë z. E.P me fletëdaljen nr.56, datë 17.11.2020. Kjo për paisjet me vlerë:

- Pajisje për terapi kardiokirurgjikale transmiokardiale me lazer TMR, 1 copë, 4,824,000 lekë ;
- Pajisje për ndarjen e qelizave staminale për seleksionimin e CDI33 1 copë 3,480,000 lekë.

Sa më sipër për marrjen në dorëzim të pajseve pa dokumentacion argumentues të plotë, mban përgjegjësi komisioni i marrjes në dorëzim E.P, S. M dhe I.M.

• **Likuidimi i kontratës dhe problematikat në likuidim:** Për këtë projekt rezulton se fondet e miratuara për vitin 2019, mbështetur në kontratën nr.2179/2 prot., datë 16.09.2019, të lidhur ndërmjet UMT-së dhe AKKSHI-së, si dhe planit financiar shoqërues, do të përdoren për blerje aparaturash për zhvillimin e projektit, ndërkohë këto fonde janë detajuar në llogarinë 602 “Mallra dhe shërbime”.

Nga ana e ish Administratorit të UMT A.M, me shkresën nr.2179/9, datë 18.12.2019, drejtuar AKKSHI dhe për dijeni MFE e MAS, kërkohet sistemimi i llogarive të fondeve për projektin sipas kapitujve e kodeve përkatëse.

MAS kthen përgjigje me shkresën nr.9290/12, datë 10.12.2019, e prot. UMT 2179/8, datë 12.12.19, ku bën me dije se rishpërndarja e fondeve sipas projekteve kreu IV, përcakton që fondet grant për punën kërkimore shkencoretë miratuara me ligjin vjetor të buxhetit në programin 09770, kapitulli 01, artikulli 604 dhe kapitullin 01, artikulli 230 -231, realizohet me Vendim të Bordit të Administrimit të AKKSHI-t dhe dërgohen zyrtarisht dhe në ministrinë përgjegjëse për financat dhe për dijeni MAS

MFE kthen përgjigje me shkresën nr. 21572, datë 04.12.2019 e prot në UMT 2179/6, datë 05.12.19, ku theson se miratimi i fondeve nga ana e MFE është bërë sipas detajimit që ka sjellë MAS, bazuar në udhëzimin e përbashkët midis MAS dhe MFE nr.20, datë 20.09.19, “Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, Ndërkohë nga AKKSHI, me shkresën nr.416, datë 05.12.2019, drejtuar Administratorit të UMT dhe për dijeni MAS, vë në dijeni se “shpërndarja e fondeve në llogaritë e institucioneve bëhet nga MAS”.

Sipas shkresës së MFE nr.15065/4, datë 10.10.2019, “Detajim i grantit të punës kërkimore shkencore dhe veprimtarive krijuese”, drejtuar Degës së Thesarit, Tiranë dhe për dijeni MAS, janë këto të dhëna:

Enti qeveritar 001; Ministria e linjës 11; Emërtimi i institucionit UMT, FM; Kapitulli 08; Programi 09770; **Llogaria ekonomike 602000**; Kodi i degës thesarit 3535; Kodi projektit 9116AC dhe Vlera 8,500,000 lekë.

Meqënëse disbursimi në llogarinë e thesarit është kryer në llogarinë 602 “Mallra dhe shërbime” dhe jo në llogarinë “Investime”, nëpërmjet shkresës së Administratorit të UMT-së nr.2179/5 datë 21.11.2019 dhe shkresës nr.2179/9 prot., datë **18.12.2019** me objekt: “Mbi projektin “Identifikimi i teknikës optimale intraoperatore.....”, i është kërkuar AKKSHI, sistemimi i llogarisë ekonomike.

Ky sistemim nuk është kryer nga AKKSHI dhe fondet e miratuara për vitin e parë paraqiten të pa realizuara pranë Degës së Thesarit, Tiranë, në vlerën 8,500,000 mijë lekë, në kodin e projektit, në llogarinë 602 “Mallra dhe shërbime”.

Nga auditimi rezulton se pajisja është blerë në vlerë totale 8,304,000 lekë, është bërë hyrje në Fakultetin e Mjeksië nëpërmjet fletë-hyrjes nr.7 datë 16.10.2020 dhe është likuiduar pranë Degës së Thesarit në datën 12.11.2020 nëpërmjet urdhër-shpenzimit nr.164, në llogarinë e të ardhurave të institucionit dhe jo në llogarinë përkatëse të projektit, pra *duke përdorur si burim financimi të ardhurat e institucionit në buxhetin e vitit 2020, ndërkohë që kjo pagesë duhet të ishte kryer në llogarinë përkatëse të projektit.*

Sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi firmosësit e urdhër shpenzimit nr.164, datë 12.11.2020, Z.D (Administratore e FM) dhe G.A (NZ i FM), të cilët nuk duhej të kalonin këtë shumë në kapitullin 6, (të ardhura), dhe nuk kanë zbatuar kontratën nr.2179/2, datë 16.09.19, të lidhur midis AKKSHI (Drejtor i Përgjithshëm M.M) dhe për përfituesin E.P (Drejtues projekti) e Rektori i UMT (A.G), si dhe planit financiar shoqërues, është përcaktuar që **fondet për fazën e parë** do të përdoren për investime për blerje aparaturash me qëllim zhvillimin e projektit, **pra llogaria 230 -231, pasi AKKSHI i ka kaluar gabim fondet (sqsuar më lart).**

Me shkresën nr.528/5, datë 14.06.2021, drejtuesi i ri i projektit është vendosur A.D.

Nga ana e Drejtuesit të ri të projektit është kërkuar marrja e masave për blerjen e regjentëve nga fondet e mbetura të financuara nga AKKSHI, sipas listës përkatëse, kjo me shkresat e protokolluara në UMT me numër 1950/13, datë 14.02.22, 1950/14, datë 14.02.22

Me shkresën nr.1683, datë **07.06.2022** të UMT, Drejtoria Ekonomike, firmosur nga Administratori i UMT S.S, dhe e protokolluar në FM me nr.1179, datë 08.06.2022 (**që nga data 16.10.2020**), **pra 19 muaj mbas marrjes në dorëzim të paisjeve dhe likuidimin e tyre**, kërkohet sa vijon:

“Mbështetur në kontratën nr.2179/2, datë 16.09.19 të lidhur midis UMT dhe AKKSHI, si dhe planit financiar shoqërues, lutemi informimin mbi ecurinë e këtij projekti, fazën aktuale të zhvillimit dhe problematika të cilat mund të jenë hasur në finalizimin në kohë dhe në zbatim të kontratës”.

Si rezultat i moskthimit përgjigje nga FM, është ridërguar kërkesa drejtuar Dekanit të FM, X.D, me nr.1683/1, datë 19.07.22, prot FM 1179/1, datë 20.07.2022.

Nga FM, Administrator A.B, është kthyer përgjigje me: shkresën nr.1179/2, datë 22.07.22, ku vë në dijeni për situatën pra që likuidimi është bërë nga të ardhurat e FM, pasi fondet e AKKSHI janë celuar në llogari të gabuar.

Nga ana e Administratorit të UMT, S.S, me shkresën nr.1683, datë 11.10.22, drejtuar Administratorit të FM, A.B, dhe për dijeni dekanit të FM, X.D, sipas së cilës kërkohet:

- Kthimi i fondeve prej 8,500,000 lekë në buxhetin e shtetit (financim i AKKSHI)
- Informim mbi ecurinë e procedurave financiare të ndjekura;
- Arsyet se pse ky projekt nuk është realizuar;
- Përgjegjësitë administrative konkrete.

Nga FM, Administrator A.B, është kthyer përgjigje me shkresën nr. 1179/4, datë 12.12.2022, informon se:

- Është likuiduar shuma 8,304,000 lekë me urdhër shpenzimit nr.164, datë 12.11.2020 nga llogaria investime duke përdorur të ardhurat e FM dhe jo nga llogaria e projektit, pra është realizuar sipas planit financiar si projekt;
- Është kompetencë e UMT të bëjë sistemimin e llogarisë bazuar në aktet e UMT, Vendim nr.16, datë 25.02.2020, “Për miratimin e rregullores së brendëshme të ndryshuar, “për administrimin financiar, kontabilitetin dhe kontrollin në UMT”, neni 49, “Rishpërndarja (rishikimi)”.

Në vijim të komunikimeve shkresore që kanë pasur me njëri-tjetrin, FM-UMT, FM ka qenë në pritje të sistemimit të fondit të të ardhurave të **Fakultetit të Mjekësisë, Tiranë, fonde** të cilat janë përdorur për realizimin e këtij projekti, **si kompetencë e UMT-së, pasi disbursimi i financimit të këtij projekti në llogarinë e thesarit nga AKKSHI-ja është bërë në llogarinë 602 “Mallra dhe shërbime” dhe jo në llogarinë 230-231, “Investime” dhe FM nuk ka asnjë akses ligjor për të sistemuar këtë situatë financiare të ndodhur, kjo për faktin se kjo situatë është e mbartuar që prej viti 2020.**

Nga auditimi i bazës ligjore mbi të cilën vepron UMT, rezulton se ky sistemim është detyrë e Rektoratit, kjo bazuar në:

➤ kontratën e lidhur nr.2179/2, datë 16.09.19, të lidhur midis AKKSHI (Drejtor i Përgjithshëm M.M) dhe për përfituesin E.P (Drejtues projekti) e Rektori i UMT (A.G), nenet:

- **neni 6, “Detyrimet e përfituesit”**, ku është përcaktuar se:

“Përfituesi detyrohet:

1- **të kryejë aktivitetet e përshkruara** në Formularin e Projekt Propozimit të Plotë.

2- **të shpenzojë fondet sipas buxhetit të miratuar**, të paraqitur në Formularin e Projekt Propozimit të plotë”.

- **neni 13, “Ndryshimet e kontratës”**, ku është përcaktuar:

“ Çdo ndryshim tjetër në këtë kontratë mund të bëhet vetëm nëpërmjet një akti shtesë”.

- **Neni 16, “Sanksionet”**, ku është përcaktuar se: “Në rast se fondet e financuara me anë të këtij granti, nuk janë shpenzuar sipas zërave të buxhetit të miratuar në project propozimin e plotë, shuma e shpenzuar jo në përputhje me zërat e buxhetit do ti kthehet AKKSHI-t”;

- **Neni 17, “Zgjidhja e konflikteve”**, ku është përcaktuar se: “në rastet e mosmarrveshjeve midis palëve, ato do të kenë 30 ditë afat për zgjidhjen me mirkuptim të konfliktit. Nëqoftëse brenda kësaj periudhë nuk arrijnë në një marrveshje palët i drejtohen gjykatës”.

Etj.

➤ Si dhe bazuar në **Vendimin e Bordit të Administrimit nr.659/5, datë 03.03.2020**, Vendim nr.16, datë 25.02.2020, “Për miratimin e rregullores së brendëshme të ndryshuar, “për administrimin financiar, kontabilitetin dhe kontrollin në UMT”, **neni 49**, “Rishpërndarja (rishikimi)”, **pika 2/a**, ku është përcaktuar se: “2- kërkesa shqyrtohet nga struktura drejtuese për buxhetin dhe financat në UMT, e cila përpilon relacionin përkatës për Administratorin dhe përgatit vendimin, sipas të cilit: a- për fondet buxhetore, UMT-ja i drejtohet Bordit të Administrimit dhe më tej ministrisë përgjegjëse për arsimin”.

Sa më sipër për mos veprim bazuar në kontratën e lidhur dhe vendimin e Bordit të Administrimit, ngarkohet me përgjegjësi Administratori i UMT, S.S.

Raporti financiar mbi këtë projekt për vitin e parë të realizimit të tij, është bërë nga ish drejtuesi i projektit, z. E.P, por për arsye të zhvillimeve nuk është dorëzuar. Pas kësaj datë janë administruar disa kërkesa nga AKKSHI për dërgimin e raportit financiar, pasi pa u dorëzuar raport financiar i firmosur nga të gjithë personat përgjegjës, projekti do të konsiderohej i porealizuar nga AKKSHI dhe si rrjedhojë Universiteti duhej të kthente fondet.

Për këtë arsye janë bërë disa kërkesa dhe takime për zgjatjen e afatit dhe zëvendësimin e drejtuesit të projektit.

Në momentin që AKKSHI, ka miratuar zgjatjen e afatit dhe drejtuesin e ri të projektit, problematikë **për zhvillimin e mëtejshëm ka qenë mungesa e lëndës së shintigrafisë**, mungesë e cila ka bërë të pamundur fillimin e procedurave të prokurimit në UMT për blerjen e materialeve të nevojshme për realizimin e projektit, fakt i cili flet për mosplanifikim të saktë të projektit që në fazat e para të tij.

AKKSHI me shkresën nr. 901 prot., datë 21.09.2021 “Mbi projektin e financuar në kuadër të *PKKZH 2019*” informon se për shkak të këtyre problematikave **ndërpret marrëdhëniet kontraktuale më UMT për këtë projekt dhe në vijim është kërkuar kthimi i fondit prej 8,500,000 lekë në buxhetin e shtetit, ndërkohë që veprimi i vetëm që duhej të kryhej ishte sistemimi i fondeve nga llogaria ekonomike 602 në llogarinë 231:**

Ent.Qev	Min. Linjës	Institucioni	Emri i Institucionit	Kap	Programi	Llog. Ekon.	TDO	Kodi Projektit	Pakësim	Shtesë
1	11	1011139	Fakulteti i Mjekësisë	8	9770	6020000	3535	91106AC	8500000	
1	11	1011139	Fakulteti i Mjekësisë	8	9770	231	3535	91106AC		8,500,000
			Totali						8,500,000	8,500,000

Nga auditimi rezulton se për këtë projekt vetëm sa janë blerë paisjet në shumën 8,3 milion lekë që në datë 16.10.2020 dhe deri në mbajtjen e aktkonstatimit, paisjet nuk janë vënë në punë, për një periudhë 3 vjet, duke kaluar të gjitha afatet e garancive dhe mirmbajtjes. Gjithashtu nuk është vazhduar me procedurat e tjera për shpenzimet për mallra që duhen për vënien në punë të këtyre paisjeve, duke sjellë **mosefektivitet në përdorimin e fondeve në shumën 8,304,000 lekë.**

Kjo në një kohë që projekti me kohëzgjatje 2019 -2020, do të kishte përfituesit direct, që janë pacientët shqiptar dhe jo vetëm që vuajnë nga sëmundje iskemike kardiake, sidomos ai grup pacientësh të cilët si pasojë e infarktut akut të miokardit kanë humbur një pjesë të rëndësishme të funksionit të zemrës.

Titulli i Gjetjes: Mungesa e një sistemi kontabël të informatizuar.

Situata:

Nga auditimi i projektit: “Identifikimi i teknikës optimale intraoperatore të kardiomioplastikës qelizore në mënyrë simulante me rivaskularizimin kirurgjikal tek zemrat humane të infarktuara nëpërmjet implantimit të qelizave staminale autologe në rrugë të ndryshme, një studim eksperimental”, rezultoi se:

Për këtë projekt fondet e miratuara për vitin 2019, janë mbështetur në kontratën nr.2179/2 prot., datë 16.09.2019, të lidhur ndërmjet UMT-së dhe AKKSHI-së, si dhe planit financiar shoqërues, dhe do të përdoren për blerje aparaturash për zhvillimin e projektit, ndërkohë këto fonde janë detajuar në llogarinë 602 “Mallra dhe shërbime” nga AKKSHI dhe jo sipas kontratës së lidhur në llogarinë investime.

Nga auditimi rezulton se pajisja është blerë në vlerë totale 8,304,000 lekë, është bërë hyrje në Fakultetin e Mjekësisë nëpërmjet fletë-hyrjes nr.7 datë 16.10.2020 dhe është likuaduar pranë Degës së Thesarit në datën 12.11.2020 nëpërmjet urdhër-shpenzimit nr.164, në llogarinë e të ardhurave të institucionit dhe jo në llogarinë përkatëse të projektit, pra **duke përdorur si burim financimi të ardhurat e institucionit në buxhetin e vitit 2020, ndërkohë që kjo pagesë duhet të ishte kryer në llogarinë përkatëse të projektit.**

	<p>Për këtë projekt vetëm sa janë blerë paisjet, në shumën 8,3 milion lekë që në datë 16.10.2020 dhe deri në përfundimin e auditimit në terren, paisjet nuk janë vënë në punë, për një periudhë 3 vjet, duke kaluar të gjitha afatet e garancive dhe mirmbajtjes. Gjithashtu nuk është vazhduar me procedurat e tjera për shpenzimet për mallra që duhen për vënien në punë të tyre, duke sjellë mosefektivitet në përdorimin e fondeve në shumën 8,304,000 lekë.</p> <p>Kjo në një kohë që projekti me kohëzgjatje 2019 -2020, do të kishte përfituesit direkt, që janë pacientët shqiptar dhe jo vetëm që vuajnë nga sëmundje iskemike kardiake, sidomos ai grup pacientësh të cilët si pasojë e infarktit akut të miokardit kanë humbur një pjesë të rëndësishme të funksionit të zemrës.</p> <p>Nga auditimi i bazës ligjore mbi të cilën vepron UMT, rezulton se ky sistemimi i fondeve është detyrë e Rektoratit, kjo bazuar në: kontratën e lidhur nr.2179/2, datë 16.09.19, të lidhur midis AKKSHI dhe për përfituesin Drejtuesi projektit e Rektori i UMT, nenet: 6, “Detyrimet e përfituesit”, neni 13, “Ndryshimet e kontratës”, Neni 16, “Sanksionet”, Neni 17, “Zgjidhja e konflikteve”, si dhe bazuar në Vendimin e Bordit të Administrimit nr.659/5, datë 03.03.2020, Vendim nr.16, datë 25.02.2020, “Për miratimin e rregullores së brendëshme të ndryshuar, “për administrimin financiar, kontabilitetin dhe kontrollin në UMT”, neni 49, “,Rishpërndarja (rishikimi)””, pika 2/a.</p> <p>Nga mosveprimet e Rektoratit të UMT, nga ana e AKKSHI është kërkuar rikthimi i fondeve në llogarinë e saj, duke ndërprerë projektin.</p> <p>Në marrjen në dorëzim rezultoi se: Certifikata e instalimit, testimi dhe trajnimit, datë 16.10.2020 e subjektit “F” SHPK, e firmosur edhe nga grupi i marrjes në dorëzim, shkruan: “Unë i nënshkruari, O.S, në cilësinë e përfaqësuesit të OE “F” SHPK, deklaroj se janë instaluar, testuar dhe është bërë trajnimi i stafit përgjegjës për përdorimin e produkteve të ofertuar për prokurimin”.</p> <p>Ndërkohë në DST e procedurës përkatëse të prokurimit në lidhje me trajnimin, flitet vetëm në kapacitetin teknik (pika 2.3/8) ku është përcaktuar se: Për kapacitetin teknik: 8-Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën 2 inxhinier njëri prej tyre i diplomuar në profilin Inxhinieri Klinike dhe tjetri Inxhinier Elektronik\ Elektrik, të cilët duhet të jenë përgjegjës për instalim dhe trajnim të stafit mjekësor”.</p> <p>Nuk ka asnjë të dhënë se kush do të trajnohet, sa ditë do të zgjasë ky trajnim.</p> <p>Faktikisht rezulton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - nuk ka asnjë të dhënë nëse 2 pajisjet janë instaluar pasi ato ndodhen në pavijon, thuhet se nuk janë vënë në punë, në gjendjen sipas fotos sa vijon: - vemë në dukje faktin se procesverbali i marrjes në dorëzim, fletë hyrja e FM (nr.7, datë 16.10.2020,), fatura tatimore e kontraktorit (nr.460, datë 16.10.2020,) dhe certifikata e instalimit, testimi dhe trajnimit, mbajnë të njëjtën datë 16.10.2020.
Ndikimi/Efekti:	mosefektivitet në përdorimin e fondeve në shumën 8,304,000 lekë.
Shkaku:	Moszbatim i kontratës së lidhur
Rëndësia:	E lartë

Kriteri	Kontrata e lidhur mes, palëve UMF nr.30 dhe aktet nënligjore të LPP.
Rekomandime:	Nga ana e UMT të analizohet situata e krijuar, të nxirren përgjegjësitë si dhe të merren masa të menjëhershme për vënien në funksion të paisjeve mjekësore.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur komenti me shkresë nr. 1421/29, datë 30.11.2023, e protokolluar në KLSH me nr. 401/16, datë 01.12.2023, “Sqarime”, nga **Administratori M.J.**

Pretendimi i subjektit: Vlerësimi i rekomandimit pasi AKKSHI ka ndërprerë mardhëniet kontraktuale dhe ka kërkuar kthimin e fondeve.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Komenti juaj merret në konsideratë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur komenti me shkresë nr. 1421/18, datë 21.11.23, e protokolluar në KLSH me nr. 401/16, datë 01.12.2023, “Komente mbi Projekt Raportin”, nga **S.S.**

Pretendimi i subjektit: Në Projekt Raport nuk relatohet fakti se S.Sh. ka ushtruar detyrën 02.03.22 deri 02.06.23, si dhe listohen shkresat e bëra për këtë problem nga ana e saj.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Ju sqarojmë se: të gjitha qëndrimët e grupit të auditimit janë të njëta me Projekt Raportin e Auditimit..

Gjithashtu ju sqarojmë se edhe në lidhje me komentet e bëra nga ana e juaj në lidhje me:

- Akt konstatimin nr.8, në lidhje me nënshkrimin e kontratave, akt konstatimin nr.9, qëndrimi i grupit të auditimit është i njëjtë me atë të projekt raportit të auditimit, për arsye se ju në komentet e paraqitura në këtë fazë nuk keni paraqitur prova dhe fakte të reja.

2.13 Mbi administrimin e pronës shtetërore.

Nga ana e strukturave drejtuese të UMT, për periudhën objekt auditimi, janë kryer këto veprime sipas institucioneve përgjegjëse, si më poshtë vijon:

-Me VKM nr. 834, datë 13.12.2006, është miratuar lista e pjesëshme e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të Bashkisë Tiranë. Lista ka 14 godina për të cilat, përgjegjësi administrative ka Universiteti i Tiranës por janë në përdorim nga Universiteti i Mjekësisë. Objektet në përdorim të Universitetit të Mjekësisë, janë: Godina e Rektoratit me numër zone kadastrale 8120 J-14 dhe numër pasurie 10/126; Godina e Farmacisë dhe Shëndetit Publik, me numër zone kadastrale 8130 J-14 dhe numër pasurie 10/119; Godina e Anatomisë Normale, me numër zone kadastrale 8130 K-14 dhe numër pasurie 1/216; Godina e Paraklinikut, me numër zone kadastrale 8130 K-14 dhe numër pasurie 1/207; Salla Galileo, me numër zone kadastrale 8130 K-15 dhe numër pasurie 1/302; Salla e Maternitetit Gliozheni, me numër zone kadastrale 8130 IK-14 dhe numër pasurie 1/77; Salla e Infektivit, me numër zone kadastrale 8130 IK-14 dhe numër pasurie 1/430; Salla e Kirurgjisë/Mjeku Familjes, me numër zone kadastrale 8130 IK-14 dhe numër pasurie 1/223; Salla e Terapisë, me numër zone kadastrale 8130 IK-14 dhe numër pasurie 1/279; Salla e Maternitetit Geraldinë, me numër zone kadastrale 8360 M-11 dhe numër pasurie 1/77; Palestra e Universitetit të Mjekësisë, me numër zone kadastrale 8370 L-13 dhe numër pasurie 3/73; Godina e Dekanatit, me numër zone kadastrale 8130 K-14 dhe numër pasurie 1/296; Godina e re e Fakultetit të Shkencave Mjekësore dhe Teknike, me numër zone kadastrale 8130 K-14 dhe numër pasurie 1/256; Godina e FMD , me numër zone kadastrale 8130 K-14 dhe numër pasurie 1/292.

-Me shkresën nr. 1750 Prot., datë 19.06.2019, Administratori i UMT-së, i kërkon Agjencisë së Kadastrës Shqiptare, Drejtorisë Vendore, Tirana Veri, informacion për gjendjen juridike të disa pasurive në përdorim të UMT-së. Përgjigjia nga Drejtoria Vendore Tirana Veri, ka ardhur me shkresën nr. 1750/3 Prot., datë 11.07.2019.

-Me shkresën nr. 1884 Prot., datë 01.07.2019, Administratori i UMT-së, përcakton komisionin e inventarizimit të ndërtesave dhe ambienteve në përdorim të Universitetit të Mjekësisë.

-Me shkresën 1537/1 prot., datë 22.07.2019, Sektori i Qëndrave Historike pranë Ministrisë së Kulturës, i dërgon UMT-së, informacion lidhur me statusin juridik të Godinës së Rektoratit dhe cilëson se kjo Godinë, është monument kulture i kategorisë II.

-Me shkresën nr. 1921 Prot., datë 30.06.2022, Administratori i UMT-së, i kërkon Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, realizimin e shërbimit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme që Universiteti i Mjekësisë Tiranë, ka në administrim. Në këtë kërkesë, në mënyrë të përmbledhur, cilësohet: “.... Në lidhje me objektet që administrohen nga UMT, në mbështetje të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 për “Pronat e paluajtshme të shtetit”, ka dalë VKM-ja nr. 834, datë 13.12.2006 “Për miratimin e listës së pjesëshme të inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në bashkinë Tiranë të Qarkut të Tiranës. Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 48, datë 23.01.2013 “Për krijimin e Universitetit të Mjekësisë Tiranë, u krijua UMT si institucion publik i arsimit të lartë. Në VKM nr. 48, datë 23.01.2013, kreu V, pika 3, thuhet se: “UMT-së i kalojnë të gjitha asetet e luajtshme dhe të paluajtshme që zotërojnë dhe disponojnë FM dhe Fakulteti i Infermierisë të Universitetit të Tiranës”.

-Me shkresën nr. 1921/2 Prot., datë 06.09.2022, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, i sqaron UMT-së, procedurat që duhen ndjekur për realizimin e procesit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme në administrim të Universitetit të Mjekësisë.

-Me shkresën nr. 1300/2 Prot., datë 20.06.2023, Administratori i UMT-së, i dërgon Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, dokumentacionin e nevojshëm për vazhdimin e procedurave për regjistrimin e pronave që UMT ka në administrim.

-Nga auditimi konstatohet se janë dërguar akte administrative shkresore nga UMT-ja drejtë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe anasjelltas, por pa finalizuar këtë proces me miratimin e listës së pronave dhe procedimin për regjistrimin e tyre pranë ZVRPP. Konstatohet se ka mosveprim nga ana e strukturave përgjegjëse pranë dy institucioneve respektive të ngarkuara nga ligji. Sa më sipër, në kushtet që nga ana e UMT-së, nuk janë regjistruar pronësia dhe kufijtë e pasurive të paluajtshme si dhe nuk janë dokumentuar aktet e fitimit të pronësisë për çdo rast, është vepruar në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 *“Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”*, i ndryshuar si dhe kërkesat e ligjit nr. 33/2010 *“Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”*, nenit 2, pika 10, që përcakton se: *“Pasuri e paluajtshme”* është toka, burimet ujore, ndërtesat, objektet dhe çdo gjë tjetër e paluajtshme, sipas përcaktimit të Kodit Civil. Nenit 24, *“Regjistrimi fillestar”*, *“Regjistrimi fillestar i çdo pasurie të paluajtshme përfshin pasqyrimin e saj në hartën kadastrale dhe përgatitjen e një karteje, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me dispozitat e çdo akti, që përcakton pronësinë ose të drejta të tjera reale që ekzistojnë për pasuritë e paluajtshme”*. Nenit 45/1, *“Regjistrimi i kalimit të pronësisë me anë të ligjit, me vendim të gjykatës apo të një akti administrativ, në rastet kur shteti, personi juridik/fizik ka fituar të drejtën e pronësisë mbi një pasuri të paluajtshme, me anë të ligjit, vendimit gjyqësor të formës së prerë për fitimin apo kalimin e së drejtës së pronësisë apo të aktit të një organi administrativ, regjistruesi, mbështetur në këto akte të paraqitura nga personi i interesuar, bën regjistrimin, duke shënuar pronar shtetin, personin juridik/fizik, të cilit i ka kaluar e drejta e pronësisë”*. Nenit 46/1, *“Regjistrimi i lejes së ndërtimit”*, *“Leja e ndërtimit dhe/ose leja e zhvillimit, e lëshuar nga autoriteti përgjegjës, përcillet për regjistrim nga organet e pushtetit vendor në zyrën përkatëse vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Regjistruesi bën regjistrimin e lejes së ndërtimit në një regjistër të veçantë, të ndryshëm nga ai ku është kryer regjistrimi i truallit, por duke kryer lidhjen me truallin, i cili përbën sheshin e ndërtimit, për të cilin është lëshuar leja e ndërtimit”*.

Titulli Gjetjes:	Mos regjistrimi i pronësisë dhe i kufijve të pasurive të paluajtshme duke mos dokumentuar për çdo rast, aktet e fitimit të pronës nga Universiteti i Mjekësisë Tiranë.
Situata:	Nga auditimi konstatohet se janë dërguar akte administrative shkresore nga UMT-ja drejtë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe anasjelltas, por pa finalizuar këtë proces me miratimin e listës së pronave dhe procedimin për regjistrimin e tyre pranë ZVRPP. Konstatohet se ka mosveprim nga ana e strukturave përgjegjëse pranë dy institucioneve respektive të ngarkuara nga ligji. Sa më sipër, në kushtet që nga ana e UMT-së, nuk janë regjistruar pronësia dhe kufijtë e pasurive të paluajtshme si dhe nuk janë dokumentuar aktet e fitimit të pronësisë për çdo rast, është vepruar në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 <i>“Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”</i> , i ndryshuar, ligjit nr. 33/2010 <i>“Për regjistrimin e pasurive të</i>

	paluajtshme”, nenit 2, pika 10, nenit 24 të Kodit Civil “Regjistrimi fillestar” si dhe në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe me dispozitat e çdo akti që përcakton pronësinë ose të drejta të tjera reale që ekzistojnë për pasuritë e paluajtshme, si nenit 45/1 dhe nenit 46/1.
Kriteri:	Ligji nr.8743, datë 22.02.2001 “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, i ndryshuar. Ligji nr. 33/2010 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”. VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar. Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3 “Liria akademike dhe autonomia e institucioneve të arsimit të lartë”, gërma (d).
Ndikimi/Efekti:	Mos regjistrimi i godinave në administrim të UMT dhe rezultati financiar.
Shkaku:	Mos veprim nga ana e strukturave përgjegjëse pranë dy institucioneve respektive të ngarkuara nga ligji.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandim:	Administratori i Universitetit të Mjekësisë Tiranë, të marrë masat për të ngritur një grup pune, me qëllim pasqyrimin e dinamikës dhe lëvizjet e objekteve respektive në administrim të Universitetit, të ndërtojë gjurmën e auditimit për mënyrën e sigurimit të këtyre pasurive, duke saktësuar origjinën dhe administruar dokumentacionin e nevojshëm, në bashkëpunim dhe me MAS, dhe pas saktësimin të listës përfundimtare, duke reflektuar efektet e vendimeve të Këshillit të Ministrave për transferimin e pronave që ky Universitet ka administruar, të ndërmerren veprimet e nevojshme ligjore me qëllim pasqyrimin e situatës së duhur në pasqyrat financiare të institucionit.
Rekomandim:	Nga Universiteti i Mjekësisë Tiranë, të riaplikohet pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, për vazhdimin e procedurave për regjistrimin e pronave që UMT ka në administrim, pasi të jenë kryer korrigjimet e duhura duke rakorduar gjendjen e këtyre pasurive me listen analitike të aktiveve, në pasqyrat financiare të vitit 2023.

2.14 Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen dhe zbatimin e kontratave deri në marrjen në dorëzim.

- **Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.**

Nga auditimi ka rezultuar se, është hartuar regjistri i parashikimeve dhe i realizimit për vitet objekt auditimi.

Mbas miratimit në sistem të regjistrit nga APP, janë dërguar në Degën e Thesarit, regjistri i parashikimit të prokurimeve për vitet objekt auditimi. Gjithashtu në të gjitha rastet e shtesave dhe pakësimeve është dërguar regjistri përkatës.

Dërgimi i regjistrit të parashikimeve në APP, është bërë brenda afateve të përcaktuara në VKM nr. 914, neni 4 dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar.

- **Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit).**

Për auditimin e kësaj nën çështjeje u verifikuan: Dosjet e procedurave; Përcaktimi i kriterëve të vlerësimit; Hartimi i DT; dokumentacioni ligjor dhe administrativ në SPE, lidhja e kontratave, etj.

- **Mbi administrimin e dosjeve nga NJP:** Nga Grupi i auditimit u shqyrtua i gjithë dokumentacioni i ndodhur në dosjen e prokurimit për të gjitha procedurat e audituara, nga ku rezultoi se: Në përgjithësi nga NJP, janë zbatuar të gjitha detyrat e përcaktuara, si: përgatitja e regjistrave të prokurimit; përzgjedhja e llojit të procedurës, hartimi urdhrit të prokurimit; përgatitja e DT, plotësimi i gjithë dokumenteve standarde për t’u plotësuar nga AK, ka administruar të gjitha procesverbalet e mbajtura gjatë zhvillimit të procedurës; ka respektuar afatet e procedurës, ka administruar dokumentacionin e OE fitues, ka shqyrtuar të gjitha rekomandimet e APP-së, mbi kriteret kualifikuese, sipas vërejtjeve të saj gjatë monitorimit të procedurave, etj. Nga ana e juristit të NJP janë administruar dhe inventarizuar të gjitha dosjet e prokurimit. Pjesë e dosjeve ishte i gjithë dokumentacioni i kërkuar sipas akteve ligjore, nënligjore dhe DST.

Tabela analitike “Mbi procedurat e prokurimit publik të zhvilluara nga AK, UMT dhe të audituara nga grupi i auditimit të KLSH:

Nr	Objekti I prokurimit	Procedura e prokurimit	Fondi limit	OE		Fituesi	Vlera fituese	Diferenca nga FL
				gjithsej	S'kualifikuar			
Viti 2020								
1	“Furnizim - vendosje dritare dhe dyer per Dekanatin e FM”	e hapur e thjeshtuar, mallra	3,488,289	2	1	“H ”	3,460,000	28,289
2	“Rikonstruksion i tarracës së godinës “Galileo Galilei” brenda QSU “Nene Tereza”, Tiranë”	e hapur e thjeshtuar, punë”	2,382,081	3	0	“H ”	1,645,890	736,191
Viti 2022								
3	“Vlerësimi i protezave fikse metal qeramikë të mbështetura mbi implante, për FMD Loti I +II	e hapur e thjeshtuar, mallra	164,584	1	0	“M.M” SHPK	1,887,000	14,584
			1,978,969	1	0	“M.M” SHPK	150,000	91,969

4	“Blerje pajisje stomatologjike për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”	e hapur e thjeshtuar, mallra	5,239,666.7	1	0	“F.N.A” SHPK	5,129,800	109,867
5	Rikonstruksion i sallave të Rektoratit dhe catisë së UMT	e hapur, punë”	18,059,998.7	3	2	“T” SHPK “K” SHPK, “S” SHPK	18,037,348.8	22,650
6	Furnizim vendosje kondicionerësh për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë	e hapur e thjeshtuar mallra	7,479,462.55	3	0	K TB2 SHPK	7,269,222.67	210,240
7	Blerje materiale kancelarie	e hapur e thjeshtuar mallra	1,855,430	3	0	“I.O”	1,156,166.22	699,264
8	Blerje materiale pastrimi dhe dezinfektimi për njësitë shpenzuese të UMT	e hapur e thjeshtuar mallra	2,741,523	6	5	“S”	1,960,000	781,523
9	Blerje tonera për njësitë shpenzuese të UMT	e hapur e thjeshtuar mallra	5,012,728	10	5	I.O	2,875,761	2,136,967
10	Aplikimi i teknologjisë digitale në stomatologji për FMD në UMT	e hapur mallra	695,333	2	1	“M.M” SHPK	595,000	100,333
11			21,561,001	3	2	“F.N.A” SHPK	17,920,000	3,641,001

Nga auditimi në mënyre të përgjithshme rezultoi:

1- Në këtë AK gjatë periudhës objekt auditimi **rezulton se ka 24 anulime procedurash** të cilat shkojnë deri në tre herë anulim, në vlerën **216,010,127.35 lekë** kjo sipas aneksit nr.14/1, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

2- Në përgjithësi kriteret e vecanta për kualifikim nuk janë të argumentuara dhe në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, dhe më të theksuara në procedurat e prokurimit

- “Furnizim - vendosje dritare dhe dyer per Dekanatin e FM”;
- “Rikonstruksion i tarracës së godinës “Galileo Galilei” brenda QSU “Nene Tereza”;
- “Vlerësimi i protezave fikse metal qeramikë të mbështetura mbi implante, për FMD”;
- “Blerje pajisje stomatologjike për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”;
- “Rikonstruksion i sallave të Rektoratit dhe catisë së UMT”;
- “Furnizim vendosje kondicionerësh për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”.

3- Janë konstatuar në disa raste vonesa në lidhjen e kontratës nga Fakulteti i Mjekësisë;

4- Janë konstatuar në disa raste që raporti përmbledhës mban datë përpara procesverbalit të vlerësimit të dokumentacionit të OE fitues;

5- Në 4 raste të procedurave të poshtëshënuara nga ana e UMT, janë zhvillur procedura në cilësinë si organi qëndror blerës UMT, dhe sipas nenit 53 të LPP, përgjegjësia e zhvillimit të procedurës së prokurimit që nga njoftimi i kontratës deri tek shpallja e fituesit është në kompetencë të UMT, dhe nënshkrimi i kontratës bëhet nga AK përfitues, sipas nenit 67/7 të VKM nr.285/2021. Por nga ana e Administratores së Rektoratit, S.S, për të 4 rastet është lidhur kontrata nga UMT dhe është dërguar për zbatim në fakultetet, për të cilët ka zhvilluar procedurën e prokurimit, në një kohë që fondet nuk janë në dizpozicion të UMT por të fakulteteve. Nga Rektorati, Administratorja, është lidhur kontratë pa fonde në dizpozicion.

Ky veprim është kryer nga Administratorja pavarësisht korespondencës midis Fakultetit të Mjekësisë, Rektoratit me APP.

Kjo ka sjellë moszbatim të kontratës nga disa fakultete, mosmarrje në dorëzim të mallit, apo vendosje të mallit në subjekt i cili nuk është likuiduar dhe kontraktuesit kërkojnë likuidimin e mallit, duke vendosur këto njësi shpenzuese në udhëkryq.

Sipas procedurave të zhvilluara sipas viteve objekt auditimi rezultoi:

1- Procedura e prokurimit me objekt: “Blerje të pajisjeve mjekësore laboratorit për Fakultetin e Mjekësisë, Tiranë”, me këto të dhëna:

Urdhër Prok. 175, 31.10.2019	NJHDT: – L.K, A.K, D.S		
Iloji i Procedurës “e hapur, mallra”	KVO, nr. 176, 31.10.2019 M.F Kryetare, N.H, L.D E.D, A.G Ndryshuar KVO, nr. 199, 13.11.2019 dhe urdhër nr. 216, datë 02.12.2019 (2 herë urdhër) A.G me F.Z si ekspert i jashtëm Urdhër nr. 227, datë 11.12.2019 për ndryshimin e anëtarit Znj. N.H me Znj. E.N Pas hapjes së ofertave është ndryshuar me urdhërin nr. 232, datë 18.12.2019 Znj. E.N me Z. A.R (ekspert i jashtëm Bl)		
Fondi Limit 32,285,492 lekë	OE fitues: “B.A” SHPK & “A” SHPK	Diferenca me fondin limit 9,785,792	
Burimi Vetëfinancim	Oferta fituese 22,499,700	Operatorët Ekonomikë - Pjesëmarrës në tender 5	
Data e hapjes së tenderit 11/12/2019	Ankimime: PO		
Ka patur asistencë nga APP për DST	Ankesa në KPP Nuk ka patur		
Lidhja e Kontratës Nr. 428/1 Prot., datë 13.07.2020	Vlera e kontratës 26,999,640 lekë	Afati 60 ditë pune nga nënshkrimi i kontratës	Likuiduar:
Titullari i AK A.M			

Nevojat për këtë procedurë kanë ardhur nga FM me shkresën nr. 1296/14 prot., datë 11.10.2019, protokolluar pranë UMT-së me nr. 2750 prot., datë 11.10.2019. Bashkëngjitur shkresës ka një listë materiale laboratorike të sigluara nga administratori i FM, Z.D dhe një tjetër person për të cilin nuk ka askund emër, mbiemër dhe pozicion, për të cilën mban përgjegjësi Administratori i FM Z.D.

Me urdhërin nr.163, datë 23.10.2019 “Për përlllogaritjen e fondit limit”, është ngritur grupi i punës i përbërë nga L.K, B.L dhe D.S.

Me procesverbalin nr.2892/2 Prot., datë 23.10.2019, grupi i punës ka vendosur t’i dërgojë ftesë OE të cilët kanë realizuar kontrata të ngjashme në prokurime të ngjashme 5 OE, ftesa e cila mban numrin nr.2892/4 Prot., datë 23.10.2019.

Operatorët ekonomikë të cilëve ju është dërguar ftesa për Ofertë janë: “F” SHPK i cili ka paraqitur ofertën e tij protokolluar me nr. 2892/6 Prot.; “A” SHPK; “E” SHPK ka paraqitur ofertën e tij protokolluar me nr. 2892/5 Prot.; “O.D” SHPK dhe “M” SHPK ka paraqitur ofertën e tij protokolluar me nr. 2892/7 Prot.;

Grupi i punës ka përlllogaritur fondin limit me procesverbalin nr. 2892/8 Prot., datë 31.10.2019, ku vlera e fondit limit është **32,285,492 lekë pa TVSH**.

Hartimi i DT: Nga ana e NJHDT është mbajtur procesverbali i argumentimit nr. 2892/17 Prot., datë 31.10.2019, “Procesverbal i hartimit të dokumentave të prokurimit me objekt: “Blerje të pajisjeve mjekësore laboratorit për Fakultetin e Mjekësisë, Tiranë”. Nga procesverbali i mbajtur konstatohet se mungon argumentimi i detajuar teknik i kriterëve, duke mos zbatuar përcaktimet e nenit 61 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, në të

cilin është përcaktuar se çdo kriter i vecantë dhe specifikim teknik duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal, si më poshtë:

Në DT është kërkuar: Vertetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën Janar 2019 – Shtator 2019 e shoqëruar me listepagesat (formularët E-sig 025 për keto periudha ku të ketë jo më pak se 5(pese) punonjës.

➤ Nga ku rezulton se nuk është argumentuar me objektin e prokurimit kërkesa për 5 punonjës për periudhën janar – shtator 2019.

Në DT është kërkuar: Të vërtetohet që ka të paktën 1 Inxhinier dhe 1 biolog/bioteknolog në stafin e vet të trajnuar për pajisjet mjekësore të cilat do të kryejnë trajnimet e stafit, të vërtetuara nëpërmjet diplomës, çertifikatës/çertifikatave të trajnimit, CV-së, kontratës individuale të punës.

➤ Nuk është përcaktuar çfarë inxhinieri kërkohet por thjeshtë është kërkuar 1 inxhinier duke konfuzuar operatorët ekonomikë si dhe kërkesa për biolog/bioteknolog nuk përputhet me fushën objekt prokurimi, pasi bioteknologjia është një nga nëndegët e biologjisë dhe është një shkencë që studion organizmat e gjallë.

Në DT është kërkuar: Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqes autorizim nga prodhuesi / MAH / ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin) nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë pajisjet mjekësore objekt prokurimi. Autorizimi duhet të jetë original i perkthyer ose kopje e perkthyer dhe noterizuar.

➤ Operatori ekonomik ka kërkuar autorizimin e prodhuesit, në një kohë që nuk është e nevojshme ky kriter.

Në DT është kërkuar: Ofertuesi duhet të paraqesë autodeklaratë për trajnimin e punonjësve që do të përdorin pajisjet mjekësore objekt prokurimi.

➤ Në këtë kërkesë nuk është përcaktuar asnjë e dhënë se sa punonjës që do të përdorin pajisjet mjekësore do të trainohen dhe sa ditë do të trainohen

Në DT është kërkuar: Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë çertifikatën **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, dhe nëse operatori ekonomik ofertues është prodhues i pajisjeve mjekësore duhet të paraqesë çertifikatën **SSH EN ISO 13485:2016** “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”, për tregjetim të pajisjeve mjekësore në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

➤ ISO 13485:2016 specifikon kërkesat për sistemin e menaxhimit të cilësisë që duhet të zbatohet nga organizatat që operojnë në industrinë e pajisjeve mjekësore. Ky standard specifikon kërkesat e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë për kompanitë aktive në projektimin, prodhimin, shitjen, instalimin dhe shërbimin e pajisjeve mjekësore. Ky standard:

- Vë theks të veçantë në menaxhimin e riskut dhe vendimmarrjen bazuar në risqet e përfshira në proceset që nuk kanë të bëjnë me zbatimin e produktit. Përqendrohet në rreziqet që lidhen me sigurinë dhe performancën e pajisjeve mjekësore dhe përputhshmërinë e tyre me kërkesat rregullatore.

- Kërkon që organizatat të kryejnë kontrole më të rrepta në rastet kur kanë procese të kontraktuara, duke zbatuar marrëveshje me shkrim për vlerësimin e furnitorëve të tyre në bazë të riskut. Përgjigjet ndaj kërkesave rregullatore në rritje për organizatat në të gjithë zinxhirin e furnizimit të pajisjeve mjekësore.

Ky certifikim është krijuar për të gjitha bizneset që operojnë në industrinë e pajisjeve mjekësore. Për rrjedhojë duhej të ishte kërkuar vetëm kjo lloj ISO dhe jo edhe ISO **9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, pasi nuk ka lidhje me mallrat mjekësore.

Në DT është kërkuar: Operatori ekonomik duhet të paraqesë **oferten teknike**, për pajisjet objekt, në formë tabele, ku të plotësohet: Specifikimet teknike, Emri i kompanisë prodhuese, Origjina e mallit, Emertimi i katalogut të pajisjes / produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i referencës së artikullit (kodi) nxjerrë nga katalogu i prodhuesit, si dhe certifikimet perkatëse për produktet.

➤ Kërkesa është e pa argumentuar dhe e fryrë, pasi nga NJDT janë kërkuar njëherë autorizimet dhe katalogjet.

Në lidhje me kriteret nga ana e **APP është bërë asistenca** më datë 13.11.2019 për specifikimet teknike për katër artikuj të cilat i referohen një marke specifike.

Ankimimet:

Operatori ekonomik “B.A” SHPK ka paraqitur ankesë nr. 2892/20 prot., datë 13.11.2019 lidhur me specifikimet teknike artikulli 9 dhe 13.

Operatori ekonomik “S.M” SHPK ka paraqitur ankesë nr. 2892/21 prot., datë 13.11.2019 lidhur me specifikimet teknike dhe kriterin për pikën c) Të vërtetojë që ka të paktën 1 Inxhinier dhe 1 biolog/bioteknolog në stafin e vet të trajnuar për pajisjet mjekësore i cili do të kryej trajnimet e stafit, të vërtetuar nëpërmjet diplomës, certifikatës/certifikatave së trajnimit, CV-së, kontratës individuale të punës”.

Argumentimi nga OE *“Nuk e kuptojmë përse nevojiten biologë/bioteknologë në tenderat e mjekësisë. Mesa dimë ne, biologët/bioteknologët e ushtrojnë profesionin e tyre tek kafshët dhe tek bimët ndërsa inxhinierët dhe mjektë, janë ata që merren me aparaturat mjekësore që ushtrojnë veprim tek njerëzit. Deri sot, një tender në mjekësi ku të kërkohet biolog/bioteknologë, nuk e kemi hasur gjatë 22 viteve që oeprojmë në këtë fushë. Mënyra si është përgatitur kjo procedurë prokurimi është shumë joprofesionale, ndoshta e përkthyer në Google Translate dhe me shumë gafa.*

Kërkojmë që të rishikohen specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta të kualifikimit, në mënyrë të tillë që të mos preket konkurrenca”.

Operatori ekonomik “M” SHPK ka paraqitur ankesë nr. 2892/22 prot., datë 13.11.2019 lidhur me specifikimet teknike dhe kriteret c) Të vërtetojë që ka të paktën 1 Inxhinier dhe 1 biolog/bioteknolog në stafin e vet të trajnuar për pajisjet mjekësore i cili do të kryej trajnimet e stafit, të vërtetuar nëpërmjet diplomës, certifikatës/certifikatave së trajnimit, CV-së, kontratës individuale të punës. Dhe d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë certificate CE ose deklaratë konformiteti për pajisjet e ofertuara, sipas direktivave perkatëse për MDD, në përputhje me klasifikimin e produktit.

Pezullimi i procedurës së prokurimit është bërë me urdhër nr. 202, datë 13.11.2019 dhe me urdhërin nr. 208, datë 14.11.2019 për shqyrtimin e ankesës janë ngarkuar A.B – Kryetar, F.Z – Anëtar, E.D – Anëtar.

Është mbajtur procesverbali nr. 2892/25 prot., datë 15.11.2019 për shqyrtimin e ankesave të paraqitura. Është hedhur shtojca ku janë modifikuar vetëm specifikimet teknike të disa artikujve më datë 19.11.2019. Afati i hapjes së ofertave nga data 02.12.2019 është përcaktuar data 09.12.2019. Është hequr pezullimi më datë 02.12.2019.

Për arsye se data 09.12.2019 ditë pushimi zyrtar është hedhur shtojcë më datë 06.12.2019 dhe data e hapjes është 11.12.2019 (Është pezulluar procedura me urdhër nr. 225, datë 06.12.2019 për hedhjene shtojcës dhe është hequr nga pezullimi me urdhër nr. 226, datë 06.12.2019).

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 “Për rregullat e Prokurimit Publik” sipas të cilit:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës”

ngarkohet me përgjegjësi NHJDT të përbërë nga L.K, A.K, D.S

Zhvillimi i procedurës së prokurimit: Procedura e prokurimit është hapur me procesverbalin me nr. 2892/39 prot., datë 11.12.2019. Janë paraqitur në sistem 5 oferta.

Më datë 26.12.2019 KVO ka kërkuar shtyrjen e afatit me procesverbalin nr. 2892/44 prot. pasi nuk kanë mundur verifikimin e specifitimeve teknike.

Është mbajtur procesverbali i vlerësimit nr. 95/5 prot., datë 14.01.2020.

OE	NIPTI	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
“B.A” SHPK & “A” SHPK		22,499,700	Kulifikuar anomalisht e ulët
“F” SHPK	K.....I	32,285,492	<p>Arsyet e skualifikimit përkatësisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për artikullin 1 Real Time Quantitative Thermal Block (RT - PCR) kemi kërkuar që paisja te mundesoje ndriçim uniform te termo-blokut me teknologjine e ndriçimit tunel ndërkohë paisja e ofertuar është pa teknologjine e ndriçimit tunel. - Për artikullin 13 Spektrofotometër FTIR kemi kërkuar që paisja te kete rezolucion 1,5 nm, nderkohe paisja e ofertuar është 2 nm. - Për artikullin 14 Franz Diffusion Cell kemi kërkuar që paisja te jete me tregues e kontrollues digital të shpejtësisë 200-800 rpm, nderkohe paisja e ofertuar është me shpejtesi 400-2000 rpm . - Për artikullin 15 Aparat për zbërthimin e tabletave, kemi kërkuar që paisja te jete disintegration tester, nderkohe paisja e ofertuar është dissolution tester. - Për artikullin 16 Aparat për matjen e thërmimit të tabletave, kemi kërkuar që paisja te jete friability tester, nderkohe paisja e ofertuar është disintegration tester
“O.D” SHPK	K....N	31,918,999	<p>Arsyet e skualifikimit përkatësisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për artikullin 14 Franz Diffusion Cell kemi kërkuar që paisja te jete me tregues ekontrollues digital të shpejtësisë 200-800 rpm, nderkohe paisja e ofertuar është me shpejtesi 400-2000 rpm - Për artikullin 15 Aparat për zbërthimin e tabletave kemi kërkuar që: koha 1min deri 99 orë, 59 min, 59 sec., nderkohe paisja e ofertuar është: koha nga 1s - 23h 59min 59s. - Për artikullin 16 Aparat për matjen e thërmimit të tabletave, kemi kërkuar që qartësia e matjes te jete 1 revolution, nderkohe paisja e ofertuar nuk shprehet fare sa është qartësia e matjes.
“K” SHPK	K.....IA	Pa ofertë	E pa kualifikuar

“M” SHPK	J,,,,,,,,,F	Pa ofertë	E pa kualifikuar
----------	-------------	-----------	------------------

Nga auditimi i ofertës fituese rezultoi se:

- Punëdhënësi: A SHPK, ka lidhur kontratë me punëmarrësin N.C, me nr. Personal J.K me profesion Bioteknolog Molekular dhe Industrial, sipas së cilës Punëmarrësi është i detyruar të fillojë punën më: 01/02/2018 deri me: 31/01/2020. Kjo kontratë e hedhur në sistem është pa datë dhe pa firma të sipërmarrësit dhe punëdhënësit.
- Dokument jo i rregullt.
 - Kataloget e hedhur në SPE, janë të papërkthyer dhe në fund kanë një vërtetim të njëjtë ku ndryshon vetem nr. Rep.

Veprim në kundërshtim me kriterin për kualifikim sa vijon:

“ë) Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten katalogje, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (**pjesët e katalogut që përmbajnë emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohet, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen**). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (të markuara sipas artikullit) te percaktuar ne formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetëm në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit”.

Si dhe me kriterin e përgjithshëm:

”Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, **konsiderohen si kushte për skualifikim**”.

Nga ana e KVO është mbajtur procesverbali për përlogaritjen e ofertës anomalisht të ulët nr. 95 Prot., datë 10.01.2020, ku është konstatuar se oferta e OE të BOE “B.A” SHPK & “A” SHPK është anomalisht e ulët, të cilit (BOE) i është dërguar shkresa nr. 95/2 prot., datë 10.01.2020, për sqarime lidhur me ofertën ekonomike. Po në këtë datë (10.01.2020), BOE ka paraqitur analizën e çmimeve të ofertës. **Të gjithë dokumentat justifikuese kanë qënë jo në gjuhën shqipe të papërkthyer dhe të pa noterizuara.**

Sa më sipër në kushtet kur asnjë OE nuk është i vlefshëm KVO duhej të anulonte procedurën e prokurimit, bazuar në VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 73, Mungesa e konkurrencës”.

Me veprimet e mosveprimet e KVO është shkaktuar paligjshmëri ne përdorimin e fondeve në shumën 22,499,700 lekë, për të cilën mban përgjegjësi KVO e për bërë nga M.F Kryetare, A.R, L.D, E.D, F.Z.

Lidhja e kontratës:

Autoriteti Kontraktor, UMT i ka dërguar FM autorizimin për nënshkrimin e kontratës nr. 95/12 prot., datë 10.02.2020. FM ka përcjellë kontratën e nënshkruar nr. 428/1 prot., datë 13.07.2020.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur komenti me shkresë nr. s`ka, datë 23.10.2023, (e protokolluar në KLSH me nr. 401/12, datë 02.11.2023, “Mbi observacionet e akt konstatimit nr.6” përkatësisht nga **A.K.**

Pretendimi i subjektit:

- Lihet të nënkuptohet për shkak të mungesës së qartësisë/ koherencës së akt konstatimit, lihet të nënkuptohet se unë (A.K), kam marrë pjesë në gjithë procedurën me përjashtim të KVO.

- Në lidhje me kriteret për kualifikim të paargumentuara nga ana e NJHDT.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Akt konstatimi është i qartë dhe koherent dhe emri juaj është përmendur vetëm në lidhje me DST –Kriteret.

Në lidhje me kriteret ju sqarojmë se kriteret e veçanta për kualifikim duhet të jenë të mirëargumentuara dhe në lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit. (baza ligjore është trajtuar në akt konstatimin përkatës si dhe në Projekt Raport.

Ju keni bërë komente në lidhje me akt konstatimin ndërkohë që këto komente janë pasqyruara në Projekt Rapor. Ju duhet të kishit bërë komente mbi Projekt Raportin.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur komenti me shkresë nr. 1421/19, datë 23.10.2023, (e protokolluar në KLSH me nr. 401/12, datë 02.11.2023, “Shpjegime” përkatësisht nga **F.Z e A. R.**

Pretendimi i subjektit: në lidhje me katalogët e papërkthyer , ku pretendohet se KVO ka pasur kapacitetin për t’i trajtuar me përgjegjësi këto specifikime sepse në përbërje ka patur dhe tre specialistë me eksperiencë në fushën e paisjeve mjekësore.

Qëndrimi i grupit të auditimit: është kusht i DST/ kriterëve për kualifikim përkthimi i dokumenteve pasi gjuha e ofertës është gjuha shqipe.

Viti 2021

2- Procedura e prokurimit me objekt: “**Furnizim - vendosje dritare dhe dyer për Dekanatin e FM**”, me këto të dhëna:

Urdhër Prokurimi nr. 149, datë 14.10.2021	NJHDT: – G.N, D.S, A.L	KVO , nr. 150, 14.10.2021 F.S, P.L E.D	
Lloji i Procedurës “Procedura e hapur e thjeshtuar, mallra”			
Fondi Limit 3,488,289 lekë	OE fitues: “H ”	Diferenca me fondin limit 22,829 lekë	
Burimi Financimit: Te ardhura dytesore.	Oferta fituese 3,460,000 lekë	Operatorët Ekonomike - Pjesëmarrës në tender 2 - S’kualifikuar 1	
Data e hapjes së tenderit 25/10/2021			
Ankimime: S`ka	S`ka asistence nga APP për DST	S`ka ankesë	
Lidhja e Kontratës nr.2613/1, datë 14.01.22,	Vlera e kontratës 4,152,000 lekë	Afati 21 ditë	Likuiduar
Titullari i AK B.C			

Nga auditimi rezultoi se:

➤ Në dosje mungon argumentimi i domosdoshmërisë së kryerjes së kësaj procedurë prokurimi, si dhe mungon procesverbali i përlllogaritjes së fondit limit në kundërshtim me nenin 21, “Autoriteti ose enti kontraktor”, të LPP Nr. 162/2020, pikat 1 dhe 2, ku është përcaktuar se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin nëpërputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore tënxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve tëtrajtimin të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor **ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat etij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.**

2. Autoriteti ose enti kontraktor **administron të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi deri te zbatimi i kontratës, me qëllim kontrollin e zbatimit të ligjit.**

➤ Gjithashtu preventivi nuk ka numër analize të zërave të punimeve si dhe nuk ka analiza teknike të cmimeve, veprim në kundërshtim me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre.

➤ Nisur nga fakti që objekti ku do të bëhet investimi është monument i kategorisë së II-të, në dosje nuk ka asnjë dokumentacion që të vërtetojë zbatimin e ligjit nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, nenet: 13, 21, 23.

Konkretisht preventive i DST në SPE është sa më poshtë vijon:

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr	EMERTIMI I PUNIMEVE	Njesia	Sasia
	Dekanati		
	A.Punime prishje		
1	Heqje dritare ekzistuese	m ²	55
2	Heqje dyer dhe vetrata	m ²	88
	B. Punime ndertimore		
1	Davancialemermeri per dyer dhe dritare	m ²	36
	C.Punime ndertimore		
1	F V dritare d/alumini plastike me dopioxham	m ²	55
2	F V vetrata d/alumini plastike me dopioxham, me xham e temperuar	m ²	48
3	F V dyer te brendshme druri importi, kati I	m ²	35
4	F V dyer te brendshme tamburat e te rimesuara, kati perdhe	m ²	33
5	Dyer te jashtme druri, cilesi e I, per hyrjen kryesore	copë	13.95

Nisur nga fakti që kriteret e procedurës së prokurimit janë për punë, ky preventiv nuk ka të përcaktuara analizat e cmimeve të ndërtimit pjesë e këtij preventivi, veprim në kundërshtim me ligjin 8402, “Për ndërtimin” dhe aktet e tjera nënligjore të dala në zbatim të tij.

Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga G.N, D.S dhe A.L.

Hartimi i DT. Nga ana e NJHDT është mbajtur procesverbali i argumentimit, datë 14.10.2021, “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim”. Pavarësisht se është hartuar procesverbali i argumentimit të kriterëve për kualifikim, NJHDT nuk i ka argumentuar këto kriterë në procesverbalin e hartimit dhe argumentimit të fondit limit në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 39, “Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike”, pika 4, ku është përcaktuar se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

E konkretisht nuk janë argumentuar kërkesat në lidhje me:

Në DT është kërkuar: OE pjesëmarrës duhet të ketë një punësim mesatar **jo më të vogël se 8 punonjës**, për periudhën **3 muajt e fundit nga data e hapjes së prokurimit.**

➤ **Të cilën nuk e ka argumentuar me volumin e punës** sipas zbërthimit të zërave të punimeve bazuar në VKM nr.629, datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të cmimeve të punimeve të ndërtimit”.

Në DT është kërkuar: OE duhet të ketë punonjës specialistë me kohë të plotë, të paisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga I.SH.T.I. ose nga institucione ekuivalente me të, ku nga këta të jenë të paktën:

- 1 teknik ndërtimi të mesëm
- 3 specialist punime PVC
- 3 punëtorë të thjeshtë

➤ nuk është mirëargumentuar teknikisht nevoja, bazuar në punimet konkrete që do të kryhen dhe grafikun e zbatimit për numrin i punonjesve në total dhe të specializuar si dhe makineritë e kërkuara, me volumin e punimeve, sipas zbërthimit të zërave të punimeve bazuar në VKM nr.629, datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të cmimeve të punimeve të ndërtimit”.

Në DT është kërkuar: Grafiku i Punimeve, ndërkohë që ky grafik duhet të jepet nga vetë AK, sipas **VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit public”, neni 15, “Përmbajtja e dokumenteve standarde të tenderit”, pika 3** ku është përcaktuar se:

3. *Informacioni specifik përmban informacion për kontratat e punëve, mallrave dhe shërbimeve:*

a) *Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën:*

- *projektin dhe specifikimet;*
- *preventivin e hollësishëm dhe strukturën e kostos/ mënyrën e paraqitjes së ofertës;*
- *grafikun e zbatimit;*
- *kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.*

Në DT është kërkuar: Të paraqiten analizat e cmimeve.

➤ Sa kërkuar është në kundërshtim me VKM nr. 664, datë 26.9.2012, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, ku pika 12, është ndryshuar: “9. Në fund të pikës 12, fjalët “... të llogaritura me programin e miratuar ...” zëvendësohen me “... Në rastin kur zëri i punës nuk figuron në manual, institucioni u kërkon subjekteve ofertuese të paraqesin analizën teknike, bazur në metodologjinë e përcaktuar në udhëzimin nr.2, datë 8.5.2003, të Këshillit të Ministrave, dhe të paraqitur me formatin e unifikuar. Një fotokopje të analizave të paraqitura nga subjektet ofertuese për zërin e punës, institucioni ia dërgon ministrisë, e cila e shqyrton analizën e re dhe, nëse e gjykon të drejtë, e reflekton çmimin në manualin e çmimeve të periudhës vijuese”.

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 4 dhe neni 40, pika 3, “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik sipas të cilit:

dhe 4. “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77,të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

ngarkohet me përgjegjësi NHJDT të përbërë nga G.N, D.S dhe A.L.

Zhvillimi i procedurës së prokurimit: Procedura e prokurimit është hapur me procesverbalin datë 25.10.21 dhe është vlerësuar me procesverbalin datë 27.10.21, sa më poshtë vijon:

OE	NIPTI	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
“B”	K.....V	3 486 440	<p><i>Arsyet e skualifikimit përkatësisht:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Nuk plotëson pikën 2.2.2 të kapacitetit teknik dhe financiar, shtojca 7 e Dokumentave Standarte të Tenderit, mungon raporti i auditit për vitin 2020. - Nuk plotëson pikën 2.3.2 të Kapacitetit Teknik shtojca 7 e Dokumentave Standarte të Tenderit, mungon licenca e restaurimit. - Nuk plotëson pikën 2.3.4 të Kapacitetit Teknik shtojca 7 e Dokumentave Standarte të Tenderit, specilaistët e kërkuar nuk janë vetëdeklaruar sipas shtojcës 8. - Nuk plotëson pikën 2.3.6 të Kapacitetit Teknik shtojca 7 e Dokumentave Standarte të Tenderit, mungon ISO 18001-2007. - Nuk plotëson pikën 2.3.7 të Kapacitetit Teknik shtojca 7 e Dokumentave Standarte të Tenderit, mungon Grafiku i punimeve. - Nuk plotëson pikën 2.3.8 të Kapacitetit Teknik shtojca 7 e Dokumentave Standarte të Tenderit, mungon Analiza e cmimeve.
“H ”	K.....E	3 460 000	Kualifikuar e shpallur fitues

Nga auditimi rezulton se është shpallur fitues oferta më e ulët e vlefshme.

Më datë 29.10.2021 është ngarkuar në SPE formular i njoftimit të fituesit paraprak pa respektuar pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pika 6.

Pasi dokumentacioni nga OE fitues është sjellë **pasi kanë përfunduar afatet e ankimit dhe është hartuar Raporti Përmbledhës.** Raporti Përmbledhës i cili miratohet nga Titullari i Autoritetit Kontraktor është protokolluar më datë 11.11.2021, ndërkohë dokumentacioni i operatorit është sjellë më datë 11.11.2021 dhe është verifikuar nga KVO më datë **15.11.2021**.

Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi KVO i përbërë nga F.S, P.L dhe E.D.

Publikimi i njoftimit të fituesit është bërë më datë 01.11.2021. Afati i ankimit për këtë procedurë ka qënë 7 ditë kalendarike nga publikimi i njoftimit të fituesit, ka përfunduar më datë 8.11.2021.

Bazuar në pikën 1 të nenit 85 të VKM Nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar citohet: “Autoriteti /enti kontraktor do të ftojë operatorin ekonomik të shpallur fitues, që të lidhë kontratën menjëherë pas përfundimit të afateve të ankimit ose dhënies së një vendimi përfundimtar për ankesën, por, në çdo rast, jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga kjo datë”.

Autorizimi për nënshkrimin e kontratës FM nga Rektorati UMT (që ka zhvilluar procedurën e prokurimit) i është bërë me shkresën nr. 2566/9 prot., datë 18.11.2021, ndërkohë kontrata është firmosur nga FM më datë **14.01.2022** për vlerën 3,460,000 lekë pa TVSH, ose **rreth 2 muaj më vonë.**

Marrja në dorëzim: Urdhër i Administratorit të FM nr. 2613/3, datë 14.01.21, për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të materialeve: “Furnizim - vendosje dritare dhe dyer për Dekanatin e FM”, të përbërë nga: A.L, E.L, F. H., H. B. dhe E.A.

3- Procedura e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i tarracës së godinës “Galileo Galilei” brenda QSU “Nene Tereza”, Tiranë”, me këto të dhëna:

Urdhër Prokurimi nr. 151, 14.10.2021	NJHDT: – G.N, A.L, D.S	KVO, nr. 152, 14.10.2021 F.S, P.L, E.D	
Lloji i Procedurës “e hapur e thjeshtuar, punë”			
Fondi Limit 2,382,081 lekë	OE fitues: “H”	Diferenca me fondin limit 736,191 lekë	
Burimi Financimit Te ardhura dytesore	Oferta fituese 1,645,890 lekë	Operatoret Ekonomike - Pjesëmarrës në tender 3 - S`kualifikuar 0	
Data e hapjes së tenderit 28/10/2021			
Ankimime: S`ka	S`ka asistence nga APP për DST	Përgjigje Ankesës: s`ka	
Lidhja e Kontratës nr. 2608/1, datë 14.01.22	Vlera e kontratës 1,975,068 lekë	Afati 30 ditë	Likuiduar
Titullari i AK B.C			

Kërkesa për argumentimin e kësaj procedure prokurimi ka ardhur nga FM me nr.1143/13, datë 05.10.2021, nga Administratore Z.D, së bashku me specifikimet teknike dhe relacionin tek e preventivin e punimeve.

Bashkëlidhur këtij preventivi nuk është analiza e cmimit të zërit “Depozitim material ndertimi në landfill (mbeturina)”, në kundërshtim me VKM nr.514, datë 15.8.2007, “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pikat 8 -14.

Hartimi i DT. Nga ana e NJHDT është mbajtur procesverbali i argumentimit datë 14.10.2021, “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim”. Pavarësisht se është hartuar procesverbali i argumentimit të kritereve për NJHDT nuk i ka argumentuar këto kritere, në procesverbalin e hartimit dhe argumentimit të fondit limit në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 39, “Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike”, pika 4, ku është përcaktuar se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve”. E konkretisht:

➤ **nuk është mirëargumentuar teknikisht nevoja**, bazuar në punimet konkrete që do të kryhen dhe grafikun e zbatimit për licensat, stafin inxhinierik dhe numrin i punonjesve në total dhe të specializuar si dhe makineritë e kërkuara, me volumin e punimeve, sipas zërthimit të zërave të punimeve bazuar në VKM nr.629, datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, e konkretisht kriteret:

- Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:
NP – 3 A Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godina civile dhe industriale
NS – 4 A Punime të rifiniturës dhe të lidhura me to

NS – 14 A Impiante të brëndshme elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV, etj.

- OE pjesëmarrës, për kryerjen e këtij investimi duhet të ketë një punësim mesatar jo më të vogël se **11** punonjës, për periudhën **3 muajt e fundit nga data e hapjes së prokurimit**, të vertetuar me:

- OE pjesëmarrës për kryerjen e këtij Investimi, duhet të ketë punonjës specialistë me kohë të plotë, të paisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga I.SH.T.I. ose nga institucione ekuivalente me të, ku nga këta të jenë të paktën: 1 elektrikist; 2 hidroizolues; 1 karpentiere; 2 suvatues; 2 specialist gipsi dhe 1 specialist për punime në lartësi.

- OE pjesëmarrës për kryerjen e këtij investimi, duhet të deklarojnë se disponojnë makineritë dhe mjetet e mëposhtme:

Nr	Makineritë / Mjetet	Njësi	Sasi	Gjendja Juridike
1	Kamionçinë, kapaciteti mbajtës 3.5 – 5 ton	copë	1	Pronësi ose me qera
2	Autobot uji, kapaciteti 2000 litra	copë	1	Pronësi ose me qera
3	Matrapik	copë	1	Pronësi ose me qera
4	Kompresor	copë	1	Pronësi ose me qera
5	Gjenerator 0.4 kV, me fuqi jo më pak se 10 kW	copë	1	Pronësi ose me qera
6	Depozitë uji, kapaciteti 5000 litra	copë	1	Pronësi ose me qera
7	Skela metalike	m2	800	Pronësi ose me qera
8	Panel elektrik i paisur me matës të energjisë elektrike (për matjen e konsumit të energjisë elektrike te OE)	copë	1	Pronësi ose me qera

Në DT është kërkuar: OE pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre të punësuar me kohë të plotë dhe të jenë aktualisht si Drejtues Teknik në Liçencen e shoqërisë si dhe në Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni ne fuqi për periudhën **3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së prokurimit**, 1 Inxhinier Ndërtimi. *Drejtuesit Teknik nuk duhet të jenë të dypunësuar. Kjo në zbatim të VKM. Nr. 42, datë 16.01.2008. Si rrjedhojë OE duhet të deklarojë se Drejtuesit Teknik nuk janë të dypunësuar apo të angazhuar në ndonjë veprimtari tjetër jashtë OE pjesëmarrës. A.K. rezervon të drejtën e verifikimit të Deklaratës.*

➤ **kërkesë e përcaktuar në kundërshtim** me kreun I, pika 2.1 të UKM nr.2, datë 13.05.2005, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit, ku parashikohet se për punime deri në 30 milion lekë nuk është e detyrueshme qëndrimi i drejtuesit teknik në kantier gjatë gjithë periudhës së punimeve.

Në DT është kërkuar OE pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre të punësuar, me kohë të plotë / jo të plotë: 1 ekspert MNZ, i çertifikuar, vertetuar me: leje e ekspertit M.N.Z., të vlefshme.

➤ Kjo kërkesë është e tejkualuar e LPP, pasi projektimi MNZ është tejkualuar njëherë gjatë procesit të studimit dhe projektimit, nëpërmjet hartimit të preventivit, specifikimeve teknike, projektit dhe relacionit teknik të objektit.

Në DT është kërkuar: Krahas stafit të mësipërm OE pjesëmarrës për kryerjen e këtij investimi, duhet të ketë të paktën **1 punonjës** të pajisur me Çertifikatë për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë, lëshuar nga Institucionet përkatëse”, në përputhje me klauzolat e ligjit nr. 10327, datë 18.02.2010, "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", të vërtetuar me: çertifikatë për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë, lëshuar nga Institucionet përkatëse; kontratë pune të vlefshme; diplomë; librezë pune si dhe: Të jenë në listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni ne fuqi për periudhën **3 muajt e fundit nga data e hapjes së prokurimit**

➤ Kërkesë jo në përputhje me nenin 7 dhe 38, të ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”, i ndryshuar si dhe referuar rregullave të prokurimit publik dhe legjislacionit të fushës përkatëse, kërkesa e autoritetit kontraktor që punonjësit për sigurimin teknik dhe mbrojtjen e shëndetit në punë të figurojnë në listë pagesa, ta kenë të gjithë OE pjesë e një BOE si dhe të kenë dëshmitë përkatëse, është një kërkesë e ekzagjeruar dhe aspak në përputhje me ligjin nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”, i ndryshuar.

➤ Gjithashtu NJHDT nuk ka përcaktuar se çfarë lloj diplome kërkon për këtë lloj eksperti, duke e lënë këtë kërkesë evazive.

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 39, “**Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike**”, pika 4 dhe neni 40, pika 3, “**Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave**”, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik sipas të cilit:

“3 dhe 4. “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77,të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

ngarkohet me përgjegjësi NHJDT të përbërë nga G.N, D.S dhe A.L.

Zhvillimi i procedurës së prokurimit: Procedura e prokurimit është hapur me procesverbalin datë 28.10.21 dhe është vlerësuar me procesverbalin datë 01.11.2021, sa më poshtë vijon:

OE	NIPTI	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
“2”	L.....L	1 715 187	Kualifikuar
“H”	K.....E	1 645 890	Kualifikuar
“M”	J.....Ŵ	2 101 996	Kualifikuar

Në këtë procedurë prokurimi ka fituar vlera më e ulët e vlefshme.

Në vazhdim të procedurës së prokurimit rezultoi se:

Më datë **01.11.2021** është ngarkuar në SPE formulari i njoftimit të fituesit paraparak pa respektuar pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.5.2021 “**Për miratimin e rregullave të prokurimit publik**”, i ndryshuar, **pasi dokumentacioni nga OE fitues është sjellë pasi kanë përfunduar afatet e ankimit dhe është hartuar Raporti Përmbledhës.**

Raporti Përmbledhës i cili miratohet nga Titullari i Autoritetit Kontraktor është protokolluar më datë 11.11.2021, ndërkohë dokumentacioni i operatorit është sjellë më datë 11.11.2021 dhe është verifikuar nga KVO më datë 15.11.2021.

Sa trajtuar ngarkohet me përgjegjësi KVO i përbërë nga F.S, P.L dhe E.D.

Publikimi i njoftimit të fituesit është bërë më datë 02.11.2021. Afati i ankimit për këtë procedurë ka qënë 7 ditë kalendarike nga publikimi i njoftimit të fituesit, ka përfunduar më datë 09.11.2021.

Lidhja e kontratës: Nga ana e UM me shkresën nr.2568/8, datë 18.11.2021 i është dërguar FM autorizim për nënshkrim kontrate.

FM me shkresën nr.2608/5, datë 20.01.2022, e prot në UMT 2568/9, datë 20.01.22, ka dërguar kontratën e nënshkruar dhe planin e kontratës. Kontrata numër 2608/1, datë 14.01.22.me vlerë 1,975,068 lekë, me afat 30 ditë dhe hyrje në fuqi pas nënshkrimit të kontratës me mbikqyrësin.

Viti 2022

Autoriteti Kontraktor, UMT, gjatë vitit 2022 ka zhvilluar disa procedura prokurimi në rolin e Autoritetit Kontraktor qëndror blerës, për të cilat i është deleguar e drejta për prokurim nga 3 fakultete që janë pjesë e UMT: FM, FMD dhe FSHMT. **Theksojmë se nuk ka dokument ku nga ana e këtyre njësive shpenzuese të delegohet e drejta për zhvillimin e procedurave të prokurimit**, jo vetëm për këto raste por edhe për raste të tjera të trajtuara.

Nga auditimi rezulton se këto fakultete janë njësi shpenzuese (autoritete kontraktore) më vetë, të pajisura me llogari personale për prokurimin elektronik, si **dhe fondet buxhetore për realizimin e procedurave të prokurimit menaxhohen nga ana e tyre** (likuidimet për çdo blerje malli, realizim shërbimi, kryerje pune realizohen nga vetë fakultetet).

Pas miratimit të buxhetit të vitit 2022, fakultetet kanë përcjellë regjistrat e parashikimeve për miratim nga Administratori i UMT.

Në lidhje me 4 procedura të prokurimit me objekt:

a- “Blerje materiale pastrimi dhe dezinfektimi për njësitë shpenzuese të UMT”;

b- “Furnizim vendosje kondicionerësh për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”;

c- “Prodhim dhe printim diplomash për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”;

d- “Blerje pajisje stomatologjike për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”.

rezulton se pasi është publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik njoftimi i fituesit (në përfundim të afateve të ankimit), nga ana e administratorit të mëparshëm është proceduar me nënshkrimin e kontratës për të gjitha njësitë në total (Rektorati dhe 3 fakultetet), duke cituar në kontratë fondet respektive të secilës njësi. Nga administratori i UMT është ngritur Komisioni i Marrjes në Dorëzim të Mallrave për të gjitha njësitë në total (Rektorati dhe 3 fakultetet), të ndara sipas secilës njësi.

Nga ana e Administratorit të UMT, S.S, nuk është bërë autorizim për lidhje kontrate për tre fakultetet për pjesën takuese të tyre, por kontrata për çdo procedurë (4) është lidhur nga AK, UMT, në kushtet kur fondet në dispozicion nuk janë të vetat por të tre AK të tjera, të cilët i kanë deleguar të drejtën për prokurim UMT.

Kontrata nga Administratori i UMT, është nënshkruar në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, nenet:

Neni 4 Përkufizime

9. “Fondet publike” janë:

a) çdo vlerë monetare e buxhetit të shtetit, e përcaktuar për përdorim në prokurimet publike;

b) çdo vlerë monetare e buxhetit vendor, e përcaktuar për përdorim në prokurimet publike;

c) fonde ndihme ose kredi, të dhëna nga donatorë të huaj, sipas njëmarrëveshjeje ndërkombëtare, në të cilën kërkohet zbatimi i procedurave të këtij ligji;

ç) të ardhurat nga shteti, ndërmarrjet lokale, shoqëritë tregtare dhe entet e tjera, ku shteti zotëron shumicën e aksioneve ose të kapitalit.

14. “Kontratat publike” janë kontratat me shpërblim, të lidhura me shkrim, ndërmjet një apo më shumë operatorëve ekonomikë dhe një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore, që kanë si objekt kryerjen e punimeve, furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, në përputhje me këtë ligj.

33. “Organ qendror blerës” është autoriteti ose enti kontraktor, i cili:

a) siguron për autoritetet ose entet kontraktore mallra dhe/oseshërbime;

b) përzgjedh fituesit për kontrata publike për punime, mallraose shërbime, të caktuara për autoritetet ose entet kontraktore.

Neni 21, “Autoriteti ose enti kontraktor”:

3. Kur një ose më shumë autoritete ose ente kontraktore kanë nevojë për të njëjtat mallra, punime apo shërbime, atëherë ata, nëse marrin një vendim të tillë, **mund t’ia delegojnë të drejtën e kryerjes së procedurës së prokurimit** një autoriteti ose enti tjetër kontraktor.

Neni 53, “Blerja e përqendruar”

1. Kur një ose më shumë autoritete ose ente kontraktore kanë nevojë për të njëjtat mallra, punime apo shërbime, atëherë ata, nëse marrin një vendim të tillë, mund t’i ngarkojnë njërit prej tyre detyrën e prokurimit të këtyre mallrave, punimeve apo shërbimeve në emër të të tjerëve.

2. Këshilli i Ministrave, me kërkesën e një autoriteti ose enti kontraktor ose me nismën e vet mund të ngarkojë për procedura të veçanta prokurimi një autoritet ose ent tjetër kontraktor si organ qendror blerës.

3. Autoriteti ose enti kontraktor mund t’i kërkojë organit qendror blerës të kryejë një procedurë të caktuar të përzgjedhjes së fituesit ose një sërë procedurash të tilla në emër të tij, kur blerja e përqendruar do të ishte më e leverdishme për shkak të rritjes së sasisë së kërkuar për furnizimet me mallra të ngjashme dhe kushte të ngjashme sipas tregut.

Në kryerjen e procedurave të përzgjedhjes së fituesit, organi qendror blerës zbaton dispozitat e këtij ligji”.

dhe

VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar:

- pikën 7, neni 67, “**Prokurimi i përqendruar dhe delegimi i prokurimit**”, ku përcaktohet se: “*Organi qendror blerës ose autoriteti kontraktor, të cilit i është deleguar e drejta e prokurimit, është plotësisht përgjegjës për kryerjen e të gjithë procedurës së prokurimit, që nga njoftimi i kontratës deri te publikimi i njoftimit të shpalljes së fituesit, ndërsa nënshkrimi i kontratës bëhet nga vetë autoriteti/et kontraktor/e përfitues/e. Në rastin e përdorimit të marrëveshjes kuadër, procedura e prokurimit për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje bëhet nga organi qendror blerës, ndërsa procedura e minikonkurrimit për të lidhur kontratë brenda marrëveshjes kuadër bëhet nga vetë autoritetet kontraktore përfituese”.*

- pikën 4, neni 106, “**Kohëzgjatja e kontratës**”, ku përcaktohet se: “**Në çdo rast, financimi i kontratave të prokurimit bëhet në përputhje me parashikimet e legjislacionit përkatës për menaxhimin e sistemit buxhetor** në Republikën e Shqipërisë”.

Ky veprim është kundërshtuar edhe nga APP me shkresat përkatëse të trajtuara në pjesët në vijim ku cilësohet se:

“sgarojmë se UMT në cilësinë e organit qendror blerës ka përgjegjësi për të kryer të gjithë procedurën e prokurimit, ndërsa nënshkrimi i kontratës dhe ndjekja e zbatimit të saj bëhet nga vetë AK përfitues që ka në dispozicion fondet publike.

Ritheksojmë se në çdo rast, nënshkrimi i një kontrate në përfundim të procedurës së prokurimit do të bëhet nga AK, i cili ka fondet në dispozicion, si dhe ka detyrimin të ndjekë kontratën dhe pagesën e faturave respektive.”.

Kjo ka sjellë refuzim për marrjen në dorëzim ta mallrave (zbatim të urdhërit të Administratores së UMT, nr.56, datë 23.02.2023, për ngritje komisioni të marrjes në dorëzim) nga FMD dhe FM, sipas shkresës nr.172, datë 10.03.2023 të FMD (Administrator A.B) e likuidimit të mallrave Sa më sipër nga veprimet e mosveprimet e Administratorit të UMT, për kontratat e lidhura:

- a- “Blerje materiale pastrimi dhe dezinfektimi për njësitë shpenzuese të UMT”, e lidhur me numër 2925, datë 19.01.2023;
- b- “Furnizim vendosje kondicionerësh për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, e lidhur me nr. 4223/16, datë 30.12.2022;
- c- “Prodhim dhe printim diplomash për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, e lidhur me nr. 1884/68 Prot., datë 25.01.2023;
- d- “Blerje pajisje stomatologjike për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, e lidhur me nr. 1907/29 Prot., 10.02.2023.

rezultton se afërsisht pas 8 muajsh nga lidhja e kontratave, situata paraqitet:

- Është realizuar (dorëzuar malli dhe likuiduar) vetëm për Rektoratin për të katër kontratat;
 - Për kontratën **“Blerje materiale pastrimi dhe dezinfektimi për njësitë shpenzuese të UMT”, gjendja është:**
 - a- AK, FMD, ka marrë në dorëzim mallrat më datë 27.01.2023. Nga ana e FMD nuk është likuiduar.
 - b- AK, FSHMT, ka marrë në dorëzim mallrat nga kontraktori “S” SHPK, me fletë hyrje nr.11 dhe 11/1, datë 30.12.2020, sipas faturës tatimore nr.19, datë 30.12.2020, në vlerën 5,509,458 lekë, sipas dokumentacionit bashkëlidhur shkresës së FSHMD, me nr. 435, datë 16.04.2021. Nga ana e FSHMT nuk është realizuar likuidimi.
 - c- AK, FM, nuk e ka zbatuar kontratën me nr. 2925/35 Prot., datë 19.01.2023, nuk i ka marrë në dorëzim mallrat brenda afatit të caktuar në kontratë, pasi nuk ka lidhur kontratë vetë si AK.
 - Për kontratën **“Furnizim vendosje kondicionerësh për njësitë shpenzuese të UMT”, gjendja është:**
 - a- AK, FMD, ka marrë në dorëzim mallrat më datë 30.01.2023. Nga ana e FMD nuk është realizuar likuidimi.
 - b- AK, FSHMT, ka marrë në dorëzim mallrat më datë 30.01.2023. Nga ana e FSHMT nuk është realizuar likuidimi.
 - c- AK, FM, nuk e ka zbatuar kontratën me nr. 4223/16 Prot., datë 30.12.2022, nuk i ka marrë në dorëzim mallrat brenda afatit të caktuar në kontratë.
 - Për kontratën **“Prodhim dhe printim diplomash për njësitë shpenzuese të UMT”, gjendja është:**
 - a- AK, FSHMT janë marrë në dorëzim diplomat, por nuk janë likuiduar.
 - b- AK, FM, nuk e ka zbatuar kontratën
 - c- AK, FMD, nuk është berë marrja në dorëzim, nuk e ka zbatuar kontratën.
 - Për kontratën **“Blerje pajisje stomatologjike për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, gjendja është:**
 - a- AK, FMD, nuk është berë marrja në dorëzim, nuk e ka zbatuar kontratën.

Sa më sipër për veprimet dhe mosveprimet e saj, mban përgjegjësi ish Administratori i UMT, S.S, e cila në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të prokurimit publik, ka lidhur kontrata pa fonde në dispozicion, duke mos i autorizuar ato (lidhjen e kontratave) autoriteteve kontraktore, të cilat i kanë deleguar të drejtën të prokurojnë në emër të tyre (për të cilën nuk u paraqit ndonjë dokument).

Lidhja e padrejtë e kontratave prej Administratorit të UMT, shtyrja e afateve të kontratave me qëllim realizimin e tyre, ka sjellë mosrealizim të kontratave, në disa raste marrje në dorëzim të mallrave por pa u likuiduar, kjo pavarësisht faktit se APP në shumë

shkresa të saj ka vënë në dijeni AK, UMT, që lidhja e kontratës prej tij dhe jo prej AK që I kanë deleguar të drejtën për prokurim është në kundërshtim me LPP.

Me veprimet e saj ish Administratori i UMT, ka sjellë një vonesë mbi 8 muajore në realizimin e kontratës, pranim në disa raste të mallrave të prokuruar por pa u likuiduar, duke vendosur këto AK^{re} në konflikt me kontraktorët dhe kerkesën e tyre për zbatimin e detyrimeve kontraktuale të UMT.

Në mënyrë analitike sa trajtuar është sa më poshtë vijon:

4- Procedura e prokurimit me objekt: “Blerje materiale pastrimi dhe dezinfektimi për njësitë shpenzuese të UMT”, me këto të dhëna:

Urdhër Prokurimi Nr. 220, datë 20.10.2022	NJHDT: – A.L F.Z K.R	KVO , nr. 221, datë 20.10.2022 N.D, A.B, ndryshuar me urdhër nr.250/07.11.22 me P.L F.L	
Procedura e Prokurimit “e hapur e thjeshtuar mallra”			
Fondi Limit 2,741,523 lekë Për FM – 833,333 lekë; Për FMD – 499,837 lekë Për FSHMT – 775,133 lekë; Për Rektoratin – 633,220 lekë.	Data e hapjes së tenderit 07.11.2022	Diferenca me fondin limit 781,523 lekë	
	OE fitues: “S”	Operatorët Ekonomike - Pjesëmarrës në tender 6 - S’kualifikuar 5	
Burimi Financimit Buxheti i shtetit 1,333,170 lekë Të ardhurat e veta 1,408,353.8 lekë	Oferta fituese 1,960,000 lekë	Ankimime: S`ka S`ka asistence nga APP për DST Përgjigje Ankesës: s`ka	
Kontrata 2925, 19.01.2023	Vlera e kontratës 2,352,000 lekë	Afati 30 ditë	Pa likuiduar
Titullari i AK S.S			

Nuk disponohen kërkesa nga njësitë shpenzuese FM, FSHMT dhe FMD për kryerjen e kësaj procedurë prokurimi nga Rektorati.

Kjo procedurë është anuluar njëherë sipas Urdhërit të Titullarit të AK nr.207, datë 10.10.2022, i dalë në zbatim të Vendimit të KPP nr. 934/2022 datë 27.09.2022, nr.1647/10, datë 27.09.2022.

Hartimi i DT: Nga ana e NJHDT është mbajtur procesverbali i argumentimit datë 24.10.2022 “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim”, për artikujt e kërkuar.

Zhvillimi i procedurës së prokurimit: Procedura e prokurimit është hapur me procesverbalin datë 07.11.2022 dhe është vlerësuar me procesverbalet datë 10.11.2022 dhe 11.11.2022, sa më poshtë vijon:

OE	NIPTI	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
“2”	L22319013O	0	S`kualifikuar pasi nuk ka paraqitur në SPE ofertë ekonomike
“A”	K.....V	1,903,150	S`kualifikuar pasi: OE nuk ka dorëzuar mostrat në ambjentet e UMT-së, në datën dhe orën e hapjes së ofertave. Mos paraqitja e mostrave sipas specifikimeve teknike të kërkuara është kusht për s`kualifikimin e OE. OE nuk ka dorëzuar listen e mostrave të paraqitura me nënshkrimin dhe vulën e OE.
“S”	L.....R	1,960,000	Kualifikuar dhe shpallur fitues me Vendim KPP
“X.G”	L.....M	2,635,510	S`kualifikuar pasi: Shtojca nr.8 e vetdeklarimit nuk e ka paraqitur ne përputhje me pikën 3 të Vendimit nr.08 datë 05/10/2022 me nr. 6760 Prot. datn 05/10/2022 nga APP.

“M.V PF”	L.....C	1,683,650	S`kualifikuar pasi: Shtojca nr.8 e vetdeklarimit nuk e ka paraqitur ne përputhje me pikën 3 të Vendimit nr.08 datë 05/10/2022 me nr. 6760 Prot. datn 05/10/2022 nga APP.
“M.D”	K.....T	1,888,065	S`kualifikuar pasi: OE nuk ka dorëzuar mostrat në ambjentet e UMT-së, në datën dhe orën e hapjes së ofertave.

Njoftim fituesi paraprak nr.2925/16, datë 14.11.2022.

Ankimim për vlerësim:

X.G PF, datë 16.11.2022, me nr. 2925/17. Ky ankimues kundërshton arsyen e s`kualifikimit të vet dhe ankimon kualifikimin e OE “S”, për të cilin kundërshton specififikimet teknike për 7 artikuj si dhe nuk ka certifikatë konformiteti për 3 produkte dhe nuk ka certifikatë ISO 9001 dhe 14001.

M.V PF, datë 18.11.2022, me nr.2925/21, për të cilin kundërshton specififikimet teknike për 7 artikuj si dhe hedh poshtë arsyet e s`kualifikimit.

Bazuar në ankesën e bërë pranë UMT është bërë pezullimi i procedurës së prokurimit me urdhërin nr. 260, datë 17.11.2022 dhe më Urdhërin nr. 261, datë 17.11.2022 është ngritur KSHA i përbërë nga L.L, P.L, K. R. Ky komision është ndryshuar me urdhërin nr.263, datë 21.11.2022 me përbërje M.C, E.T dhe K. R.

KSHA për ankimuesin **X.G PF**, me procesverbalin nr.2925/25, datë 22.11.2022, i ka dhënë të drejtë pjesërisht vetëm për datën e shtojcës nr.8 të DST.

KSHA për ankimuesin **M.V PF**, me procesverbalin nr.2925/27, datë 22.11.2022, i nuk i ka dhënë të drejtë.

Kthim përgjigje **X.G PF**, me shkresën nr 2925/29, datë 23.11.2022.

Kthim përgjigje **M.V PF**, me shkresën nr 2925/30, datë 23.11.2022.

Nga ana e KPP me shkresën nr.2541/3, datë 21.12.2022, është kërkuar informacion mbi ankesat e OE, për të cilën me shkresën nr.2925/32, datë 27.12.2022 është kthyer përgjigje nga AK.

KPP me vendimin nr.21/2023, me nr.2541/5, datë 11.01.2023, ka vendosur të mos pranojë ankesën e OE **X.G PF** dhe **X.G PF** dhe lejon AK të vazhdojë procedurën e prokurimit.

KVO pas vendimit të KPP ka shpallur fitues OE “S”, si ofertë të vlefshme.

Sigurimi i kontratës datë 18.01.2023, në shumën 232,200 lekë.

Kontrata është lidhur më AK Universiteti i Mjekësisë Tiranë me numër 2925, datë 19.01.2023. Kjo kontratë është lidhur nga UMT në kushtet kur fondet në dispozicion nuk janë të vetat (vetëm shuma prej 672,924 lekë me TVSH disponohet nga Rektorati). Kontrata nga administrator i UMT, është nënshkruar në kundërshtim me pikën 7, neni 67 i VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar citohet se: “*Organi qendror blerës ose autoriteti kontraktor, të cilit i është deleguar e drejta e prokurimit, është plotësisht përgjegjës për kryerjen e të gjithë procedurës së prokurimit, që nga njoftimi i kontratës deri te publikimi i njoftimit të shpalljes së fituesit, ndërsa nënshkrimi i kontratës bëhet nga vetë autoriteti/et kontraktor/e përfitues/e. Në rastin e përdorimit të marrëveshjes kuadër, procedura e prokurimit për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje bëhet nga organi qendror blerës, ndërsa procedura e minikonkurrimit për të lidhur kontratë brenda marrëveshjes kuadër bëhet nga vetë autoritetet kontraktore përfituese”.*

Në këtë kontratë në: **nenin 5 të KPK**, “dorëzimi” dhe nenin 3 “dorëzimi” të KVK, është përcaktuar afati i dorëzimit 10 ditë dhe vendi i dorëzimit Rektorat, FM, FMD, FSHMT si dhe sasia përe çdo njësi shpenzuese;

nenin 7, “Cmimi i kontratës” të KPK dhe nenin 4 “Cmimi i kontratës” të KVK, është përcaktuar cmimi total në shumën 2,352,000 lekë me TVSH si dhe i ndarë:

- Rektorati, në shumën 672,924 lekë me TVSH;
- FM, në shumën 559,080 lekë me TVSH;
- FMD, në shumën 346,896 lekë me TVSH;
- FSHMT, në shumën 773,100 lekë me TVSH.

Nga ana e Administratorit të UMT, S.S janë dërguar shkresat sa më poshtë vijon:

Nr.	dokumenti nr/datë	Lenda	Drejtuar
1	2925/37,23.01.23	Dergim kontrate	FM, FSHMT, FMD
2	2529/39, 23.01.23	Përcjellje urdhëri	FSHMT, adminsitrorit A.M
3	2925/40, 23.01.23	Përcjellje urdhëri	FMD, adminsitrorit A.T
4	2925/41, 23.01.23	Përcjellje urdhëri	FM, adminsitrorit A.B
<p>Bashkëlidhur Urdhër i Administratorit, nr.17, datë 23.01.23, 2925/38, datë 23.01.23 për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës. Përcaktohen Komisionet e marrjes në dorëzim: Rektorati: F.Z, E.N, S.B FM: K.X, I.M,E.A; FSHMT: A.H,K.R,D.R; FMD: A.O, E.I, A.K.</p>			
5	2925/42, datë 30.01.23	Përcjellje kopje e dokumentacionit të procedurës (ridërgim)	E.A, teknik i specialiteteve të ndryshme FM; Për dijeni: X.D, Dekan i FM
6	2925/43, datë 30.01.23	Përcjellje kopje e dokumentacionit të procedurës (ridërgim)	K.X, Kryetar i Degës së menaxhimit të Shërbimeve FM; Për dijeni: X.D, Dekan i FM
7	2925/44, datë 30.01.23	Përcjellje kopje e dokumentacionit të procedurës (ridërgim)	I.M, teknik i specialiteteve të ndryshme FM; Për dijeni: X.D, Dekan i FM
<p>Memo informuese nr.2925/46, datë 30.01.2023 nga Drejtor I Drejtorisë së Shërbimeve N.D, drejtor Administratorit S.S, për shtyrjen e afatit të kontratës, pasi OE është paraqitur disa herë në FM dhe nuk ka arritur të dorëzojë mallin për mungesë të grupit të punës dhe kërkon shtyrjen e afatit të kontratës me 10 ditë. Kjo meno është miratuar nga Administratori S.S.</p>			
<p>Amendim Kontrate të lidhur midis OE S dhe UMT, me numër 2925/47, datë 30.01.2023, ku afati nga 10 ditë bëhet 20 ditë.</p>			
<p>Shkresë drejtuar APP nga FM</p>			
	Nr. Prot., FM 136/2, datë 31.01.2023 nr prot., UMT 2925/48, datë 31.01.23	Përcillet shkresa e APP me nr. prot 136/1, datë 31.01.2023	Bordit të Administrimit të UM, Tiranë, S.S Për Dijeni: Rektorit të UMT Dekanit të FM Njësisë së AB
8	2925/49, datë 01.02.2023	Kthim përgjigje dhe kërkesë për unifikim praktike	APP
<p>Sipas kësaj shkrese citoj: “Interpretimi i juaj (APP) i parashtruar në shkresën tuaj 899/1, datë 31.01.23, bazohet vetëm në ligjin e Prokurimit Publik dhe nuk mbahet parasysh përcaktimet e ligjit për Arsimin e Lartë si i vetmi ligj organik dhe i posacëm që rregullon veprimtarinë e UM dhe për nga hierarkia e akteve prevalon mbi ligjin e përgjithshëm që është ai për Prokurimin Publik”. Sa më sipër i kërkohet APP të marrë një iniciativësa më shpejt për nxjerrjen e udhëzimeve dhe akteve të tjera me qëllim unifikimin e praktikës për të tilla rastë në të gjithë ILA, pasi ndiqen praktika të ndryshme. Gjithashtu kërkon udhëzim nga APP se si të veprojë me procedurën e nisur.</p>			
9	2925/52, 2.02.23	Plani i zbatimit të kontratës	Nuk ka.
10	2925/53, 06.02.23	Autorizim për kryerje pagese	Administratorëve të FSHMT, FMD, FM
	2925/54, 06.02.23	Procesverbal për ndjekjen e kontratës në Rektorat nga grupi i marrjes në dorëzim. Fatura tatimore numër 7/2023, datë 30.01.23 në shumën 560,770 lekë + 112,154 lekë	

Nr.	dokumenti nr/datë	Lenda	Drejtuar
		TVSH.	
11	2925/56, 06.02.23	Mbi zbatimin e afateve të urdhëruara	A.G, Administrator i FM. Për dijeni: Rektorit dhe Dekanit të FM
	2925/59, datë 15.02.23	Kërkesë nga kontraktori për marrjen në dorëzim të materialeve nga UM. Në kartelën shoqëruese të kërkesës është dhënë për trajtim nga Drejtoria e Shërbimeve dhe është vënë shënim nga Administratori i UM: “Si kontrata e kondicionerëve 15 ditë zgjatje afati”.	
12	2925/60, datë 16.02.23	Amendim kontrate të UMT, për shtryrje afati nga 20 ditë në 35 ditë	
13	2925/61, datë 17.02.23	Plani i zbatimit të kontratës	Nuk ka.
14	4223/34, datë 22.02.23	Përcillet informacion për problematikat e hasura për zbatimin e kontratave	APP
	Shkresë e APP nr.899/6, datë 24.02.23 e prot në UMT me numër 2925/65, datë	Kthim përgjigje shkresës së UMT nr.2925/63, datë 20.02.2023, me lëndë “Informacion në lidhje me situatën e pa precedentë të krijuar në UM si rrjedhojë e veprimeve e mos veprimeve në kundërshtim me ligjin të Administratorit të FM.”	UMT Për dijeni: Bordit të Administrimit, Senatit Akademik, Sekretarit të Përgjithshëm të MFE Sekretarit të përgjithshëm të MAS Fakultetit të Mjeksisë
Në këtë shkresë sqarohet nga ana e APP se në rast së institucioni vepron në cilësinë e një organi qëndror blerës, sipas nenit 53 të LPP, atëhere përgjegjësia e zhvillimit të procedurës së së prokurimit që nga njoftimi i kontratës deri tek shpallja e fituesit është në kompetencë të autoritetit tuaj kontraktor, por nënshkrimi i kontratës bëhet nga AK përfitues sipas nenit 67/7 të VKM nr.285/2021.			
	Shkresë e MAS nr.1301/2, datë 02.03.2023 e prot në UMT me nr.2925/68, datë 03.03.2023,	Kthim përgjigje shkresës nr.2925/63, datë 20.02.2023, nga Sekretari i Përgjithshëm i MAS E.T	UMT.
Në këtë shkresë SP citon: “referuar informacionit të përcjellë rezultojn se UMT ka zhvilluar procedura prokurimi si AK për nevoja të veta , duke qenë se fondet në dispozicion për prokurim janë të UMT dhe në përfundim të procesit detyrimin për nënshkrimin e kontratave e ka UMT, ndërsa fakultetet janë në dispozicionin e subjekteve përfituese. MAS vlerëson se në kushtet kur procedurën e prokurimit publik dhe lidhja e kontratave me OE është realizuar nga Administratori i UMT, në cilësinë e TAK dhe jo në kushtet e organit qëndror blerës, është detyrë dhe përgjegjësi e këtij të fundit edhe ndjekja e zbatimit të tyre bazuar në parashikimet e legjislacionit të LPP”.			
	Shkresë e FM nr.162/11, datë 09.03.2023 e prot në UMT me nr.2925/72, datë 09.03.2023,	Kthim përgjigje shkresës “kërkesë për caktimin e ditës për dorëzimin e mallrave”	OE “K.T” Për dijeni S.S, administrator e UMT.
Në këtë shkresë citojm: “...me qëllim për të mos sjellë pengesa juve si OE... jemi të gatshëm në çdo kohë që të procedojmë në një nga dy mënyrat e mëposhtme: -të nënshkruajmë kontratën se bashku, sapo UMT të sjellë njoftimin zyrtar për shpalljen si fitues dhe autorizim kontrate për ju. -ose ju (OE) të shprehni vullnetin tuaj me deklaratë noteriale dypalëshe midis jush dhe UMT me të cilën keni nënshkruar kontratën, ku të dy të shprehni se FM nuk ka asnjë detyrim financiar për të paguar vlerën e kësaj kontrate.			

Nëpërmjet shkresës me nr. 2925/37 prot., datë 23.01.2023 me lëndë: “Dërgim i kontratës me objekt: “Blerje materiale pastrimi dhe dezinfektimi për njësitë shpenzuese të Universiteit të

Mjekësisë, Tiranë”, i është përcjellë njësisive shpenzuese përfituese për zbatim kontrata e cituar më sipër. Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, ka ngritur urdhërin nr. 17, nr. 2925/38 Prot., datë 23.01.2023 “*Për ndjekjen e zbatimit dhe realizimin e kontratës me objekt: “Blerje materiale pastrimi dhe dezinfektimi, për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë*”, i cili është i detajuar në komisione për secilën nga njësitë shpenzuese përfituese, pjesë e kontratës së nënshkruar. Anëtarët e caktuar janë punonjës përkatës të këtyre njësisive shpenzuese. Sipas Njësive shpenzuese gjendja paraqitet:

Rektorati: Më datë 30.01.2023 Rektorati i Universitetit të Mjekësisë Tiranë, ka marrë në dorëzim mallrat, në prani të komisionit të ngritur në urdhërin e cituar më sipër dhe operatorit ekonomik fitues. Nga ana e **Rektoratit të UMT është realizuar dhe likujdimi i faturës.**

Njësia shpenzuese FMD ka marrë në dorëzim mallrat më datë 27.01.2023 në prani të komisionit të ngritur në urdhërin e cituar më sipër dhe operatorit ekonomik fitues.Nga ana e **FMD nuk është realizuar likujdimi.**

Njësia shpenzuese FSHMT ka marrë në dorëzim mallrat më datë 30.01.2023 mallrat në prani të komisionit të ngritur në urdhërin e cituar më sipër dhe operatorit ekonomik fitues. Nga ana e **FSHMT nuk është realizuar likujdimi.**

Nga ana e **FM nuk është zbatuar kontrata** me nr. 2925/35 prot., datë 19.01.2023, pas mallrat nuk janë marrë në dorëzim.

Sa më sipër, nëpërmjet shkresës Nr. 2925/41 Prot., datë 23.01.2023 me lëndë “*Përcjellje urdhëri*” administratori i UMT i është drejtuar FM për zbatimin e urdhërit nr. 17, nr. 2925/38 Prot., datë 23.01.2023 “*Për ndjekjen e zbatimit dhe realizimin e kontratës me objekt: “Blerje materiale pastrimi dhe dezinfektimi, për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë*”. Nga ana e FM nuk ka patur asnjë përgjigje për njoftimet, për këtë arsye nëpërmjet shkresave nr. 2925/42 prot., datë 30.01.2023, nr. 2925/43 prot., datë 30.01.2023 dhe nr. 2925/44 prot., datë 30.01.2023 janë njoftuar secili prej anëtarëve të komisionit për marrjen në dorëzim për njësinë shpenzuese të FM . Nga ana e komisionit deri në ditën e fundit për marrjen në dorëzim të mallrave nuk është bërë asnjë marrje në dorëzim, për këtë arsye Universiteti i Mjekësisë Tiranë ka bërë amendim kontrate me nr. 2925/47 prot., datë 30.01.2023 lidhur me afatin e dorëzimit të mallit i cili ndryshon në brenda 20 (njëzet) ditëve pune nga dita e nënshkrimit të kontratës mes palëve. Nëpërmjet shkresë nr. 2925/56 prot., datë 08.02.2023 me lëndë “*Mbi zbatimin e afateve të urdhëruara*” Universiteti i Mjekësisë Tiranë i është drejtuar FM ku e bënë me dije për moszbatimin e afateve të kontratës nr. 2925/35 Prot., datë 19.01.2023 si dhe amendimit të kontratës me nr. 2925/47 prot., datë 30.01.2023 e cila përfundon më 16.02.2023.

Sa më sipër për arsye se FM nuk ka marrë në dorëzim sërish mallrat Universiteti i Mjekësisë Tiranë ka bërë amendim kontrate me nr. 2925/60 prot., datë 16.02.2023 lidhur me afatin e dorëzimit të mallit i cili ndryshon në brenda 35 ditëve pune nga dita e nënshkrimit të kontratës mes palëve. **Nga ana e FM akoma nuk është bërë marrja në dorëzim e mallrave duke e lënë kontratën dhe amendimet e saj të pazbatuara.**

Si konkluzion kjo procedurë ka filluar më 20.10.2022 dhe deri në mbajtjen e këtij konstatimi nuk ka përfunduar, pra 10 muaj, për të cilën mban përgjegjësi ish Administratorja e UMT S.S e cila ka lidhur kontratë në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të LPP dhe të buxhetit.

5- Procedura e prokurimit me objekt: “Furnizim vendosje kondicionerësh për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, me këto të dhëna:

Urdhër Prokurimi Nr. 267, datë 23.11.2022	NJHDT: – L.L P.L R.S	KVO , nr. 269, 23.11.2022 N.D E.T L.M
Lloji i Procedurës së Prokurimit “e hapur e thjeshtuar mallra”		
Fondi Limit 7,479,462.55 lekë - Për Rektoratin UMT 117,794.58 lekë - Për FM, në shumën 1,613,052.71 lekë; - Për FSHMT 4,463,269.43 lekë; - Për FMD 1,285,345.84 lekë.	Burimi Financimit Te ardhurat	Diferenca me fondin limit 210,239.88 lekë
	Data e hapjes së tenderit 06.12.2022	Operatorët Ekonomike - Pjesëmarrës në tender 3 - S’kualifikuar 0
	OE fitues: K TB2 SHPK	
Lidhja e Kontratës: 4223/16, datë 30.12.2022	Oferta fituese 7,269,222.67	Ankimime: S`ka Përgjigje Ankesës: s`ka
Vlera e kontratës 8,723,067.204 lekë	S`ka asistence nga APP për DST	Afati 30 ditë Pa likuiduar
Titullari i AK S.S		

Nga auditimi rezultoi: Nuk disponohen kërkesat nga njësitë shpenzuese për kryerjen e procedurës së prokurimit dhe as specifikimet teknike që kërkohen të plotësojnë këto mallra. Nuk disponohen kërkesa nga njësitë shpenzuese FM, FSHMT dhe FMD për kryerjen e kësaj procedurë prokurimi nga Rektorati.

Hartimi i DT. Nga ana e NJHDT është mbajtur procesverbali i argumentimit datë 24.11.2022, “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim”, për artikujt sa më poshtë vijon:

Nr.	Emërtimi i mallit	Njësi	Sasi			
			Rektorat	FM	FSHMT	FMD
1	Kondicioner unisplit mural 9000 BTU	copë		1		
2	Kondicioner unisplit mural 12000 BTU	copë			11	2
3	Kondicioner unisplit mural 18000 BTU	copë	1	13	30	3
4	Kondicioner unisplit mural 24000 BTU	copë				5

Pavarësisht se është hartuar procesverbali i argumentimit të kriterëve për NJHDT nuk i ka argumentuar këto kriterë, në procesverbalin e hartimit dhe argumentimit të fondit limit në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 39, “Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike”, pika 4, ku është përcaktuar se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”. Ndërkohë procedura e prokurimit është mallra ndërsa kriteret e kualifikimit janë vendosur për procedurë prokurimi punë, e konkretisht janë të paargumentuara sa më poshtë vijon:

Në DT është kërkuar: (2.3.2) OE duhet te jete i pajisur me Liçensë profesionale të Shoqërisë e vlefshme me kategorinë: NS-12 / A “Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit”.

➤ Sipas VKM nr.42, datë 16.1.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, për këtë kategori është përcaktuar se: “N.S - 12 Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit: Konsiderohen montimi dhe mirëmbajtje ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve pneumatike, të kompletuara me

punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi”.

Në këtë rast kërkesa për këtë kategori license ka të bëjë **me një sistemi të plotë**, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve pneumatike, të kompletuara me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi, ndërkohë që sipas preventivit kemi të bëjmë thjesht me furnizim e vendosje kondicioner pra jo sisteme.

Në DT është kërkuar: 2.3.3 OE, duhet të ketë të punësuar për muajin Gusht, Shtator, Tetor2022, një staf punonjësish prej minimalisht 13 persona, nga të cilët :

- 1 **Inxhinier Mekanik**, i cili duhet jetë Drejtues Teknik i kompanisë për të cilin OE duhet të paraqesë: Diplomën; CV-në; Dëshminë e Kualifikimit të Sigurimit Teknik; Librezën e punës; Kontratën individuale të punës. Inxhinieri mekanik duhet të jetë i pajisur me Çertifikatë për Auditimin e Energjisë.

- 1 **Inxhinier Elektrik** për të cilin OE duhet të paraqesë: **Liçensë individuale në zbatim**, e vlefshme me kategorinë NS 14/A “Impiante te brendshme elektrike”; Diplomen; CV-në; Librezen e punës; Dëshminë e Kualifikimit të Sigurimit Teknik; Kontratën individuale të punës.

-1 **Inxhinier Mjedisi** për të cilin OE duhet të paraqesë: Diplomen, Dëshminë e Kualifikimit të Sigurimit Teknik; Kontratën individuale të punës.

- 4 punonjës teknik kondicioneri;

Ku të paktën 2 prej teknikëve të kondicionerit OE duhet të paraqesë: Kontratë individuale pune; Dëshminë e Kualifikimit të Sigurimit Teknik, lëshuar nga Institucione te autorizuar; Dëshmi/ Certifikatë formimi profesional.

Dhe per 2 prej teknikëve të kondicionerit OE duhet të paraqesë: Kontratë individuale pune; Dëshminë e Kualifikimit të Sigurimit Teknik, lëshuar nga Institucione te autorizuar;

- 1 punonjës saldator, për të cilin OE duhet të paraqesë: Kontratë individuale pune; Dëshminë e Kualifikimit të Sigurimit Teknik lëshuar nga Institucione te autorizuar; Dëshmi/Certifikatë formimi profesional.

- 1 punonjës elektrikist, për të cilin OE duhet të paraqesë: Kontratë individuale pune; Dëshminë e Kualifikimit të Sigurimit Teknik lëshuar nga Institucione te autorizuar; Dëshmi/ Certifikatë formimi profesional.

- 1 **punonjës hidraulik**, për të cilin OE duhet të paraqesë: Kontratë individuale pune; Dëshminë e Kualifikimit të Sigurimit Teknik lëshuar nga Institucione te autorizuar; Dëshmi/Certifikatë formimi profesional.

- Listepagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025) **për 3 muajt e fundit ku të figurojnë punonjësit e kërkuar.**

➤ **Nga ku nga auditimi rezultojnë kërkesa të tejkaluara të LPP e RRPP si dhe akteve ligjore e nënligjore që kanë lidhje me procedurën e prokurimit, sa më poshtë vijon:**

➤ **Nga ana e NJHDT** nuk është mirëargumentuar teknikisht nevoja. Kriteri i disponimit të stafit në fjalë i shërben autoritetit kontraktor për të provuar vetëm kapacitetet teknike dhe profesionale të operatorit ekonomik, që vlerësohen të nevojshme për të realizuar kontratën që prokurohet. Stafi teknik duhej të ishte kërkuar bazuar në punimet konkrete që do të kryhen dhe grafikun e zbatimit për stafin inxhinierik dhe numrin i punonjesve në total dhe të specializuar,

me volumin e punimeve, sipas zbërthimit të zërave të punimeve bazuar në VKM nr.629, datë 15.07.2015, "Për miratimin e manualeve teknike të cmimeve të punimeve të ndërtimit";

➤ Kërkesa për të qenë të paisur me licensë individuale për një procedurë prokurimi ndërtim, është e gabuar, pasi me licensa individuale pajisen individët dhe subjektet për ushtrimin e aktivitetit në fushën e studimit e projektimit dhe mbikëqyrjes së kolaudimit të zbatimit të punimeve në ndërtim, në bazë të VKM nr. 943, datë 28.12.2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 759, datë 12.11.2014, "Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim" dhe Rregullores "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrje e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim".

➤ Në lidhje me stafin është kërkuar edhe inxhinier mjedisi në një kohë që nuk ka punime të tilla në kuptim të VKM nr.42, datë 16.1.2008, ku është përcaktuar se: "**N.P. 12 Punime të inxhinierisë mjedisore** Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemimit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karrierave dhe mbetjeve inerte".

➤ **Numri i kërkuar prej 3 inxhinierësh në staf** (1 inxhinier mjedisi, 1 inxhinier elektrik, 1 inxhinier mekanik), është i fryrë dhe ul konkurrencën në procedurë, pasi nuk është i argumentuar me volume punimesh. Sa i përket kërkesës së autoritetit kontraktor që stafi i punonjësve të jetë i pasqyruar në listëpagesa për tre muaj, **kufizon numrin e shoqërive pjesëmarrëse që nuk zotërojnë staf teknik të përhershëm** (gjë që reflektohet në listëpagesat e shoqërisë), por që kanë mundësinë t'a sigurojnë këtë staf, duke lidhur kontrata pune me afat sa afati i kontratës objekt prokurimi.

➤ Kërkesa për: "**1 inxhinier mekanik**, i cili duhet jetë drejtues teknik i kompanisë për të cilin OE duhet të paraqesë: diplomën; CV-në; dëshminë e kualifikimit të sigurimit teknik; librezën e punës; kontratën individuale të punës. **Inxhinieri mekanik duhet të jetë i pajisur me Çertifikatë për Auditimin e Energjisë**", është kërkesë në tejkallim të LPP, pasi:

Në nenin 16 pika 4 dhe 5 të ligjit nr.125/2015 "Për efincencën e energjisë" parashikohet se:

"4. Auditimi energjetik është i detyrueshëm për:

a) çdo person juridik, publik ose privat, që kategorizohet si konsumator i madh energjie;

b) të gjithë personat fizikë dhe/ose juridikë, që aplikojnë për një program të financuar nga Fondi për Eficiencën e Energjisë për nxitjen dhe përmirësimin e eficiencës së energjisë.

5. Auditimet energjetike të detyrueshme kryhen:

a) çdo 3 vjet për subjektet e përcaktuara në shkronjën "a", të pikës 4, të këtij neni;

b) çdo herë, përpara se një ndërtesë, objekt industrial dhe objektet e tjera që vlerësohen, vihen në punë dhe/ose ndërtohen nga e para apo i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm."

Në dokumentet e procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktor ka publikuar njëherazi "Preventivin e punimeve", "Relacionin Teknik", "Specifikimet Teknike", "Grafikun e punimeve" dhe "Projektin e Zbatimit". Nga shqyrtimi i dokumentacionit në tërësi, konstatohet se në asnjë

rast autoriteti kontraktor nuk ka parashikuar në “Relacionin Teknik”, “Specifikimet Teknike” kryerjen e shërbimit të auditimit të efincencës së energjisë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, nga auditues energjitik të licencuar. Gjithashtu autoriteti kontraktor nuk ka parashikuar si zë të veçantë kryerjen e shërbimit të auditimit të efincencës së energjisë. Sa më sipër, kriteri i mësipërm i vendosur nga autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit, nuk është proporcional me objektin e procedurës së prokurimit, natyrën, përmasat e kontratës si edhe me qëllimin e kërkuar nga vetë autoriteti kontraktor. Bazuar në detyrimet që rrjedhin nga ligji nr.124/2015 “Për efincencën e energjisë”, autoriteti kontraktor në çdo moment mund të kryejë procesin e auditimit energjitik me një procedurë të veçantë përpara fillimit të procedurës së prokurimit.

➤ Kërkesa për: 1 inxhinier **elektrik** për të cilin OE duhet të paraqesë: licensë individuale në zbatim, e vlefshme me kategorinë ns 14/a “impiante te brendshme elektrike”; diplomën; cv-në; librezën e punës; dëshminë e kualifikimit të sigurimit teknik; kontratën individuale të punës.

Kërkesa për të qenë të paisur me licensë individuale për një procedurë prokurimi ndërtim, është e gabuar, pasi me licensa individuale pajisen individët dhe subjektet për ushtrimin e aktivitetit në fushën e studimit e projektimit dhe mbikëqyrjes së kolaudimit të zbatimit të punimeve në ndërtim, në bazë të VKM nr. 943, datë 28.12.2016 Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 759, datë 12.11.2014, "Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim" dhe Rregullores "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrje e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim".

➤ Kërkesa për 1 **inxhinier** mjedisi për të cilin OE duhet të paraqesë: diplomën, dëshminë e kualifikimit të sigurimit teknik; kontratën individuale të punës, nuk qëndron pasi:

Në lidhje me këtë kriter, së pari, duke marrë shkas nga punimet e përfshira në dokumentet teknike të procedurës (preventiv, projekt, specifikimet teknike dhe relacion teknik), rezulton se, zërat e kërkuar nuk parashikojnë llojet e punimeve të përfshira në përkufizimin e kategorisë së mëposhtme, sipas VKM nr.42, datë 16.01.2008: “*N.P- 12 Punime të inxhinierisë mjedisore - ndërtim, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogeologjike, nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemimit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karrierave dhe mbetjeve inerte*”.

Gjithashtu, duke konsideruar faktin që kriteri sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së OE ofertues të mundshëm, të cilët vlerësohet se kanë kapacitetin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm për ekzekutimin e kontratës AK duhet t'i përmbahej përcaktimeve të nenit 2 të LPP nr. 162/2020 për të shmangur çdo kriter apo kërkesë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.

Në DT është kërkuar “*OE duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat e leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombetare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, që kanë lidhje me objektin e kontratës, edhe: ISO 50001:2018 (ose e përditësuar) (Sistemi i menaxhimit te Energjise)*”.

➤ Kjo certifikatë ISO, nuk ka lidhje me objektin e prokurimit në fjalë, pasi ISO 50001 bazohet në modelin e sistemit të menaxhimit të përmirësimit të vazhdueshëm që përdoret edhe për standarde të tjera të njohura si ISO 9001 ose ISO 14001. Kjo e bën më të lehtë për organizatat të integrojnë menaxhimin e energjisë në përpjekjet e tyre të përgjithshme për të përmirësuar cilësinë dhe menaxhimin e mjedisit. ISO 50001 ofron një kornizë të kërkesave për organizatat për: Zhvillimin e një politike për përdorimin më efikas të energjisë; Përcaktimin e objektivave dhe objektivat për të përmbushur politikën; Përdorimi i të dhënave për të kuptuar më mirë dhe për të marrë vendime në lidhje me përdorimin e energjisë; mat rezultatet dhe shqyrton se sa mirë funksionon politika dhe përmirësimi vazhdueshëm për menaxhimin e energjisë.

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas të cilit:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. **Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.** Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

ngarkohet me përgjegjësi NHJDT të përbërë nga L.L, P.L dhe R.S.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur komenti me shkresë nr. s`ka, datë 22.11.2023, e protokolluar në KLSH me nr. 401/14, datë 23.11.2023, “s qarime në lidhje me Projekt Raportin” dhe me nr.1421/20 datë 22.11.2023 , e protokolluar në KLSH me nr. 401/16, datë 01.12.2023, nga **L.L.**

Pretendimi i subjektit: Duke mos qenë specialiste e fushës për të argumentuar kapacitetin teknik, specifikimet teknike, hartimin e kërkesave për kualifikim, lidhur me kapacitetin teknik si dhe cdo informacion tjetër specifik të nevojshëm, nuk kam nënshkruar procesverbalin e sipërpërmendur, por e kam vlerësuar të rregullt për vazhdimin e procedurës pasi ky procesverbal objek akt konstatimi është miratuar nga dy anëtarët e tjerë të NjP. I bashkëngjitet këtij observacioni procesverbali i argumentimit datë 24.11.2023 “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Ju sqarojmë se: Është detyra e juaj bazuar në:

- VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 78, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pikat 1 dhe 2, ku është përcaktuar se

1. **Dokumentet e tenderit hartohen nga njësia e prokurimit në përputhje me këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi.** Në hartimin e dokumenteve të tenderit, njësia e prokurimit duhet të përdorë dokumentet standarde të tenderit, sipas llojit të procedurës e tipit të kontratës.

2. Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit.

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, **si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.** Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit”.

- Urdhëri i prokurimit i Titullarit të AK, që ju ka caktuar këtë detyre.

- Gjithashtu në komentin tuaj se: “Sa më sipër përgjegjësi i Takon Titullarit të UMT, e cila nuk ka caktuar një specialist fushe në përbërje të NJHDT, ju sqaroj se , në cilësinë e juristes ju nuk duhej të kishit lejuar të vazhdonte procedura pa specialist fushe.

Zhvillimi i procedurës së prokurimit: Procedura e prokurimit është hapur me procesverbalin datë 06.12.2022 dhe është vlerësuar me procesverbalin datë 12.12.2022, sa më poshtë vijon:

OE	NIPTI	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
A SHPK	K.....W	7,495,200	S`kualifikuar pasi: 1. <i>Oferta e paraqitur është më e lartë se fondi limit.</i> 2. <i>Nuk disponon leje mjedisore të tipit B që e ka paraqitur është në emër të subjektit mbështetës Dajti Park 2007 të cilin e ka përmendur në shtojcën e vetdeklarimit. Sipas DST shtojca e vetdeklarimit te përmendur më lart duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.</i> 3. <i>Nuk ka paraqitur katalogun e markuar me specifikimet teknike të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.</i>
K TB2 SHPK	K.....W	7,269,222.7	Kualifikuar dhe shpallur fituese
L.S	K.....A	0	S`kualifikuar pasi nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

Nga auditimi rezulton se është shpallur fitues oferta më e ulët e vlefshme.

Lidhja e kontratës: Kjo kontratë është lidhur nga UMT në kushtet kur fondet në dizpozicion nuk janë të vetat (vetëm shuma prej 117,794.58 lekë pa TVSH disponohet nga Rektorati). Kontrata nga administrator i UMT, është nënshkruar në kundërshtim me pikën 7, neni 67 i VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar citohet se: “Organi qendror blerës ose autoriteti kontraktor, të cilit i është deleguar e drejta e prokurimit, është plotësisht përgjegjës për kryerjen e të gjithë procedurës së prokurimit, që nga njoftimi i kontratës deri te publikimi i njoftimit të shpalljes së fituesit, **ndërsa nënshkrimi i kontratës bëhet nga vetë autoriteti/et kontraktor/e përfitues/e.** Në rastin e përdorimit të marrëveshjes kuadër, procedura e prokurimit për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje bëhet nga organi qendror blerës, ndërsa procedura e minikonkurrimit për të lidhur kontratë brenda marrëveshjes kuadër bëhet nga vetë autoritetet kontraktore përfituese”.

Kontrata është lidhur me nr. 4223/16, datë 30.12.2022, me vlerë 8,723,067.204 lekë me TVSH (bashkëlidhur sigurimi i kontratës). Sipas nenit nr.5, “Dorëzimi”, është përcaktuar vendi i dorëzimit, sipas DST në 4 vende: UMT (Rektorati), Fakultetin e Mjekësisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore dhe FMD . Afati i lëvritimit në kontratë është caktuar brenda 30 ditëve kalendrike nga dita e nënshkrimit të kontratës mes palëve. Nëpërmjet shkresës me nr. 4223/17 prot., datë 06.01.2023 me lëndë: “Njoftim për lidhjen dhe zbatimin e kontratës nr. 4223/16 prot., datë 30.12.2022”, Administratori i UMT i ka përcjellë njësive shpenzuese përfituese për zbatim kontratën e cituar më sipër. Administratori i UMT S.S ka ngritur Urdhërin nr. 7, nr. 4223/19 Prot., datë 12.01.2023, “Për ndjekjen dhe realizimin e kontratës me objekt: “Furnizim – vendosje kondicioner për njësitë shpenzuese të UMT”, i cili është i detajuar në komisione për secilën nga njësitë shpenzuese përfituese, pjesë e kontratës së nënshkruar. Anëtarët e caktuar janë punonjës përkatës të këtyre njësive shpenzuese.

Nga ana e Administratorit të UMT S.S, ka dalë urdhëri nr.4223/19, datë 12.11.2023, ku janë ngritur komisionet e marrjes në dorëzim më përbërje:

Rektorati	Fakulteti Mjekësisë	Fakulteti Shkencave Mjekësore Teknike	Fakulteti Dentare	Mjekësisë
F.Z	K.X	A.H	A.O	
E.N	I.M	F.E	E.I	
S.B	E.A	D.R	A.K	

Nëpërmjet shkresave Nr. 4223/20 Prot., datë 12.01.2023, Nr. 4223/21 Prot., datë 12.01.2023 dhe Nr. 4223/22 Prot., datë 12.01.2023 me lëndë “Përcjellje urdhëri” i është bërë me dije njësisë shpenzuese përfituese Urdhërin Nr.7, datë 12.01.2023.

Gjendja ekzistuese e kontratës:

Rektorati i UMT, më datë 30.01.2023, ka marrë në dorëzim 1 kondicioner, në prani të komisionit dhe Kontraktorit. Nga ana e Rektoratit të UMT është realizuar dhe likuidimi i faturës.

Njësia shpenzuese FMD ka marrë në dorëzim mallrat më datë 30.01.2023, në prani të komisionit të ngritur kontraktorit. Nga ana e FMD nuk është realizuar likuidimi.

Njësia shpenzuese FSHMT ka marrë në dorëzim mallrat më datë 30.01.2023 në prani të komisionit dhe kontraktorit. Nga ana e FSHMT nuk është realizuar likuidimi.

Nga ana e **Njesisë shpenzuese FM** nuk është zbatuar kontrata me nr. 4223/16 Prot., datë 30.12.2022.

Me **shkresën nr.4223/17, datë 06.01.2023** të TAK S.S, është dërguar njoftim për lidhjen e kontratës nr. 4223/16, datë 30.12.2022, drejtuar A.B, Administrator i FMT, A.M, Administrator i FSHMT, A.T, Administratore e FMD, sipas së cilës UMT ka zhvilluar procedurën e prokurimit “procedurë e hapur e thjeshtuar, mallra”, me objekt “Furnizim vendosje kondicioner për njësitë shpenzuese të UMT”, ku bashkëlidhur ka dërguar edhe dokumentacionin përkatës dhe janë njoftuar secili prej anëtarëve të komisionit për marrjen në dorëzim për njësinë shpenzuese të FM të cilëve ju bëhet me dije zbatimimi i kontratës brenda afateve të përcaktuara, me shkresat:

Shkresë		Drejtuar	Detyra	Për dijeni	Detyra
Nr.	Datë				
4223/24	30.01.23	K.X	Kryetar i degës së menazhimit të shërbimeve të Fakultetit të Mjekësisë	X.D	Dekan i FM
4223/25	30.01.23	I.M	Teknik specialiteteve të ndryshme Fakulteti i mjeksise	X.D	Dekan i FM
4223/25	30.01.23	E.A	Teknik specialiteteve të ndryshme Fakulteti i mjeksise	X.D	Dekan i FM

Nga ana e FM nuk ka patur asnjë përgjigje për njoftimet, si dhe nga ana e komisionit deri në ditën e fundit për marrjen në dorëzim të mallrave nuk është bërë asnjë marrje në dorëzim, për këtë arsye UMT ka bërë amendim kontrate me Nr. 4223/27 Prot., datë 30.01.2023 lidhur me afatin e dorëzimit të mallit i cili ndryshon në brenda 40 (dyzet) ditëve kalendarike nga dita e nënshkrimit të kontratës mes palëve.

Me shkresën nr. 4223/29, datë 06.02.2023, të Administratorit S.S, drejtuar A.M, Administrator i FSHMT, A.T, Administrator i FMD, A.B, Administrator i Fakultetit të Mjekësisë, sipas së cilës autorizohet kryerja e pagesave pranë Degës së Thesarit Tiranë, për secilën njësi sipas vlerave përkatëse të përcaktuara në kontratë.

Sipas këtyre shkresave kërkohet që të merren masa për zbatimin e kontratës brenda ditës së shkresës, si dhe moszbatimi i afateve të urdhëruara i ngarkon me përgjegjësi dhe do të shoqërohen me masa administrative.

Bashkëlidhur është **amendim kontrate nr.4223/27**, datë 30.01.2023, ku afati nga 30 ditë është bërë **40 ditë kalendarike** nga nënshkrimi i kontratës.

Gjithashtu është bërë **amendim tjetër kontrate, nr.4223/31**, datë 15.02.2023, ku afati është bërë **55 ditë kalendarike** nga dita e nënshkrimit të kontratës.

Ky amendim kontrate është përcjellë me shkresën nr.4223/33, datë 21.02.2023, A.B, Administrator i Fakultetit të Mjeksisë dhe për dijeni Xh. D., Dekan i FM dhe A.G, Rektor i UM. Nga ana e kontraktorit, K, me shkresën e protokolluar me nr. 4223/30, datë 08.02.2023, bëhet me dije *se afati i kontratës ka përfunduar, dhe FM nuk ka qenë bashkëpunues për të përmbushur detyrimet kontraktuale. Vë në dijeni se janë në pritje të zgjidhjes së problematikës.*

Me shkresën nr. 4223/34, datë 22.02.2023, është përcjellë informacion në APP me objekt: “Përcillet informacion për problematikën e hasura në zbatimin e kontratave”.

Në fletën shoqëruese të praktikës datë 15.02.2023 nga ana e Administratores S.S është vënë shënimi: “Të zgjatet kontrata me OE për 15 ditë për arsye të problematikës së krijuar nga FM dhe me qëllim shmangien e penalteteve që do të kishte UMT për moszbatimin e kontratës.

Me shkresën nr. 2925/56, datë 08.02.2023, me lëndë “Mbi zbatimin e afateve të urdhëruara” të Administratorit të UM, S.S, me objekt: “Mbi zbatimin e afateve të urdhëruara”, drejtuar A.B, Administrator i FM, kërkohet: “Të merren masa për zbatimin në afat të kontratës. Moszbatimi i afateve të urdhëruara ju ngarkon me përgjegjësi direkte dhe do të shoqërohen me masa administrative”.

Nga ana e FM akoma nuk është bërë marrja në dorëzim e mallrave duke e lënë kontratën dhe amendimet e saj të pazbatuara.

Si konkluzion kjo procedurë ka filluar më 23.11.2022 dhe deri në mbajtjen e këtij konstatimi nuk ka përfunduar, pra 9 muaj, për të cilën mban përgjegjësi ish Administratorja e UMT S.S e cila ka lidhur kontratë në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të LPP dhe të buxhetit.

6- Procedura e prokurimit me objekt: “Prodhim dhe printim diplomash për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, me këto të dhëna:

Urdhër Prokurimi nr. 118, datë 12.07.2022	NJHDT: – L.K, E.H, P.L	KVO , nr. 119, 12.07.2022 E.V, F.Z, E.D. Ndryshuar nr. 176, 15.09.2022 E.D me M.C	
Lloji i Procedurës “Procedurë e hapur e thjeshtuar, mallra”			
Fondi Limit 1,580,419 lekë	OE fitues: “T” SHPK	Diferenca me fondin limit 664,241 lekë	
Burimi Financimit: Vetëfinancim 166,545 lekë Buxheti i Shtetit 1,413,874 lekë	Oferta fituese 916,178 lekë	Operatorët Ekonomikë - Pjesëmarrës në tender 5	
Data e hapjes së tenderit 09/01/2023		Ankesa në KPP janë 2 nga OE “T” SHPK lidhur me skualifikimin.	
Ankimime: PO	S`ka asistence nga APP për DST		
Lidhja e Kontratës 18847/68, datë 25.01.2023	Vlera e kontratës 1,099,413.6 lekë	Afati 15 ditë pune nga nënshkrimi i kontratës	Pa likuiduar
Titullari i AK S.S			

Nevojat për dokumentacion specifik, diploma për vitin 2022, nga ana e FM janë bërë me shkresën nr. 2902 Prot., datë 29.12.2021, firmosur nga E. D., Kryesekretare nga Zv. Dekani dhe shkresa me nr. 734 Prot., datë 14.04.2022 firmosur nga Prof. Dr. A. Ç.

Nga ana e FMD nevojat për diploma për vitin 2022 kanë ardhur nëpërmjet shkresës nr. 348 Prot., datë 08.06.2022 të firmosur nga A.T, administratore.

Nga ana e FSHMT nevojat për diploma për vitin 2022 kanë ardhur nëpërmjet shkresës nr. 815/5 Prot., datë 28.06.2022 të firmosur nga A.M, administratore.

Me urdhërin nr.104, datë 29.06.2022 *“Për përlllogaritjen e fondit limit për realizimin e procedurës së prokurimit me objekt “Prodhim dhe printim diplomash për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”*, është ngritur grupi i punës i përbërë nga L.K, A.L dhe D.S.

Me procesverbalin nr.1884/2 Prot., datë 28.06.2022, grupi i punës ka vendosur t’i dërgojë ftesë OE të cilët kanë realizuar kontrata të ngjashme në prokurime të ngjashme 7 OE, ftesa e cila mban numrin nr.1884/3 Prot., datë 28.06.2022.

Operatorët ekonomikë të cilëve ju është dërguar Ftesa për Ofertë janë:

- “F.” SHPK, i cili ka paraqitur ofertën e tij protokolluar me nr. 1884/5 Prot., datë 04.07.2022; “A.P” SHPK; “Shtepia Botuese Shtypshkronja M.a” SHPK; “L.H.” p.f, cili ka paraqitur ofertën e tij protokolluar me nr. 1884/6 Prot., datë 05.07.2022; “M.” SHPK; “R. & B.” SHPK; “S. P.” SHPK, i cili ka paraqitur ofertën e tij protokolluar me nr. 1884/4 Prot. datë 01.07.2022.

Grupi i punës ka përlllogaritur fondin limit me procesverbalin nr. 1884/7 Prot., datë 06.07.2022, ku vlera e fondit limit fillestare është 1,671,537 lekë pa TVSH. Më pas grupi i punës i është drejtuar me e-mail Fakulteteve për të rikonfirmuar sasinë. Pas konfirmimeve fondi limit përfundimtar mbajtur me procesverbalin me nr. 1884/9 Prot., datë 12.07.2022 është 1,580,419 lekë pa TVSH.

Hartimi i DT: Nga ana e NJHDT është mbajtur procesverbali i argumentimit nr. 1884/13 Prot., datë 13.07.2022, *“Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim”*. Nga procesverbali i mbajtur konstatohet se mungon argumentimi i detajuar teknik i kriterëve si më poshtë:

Në DT është kërkuar: OE duhet të disponojë makineri shtypi “OFFSET”, minimalisht 2 ngjyrësh.

OE duhet të disponojë makineri për shtypin e varakut të nxehtë.

➤ Lidhur me disponimin e makinerive nga ana e AK nuk është paraqitur argumentimi teknik lidhur me domosdoshmërinë e këtyre pajisjeve gjatë procesit të prodhimit sipas specifikimeve teknike që kërkohet prodhimi i diplomave.

Në DT është kërkuar: Certifikatën ISO 45001:2018 mbi sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit, ose ekuivalente.

➤ kërkesë e cila nuk i shërben objektit të prokurimit.

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas të cilit:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Ngarkohet me përgjegjësi NHJDT të përbërë nga L.K, E.H dhe P.L.

Zhvillimi i procedurës së prokurimit: Procedura e prokurimit është hapur me procesverbalin pa numër protokoll, datë 25.07.2022. Janë paraqitur në sistem 5 oferta.

Janë marrë në dorëzim mostrat më datë 25.07.2022 për 2 OE përcjellë nga Sektori i Protokoll Arkivës për KVO me shkresën Nr. 1884/17 Prot., datë 25.07.2022:

- “A.P” SHPK protokolluar mostra me Nr. 1884/15 Prot., datë 25.07.2022.

- “I” SHPK protokolluar mostra me Nr. 1884/16 Prot., datë 25.07.2022.

Nga ana e KVO është mbajtur procesverbali për përllogaritjen e ofertës anomalisht të ulët nr. 1884/18 Prot., datë 25.07.2022 ku është konstatuar se oferta e OE “I” SHPK është anomalisht e ulët por nuk ka të pasqyruar përllogaritjet konkrete.

Është bërë urdhër nr. 136, datë 22.07.2022 për “Pezullimin e procedurës së prokurimit”.

OE “I” SHPK ka sjellë analizë të detajuar me argumentimet përkatëse sipas shkresës Nr. 1884/20 Prot., datë 29.07.2022.

Është bërë urdhër Nr. 139, datë 01.08.2022 për “Heqjen e pezullimit të procedurës së prokurimit”.

Është mbajtur procesverbali nr. 1884/22 Prot., datë 02.08.2022 ku është skualifikuar OE “I” SHPK dhe pse ka paraqitur një argumentim shumë të detajuar KVO e ka quajtur shpjegimin **jo bindës**.

Në këtë fazë KVO ka bërë vlerësimin me procesverbalin nr. 1884/23 Prot., datë 02.08.2023 sa më poshtë vijon:

OE	NIPTI	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
“O” SHPK	J.....E	1,190,310	Kualifikohet
“I” SHPK	L.....L	916,178	Nuk kualifikohet për ofertë anomalisht të ulët
“F” SHPK	J.....M	1,009,960	Kualifikohet dhe ren ditët i pari
“A.P” SHPK	L.....Q	1,327,376	Kualifikohet
“D.G” SHPK	L.....T	1,496,905	Nuk kualifikohet pasi sigurimi i ofertës i paraqitur është më i ulët se 2 % e vlerës së fondit limit.

Vlerësimi i ofertave: Është skualifikuar “I” SHPK me argumentimin se: “Argumenti i paraqitur nga OE “I” SHPK nuk jep garanci si dhe bindje mbi garancinë e përmbushjes së kontratës”.

OE i kualifikuar është “F” SHPK i cili ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar dhe është publikuar njoftimi paraprak i fituesit nr. 1884/25 Prot., datë 08.08.2022.

Është zëvendësuar personi përgjegjës për prokurimin L.K me D.D. me shkresën nr. 2268/4 Prot., datë 12.08.2022. Personi përgjegjës për prokurimin D. D. me memon nr. 1884/27 Prot., datë 22.08.2022 ka bërë me dije administratorin për ankesën e paraqitur në KPP nga OE “I” SHPK

Më datë **17.08.2022** KPP i ka dërguar e-mail personit përgjegjës për prokurimin ku i kërkon kryerjen e veprimeve procedurale në sistemin elektronik të ankesave. Më datë **19.08.2022** i është kthyer e-mail KPP ku i thuhet se për arsye se ankesa nuk është paraqitur pranë AK nuk mund të trajtohet pasi është në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit.

Në dosje ekziston një shkresë përcjellëse nga OE “I” SHPK, e cila është e pa protokolluar nga AK, por që mban datën **16.08.2022**. Është pezulluar procedura me urdhërin nr. 154, datë 22.08.2022. Është ngritur komisioni për shqyrtimin e ankesës me urdhërin nr. 155, datë 22.08.2022 përbërë nga E.H (kryetar), H.F, R.S.

Është ndryshuar komisioni për shqyrtimin e ankesës me urdhërin nr. 156, datë 23.08.2022 E.H (kryetar) me S.O për arsye shëndetësore të E.H dhe H.F me D.I për shkak të volumit që ka Drejtoria e Administrimit Akademik dhe Kurrikulës. KSHA e ngritur vendosi nëpërmjet

procesverbalit nr. 1884/32 Prot., datë 30.08.2022 të **pranojë plotësisht ankesën e OE**. Përgjigja i është bërë me dije OE dhe KPP me shkresën nr. 1884/34 Prot., datë 01.09.2022.

Me **Vendimin e KPP**, nr. 860/2022, datë 07.09.2022 ka vendosur të mbyll çështjen e paraqitur nga OE "I" SHPK dhe është lejuar AK të vijojë me hapat e tjerë.

Është bërë heqja e procedurës nga pezullimi me urdhërin nr. 175, datë 15.09.2022.

Është bërë ndryshimi i Urdhrit nr. 119, datë 12.07.2022 me Urdhërin nr. 176, datë 15.09.2022 ku është zëvendësuar E.D me M.C.

Është bërë rivlerësimi me procesverbalin nr. 1884/38 Prot., datë 16.09.2022 (në sistem më datë 19.09.2022) si më poshtë:

OE	NIPTI	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
"O" SHPK	J.....E	1,190,310	Kualifikohet
"I" SHPK	L.....L	916,178	Kualifikohet
"F" SHPK	J.....M	1,009,960	Kualifikohet
"A.P" SHPK	L.....Q	1,327,376	Kualifikohet
"D.G" SHPK	L.....t	1,496,905	Nuk Kualifikohet

Me datë 19.09.2022 i është kërkuar OE "I" SHPK, dorëzimi i dokumentacionit brenda 5 ditëve. OE ka dorëzuar dokumentacionin më datë 20.09.2022.

KVO me shkresën nr. 1884/40 Prot., datë 22.09.2022 i kanë kërkuar personit përgjegjës për prokurimin interpretim ligjor lidhur me dokumentat e paraqitura nga OE "I" SHPK për arsye se dokumenti i pagesës së energjisë elektrike është jo original dhe jo i noterizuar, 371 faqe dokumentacionin janë me vulë noteri jo të lidhura si dhe në një akt notarial Nr. Rep 7409, datë 19.09.2022 citohet "*dokumenta bashkëlidhur*" pa listuar dokumentacionin.

Për arsye se dokumentat nuk janë dorëzuar siç kërkohet në dokumentat e tenderit, për arsye se vërtetimi i pagesës së energjisë elektrike është jo original dhe jo i noterizuar, KVO me procesverbalin nr. 1884/41 prot., datë 26.09.2022 ka vendosur skualifikimin e OE "I" SHPK

KVO ka konceptuar shkresën e firmosur nga administratori me nr. 1884/43 Prot., datë 27.09.2022 e cila i drejtohet KPP ku e bënë me dije lidhur me zbatimin e vendimit, por me problematikën në dorëzimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE është bërë skualifikimi i OE. Në sistem më datë 27.09.2022 është bërë rivlerësimi duke e s`kualifikuar OE "I" SHPK për arsye se dokumentet e dorëzuara nuk janë si janë kërkuar në DST.

Është konceptuar Njoftimi i Fituesit nr. 1884/46 Prot., datë **10.10.2022** ku është njoftuar fitues "F" SHPK, por për shkak se D.D nuk ka qënë në punë për arsye shëndetësore nga data 06.10.2022 e në vijim është bërë publikimi i njoftimit të fituesit më datë **21.10.2022**.

Është paraqitur ankesa e OE "I" SHPK më datë 24.10.2022 lidhur me s`kualifikimin si dhe me shkresën nr. 1884/47 Prot., datë 25.10.2022, OE ka risjellë të noterizuar dokumentacionin e vërtetimit të energjisë elektrike.

Më datë 27.10.2022 OE "F" SHPK ka paraqitur ankesë pranë AK për OE "I" SHPK dhe është pezulluar procedura me urdhërin nr. 235, datë 28.10.2022, duke u ngritur Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nr. 236, datë 28.10.2022 i përbërë nga E.H, H.F, N.D. Më datë 01.11.2022 me shkresën nr. 1884/52 Prot., administratori i është drejtuar OE "F" SHPK dhe KPP që ankesa është e pavlefshme pasi nuk është në databazën e KPP si dhe mungon mandati i pagesës. Me Vendimin nr. 1884/53 Prot., datë 02.11.2022 KSHA ka pranuar pjesërisht ankesën e OE "I" SHPK. Përgjigja i është bërë me dije OE dhe KPP me shkresën nr. 1884/55 Prot., datë 03.11.2022. Me Vendimin nr. 1310/2022, datë 30.12.2022 KPP ka vendosur të mbyll çështjen e paraqitur nga OE "I" SHPK dhe është lejuar AK të vijojë me hapat e tjerë.

Nuk është bërë heqja e procedurës nga pezullimi me urdhër.

Është bërë rivlerësimi me procesverbalin nr. 1884/66 Prot., datë 12.01.2023 si më poshtë:

OE	NIPTI	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
“O” SHPK	J.....E	1,190,310	Kualifikohet
“I” SHPK	L.....L	916,178	Kualifikohet dhe shpallet fitues
“F” SHPK	J.....M	1,009,960	Kualifikohet
“A.P” SHPK	L.....Q	1,327,376	Kualifikohet
“D.G” SHPK	L.....t	1,496,905	Nuk Kualifikohet

Është bërë njoftimi i fituesit pas ankimit me shkresën nr. 1884/67 Prot., datë 17.01.2023.

Lidhja e kontratës: AK, UMT, ka nënshkruar kontratën me nr. 1884/68 Prot., datë 25.01.2023, me objekt: *“Prodhim dhe printim diplomash për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”*, ku në nenin 5 *“Dorëzimi”* janë të mirëpërcaktuara vendet e dorëzimit dhe ndarja e mallrave për secilën njësi shpenzuese përfituese nga kjo kontratë. Afati i lëvrimin në kontratë është caktuar brenda 15 ditëve pune nga dita e nënshkrimit të kontratës mes palëve.

Kontrata nga administratori i UMT, është nënshkruar në kundërshtim me pikën 7, neni 67 i VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar citohet se: *“Organi qendror blerës ose autoriteti kontraktor, të cilit i është deleguar e drejta e prokurimit, është plotësisht përgjegjës për kryerjen e të gjithë procedurës së prokurimit, që nga njoftimi i kontratës deri te publikimi i njoftimit të shpalljes së fituesit, **ndërsa nënshkrimi i kontratës bëhet nga vetë autoriteti/et kontraktor/e përfitues/e.** Në rastin e përdorimit të marrëveshjes kuadër, procedura e prokurimit për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje bëhet nga organi qendror blerës, ndërsa procedura e minikonkurrimit për të lidhur kontratë brenda marrëveshjes kuadër bëhet nga vetë autoritetet kontraktore përfituese”*.

Për marrjen në dorëzim administratori i UMT ka ngritur urdhërin nr. 1907/31 Prot., datë 22.02.2023 (pas 12 ditëve nga hyrja në fuqi e kontratës).

Nëpërmjet shkresës me nr. 227 Prot., datë 25.01.2023 me lëndë: *“Përcillet për zbatim kontrata me nr. 1884/68 Prot., datë 25.01.2023”*, Administratori i UMT i ka përcjellë njërive shpenzuese përfituese për zbatim kontratën e cituar më sipër.

OE i shpallur fitues ka paraqitur shkresë-kërkesë pranë UMT, protokolluar me Nr. 1884/71 Prot., datë **02.02.2023** ku kërkon dorëzimin e materialeve që lidhen me dizanjin, numrin serial që do të vendoset në secilën diplomë si dhe mostrat fizike të diplomave për secilin fakultet. Këto tre elementë janë shumë të domosdoshëm në mënyrë që OE fitues të realizojë prodhimin e diplomave sipak kërkesave specifike që ka secili fakultet. OE fitues cilëson në kërkesën e bërë se: *“Rrjedhimisht, kjo kontratë do të duhet të konsiderohet e pezulluar deri në momentin që do të kemi në dispozicion materialet”*.

Nëpërmjet shkresave nr. 1884/72 Prot., datë 03.02.2023, nr. 1884/73 Prot., datë 03.02.2023 si dhe nr. 1884/74 Prot., datë 03.02.2023 me lëndë *“Të merren masa për vënien në dispozicion të materialeve të nevojshme për prodhimin e diplomave të studentëve”* Administratori i UMT i është drejtuar të tre fakulteteve për zbatimin e këtij detyrimi ligjor që ndikon në zbatimin e kontratës.

FMD dhe **FSHMT** kanë paraqitur shkresat me nr. 182/1 Prot., datë 08.02.2023, protokolluar pranë UMT me nr. 1884/75 Prot., datë 08.02.2023 me lëndë *“Dërgim informacioni”* si dhe me nr. 348/3 Prot., datë 08.02.2023, protokolluar pranë UMT me nr. 1884/76 Prot., datë 09.02.2023 me lëndë *“Kthim përgjigje shkresës nr. 1884/74 prot., datë 03.02.2023”*, ku dërgojnë materialin e nevojshëm për zbatimin e kontratës së nënshkruar.

Nga ana e FM nuk ka ardhur asnjë përgjigje referuar kërkesës së bërë, për këtë arsye i është dërguar e-mail nga Administratori i UMT, më datë 14.02.2023, ku i paraqiten të gjithë kërkesat që duhet të plotësohen në mënyrë që të mos pengohet vijimi i zbatimit të kontratës. Nga FM nuk ka asnjë përgjigje as të e-mailit të dërguar.

OE fitues ka paraqitur sërish shkresë – kërkesë, protokolluar pranë UMT me nr. 1884/77 Prot., datë 18.02.2023, ku shprehet se: “...duke marr në konsideratë faktin se ende sot nuk kemi në dispozicion materialet e plota për fillimin e zbatimit të kontratës, e vlerësojmë të domosdoshëm shtyrjen e afatit të kontratës me 15 ditë nga dita e sotme”, për këtë arsye është bërë amendimi i kontratës me nr. 1884/78 Prot., datë 16.02.2023 lidhur me afatin e dorëzimit të mallit i cili ndryshon në brenda 30 ditëve pune nga dita e nënshkrimit të kontratës mes palëve.

Nga ana e FSHMT janë marrë në dorëzim diplomat por nuk janë likjuar.

Nga ana e FM dhe FMD nuk është bërë marrja në dorëzim.

Si konkluzion kjo procedurë ka filluar më 12.07.2022 dhe deri në mbajtjen e këtij konstatimi nuk ka përfunduar, pra 1 vit, për të cilën mban përgjegjësi ish Administratorja e UMT S.S e cila ka lidhur kontratë në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të LPP dhe të buxhetit.

1- Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur komenti me shkresë nr. 1421/12, datë 09.10.2023, (komenti me numër prot të UMT 2915/1, datë 09.10.2023, 2912/5, datë 10.10.2023) e protokolluar në KLSH me nr. 401/6, datë 10.10.2023, “Mbi observacionet e akt konstatimeve” përkatësisht nga **E.H dhe L.K.**

Pretendimi i subjektit: Subjekti jep arsyetimin e vendosjes së kriterëve të veçanta për kualifikim në lidhje me maqinerinë e shtypit .

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Ju sqarojmë se gjithë arsyetimin që e keni vendosur në komentin e paraqitur duhej ta kishit vendosur tek procesverbali i argumentimit të kriterëve të veçanta për kualifikim. Ky procesverbal është gjurme auditimi i cili bëhet ojesë e dosjes së procedurës së prokurimit.

2- Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur komenti me shkresë nr. 1421/12, datë 09.10.2023, (numri i komentit 2915/4, datë 10.10.2023) e protokolluar në KLSH me nr. 401/6, datë 10.10.2023, “Mbi observacionet e akt konstatimeve” nga **R.S.**

Pretendimi i subjektit: Unë jam specialiste finance nuk kam kualifikimin e duhur për specifikimet teknike dhe kriteret e kualifikimit. Kjo procedurë është publikuar më parë dhe dhe grupi i DT i ka marrë të mirqëna të dhënat. Publikimin e kontratës i kemi bërë sipas afateve. App nuk ka bërë asnjë kundërshtim apo sygjerim.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Komenti juaj nuk paraqet prova dhe fakte të reja nga sa trajtuar në akt konstatim.

7- Procedura e prokurimit me objekt: “Blerje pajisje stomatologjike për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, me këto të dhëna:

Urdhër Prokurimi nr. 303, datë 28.12.2022	NJHDT: – L.L, S.T, P.K	KVO, nr. 304, 28.12.2022, N.D M.C, E.T
Lloji i Procedurës “Procedurë e hapur e thjeshtuar, mallra”		Diferenca me fondin limit 109,866.7 lekë
Fondi Limit 5,239,666.7 lekë	OE fitues: “F.N.A”	
Burimi Vetëfinancim	Financimit: 5,129,800	Operatorët Ekonomikë - Pjesëmarrës në tender 1
Data e hapjes së tenderit 09/01/2023		

Ankimime: S`ka	S`ka asistence nga APP për DST	S`ka ankesë	
Lidhja e Kontratës Nr. 1907/29 Prot., datë 10.02.2023	Vlera e kontratës 6,155,760 lekë	Afati 45 ditë pune nga nënshkrimi i kontratës	Likuiduar: jo
Titullari i AK S.S			

Nevojat për paisje stomatologjike për vitin 2022, nga ana e FMD janë bërë me shkresën Nr.363 Prot., datë 16.06.2022, firmosur nga A.T, Administratore.

Me urdhërin nr.108, datë 29.06.2022 “Për përlllogaritjen e fondit limit për realizimin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje paisje stomatologjike”, është ngritur grupi i punës i përbërë nga F.Z, A.B dhe D.S.

Me procesverbalin Nr.1907/2 Prot., datë 30.06.2022, grupi i punës ka vendsur t`i dërgojë ftesë OE të cilët kanë realizuar kontrata të ngjashme në prokurime të ngjashme 9 (nëntë) OE, ftesa e cila mban numrin Nr.1907/3 Prot., datë 12.07.2022 (**Pas 12 ditëve nga përzgjedhja ju është dërguar ftesa OE**).

Operatorët ekonomikë të cilëve ju është dërguar Ftesa për Ofertë janë: “E” SHPK; “A.D” SHPK; “O.D” SHPK; “D.M.C” SHPK; “A” SHPK; “E” SHPK; “M” SHPK; “F.N.A” SHPK; “M.M” SHPK;

D.S për arsye të largimit nga puna me urdhërin nr.194, datë 30.09.2022, është zëvendësuar me P.L.

Nga data 29.06.2022 deri më datë 30.09.2022 (tre muaj) nga ana e komisionit të ngritur nuk është realizuar asnjë përlllogaritje e fondit limit.

Komisioni i ndryshuar i përbërë nga F.Z, A.B dhe P.L me procesverbalin Nr.1907/5 Prot., datë 30.09.2022, kanë vendsur t`i dërgojnë ftesë 4 OE të cilët kanë realizuar kontrata të ngjashme në prokurime të ngjashme, ftesa e cila mban numrin Nr.1907/7 Prot., datë 03.10.2022. Ftesa është dërguar shkresërisht dhe me e-mail më datë 03.10.2022.

Operatorët ekonomikë të cilëve ju është dërguar Ftesa për Ofertë janë: “E” SHPK; “O.D” SHPK; “E” SHPK dhe “F.N.A” SHPK;

Për arsye se ansjë nga operatorët e mësipërm nuk ju përgjigj Ftesës për Ofertë, Komisioni ka mbajtur procesverbalin Nr.01/1 protokolluar me Nr. 1907/8 Prot., datë 27.10.2022 për përzgjedhjen e 3 (tre) OE të cilët kanë realizuar kontrata të ngjashme në prokurime të ngjashme, ftesa e cila mban numrin Nr.1907/9 Prot., datë 28.10.2022. Ftesa është dërguar dhe me e-mail më datë 31.10.2022.

Operatorët ekonomikë të cilëve ju është dërguar Ftesa për Ofertë janë: “Medical Distribucion” SHPK; “F.U” SHPK; “M” SHPK;

Për arsye se asnjë nga operatorët e mësipërm nuk ju përgjigj Ftesës për Ofertë Komisioni ka mbajtur procesverbalin me Nr. 1907/11 Prot., datë 05.12.2022 për përzgjedhjen e 3 (tre) OE të cilët kanë realizuar kontrata të ngjashme në prokurime të ngjashme, ftesa e cila mban numrin Nr.1907/12 Prot., datë 05.12.2022. Komisioni ka zgjedhur ti drejtohet sërish OE “F.N.A” SHPK dhe pse në dy ftesa të mëparshme ai nuk ka kthyer përgjigje si dhe OE “M.M” SHPK i cili në një ftesë të mëparshme nuk i është përgjigjur Ftesës.

Operatorët ekonomikë të cilëve ju është dërguar Ftesa për Ofertë janë: “M.M” SHPK; “F.N.A” SHPK; “B.B” SHPK;

Nga Ftesa e parë më datë **30.06.2022** deri në Ftesën e katërt më datë **05.12.2022 kanë kaluar 5 muaj dhe Komisioni nuk ka marrë asnjë masë për të ndryshuar metodën e përlllogaritjes së fondit limit** pasi studimi i tregut nuk është procedura e vetme për përlllogaritjen e tij. Bazuar në

pikën 1 të nenit 76 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar .

Me procesverbalin Nr. 1907/16 Prot., datë 23.12.2022 Komisioni ka përllogaritur fondin limit bazuar në mesataren e ofertave të paraqitura. Është paraqitur ofertë nga OE “M.M” SHPK, “F.N.A” SHPK dhe “B.B” SHPK Vlera e fondit limit është 5,239,666.7 (pesë milion e dyqind e tridhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë shtatë) lekë pa TVSH.

Vlera e fondit limit ka dal pas afërsisht pas 6 muajsh nga ngritja e Komisionit nga Titullari i AK, duke shkaktuar vonesa të mëdha në vijimin e procedurës së prokurimit për të cilët ngarkohet me përgjegjësi komisioni i përbërë nga F.Z, A.B dhe P.L.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur komenti me shkresë nr. ska, datë 21.11.23, e protokolluar në KLSH me nr. 401/16, datë 01.12.2023, “Komente mbi Projekt Raportin”, nga **F.Z.**

Pretendimi i subjektit: në lidhje me vonesat për 6 muaj përllogaritjen e fondit limit

Qëndrimi i grupit të auditimit: Vlera e fondit limit ka dal pas afërsisht pas 6 muajsh nga ngritja e Komisionit nga Titullari i AK, duke shkaktuar vonesa të mëdha në vijimin e procedurës së prokurimit dhe në mospërdorimin e fondeve të institucionit e mosplotësimin e kërkesave. Për më hollësisht referojuni materialit.

Hartimi i DT: Nga ana e NJHDT është mbajtur **procesverbali i argumentimit datë 28.12.2022**, “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim”.

Zhvillimi i procedurës së prokurimit: Procedura e prokurimit është hapur me procesverbalin Nr. 1907/22 Prot., datë 09.01.2023 dhe është vlerësuar me procesverbalin Nr. 1904/23 Prot., datë 10.01.2023, sa më poshtë vijon:

OE	NIPTI	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
“F.N.A” SHPK	K.....V	5,129,800	Kualifikohet

Vlerësimi i ofertave: Ka patur vetëm 1 OE pjesëmarrës i cili është kualifikuar.

Lidhja e kontratës: Më datë 10.02.2023 është lidhur kontrata nga Rektorati i Universitetit të Mjekësisë Tiranë me nr. 1907/29 prot., me vlerë 5,129,800 lekë pa TVSH dhe 6,155,760 lekë me TVSH. Afati për dorëzimin e mallit brenda 45 ditëve pune nga dita e nëshkrimi i kontratës.

Kontrata nga Administratori i UMT, është nënshkruar në kundërshtim me pikën 7, neni 67 i VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Në nenin 5 “Dorëzimi” është mirë përcaktuar vendi i dorëzimit në Fakultetin e Mjekësisë Dentare. Administratori i UMT ka ngritur Urdhrin nr. 46, datë 22.02.2023, nr. 1907/31 Prot., datë 22.02.2023 “Për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të mallrave, furnizuar sipas procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje pajisje stomatologjike për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”. Nëpërmjet shkresës me nr. 1907/34 Prot., datë 23.02.2023 me lëndë: “Njoftim Urdhri”, Administratori i UMT i ka përcjellë FMD dhe komisionit të caktuar për marrjen në dorëzim të mallrave për zbatim kontratën e cituar më sipër.

OE i shpallur fitues ka paraqitur e-mail si dhe shkresën me Nr.1907/36 Prot., datë 07.04.2023, ku kërkon informacion për datën, vendin dhe personin e kontaktit për të proceduar me dorëzimin.

Nga ana e FMD nuk janë marrë në dorëzim mallrat duke e lënë kontratën të pazbatuar.

Si konkluzion kjo procedurë ka filluar më 28.12.2022 dhe deri në mbajtjen e këtij konstatimi nuk ka përfunduar, pra 8 muaj, për të cilën mban përgjegjësi ish

Administratorja e UMT S.S e cila ka lidhur kontratë në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të LPP dhe të buxhetit.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur komenti me shkresë nr. s`ka, datë 22.11.2023, e protokolluar në KLSH me nr. 401/14, datë 23.11.2023, “sqarime në lidhje me Projekt Raportin” nga **L.L.**

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me konstatimet e audituesve përsa i përket HDT referuar urdhërit të prokurimit nr.303, datë 28.12.2022 dhe urdhërit të prokurimit nr. 307, datë 30.12.2023, ju bëj me dije se prej datës 28.12.2022 deri më 05.01.2023, **nuk kam qenë e pranishme në punë për arsye shëndetësore**, gjithashtu më datë 05.01.2023 kam dërguar njoftim me anë të email për dorëheqje nga pozicioni sepçialistes së sektorit të prokurimeve. I bashkëngjiten këtij observacioni raportet me numër rregjistri 3701 dhe numër rregjistri 17 për paaftësi në punë për periudhën e cituar si dhe emaili për njoftimin e dorëheqjes.

Sa më sipër prej datës 28.12.2022 e në vazhdim nuk kam krye asnjë funksion për sa i përket pozicionit tim të punës si specialiste pranë Sektorit të Prokurimeve, ndaj nuk mbaj përgjegjësi për veprimet e ndërmarra nga AK, pra UMT, në lidhje me procedurat e sipërpërmendura.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Mbas shqyrtimit të fakteve të reja të paraqitura komenti juaj merret në konsideratë.

4- Procedura e prokurimit me objekt: “Vlerësimi i protezave fikse metal qeramikë të mbështetura mbi implante, për FMD”, i ndarë në lote sa vijon:

Loti I: Blerje materiale stomatologjike për projektin “Vlerësimi i protezave fikse metal qeramikë të mbështetura mbi implante” dhe

Loti II: Blerje pajisje stomatologjike për projektin “Vlerësimi i protezave fikse metal qeramikë të mbështetura mbi implante”,
me këto të dhëna:

Urdhër Prokurimi nr. 213, datë 12.10.22	NJHDT: – A.T, përfaqësuese e FMD, zv me N.D me urdhër nr.215, datë 13.10.22.	KVO , nr. 238, 31.10.2022 A.B, D.I, K.K
Lloji i Procedurës “Procedure e hapur, e thjeshtuar, mallra”	A.L, personi përgjegjës për prokurim F.L, specialist fushe	Diferenca me fondin limit 14,584 lekë.
Fondi Limit: 2,143,552 lekë Loti I: 1,978,969 lekë Loti II: 164,584 lekë.	OE fitues: Loti II “M.M” SHPK	Operatoret Ekonomike Loti I - Pjesëmarrës në tender 1 - S`kualifikuar 1
Burimi Financimit: buxheti shtetit (MAS)	Oferta fituese 150,000 lekë	Loti II - Pjesëmarrës në tender 1 - S`kualifikuar 0
Data e hapjes 14/11/2022	S`ka asistence nga APP për DST	
Ankimime: S`ka		
Titullari i AK S.S		

Anuluar, dhe riperseritur sa më poshtë vijon

Nga ku rezultoi sa vijon:

Me urdhërin nr.184, datë 23.09.2022, “Për përcaktimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit për realizimin e procedurës së prokurimit”, është ngritur grupi i punës i përbërë nga F.L, B.L dhe E.R. B.L është zëvendësuar me S.T, sipas urdhërit të Admionistratorit nr. 197, datë 03.10.22.

Grupi i punës me procesverbalin nr.2270/23, datë 03.10.22, ka vendosur realizimin e testimit të tregut për të dy lotet.

Me procesverbalin nr.2270/25, datë **04.10.2022**, ka vendosur ti dërgojë ftesë për ofertë OE që operojnë në fushën e tregtimit të materialeve paisjeve mjekësore stomatologjike, duke kontrolluar në QKB, për OE aktivë me natyrë të njëjtë me fushën objekt i procedurës së prokurimit,OE të cilët kanë realizuar kontrata të ngjashme me sukses, si dhe OE pjesmarrës në prokurime të ngjashme, me ftesën nr.2270/27, datë 04.10.22, sa vijon: S.D.A SHPK; D.M.C SHPK; C.PSHPK; O.D SHPK; F.N.A SHPK dhe E SHPK.

Nga dokumentacioni i dosjes së procedurës rezulton se ka kthyer përgjigje:

- D. M. SHPK, me nr. 2270/29, datë 06.10.22.
- S.D.A SHPK, me numër 2270/32, datë 06.10.22
- C.PSHPK, me numër 2270/33, datë 07.10.22

Nga grupi i punës me memon nr.2270/35, datë **07.10.22**, drejtuar Administratorit dhe miratuar prej tij, grupi i punës kërkon “meqenëse ofertat e dorëzuara brenda kësaj datë janë të pamjaftueshme për përlllogaritjen e fondit limit (data 06.10.22), propozojnë shtyrjen e afatit të dorëzimit/pranimit të ofertave deri në plotësimin e minimumit të nevojshëm për përlllogaritjen e fondit limit”.

- Oferte cmimi me numer 2270/37, datë 11.10.22 nga E SHPK,

Me procesverbalin nr. 2270, datë 12.10.2022 është përlllogaritur fondi limit sipas loteve.

Hartimi i DT: Nga ana e NJHDT është mbajtur procesverbali i argumentimit datë 02.11.2022, “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim”. Pavarësisht se është hartuar procesverbali i argumentimit të kritereve për NJHDT nuk i ka argumentuar këto kritere, në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 39, “Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike”, pika 4, ku është përcaktuar se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve”. E konkretisht:

Për të dy lotet është kërkuar:

“OE ofertues duhet të paraqesë çertifikatën **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, dhe nese OE ofertues është prodhues i pajisjeve mjekësore duhet te paraqesë çertifikatën **SSH EN ISO 13485:2016** “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”, ose **EN ISO 13485:2016** mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore” per tregitim të pajisjeve mjekësore në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

OE ofertues ne rastet **kur nuk është prodhues** i artikujve objekt prokurimi, **duhet të paraqesë autodeklaratë** qe furnizuesi nga i cili siguron artikujt objekt prokurimi është konform standarteve te cilesise **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose **EN ISO 13485:2016** mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”ose **SSH EN ISO 13485:2016** mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”, te vlefshme, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise”.

➤ NJHDT nuk duhet të kërkonte certifikatën **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” por **SSH EN ISO 13485:2016** “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”, ose **EN ISO 13485:2016** mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore” si në rastet nëse OE do të ishte prodhues dhe në rastet nëse do të ishte tregëtues i këtyre pajisjeve. ISO 13485:2016 specifikon kërkesat për sistemin e menaxhimit të cilësisë që duhet të zbatohet nga organizatat **që operojnë në industrinë** e pajisjeve mjekësore. Ky standard specifikon kërkesat e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë për kompanitë **aktive në projektimin, prodhimin, shitjen, instalimin dhe shërbimin e pajisjeve mjekësore**. Ky certifikim është krijuar për të gjitha bizneset që operojnë në industrinë e pajisjeve mjekësore.

Ndërsa për Lotin II: “Blerje pajisje mjekësore stomatologjike për projektin “Vlerësimi i protezave fikse metal qeramike të mbështetura mbi implante, për Fakultetin e Mjekësisë Dentare në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, **janë kërkuar:**

- OE duhet të lëshojë një deklaratë për periudhën e garancisë së mallrave që kërkohen të prokurohen nga data e dorëzimit të artikujve objekt prokurimi, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin, mirembajtjen dhe shërbimin pa pagesë, të defekteve.

- Ndërsa në specifikimet teknike është përcaktuar: **Garancia e pajisjes së bashku me asistencën teknike dhe trajnuese - 24 muaj**

- OE duhet të paraqesë deklaratë, ku deklaron se merr përsipër trajnimin e stafit mjekësor për përdorimin e pajisjes sipas specifikimeve teknike.

➤ Nuk është përcaktuar mënyra e trajnimit, sa kohë duhet të zgjasë trajnimi, nga çfarë personeli do të bëhet.

➤ Nuk ka zë më vete në preventivin e DST në lidhje me trajnimin.

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas të cilit:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

ngarkohet me përgjegjësi NHJDT të përbërë nga N.D, A.L, F.L.

Zhvillimi i procedurës së prokurimit: Procedura e prokurimit është hapur me procesverbalin Nr. 3030/8 Prot., datë 14.11.22 dhe është vlerësuar me procesverbalin Nr. 3030/9 Prot., datë 18.11.22, sa më poshtë vijon:

OE	NIPTI	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
Loti II “M.M” SHPK	L.....T	150.000	Kualifikohet dhe shpallet fituese
Loti I “M.M” SHPK	L.....T	1,887,000	S`kualifikohet, për dokumentacion jo të noterizuar.

Në këtë procedurë ka fituar oferta e vlefshme

Loti I, është anuluar dhe është rishpallur me urdhër prokurimi dhe të dhëna sa vijon:

Urdhër Prok. nr. 275, 02.12.22	NJHDT: – N.D, A.L, P.K	KVO, nr. 276, 02.12.2022 A.B, D.I, zv me P.L, K.K
Lloji i Procedurës “hapur, e thjeshtuar, mallra”		

Fondi Limit: 1,978,969 lekë	OE fitues: "M.M" SHPK	Diferenca me fondin limit 91,969 lekë.	
Burimi Financimit: buxheti shtetit (MAS)	Oferta fituese 1,887,000 lekë	Operatorët Ekonomike - Pjesëmarrës në tender 2 - S'kualifikuar 0	
Data e hapjes së tenderit 19/11/2022			
Ankimime: S`ka	S`ka asistencë nga APP për DST	S`ka ankesë	
Lidhja e Kontratës 3020/32, datë 09.01.23	Vlera e kontratës 1,917,000 lekë.	Afati 45 ditë	Likuiduar:
Titullari i AK S.S			

Zhvillimi i procedurës së prokurimit: Procedura e prokurimit është hapur me procesverbalin Nr. 3030/23 Prot., datë 19.11.22 dhe është vlerësuar me procesverbalin Nr. 3030/24 Prot., datë 21.12.22, sa më poshtë vijon:

OE	NIPTI	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
"C.P" SHPK	K.....U	1,899,000	Kualifikohet
"M.M" SHPK	L.....T	1,887,000	Kualifikohet dhe shpallet fituese

Në këtë procedurë ka fituar oferta me vlerë më të ulët e vlefshme

Lidhja e kontratës:

Për Lotin II: Me numër 3030/31, datë 05.01.23, me vlerë 180,000 lekë, me afat 45 ditë kalendarike.

Për Lotin I: Me numër 3020/32, datë 09.01.23, me vlerë 1,917,000 lekë, me afat 45 ditë kalendarike.

5- Procedura e prokurimit me objekt: "Rikonstrukcion i sallave të Rektoratit dhe çatisë së UMT", me këto të dhëna:

Urdhër Prok. nr. 307, 30.12.22	NJHDT: – L.L, A.L, P.L	KVO, nr. 308, 30.12.2022: N.D, M.C, E.T	
Lloji i procedurës "hapur, punë"	OE fitues: "P" SHPK "K" SHPK, "S" SHPK	Diferenca me fondin limit 22,649.9 lekë	
Fondi Limit 18,059,998.7 lekë	Oferta fituese 18,037,348.8 lekë	Operatorët Ekonomike - Pjesëmarrës në tender 3 - S'kualifikuar 2	
Burimi Financimit: Të ardhura dytesore.	Oferta fituese 18,037,348.8 lekë	Operatorët Ekonomike - Pjesëmarrës në tender 3 - S'kualifikuar 2	
Data e hapjes së tenderit 19/01/2023			
Ankimime: S`ka	S`ka asistencë nga APP për DST	S`ka ankesë	
Lidhja e Kontratës nr.4248/17, datë 31.03.2023,	Vlera e kontratës 21,671,998.44 lekë.	Afati 4 muaj	Likuiduar:
Titullari i AK S.S			

Nga auditimi rezultoi: Kjo procedurë prokurimi është anuluar 3 herë datat 14.10.2021 dhe 10.12.21, 11.05.2022. Herën e tretë është anuluar me vendim të KPP nr.404/2022, me nr. 713/6, datë 29.04.2022, për arsye se:

- Struktura e preventivit nuk është hartuar sipas dizpozitave ligjore të fushës së ndërtimit;
- Në preventiv në zërin paisje është tatuar dy herë në total TVSH.

Në të tre herët, si dhe në procedurën me Urdhër Prokurimi nr. 307, datë 30.12.22, në asnjë rast nuk është kryer opoenca teknike për projektin që do të prokurohet.

Zbatimi i një projekti pa opoençë teknike është në kundërshtim me: **ligjin nr. 120/2020**, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, **Neni 2, neni 6/ 1 dhe 6/2.**

Nisur nga fakti që objekti ku do të bëhet investimi është monument i kategorisë së II-të, në dosje nuk ka asnjë dokumentacion që të vërtetojë zbatimin e ligjit nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”,

Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga L.L, A.L dhe P.L si dhe Administratori S.S.

Nga ana e hartuesit të projektit “A” SHPK, me shkresën nr. s`ka, datë s`ka, e protokolluar në UMT me nr. 1513/1, datë 02.06.22, është ridërguar preventivi i rishikuar sipas kërkesës së shkresës së UMT nr.1513, datë 24.05.2022, në vlerën 22,294,399.7 lekë.

Në dosje ndodhen dy preventiva të ndryshëm, të cilat kanë ndryshime nga njëri tjetri, e konkretisht:

- njëri bashkëlidhur shkresës përcjellëse firmosur nga administratori N.C i cili ka firmosur edhe preventivin, i cili mban datën 01.06.22, me fond limit 18,576,994 lekë;

Preventivi i sjellë nga ana e hartuesit të projektit “A” SHPK:

a-, nuk janë punime hidroizolim tarrace, 11 zëra; Punime rrufepritësi në 9 zëra.

b- kanë kapitullin mobile për sallën e konferencave 4 zëra dhe salla për adaptim zyre 12 zëra.

Si dhe një preventiv i hartuar si përmbledhje e tre preventivave:

1- Preventivi i zbatimit të objektit “Rikonstruksioni i sallave dhe catisë”, i hartuar nga OE “A” SHPK, të bërë në vitin 2019;

2- Preventivi i zbatimit të objektit “Punime h/izolim tarace dhe punime rrufepritësi”, të hartuar nga specialistët e Sektorit të Shërbimeve dhe Investimeve;

3- Preventivi i zbatimit të punimeve të objektit “Furnizim dhe vendosje të sistemit të sinjalizimit dhe mbrojtjen nga zjarri për Rektoratin e UMT”, të hartuar nga OE “F”, SHPK, pjesa e katit të parë dhe një pjesë e ambientit teknik.

Nga auditimi rezultoi se:

Nuk ka një dokument që të vërtetojë se çfarë zërash janë hequr nga preventivat e zbatimit të punimeve të tenderuara më parë, për të cilët është bërë dhe pagesa.

Këto pagesa sa vijon:

- Preventivi i zbatimit të objektit “Rikonstruksioni i sallave dhe catisë”, i hartuar nga OE “A” SHPK, të bërë në vitin 2019, në shumën **797,400 lekë** me TVSH, me urdhër shpenzimi nr.195, datë 25.10.2019;

- Preventivi i zbatimit të punimeve të objektit “Furnizim dhe vendosje të sistemit të sinjalizimit dhe mbrojtjen nga zjarri për Rektoratin e UMT”, të hartuar nga OE “F” SHPK, pjesa e katit të parë dhe një pjesë e ambientit teknik, në shumën **117,600 lekë** me TVSH me urdhër shpenzimin nr.201, datë 10.12.2020;

duke rezultuar pagesa me efekt negativ, pasi detyrat e projektimit të prokuruar kanë dalë pa efektivitet në shumën totale 915,000 lekë.

Nuk ka asnjë urdhër Titullari për bashkimin e këtyre preventivave, për zërat e hequr apo të shtuar.

Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi ish shefi i sektorit të shërbimeve F.Z. (Për të cilin pavarëisht se u kërkuar disa herë për sqarime nëpërmjet UMT, nuk u paraqit për të dhënë sqarimet e mundshme të nevojshme) dhe Administratori i UMT S.S.

Për projektin dhe preventivin për punimet e h/izolim tarace dhe punime rrufepritësi, rezulton të jenë kryer nga Drejtoria e shërbimeve. Nga auditimi rezulton se projekti **nuk shqërohet nga licencat e projektuesve me kategoritë përkatëse.** Personat përgjegjës për realizimin e projektit

duhet të jenë të licencuar sipas kategorive përkatëse të punimeve që do të kryhen, brenda afatit të vlefshmërisë. Për veprimet e mësipërme, që bien në kundërshtim me VKM nr. 759, datë 12.11.2014, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrjnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, e cila ka miratuar Rregulloren “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe subjekte juridike që do të ushtrjnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, neni 16 “Licenca – kategoritë e punimeve”, pika 1.

ngarkohen me përgjegjësi grupi i punës i përbërë nga F.X.

Nuk ka dokument se kush ja ka dhënë njësisë së prokurimit dokumentacionin sa vijon:

- **Preventivin përfundimtar të hedhur në procedurë në të cilin:**

a- Kapitulli II “furnizim dhe vendosje të sistemit të sinjalizimit dhe mbrojtjen nga zjarri , nënkapitujt A, “Punime për katin e bodrumit”, “Makineri e paisje”, : Sistemi i sinjalizimit dhe mbrojtjes nga zjarri”, “Furniaim e paisje elektrike”,

Nënkapitulli B, “punime për katin përdhe”, Kapitulli, “Sistemi i sinjalizimit dhe i mbrojtjes nga zjarri”, kapitulli E2, “Furnizim paisje elektrike”,

b- Kapitulli II, “Makineri e paisje”, të punimeve elektrike kati bodrum.

➤ **Janë hedhur me sasinë zero (0).**

- **Specifikimet teknike që gjenden ne SPE**, janë të projektuesit “A” SHPK, të firmosura nga N.C, dhe janë për:

a- Mobilim (tavolinë pune, karrike e poltrona të llojeve të ndryshme, dollap, rafte, etazhere, komodina, grila etj.

b- Çatia;

c- Instalimet elektrike

d- Sistemi i alarmit të zjarrit;

e- Sistemi i kamerave CCTV.

Për të cilat në preventiv nuk janë mobilimi, dhe sistemi i kamera CCTV ndërsa sistemi i alarmit të zjarrit është në preventiv me 0 lekë, etj.

Sa më sipër trajtuar rezulton se: Preventivi dhe specifikimet teknike, janë të paplota, me mangësi dhe jo koherente me njëra tjetrën.

Autoriteti kontraktor duhet të administronte të gjithë dokumentacionin për procedurën prokurimit, duke filluar nga planifikimi i saj. Nga ana e NJHDT duhet të ishin lënë gjurmë auditimi me procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurën që nga fillimi i saj.

Veprime në kundërshtim me:

Ligjin nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, neni 38, “specifikimet teknike: të, VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”:

Neni 2, “Dokumentimi i procesit”;

Neni 15, “Përmbajtja e dokumenteve standarde të tenderit”;

Neni 24, “Udhëzimet për ofertuesit/kandidatët”;

Neni 39, “Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike”;

Hartimi i DT: Nga ana e NJHDT është mbajtur procesverbali i argumentimit datë s`ka, “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim”.

➤ Në këtë procesverbal është kërkuar paraqitja e dokumentacionit ligjor administrativ dhe jo me vetdeklarim, kërkesë kjo e ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, neni 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, në të cilin kërkohet:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

5. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë:

a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit kontraktor duhet të jenë në origjinal ose kopje të noterizuara të tyre;

b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

Rregulla të posaçme për këtë pikë parashikohen në rregullat e prokurimit publik”.

Dhe neni 26, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, i VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në të cilin është përcaktuar se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. *Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:*

a) *operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*

b) *operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

c) *personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

ç) *operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;*

d) *operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;*

dh) *operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve⁴ të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;*

e) *operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;*

ë) *operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;*

f) *operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;*

⁴ Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.”.

Sa trajtuar ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Hartimit të DT, e përbërë nga L.L, A.L, P.L

➤ Pavarësisht se është hartuar procesverbali i argumentimit të kriterëve për NJHDT nuk i ka argumentuar këto kriterë, në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 4, ku është përcaktuar se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”. E konkretisht:

Në DT është kërkuar: Licenca Profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

- NP – 2 A Ndërtime civile dhe industriale;
- NP- 3 – A Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada;
- N.S -1 - A Punime për prishjen e ndërtimeve;
- N.S-2 - A Impiante hidro-termosantare dhe mirëmbajtja e tyre;
- N.S-4 - A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese;
- N.S - 13 – A Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni;
- N.S- 14 - A Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.

➤ **Nga ana e NJHDT janë kërkuar kategoritë NP2 dhe NP3. Sa më sipër jemi në rastin e rikonstruksionit dhe nuk duhej të ishte kërkuar kategoria NP2. Në kuptim të VKM nr.42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, kategoria NP2 dhe NP3 është për sa vijon:**

N.P. 2 Ndërtime civile e industriale Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadione, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të parandëruar, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse.

N.P. 3 Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim,

konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

Emërtimi i licensës N.S-2 - A është vënë jo i plotë, duhej të ishte: “Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre”.

➤ **Nga ana e NJHDT** nuk ka argumentim të licensave të punimeve me volumin punimesh në vlerë, sipas VKM nr.629, datë 15.7.2015 "Per miratimin e manualeve teknike te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre".

Në DT është përcaktuar se: OE duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe **të deklaroje se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera.**

➤ kërkesë e përcaktuar në kundërshtim me kreun I, pika 2.1 të UKM nr.2, datë 13.05.2005, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit, ku parashikohet se për punime deri në 30 milion lekë nuk është e detyrueshme qëndrimi i drejtuesit teknik në kantier gjatë gjithë periudhës së punimeve.

OE, duhet te kete si pjese te stafit te tij ne listpagesa staf teknik si me poshte:

Në DT është kërkuar që: OE duhet të disponojë:

- **Arkitekt, 1 dhe 1 Arkitekt Restaurator**

- Inxhinier Ndertimi, 1;

- Inxhinier Mekanik, 1;

- Inxhinier Elektrik, 1;

➤ Nuk është argumentuar nevoja e këtij stafi inxhinierësh me volumin e punimeve bazuar në VKM Nr.629, datë 15.7.2015 "Per miratimin e manualeve teknike te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre".

➤ **Në lidhje me kërkesën për arkitekt dhe arkitekt restaurator, sqarojmë se** në dokumentet e procedurës së prokurimit autoriteti kontraktor ka publikuar njëherazi “preventivin e punimeve”, “relacionin teknik”, “specifikimet teknike”, “grafikun e punimeve” dhe “projektin e zbatimit”, duke i vënë në dispozicion, informacionin operatorëve ekonomikë pjesëmarrës mbi projektin të cilët këto të fundit do të zbatojnë në rast të fitimit të kontratës. Disponueshmëria si pjesë e stafit teknik të një arkitekti në fazën e zbatimit të punimeve, ku ndër të tjera autoriteti kontraktor ka kërkuar referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit pjesë të stafit teknik, inxhinierët, si ndërtimi, mekanik dhe elektrik, shkon përtej synimit të autoritetit kontraktor dhe njëherazi nuk është në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës. Disponueshmëria e një arkitekti referuar natyrës së punimeve dhe duke marrë në konsideratë faktin se autoriteti kontraktor ka parashikuar në mënyrë të detajuar projektin e zbatimit, specifikimet teknike, nuk shfaqet e nevojshme në proporcion me natyrën dhe volumin e punimeve.

Në DT është kërkuar që: Duke vlerësuar llojin, volumet e punimeve dhe afatin e zbatimit të punimeve, të përcaktuara nga projektuesit për këtë objekt, OE pjesëmarrës, për kryerjen e këtij Investimi duhet të ketë një punësim mesatar jo më të vogël se **50 punonjës** me kohë të plotë, për periudhën **3 muajt e fundit nga data e hapjes së prokurimit.**

➤ Nuk është argumentuar nevoja e e një punësimi mesatar **jo më të vogël se 50 punonjës**, me volumin e punimeve bazuar në VKM Nr.629, datë 15.7.2015 "Per miratimin e manualeve teknike te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre" dhe për një fond limit prej **18,059,998 lekë.**

Në DT është kërkuar që: Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e ligjit nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe VKM nr.

312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij I (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë").

➤ Kërkesë jo në përputhje me nenin 7 dhe 38 të ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 "Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë", i ndryshuar si dhe referuar rregullave të prokurimit publik dhe legjislacionit të fushës përkatëse, kërkesa e autoritetit kontraktor që punonjësit për sigurimin teknik dhe mbrojtjen e shëndetit në punë të figurojnë në listë pagesa, ta kenë të gjithë OE pjesë e një BOE si dhe të kenë dëshmitë përkatëse, është një kërkesë e ekzagjeruar dhe aspak në përputhje me ligjin nr. 10237, datë 18.02.2010 "Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë", i ndryshuar.

Në DT është kërkuar: OE pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre të punësuar, me kohë të plotë / jo të plotë: 1 Ekspert MNZ,i certifikuar, vertetuar me kontratë pune (të vlefshme për të paktën periudhën e zbatimit të Kontratës).

➤ Kjo kërkesë është e tejkualuar e LPP pasi punimet për MNZ janë tejkualuar njëherë gjatë procesit të studimit dhe projektimit, nëpërmjet hartimit të preventivit, specifikimeve teknike, projektit dhe relacionit teknik të objektit. Garantimi i realizimit të objektit të kontratës përmbushet nëpërmjet disponimit nga ofertuesi i kategorisë respektive të licensës profesionale NS2 për mbrojtjen nga zjarri.

Në DT është kërkuar: Të pakën 1 punonjës të certifikuar për sigurimin teknik ISO 17024:2012 nga një organ i akredituar nga DPA.

➤ Theksojme se kjo kërkesë është e pa argumentuar pasi kjo lloj certifikate i jepet organizmave që operojnë në fushën e certifikimit të personelit dhe e ka emërtimin: "Vlerësimi i konformitetit - Kërkesa të përgjithshme për trupat që kryejnë certifikim personeli".

Në DT është kërkuar: Të paktën 1 specialist për testimin e performancës së produkteve të ndërtimit të certifikuar nga institucioni shtetëror.

➤ Kjo kërkesë është jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9290, datë 7.10.2004 "Për produktet e ndërtimit" i ndryshuar, nenet:

Neni 3 Përkufizime

12. "Organ certifikimi" është organi që vërteton konformitetin e produkteve të ndërtimit ose të një sistemi, për mbikqyrjen dhe kontrollin e prodhimit.

13. "Organ inspektimi" është organi që vlerëson dhe rekomandon metodat e kontrollit të cilësisë e të seleksionimit të produkteve të ndërtimit, të prodhuara dhe të përdorura nga prodhuesi.

14. "Laborator testimi" është organi që mat, ekzaminon, teston, kalibron ose përcakton karakteristikat apo cilësinë e materialeve a të produkteve të ndërtimit.

Neni 8 Vlerësimi i konformitetit

Kur produkti i ndërtimit nuk i plotëson, tërësisht ose pjesërisht, kërkesat e nenit 6 apo të nenit 7, hidhet në treg vetëm nëse prodhuesi zbaton procedurat e vlerësimit të konformitetit, të përcaktuara në pikën 1 të nenit 17 të këtij ligji. Në këtë rast, deklarimi i konformitetit bazohet në testin fillestar të produktit, kryer nga një laborator i miratuar testimi.

Neni 19 Përgjegjësia e organit të certifikimit

1. Prodhues i materialeve të ndërtimit mund të angazhojë një organ certifikimi në procedurat e vlerësimit të konformitetit vetëm nëse ky organ ka autorizim, që vërteton aftësinë dhe përgjegjësinë e nevojshme për kryerjen e certifikimit të konformitetit, me rregullat dhe

proçedurat e caktuara. Produktet, të cilat janë brënda përgjegjësisë të organit të certifikimit, cilësohen në autorizim.

2. Detyrat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni kryhen nga organi i certifikimit, i cili mund t'ia caktojë një ose më shumë nga këto detyra edhe organeve të inspektimit ose laboratorëve të testimit.

Në DT është kërkuar: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Eskavator goma 0.25 m3	copë 1
Kamioncina deri 3.5 Ton	copë 2
Kamion 10-15 Ton	copë 2
Fadrome me goma	copë 1
Autobot uji	copë 1
Pompe suvatimi	copë 2
Matrapik	copë 1
Gjenerator 0.4 kV, me fuqi jo më pak se 10 kW	copë 1
Saldatrice	copë 1
Vibrator thellesie	copë 1
Autobetonierë 500 liter	copë 1
Auto veteshkarkues	copë 1
Autovinc 5 ton	copë 1

➤ Nga ana e NJHDT nuk është argumentuar numri i mjeteve e paisjeve me volumin e punimeve, sipas zbrërthimit të zërave të punimeve, bazuar në VKM nr.629, datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”;

Në DT është kërkuar: Licencë kategoria III.2. B për “Grumbullim dhe transport i mbetjeve nga ndertimet ose prishjet”, ku të jenë të përfshirë kodet 170101, 170102, 170207, 170504, 200304, 200306 të gjitha mbetjet e pa riciklueshme nga punimet e parashikuara në preventiv si: mbetjet e dherave, llumrave etj .

➤ Sa kërkuar NJHDT duhej të kishte në konsideratë faktin se OE mund të lidhte kontratë me me subjekte të cilët kanë licensë kategoria III.2.B, pasi jo të gjithë OE e kanë këtë licensë.

Në DT është kërkuar: O.E, bashkangjitur me preventivat e punimeve, duhet të paraqesë edhe analizat teknike **për të gjitha zërat e preventivit të ofertës,** bazuar në VKM nr. 514, datë 15.08.2007, me objekt “ *Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit* “

➤ Sa kërkuar është në kundërshtim me VKM nr. 664, datë 26.9.2012, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, ku pika 12, është ndryshuar: “9. Në fund të pikës 12, fjalët “... të llogaritura me programin e miratuar ...” zëvendësohen me “... **Në rastin kur zëri i punës nuk figuron në manual, institucioni u kërkon subjekteve ofertuese të paraqesin analizën teknike,** bazur në metodologjinë e përcaktuar në udhëzimin nr.2, datë 8.5.2003, të Këshillit të Ministrave, dhe të paraqitur me formatin e unifikuar. Një fotokopje të analizave të paraqitura nga subjektet ofertuese për zërin e punës, institucioni ia dërgon ministrisë, e cila e shqyrton analizën e re dhe, nëse e gjykon të drejtë, e reflekton çmimin në manualin e çmimeve të periudhës vijuese ...”.

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas të cilit:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. **Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.** Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

ngarkohet me përgjegjësi NHJDT të përbërë nga L.L, A.L dhe P.L.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur komenti me shkresë nr. s`ka, datë 22.11.2023, e protokolluar në KLSH me nr. 401/14, datë 23.11.2023, “s qarime në lidhje me Projekt Raportin” nga **L.L.**

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me konstatimet e audituesve përsa i përket HDT referuar urdhërit të prokurimit nr.303, datë 28.12.2022 dhe urdhërit të prokurimit nr. 307, datë 30.12.2023, ju bëj me dije se prej datës 28.12.2022 deri më 05.01.2023, **nuk kam qenë e pranishme në punë për arsye shëndetësore**, gjithashtu më datë 05.01.2023 kam dërguar njoftim me anë të email për dorëheqje nga pozicioni sepçialistes së sektorit të prokurimeve. I bashkëngjiten këtij observacioni raportet me numër rregjistri 3701 dhe numër rregjistri 17 për paaftësi në punë për periudhën e cituar si dhe emaili për njoftimin e dorëheqjes.

Sa më sipër prej datës 28.12.2022 e në vazhdim nuk kam krye asnjë funksion për sa i përket pozicionit tim të punës si specialiste pranë Sektorit të Prokurimeve, ndaj nuk mbaj përgjegjësi për veprimet e ndërmarra nga AK, pra UMT, në lidhje me procedurat e sipërpërmendura.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Mbas shqyrtimit të fakteve të reja të paraqitura komenti juaj merret në konsideratë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur komenti me shkresë nr. s`ka, datë 22.11.2023, e protokolluar në KLSH me nr. 401/15, datë 23.11.2023, “s qarime në lidhje me Projekt Raportin” dhe nr. 1421/22, datë 22.11.2023, e protokolluar në KLSH me , e protokolluar në KLSH me nr. 401/16, datë 01.12.2023 nga **A.L.**

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me preventivin dhe specifikimet teknike, të cilat na janë dhënë në dizpozicion prej procedurave përkatëse të prokurimit nga të cilat janë realizuar në vitin 2019, duke na garantuar që janë përpiluar dhe miratuar nga specialistë të fushës. Në shkresën e Sektorit të Shërbimeve dhe Investimeve, sqarohet gjithë procedura e ndjekur që nga vendimi i KPP për procedurën e anuluar dhe gjithë procedura e për të realizuar investimin.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Ju sqarojmë se ju nuk jepni asnjë të dhënë se kush i ka hartuar preventivat dhe specifikimet teknike dhe nga kush ju janë dhënë.

Gjithashtu sqarojmë se cdo procedurë prokurimi është dosje më vete dhe kompletohet me të gjithë dokumentacionin përkatës, përfshirë këti edhe analizën e anulimit te procedurës me parë. Kjo bazuar në VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 74, “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit” në përgjithësi dhe pika 3 dhe 4 në veçanti.

Pretendimi i subjektit: Në kuptim të nenit 82 të LPP nuk është detyrim paraqitja e këtyre dokumenteve provues dhe është lënë në diskrecionin e OE nëse ai do ta paraqesë që në fazën e parë dokumentacionin provues.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Bazuar në VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **Neni 26, Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, është përcaktuar se: 1.Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara**

nga autoritetet publike ose palë të treta, **formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.**

Sqarojmë se ju për cdo rast keni kërkuar të paraqiten dokumente nga kandidati i interesuar.

Sqarojmë në lidhje për kriteret për kualifikim se ju nuk i keni argumentuar në lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit, të trajtuara më hollësisht në akt konstatimin përkatës.

Gjithashtu ju sqarojmë se nuk keni paraqitur prova dhe fakte të reja e për rrjedhojë komenti juaj nuk merret në konsideratë. Dokumentacioni i paraqitur në komentë është audituar në periudhën e auditimit në terren.

Zhvillimi i procedurës së prokurimit: Procedura e prokurimit është hapur me procesverbalin datë 19.01.2023 dhe është vlerësuar me procesverbalin datë 23.01.2023, sa më poshtë vijon:

OE	NIPTI	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
"2" SHPK	L.....L	14,610,929	<p>S' kualifikuar pasi:</p> <ul style="list-style-type: none"> nuk e ka shoqëruar deklaratën e Drejtuesit Teknik të punimeve me dokumentacionin e kërkuar, Librezë pune, Kontratë pune e vlefshme dhe Diplomë. OE nuk ka paraqitur Kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, për të konfirmuar prezencën e stafit. OE drejtuesi teknik duhet të zotërojë nënkategorinë: Z/A/6. ka dorëzuar licencë për projektim, jo për zbatim siç është kërkuar në DST. nuk ka në stafin e tij 1 punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë". nuk ka paraqitur <u>Diplomë</u> për stafin teknik të punësuar për kryerjen e punimeve për punonjësit si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> Teknik Ndërtimi 2 (dy) Teknik Mekanik 2 (dy) Teknik Hidraulik 2 (dy) nuk ka paraqitur kontratë pune për <ul style="list-style-type: none"> 1 Ekspert M.N.Z.i certifikuar punonjes te certifikuar për sigurimin teknik ISO 17024:2012 nga nje organ i akredituar nga DPA. Specialist për testimin e performances së produkteve të ndërtimit të certifikuar nga institucioni shtetëror përkatës. OE pjesëmarrës për të dëshmuar një punonjës "Arkitekt Restaurator" nuk ka paraqitur: Diploma, Kontratë Pune, CV, Librezë Pune, Licencë. nuk ka paraqitur asnjë dokument vërtetues në lidhje me mjetet që ka në dispozicion
"E" SHPK	K.....W	0	S' kualifikuar pasi oferta ekonomike 0 lekë.
"T" SHPK "K" SHPK "S" SHPK	M.....K K.....C J.....Q	18,037,348,8	Kualifikuar dhe shpallur fitues.

Vlerësimi i ofertave:

Komisioni i vlerësimit të ofertave, me njohjen e DST, nuk ka zbatuar VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 75, “Komisioni i vlerësimit të ofertave”, pika 4, ku është përcaktuar se: “Komisioni është përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Anëtarët e komisionit duhet të zbatojnë detyrat në pavarësi të plotë. Nëse kërkohen sqarime për dokumentet e tenderit, këto merren nga njësia e prokurimit.

Në çdo rast, përgjegjësia për vlerësimin e ofertave është e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Përfundimisht, nëse Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson dhe argumenton se një ose disa kritere janë hartuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit dhe/ose legjislacionin e fushës në fuqi, ka të drejtë t’i propozojë titullarit anulimin e procedurës.

Anëtarët e komisionit nuk kryejnë asnjë veprim tjetër, përveç atyre të përcaktuara shprehimisht në këto rregulla.”.

Kjo për faktin se ka konsideruar OE “2” si jo të rregullt duke e s`kualifikuar atë, **me arsyetimin se ka sjellë vetëdeklarime** dhe jo dokumentacion vërtetues, ndërkohë bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore të prokurimit publik, (të trajtuar në fillim të procedurës nga grupi i auditimit), OE pjesmarrës në procedurë i vetëdeklarojnë.

Nga auditimi i dokumentacionit të OE “2” SHPK, rezulton se:

Auditimi i dokumentacionit të Operatori ekonomik “2” SHPK me NIPT: L.....L dhe ofertë ekonomike **14,610,929 lekë pa TVSH nuk kualifikohet sepse nuk ka plotësuar të gjitha kriteret sipas Dokumentave Standarte të Tenderit, konkretisht te kriteret e veçanta të kualifikimit:**

- **Pika 2.3.3**, Operatori ekonomik nuk e ka shoqëruar deklaratën e Drejtuesit Teknik të punimeve me dokumentacionin e kërkuar, Librezë pune , Kontratë pune e vlefshme dhe Diplomë.
- **Pika 2.3.4**, operatori ekonomik nuk ka paraqitur Kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, për të konfirmuar prezencën e stafit.
- **Pika 2.3.5** , drejtuesi teknik duhet të zotërojë nënkategorinë: **Z/A/6**. Zbatim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së projektuar. Operatori ekonomik ka dorëzuar licencë për projektim, **jo për zbatim** siç është kërkuar në DST.
- **Pika.2.3.7** Operatori/ët ekonomik nuk ka në stafin e tij 1 punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë”.
- **Pika.2.3.8** Operatori ekonomik nuk ka paraqitur Diplomë për stafin teknik të punësuar për kryerjen e punimeve për punonjësit si më poshtë:
 - Teknik Ndërtimi 2
 - Teknik Mekanik 2
 - Teknik Hidraulik 2 (dy)
- **Pika.2.3.9, operatori ekonomik nuk ka paraqitur kontratë pune për**
 - 1 (një) Ekspert M.N.Z.i certifikuar
 - punonjes te certifikuar për sigurimin teknik ISO 17024:2012 nga nje organ i akredituar nga DPA.
 - Specialist për testimin e performances së produkteve të ndërtimit të certifikuar nga institucioni shtetëror përkatës.
- **Pika 2.3.11** Operatori ekonomik pjesëmarrës për të dëshmuar një punonjës “**Arkitekt Restaurator**” **nuk ka paraqitur:** Diploma, Kontratë Pune, CV, Librezë Pune, Licencë.

• **Pika 2.3.12, Pika 2.3.12, operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokument vërtetues në lidhje me mjetet që ka në dispozicion, konkretisht për pikat a), b), c), d), e) si më poshtë vijon:**

a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

b) Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

c) Për mjetet e deklaruara që transportojnë mallra të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqitet çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme).

d) Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

e) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në nje foto te vetme mjeti dhe targa e tij.

Sa kërkuar nga ana e KVO referuar Dokumentave Standarde të Tenderit kriteret 2.3.3., 2.3.4., 2.3.7., 2.3.8., 2.3.9., 2.3.11., 2.3.12. **janë kërkuar dokumentacioni provues që në fazën e dorëzimit të ofertave** (ditën e hapjes së procedurës), nuk është përcaktuar nga Njësia e Prokurimit që këto kriteret lidhur me fuqinë punëtore dhe mjetet plotësohen me formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, në kundërshtim me germën h) dhe i), pika 2 dhe pika 6 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe pika 5/b e nenit 82 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vijuar me vlerësim bazuar në kriteret e përcaktuara nga Njësia e Prokurimit, në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 75, “Komisioni i vlerësimit të ofertave”, pika 4.

Nga auditimi rezulton se:

Lidhur me kriterin **2.3.1**, Liçenca Profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës. Operatorët ekonomik oferutes duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate.

➤ **Në SPE, është licensa për zbatim NZ.**

Lidhur kriterin **2.3.3**, Operatori ekonomik nuk e ka shoqëruar deklaratën e Drejtuesit Teknik të punimeve me dokumentacionin e kërkuar, Librezë pune, Kontratë pune e vlefshme dhe Diplomë,

➤ **ka paraqitur dokumentin** “Deklaratë përgjegjës teknik kantieri”, **ku ka deklaruar Inxhinieri A.F** si drejtues teknik, përfshirë në liçensën e shoqërisë dhe i pa angazhuar në kontrata të tjera.

Lidhur me kriterin **2.3.4**, operatori ekonomik nuk ka paraqitur Kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, për të konfirmuar prezencën e stafit,

➤ **ka paraqitur dokumentin “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”**, **ku ka deklaruar** me emra dhe profesione secilin punonjës.

Lidhur me kriterin **2.3.5**, drejtuesi teknik duhet të zotërojë nënkategorinë: **Z/A/6**. Zbatim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së projektuar. Operatori ekonomik ka dorëzuar licencë për projektim, jo për zbatim siç është kërkuar në DST,

➤ **është dorëzuar licenca SH. Z. 1 e shoqërisë “C.96” SHPK** me drejtues teknik dhe ligjor një person A. P. ku përfshihet dhe kategoria e kërkuar N-Z/A/6 Zbatim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së projektuar.

Kërkesa e DST për këtë pikë është:

2.3.1. “ Gjithashtu operatori ekonomik, duhet të zotërojë licencë profesionale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Kulturës, sipas Vendimit Nr. 792, datë 7.10.2020 ”Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të posaçme të licencimit, dokumenteve shoqëruese, nënkategorive të licencave, procedurave për dhënien, pezullimin ose revokimin, si dhe kuotizimit vjetor të licencave për ndërhyrjet në pasuritë kulturore materiale”, **si person juridik ose person fizik**, në Zbatim (Z), në veprimtarinë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, të arkitekturës/ndërtimore, për nënkategoritë si më poshtë:

Nënkategoria e licencës për **personin juridik (N-)** në zbatim (Z) në veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, në kategoritë (A) dhe (V):

N-Z/A/6. Zbatim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së projektuar, për të cilën drejtuesi teknik duhet të zotërojë nënkategorinë:

Z/A/6. Zbatim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së projektuar

Drejtuesi teknik i personit juridik të paraqitur në liçensën e shoqërisë duhet të rezultojë i siguar në listëpagesat përkatëse të sigurimeve shoqërore dhe të paraqiten si pjesë e dokumentacionit.

Ne rastin e BOE, mjafton që njeri nga pjesetaret e bashkimit të dispononjë këtë licencë.

Lidhur me kriterin **2.3.7** Operatori/ët ekonomik nuk ka në stafin e tij 1 (një) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë".

➤ **ka paraqitur dokumentin “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”**, **ku ka vetëdeklaruar punonjës Z. E.D me profesion Inxh. Elektrik** si njëkohësisht dhe "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë".

Lidhur me kriterin **2.3.8** OE nuk ka paraqitur Diplomë për stafin teknik të punësuar për kryerjen e punimeve për punonjësit si më poshtë: Teknik Ndërtimi 2; Teknik Mekanik 2; Teknik Hidraulik 2.

➤ **Është vetëdeklaruar stafi teknik i kërkuar në dokumentin “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”**.

Për kriteret **2.3.9; 2.3.11, 2.3.12:**

Lidhur me kriterin 2.3.9, operatori ekonomik nuk ka paraqitur kontratë pune për

- 1 (një) Ekspert M.N.Z.i certifikuar

- punonjës të certifikuar për sigurimin teknik ISO 17024:2012 nga një organ i akredituar nga DPA.

- Specialist për testimin e performances së produkteve të ndërtimit të certifikuar nga institucioni shtetëror përkatës.

Lidhur me kriterin 2.3.11: Operatori ekonomik pjesëmarrës për të dëshmuar një punonjës “Arkitekt Restaurator” nuk ka paraqitur: Diploma, Kontratë Pune, CV, Librezë Pune, Licencë.

Lidhur me kriterin 2.3.12, operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokument vërtetues në lidhje me mjetet që ka në dispozicion, konkretisht për pikat a), b), c), d), e) si më poshtë vijon:

f) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

g) Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

h) Për mjetet e deklaruara që transportojnë mallra të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqitet çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme).

i) Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

j) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në nje foto te vetme mjeti dhe targa e tij.

➤ **Kriteret 2.3.9; 2.3.11, 2.3.12 janë vetëdeklaruar në “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” fuqina punëtore e kërkuar dhe mjetet.**

Komisioni i vlerësimit të ofertave ka shpallur fitues BOE “T” SHPK & “K” SHPK & “S” SHPK me ofertë ekonomike 18,037,348.8 lekë, dhe ka s`kualifikuar me të padrejtë OE “2” SHPK me vlerë të ofertës 14,610,929 lekë, me një diferencë 3,426,419.80 lekë.

Duke mos konstatuar faktin se NJHDT nuk ka kërkuar vetëdeklarime por dokumentacion në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 75, “Komisioni i vlerësimit të ofertave”, pika 4.

Nga auditimi i dokumentacionit të BOE fitues rezultoi:

OE K, nuk ka paraqitur në sistem kontratë të ngjashme, O.M dokumentacioni i paraqitur për diplomën në Universitetin e Firences e ka të papërkthyer e të pa noterizuar, konkretisht:

Në zbatim të kriterit:

2.3.2. Gjithashtu operatori ekonomik, duhet të zotërojë licencë profesionale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Kulturës, sipas Vendimit Nr. 792, datë 7.10.2020 ”Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të posaçme të licencimit, dokumenteve shoqëruese, nënkategorive të licencave, procedurave për dhënien, pezullimin ose revokimin, si dhe kuotizacionit vjetor të licencave për ndërhyrjet në pasuritë kulturore materiale”, si person juridik ose person fizik, në

Zbatim (Z), në veprimtarinë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, të arkitekturës/ndërtimore, për nënkategoritë si më poshtë:

Nënkategoria e licencës për **personin juridik (N-)** në zbatim (Z) në veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, në kategoritë (A) dhe (V):

N-Z/A/6. Zbatim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së projektuar, për të cilën drejtuesi teknik duhet të zotërojë nënkategorinë:

Z/A/6. Zbatim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së projektuar

Drejtuesi teknik i personit juridik të paraqitur në licencën e shoqërisë duhet të rezultojë i siguar në listëpagesat përkatëse të sigurimeve shoqërore dhe të paraqiten si pjesë e dokumentacionit.

Ne rastin e BOE, mjafton që njeri nga pjesetaret e bashkimit të disponojë këtë licencë”.

Konkretisht në këtë rast nga ana e KVO është quajtur e rregullt që për restauratorin O. M. nuk është licenca individuale, por si subjekt i licensuar, ndërkohë në dokumentacionin e OE të s`kualifikuar në të njëjtat kushte nuk është marrë në konsideratë, duke mbajtur qëndrim me dy standarte në të njëjtën procedurë, e konkretisht dokumenti është:

Në plotësim të kërkesës

2.3.9. O.E. pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre të punësuar, me kohë të plotë / jo të plotë:

Te paken 1(nje) punonjes te certifikuar per sigurimin teknik ISO 17024:2012 nga nje organ i akredituar nga DPA vertetuar me: Kontratë pune (të vlefshme për të paktën periudhën e zbatimit të Kontratës)

Ka paraqitur dokumentacionin kontratë pune të lidhur me punonjësën F.L, me pozicion pune punonjes te certifikuar per sigurimin teknik ISO 17024:2012, dëshmi kualifikimi me titull: “Specialist MKZ”, pra jo për sigurimin teknik në punë.

OE “S” SHPK,

Dokument i vlerësuar nga KVO, (janë dokumente të skanuar të hedhur në SPE, dokument pdf me emërtimin TZ0011_S_02_DT) të paraqitura në procedurë, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, Fier, janë totalisht të palexueshëm.

OE “I .G.” SHPK, nuk plotëson kriterin “Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron **vjetore për vitet financiare (2019, 2020, 2021)**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare”.

Në dokumentacionin e paraqitur ka sjellë xhiron e realizuar për vitet 2020 dhe 2021, konkretisht:

Ndërkohë të gjithë OE pjesë e BOE, kanë deklaruar që plotësojnë specifikimet teknike të procedurës, ndërkohë që këto specifikime janë të tejkaluara të preventivit, konkretisht:

A: DEKLARATË

“Për përmbushjen e specifikimeve teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojmë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me preventivin e punimeve dhe grafikun e zbatimit të punimeve të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [X] Jo []

Në procesverbalin e vlerësimit të ofertave nr.4248/9, datë 23.01.2023, në asnjë rast nuk përmendet rasti i dokumentacionit të palexueshëm të OE “S”, si dhe as bërja e kërkesës për sqarimin e tyre, sikurse u pretendua në ballafaqim me Kryetaren e KVO. Edhe Raporti përmbledhës i miratuar nga Titullari i AK, S.S, me nr.4248/16, datë 09.03.2023, dhe i firmosur nga KVO, në asnjë rast nuk përmend dokumentacionin e OE “S” SHPK, i cili është i palexueshëm, me simbole, nuk përmend faktin që janë kërkuar sqarime OE, dhe ka sjellë dokumente të tjerë

Konkluzion:

- Preventivi i firmosur, është bashkim tre preventivash në mënyrë pjesore;
- Nuk ka oponencë teknike përpara se të hidhej në procedurë prokurimi;
- NJHDT, ka hedhur në SPE, specifikime teknike që nuk kanë lidhje me objektin e prokurimit dhe preventiv në rreth 40% të zërave me sasi 0.
- Nuk ka dokumentacion vërtetues se nga i ka marrë NJHDT specifikime teknike dhe preventivin;
- NJHDT ka argumentuar kriteret dhe ka hartuar DST, duke kërkuar dokumentacion vërtetues dhe jo me vetdeklarim kërkesë e akteve ligjore e nënligjore të LPP;
- NJHDT, ka hartuar kriteret të vecanta për kualifikim jo në lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit;
- KVO, nuk ka zbatuar aktet ligjore e nënligjore të prokurimit publik, duke mos i njohur ato;
- BOE, nuk i plotëson kriteret e vecanta për kualifikim dhe duhej të s`kualifikohej dhe jo të shpallej fitues.
- OE “2”, bazuar në aktet ligjore e nënligjore të LPP dhe kriteret e DST, i plotëson kriteret e vecanta për kualifikim.

Nga veprimet dhe mosveprimet e NJHDT dhe KVO është shpallur fitues BOE I” SHPK “K” SHPK, “S” SHPK, me vlerë të ofertës 18,037,348.8 lekë në kushtet kur nuk plotëson kriteret dhe është s`kualifikuar OE “2” SHPK, me ofertë 14,610,929 lekë ose 3,426,419.80 lekë më pak, në kushtet kur NJHDT i ka kërkuar në kundërshtim me LPP vërtetimin e kriterëve dhe KVO ka vlerësuar pa njohur aktet ligjore dhe nënligjore të LPP, duke shkaktuar dëm me efekt negativ në shumën 3,426,419.8 lekë.

Sa trajtuar ngarkohen me përgjegjësi:

**F.Z, për preventivat, NJHDT: L.L, A.L, P.L, KVO: N.D, M.C, E.T dhe Titullari i AK S.S.
Lidhja e kontratës: nr.4248/17, datë 31.03.2023.**

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur komenti me shkresë nr. 1421/12, datë 09.10.2023, (Komenti i prot në UMT me nr. 2916/4, datë 10.10.2023)e protokolluar në KLSH me nr. 401/6, datë 10.10.2023, “Mbi observacionet e akt konstatimeve” nga **N.D, M.C, E.T.**

Pretendimi i subjektit: në lidhje me pretendimin sa vijon:

a- **në lidhje me pretendimin për diplomën e O.M, ku pretendoni se OE ka dorëzuar dëshmi për njohje diplomimi, njohur nga MAS, dëshmi e cil është e vlefshme vetëm nëse shoqërohet me diplomën e huaj, që në rastin konkret është shoqëruar. Në momentin që OE ka sjellë dokumentin në formë fizike, ky dokument është paraqitur sipas formës së kërkuar në DST, konkretisht i noterizuar.**

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Ju sqarojmë se në kriteret e veçanta për kualifikim është kërkuar: 2.3.11: Operatori ekonomik pjesëmarrës për të dëshmuar një punonjës “Arkitekt Restaurator” duhet paraqitur: **Diploma**, Kontratë Pune, CV, Librezë Pune, Licencë. Gjithashtu në fund të kriterëve të veçanta është vënë shënimi që cdo dokument duhet të jetë origjinal ose fotokopje e noterizuar.

Ju vetë në koment e pranoni faktin që kur ka sjellë dokumentin diplomë në formë fizike e ka sjellë të noterizuar par jo në SPE. Ky koment nuk merret në konsideratë.

b- **në lidhje me pretendimin sa vijon:** për dokumentacionin e palexueshëm të OE “S” SHPK, ku pretendohet se kërkesa për sqarim është nga KVO është kryer nëpërmjet postës elektronike. KVO e ka dokumentuar këtë proces nëpërmjet komunikimit zyrtar elektronik me OE “S” SHPK.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Ju nuk keni zbatuar në asnjë rast kërkesat e VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pasi në asnjë procesverbal të punës së KVO e as në Raportin përmbledhës të procedurës nuk e keni përmendur një veprim të tillë, duke vepruar në kundërshtim me neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, ku përcaktohet sa vijon:

1. Kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë 20 (njëzet) ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe 15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, përveç rasteve të tjera të cilësuar ndryshe në këto rregulla.

Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, **afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve.**

2. Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe **janë të përgjegjshme/vlefshme**. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

i. “Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuar në dokumentet e tenderit;
ii. “Rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuar në dokumentet e tenderit; dhe
iii. “Mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit.

Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave **kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal**. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, **nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë.**

Aq më tepër që procedura është vlerësuar me procesverbalin datë 23.01.2023, ndërsa Kryetarja e KVO ka dërguar email tek info@ S.al, më datë 26.01.2023, ora 15 e 21 dhe kthim përgjigje është po datë 26.01.2023, ora 15 e 47 dhe 27.01.2023, ora 9 e 42, nga **ku rezulton se këto kërkesa janë bërë pas hartimit të procesverbalit të vlerësimit.**

Sa më sipër komenti juaj nuk merret në konsideratë

Ndërkohë ju nuk jepni ndonjë koment në lidhje me qëndrimin e KVO për licensën e restauratorit të K SHPK e cila nuk është personale për zbatim por është si subjekt, ndërkohë që një nga arsytet

e s`kualifikimit të “2” SHPK është se nuk ka licensë personale për zbatim, etj të trajtuara në akt konstatim dhe në këtë projekt raport.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur komenti me shkresë nr. ska, datë 21.11.2023, e protokolluar në KLSH me nr. 401/16, datë 10.10.2023, “Mbi observacionet e akt konstatimeve” nga **F.Z**

Pretendimi i subjektit: jep sqarime mbi përgatitjen e dokumentacionit teknik të procedurës.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në sa trajtoni ju nuk jepni fakte te reja përmbi cfarë është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit.

6- Procedura e prokurimit me objekt: “Blerje materiale kancelarie”, me këto të dhëna:

Urdhër Prokurimi Nr. 123, datë 15.07.2022	NJHDT: – D.S A.O D.D	KVO , nr. 124, datë 15.07..2022 F.Z,E.D, zv me L.P (nr.153, datë 19.08.22) K.R
Lloji i Procedurës së Prokurimit “e hapur e thjeshtuar mallra”		
Fondi Limit 1,855,430 lekë Për FM – 333,319 lekë; Për FMD – 199,537 lekë Për FSHMT – 689,525 lekë; Për Rektoratin – 633,049 lekë.	OE fitues: “I.O” Oferta fituese 1,156,166.22 lekë	Diferenca me fondin limit 699,263.78 lekë Operatorët Ekonomike - Pjesëmarrës në tender 3 - S`kualifikuar 0
Burimi Financimit Buxheti i shtetit 1,222,381 lekë Të ardhurat e veta 633,049 lekë	Data e hapjes së tenderit 01.08.2022	Ankimime: S`ka; S`ka asistence nga APP për DST Përgjigje Ankesës: s`ka
Lidhja e Kontratës nr. 1699/34, datë 26.09.22	Vlera e kontratës 1,387,399.5 lekë	Afati 10 ditë Likuiduar
Titullari i AK S.S		

Kërkesat:

Mungojnë në dosje kërkesat e njëjive shpenzuese.

Specifikimet teknike dhe përllogaritja e fondit limit.

Nga ana e tre fakulteteve janë paraqitur kërkesat për mallrat e nevojshëm.

Urdhëri nr. 12, datë 31.01.2022,, nga Administratori i UM, A.T, për unifikimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit për procedurat e prokurimit me objekt:

- Blerje material kancelarie;
- Blerje material pastrimi dhe dezinfektimi.

Në këtë urdhër është përcaktuar komisioni i përbërë nga

- L.K, kryetar; P.L; K.X; A.O; K.Rj.

Ky urdhër Administratori i është dërguar FM, FSHMT, FM dhe Drejtorisë së shërbimeve mbështetëse në Rektorat me shkresën nr. 246/1, datë 31.01.2022.

Urdhër nr.90, datë 09.06.2022, të Administratorit, S.S, për përllogaritjen e fondit limit dhe rishikimin e specifikimeve teknike, me grup pune L.K, D.S dhe A.O. Komisioni me procesverbalin nr.1699/2, datë 28.06.2022, ka bërë unifikimin e specifikimeve teknike. Me procesverbalin nr. 1699/3, datë 29.06.22, është bërë përzgjedhja e operatorëve ekonomik dhe janë përzgjedhur 6 OE. Si dhe me shkresën nr. 1699/4 datë 30.06.22, dhe 1699/5 datë 04.07.22, 1699/7, datë 04.07.22 drejtuar 6 OE është dërguar kërkesë për ofertë.

Hartimi i DT. Nga ana e NJHDT është mbajtur procesverbali i argumentimit datë 20.07.2022 (1699/17), “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim”, për artikujt e kërkuar.

Zhvillimi i procedurës së prokurimit: Procedura e prokurimit është hapur me procesverbalin datë 01.08.2022 dhe është vlerësuar me procesverbalin datë 04.08.2022, sa më poshtë vijon:

OE	NIPTI	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
“I.O”	J.....Q	1 156 166.22	Kualifikuar dhe shpallur fituese
M&D”	J.....N	1 334 726	Kualifikuar
“L.D”	L.....J	1 391 950	Kualifikuar

Në këtë procedurë ka fituar vlera më e ulët e vlefshme e ofruar.

Lidhja e kontratës: Me shkresën nr. 1699/28, datë 24.08.2022, dhe 1699/29, datë 24.08.22, me objekt: “njoftim për nënshkrimin e kontratës”, drejtuar administratorëve të FM, FMD, FSHMT, për lidhje kontrate.

Sigurimi i kontratës datë 05.09.2022 në shumën 138,739.95 lekë, me afat deri në përfundimin e kontratës.

Kontrata nr. 1699/34, është lidhur datë 26.09.22, me afat 10 ditë nga data e nënshkrimit.

7- Procedura e prokurimit me objekt: “Blerje tonera për njësitë shpenzuese të UMT”, me këto të dhëna:

Urdhër Prokurimi 201, datë 05.10.2022	NJHDT: – A.L, L.P F.E	KVO , nr. 203, datë 06.10.2022 S.O, M.C X.S
Procedura e Prokurimit “e hapur e thjeshtuar mallra”		
Fondi Limit 5,012,728 lekë Për FM – 1,644,864.3 lekë; Për FMD – 599,483.3 lekë Për FSHMT – 1,118,654.4 lekë; Për Rektoratin – 1,649,726 lekë.	Data e hapjes së tenderit 24/ 10/2022 OE fitues: I.O Oferta fituese 2,875,761 lekë	Diferenca me fondin limit 2,136,967 lekë Operatorët Ekonomike - Pjesëmarrës në tender 10 - S`kualifikuar 5
Burimi Financimit Buxheti i shtetit 3,363,002 lekë Të ardhurat e veta 1,649,726 lekë	Vlera e kontratës Total 3,450,913.2 lekë Afati 15 ditë	Ankimime: S`ka S`ka asistence nga APP për DST Përgjigje Ankesës: s`ka
Lidhja e Kontratës: UMT me nr.2667/23, datë 22.11.2022; FMD - 704/1, datë 14.12.2022; FSHMT - 1669/1, datë 20.12.2022; FM- 2.12.2022		
Titullari i AK S.S		

Kjo procedurë është e rihapur, pasi procedura e prokurimit e para është anuluar me vendim të KPP nr. 872/2022, datë 22.09.2022 me nr.1830/5, datë 22.09.2022.

Me shkresën nr. 2667, datë 29.09.2022 të Sektorit të prokurimeve të UMT është rikërkuar miratimi për rifillimin e procedurës, kërkesë e miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor.

Me urdhërin nr.2667/1, datë 03.10.22, është urdhëruar unifikimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e fondit limit, nga komisioni me përbërje D.D, L.P dhe F.E.

Përlllogaritja e fondit limit është bërë me procesverbalin datë 04.10.22 (2667/4); 05.10.2022 (2667/6).

Hartimi i DT: Nga ana e NJHDT është mbajtur procesverbali i argumentimit datë 06.10.2022 “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim”, për artikujt e kërkuar.

Zhvillimi i procedurës së prokurimit: Procedura e prokurimit është hapur me procesverbalin datë 07.11.2022 dhe është vlerësuar me procesverbalet datë 24.10.2022 dhe 28.10.2022, sa më poshtë vijon:

OE	NIPTI	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
A.P	L.....V	2,889,000	S`kualifikuar pasi: Nuk është dorëzuar deklaratë e plotë, në lidhje me garancinë, transportin dhe ambalazhimin e tonerave
B.E	J.....D	3,892,620	Kualifikuar
B.S	K.....V	2,975,920	Kualifikuar
C	K.....V	2,506,364	S`kualifikuar pasi: nuk ka plotësuar të gjitha kriteret sipas DST, konkretisht te kriteret e veçanta, për Kapacitetin teknik, pikën 2.3.3, nuk është dorëzuar deklaratë e plotë.
E.C	K.....A	3,098,099	S`kualifikuar pasi: oferta nuk është e vlefshme sepse nuk plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material.
I.O	J.....Q	2,875,761	Kualifikuar dhe shpallur fitues.
I	K.....M	2,955,585	Kualifikuar
L.D	L.....J	2,500,000	S`kualifikuar pasi: Për Kapacitetin teknik, pika 2.3.3, nuk është dorëzuar deklaratë e plotë
M&D	J.....N	3,637,422	Kualifikuar
R.K	L.....B	4,785,498	S`kualifikuar pasi: Shuma e gabimeve aritmetike rezultoi të jetë më e madhe se 2%.

Nga auditimi rezultoi se ka fituar oferta me vlerë më të ulët e vlefshme.

Lidhja e kontratës:

Kontrata nga UMT me nr.2667/23, datë 22.11.2022, me vlerë 1,080,000 dhe afat 15 ditë nga lidhja e kontratës.

Urdhër nr. 280/ datë 06.12.22, për ngritje e grupit të marrjes në dorëzim të mallit për Rektoratin I përbërë nga L.L, A.B dhe A.M. Nga ana e kontraktorit datë 06.12.22, e protok. Në UMT 2667/27, datë 12.20.22, është kërkuar shtyrje afati për 7 ditë deri më datë 12.12.2022. Në kartelën shoqëruese të praktikës nga Administratori S.S është vënë shënimi “Ok, miratohet kërkesa e Infosoft, të zbatohen penalitetet në kontratë”. Proceverbali i marrjes në dorëzim nr.2667/30 në Rekorat, datë 12.12.2022. Me urdhërin e brendshëm të Administratorit nr.9, datë 13.01.2022 “për përlllogaritjen e vlerës së dëmit të pagueshëm”, është ngritur komisioni me përbërje N.D, A.L dhe S.T, nga të cilët është mbajtur procesverbali nr.2667/46, datë 13.02.22, ku demi nga vonesat është caktuar në shumën 14,400 lekë.

8- Procedura e prokurimit me objekt: “Aplikimi i teknologjisë digitale në stomatologji për FMD në UMT”,

- **Loti i I-rë** “Blerje materiale stomatologjike për projektin “Aplikimi i Teknologjisë Dixhitale në Stomatologji, për Fakultetin e Mjekësisë Dentare në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”.

-**Loti i II-të** “Blerje pajisje mjekësore stomatologjike për projektin “Aplikimi i Teknologjisë Dixhitale në Stomatologji, për Fakultetin e Mjekësisë Dentare në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”.

me këto të dhëna:

Urdhër Prokurimi Nr. 291, datë 16.12.2022	NJHDT: – A.L, P.K, R.S	KVO , nr. 292, datë 16.12.2022, N.D, G.B, S.T, ndryshuar me urdhërin nr.301/27.12.22 me L.M
Procedura e Prokurimit “e hapur mallra”	Data e hapjes së tenderit 04.01.2023	
Fondi Limit 22,256,334 lekë Loti parë - 695,333 lekë Loti i dytë – 21,561,001 lekë	OE fitues: Loti I: “M.M” SHPK Loti II: “F.N.A” SHPK	Diferenca me fondin limit Loti I: 100,333 lekë Loti II: 3,641,001 lekë
Burimi Financimit Buxh	Oferta fituese	Operatorët Ekonomikë

Lidhja e Kontratës Loti I: nr.2270/105, datë 26.01.2023 Loti II: nr.2270/106, datë 26.01.2023	Loti I: 595,000 lekë Loti II: 17,920,000 lekë Vlera e kontratës Loti I: 595,000 lekë pa TVSH Loti II: 21,504,000 lekë pa TVSH	Loti I - Pjesëmarrës në tender 2 - S'kualifikuar 1 Loti II - Pjesëmarrës në tender 3 - S'kualifikuar 2
Ankimime: Ka; Ka asistence nga APP për DST, Përgjigje Ankesës: s'ka		Afati 45 Likuiduar
Titullari i AK S.S		ditë

Kjo është një procedurë prokurimi e rishpallur në SPE nga AK.

Në dosjen e procedurës së rishpallur nuk disponohen kërkesat për kryerjen e procedurës së prokurimit si dhe kush i ka sjellë dhe miratuar specifikimet teknike. Gjithashtu nuk ka të dhëna mbi përllogaritjen e fondit limit.

Hartimi i DT është bërë me procesverbalin e argumentimit datë 09.12.2022.

Me emailin datë 20.12.2022 nga ana e APP (asistenca e APP), është rekomanduar riformulimi në lidhje me deklaratën e certifikatave ISO të kërkuara si dhe sjell në vëmendje që çdo kriter dhe specifikim teknik duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish.

Nga ana e NJHDT është bërë ndryshimi nëpërmjet shtojcës datë 21.12.2022.

Ankimim për DT:

Në lidhje me DT është paraqitur ankimim në AK me nr. 2270/87, datë 27.12.2022 nga OE "Carpathia Albania" SHPK.

Në lidhje me ankimimin është pezulluar procedura me urdhërin nr.297, datë 21.12.2022 dhe është hequr pezullimi me urdhërin nr.298, datë 21.12.2022.

Ky ankimim është në lidhje me:

- Nuk janë argumentuar specifikimet teknike, kërkesë e VKM nr.285, datë 19.05.2021.
- Të hiqet specifikimi që përcakton dhe kushtëzon teknologjinë RFID pasi sot ka teknologji të tjera të avancuara. Duke kushtëzuar teknologjinë vetëm me sistemin RFID eliminohet konkurrenca e ndershme në tender.
- Për kompresorin me komprimim spiral me presion 10 bar, të hiqet version i kontrollit SIGMA CONTROL 2 pasi nuk është një specifikë e domosdoshme në një kompresor ajri.

Nga ana e KPP, e protokolluar në UMT me nr.2270/91, datë 04.01.23, në lidhje me ankimimin e OE "Carpathia Albania", i cili ka hequr dorë nga ankimimi, me vendimin nr. 1305/2022, nr. 2867/3, datë 29.12.2022, ka vendosur të përfundojë procedimin administrative dhe të lejojë AK të vazhdojë procedurën e prokurimit.

Zhvillimi i procedurës së prokurimit: Procedura e prokurimit është hapur me procesverbalin datë 04.01.2023 dhe është vlerësuar me procesverbalin datë 09.01.2023 për të dy lotet sipas tabelave, sa më poshtë vijon:

Loti I:

OE	NIPTI	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
"C.P" SHPK	K.....U	629,999	S'kualifikuar pasi: - Sigurimin e Ofertës, nuk është i vlefshëm për periudhën e percaktuar në DST (150 ditë). Ai është i vlefshëm për 143 ditë dhe nuk është në përputhje me dokumentat e tenderit - në <u>deklaratën</u> për Dorezimin e ofertave Pavarura, pika 6 nuk ka çekuar me X asnje nga opsionet e cituara sipas formularit të shtojcës 8.

“M.M” SHPK	L.....T	595,000	Kualifikuar dhe shpallur fitues
------------	---------	---------	--

Loti II:

OE	NIPTI	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
C.PSHPK	K.....U	20,900,000	<p><i>S`kualifikuar pasi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - nuk ka çekuar me X asnje nga opsionet e cituara sipas formularit te shtojces 8 dhe nuk është ne perputhje me dokumentat e tenderit. - Sigurimin e Ofertës, është paraqitur por nuk është i vlefshëm per periudhen e percaktuar ne DST (150 ditë). Ai është i vlefshëm per 149 ditë dhe nuk është ne perputhje me dokumentat e tenderit. - Vërtetimi i paraqitur me vulë elektronike, me datë 06.07.2022 është i vlefshëm deri në datë 31.12.2022. Proçedura është hapur në datë 04.01.2023 dhe dokumenti nuk vlen. - Nga ana e OE janë dorëzuar: “ Katalogët e prodhuesit në gjuhën angleze, të përkthyer, të pamarkuara “, Në katalogët e dorëzuar nga ana e O.E Paisja Nr.2 Furra sinterizuese, kristalizuese, glazuruese është paraqitur vetem me nje funksion, ate sinterizues. Mungon furra kristalizuese, glazuruese duke mos realizuar kërkesat në D.S.T. - O.E i ka sjelle certifikatat e trajnimit ne gjuhen angleze pa perkthyer dhe pa noterizuar. - tekB: DEKLARATË (Per Disponimin e punojsve dhe makinerive te nevojshme) tek ndarja e Profili I punonjesve nuk është plotësuar asnje e dhene per keta punonjes nga ana e operatorit ekonomik.
D.M.C” SHPK	L.....G	21,501,500	<p><i>S`kualifikuar pasi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - OE nuk ka plotësuar piken 2.2.2 tek dokumentat e tenderit. - katalogët e dorëzuar nuk jane te noterizuar pas vërtetimit te perkthimit sipas kerkesave të D.S.T. - CV-të O.E i ka sjelle ne gjuhen angleze pa perkthyer dhe pa noterizuar. - Mungon diploma per inxhinjerin. - Tek ndarja e profili i punonjësve nuk është plotësuar asnje e dhene per keta punonjes nga ana e operatorit ekonomik. - OE per Prodhuesin 3 SHAPE ka paraqitur autorizim te leshuar ne datën 15.11.2021 qe nuk është I noterizuar dhe bie ne kundërshtim me dokumentat e tenderit.
“F.N.A” SHPK	K92201080V	17,920,000	Kualifikuar dhe shpallur fitues

Në të dy lotet nga auditimi rezultoi se ka fituar vlera më e ulët e vlefshme.

Lidhja e kontratës:

Për lotin I, kontrata është lidhur me “M.M” SHPK, me nr.2270/105, datë 26.01.2023 nga UMT, në cilësinë e AK, firmosur nga Administratori S.S, me afat 45 ditë pune nga data e nënshkrimit të kontratës dhe vendi i dorëzimit FMD në vlerën **595,000 lekë pa TVSH.**

Për lotin II, kontrata është lidhur me “F.N.A” SHPK, me nr.2270/106, datë 26.01.2023 nga UMT, në cilësinë e AK, firmosur nga Administratori S.S, me afat 45 ditë pune nga data e nënshkrimit të kontratës dhe vendi i dorëzimit FMD në vlerën **21,504,000 lekë pa TVSH.**

Zbatimi i kontratës:

Me urdhërin nr.48, datë 22.02.2023 të Administratorit është ngritur komisioni I marrjes në dorëzim për të dy lotet i përbërë nga K.G, E.K, E.N, M.C, A.K.

Me urdhërin nr 51, datë 22.02.2023 është caktuar personi përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës E.T.

Procesverbali i marrjes në dorëzim për lotin e parë, me nr.2270/117, datë 30.03.2023. fatura tatimore elektronike e “M.M” SHPK nr.388, datë 30.03.2023, në shumën 595,000 lekë.

Për lotin e dytë: Nga ana e subjektit fitues të lotit II, “F.N.A” SHPK, me shkresën e prot në UMT me nr. 2270/116, datë 29.03.2023, ku kërkon shtyrjen e kontratës për arsye të forcës madhore (transportuesi) kërkohet shtyrja e afatit për paisjen nr.1, deri më datë 07.04.2023.

Nga ana e AK është bërë amendim kontrate nr.2270/118, datë 31.03.2023, ku afati shtyhet nga 45 ditë punë ne 51 ditë pune nga dita e nënshkrimit të kontratës.

Procesverbali i marrjes në dorëzim për lotin e dytë, me nr.2270/121, datë 06.04.2023.

Fatura tatimore elektronike e “F.N.A” SHPK nr.380 datë 06.04.2023, në shumën 21,504,000 lekë.

Likuiduar me urdhër shpenzimin 84464, datë 20.04.23 në shumën 21,504,000 lekë dhe hyrje me fletë hyrjen nr.4, datë 06.04.23.

2.14/1- Mbi zbatimin e kontratave.

1 -Mbi realizimin e kontratës me objekt “Rikonstruksion i taracës së godinës së paraklinikut dhe bodrumeve të godinës së Dekanatit të Fakultetit të Mjekësisë, Tiranë”.

-Kontrata midis “2” SHPK dhe FM , është me nr. 502/19 Prot., datë 31.08.2020 dhe objekt “Rikonstruksion i taracës së godinës së paraklinikut dhe bodrumeve të godinës së Dekanatit të Fakultetit të Mjekësisë, Tiranë”. Është me afat 4 (katër) muaj kalendarikë nga dita e marrjes së lejes ndërtimore tek Bashkia Tiranë nga Autoriteti Kontraktor. Vlera e plotë e kontratës është 15,347,539 lekë me TVSH.

-Me shkresën nr. 1807 Prot., datë 16.09.2020, Administratori i FM-së, znj. Z.D, autorizon z. A.K, mbikqyrësin e punimeve, për aplikimin në portalin e-albania për leje infrastrukturore për objektin e prokuruar nga UMT.

-Me shkresën nr. 2402 Prot., datë 05.11.2020, Administratori i FM-së, njofton Bashkinë Tiranë për një ndërhyrje emergjente në godinat e Fakultetit të Mjekësisë.

-Me shkresën nr. 2402/1 Prot., datë 19.11.2020, Administratori i FM-së, njofton Bashkinë Tiranë për një ndërhyrje për mirëmbajtjen e zakonshme në godinat e Fakultetit të Mjekësisë.

-Me shkresën nr. 502/20 Prot., datë 31.08.2020, Administratori i FM-së, ngre grupin e punës për marrjen në dorëzim të punimeve me përbërje znj. N.S e diplomuar në Juridik, znj. E.L me diplomë Bachelor (ska të dhëna për fushën e diplomimit) dhe z. I.M me pozicion magazinier pranë Fakultetit të Mjekësisë.

-Me shkresën nr. 502/21 Prot., datë 12.11.2020, Administratori i FM-së, njofton OE të shpallur fitues, se punimet e parashikuara në godinën e paraklinikut, nuk do të realizohen pasi kërkohet një ndërhyrje e thelluar në rikonstruksion, referuar dhe Akt-Ekspertizës Teknike të Institutit të Ndërtimit me nr. 1279/5 Prot., datë 28.10.2020.

-Me shkresën nr. 502/22 Prot., datë 12.11.2020, Administratori i FM-së, kërkon të informohet nga mbikqyrësi i punimeve, se në çfarë faze është procedura për marrjen e lejes infrastrukturore pas autorizimit të lëshuar atë me nr. 1807 Prot., datë 16.09.2020.

-Me shkresën nr. 502/24 Prot., datë 26.11.2020, mbikqyrësi i punimeve, njofton Universitetin e Mjekësisë, lidhur me refuzimin e lejes ndërtimore nga Bashkia Tiranë me arsyetimet se:

1- “Mungon certifikata e pronësisë”.

2- “Punimet e kërkuara, i tejkalojnë përcaktimet e nenit 7 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015

Mbi miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”.

3- “...kompetente për shqyrtimin e aplikimeve për objektet në pronësi shtetërore është KKT”.

-Me shkresën nr. 502/25 Prot., datë 27.11.2020, Administratori i FM-së, znj. Z.D, njofton Kontraktorin “2” SHPK, që të fillojë punimet sipas kontratës me nr. 502/19 Prot., datë 31.08.2020 dhe objekt “Rikonstruksion i taracës së godinës së paraklinikut dhe bodrumeve të godinës së Dekanatit të fakultetit të Mjekësisë, Tiranë”.

-Me shkresën nr. 502/26 Prot., datë 01.12.2020, mbahet procesverbali i grupit të punës për marrjen në dorëzim të punimeve sipas urdhrimit me nr. 502/20 Prot., datë 31.08.2020.

-Me shkresën nr. 502/27 Prot., datë 01.12.2020, mbahet procesverbali i fillimit të punimeve.

-Me shkresën nr. 91/4 Prot., datë 29.01.2021, Dekanati i Fakultetit të Mjekësisë, miraton propozimet e mbikqyrësit të punimeve për zërat që shtohen dhe hiqen.

-Me shkresën nr. 502/35 Prot., datë 31.03.2021, mbikqyrësi i punimeve, njofton Fakultetin e Mjekësisë për përfundimin e punimeve.

-Me shkresën nr. 502/44 Prot., datë 30.04.2021, mbahet procesverbali i marrjes së përkohëshme në dorëzim të punimeve.

Sa më sipër:

Kontrata ka pasur si objekt “Rikonstruksionin e taracës së godinës së paraklinikut dhe bodrumeve të godinës së Dekanatit të fakultetit të Mjekësisë, Tiranë”. Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të kontratës, u konstatua se taraca nuk është bërë rikonstruksion për arsye të ndryshimit të projektit pasi godina ku ishte parashikuar rikonstruksioni i taracës, është vlerësuar nga Instituti i Ndërtimit, si godinë e dëmtuar pas tërmetit të vitit 2019 (trajtuar më lart). Në këto kushte, në gjykim të grupit të auditimit, kontrata e nënshkruar duhej të anulohet e të rifillonte një procedurë e re prokurimi me objekt të ndryshëm nga objekti fillestar pra pa kërkuar rikonstruksionin e taracës. Procedura e prokurimit e zhvilluar në vitin 2020, sipas urdhër prokurimi nr. 1422/3 Prot., datë 15.08.2019, ka pasur kritere edhe për punime të taracës. Konkretisht, tek Shtojca 12, Kapitulli 2, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.9, kërkohet që: “Operatori ekonomik duhet të ketë në përbërje të stafit ose me kontratë pune (me afat vlefshmërie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt), 2 punonjës të certifikuar për të kryer punime në lartësi, të lëshuara nga institucione të certifikuara/akredituara në Shqipëri ose tek ato ndërkombëtare”.

Gjithashtu, tek pika 2.3.11, “Makineritë dhe paisjet, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës”, midis të tjerash, kërkohet që operatori ekonomik të disponojë “1 Autovinç” dhe “600m2 Skela metalike suvatimi”. Kërkesat e mësipërme, i janë referuar zërave të punimeve sipas preventivit të parashikuar. Me ndryshimin e zërave të punimeve në atë masë që është ndryshuar objekti i prokuruar, pra janë hequr punime në lartësi për të cilat ka konkuruar dhe është shpallur fitues operatori ekonomik, FM, Administratori znj. Z.D, duhej të anulonte kontratën e nënshkruar dhe të kërkonte nga Universiteti i Mjekësisë, zhvillimin e një procedure të re prokurimi, me një preventiv të ndryshëm nga ai i pari si pasojë e ndërhyrjes në punime të cilat kanë qenë bazë për përzgjedhjen e operatorit fitues. Vlen të theksohet fakti se në grupet e punës të ngritura nga FM për ndjekjen e zbatimit të kontratës, nuk ka asnjë inxhinier apo specialist të fushave inxhinierike që të mund të arsyetojë teknikisht ndryshimin e zërave të punimeve apo edhe staf të fushës juridike, që të vlerësojë rëndësinë e lartë të këtyre ndryshimeve dhe njëkohësisht të propozojë korrigjimet e nevojshme ligjore. Struktura të tilla inxhinierike dhe juridike, ka vetëm Universiteti i Mjekësisë i cili ka staf administrativ në ndryshim nga Fakultetet të cilat kanë kryesisht staf akademik në strukturat e tyre. Zërat e preventivit të punimeve, nuk mund të miratohen nga

Dekanati i FM i cili ska asnjë specialist të fushave përkatëse por vetëm pedagogë të Fakultetit të Mjekësisë. Si rezultat, procedurat e ndjekura nga FM, janë me mangësi si nga ana teknike por dhe nga ajo juridike pasi në njërin rast kemi të bëjmë me miratime zërash të rinj të preventivit (të ndryshëm nga ata të prokuruar) të detyruar nga Instituti i Ndërtimit dhe në rastin tjetër, kemi mosfiksionim të stafit administrativ ose strukturave juridike dhe teknike të Universitetit të Mjekësisë pasi duhej që normalisht të propozonin ndryshimin e objektit të procedurës së prokurimit pasi janë hequr punimet në lartësi dhe si rezultat edhe kriteret e kualifikimit për këto lloj punimesh ose dhe fondi limit, duhej të ndryshoheshin duke i propozuar Administratorit të Universitetit të Mjekësisë fillimin e një procedure të re prokurimi me objekt të ndryshëm nga ai i pari. FM, ndodhet në të njëjtën godinë me Universitetin e Mjekësisë. Lejimi nga ana e Fakultetit të Mjekësisë, i vazhdimit të ekzekutimit të kontratës, me zëra punimesh tërësisht të ndryshuar, zëra të cilët kanë qenë bazë për përzgjedhjen e kontraktorit, ka favorizuar kontraktorin pasi zërat e rinj të shtuar, nuk kanë asnjë lidhje ata të hequr, duke ndryshuar në këtë mënyrë, objektin e kontratës në fakt.

2 -Mbi realizimin e kontratës me objekt “Rikonstruksion i tarracës së godinës Galileo Galilei”.

-Kontrata midis “H” SHPK dhe FM , është me nr. 2608/1 Prot., datë 14.01.2022 dhe objekt “Rikonstruksion i taracës së godinës Galileo Galilei”. Është me afat 30 ditë kalendarik nga dita e marrjes së lejes ndërtimore tek Bashkia Tiranë nga Autoriteti Kontraktor. Vlera e plotë e kontratës është 1,645,890 lekë pa TVSH dhe 1,975,068 lekë me TVSH.

-Me shkresën nr. 2608/3 Prot., datë 14.01.2022, Administratori i Fakultetit të Mjekësisë, ngre grupin e punës për ndjekjen e procedurave, problematikave dhe marrjen në dorëzim të punës së bërë nga firma “H SHPK, për realizimin e kontratës së lidhur. Grupi i punës është me përbërje znj. A.L e diplomuar në inxhinieri, znj. I.D. e diplomuar për Gjuhë të Huaj dhe znj. E.L me diplomë Bachelor (ska të dhëna për fushën e diplomimit).

-Me shkresën nr. 2568/10 Prot., datë 11.04.2022, Administratori i UMT-së, znj. S.S, Sektori i Shërbimeve dhe Investimeve, kërkon nga FM, marrjen e masave për fillimin e zbatimit të kontratës.

-Me shkresën nr. 2608/7 Prot., datë 13.04.2022, FM, i përgjigjet Universitetit të Mjekësisë se nuk mund të fillojë zbatimin e kontratës pa u përcaktuar më parë mbikqyrësi i punimeve dhe pa u miratuar buxheti i vitit 2022 nga Bordi i Administrimit.

-Kontrata midis mbikqyrësit të punimeve “V” SHPK dhe Fakultetit të Mjekësisë, është me nr. 2608/13 Prot., datë 07.07.2022.

-Me shkresën nr. 2608/14 Prot., datë 07.07.2022, Administratori i Fakultetit të Mjekësisë, autorizon mbikqyrësin e punimeve që të aplikojë për marrjen e lejes për institucionin pranë Bashkisë Tiranë.

-Me shkresën nr. 2608/15 Prot., datë 12.07.2022, mbikqyrësi i punimeve njofton se punimet do të fillojnë në datën 13.07.2022.

-Me shkresën nr. 2608/16 Prot., datë 12.07.2022, Administratori i FM-së, njofton kontraktorin për fillimin e punimeve.

-Me shkresën nr. 2608/17 Prot., datë 13.07.2022, mbikqyrësi i punimeve, njofton fillimin e punimeve.

-Me shkresën nr. 2608/18 Prot., datë 13.07.2022, mbahet procesverbali i fillimit të punimeve.

-Me shkresën nr. 2608/19 Prot., datë 13.07.2022, mbahet Akt Dorëzimi i sheshit të ndërtimit.

-Me shkresën nr. 2608/20 Prot., datë 13.07.2022, mbahet procesverbali për fillimin e punimeve, nga grupi i ngritur me urdhër të Administratorit të FM-së me përbërje znj. A.L e diplomuar në inxhinieri, znj. I.D. e diplomuar për Gjuhë të Huaj dhe znj. E.L me diplomë Bachelor (ska të dhëna për fushën e diplomimit).

-Me shkresën nr. 2608/21 Prot., datë 13.07.2022, mbahet procesverbali mbi piketimin e objektit.

-Me shkresën nr. 2608/22 Prot., datë 16.08.2022, komisioni i ngritur për ndjekjen dhe zbatimin e punimeve, informon Administratorin e FM-së dhe midis të tjerash, cilëson: “....., komisioni konstaton se punimet kanë përfunduar por jemi në pritje të dhënies së aprovimit nga mbikqyrësi i punimeve në mënyrë shkresore”.

-Me shkresën nr. 2608/23 Prot., datë 16.08.2022, Administratori i FM-së, i dërgon mbikqyrësit të punimeve, kërkesën për informacion lidhur me zbatimin e punimeve ku midis të tjerash cilëson se: “....., konstatohet se ende nuk na keni dhënë asnjë informacion shkresor rreth punimeve, përfundimit të tyre dhe zbatimit të kontratës. Sa më lart, kërkojmë nga ana juaj të merrni masat e menjëhershme për të na vënë në dispozicion të gjithë informacionin e plotë teknik në lidhje me zbatimin e kontratës së rikonstruksionit, si një detyrim ligjor që ju keni ndaj nesh”. E njëjta shkresë me të njëjtën përmbajtje, është dërguar përsëri nga Administratori i FM-së tek mbikqyrësi i punimeve sipas dokumentit me nr. 2608/24 Prot., datë 19.08.2022.

-Me shkresën nr. 2608/25 Prot., datë 17.10.2022, Administratori i FM-së, i dërgon përsëri kërkesën për informacion mbikqyrësit të punimeve e cila është e njëjtë në përmbajtje me kërkesat e mëparshme.

-Me shkresën nr. 2608/26 Prot., datë 15.12.2022, mbikqyrësi i punimeve, dërgon pranë Fakultetit të Mjekësisë, njoftimin për përfundimin e punimeve ku në mënyrë të përmbledhur cilëson se punimet kanë përfunduar në datën 13.08.2022 por për shkak të gjendjes shëndetësore jo të mirë, nuk ka pasur mundësi fizike ta dorëzoj njoftimin në kohë.

-Relacioni përfundimtar i mbikqyrësit të punimeve, është me shkresën nr. 2608/28 Prot., datë 22.12.2022.

-Dokumentacioni teknik është dorëzuar tek FM-ja me shkresën nr. 2608/29 Prot., datë 22.12.2022.

-Me shkresën nr. 2608/30 Prot., datë 22.12.2022, Administratori i FM-së, nxjerr urdhrin për përcaktimin e kolaudatorit të punimeve.

-Me shkresat me nr. 2608/31 & nr. 2608/32 Prot., datë 23.12.2022, mbahen procesverbalet nga komisioni i blerjeve të vogla për përcaktimin e kolaudatorit të punimeve. Kolaudatori i punimeve, përcaktohet “M.A.K” SHPK.

-Me shkresën nr. 2608/33 Prot., datë 29.12.2022, mbahet procesverbali i kolaudimit të objektit. Në këtë shkresë, kolaudatori cilëson se punimet kanë përfunduar në datën 13.08.2022 por nga auditimi i dosjes së zbatimit të punimeve, nuk u konstatua asnjë njoftim i tillë nga mbikqyrësi i punimeve.

-Certifikata e marrjes së përkohëshme në dorëzim të punimeve, është mbajtur me shkresën me nr. 2608/36 Prot., datë 29.12.2022 dhe është e nënshkruar nga antarët e grupit të ngritur me shkresën me nr. 2608/3 Prot., datë 14.01.2022.

-Sa më sipër, referuar nenit 35, të kontratës së nënshkruar asaj me nr. 2608/1 Prot., datë 14.01.2022, në dosje nuk u konstatua asnjë shkresë zyrtare e protokolluar që të plotësojë kërkesat e pikave 35.1, 35.2, 35.3, e në vazhdim deri tek pika 35.5, lidhur me njoftimet për përfundimin e punimeve. Punimet kanë filluar në datën 13.07.2022 sipas shkresës me nr. 2608/17 Prot., datë 13.07.2022, të mbikqyrësit të punimeve. Duhej të përfundonin pas 30 ditësh kalendarike ose në

datën 13.08.2022. Për arsye se nuk rezulton asnjë dokument zyrtar (me numër protokolli) nga deklaruesi ligjor i përfundimit të punimeve pra nga mbikqyrësi i tyre, brenda afatit të kontratës, Kontraktorit, nga grupi i punës i ngritur për monitorimin e kontratës, në gjykim të grupit të auditimit i duhej bërë e ditur për mungesën e këtij dokumentacioni.

3 -Mbi auditimin e disa dosjeve të zbatimit të kontratave.

-Kontrata midis “B.E” SHPK dhe FM , është me nr. 1737/1 Prot., datë 03.12.2018 dhe objekt “Blerje paisjesh elektronike për Universitetin e Mjekësisë”. Është me afat 30 ditë kalendarike nga dita e nënshkrimit të kontratës. Vlera e plotë e kontratës është 12,421,068 lekë me TVSH. Procesverbali i marrjes në dorëzim të paisjeve, është me datë 03.01.2019. Bashëlidhur procesverbalit, është dhe fletë-hyrja e paisjeve me faturën me nr. 01/1, datë 03.01.2019.

-Kontrata midis “K” SHPK dhe FM , është me nr. 1392/4 Prot., datë 26.10.2018 dhe objekt “Blerje materialesh laboratorit farmacie dhe mikrobiologjike”. Është me afat 30 ditë kalendarike nga dita e nënshkrimit të kontratës ose me datë përfundimi datën 24.11.2018. Vlera e plotë e kontratës është 2,054,205.6 lekë me TVSH. Procesverbali i marrjes në dorëzim të paisjeve, është me nr. 1392/12 Prot., datë 04.01.2019. Tek ky procesverbal, cilësohet se materialet janë dorëzuar në dy data të ndryshme dhe konkretisht në datën 06.11.2018 sipas faturës nr. 18905 dhe në datën 19.11.2018 sipas faturës nr. 18B004. Nga auditimi i praktikës së ndjekur për marrjen në dorëzim të materialeve dhe likuidimin e faturave përkatëse, u evidentua se: Procesverbali i mbajtur nga komisioni i marrjes në dorëzim të materialeve, është me nr. 1392/12 Prot., datë 04.01.2019. Komisioni, cilëson se materialet, kanë ardhur bashkë me faturat në dy data të ndryshme, pra në datën 06.11.2018 sipas faturës me nr. 18905 dhe në datën 19.11.2018 sipas faturës me nr. 18B004. Komisioni, nuk ka mbajtur ndonjë dokument të përkohshëm sipas faturës së parë pra të datës 06.11.2018 ose dhe të faturës së dytë atë të datës 19.11.2018, por ka mbajtur një procesverbal përmbledhës, me datë 04.01.2019 duke cilësuar se materialet kanë ardhur përpara datës së mbajtjes së procesverbalit pa asnjë dokument të përkohshëm bashkalidhur praktikës. Në vazhdim, në dosje u gjend fatura me nr. Serial 69146278, nr.fature 18905 dhe datë 06.11.2018 dhe fatura me nr. Serial 70943180, nr.fature 18-B004 dhe datë 19.11.2018. Deri këtu, është dokumentuar fakti se kontraktori ka lëshuar faturat në këto data (brenda afatit të përcaktuar në kontratë) por jo që të ketë dorëzuar mallin i cili, dokumentohet me Fletë-Hyrjen (total 5 fletë për faturën e parë) me nr. 3, datë 04.01.2019 dhe Fletë-Hyrjen (total 2 fletë për faturën e dytë) me nr. 4, datë 04.01.2019. Urdhër shpenzimi është me nr. 78, datë 04.04.2019 dhe vlerë 2,054,206 lekë. Nga dokumentacioni i mësipërm, grupi i auditimit, vlerëson se materialet e prokuruar, nuk janë dorëzuar brenda afatit të përcaktuar në kontratë pra brenda datës 24.11.2018, por janë dorëzuar në datën që janë bërë hyrje në magazinën e institucionit dhe konkretisht në datën 04.01.2019. Komisioni i marrjes në dorëzim të materialeve, duhej të propozonte mbajtjen e penalitetit nga kontraktori “K” SHPK, për dorëzimin e materialeve jashtë afateve të përcaktuara, në referencë të pikës 24.1, të nenit 24 “Likuidimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar”, të kontratës nr.1392/4 Prot., datë 26.10.2018 ku cilësohet se “Për kontratat me periudhë zbatimi jo me shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës”. Meqenëse nuk është e dokumentuar se është vepruar konform pikës 36, pikës 37 “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve”, dhe pikës 44 “Marrja në dorëzim e aktiveve

të furnizuara”, kontraktorit “K” SHPK, duhej ti mbahej penaliteti nga FM në vlerën 2,054,206 lekë / 4 = **513,552 lekë**.

-Kontrata midis “O.D” SHPK dhe FM , është me nr. 98/1 Prot., datë 04.02.2019 dhe objekt “Blerje paisjesh laboratorit për Fakultetin e Mjekësisë”. Është me afat 60 ditë kalendarike nga dita e nënshkrimit të kontratës ose me datë përfundimi datën 04.04.2019. Vlera e plotë e kontratës është 13,440,000 lekë me TVSH. Procesverbali i marrjes në dorëzim të paisjeve, është me nr. 98/4 Prot., datë 26.03.2019. Tek ky procesverbal, midis të tjerash cilësohet se “...materiale të dorëzuara si sasi por për të verifikuar nëse plotësojnë kushtet, duhet kohë”. Procesverbali i marrjes përfundimtare në dorëzim të materialeve, është me nr. 98/5 Prot., datë 05.04.2019.

-Kontrata midis “I.O” SHPK dhe FM , është me nr. 2527/1 Prot., datë 02.12.2022 dhe objekt “Blerje tonera për Fakultetin e Mjekësisë”. Është me afat 15 ditë kalendarike nga dita e nënshkrimit të kontratës ose me datë përfundimi datën 16.12.2022. Vlera e plotë e kontratës është 1,307,665.2 lekë me TVSH. Procesverbali i marrjes në dorëzim të paisjeve, është me nr. 2527/6 Prot., datë 16.12.2022. Tek ky procesverbal, midis të tjerash cilësohet se “...komisioni konstatoi se mallrat janë në përputhje me kontratën.....”.

Titulli i Gjetjes:	Zëra punimesh të kryera me vonesë jashtë afatit të kontratës.
Situata:	Kontrata midis “K” SHPK dhe FM , është me nr. 1392/4 Prot., datë 26.10.2018 dhe objekt “Blerje materialesh laboratorit farmacie dhe mikrobiologjike”. Është me afat 30 ditë kalendarike nga dita e nënshkrimit ose me datë përfundimi datën 24.11.2018. Vlera e plotë e kontratës është 2,054,205.6 lekë me TVSH. Procesverbali i marrjes në dorëzim të paisjeve, është me nr. 1392/12 Prot., datë 04.01.2019. Tek ky procesverbal, cilësohet se materialet janë dorëzuar në dy data të ndryshme dhe konkretisht në datën 06.11.2018 sipas faturës nr. 18905 dhe në datën 19.11.2018 sipas faturës nr. 18B004. Nga auditimi i praktikës së ndjekur për marrjen në dorëzim të materialeve dhe likuidimin e faturave përkatëse, u evidentua se: Procesverbali i mbajtur nga komisioni i marrjes në dorëzim të materialeve, është me nr. 1392/12 Prot., datë 04.01.2019. Komisioni, cilëson se materialet, kanë ardhur bashkë me faturat në dy data të ndryshme, pra në datën 06.11.2018 sipas faturës me nr. 18905 dhe në datën 19.11.2018 sipas faturës me nr. 18B004. Komisioni, nuk ka mbajtur ndonjë dokument të përkohshëm sipas faturës së parë pra të datës 06.11.2018 ose dhe të faturës së dytë atë të datës 19.11.2018, por ka mbajtur një procesverbal përmbljedhës, me datë 04.01.2019 duke cilësuar se materialet kanë ardhur përpara datës së mbajtjes së procesverbalit pa asnjë dokument të përkohshëm bashkalidhur praktikës. Në vazhdim, në dosje u gjend fatura me nr. Serial 69146278, nr.fature 18905 dhe datë 06.11.2018 dhe fatura me nr. Serial 70943180, nr.fature 18-B004 dhe datë 19.11.2018. Deri këtu, është dokumentuar fakti se kontraktori ka lëshuar faturat në këto data (brenda afatit të përcaktuar në kontratë) por jo që të ketë dorëzuar mallin i cili, dokumentohet me Fletë-Hyrjen (total 5 fletë për faturën e parë) me nr.

	3, datë 04.01.2019 dhe Fletë-Hyrjen (total 2 fletë për faturën e dytë) me nr. 4, datë 04.01.2019. Urdhër shpenzimi është me nr. 78, datë 04.04.2019 dhe vlerë 2,054,206 lekë. Nga dokumentacioni i mësipërm, grupi i auditimit, vlerëson se materialet e prokuruar, nuk janë dorëzuar brenda afatit të përcaktuar në kontratë pra brenda datës 24.11.2018, por janë dorëzuar në datën që janë bërë hyrje në magazinën e institucionit dhe konkretisht në datën 04.01.2019. Komisioni i marrjes në dorëzim të materialeve, duhej të propozonte mbajtjen e penalitetit nga kontraktori “K” SHPK, për dorëzimin e materialeve jashtë afateve të përcaktuara, në referencë të pikës 24.1, të nenit 24 “Likujdimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar”, të kontratës nr.1392/4 Prot., datë 26.10.2018 ku cilësohet se “Për kontratat me periudhë zbatimi jo me shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës”. Meqenëse nuk është e dokumentuar se është vepruar konform pikës 36, pikës 37 “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve”, dhe pikës 44 “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara”, kontraktorit “K” SHPK, duhej ti mbahej penaliteti nga FM në vlerën 2,054,206 lekë / 4 = 513,552 lekë .
Kriteri:	Kontrata me nr. 1392/4 Prot., datë 26.10.2018, neni 24 “Likujdimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar”.
Ndikimi/Efekti:	Ekzekutimi i punimeve jashtë afateve të përcaktuara.
Shkaku:	Mos respektimi i nenit 24 “Likujdimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar” i kontratës nr. 1392/4 Prot., datë 26.10.2018.
Rëndësia:	E Mesme
Rekomandim:	Nga FM të Universitetit të Tiranës, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës 513,552 lekë , nga “K” SHPK, si vlerë që i përket penalitetit që duhej mbajtur për arsye të ekzekutimit të kontratës jashtë afateve të përcaktuara.

Titulli i Gjetjes:	Ndryshim i objektit të prokurimit, gjatë ekzekutimit të kontratës.
Situata:	Kontrata midis “2” SHPK dhe FM , është me nr. 502/19 Prot., datë 31.08.2020 dhe objekt “Rikonstruksion i taracës së godinës së paraklinikut dhe bodrumeve të godinës së Dekanatit të Fakultetit të Mjekësisë, Tiranë”. Është me afat 4 (katër) muaj kalendarikë nga dita e marrjes së lejes ndërtimore tek Bashkia Tiranë nga Autoriteti Kontraktor. Vlera e plotë e kontratës është 15,347,539 lekë me TVSH. Kontrata ka pasur si objekt “Rikonstruksionin e taracës së godinës së paraklinikut dhe bodrumeve të godinës së Dekanatit të fakultetit të Mjekësisë, Tiranë”. Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të kontratës, u konstatua se taraca nuk është bërë rikonstruksion për arsye të ndryshimit të projektit pasi godina ku ishte parashikuar rikonstruksioni i taracës, është vlerësuar nga Instituti i Ndërtimit, si godinë e dëmtuar pas tërmetit të vitit 2019. Në këto kushte, në gjykim të grupit të auditimit, kontrata e nënshkruar duhej të anulohet e të rifillonte një procedurë e re prokurimi me objekt të ndryshëm nga objekti

	<p>filleshtar pra pa kërkuar rikonstruksionin e taracës. Procedura e prokurimit e zhvilluar në vitin 2020, sipas urdhër prokurimi nr. 1422/3 Prot., datë 15.08.2019, ka pasur kritere edhe për punime të taracës. Konkretisht, tek Shtojca 12, Kapitulli 2, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.9, kërkohet që: “Operatori ekonomik duhet të ketë në përbërje të stafit ose me kontratë pune (me afat vlefshmërie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt), 2 punonjës të certifikuar për të kryer punime në lartësi, të lëshuara nga institucione të certifikuara/akredituara në Shqipëri ose tek ato ndërkombëtare”. Gjithashtu, tek pika 2.3.11, “Makineritë dhe paisjet, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës”, midis të tjerash, kërkohet që operatori ekonomik të disponojë “1 Autovinç” dhe “600m2 Skela metalike suvatimi”. Kërkesat e mësipërme, i janë referuar zërave të punimeve sipas preventivit të parashikuar për punime në lartësi për rikonstruksionin e taracës. Me ndryshimin e zërave të punimeve në atë masë që është ndryshuar objekti i prokuruar, pra janë hequr punime në lartësi për të cilat ka konkuruar dhe është shpallur fitues operatori ekonomik, FM, Adminsitratori znj. Z.D, duhej të anulonte kontratën e nënshkruar dhe të kërkonte nga Universiteti i Mjekësisë, zhvillimin e një procedure të re prokurimi, me një preventiv të ndryshëm nga ai i pari si pasojë e ndërhyrjes në punime të cilat kanë qenë bazë për përzgjedhjen e operatorit fitues. Vlen të theksohet fakti se në grupet e punës të ngritura nga FM për ndjekjen e zbatimit të kontratës, nuk ka asnjë inxhinier apo specialist të fushave inxhinierike që të mund të arsyetojë teknikisht ndryshimin e zërave të punimeve apo edhe staf të fushës juridike, që të vlerësojë rëndësinë e lartë të këtyre ndryshimeve dhe njëkohësisht të propozojë korrigjimet e nevojshme ligjore. Struktura të tilla inxhinierike dhe juridike, ka vetëm Universiteti i Mjekësisë i cili ka staf administrativ në ndryshim nga Fakultetet të cilat kanë kryesisht staf akademik në strukturat e tyre. Zërat e preventivit të punimeve, nuk mund të miratohen nga Dekanati i FM i cili ska asnjë specialist të fushave përkatëse por vetëm pedagogë të Fakultetit të Mjekësisë. Si rezultat, procedurat e ndjekura nga FM, janë me mangësi si nga ana teknike por dhe nga ajo juridike pasi në njërin rast kemi të bëjmë me miratime zërash të rinj të preventivit (të ndryshëm nga ata të prokuruar) të detyruar nga Instituti i Ndërtimit dhe në rastin tjetër, kemi mosfunksionim të stafit administrativ ose strukturave juridike dhe teknike të Universitetit të Mjekësisë pasi duhej që normalisht të propozonin ndryshimin e objektit të procedurës së prokurimit pasi janë hequr punimet në lartësi dhe si rezultat edhe kriteret e kualifikimit për këto lloj punimesh ose dhe fondi limit, duhej të ndryshoheshin duke i propozuar Administratorit të Universitetit të Mjekësisë fillimin e një procedure të re prokurimi me objekt të ndryshëm nga ai i pari.</p>
Kriteri:	Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin public”, neni 2, gërma (d).
Ndikimi/Efekti:	Favorizim i kontraktorëve gjatë fazës së zbatimit të kontratës.
Shkaku:	Mospërmbushje e detyrave të ngarkuara nga Ligji.
Rëndësia:	E Lartë

Rekomandim:	Universiteti i Mjekësisë Tiranë, Fakultetet respektive, gjatë fazës së ekzekutimit të kontratave publike, të marrin masa që mos të ndryshojnë në atë masë specifikimet teknike dhe zërat për ekzekutim, saqë këto të fundit, të ndikojnë në kriteret e përzgjedhjes së fituesit të procedurës së prokurimit.
Rekomandim:	Fakultetet respektive të Universitetit të Mjekësisë Tiranë, gjatë fazës së ekzekutimit të kontratave publike, të marrin masa që për çdo ndryshim të zërave të punimeve, të bashkëpunojnë me Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtorinë e Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore të UMT-së, për marrjen e një asistence profesionale nga specialist të fushave përkatëse.

2.15 Të tjera të dala nga auditimi

- **Mbi përlllogaritjen e tarifave të shkollimit në UMT.**

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dizpozicion ka rezultuar:

a- Lidhur me kostot e programeve të studimit, UMT, nuk ka kryer një metodologji për llogaritjen e kosteve deri në shtator 2023 (periudhë e përfundimit të auditimit në terren), pavarësisht se në dhjetor 2018, nga KLSH është ushtruar auditim performance me temë: “Cilësia dhe tarifimi i shërbimeve studentore pranë IAL-ve publike”, ku është lënë rekomandimi nr.8, për sa vijon: “Universiteti i Tiranës; **Universiteti i Mjekësisë, Tiranë**; Universiteti Bujqësor i Tiranës; Universiteti “Fan S. Noli” Korçë; Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës; Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë dhe Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, **duhet të përcaktojnë tarifën e shkollimit dhe shërbimeve ndaj studentëve për të gjitha ciklet e studimit mbi bazën e analizës së kostove të tyre**” (faqe 45 të Raportit Përfundimtar si dhe në aneksin II të tij, është paraqitur “Metodologji për llogaritjen e kostove”).

Nga ana e UMT u pohua që nuk kanë bërë analizë të kostove të tarifave sipas programeve të studimit, për student për ciklin e studimeve bachelor dhe atë të ciklit të dytë të integruar, me përjashtim të rastit të sipërpërmendur.

Shto kuti

b- Në lidhje me tarifën e shkollimit të UMT, nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dizpozicion nga Rektorati i UMT, rezulton se është bërë një llogaritje për vitin 2019, bazuar në kostot e vitit 2018, sipas shkresës nr. 1393/2, datë 30.05.2019, **llogaritje të cilat nuk kanë kaluar në Bordin e Administrimit për miratim, pra nuk janë miratuar.**

Këto llogaritje paraqiten në tabelën sa më poshtë vijon:

Nr.	Emërtimi	Kosto		Tarifa aktuale viti 2022-2023
		Faktike 2018	E planifikuar 2019	
1	Bachelor infermieri e përgjithshme dhe shëndet publik dhe FMD	104,154	172,710	40,000
2	Programe të tjera, cikli i parë bachelor	100,785	171,565	35,000-40,000
3	Cikli i studimit të integruar	168,183	222,492	45,000
4	Master Shkencor	100,020	168,634	105,000
5	Master profesional	109,980	177,546	72,000
6	Specializime	107,039	217,344	115,000
	Kosto mesatare si UMT	133,807	203,902	

Burimi i të dhënave UMT.

Nga analiza e kryer nga UMT është argumentuar se:

“Niveli i ulët i kostos mesatare si UMT-ë është i lidhur me të gjithë faktorët ekonomikë e financiarë të vitit 2018, që janë:

- *Mosplotësimi i numrit faktik të punonjësve, që rrjedhimisht sjell mosrealizime të fondit të pagave; Në mosplotësimin dhe mospagesën në kohë të orëve të mbigarkesës nga pedagogët e brendshëm; Mosrealizimin dhe zhvendosjen në kohe të shpenzimeve material të nevojshme për aktivitetin e UMT-së;*

- *Nga analiza e kryer ka rezultuar se programet me numër të vogël studentësh janë jo efektive nga pikëpamja e kostos.*

- Gjithashtu disa pedagogë të brendshëm plotësojnë ngarkesën mësimore në fakultete të tjera brenda UMT-së, ndërkohë kur planifikimi dhe pagesa kryen në fakultetin ku janë në organikë. Kjo ka sjellë një denatyrim të lehtë të kostove në FMD, dhe për këtë pjesë një rritje të lehtë të kostove ne FM.

Ndërsa aktualisht tarifat e studimit për të gjitha programet e studimit të ofruara nga njësitë kryesore /FM dhe specifikisht tarifa e studimit të programit të integruar të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme”, për vitin akademik 2023-2024 janë miratuar me Vendimin e Senatit Akademik të UMT-së nr. 20, datë 10.03.2022 dhe me Vendim Bordi Administrimi të UMT-së nr. 25, datë 28.03.2023 “Për miratimin e tarifave të shkollimit për programet e ciklit të parë, të integruar të ciklit të dytë dhe të ciklit të dytë të studimeve, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin 2023-2024”, vendim i cili është publikuar në faqen zyrtare të internetit të UMT-së.

c- Për vitin 2022, në UMT, ka ardhur kërkesë nga MAS (me email), pra jo në rrugë shkresore, ku është paraqitur një formulë e gatshme (template i gatshëm i përgatitur për të gjithë IAL-të nga MAS), ku nga ana e UMT është plotësuar vetëm numri i studenteve dhe programet e studimit.

Sipas përllogaritjeve bazuar në këtë template, analiza financiare e kostos sipas programit të studimit për kohën e plotë 2020 -2021, paraqiten në tabelën sa më poshtë:

Drejtimi i studimeve	Analiza financiare e kostos per tarifen e shkollimit			Tarifat aktuale 2022-2023
	në programet e bachelor	në programet e master shkencor	në programet e master profesional	
FM				
Shëndet Publik	490,879.26			40,000
MSC Shendet Publik		775,258.08		105,000
MP në Shëndet Publik			775,258.08	72,000
MP në Menaxhim Shëndetësor			775,258.08	72,000
FMD				
Higjenist Dentar	490,879.26			40,000
Teknik Dentar	490,879.26			40,000
FSHMT				aktuale
Infermieri e Përgjithëshme	327,252.84			40,000
Mami	327,252.84			35,000
Fizioterapi	327,252.84			35,000
Teknik Imazherie	327,252.84			35,000
Teknik laborator	327,252.84			35,000
Logopedi	327,252.84			35,000
MSC Infermieri		516,838.72		105,000
MSC Mami		516,838.72		105,000
MSC Logopedi		516,838.72		105,000
MSC Teknik Laboratori		516,838.72		105,000
MSC Teknik Imazherie		516,838.72		105,000
MSC Fizioterapi		516,838.72		105,000
MP në Menaxhim Infermieror			516,838.72	72,000
MP në Mami			516,838.72	72,000
MP në Logoedi			516,838.72	72,000
MP në Teknik laborator			516,838.72	72,000

MP në Teknik Imazherie			516,838.72	72,000
MP në Fizioterapi			516,838.72	72,000
MP në Kujdes Paliativ			516,838.72	72,000

Burimi i të dhënave UMT.

Nga ku rezulton se tarifat e përlllogaritura nga template i MAS janë shumë më të larta se kostot e përlllogaritura nga UMT në vitin 2019.

d- Mbi ligjin nr. 60/2023 “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë”.

• **Pajtueshmëria me legjislacionin specifik për arsimin e lartë.**

Institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri, zhvillojnë/kryejnë veprimtarinë e tyre në përputhje me ligjin specifik nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH” dhe akteve nënligjore në fuqi të dalë në zbatim të tij.

Në këtë ligj, në nenin **91 “Lëshimi i diplomave, certifikatave dhe suplementi i diplomës”**, në pikën 1, është përcaktuar se “Në përfundim të programit të studimit, studenti pajiset me diplomën ose certifikatën përkatëse. Elementet përbërëse, forma e diplomës dhe procedurat për regjistrimin përcaktohen nga ministria përgjegjëse për arsimin”.

Nga ku rezulton se nuk është parashikuar si e drejtë e studentit pajisja me diplomë nga institucion tjetër përveç IAL në të cilën studenti ka përfunduar studimet.

Në **ligjin nr.60/2023** “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme”, në **nenin 1, “Objekti”**, është përcaktuar se “Ky ligj përcakton rregulla të veçanta për trajtimin e studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë”.

Në **nenin 4 të ligjit nr.60/2023**, përcaktohet se kandidati "pranon kalimin zyrtarisht të diplomës përkatëse të arsimit të lartë nga institucioni publik i arsimit të lartë, ku ka përfunduar studimet, në institucionin shëndetësor ku punësohet deri në shlyerjen e detyrimeve për punësim sipas afatit 5/3/2- vjeçar, me të drejtën që pas përmbushjes së detyrimit të punësimit të tërheqë diplomën universitare”.

Në përfundim të sa më lart, konstatojmë se **neni 4, i ligjit 60/2023, është në kundërshtim me nenin 91, pika 1, të ligjit 80/2015.**

• **Mbi zbatimin e ligjit nr.60/2023.**

Ligji nr.60/2023 është miratuar në datë 21.07.2023, botuar në Fletoren Zyrtare nr.123, datë 16.08.2023 dhe në zbatim të nenit 11 të tij, hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare (datë 31.08.2023).

Të gjitha detyrimet e studentëve që regjistrohen **për herë të parë** në mjekësi të përgjithshme, duhet të fillojnë me nënshkrimin e një deklaratë (neni 4, pika 1/a ligji 60/2023) para zhvillimit të testimit të informatizuar. Testimi i informatizuar është zhvilluar në datat 14-23 gusht 2023 (burimi i të dhënës: njoftimi në faqet zyrtare të QSHA dhe UMT), para datës së hyrjes në fuqi të ligjit 60/2023 (31 gusht 2023, neni 11 i ligjit).

Para zhvillimit të testimit të informatizuar për pranimin në programin “Mjekësi e Përgjithshme” **maturantët nuk kanë nënshkruar deklaratën** sipas nenit 4, pika 1/a, e për pasojë dhe plotësimin e pikave b (marrëveshja) dhe c (kalimi i diplomës një institucioni tjetër) të këtij neni.

Konstatohet se regjistrimi i maturantëve fitues në programin Mjekësi ka filluar që në datën 29 gusht 2023, sipas akteve nënligjore të MAS dhe institucioneve të varësisë të saj (deri me 30 gusht janë regjistruar 95% të studentëve fitues në mjekësi).

- **Mbi pagesën e vlerës së plotë të kostos së studimeve për studentët e mjekësisë që janë në proces studimi dhe që nuk pranojnë të nënshkruajnë marrëveshjen për qëndrimin me 3 ose 2 vite në vend.**

Në nenin 5 të ligji 60/2015 (Miratuar në datën 21.7.2023 dhe hyn në fuqi 05.08.2023) është parashikuar pagesa e vlerës së plotë të kostos së studimeve për studentët (në proces) që nuk pranojnë të nënshkruajnë marrëveshjen sipas përcaktimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 4 të këtij ligji.

Ndërkohë që metodologjia për përcaktimin e kostos së studimeve është përcaktuar me VKM nr. 527, datë 7.9.2023, “Për përcaktimin e metodologjisë së kostos së studimeve për programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë dhe çdo mbështetje tjetër për studentët e këtij programi studimi”, VKM e cila ka hyrë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

e- Mbi numrin e aplikimeve në programin mjekësi e përgjithshme, për vitin akademik 2023-2024, numrin e aplikantëve që janë futur në testimin e informatizuar, si dhe arsyet se pse është futur ky kriter këtë vit akademik;

Për vitin akademik 2023-2024, numri i aplikimeve në programin mjekësi e përgjithshme ishte **1813 aplikantë**, nga te cilët **1021 aplikantë ishin pjesëmarrës në testimin e informatizuar (+1 aplikant i cili është skualifikua gjatë testimit për përdorim kopje).**

Testimi i informatizuar për studentet e mjekësisë është në plotësim të Planit Strategjik të Zhvillimit të UMT, 2021-2024, përkatësisht të objektivit 4.1 **Studentët: Forcimi i meritokracisë në përzgjedhje përmes sistemit të testimit në hyrje të njohurive të studentëve në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, nëpërmjet realizimit të konkursit të pranimit të ndershëm dhe transparent.**

Në tre vitet me mëparshme janë realizuar analiza statistikore të arritjeve akademike të studenteve që përfundojnë vitin e parë në mjekësi (për grup lëndët kimi, fizikë, biologji) krahasuar me rezultatet e tyre të arsimit të mesëm po për këtë grup lëndësh (kimi, fizike, biologji). Gjetja (devijimi) ishte që rreth 45% e studentëve vlerësoheshin 3-4 nota më të ulta sesa rezultatet e arsimit të mesëm (duke marrë si vlerë normale uljen deri në 2 nota) ose ishin ngelës në këto lëndë.

Referuar pikës b, Senati Akademik ka miratuar me Vendim nr.80, datë 7.10.2022, kriteret e pranimit për programin Mjekësi e përgjithshme si më poshtë:

- Rezultatet e arsimit të mesëm, në masën 70% të pikëve totale
- Rezultatet e testimit të informatizuar, në masën 30% të pikëve totale

Testimi informatizuar (ku maturanti e merr automatikisht përgjigjen e vlerësimit të tij për testin) është realizuar në bashkëpunim me MAS dhe QSHA, pasi UMT nuk ka infrastrukturën e nevojshme.

• **Mbi trendin e aplikimeve për mjekësi të përgjithshme, në tre vitet e fundit:**

Numri i aplikimeve dhe kuotat e miratuara për çdo vit akademik nga viti akademik 2019-2020 deri në vitin 2023-2024, paraqitet në tabelën në vijim:

Aplikime/kuota ne vite Mjekesi e pergjithshme										
Program Studimi	Nr. Aplikantësh					Kuota				
	23-24	22-23	21-22	20-21	19-20	23-24	22-23	21-22	20-21	19-20
Mjekësi e Përgjithshme	1,813	3,183	3,040	3,205	3,205	400	360	260	260	260

• **Mbi uljen e numrit të aplikimeve, në programin mjekësi e përgjithshme (indicje kjo nga media e shkruar).**

Lidhur me uljen e numrit të aplikantëve në opinionin tonë të bazuar në statistika dhe të rezultuara nga auditimi, kanë ndikuar faktorët:

- **Ulja në nivel vendi, i numrit total të maturanëve,** rreth 19,600 maturanë nga 21,000 maturanë që ishin vitin 2021 -2022. (Kjo e dhënë është marrë ne formë verbale nga Rrjeti Akademik Shqiptar).

- **Futja e testimit te informatizuar.** Kjo ka sjellë që maturanët gjatë plotësimit të formularit A2, për përzgjedhjen e 10 programeve, të jenë të rezervuar në përzgjedhjen e Mjekësisë se përgjithshme, jo thjesht për të mbushur numrin.

Nga historiku i pranimeve në programin mjekësi e përgjithshme, sqarojme se në vitet kur pranimet në këtë program bëheshim me provim/testim me shkrim, numri i aplikantëve ka qenë rreth 1600-1800, ndërkohë që në të periodhe kanë qenë rreth 50-55 mijë maturanë.

Këto të dhëna gjenden ne Universitetin e Tiranës, pasi FM (përgjegjës për programin e mjekësisë) ka qenë pjesë e UT.

f- Mbi përlllogaritjen e kosos së studimeve për programin e studimit të ciklit të dytë “Mjekësisë e Përgjithshme”, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, viti 2023.

Në UMT, në zbatim të Urdhrit nr. 116, datë 11.09.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për caktimin e kosos së studimeve për programin e studimit të ciklit të dytë “Mjekësisë e Përgjithshme”, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, i ndryshuar, është ngritur grupi i punës me përbërje:

1.	S.T	Kryetar, Drejtor i përkohshëm i Drejtorisë Ekonomike
2.	A.C	Anëtar, ZV/Dekan i FM;
3.	A.B	Anëtar, Administrator i FM;
4.	E.H	Anëtar, Pedagoge në FM, Departamenti Farmaci;
5.	E.V	Anëtar, Drejtore e Drejtorisë së Akreditimit
6.	N.D	Anëtar, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve të Përgjithshme
7.	E.H	Anëtar, Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore;
8.	M.D	Anëtar, Kryetare e Degës së Financës, FM.

Ky grup bazuar në VKM nr. 527, datë 07.09.2023 “Për caktimin e metodologjisë së kosos së studimeve për programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë dhe çdo mbështetje tjetër për studentët e këtij programi studimi”, si dhe në të dhënat e vendosura në dispozicion nga FM dhe Rektorati i UMT-së, ka shqyrtuar dhe analizuar këto të dhëna dhe ka dalë në vlerësimin.

Metodologjia për përlllogaritjen e kosos sipas përcaktimeve të Vendimit të KM-së nr. 527, datë 07.09.2023

Metodologjia për përlllogaritjen e kostos, është bazuar në përcaktimet e Vendimit të KM-së nr. 527, datë 07.09.2023 “Për caktimin e metodologjisë së kostos së studimeve për programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë dhe çdo mbështetje tjetër për studentët e këtij programi studimi”.

Sipas përcaktimeve në këtë Vendim, në përlllogaritjen e kostos së studimit të këtij programi studimi, merren në konsideratë **a) kostot direkte** dhe ato **b) indirekte**, sipas klasifikimit të mëposhtëm:

a- Kostot direkte, përfaqësohen nga të gjitha shpenzimet, që parashikohen të kryhen në një vit buxhetor për ofrimin e shërbimit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor dhe që lidhen drejtpërsëdrejti me treguesit, si më poshtë vijon:

a.1 Numrin e kuotave të certifikuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, në vitin përkatës akademik të studimeve;

a.2 Numrin e studentëve për një grup mësimor, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi;

a.3 Numrin e personelit akademik, të personelit ndihmësakademik, të personelit administrativ dhe të punonjësve të shërbimeve mbështetëse të miratuar me vendim të organeve kolegjiale të IAL-së;

a.4 Shpenzimet (bruto) për personelin: paga, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, që paguan punëdhënësi për personelin akademik, ndihmësakademik, administrativ e atë të shërbimeve mbështetëse, si dhe shpërblyme apo ndihma financiare, që përballohen nga fondi i veçantë, sipas kuadrit ligjor në fuqi;

a.5 Shpenzimet **për bursa** dhe trajtime të tjera për studentët.

Sipas përcaktimeve në Vendimin e mësipërm të KM-së, ndarja e kostove direkte dhe indirekte, por pa u kufizuar në to, parashikohet në raportet e mëposhtme:

- Pjesa e shpenzimeve të personelit parashikohet në masën 75%-80% të shpenzimeve/kostos totale të studimeve;
- Pjesa e shpenzimeve kapitale parashikohet në masën 10%-15% të shpenzimeve të personelit;
- Pjesa e shpenzimeve operative parashikohet në masën 15%-20% të shpenzimeve të personelit.

a) Grupi i punës për përcaktimin e **kostove direkte** për këtë program studimi, si dhe bazuar në treguesit që përfshihen në këtë kosto, ka vepruar sa vijon:

a.1 Lidhur me numrin e kuotave të certifikuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit për këtë program studimi, Grupi i Punës ka marrë të dhënat në shkresën nr. 2693/2 prot., datë 15.09.2023, të cilat pasqyrohen në tabelën e mëposhtme, (tabela nr. 1).

Viti Akademik	Kuota total	Certifikimi i kuotave nga MAS
2018-2019	332	Raport i grupit të punës te MAS nr. 8080 prot., datë 24.07.2018
2019-2020	332	Raport i grupit të punës te MAS nr. 7525 prot., datë 26.07.2019
2020-2021	334	Raport i grupit të punës te MAS nr. 4020 prot., datë 24.07.2020
2021-2022	334	Raport i grupit të punës te MAS nr. 2666/28 prot., datë 22.07.2021
2022-2023	454	Raport i grupit të punës te MAS nr. 3079/66 prot., datë 19.07.2022
2023-2024	464	Raport i grupit të punës te MAS nr. 2790/1 prot., datë 18.07.2022
TOTAL	2250	

Burimi i të dhënave DAAK, Rektorati i UMT

a.2 Sa i përket numrit të studentëve/grup mësimor, Grupi i Punës është bazuar në:

- VKM nr. 418/2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe degëve të tyre”,

- VKM nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar,
- Udhëzimin e MAS nr. 29/2018 “Për veprimtarinë mësimore dhe ngarkesën e personelit akademik në IAL”, i ndryshuar, referuar programit mësimor të miratuar “Mjekësi e Përgjithshme”, si dhe në të dhënat e vëna në dispozicion nga sekretaria mësimore e FM në UMT.

a.3 Numri i personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ e të punonjësve të shërbimeve mbështetëse, është miratuar me Vendimin e Bordit të Administrimit të UMT-së, nr. 40, datë 04.07.2019 “Për miratimin e numrit të personelit të UMT-së në të gjitha nivelet”, i ndryshuar.

Nr.	Njësitë	Personel akademik	Personel ndihmës akademik me karakter mësimor/administrativ	Personel administrativ	Total UMT
1	FM	226	62	28	316
2	FSHMT	82	29	19	130
3	FMD	24	14	7	45
4	Njësia kryesore	-	33	26	59
Totali për kategori		332	138	80	550

Burimi i të dhënave është Vendimi i BA nr. 40, datë 04.07.2019

a.4 Shpenzimet bruto për personelin: paga, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, që paguan punëdhënësi për personelin akademik, ndihmësakademik, administrativ e atë të shërbimeve mbështetëse, si dhe shpërblime apo ndihma financiare, që përballohen nga fondi i veçantë, transferimet në njësinë qendrore të Rektoratit, të cilat janë miratuar në Projekt Buxhetin Afatmesëm me Vendim të Bordit të Administrimit nr. 49, datë 14.08.2023 “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 dhe treguesve të buxhetit të vitit 2024, për Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, për Fakultetin e Mjekësisë, si më poshtë vijon:

Burimi financimi	Pagat	Kontributet e Sigurimeve Shoqërore	Mallra dhe Shërbime	Të Tjera Transferata Koherente Brendshme	Transferata për Buxhetet Familjare dhe Individët	Shpenzime Kapitale të Patrupëzuar-ara	Shpenzime Kapitale të Trupëzuara	Totali
Totali	657,310,697	102,967,361	73,376,000	27,486,200	83,700,000	10,200,000	24,660,000	979,700,258
Çelje nga Buxheti i Përgjithshëm	524,836,336	83,223,902			83,700,000			691,760,238
Shpenzime nga të Ardhurat	132,474,361	19,743,459	73,376,000	27,486,200		10,200,000	24,660,000	287,940,020

Burimi i të dhënave është PBA FM 2024-2026, pjesë përbërëse e PBA së UMT

a.5 Shpenzimet për bursa për studentët, të cilat janë pasqyruar në tabelën e mëposhtme, sipas të dhënave të parashikuara në Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 të Fakultetit të Mjekësisë.

Nr.	Buxhet Familjar / Individë* programi 09450	I Prtishmi 2023		Parashikimi 2024		Parashikimi 2025		Parashikimi 2026	
		Nr. Përfituesve	Shuma	Nr. Përfituesve	Shuma	Nr. Përfituesve	Shuma	Nr. Përf.	Shuma
606	Transferata për Buxhetet familjare dhe individët të paguara nga	925	83,072,500	930	83,700,000	930	83,700,000	935	84,150,000

Nr.	Buxhet Familjar / Individë* programi 09450	I Pritshmi 2023		Parashikimi 2024		Parashikimi 2025		Parashikimi 2026	
		Nr. Përfituesve	Shuma	Nr. Përfituesve	Shuma	Nr. Përfituesve	Shuma	Nr. Përf.	Shuma
	Institucione te tjera								
606	Bursa	925	83,072,500	930	83,700,000	930	83,700,000	935	84,150,000
	TOTALI	925	83,072,500	930	83,700,000	930	83,700,000	935	84,150,000

Burimi i të dhënave është PBA FM 2024-2026, pjesë përbërëse e PBA së UMT

Lidhur me kostot indirekte, përlllogaritjet janë kryer si më poshtë:

b- Kostot indirekte, të cilat përfshijnë shpenzimet kapitale dhe shpenzime të tjera operative, që parashikohen të kryhen nga institucioni i arsimit të lartë, si më poshtë vijon:

b.1 Shpenzime kapitale për ndërtime dhe rehabilitime të godinave, krijimin e infrastrukturës kapitale për realizimin e procesit të mësimdhënies e të mësimnxënies, përfshirë edhe infrastrukturën mësimore-didaktike dhe atë të kërkimit shkencor;

b.2 Shpenzime operative për sigurimin e jetës së studentëve në shoqëritë e sigurimit, sigurimin e infrastrukturës fizike (godinave) dhe të bazës laboratorike e mësimore-didaktike, shpenzime për energjinë elektrike, ujën, ruajtjen, mirëmbajtjen dhe pastrimin e objekteve;

b.3 Shpenzime për kancelari, karburant për ngrohje dhe mjete transporti, shpenzime për shërbime bankare, shpenzime për qira, pritje-përcjellje, si dhe shpenzime të tjera të institucionit të arsimit të lartë, të papërfshira më lart e që janë në funksion të shërbimit të mësimdhënies e të mësimnxënies dhe të kërkimit shkencor.

Në lidhje me shpenzimet kapitale:

Për ndërtime dhe rehabilitim godinash, krijimit të infrastrukturës kapitale për ofrimin e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies duke përfshirë edhe infrastrukturën mësimore-didaktike dhe praktikat klinike/diagnostifikuese, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, ka në funksion të veprimtarisë së tij asete të vëna **në përdorim dhe në dispozicion**.

i. Asete që administrohen nga UMT (në përdorim):

- | | | | |
|---|---|----|--------------------------------------|
| 1 | Godina Qendrore (Rektorati UMT-së, Dekanati i FM-së) | 9 | Salla e Infektivit |
| 2 | Godina e Re (Dep. Farmacisë, Dep. i Shëndetit Publik) | 10 | Salla e Terapisë |
| 3 | Godina e Lëndëve Paraklinike | 11 | Salla e Morgut |
| 4 | Godina e Anatomisë Normale | 12 | Godina e Stomatologjisë (kati 4+5) |
| 5 | Godina e Pediatrisë (Galileo Galilei) | 13 | Godina 2 Katëshe e Dekanatit (FSHMT) |
| 6 | Salla e Kirurgjisë | 14 | Godina 1 (FSHMT) |
| 7 | Salla e Obstetrikës (materniteti i vjetër) | 15 | Godina 2 (FSHMT) |
| 8 | Salla e Leksioneve (materniteti i ri) | 16 | Palestra |

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 8, të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, dhe VKM-së nr. 834, datë 13.12.2006 “Për miratimin e listës së pjesshme të inventarit (pjesa e parë + pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme shtetërore, në Bashkinë Tiranë të Qarkut të Tiranës” këto asete janë në pronësi të Bashkisë Tiranë. Me shkresën nr. 2139/1 prot., datë 11.04.2007 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës është miratuar lista e inventarëve të pronave shtetërore ku specifikohet statusi juridik i pronës së regjistruar në regjistrin hipotekor/kadastral nr. 1832, datë 09.05.1995 “Institucioni me përgjegjësi administrative, Universiteti i Tiranës”. Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 48, datë 23.01.2013 “Për krijimin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë” i ndryshuar, u krijua UMT si institucion publik i arsimit të lartë. Në VKM-në nr. 48 datë 23.01.2013, kreu V pika 3, përcaktohet se: “UMT-së i kalojnë të gjitha asetet e luajtshme dhe të paluajtshme që zotërojnë dhe disponojnë FM dhe Fakulteti i Infermierisë, të Universitetit të Tiranës”. Aktualisht këto prona administrohen nga UMT.

Asete në dispozicion:

Referuar akteve ligjore e nënligjore në fuqi, UMT-ja ka në dispozicion asete të Strukturave Shëndetësore Universitare ku ushtron funksione mësimore dhe kërkimore-shkencore mbështetur në vendimet sa vijon:

VKM nr. 66, datë 03.02.2017 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për ngritjen e organizimin e shërbimeve dhe strukturave shëndetësore universitare“, në pikat 14, 15 dhe 16 të së cilit përcaktohet se, strukturë shëndetësore universitare janë dhe Instituti i Shëndetit publik, Klinika Stomatologjike Universitare, strukturë Shëndetësore Universitare është edhe Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut.

VKM nr. 654, datë 10.11.2017 “Për miratimin, si strukturë shëndetësore Universitare, të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë”, pika 1, në të cilin përcaktohet: Miratimin e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, si strukturë shëndetësore universitare e përgjithshme,si dhe funksione mësimore e kërkimore-shkencore për të realizuar formimin universitar të specialistëve të shëndetësisë, si pjesë e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

VKM nr. 655, datë 10.11.2017 “Për miratimin, si strukturë shëndetësore Universitare, të Spitalit Universitar Obstetrikë Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”, Tiranë”, pika 1, në të cilin përcaktohet: Miratimin e Spitalit Universitar Obstetrikë Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”, si strukturë shëndetësore universitare e përgjithshme,si dhe funksione mësimore e kërkimore-shkencore për të realizuar formimin universitar të specialistëve të shëndetësisë, si pjesë e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

Në VKM nr. 656, datë 10.11.2017 “Për miratimin, si strukturë shëndetësore Universitare, të Spitalit Universitar Obstetrikë Gjinekologjik “Koço Gliozheni”, Tiranë”, pika 1, në të cilin përcaktohet: Miratimin e Spitalit Universitar Obstetrikë Gjinekologjik “Koço Gliozheni”, si strukturë shëndetësore universitare e profilizuar,si dhe funksione mësimore e kërkimore-shkencore për të realizuar formimin universitar të specialistëve të shëndetësisë, si pjesë e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

VKM nr. 657, datë 10.11.2017 “Për miratimin, si strukturë shëndetësore Universitare, të Spitalit Universitar të Traumës”, pika 1, në të cilin përcaktohet: Miratimin e Spitalit Universitar të Traumës”, si strukturë shëndetësore universitare e përgjithshme,si dhe funksione mësimore e kërkimore-shkencore për të realizuar formimin universitar të specialistëve të shëndetësisë, si pjesë e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

VKM nr. 658, datë 10.11.2017 “Për miratimin, si strukturë shëndetësore Universitare, të Spitalit Universitar “Shefqet Ndroqi” Tiranë”, pika 1, në të cilin përcaktohet: Miratimin e Spitalit Universitar “Shefqet Ndroqi”, si strukturë shëndetësore universitare e përgjithshme, ...si dhe funksione mësimore e kërkimore-shkencore për të realizuar formimin universitar të specialistëve të shëndetësisë, si pjesë e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

Memorandumet e Bashkëpunimit të nënshkuara midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, përkatësisht me nr. 4730 prot., datë 19.11.2021 dhe Memorandumin me nr. 2435 prot. datë 30.04.2019.

Në këto memorandume ndër të tjera citohet se: “MShMS-ja angazhohet të përcaktojë kapacitete pritëse të qendrave/institucioneve spitalore të sistemit shëndetësor.....”, si dhe se “MShMS-ja garanton që në projektet e investimeve të ardhshme të spitaleve universitare të vlerësojë planifikimin për krijimin e ambienteve të mësimdhënies dhe hapësirave ndihmëse për zhvillimin e procesit mësimor paraklinik dhe klinik.....”

Për sa më sipër vlerësimi i saktë sasior i kostove kapitale në opinion të grupit, është i pamatshëm pasi veprimtaria që kryhet është e përbashkët midis institucionit të shërbimit spitalor dhe FM në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë. Në dijeninë tonë një studim i tillë që të përcaktojë koston e kontributit të institucioneve shëndetësore në realizimin e programeve të studimit me karakter klinik (për të gjithë studentët), nuk është kryer ndonjëherë dhe grupi i punës nuk disponon të dhëna konkrete.

Sa më sipër, për pjesën e shpenzimeve kapitale, duke qenë se kjo infrastrukturë ofrohet në prona shtetërore, për të cilat UMT nuk i ka në pronësi por i ka në administrim (përdorim)/dispozicion, shpenzimet kapitale janë propozuar të llogariten brenda raportit të përcaktuar në metodologjinë e VKM nr. 527/2023, në masën 10-15% të shpenzimeve të personelit.

Shpenzimet operative: Për shpenzimet operative, ku përfshihen shpenzime për kancelari, karburant për ngrohje, energji elektrike, ujë, shërbime sigurie dhe ruajtje, materiale dhe pajisje laboratorike, libra dhe publikime profesionale, shërbime për sistemet digjitale të informacionit, shërbime bankare, shpenzime për qira, pritje-përcjellje, shpenzime të sigurimit, si dhe shpenzime të tjera të institucionit të arsimit të lartë, në funksion të shërbimit të mësimdhënies e të mësimnxënies dhe të kërkimit shkencor janë parashikuar referuar Projekt Buxhetin Afatmesëm, të miratuar me Vendim të Bordit të Administrimit nr. 49, datë 14.08.2023 “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 dhe treguesve të buxhetit të vitit 2024, për Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, për Fakultetin e Mjekësisë, si dhe Vendimit të Grupit të Menaxhimit Strategjik në UMT, nr.1 datë 09.06.2023 “Për miratimin e deklaratës së politikës, si dhe tavanëve të shpenzimeve për Projekt Buxhetin Afatmesëm 2024-2026, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”.

Po ashtu Universiteti i Mjekësisë, Tiranë ka edhe kosto operative të pamatshme që shkojnë për realizimin e programeve mësimore të cilat përballohen nga strukturat shëndetësore universitare.

Sa më sipër, shpenzimet operative propozohen të llogariten brenda raportit të përcaktuar në metodologjinë e Vendimit të KM nr. 527/2023, në masën 15-20% të shpenzimeve të personelit.

Përlllogaritja e Kostos

Për përlllogaritjen e koston së studimeve, Grupi i Punës ka ndjekur metodën e përlllogaritjes së peshës specifike me qëllim ndarjen e shpenzimeve për programet e studimit që ofron FM.

Për përlllogaritjen janë përdorur tregues si ngarkesa me orët mësimore në auditorë, si dhe shpërndarja e tyre sipas veprimtarive të programit të studimit të “Mjekësisë së Përgjithshme” aktual, duke ju referuar planeve mësimore të miratuara si dhe numrit të studentëve për grup mësimor.

Këto të dhëna janë bazuar në planet mësimore të miratuara nga Senati Akademik i UMT-së, dhe grupet mësimore të konfirmuara nga sekretaria mësimore e Fakultetit të Mjekësisë. (Reference Aneksi nr.1).

Grupi i Punës, bazuar në vlerësimin e të gjithë të dhënave të mblledhura, propozon tri variante që përcaktojnë përlllogaritjen e koston së studimit në programin e integruar të ciklit të dytë Mjekësi e Përgjithshme, në Fakultetin e Mjekësisë në UMT.

Varianti i parë i përlllogaritjes së koston së studimit të programit të studimit “Mjekësi e Përgjithshme” synon përcaktimin e peshës specifike në %, të programit të studimit “Mjekësi e Përgjithshme” në raport me programet e tjera të studimit të ofruara nga FM.

Varianti i dytë është i ngjashëm me variantin e parë por duke marrë në konsideratë vetëm ngarkesën mësimore leksione-seminare të programeve të specializimeve aftatgjata, duke qenë se

praktikat klinike mësimore janë një proces i lidhur kryesisht me kontributin e strukturave shëndetësore universitare.

Ndërsa **varianti i tretë** është ndërtuar ndryshe nga dy të parët. Janë marrë për bazë orët mësimore të programit të studimit “Mjekësisë e Përgjithshme” dhe mbi bazën e tyre janë identifikuar zërat e tjerë të kostos. Për pak më shumë se 30.000 orë të këtij programi studimi do të duheshin rreth 200 (dyqind) pedagogë të brendshëm, ku ngarkesa e tyre vjetore është mesatarisht 150 (njëqind e pesëdhjetë) orë. Për koeficientët e tjerë në përlogaritjen e kostos së studimit “Mjekësi e Përgjithshme” janë përdorur ato të Vendimit të KM nr. 527/2023.

Varianti 1: Përcaktimi i peshës specifike në %, i programit të studimit “Mjekësi e Përgjithshme” në raport me programet e tjera të studimit të ofruara nga FM. Referuar planeve mësimore të studimit, orët përkatëse në auditor, numrit të grupeve të studentëve të programeve të studimit (cikli I+II+III) të konvertuara në përputhje me koeficientët të Udhëzimit të MAS nr. 29/2018 “Për veprimtarinë mësimore dhe ngarkesën e personelit akademik në IAL”, i ndryshuar, është përlogaritur pesha specifike që zë çdo program studimi ndaj totalit.

	Të dhënat për fakultetin	Të dhënat "Mjekësi e Përgjithshme"
Pesha Specifike	100%	39.4%
Kosto direkte		
Fondi personeli	747,170,330*	294,385,110
Shpenzime per bursa	83,700,000	76,400,000
Total kosto direkte	830,870,330	370,785,110
Kosto indirekte		
Shpenzime Kapitale 15% mbi fondin e pagave**	124,630,550	44,157,767
Shpenzime Operative 20% mbi fondin e pagave**	166,174,066	58,877,022
Total kosto indirekte	290,804,616	103,034,789
Total kosto (direkte + indirekte)	1,121,674,946	473,819,899
Nr. i kuotave te certifikuara te studenteve MP viti akademik 23-24		2,250
Kosto për student		210,587

*Kjo vlerë ka dalë referuar PBA së FM, ku totalit të fondit të pagave i është zbritur parashikimi i fondit të Doktoraturave dhe i është shtuar vlera përkatëse që FM jep për pagat e njësisë qendrore, Rektoratit të UMT-së.

**Shpenzimet kapitale dhe operative janë marrë në vlerat maksimale të parashikuara nga VKM referuar/sqaruar pikave të mësipërme b1 dhe b2.

Varianti 2: Ky variant është paraqitur në të njëjtën mënyrë si varianti i parë por duke përfshirë vetëm ngarkesën mësimore leksione-seminare të programeve të specializimeve aftatgjata, duke qenë se praktikat klinike mësimore janë një proces i lidhur kryesisht me kontributin e strukturave shëndetësore universitare.

	Të dhënat për fakultetin	Të dhënat "Mjekësi e Përgjithshme"
Pesha Specifike	100%	51.8%
Kosto direkte		
Fondi personeli	747,170,330	387,034,231
Shpenzime për bursa	83,700,000	76,400,000
Total kosto direkte	830,870,330	463,434,231
Kosto indirekte		
Shpenzime Kapitale 10% mbi fondin e pagave*	83,087,033	38,703,423
Shpenzime Operative 15% mbi fondin e pagave*	124,630,550	58,055,135
Total kosto indirekte	1,038,587,913	96,758,558
Total kosto (direkte + indirekte)	1,869,458,243	560,192,789

Numri i kuotave te certifikuara te studenteve MP viti akademik 23-24		2,250
Kosto për student		248,975

* Shpenzimet e kapitale dhe operative janë marrë në vlerat minimale të parashikuara nga VKM duke qenë se ky variant i ka të reduktuara kostot e kontributeve të strukturave shëndetësore universitare krahasuar me variantin e parë.

Varianti 3: Ky variant është ndërtuar ndryshe nga dy të parët. Janë marrë për bazë orët mësimore të programit të studimit “Mjekësisë e Përgjithshme” dhe mbi bazën e tyre janë identifikuar zërat e tjerë të kostos. Për pak më shumë se 30.000 orë të këtij programi studimi do të duheshin rreth 200 (dyqind) pedagogë të brendshëm, ku ngarkesa e tyre vjetore është mesatarisht 150 (njëqind e pesëdhjetë) orë. Për koeficientët e tjerë në përllogaritjen e kostos së studimit “Mjekësi e Përgjithshme” janë përdorur ato të Vendimit të KM nr. 527/2023.

	Të dhënat për fakultetin	Të dhënat "Mjekësi e Përgjithshme"
Kosto direkte		
Fondi personeli	760,278,058	540,020,632
Shpenzime për bursa	83,700,000	76,400,000
Total kosto direkte	843,978,058	616,420,632
Kosto indirekte		
Shpenzime Kapitale 10% mbi fondin e pagave*	84,397,806	54,002,063
Shpenzime Operative 15% mbi fondin e pagave*	126,596,709	81,003,095
Total kosto indirekte	210,994,515	135,005,158
Total kosto (direkte + indirekte)	1,054,972,573	751,425,790
Nr. i kuotave te certifikuara të studenteve MP viti akademik 23-24		2,250
Kosto për student		333,967

* Shpenzimet kapitale dhe operative janë marrë në vlerat minimale të parashikuara nga VKM duke qenë se ky variant i ka të reduktuara kostot e kontributeve të strukturave shëndetësore universitare krahasuar me variantin e parë.

Ky grup ka paraqitur relacionin në Rektorat, Senatit Akademik dhe Bordin e Administrimit për vendimmarrje, sipas përcaktimeve të Vendimit të KM nr. 527/2023.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur komenti me shkresë nr. 1421/12, datë 09.10.2023, (protokolli i UMT për këtë koment nr.2917/1, datë 10.10.2023, e protokolluar në KLSH me nr. 401/6, datë 10.10.2023, “Mbi observacionet e akt konstatimeve” nga M.J.

Pretendimi i subjektit: Bazuar në vlerësimin e të gjithë të dhënave të mbledhura, të dokumentacionit shtesë të adminsitruar në Rektoratin e UMT me nr.2956/5 prot, datë 03.10.2023 dhe nr.2956/6, datë 04.10.2023 në fushën e kompetencës të secilit prej antarëve të Grupit të punës, propozon variantin e dytë, referuar relacionit të grupit të punës nr.2693/3 prot datë 27.09.2023) për përllogaritjen e kostos së studimit në programin e integruar të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme”, në FM në UMT më kosto për student 248,975 lekë, e miratuar në organet kolegiale të UMT Vendimi Qarkullues i Senatit Akademik të UMT nr.109, datë 06.10.2023 dhe Vendimin e Bordit të Administrimit nr.62, datë 09.10.2023.

III. KONKLUZIONI I PËRGJITHSHËM DHE OPINIONI I AUDITIMIT.

OPINIONI I AUDITIMIT

I. Opinion mbi auditimin e përputhshmërisë⁵:

Ne kemi audituar zbatueshmërinë e akteve ligjore dhe nën ligjore, gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga ana e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, në lidhje me planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, të ardhurat si dhe realizimin e shpenzimeve me ekonomikitet dhe efektivitet; veprimtarinë e MFK dhe Auditit të brendshëm, vendimet e Bordit të Administrimit dhe të Senatit, strukturën organizative, procesin e rekrutimit e largimit nga puna, projektet kërkimore shkencore, specializimet afatgjata, pasqyrat financiare, qarkullimin e vlerave materiale e monetare, zbatimin e procedurave të prokurimit publik, përcaktimin e tarifave të studentëve.

Opinion i modifikuar/ i kualifikuar.

Sipas opinionit tonë, përveç rasteve të cilësuar në paragrafin e “Baza për opinionin për opinionin e modifikuar” subjekti i audituar, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, përgjithësisht ka vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit të nxjerra nga aktet ligjore dhe nënligjore, mbi të cilën ka ushtruar veprimtarinë e tij.

Baza për opinionin e modifikuar/ kualifikuar:

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për përputhshmërinë.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme, e plotë, e saktë dhe e përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë në përgjithësi kanë vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit. Mangësitë e evidentuara në disa çështje të audituara sipas përshkrimit të mëposhtëm, janë materiale, por jo të përhapura të cilat justifikojnë dhënien e opinionit të modifikuar/ të kualifikuar.

Përshkrimi i çështjeve:

- UMT, për tarifën e programeve të studimit, nuk ka kryer një metodologji për llogaritjen e tyre deri në shtator 2023. Tarifën e aplikuar nga UMT dalin mbi bazën e një reference në lidhje me shpenzimet hipotetike të vitit koherent, duke marrë për bazë shpenzimet e vitit të mëparshëm. Rezultoni pa pajtueshmëri me legjislacionin specifik për arsimin e lartë. Institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri, zhvillojnë/kryejnë veprimtarinë e tyre në përputhje me ligjin specifik nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH” dhe akteve nënligjore në fuqi të dalë në zbatim të tij.

- Nga auditimi i sistemeve të MFK në UMT, rezultoi se, nuk janë implementuar si duhet kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

- Veprimtaria e NJAB ka qenë në mos përputhje të plotë me kuadrin rregullator në fuqi.

- Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, ka pasur dhe vazhdon të ketë mungesë të theksuar të stafit akademik.

⁵ ISSAI 4000-23: Objektivi kryesor i auditimit të përputhshmërisë është t’i sigurojë përdoruesit të synuar informacione nëse entitetet publike të audituara ndjekin vendimet parlamentare, ligjet, aktet legjislative, politikat, kode të përcaktuara dhe terma të dakordësuar

- Rektori, rezulton të jetë i punësuar me orar të plotë, në pozicionin e pedagogut në Departamentin e Kirurgjisë, të Fakultetit të Mjekësisë, të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë. Rektori, është staf administrativ i Rektoratit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe jo staf akademik siç figuron në listë pagesat dhe listë prezencat e FM të Universitetit të Mjekësisë Tiranë.

- Prezenca e anëtareve të Bordit të Administrimit, është e konfirmuar me një shkresë të vetme në fund të çdo muaji, pa datë, pa numër protokoll dhe pa listë prezencat me datat përkatëse për çdo mbledhje të zhvilluar.

- Pedagoget e kontraktuar me vonesë nga Rektorati, rezultojnë ligjërisht të kenë dhënë orë mësimi dhe të kenë kryer vlerësimet respektive për orët e mësimdhënies të zhvilluara, pa patur më parë një kontratë punësimi me Universitetin Mjekësor të Tiranës. Pedagoget e jashtëm, të kontraktuar nga UMT, kanë kryer punën e pedagogut dhe njëkohësisht kanë certifikuar studentët për lëndët mësimore të dhëna ndaj tyre, pa patur marrëdhënie pune ligjore.

- U konstatua se nuk është bërë një analizë e mirë strukturuar për planifikimin e nevojave buxhetore, është i pranishëm risku i kryerjes së parashikimeve të pabazuara nga ana e departamentit të menaxhimit të programeve, që figurojnë me përqindje të ulët realizueshmërie në disa raste.

- Përdorimi i të ardhurave është me mosrealizime, janë trashëguar të ardhurat nga viti 2019 në vitin 2020 në shumën **711,593,504** lekë, nga viti 2020 në vitin 2021 në shumën **704,162,196** lekë dhe nga viti 2021 në vitin 2022 në shumën **802,513,792** lekë, ndërkohë që në ligjin nr. 80/2015, neni 118 “*Institucionet publike të pavarura të arsimit të lartë*”, në pikën 5, është përcaktuar se: “*IALPP-të nuk kanë qëllim fitimin dhe të ardhurat e përfituara nga veprimtaria dhe pasuritë e tyre përdoren për realizimin e misionit të institucionit*”.

- Në FSHMT, të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, në shumicën e rasteve nuk ka dokumentacion të plotë justifikues lidhur me evidentimin e shpenzimeve të karburantit.

- Në pasqyrat financiare të konsoliduar të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, për **Fakultetin e Mjekësisë** vlera e llogarisë nën rubrika “Gjendje e inventarit qarkullues” llogaria 31 “Materiale”, si dhe nën rubrika “Aktive afat gjata materiale”, llogaria 214 “Instalime elektrike, makineri e pajisje si dhe llogaria 218 “Inventar ekonomik,” vlera neto kontabël e tyre është e pa rakorduar me vlerën fizike. Si UMT për periudhën nga viti 2013 e në vazhdim, veprimet për ndryshimet e gjendjeve të këtyre llogarive janë të rakorduar, për hyrje daljet, por gjendja fillestare në çelje në fillim të vitit 2013 (vit i bashkimit), nuk ka një listë të artikujve gjendje, nuk vërtetohet gjendja kontabël me atë fizike.

- Nga ana e UMT-së, nuk janë regjistruar pronësit dhe kufijtë e pasurive të paluajtshme si dhe nuk janë dokumentuar aktet e fitimit të pronësisë për çdo rast

- Parregullsi në zbatimin e kontratave;

- Në Autoritetin Kontraktor UMT, gjatë periudhës objekt auditimi rezulton se ka 24 anulime procedurash të cilat shkojnë deri në tre herë anulim, në vlerën 216,010,127.35 lekë, duke sjellë mospërdorim të fondeve si nga buxheti ashtu dhe nga të ardhurat e veta, me ndikim në realizimin e misionit të kësaj IAL.

- Në përgjithësi kriteret e veçanta për kualifikim nuk janë të argumentuara dhe në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP si dhe ka raste të vlerësimit të gabuar nga ana e KVO.

- U konstatua dëm ekonomik në një rast në shumën **513,552 lekë si dhe përdorim pa efektivitet të fondeve në tre raste në shumën 35,145,120 lekë.**

Përgjegjësitë e Drejtuesve të UMT:

Strukturat drejtuese të UMT, janë përgjegjëse për hartimin e politikave në përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet të fondeve publike, në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit).

Gjithashtu, strukturat drejtuese të UMT janë përgjegjëse për funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, hartimin e procedurave, aktiviteteve të kontrollit, gjurmës së auditimit për të aktivitet kryesore të saj.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi, që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me zbatueshmërinë e kriterëve të vlerësimit, kuadrin ligjor dhe rregullator nga ana e subjektit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë në vendosim, që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET**A- PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI.**

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultojnë pa pajtueshmëri me legjislacionin specifik për arsimin e lartë. Institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri, zhvillojnë/kryejnë veprimtarinë e tyre në përputhje me ligjin specifik nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH” dhe akteve nënligjore në fuqi të dalë në zbatim të tij.

Në këtë ligj, në nenin 91 “Lëshimi i diplomave, certifikatave dhe suplementi i diplomës”, në pikën 1, është përcaktuar se “Në përfundim të programit të studimit, studenti pajiset me diplomën ose certifikatën përkatëse. Elementet përbërëse, forma e diplomës dhe procedurat për regjistrimin përcaktohen nga ministria përgjegjëse për arsimin”. Nga ku rezultojnë se nuk është parashikuar si e drejtë e studentit pajisja me diplomë nga institucion tjetër përveç IAL në të cilën studentit ka përfunduar studimet.

Në ligjin nr.60/2023 “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme”, në nenin 1, “Objekti”, është përcaktuar se “Ky ligj përcakton rregulla të veçanta për trajtimin e studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë”.

Në nenin 4 të ligjit nr.60/2023, “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme”, përcaktohet se kandidati "pranon kalimin zyrtarisht të diplomës përkatëse të arsimit të lartë nga institucioni publik i arsimit të

lartë, ku ka përfunduar studimet, në institucionin shëndetësor ku punësohet deri në shlyerjen e detyrimeve për punësim sipas afatit 5/3/2- vjeçar, me të drejtën që pas përmbushjes së detyrimit të punësimit të tërheqë diplomën universitare”.

Në përfundim të sa më lart, konstatojmë se neni 4, i ligjit 60/2023, është në kundërshtim me nenin 91, pika 1, të ligjit 80/2015.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.15. faqe 221 -232 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandim: Universiteti i Mjekësisë Tiranë dhe organet kolegjiale të tij, të marrin masat për dërgimin e propozimeve të nevojshme ligjore tek Ministria e Arsimit Sporteve, për shmangien e konfliktit ligjor të krijuar nga dy ligje për të njëjtin qëllim.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi për zbatimin e ligjit nr.60/2023, “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme”, i cili është miratuar në datë 21.07.2023, botuar në Fletoren Zyrtare nr.123, datë 16.08.2023 rezultoi se ai në zbatim të nenit 11 të tij, hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare (datë 31.08.2023). Të gjitha detyrimet e studentëve që regjistrohen për herë të parë në mjekësi të përgjithshme, duhet të fillojnë me nënshkrimin e një deklaratë (neni 4, pika 1/a ligji 60/2023) para zhvillimit të testimit të informatizuar. Testimi i informatizuar është zhvilluar në datat 14-23 gusht 2023 (burimi i të dhënës: njoftimi në faqet zyrtare të QSHA dhe UMT), para datës së hyrjes në fuqi të ligjit 60/2023 (31 gusht 2023, neni 11 i ligjit). Para zhvillimit të testimit të informatizuar për pranimin në programin “Mjekësi e Përgjithshme” maurantët nuk kanë nënshkruar deklaratën sipas nenit 4, pika 1/a, e për pasojë dhe plotësimin e pikave b (marrëveshja) dhe c (kalimi i diplomës një institucioni tjetër) të këtij neni. Konstatojmë se regjistrimi i maurantëve fitues në programin Mjekësisë ka filluar që në datën 29 gusht 2023, sipas akteve nënligjore të MAS dhe institucioneve të varësisë të saj (deri me 30 gusht janë regjistruar 95% të studentëve fitues në mjekësi).

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.15. faqe 221 -232 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandim: Universiteti i Mjekësisë Tiranë dhe organet kolegjiale të tij, të marrin masat për dërgimin e propozimeve të nevojshme ligjore tek Ministria e Arsimit Sporteve, për hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore për maurantët fitues në programin e mjekësisë, të cilët kanë përfunduar procedurat përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr.60/2023, i cili është miratuar në datë 21.07.2023 “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme”.

Menjëherë

B- MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i sistemeve të MFK në UMT, rezultoi se, nuk janë zbatuar si duhet kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pasi:

- “Mjedisi i kontrollit” nuk ka programe të trajnimit për integritetin dhe sjelljen; mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm; nuk ka asnjë plan menaxhimi për veprime korrigjuese, përshkrimi i punës nuk është i plotë për të gjithë stafin e Rektoratit; mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit. Nga verifikimi i veprimtarisë së Grupi të Menaxhimit Strategjik rezultoi se: Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të UMT-së, në të cilin të përfshihej Grupi i Menaxhimit Strategjik me

detyrat dhe përgjegjësitë e tij.

- “Menaxhimi i riskut”: nuk ka përfunduar asnjë mision auditimi nga Njësia e Auditimit të Brendshëm ku trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut, nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin, nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë. Nga institucioni është mjaftuar me Rregulloren e Brendshme për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjes së konfidentalitetit dhe me Kodin Etik të UMT-së.

- “Veprimtaritë e Kontrollit”: nuk ka përfunduar asnjë mision auditimi nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, sipas kërkesave të pikës 3, neni 22, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar. Nuk ka sistem back-up, RASH për sistemet e instaluar prej tij ka back-up e tij. Serveri kryesor gjendet në RASH i cili menaxhon dhe mban përgjegjësi për të. Domine i faqes zyrtare të UMT-së është e hostuar në AKSH dhe mirëmbahet nga një specialist IT. Mirëmbajtja e hardware dhe software bëhet nga një specialist në Drejtorinë e Administrimit Akademik dhe Kurrikulave, pozicion i cili është vakant për gjithë periudhën e auditimit. Aktualisht rezulton që këto detyra i ka realizuar specialisti IT web. Konstatohet se, nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT.

- “Informacioni dhe Komunikimi”: Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

- “Monitorimi”: mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produktit; raportet e monitorimit të veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë; aktiviteti i Auditimit të Brendshëm, rezulton me asnjë mision auditimi i cili të jetë përfunduar me Raport Përfundimtar Auditimi e i cili do të mund të dilte me opinion në lidhje me MFK dhe aktivitete e UMT-së, e për pasojë niveli drejtues i njësisë publike nuk mund të monitorojë në mënyrë të plotë statusin e veprimeve korrigjuese në mënyrë që ato të përfundojnë në kohën e duhur dhe të sjellin rezultatin e pritur kjo realizohet vetëm nëpërmjet planeve të veprimit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2,1. faqe 21 -39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: UMT, Grupi i Menaxhimit Strategjik, të marrë masa për plotësimin e mangësive të evidentuara si dhe implementimin e një sistemi të përshtatshëm rregullash të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, sipas përcaktimeve të ligjit të MFK-së dhe akteve nënligjore e rregullatore në zbatim të tij, për ta bërë atë efektiv dhe në dobi të veprimtarisë institucionale të UMT-së.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i veprimtarisë së auditit të brendshëm në UMT, rezulton se: Struktura dhe organizimi i njësisë së auditit të brendshëm është e përbërë nga tre punonjës, nga të cilat një përgjegjës i njësisë së auditimit dhe dy specialist. Njësia e auditit të brendshëm sipas Statutit të UMT-së, pika 2, neni 53 dhe pika 3, neni 90, është në varësi direkte të Bordit të Administrimit të UMT-së, duke siguruar kështu pavarësinë organizative të NJAB dhe krijuar kushtet për pavarësi funksionale nëpërmjet zhvillimit të veprimtarisë të NJAB bazuar në kuadrin rregullator ligjor në fuqi.

Për vitin 2020 njësia e auditit të brendshëm ka funksionuar me një përgjegjës dhe një specialist dhe **për vitin 2021** ka patur në përbërje dy specialist, por gjatë këtij viti ka dhënë dorëheqjen përgjegjësjë e kësaj njësie duke bërë që deri në datë 01.07.2022, kjo njësi të ketë patur vetëm dy

specialistët dhe më datë 01.07.2022 është caktuar një përgjegjës i cili aktualisht është larguar me dorëheqje të datës 22.05.2023 e në këtë pozicion është komanduar një nga specialistët duke qenë aktualisht struktura e pa plotësuar që ndikon në funksionimin e njësisë së auditit të brendshëm.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 39 -50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Bordi i Administrimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, në cilësinë e titullarit të Njesisë së Auditit të Brendshëm, të marrë masat me qëllim plotësimin e strukturës me personelin e nevojshëm.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në UMT të veprimtarisë së Auditit të Brendshëm, rezultoi se, për vitin 2020 nuk është përfunduar e evaduar asnjë mision auditimi. Në lidhje me këtë periudhë, auditimi i veprimtarisë së Njesisë së Auditimit të Brendshëm është realizuar dhe një vlerësim i jashtëm i cilësisë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, sipas Programit të Vlerësimit të Jashtëm të Cilësisë, në përfundim të të cilës me Raportin Përfundimtar të marsit 2021 është konkluduar me opinionin e përgjithshëm të veprimtarisë së Njesisë së Auditimit të Brendshëm duke e cilësuar: “*se veprimtaria e NJAB ka qenë në mos përputhje të plotë me kuadrin rregullator në fuqi*”.

Për vitin 2021 me Vendimin e Bordit të Administrimit nr.2, datë 14.01.2021 (me nr.84/2 prot., datë 14.01.2021) është miratuar plani vjetor, për veprimtarinë e NJAB të UMT, ku janë parashikuar 8 angazhime auditimi, nga auditimi rezultoi se nuk është përfunduar e evaduar asnjë mision auditimi.

Për vitin 2022 nga auditimi rezulton se, nuk ka patur të miratuar as plan pune nga Bordi Administrimit të UMT nga muaji gusht i vitit 2021 deri në shtator të 2022 si dhe nuk ka patur asnjë mision auditimi të realizuar. Megjithëse nga Përgjegjësi i Njesisë së Auditit të Brendshëm, i emëruar në korrik 2022 (tashmë i larguar me dorëheqje), është arritur të paraqitet e të miratohet një plan pune për periudhën e mbetur shtator –dhjetor 2022 i miratuar me VBA nr.53 datë 27.09.2022 për dy misione auditimi të tipit financiar të vlerësuar me risk të lartë në subjektet FM dhe FSHMT rezulton se (edhe sipas Raportit të veprimtarisë së NJAB për vitin 2022): të dy angazhimet e filluara e të planifikuara në planin e punës janë ndërprerë duke mos patur një punë normale raportimi përfundimtar auditimi, duke bërë që kjo NJAB prej tre vjetësh nuk arrin të përfundojë asnjë mision auditimi dhe njëkohësisht nuk arrin as të përmbushë detyrat ligjore funksionale në përmbushje të misionit e qëllimit për të cilën është krijuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 39 -50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: Bordi i Administrimit i Universitetit të Mjekësisë Tiranë, në cilësinë e titullarit të NJAB të marrë masat me qëllim jo vetëm plotësimin e strukturës së NJAB me personelin e nevojshëm por dhe të vlerësimit pas një analizimi të thellë të gjendjes së veprimtarisë së kësaj Njësie Auditimi, me qëllim zbatimin (si nga Bordi i Administrimit dhe nga NJAB) të detyrave funksionale ligjore në përmbushje të misionit e të qëllimit nëpërmjet realizimit të misioneve audituese të nisura, realizuara e të evaduara sipas legjisllacionit në fuqi.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se për vitet 2020, 2021 dhe 2022, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, ka pasur dhe vazhdon të ketë mungesë të theksuar të stafit akademik. Konkretisht për vitin 2020, UMT ka mosplotësim organike për 71 nëpunës (punonjës akademike dhe ndihmës) ose 13% më pak se plani, për vitin 2021 ka 53 punonjës më pak ose 10% më pak

dhe për vitin 2022 ka 73 punonjës më pak ose 13%, në kundërshtim me strukturën organike të miratuar. Kjo mangësi në stafin akademik dhe ndihmës akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, në vlerësim të grupit të auditimit, mund të ketë sjellë pasoja në zhvillimin me kohë të plotë të orëve mësimore sipas programeve studimore me rezultat mosarritjen e pritshmërive në mësimdhënie.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 dhe 2.4 faqe 50 -61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1 Rekomandimi: Nga ana e UMT, të merren masa për plotësimin e strukturës me qëllim pakësimin e stafit akademik të kontraktuar me kohë të pjesshme, për rritjen e pritshmërive në mësimdhënie.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në Universitetin e Mjekësisë Tiranë, të listprezencave dhe listpagesave për periudhën e auditimit, rezultoi se Rektori, figuron në Fakultetin e Mjekësisë, Departamentin e Kirurgjisë, si staf akademik me kohë të plotë.

Nga auditimi i listprezencës së ndodhur në dosjet respektive të pagave për Fakultetin e Mjekësisë dhe për stafin administrativ të Rektoratit të Universitetit të Mjekësisë Tiranë, për periudhën objekt auditimi, u konstatua se në listprezencat e stafit të Rektoratit, është paraqitur si prezent në punë me orar me kohë të plotë Rektori. Nuk ka asnjë mundësi fizike që Rektori, pjesë e stafit administrativ të Universitetit Mjekësor të Tiranës, në pozicionin si drejtues i IAL-së publike, të jetë prezent në detyrat e tij të ngarkuara me ligj sipas pozicionit të emërimit, në të njëjtën kohë që është angazhuar me kohë të plotë në mësimdhënie në departamentin përkatës të fakultetit. Ligji për arsimin e lartë, i ngarkon Rektorit, të kryejë detyrat në funksion të miradministrimit të institucionit të UMT-së. Rektori kryen në realitet, detyrat e pedagogut dhe jo detyrat që i janë ngarkuar me ligj. Nga sa është konstatuar nga grupi i auditimit, rezulton se Autoritetet Drejtuese të Universitetit të Mjekësisë Tiranë, paguhen për funksione dytësore dhe jo për funksione parësore ndërkohë që ligji i ka ngarkuar përmbushjen e detyrave në funksionet parësore, kjo edhe për vetë rëndësinë në nivel kombëtar që ka Universiteti i Mjekësisë në Shqipëri, i cili obligon një nivel menaxhimi me kohë të plotë sipas kërkesave të ligjit. Angazhimi i Stafit Drejtues administrativ të UMT-së, në mësimdhënie, me kohë të plotë, në gjykim të grupit të auditimit ka krijuar/mund të ketë krijuar pasoja në miradministrimin e detyrave që ligji i ngarkon këtyre pozicioneve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 & 2.4 faqe 50 -61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1 Rekomandime: Universiteti i Mjekësisë Tiranë, Drejtoria Ekonomike, Sektori i Financës, të marrin masat, që stafi drejtues i institucionit, të pasqyrohet në listpagesat e Rektoratit të Universitetit sipas pozicioneve të tyre ligjore dhe jo në listpagesat e fakulteteve të cilat janë në varësi të Universitetit.

Menjëherë

5.2 Rekomandime: Rektorati i Universitetit të Mjekësisë, Bordi i Administrimit, Senati Akademik, Drejtoria e Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore, të marrin masat që Rektori, të angazhohet me kohë të plotë në detyrat e tij parësore, të ngarkuara nga ligji dhe në mësimdhënie, si detyrë dytësore.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të personelit administrativ të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, u konstatuan parregullsi në mënyrën e ndjekjes së procedurave për largimin e punonjësve nga puna. Në dy raste, nuk është vepruar sipas dispozitave të Kodit të Punës. Në të dy rastet, nuk u evidentua në dosjen personale të secilit punonjës, ndonjë dokument ligjor tek i cili të cilësoheshin shkaqet lidhur me vendimet e marra nga UMT për ndërprerje të marrëdhënieve të punës ose ndërprerje të kontratës së punës me punëmarrësit. Tek vendimet për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, cilësohet korrespondenca me e-mail midis punonjësve dhe UMT-së por tek kjo korrespondence nuk ka asnjë të dhënë që punonjësit të jenë njoftuar paraprakisht për shpërndarje të marrëdhënieve të punës, sipas Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 & 2.4 faqe 50 -61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1 Rekomandim: Universiteti i Mjekësisë Tiranë, Rektori, Administratori, Drejtorja e Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore, të marrin masat që në vazhdimësi, për shpërndarje të marrëdhënieve të punës me punonjësit e Universitetit të Mjekësisë, të respektohen procedurat e duhura ligjore dhe hapat e nevojshëm për të shmangur çdo lloj dëmshpërblimi në dëm të buxhetit të shtetit, që punonjësit e larguar padrejtësisht, mund të kërkojnë.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i disa praktikave lidhur me mbledhjet që ka zhvilluar Bordi i Administrimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, u konstatua se prezenca e anëtarëve të Bordit të Administrimit, është e konfirmuar me një shkresë të vetme në fund të çdo muaji, pa datë, pa numër protokollit dhe pa listë prezencat me datat përkatëse për çdo mbledhje të zhvilluar. Nga auditimi, nuk rezultoi që sekretari i Bordit të Administrimit, të ketë mbajtur ndonjë procesverbal për listë prezencën ditore të zhvillimit të mbledhjes nga Bordi i Administrimit, por vetëm atë mujore duke mos respektuar nenin 16, pikën (1) dhe pikën (2), të ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”.

Nga auditimi me zgjedhje i praktikave të ndjekura nga Sekretari i Senatit Akademik, për periudhën objekt auditimi, nuk u konstatua ndonjë procesverbal i mbajtur në orarin e mbajtjes së mbledhjes. Procesverbalet e zbardhura të mbledhjeve të zhvilluara për periudhën objekt auditimi, janë të nënshkruara vetëm nga Kryetari i Senatit Akademik dhe Sekretari. Nuk dokumentohet nëse kanë qenë prezent në mbledhje, anëtarët e Senatit Akademik. Gjithashtu, mungesa e dokumentacionit vërtetues për listë prezencën në çdo mbledhje të zhvilluar, nuk është në përputhje me pikën 7, të VKM nr. 656, datë 31.10.2018 “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të Këshillave, Bordeve ose Komisioneve të Përhershëm”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 61 -76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1 Rekomandim: Sekretari i Bordit të Administrimit dhe i Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë Tiranë, të marrë masat që në të ardhmen, të dokumentohet prezenca e të gjithë anëtarëve pjesëmarrës në çdo mbledhje të zhvilluar nga Bordi i Administrimit, në respektim të ligjeve dhe rregullave në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje të vendimeve të Bordit të Administrimit, u konstatua një vendim për marrjen me qira të ambienteve mësimore në një universitet tjetër. Konkretisht: Vendimi nr. 10, (nr. 200/10 Prot., datë 26.10.2022), me objekt “Miratimin e pagesës

së qirasë mësimore, për Fakultetin e Mjekësisë Dentare, Tiranë, për vitin akademik 2019-2020”. Në lidhje me këtë praktikë, u konstatua se Universiteti i Mjekësisë Tiranë dhe Universiteti i Tiranës, kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi. Në nenin 3 të marrëveshjes së nënshkruar, cilësohet se: *“Bashkëpunimet e mbështetura në këtë marrëveshje do të përcaktohen në detaje në anekse të veçanta. Këto anekse do të nënshkruhen nga Drejtuesit e Njësive Kryesore të secilës palë të cilët do të pajisen me autorizimin përkatës nga Titullari i institucionit, si dhe pasi Njësitë Kryesore përkatëse brenda universiteteve, të kenë përcaktuar detajet e tyre në praktikë”*. Aneks Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Fakultetit të Shkencave të Natyrës së Universitetit të Tiranës dhe FMD të Universitetit të Mjekësisë, është nënshkruar në datën 30.06.2020. Aneks Marrëveshja nuk i referohet në përmbajtje Marrëveshjes Bazë të nënshkruar nga Rektori i Universitetit të Tiranës dhe Rektori i Universitetit të Mjekësisë pasi në Marrëveshjen Bazë, nuk bëhet fjalë për bashkëpunim në kuptimin e marrjes me qira ambientesh nga njëra palë me përfitim monetar vetëm të njëres palë por për bashkëpunim mbi bazën e shkëmbimit të personelit akademik. Pra Marrëveshja Bazë është një Marrëveshje e cila shpreh dy vullnete që përcaktojnë një sërë rregullash ose veprimesh që duhen respektuar dhe ekzekutuar nga palët për përfitim reciprok. Aneks Marrëveshja, është nënshkruar nga Dekani i Fakultetit të Mjekësisë Dentare, pa pasur më parë një autorizim me shkrim nga Rektori i Universitetit të Mjekësisë, në kundërshtim me nenin 3 të Marrëveshjes Bazë. Në Akt Marrëveshjen bazë, nuk justifikohet dhe as bazohet në ndonjë ligj apo rregullore, pagesa e punonjësve jo mësimorë të Universitetit të Shkencave të Natyrës apo përcaktimi në Akt Marrëveshje i pagesës së këtyre punonjësve për punë jashtë orarit (neni 1 i Akt Marrëveshjes) në të njëjtën kohë që këta punonjës (jo mësimorë) nuk janë pjesë e stafit të Universitetit Mjekësor të Tiranës por as nuk është kërkuar nga Fakultetet e Universitetit të Mjekësisë, staf ndihmës por vetëm ambiente dhe laboratorë. FM, FMD dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore dhe Teknike, nuk kanë në përbërje të stafeve të tyre administrative, punonjës apo konsulent të jashtëm me profesion jurist e si të tilla, nuk kanë kapacitetet e nevojshme për të zbatuar me rigorozitet ligjin dhe rregullat në fuqi. Është detyrë e Universitetit të Mjekësisë (Rektoratit) për të asistuar në konceptimin dhe hartimin e Akt Marrëveshjeve apo kontratave të ndryshme që mund të kenë nevojë të nënshkruajnë Fakultetet e Universitetit të Mjekësisë me palët e treta.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 61 -76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1 Rekomandim: Drejtoria e Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore në Universitetin e Mjekësisë, Sektori i Shërbimeve Juridike, të marrë masat që përpara nënshkrimit nga Rektori apo Drejtuesit e Njësive Kryesore të Universitetit të Mjekësisë të konceptojnë Marrëveshjet, Aneks Marrëveshjet, Kontratave apo çdo akt administrativ që nxirret për të krijuar një marrëdhënie bashkëpunimi ose jo, midis Universitetit të Mjekësisë/Fakulteteve përkatëse dhe kujtdo institucioni tjetër publik ose privat.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i praktikës së dorëzuar pranë grupit të auditimit lidhur me zbatimin e Aneks Marrëveshjes nr. 26/6 Prot., datë 30.06.2020, nga Fakulteti i Mjekësisë Dentare, që në fillimet e saj, atë të procesit të rekrutimit të stafit pedagogjik me kohë të pjesshme dhe zhvillimit të orëve mësimore për lëndët e fizikës, kimisë dhe biologjisë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës, për vitin akademik 2019-2020, rezultoi se kjo Aneks Marrëveshje, është nënshkruar pasi Dekani i FMD ka bërë publikimin e vendeve vakante për personel akademik me kohë të pjesshme për lëndët formuese, në datën 20.09.2019. Senati Akademik ka marrë vendimin nr. 43, për miratimin e personelit akademik me kohë të pjesshme

dhe të ftuar për vitin akademik 2019-2020 për Fakultetin e Mjekësisë. Kontratat individuale të punës për punonjësit me kohë të pjesshme personel akademik, në total 18 të tilla, janë me nr. 949/10 Prot., deri nr. 949/27 Prot., datë 12.10.2020. Sa më sipër, konstatohet se kontratat e nënshkuara midis Universitetit të Mjekësisë dhe pedagogëve të shpallur fitues të procedurave të rekrutimit për vitet përkatëse akademike, janë nënshkruar pas përfundimit të vitit akademik. Pra, pedagogët e jashtëm të kontraktuar nga Fakultetet përkatëse, kanë dhënë mësim tek studentët përkatës sipas cikleve të studimit dhe njëkohësisht janë likuiduar për këto orë mësimi, pa pasur në fillim një kontratë pune me Fakultetin përkatës. Miratimi dhe vendimi i shpalljes së fituesve për vendet vakante për pedagogë me kohë të pjesshme, është bërë në Muajin Maj 2020 kur pedagogët kanë qenë të domosdoshëm në Tetor 2019. Pra logjikisht, pedagogët e kontraktuar me vonesë nga Rektori, rezultojnë ligjërisht të kenë dhënë orë mësimi dhe të kenë kryer vlerësimet respektive për orët e mësimdhënies të zhvilluara, pa patur më parë një kontratë punësimi me Universitetin Mjekësor të Tiranës. Pedagogët e jashtëm, të kontraktuar nga UMT, kanë kryer punën e pedagogut dhe njëkohësisht kanë certifikuar studentët për lëndët mësimore të dhëna ndaj tyre, pa patur marrëdhënie pune ligjore (pasi kontratat rezultojnë të nënshkuara pas kryerjes së mësimdhënies me efekt prapaveprues) me UMT. Kjo gjë, përveç faktit që sjell parregullsi të karakterit ekonomiko-administrativ në Universitetin e Mjekësisë, njëkohësisht, mund të krijojë dhe probleme juridike në të ardhmen, lidhur me vlefshmërinë e shërbimit të mësimdhënies. Gjithashtu, ky shërbim, i ligjëruar pas kryerjes së tij, e bën të pamundur kontrollin në përputhje me legjislacionin në fuqi për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin si nga Auditi i Brendshëm ashtu edhe nga ai i Jashtëm, në kohën e ofrimit të këtij shërbimi.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.13. faqe 143 -146 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1 Rekomandim: Rektori i Universitetit të Mjekësisë, Senati Akademik, Bordi i Administrimit, Drejtorja e Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore në UMT, të marrin masat që në të ardhmen, kontratat individuale të punës, të nënshkruhen brenda afateve ligjore me qëllim, eliminimin e problemeve juridike, lidhur me vlefshmërinë e shërbimit të mësimdhënies.

Menjëherë dhe në vijimësi

9.2 Rekomandim: Rektori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, Senati Akademik, të marrin masa për nxjerrjen e përgjegjësive të stafit administrativ të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, lidhur me shkeljet e konstatuara në lidhje me nënshkrimin e kontratave individuale të punës për pedagogët me kohë të pjesshme, kontrata të cilat janë nënshkruar me efekte prapavepruese pas kryerjes së shërbimit të mësimdhënies.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit të vënë në dispozicion lidhur me Rregulloren e Brendshme të Universitetit të Mjekësisë dhe të fakulteteve respektive, u konstatua se institucioni ka përditësuar Statutin, sipas vendimit të Senatit Akademik me nr. 11, datë 11.02.2019 dhe rregulloren e brendshme sipas vendimit nr. 59, datë 27.06.2022. Nga auditimi u konstatua se mungonin përshkrimet e punës dhe përgjegjësitë apo detyrat e Drejtorive dhe Sektorëve përkatës. Me vendimin nr. 63, datë 08.10.2021, Senati Akademik ka miratuar kriteret e punësimit të personelit administrativ të Universitetit të Mjekësisë me përshkrimet e punës & kriteret e punësimit për personelin administrativ të UMT-së, por këto nuk janë pjesë e rregullores së brendshme të UMT-së. Nga auditimi i vendimit nr. 63, datë 08.10.2021 të Senatit Akademik, u konstatua se përshkrimet e punës & kriteret e punësimit për personelin administrativ të UMT-së, nuk janë bërë për të gjitha Drejtoritë apo sektorët e Rektoritit por

vetëm për një pjesë të stafit administrativ. Konkretisht, referuar organigramës së UMT-së, janë miratuar përshkrimet e punës & kriteret e punësimit, për Drejtorinë Ekonomike dhe Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse në Universitetin e Tiranës, por mungojnë këto përshkrime për Drejtorinë e Administrimit Akademik dhe Kurrikulës, për Drejtorinë e Kërkimit, Promovimit Akademik dhe Komunikimit dhe për Drejtorinë e Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore. Për rrjedhojë detyrat dhe të drejtat e personelit të stafit administrativ të UMT-së, nuk janë përcaktuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Mungesa e përshkrimeve të punës & kriteret e punësimit për personelin administrativ të UMT-së kufizon ndjeshëm nxjerrjen e përgjegjësive të stafit në rast të mos përmbushjes së detyrave të ngarkuara. Nuk u konstatua të ketë rregullore të brendshme ndonjë fakultet i Universitetit të Mjekësisë, në kuptim të ligjeve dhe rregullave respektive. Rregulloret e brendshme të fakulteteve, nuk janë rishikuar për tu përshtatur kërkesave të kuadrit të ligjor, konkretisht ligjit 80/2015, datë 17.09.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Nga auditimi konstatohet se Rregullorja Universitetit të Mjekësisë “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës”, nuk ka asnjë dokument që të vërtetojë rishikimin, përditësimin apo dhe hartimin e një rregulloreje të re e cila të përmbajë të gjitha rregullat dhe normat për veprimtarinë e Universitetit të Mjekësisë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4. faqe 50 -61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1 Rekomandim: Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, në funksion të kryerjes së përgjegjësive ligjore dhe realizimit të objektivave, të marrë masa për të rishikuar dhe përmirësuar Rregulloren e Brendshme të Rektoratit, duke reflektuar ndryshimet e ndodhura në kuadrin ligjor dhe aktet e tjera nënligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, u konstatua se nuk është bërë një analizë e mirë strukturuar për planifikimin e nevojave buxhetore. Nga auditimi konstatohet ndryshim (transferim) i fondeve, pa patur një analizë të detajuar argumentuese të situatës apo arsyeve që çojnë në këto vendimmarrje. Kjo dëshmon për një sistem të menaxhimit financiar jo të mirë konsoliduar, veprime jo në përputhje me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 3, pika 29 dhe ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 16, pika 2.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 76 -86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1 Rekomandim: Nga ana e Drejtorisë Ekonomike të merren masa, për të kryer planifikimin e buxhetit të pritshëm për t’u akorduar nëpërmjet një analize të mirë strukturuar të situatës faktike dhe nevojave të departamenteve.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, është i pranishëm risku i kryerjes së parashikimeve të pabazuara nga ana e departamentit të menaxhimit të programeve, që figurojnë me përqindje të ulët realizueshmërie në disa raste. Nga auditimi u konstatua se janë parashikuar zëra në llogarinë 602 “Shpenzime operative”, të cilat nuk janë realizuar siç është planifikuar. Prandaj, llogaria 602 në vitin 2020 është realizuar në masën 54.96%, në vitin 2021 është realizuar në masën 36.90% dhe në vitin 2022 në masën 43.19%. Zbatimi i buxhetit për vitin 2020 është realizuar në masën 81%, për vitin 2021 në masën 86% dhe për vitin 2022 në masën 87%,

veprime jo në përputhje me ligjin nr.57 datë 02.06.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 3, pika 29

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 76 -86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1 Rekomandim: Nga ana e Drejtorisë Ekonomike të bëhet programimi i buxhetit duke pasur parasysh nevojat reale gjatë vitit të pritshëm buxhetor dhe të shmangen programimet duke rritur bazën në një përqindje të caktuar. Gjatë vitit të angazhohen vetëm ato shpenzime të cilat janë planifikuar sipas llojit dhe të mos ndryshohet destinacioni i përdorimit të këtyre fondeve brenda artikujve buxhetorë.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nuk janë miratuar brenda afateve të përcaktuara PBA-të, e konkretisht: Programi Buxhetor Afatmesëm për vitet 2021-2023 (me një diferencë prej 84 ditë kalendarike); PBA për vitet 2022-2024 (me një diferencë prej 8 ditë kalendarike) dhe PBA për vitet 2023-2024 (me një diferencë prej 4 ditë kalendarike). Ndërkohë, miratimi i Programit Buxhetor Afatmesëm për vitet 2023-2025 është realizuar jashtë afatit të përcaktuar, si dhe është dërguar fillimisht në MAS, pa kaluar hapat për miratim sipas radhës kronologjike të përcaktuar me ligj, duke kaluar si fillim në Senat, GMS, Bord Administrimi, e së fundmi në MAS, në mospërputhje me: Ligjin nr.57 date 02.06.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; UMF nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”; UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde për zbatimin e buxhetit”; Ligji nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH”, Neni 38, pika 1/h dhe neni 49, pika 1/c.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 76 -86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

13.1 Rekomandim: Nga Organet Drejtuese të merren masa për miratimin e programit buxhetor afatmesëm brenda afateve të përcaktuara dhe respektimin e radhës kronologjike e hierarkike duke u miratuar fillimisht në Senat, GMS, Bord Administrimi, e së fundmi në MAS, në mënyrë që të mos pengohen proceset e punës në UMT.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i planifikimit, realizimit dhe përdorimit të të ardhurave rezultoi se:

-Në zërat “tarifa regjistrimi” dhe “të ardhura të tjera”, realizimi në vitet objekt auditimi është në kufijtë 114 – 205%, fakt që flet për një planifikim jo të saktë të të ardhurave.

- Zërat e shpenzimeve nga të ardhurat rezultojnë me një realizim mesatar 39.8%. Për artikullin 602 “mallra dhe shërbime të tjera”, ka një realizim mesatar vjetor 42.1%, ku përqindja më e madhe e mosrealizimit është e vitit 2020. Zëri i shpenzimit “Investime, art. (230+231)”, paraqitet me një nivel realizimi viti 2020 në 38% dhe vitet 2021 e 2022 përkatësisht me 9%, ku ka ndikuar shumë anulimi i procedurave të prokurimit apo zgjatja e procedurave të prokurimit. Në nivele të ulëta paraqiten shpenzimet nga të ardhurat në shpenzimet e pagave në planin buxhetor të miratuar të vitit 2020, 2021 e 2022. Një nga arsytet është mungesa stafit akademik dhe administrativ, **71 vende vakante** për vitin 2020, **53 vende vakante** për vitin 2021 dhe **73 vende vakante**. Gjithashtu nuk janë paguar të gjitha shpenzimet për ngarkesën mësimore pedagogë të

brendshëm e të jashtëm, shpenzimet për pagat nga të ardhurat për pedagogët me kontratë, situata e krijuar nga COVID 19 (viti 2021) si dhe në vitin 2022 nuk janë paguar të gjitha shpenzimet për ngarkesën mësimore pedagogë të brendshëm e të jashtëm, pagesat e udhëheqësve dhe oponentëve për procesin e mbrojtjes së doktoraturave.

- Përdorimi i të ardhurave është me mosrealizime, janë trashëguar të ardhurat nga viti 2019 në vitin 2020 në shumën **711,593,504** lekë, nga viti 2020 në vitin 2021 në shumën **704,162,196** lekë dhe nga viti 2021 në vitin 2022 në shumën **802,513,792** lekë, ndërkohë që në ligjin nr. 80/2015, neni 118 “Institucionet publike të pavarura të arsimit të lartë”, në pikën 5, është përcaktuar se: “IALPP-të nuk kanë qëllim fitimin dhe të ardhurat e përfituara nga veprimtaria dhe pasuritë e tyre përdoren për realizimin e misionit të institucionit”.

- Ndërkohë që të ardhurat e trashëguara të papërdorura janë në shumën **802,513,792** lekë, nga auditimi rezulton se UMT merr ambiente me qira, shfrytëzon ambiente të QSUT, merr staf akademik me kohë të pjesshme, etj., nga ku rezulton se UMT, ka pasur buxhet të trashëguar nga të ardhurat gjatë viteve, buxhet të cilin nuk e ka mirëadministruar për zhvillimin e misionit të saj, si krijimin e departamenteve të reja, duke pasur njëkohësisht mundësinë edhe të plotësimit me staf akademik dhe rritjen e investimeve në funksion të përmirësimit të shërbimit të mësimdhënies ndaj studentëve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7. faqe 86 -94 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1 Rekomandim: Nga ana e UMT, Drejtorisë Ekonomike dhe organeve kolegjinale të merren masa për planifikimin e përdorimit të të ardhurave për nevojat institucionale në shërbim të mësimdhënies dhe rritjes së cilësisë së arsimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

14.2 Rekomandim: MAS, në bashkëpunim me UMT të marrin masat për të analizuar situatën me qëllim vënien në përdorim të fondeve të mbartura për zhvillimin e mëtejshëm të UMT, duke u fokusuar në realizimin e misionit të institucionit, pse jo në hapjen e fakulteteve të reja në fushën e mjekësisë, në hapjen e laboratorëve etj.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i blerjeve me vlerë të vogël rezultoi se:

- Dosjet e procedurave të prokurimit të blerjeve me vlerë të vogël, në shumicën e rasteve nuk janë të inventarizuara. Ndërsa në disa raste, kërkesa për realizim prokurimi nuk është e protokolluar, ka dokumente të fotokopjuara në dosje, për marrjen në dorëzim të mallit nuk ka të dhëna mbi faturën tatimore (numër datë vlerë), vlerën, veprime në mospërputhje me: Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, neni 21, UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 36.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2. 8. faqe 94 -106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

15.1 Rekomandimi: Nga Komisionet e marrjes në dorëzim të merren masa për evidentimin e datave të skadencave të kiteve në procesverbalin e marrjes në dorëzim dhe plotësimin e të dhënave të faturave tatimore (numër, datë, vlerë), për të arritur objektivat dhe respektimin e afateve të skadencave të kiteve në përputhje me ligjin.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Në Fakultetin e Mjekësisë, të Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, në disa raste likuidimi i faturave tatimore të energjisë elektrike, të ujit dhe të shërbimit telefonik nuk është bërë brenda afatit 30 ditor. Fondet e buxhetit janë të ndara për 12 muaj dhe likuidimi i faturave duhet të bëhet për çdo muaj sipas afatit të përcaktuar. Mos likuidimi në kohë i tyre, nuk nxjerr në pah realizimin e buxhetit mujor dhe krijon premisa për lindjen e penaliteteve, të cilat rëndojnë mbi buxhetin e shtetit, veprime në mospërputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2. 8. faqe 94 -106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

16.1 Rekomandim: Nga Sektori i Financës të merren masa për likuidimin në kohë të faturave tatimore të energjisë elektrike, ujit dhe shërbimit telefonik.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Në FSHMT, të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, në shumicën e rasteve nuk ka dokumentacion të plotë justifikues lidhur me evidentimin e shpenzimeve të karburantit, nuk kanë bërë planifikim të nevojave për shërbim/mirëmbajtje të sistemit të ngrohjes me kaldaja. Në shumicën e rasteve, në dosje ka vetëm një fletë-dalje për karburantin dhe nuk ka bashkëngjitur dokumentacionin justifikues lidhur me situacionin, kartelat për konsumin, normën e konsumit për çdo orë ndezje të kaldajës, nuk ka informacion se sa orë është ndezur kaldaja apo se kush e ka ndezur atë. Nuk ka urdhri transferimi për daljen e karburantit nga magazina dhe destinacionin e tij. Nuk ka evidenca, lidhur me periudhën e pandemisë COVID-19, gjatë së cilës kaldajat nuk janë ndezur. Nuk kanë bërë një planifikim se sa karburant (sa litra) shpenzohet në vit për kaldajat, pasi vlerat e konsumuara sipas kontratave me kompaninë “R.E” sha janë të ndryshme. Nuk kanë bërë planifikim të nevojave për shërbim/mirëmbajtje të sistemit të ngrohjes me kaldaja. Lidhur me procesverbalet apo situacionet të FSHMT, për konsumin mujor të kaldajave të vitit 2022, (për muajt janar, shkurt dhe dhjetor 2022), ky dokument është i firmosur nga dy anëtarë të komisionit për ndjekjen e kontratës nga 3 anëtarë. Veprime jo në përputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”; Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 16, datë 25.02.2020, “Për miratimin e rregullores së brendshme për administrimin financiar, kontabilitetin dhe kontrollin në UMT”, neni 20, pika 2.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2. 8. faqe 94 -106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

18. Rekomandim: Nga ana e Administratorit të FSHMT, të dokumentohet çdo veprim lidhur me shkarkimin e karburantit dhe të bëhet planifikimi i nevojave për shërbim/ mirëmbajtje të sistemit të ngrohjes me kaldaja, pasi kjo sjell mungesën e evidentimit dhe transparencës lidhur me përdorimin e karburantit.

Menjëherë dhe në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i inventarëve për vitet objekt auditimi rezulton se nuk është nxjerrë jashtë përdorimit asnjë aset (produkt), edhe pse duke u nisur nga vitet dhe nga norma e amortizimit, ekzistojnë asete të cilat janë plotësisht të amortizuara. Në fletë hyrjen e magazinës dhe në dokumentacionin e marrjes në dorëzim të mallrave, nuk regjistrohen numrat serial/identifikimit përkatës të mallrave, duke e bërë të vështirë identifikimin e tyre, veprime jo në përputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kapitulli IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve”, pika 73 – 120.

Inventarët nuk kanë të përfshirë zërat (toka, ndërtesa, rikonstruksione), në mënyrë që të bëhet verifikimi i vlerës së aseteve, amortizimit të duhur të tyre duke përfshirë edhe shtesat, si dhe të ardhurat e gjeneruara nga përdorimi i tyre, nëse ka. Pronat e Universitetit të Mjekësisë Tiranë janë të regjistruara në Agjencinë e Kadastrës, në emër të Bashkisë Tiranë dhe jo të UMT-së, me përjashtim të shtesave, të cilat janë në emër të UMT-së. Për periudhën objekt auditimi, në lidhje me inventarizimin dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme të UMT, nuk ka gjurmë mbi kryerjen e inventarizimit, për pasojë informacioni mbi procedurat e ndjekura për inventarizimin e pasurive të paluajtshme është i pjesshëm, veprim jo në përputhje me pikën 74, të kapitullit IV, “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve” të UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2. 9. faqe 106 -112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

19.1 Rekomandim: Nga Sektori i Financës, të merren masat që asetet plotësisht të amortizuara të nxirren jashtë përdorimit, të përfshihen në inventar zërat si: toka, ndërtesa, rikonstruksione dhe për secilin mall që merret në dorëzim nga institucioni si dhe të përcaktohet dhe regjistrohet numri serial për të bërë të mundur identifikim e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

19.2 Rekomandim: Nga Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, në bashkëpunim me Sektorin e Financës dhe atë Juridik, të merren masa për regjistrimin e pronave të UMT-së në Agjencinë e Kadastrës, në emër të saj, pasi ka vështirësi në evidentimin e plotë të aktiveve në pronësi dhe për llogaritjen e amortizimit vjetor.

Menjëherë dhe në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i regjistrave të aktiveve në UMT, u konstatua se në Fakultetin e Mjekësisë nuk ka një regjistër të plotë të aktiveve që zotëron apo ka në administrim, në të cilin të evidentohet qartësisht data e hyrjes në institucion, amortizimi i akumuluar, amortizimi vjetor dhe vlera e mbetur, sipas formatit të regjistrimit të aktiveve. Nuk është trashëguar dokumentacioni nga punonjësi që është larguar, pasi ka ikur pa bërë dorëzimet, veprime jo në përputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 26, 28 dhe 30 dhe Rregulloren e Brendshme të UMT, e ndryshuar “Për administrimin financiar, kontabilitetin dhe kontrollin në UMT”, neni 9, pika 3.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2. 9. faqe 106 -112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

20.1 Rekomandim: Nga Drejtoria e Ekonomike, të merren masa për nxjerrjen e një regjistri të plotë të aktiveve që zotëron, sipas llojit, grupit dhe formatit të dispozitave ligjore në fuqi në funksion të evidentimit të jetëgjatësisë së përdorimit të aktiveve nga institucioni dhe monitorimit të llogaritjes së amortizimit vjetor .

Menjëherë

21. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare të konsoliduar të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, për Fakultetin e Mjekësisë vlera e llogarisë nën rubrika “Gjendje e inventarit qarkullues” llogaria 31 “Materiale”, si dhe nën rubrika “Aktive afat gjata materiale”, llogaria 214 “Instalime elektrike, makineri e pajisje si dhe llogaria 218 “Inventar ekonomik,” vlera neto kontabël e tyre është e pa rakorduar me vlerën fizike. Si UMT për periudhën nga viti 2013 e në vazhdim, veprimet për ndryshimet e gjendjeve të këtyre llogarive janë të rakorduar, për hyrje daljet, por

gjendja fillestare në çelje në fillim të vitit 2013 (vit i bashkimit), nuk ka një listë të artikujve gjendje, nuk vërtetohet gjendja kontabël me atë fizike.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.10. faqe 112 -127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

21.1 Rekomandim: Nga ana e Administratorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, të merren masa për ngritjen e një grupi pune për vlerësimin kontabël dhe fizik të nën rubrikave “Gjendje e inventarit qarkullues” llogaria 31 “Materiale”, nën rubrika “Aktive afat gjata materiale”, llogaria 214 “Instalime elektrike, makineri e pajisje si dhe llogaria 218 “Inventar ekonomik,” dhe zgjidhjen e situatës për sistemimin e llogarive.

Menjëherë

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 2018 “Inventar ekonomik” rezultoi se pakësimi konsiston në transferimin e aktiveve të projekteve me financim të huaj, në bankat e nivelit të dytë vetëm për ato institucione të cilat kanë sjellë konfirmim që i kanë marrë në dorëzim dhe i kanë përfshirë në kontabilitetin e tyre. Konkretisht: Për projektin Euscreen, bazuar në shkresën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, Drejtorisë së Administrimit Spitalor, me nr.5202 prot., datë 13.10.2016, “Për bashkëpunim me projektin për fushën e depistimit neonatal të dëgjimit dhe depistimit femënor të shikimit paragrafi i fundit citohet: “Në përfundim të këtij projekti aparaturat depistuese/diagnostikuese të vëna në dispozicion nga projekti, do të mbeten në administrimin e institucioneve pjesëmarrës në këtë projekt, në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë”. Gjithashtu dhe në marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhur nëpërmjet Rektorit të UMT-së dhe drejtuesve të institucioneve pjesëmarrës në projekt, në nenin 7 “*Dhurimi i aparaturave*”, është përcaktuar që në përfundim të kësaj marrëveshjeje aparaturat diagnostikuese të vëna në dispozicion nga ky projekt do të dhurohen Institucionit. Nuk janë transferuar vlerat e aktiveve të institucioneve që nuk kanë sjellë konfirmim institucionet në vitin 2021 e konkretisht e Spitalit Distrofik në vlerë fillestare 1,877,538 lekë & amortizimi në vlerë 401,848.6 lekë, si dhe Spitalit Kukës në vlerë fillestare 2,788,951 lekë dhe amortizim 583,576 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.10. faqe 112 -127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

22.1 Rekomandim: UMT-ja të marrë masa dhe të kryejë transferimin e aktiveve të vëna në dispozicion në kuadër të zbatimit të projektit EUSCREEN, të spitalit “Qendra kombëtare e mirërritjes, zhvillimit dhe rehabilitimit të fëmijëve”, Tiranë (Distrofik) në zbatim të marrëveshjeve të lidhura.

Menjëherë

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kuotave të mbuluara rezultoi se specializanti i cili përzgjedh kuotë të mbuluar ka detyrimin që brenda 2 javëve të bëjë regjistrimin pranë fakultetit përkatës, ku duhet të paraqesë kontratën që lidh specializanti me ministrinë e cila mbulon kuotën përkatëse. Në këtë kontratë janë të parashkruara të drejtat dhe detyrimet e të dy palëve (evidencë: *Kontrata për ndjekjen e specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë pranë Universitetit të Mjekësisë, ndërmjet Ministrisë Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe specializantit*). Gjithashtu specializanti ka detyrimin e kryerjes së pagesës së tarifës së shkollimit për llogari të fakultetit përkatës (115.000 lekë, tarifë e miratuar me Vendim të Bordit të Administrimit të UMT-së), si dhe ndjekjes së detyrimeve akademike të programit.

Nga auditimi i kuotave të lira, rezultoi se specializanti i cili përzgjedh kuotë të lirë ka detyrimin e pagesës së tarifës së shkollimit për llogari të fakultetit përkatës (115.000 lekë, tarifë e miratuar me Vendim të Bordit të Administrimit të UMT-së), si dhe ndjekjes së detyrimeve akademike të

programit, duke mos lidhur kontratë. Mos përcaktimi i saktë kontratave të shërbimit me specializantët (të drejtat dhe detyrimet), mund të sjellë risk potencial në mosplotësimin e detyrimeve të përcaktuara në rregulloren përkatëse për specializantët. Veprime jo në përputhje me VKM nr.824, datë 24.12.2021, “Për miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë”, shtojca 7, standardi II/6, kriteri 10; Statuti i UMT-së, neni 26; Rregullorja e studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, neni 6, neni 45.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.11. faqe 127 -133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

23.1 Rekomandim: Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, të marrë masa për hartimin e kontratës së shërbimit me specializantët pavarësisht llojit të kuotës.

Menjëherë

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i mosrealizimit të kuotave të planifikuara rezultoi se realizimi i kuotave të planifikuara për specializimet afatgjata është në masën 65% për tre vitet përkatësisht: 66% për vitin 2020-2021; 56% për vitin 2021-2022 dhe 73% për vitin 2022-2023. Referuar rregullores se specializimeve të UMT, neni 21, përcaktohet se: “Kandidati aplikon sipas formularit të aplikimit bashkëlidhur kësaj rregulloreje (shtojca nr. 2) dhe i nënshtrohet konkursit të pranimit për të testuar njohuritë në fushën përkatëse të studimit. Kriteret specifike shtesë për t'u pranuar në programin e specializimeve afatgjata janë kompetencë e UMT. Zgjedhja e programit specializues bëhet në bazë të renditjes së kandidatit sipas pikëve të përfituara (listës së meritës)”. Në nenin 34 të Rregullores të specializimeve, përcaktohet se: “Vlerësimi i kandidatëve bëhet me sistem pikëzimi (maksimumi 1000 pikë), ku 30% e pikëve (300 pikë të konvertuara) përlllogariten bazuar në notën mesatare të ponderuar dhe 70% e pikëve (700 pikë të konvertuara nga testimi i informatizuar që zhvillohet pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore. Po në këtë nen është përcaktuar kriteri cilësor minimal nëpërmjet sistemit të pikëzimit për të patur mundësi për përzgjedhjen e programit. Konkretisht, “kandidatët që kanë grumbulluar jo më pak se 380 pikë nga numri i pikëve totale të konvertuara (maksimumi 1000 pikë), kualifikohen për procesin e përzgjedhjes së programit të specializimit sipas sistemit të meritës”. Kjo ka bërë s kualifikimin e kandidatëve që nuk kanë arritur pragun e pikëve. Gjithashtu në nenin 20, pika 4, është përcaktuar se “Nuk mund të konkurrojnë kandidatët që janë duke kryer ose që kanë kryer një program specializimi afatgjatë”, dhe ky është një tjetër kufizim që pavarësisht kalimit të pragut minimal të pikëve (380 pikë) kandidati tërhiqet në rastin kur nuk ka më kuota për programin që dëshiron. Janë këto kufizime që bëjnë mosrealizimin 100% të kuotave të pranimit. Me këto veprime nuk sigurohen kapacitetet njerëzore profesionistë të specializuar në fushën e sektorit shëndetësor publik, si dhe nuk realizohen plotësisht të ardhurat dytësore të planifikuara për UMT nga kjo kategori. Në kontekstin e politikave të qeverisë e cila nëpërmjet ligjit 60/2023 ka përcaktuar detyrime për studentët e mjekësisë së përgjithshme për qëndrimin në vend, në plotësim të kërkesave të sektorit shëndetësor, dhe nuk mundëson mbulimin e kuotave të specializantëve për të garantuar shërbim shëndetësor të specializuar nëpërmjet specializantëve. Sa më sipër është jo në përputhje me ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 25, pika 7, neni 38, neni 42, neni 69; Statuti i UMT-së, neni 26, neni 89, Rregullore e studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë në fushën e mjekësisë, neni 5-6; neni 38-47.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.11. faqe 127 -133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

24.1 Rekomandim: Me qëllim realizimin e plotë të kuotave të planifikuara, si dhe në kuadër të sigurimit dhe garantimit me burime njerëzore me profesionistë të specializuar në mjekësi, për kryerjen e shërbimeve të shëndetit publik në institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, të planifikohen në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë, si dhe me ministrinë e tjera vetëm kuota të mbuluara, ku të përcaktohet dhe perioda e shërbimit të diplomuarit në sistemin shëndetësor publik.

Menjëherë

25. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e marra në vendimet e Senatit Akademik, për miratimin e kuotave të pranimit për tri vitet në auditim rezultoi se UMT, ka miratuar 13 kuota për transferim nga IAL e tjera përkatësisht: 5 për vitin 2020-2021; 3 për vitin 2021-2022 dhe 5 për vitin 2022-2023. Nga 13 kuota janë realizuar 8 kuota (1; 3 dhe 4 kuota të realizuar sipas viteve). Në vendimet e Senatit Akademik janë miratuar dhe kuota për transferim studimesh të kërkuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale bazuar në nevojat e shërbimit shëndetësor për mjekë të specializuar. Këto kuota nuk janë përfshirë në numrin total të pranimeve të reja, pasi për këto kuota aplikojnë specialistët të UMT që janë të regjistruar dhe kanë të përfunduar të paktën 1 vit akademik. Referuar vendimeve përkatëse të Senatit Akademik janë miratuar 10 kuota për çdo vit akademik në auditim, si dhe një kuota transferimi në vitin 2022-2023 në zbatim të Vendimit nr.50, datë 29.04.2022 të Senatit Akademik të UMT. Kuota të realizuara janë 28 nga 30 të miratuara. Kandidatët që aplikojnë për transferim studimesh në kuotat e MSHMS, janë specialistët të regjistruar në UMT dhe që kanë përfunduar të paktën vitin e parë. Këta specialistët (dy vitet e fundit kanë qenë më shumë se numri i kuotave) i janë nënshtruar dhe këta procesit të testimit të informatizuar dhe në bazë të listës së meritës bëhet regjistrimi i tyre. Këto veprime mund të kenë ndikim apo efekt në mosrespektimin e barazisë në përzgjedhjen e programit të studimit; Ulja e numrit të specialistëve (sipas kuotave për transferim studimesh të) të planifikuar për sektorin shëndetësor publik dhe vënë si rezultat i mos rregullimit në aktet e brendshme të UMT. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.11. faqe 127 -133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

25.1 Rekomandim: Kuota për transferim studimesh të propozuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të planifikohen si kuota të mbuluara nga kjo ministri.

Menjëherë

26. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se janë dërguar akte administrative shpresore nga Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës dhe anasjelltas, por pa finalizuar këtë proces me miratimin e listës së pronave dhe procedimin për regjistrimin e tyre pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Konstatohet se ka mosveprim nga ana e strukturave përgjegjëse pranë dy institucioneve respektive të ngarkuara nga ligji. Sa më sipër, në kushtet që nga ana e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, nuk janë regjistruar pronësit dhe kufijtë e pasurive të paluajtshme si dhe nuk janë dokumentuar aktet e fitimit të pronësisë për çdo rast, është vepruar në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, i ndryshuar, ligjit nr. 33/2010 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, nenit 2, pika 10, nenit 24 të Kodit Civil “Regjistrimi fillestar” si dhe në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe me dispozitat e çdo akti që përcakton pronësinë ose të

drejta të tjera reale që ekzistojnë për pasuritë e paluajtshme, si nenit 45/1 dhe nenit 46/1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.13. faqe 143 -146 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

26.1 Rekomandim: Administratori i Universitetit të Mjekësisë Tiranë, të marrë masat për të ngritur një grup pune, me qëllim pasqyrimin e dinamikës dhe lëvizjet e objekteve respektive në administrim të Universitetit, të ndërtojë gjurmën e auditimit për mënyrën e sigurimit të këtyre pasurive, duke saktësuar origjinën dhe administruar dokumentacionin e nevojshëm, në bashkëpunim dhe me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, dhe pas saktësimit të listës përfundimtare, duke reflektuar efektet e vendimeve të Këshillit të Ministrave për transferimin e pronave që ky Universitet ka administruar, të ndërmerren veprimet e nevojshme ligjore me qëllim pasqyrimin e situatës së duhur në pasqyrat financiare të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

26.2 Rekomandim: Nga Universiteti i Mjekësisë Tiranë, të ri aplikohet pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, për vazhdimin e procedurave për regjistrimin e pronave që Universiteti i Mjekësisë Tiranë ka në administrim, pasi të jenë kryer korrigjimet e duhura duke rakorduar gjendjen e këtyre pasurive me listën analitike të aktiveve, në pasqyrat financiare të vitit 2023.

Menjëherë dhe në vijimësi

27. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të kontratës së lidhur midis “2” SHPK dhe FM , me nr. 502/19 Prot., datë 31.08.2020, me objekt “Rikonstruksion i tarracës së godinës së para klinikut dhe bodrumeve të godinës së Dekanatit të Fakultetit të Mjekësisë, Tiranë”, me afat 4 muaj kalendarikë nga dita e marrjes së lejes ndërtimore tek Bashkia Tiranë nga Autoriteti Kontraktor dhe më vlerë 15,347,539 lekë me TVSH, rezultoi se tarraca nuk është bërë rikonstruksion për arsye të ndryshimit të projektit pasi godina ku ishte parashikuar rikonstruksioni i tarracës, është vlerësuar nga Instituti i Ndërtimit, si godinë e dëmtuar pas tërmetit të vitit 2019. Në këto kushte, kontrata e nënshkruar duhej të anulohet e të rifillonte një procedurë e re prokurimi me objekt të ndryshëm nga objekti fillestar pra pa kërkuar rikonstruksionin e tarracës. Procedura e prokurimit e zhvilluar në vitin 2020, sipas urdhër prokurimi nr. 1422/3 Prot., datë 15.08.2019, ka pasur kritere edhe për punime të tarracës, të cilat i janë referuar zërave të punimeve sipas preventivit të parashikuar për punime në lartësi për rikonstruksionin e tarracës. Me ndryshimin e zërave të punimeve në atë masë që është ndryshuar objekti i prokuruar, pra janë hequr punime në lartësi për të cilat ka konkurruar dhe është shpallur fitues operatori ekonomik, FM, Administratori znj. Z.D, duhej të anulonte kontratën e nënshkruar dhe të kërkonte nga Universiteti i Mjekësisë, zhvillimin e një procedure të re prokurimi, me një preventiv të ndryshëm nga ai i pari si pasojë e ndërhyrjes në punime të cilat kanë qenë bazë për përzgjedhjen e operatorit fitues. Në grupet e punës të ngritura nga FM për ndjekjen e zbatimit të kontratës, nuk ka asnjë inxhinier apo specialist të fushave inxhinierike që të mund të arsyetojë teknikisht ndryshimin e zërave të punimeve apo edhe staf të fushës juridike, që të vlerësojë rëndësinë e lartë të këtyre ndryshimeve dhe njëkohësisht të propozojë korrigjimet e nevojshme ligjore. Struktura të tilla inxhinierike dhe juridike, ka vetëm Universiteti i Mjekësisë i cili ka staf administrativ në ndryshim nga Fakultetet të cilat kanë kryesisht staf akademik në strukturat e tyre. Zërat e preventivit të punimeve, nuk mund të miratohen nga Dekanati i FM i cili s`ka asnjë specialist të fushave përkatëse por vetëm pedagogë të Fakultetit të Mjekësisë. Si rezultat, procedurat e ndjekura nga FM, janë me mangësi si nga ana teknike por dhe nga ajo juridike pasi në njërin rast kemi të bëjmë me miratime zërash të rinj të preventivit (të ndryshëm

nga ata të prokuruar) të detyruar nga Instituti i Ndërtimit dhe në rastin tjetër, kemi mosfunksionim të stafit administrativ ose strukturave juridike dhe teknike të Universitetit të Mjekësisë pasi duhej që normalisht të propozonin ndryshimin e objektit të procedurës së prokurimit pasi janë hequr punimet në lartësi dhe si rezultat edhe kriteret e kualifikimit për këto lloj punimesh ose dhe fondi limit, duhej të ndryshoheshin duke i propozuar Administratorit të Universitetit të Mjekësisë fillimin e një procedure të re prokurimi me objekt të ndryshëm nga ai i pari.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.14/1. faqe 212 -221 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

27.1 Rekomandim: Universiteti i Mjekësisë Tiranë, Fakultetet respektive, gjatë fazës së ekzekutimit të kontratave publike, të marrin masa që mos të ndryshojnë në atë masë specififikimet teknike dhe zërat për ekzekutim, saqë këto të fundit, të ndikojnë në kriteret e përzgjedhjes së fituesit të procedurës së prokurimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

27.1 Rekomandim: Fakultetet respektive të Universitetit të Mjekësisë Tiranë, gjatë fazës së ekzekutimit të kontratave publike, të marrin masa që për çdo ndryshim të zërave të punimeve, të bashkëpunojnë me Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtorinë e Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore të UMT-së, për marrjen e një asistence profesionale nga specialist të fushave përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

28. Gjetje nga auditimi: Në Autoritetin Kontraktor, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, gjatë periudhës objekt auditimi rezulton se ka 24 anulime procedurash, të cilat shkojnë deri në tre herë anulim, në vlerën 216,010,127.35 lekë, duke sjellë mospërdorim të fondeve si nga buxheti ashtu dhe nga të ardhurat e veta, me ndikim në realizimin e misionit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

Në përgjithësi kriteret e veçanta për kualifikim nuk janë të argumentuara dhe në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, dhe më të theksuara në procedurat e prokurimit: “Furnizim - vendosje dritare dhe dyer për Dekanatin e FM”; “Blerje të pajisjeve mjekësore laboratorit për Fakultetin e Mjekësisë, Tiranë”; “Rikonstrukcion i tarracës së godinës “Galileo Galilei” brenda QSU “Nënë Tereza”; “Vlerësimi i protezave fikse metal qeramikë të mbështetura mbi implante, për FMD”; “Blerje pajisje stomatologjike për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”; “Rikonstrukcion i sallave të Rektoratit dhe çatisë së UMT”; “Furnizim vendosje kondicionerësh për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”.

Janë konstatuar në disa raste vonesa në lidhjen e kontratës nga Fakulteti i Mjekësisë; në disa raste që raporti përmbledhës mban datë përpara procesverbalit të vlerësimit të dokumentacionit të operatorit ekonomik fitues.

Gjithashtu u konstatua neglizhencë e nëpunësve të caktuar për zbatimin e procedurave të prokurimit apo për marrjen në dorëzim të mallrave, punëve apo shërbimeve, nëpërmjet dorëheqjeve nga komisionet përkatëse duke shkaktuar zgjatje të procedurave.

Në shumë raste u konstatua se nga asistenca teknike e APP kërkohet rishikim i kriterëve, e cila nuk është bërë sipas kësaj asistence.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.14. faqe 146 -212 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

28.1 Rekomandim: Nga Autoritetin Kontraktor, të merren masat e duhura që të analizohet situata në drejtim të realizimit të investimeve, në drejtim të hartimit të saktë të preventivave, në

drejtim të përcaktimit në lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit të kërkesave të veçanta për kualifikim, në shpalljen e fituesve, në marrjen në dorëzim të punëve, mallrave dhe shërbimeve si dhe në zbatimin e urdhrave nga nëpunësit për pjesëmarrje në komisione.

Menjëherë dhe në vijimësi

29. Gjetje nga auditimi: Autoriteti Kontraktor, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, gjatë vitit 2022 ka zhvilluar disa procedura prokurimi në rolin e Autoritetit Kontraktor qëndror blerës, për të cilat i është deleguar e drejta për prokurim nga 3 fakultete që janë pjesë e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë: Fakulteti i Mjekësisë, Fakulteti i Mjekësisë Dentare dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike. Theksojmë se nuk ka dokument ku nga ana e këtyre njësive shpenzuese të delegohet e drejta për zhvillimin e procedurave të prokurimit, jo vetëm për këto raste por edhe për raste të tjera të trajtuara. Nga auditimi rezulton se këto fakultete janë njësi shpenzuese (autoritete kontraktore) më vete, të pajisura me llogari personale për prokurimin elektronik, si dhe fondet buxhetore për realizimin e procedurave të prokurimit menaxhohen nga ana e tyre (likuidimet për çdo blerje malli, realizim shërbimi, kryerje pune realizohen nga vetë fakultetet).

Në lidhje me 4 procedura të prokurimit me objekt: “Blerje materiale pastrimi dhe dezinfektimi për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”; “Furnizim vendosje kondicionerësh për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”; “Prodhim dhe printim diplomash për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”; “Blerje pajisje stomatologjike për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”.

Rezulton se pasi është publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik njoftimi i fituesit (në përfundim të afateve të ankimit), nga ana e administratorit të mëparshëm është proceduar me nënshkrimin e kontratës për të gjitha njësitë në total (Rektorati dhe 3 fakultetet), duke cituar në kontratë fondet respektive të secilës njësi. Nga ana e Administratorit të UMT, S.S, nuk është bërë autorizim për lidhje kontrate për tre fakultetet për pjesën takuese të tyre, por kontrata për çdo procedurë (4) është lidhur nga AK, UMT, në kushtet kur fondet në dispozicion nuk janë të vetat por të tre AK të tjera, të cilët i kanë deleguar të drejtën për prokurim UMT. Nga administratori i UMT është ngritur Komisioni i Marrjes në Dorëzim të Mallrave për të gjitha njësitë në total (Rektorati dhe 3 fakultetet), të ndara sipas secilës njësi.

Kontrata nga Administratori i UMT, është nënshkruar në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, nenet: 4 Përkufizime, pika 9, neni 14. “Kontratat publike”, neni 33. “Organ qëndror blerës”, Neni 21, “Autoriteti ose enti kontraktor”, Neni 53, “Blerja e përqëndruar” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pika 7, neni 67, “Prokurimi i përqëndruar dhe delegimi i prokurimit”, pikën 4, neni 106, “Kohëzgjatja e kontratës”, nga ku rezulton se afërsisht pas 8 muajsh nga lidhja e kontratave, situata paraqitet:

- Është realizuar (dorëzuar malli dhe likuiduar) vetëm për Rektoratin për të katër kontratat; Për kontratën “Blerje materiale pastrimi dhe dezinfektimi për njësitë shpenzuese të UMT”, gjendja është: FMD, ka marrë në dorëzim mallrat më datë 27.01.2023. Nga ana e FMD nuk është likuiduar. FSHMT, ka marrë në dorëzim mallrat nga kontraktori “S” SHPK, nuk është realizuar likuidimi. FM, nuk e ka zbatuar kontratën me nr. 2925/35 Prot., datë 19.01.2023, nuk i ka marrë në dorëzim mallrat brenda afatit të caktuar në kontratë, pasi nuk ka lidhur kontratë vetë si AK. Për kontratën “Furnizim vendosje kondicionerësh për njësitë shpenzuese të UMT”, gjendja është: FMD, ka marrë në dorëzim mallrat më datë 30.01.2023. Nga ana e FMD nuk është realizuar

likuidimi. FSHMT, ka marrë në dorëzim mallrat më datë 30.01.2023. Nga ana e FSHMT nuk është realizuar likuidimi. FM, nuk e ka zbatuar kontratën me nr. 4223/16 Prot., datë 30.12.2022, nuk i ka marrë në dorëzim mallrat brenda afatit të caktuar në kontratë.

Për kontratën “Prodhim dhe printim diplomash për njësitë shpenzuese të UMT”, gjendja është: FSHMT janë marrë në dorëzim diplomat por nuk janë likuiduar. FM, nuk e ka zbatuar kontratën. FMD, nuk është bërë marrja në dorëzim, nuk e ka zbatuar kontratën.

Për kontratën “Blerje pajisje stomatologjike për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, gjendja është: FMD, nuk është bërë marrja në dorëzim, nuk e ka zbatuar kontratën.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.14. faqe 146 -212 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

29.1 Rekomandimi: Nga ana e Autoritetit Kontraktor, UMT, për zgjidhjen e situatës, të merren masa të bashkëpunojnë me APP, e cila jep këshilla dhe asistencë në fushën e prokurimit publik, me qëllim mirë zbatimin e kuadrit ligjor për prokurimin publik; verifikon zbatimin e ligjshmërisë së procedurave të prokurimit publik, pas fazës së nënshkrimit të kontratës së prokurimit ose anulimit të procedurës, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore; monitoron nëse zbatimi i kontratave është bërë në përputhje me kushtet e prokuruar bazuar në raportet periodike të autoriteteve ose enteve kontraktore.

Menjëherë

30. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Furnizim vendosje kondicionerësh për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, me urdhër prokurimi nr.267, datë 23.11.2022, me fond limit 7,479,462.55 lekë, me lloj procedure “e hapur e thjeshtuar mallra”, rezultoi se pavarësisht se është hartuar procesverbali i argumentimit të kriterëve për NJHDT nuk i ka argumentuar këto kriterë, në procesverbalin e hartimit dhe argumentimit të fondit limit në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 4. Ndërkohë procedura e prokurimit është mallra ndërsa kriteret e kualifikimit janë vendosur për procedurë prokurimi punë, kërkesa të tejkaluara të LPP e RRPP si dhe akteve ligjore e nënligjore që kanë lidhje me procedurën e prokurimit. Kriteret e përcaktuara nuk janë në përputhje dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, duke sjellë mosbarazi në procedurën e prokurimit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.14. faqe 146 -212 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

30.1 Rekomandimi: Nga Autoriteti Kontraktor, UMT të merren masa për zbatimin e drejtë të akteve ligjore e nënligjore në lidhje të ngushtë me objektin e procedurës së prokurimit.

Menjëherë

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratës së lidhur midis “K” SHPK dhe Fakultetit të Mjekësisë, Tiranë, me nr. 1392/4 Prot., datë 26.10.2018, me objekt “Blerje materialesh laborator farmacie dhe mikrobiologjike”, me afat 30 ditë kalendarike nga dita e nënshkrimit ose me datë përfundimi datën 24.11.2018, me vlera 2,054,205.6 lekë me TVSH, rezultoi se procesverbali i marrjes në dorëzim të pajisjeve, është me nr. 1392/12 Prot., datë 04.01.2019. Tek ky procesverbal, cilësohet se materialet janë dorëzuar në dy data të ndryshme dhe konkretisht në datën 06.11.2018 sipas faturës nr. 18905 dhe në datën 19.11.2018 sipas faturës nr. 18B004. Nga auditimi i praktikës së ndjekur për marrjen në dorëzim të materialeve dhe likuidimin e faturave

përkatëse, u evidentua se: Procesverbal i mbajtur nga komisioni i marrjes në dorëzim të materialeve, është me nr. 1392/12 Prot., datë 04.01.2019. Komisioni, cilëson se materialet, kanë ardhur bashkë me faturat në dy data të ndryshme, pra në datën 06.11.2018 sipas faturës me nr. 18905 dhe në datën 19.11.2018 sipas faturës me nr. 18B004. Komisioni, nuk ka mbajtur ndonjë dokument të përkohshëm sipas faturës së parë pra të datës 06.11.2018 ose dhe të faturës së dytë atë të datës 19.11.2018, por ka mbajtur një procesverbal përmbledhës, me datë 04.01.2019 duke cilësuar se materialet kanë ardhur përpara datës së mbajtjes së procesverbalit pa asnjë dokument të përkohshëm bashkëlidhur praktikës. Në vazhdim, në dosje u gjend fatura me nr. serial 69146278, nr. fature 18905 dhe datë 06.11.2018 dhe fatura me nr. serial 70943180, nr. fature 18-B004 dhe datë 19.11.2018. Deri këtu, është dokumentuar fakti se kontraktori ka lëshuar faturat në këto data (brenda afatit të përcaktuar në kontratë) por jo që të ketë dorëzuar mallin i cili, dokumentohet me Fletë-Hyrjen (total 5 fletë për faturën e parë) me nr. 3, datë 04.01.2019 dhe fletë-hyrjen (total 2 fletë për faturën e dytë) me nr. 4, datë 04.01.2019. Urdhër shpenzimi është me nr. 78, datë 04.04.2019 dhe vlerë 2,054,206 lekë. Nga dokumentacioni i mësipërm, grupi i auditimit, vlerëson se materialet e prokuruar, nuk janë dorëzuar brenda afatit të përcaktuar në kontratë pra brenda datës 24.11.2018, por janë dorëzuar në datën që janë bërë hyrje në magazinën e institucionit dhe konkretisht në datën 04.01.2019. Komisioni i marrjes në dorëzim të materialeve, duhej të propozonte mbajtjen e penaltetit nga kontraktori “K” SHPK, për dorëzimin e materialeve jashtë afateve të përcaktuara, në referencë të pikës 24.1, të nenit 24 “Likuidimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar”, të kontratës nr.1392/4 Prot., datë 26.10.2018 ku cilësohet se “Për kontratat me periudhë zbatimi jo me shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës”. Meqenëse nuk është e dokumentuar se është vepruar konform pikës 36, pikës 37 “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve”, dhe pikës 44 “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara”, kontraktorit “K” SHPK, duhej ti mbahej penalteti nga FM në vlerën 2,054,206 lekë / 4 = **513,552 lekë**.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.14/1. faqe 212 -221 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandim: Nga FM të Universitetit të Tiranës, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyimit, **arkëtimi i vlerës 513,552 lekë**, nga “K” SHPK, si vlerë që i përket penaltetit që duhej mbajtur për arsye të ekzekutimit të kontratës jashtë afateve të përcaktuara.

Menjëherë

D. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i projektit: “Identifikimi i teknikës optimale intraoperatore të kardiomioplastikës qelizore në mënyrë simulante me rivaskularizimin kirurgjikal tek zemrat humane të infarktuara nëpërmjet implantimit të qelizave staminale autologe në rrugë të ndryshme, një studim eksperimental”, rezultoi se:

Për këtë projekt fondet e miratuara për vitin 2019, janë mbështetur në kontratën nr.2179/2 prot., datë 16.09.2019, të lidhur ndërmjet UMT-së dhe AKKSHI-së, si dhe planit financiar shoqërues, dhe do të përdoren për blerje aparaturash për zhvillimin e projektit, ndërkohë këto fonde janë

detajuar në llogarinë 602 “Mallra dhe shërbime” nga AKKSHI dhe jo sipas kontratës së lidhur në llogarinë investime.

Nga auditimi rezulton se pajisja është blerë në vlerë totale 8,304,000 lekë, është bërë hyrje në Fakultetin e Mjekësisë nëpërmjet fletë-hyrjes nr.7 datë 16.10.2020 dhe është likuiduar pranë Degës së Thesarit në datën 12.11.2020 nëpërmjet urdhër-shpenzimit nr.164, në llogarinë e të ardhurave të institucionit dhe jo në llogarinë përkatëse të projektit, pra duke përdorur si burim financimi të ardhurat e institucionit në buxhetin e vitit 2020, ndërkohë që kjo pagesë duhet të ishte kryer në llogarinë përkatëse të projektit.

Për këtë projekt vetëm sa janë blerë pajisjet, në shumën 8,3 milion lekë që në datë 16.10.2020 dhe deri në përfundimin e auditimit në terren, pajisjet nuk janë vënë në punë, për një periudhë 3 vjet, duke kaluar të gjitha afatet e garancive dhe mirëmbajtjes. Gjithashtu nuk është vazhduar me procedurat e tjera për shpenzimet për mallra që duhen për vënien në punë të tyre, duke sjellë mos efektivitet në përdorimin e fondeve në shumën **8,304,000 lekë**.

Nga auditimi i bazës ligjore mbi të cilën vepron UMT, rezulton se ky sistemim i fondeve është detyrë e Rektoratit, kjo bazuar në: kontratën e lidhur nr.2179/2, datë 16.09.19, të lidhur midis AKKSHI dhe për përfituesin Drejtuesi projektit e Rektori i UMT, nenet: 6, “Detyrimet e përfituesit”, neni 13, “Ndryshimet e kontratës”, Neni 16, “Sanksionet”, Neni 17, “Zgjidhja e konflikteve”, si dhe bazuar në Vendimin e Bordit të Administrimit nr.659/5, datë 03.03.2020, Vendim nr.16, datë 25.02.2020, “Për miratimin e rregullores së brendshme të ndryshuar, “për administrimin financiar, kontabilitetin dhe kontrollin në UMT”, neni 49, “Rishpërndarja (rishikimi)”, pika 2/a. Nga mosveprimet e Rektoratit të UMT, nga ana e AKKSHI është kërkuar rikthimi i fondeve në llogarinë e saj, duke ndërprerë projektin.

Në marrjen në dorëzim rezultoi se: Certifikata e instalimit, testimit dhe trajnimit, datë 16.10.2020 e subjektit “F” SHPK, e firmosur edhe nga grupi i marrjes në dorëzim, shkruan: “Unë i nënshkruari, O.S, në cilësinë e përfaqësuesit të OE “F” SHPK, deklaroj se janë instaluar, testuar dhe është bërë trajnimi i stafit përgjegjës për përdorimin e produkteve të ofertuar për prokurimin”.

Ndërkohë në DST e procedurës përkatëse të prokurimit në lidhje me trajnimin, flitet vetëm në kapacitetin teknik (pika 2.3/8) ku është përcaktuar se: 2.3/8: Për kapacitetin teknik:

8-Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën 2 inxhinier njëri prej tyre i diplomuar në profilin Inxhinieri Klinike dhe tjetri Inxhinier Elektronik\ Elektrik, të cilët duhet të jenë përgjegjës për instalim dhe trajnim të stafit mjekësor. Nuk ka asnjë të dhënë se kush do të trajnohet, sa ditë do të zgjasë ky trajnim. Faktikisht rezulton se:

- nuk ka asnjë të dhënë nëse 2 pajisjet janë instaluar pasi ato ndodhen në pavijon, thuhet se nuk janë vënë në punë.

- vëmë në dukje faktin se procesverbali i marrjes në dorëzim, fletë hyrja e FM (nr.7, datë 16.10.2020.), fatura tatimore e kontraktorit (nr.460, datë 16.10.2020,) dhe certifikata e instalimit, testimit dhe trajnimit, mbajnë të njëjtën datë, datën 16.10.2020.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.12. faqe 133 -143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandim: Nga ana e UMT të analizohet situata e krijuar, të nxirren përgjegjësitë si dhe të merren masa të menjëhershme për vënien në funksion të pajisjeve mjekësore.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje të pajisjeve mjekësore laboratorit për Fakultetin e Mjekësisë, Tiranë”, të zhvilluar me urdhër

prokurimi nr. 175, datë 31.10.2019, me fond limit 32,285,492 lekë, nga vlerësimi jo në përputhje me kriteret e veçanta për kualifikim të DST, në kushtet kur asnjë OE nuk është i vlefshëm KVO duhej të anulonte procedurën e prokurimit, bazuar në VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 73, “Mungesa e konkurrencës”. Me veprimet e mosveprimet e KVO ka shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve në shumën **22,499,700 lekë**.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.14. faqe 146 -212 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandim: Nga ana e Administratorit të UMT, të nxirren përgjegjësitë, të analizohet vlera e efektit ekonomik financiar dhe të marrë masa që në të ardhmen fondet të shpenzohen sipas parimeve të eficensës, economicitetit dhe efikasitetit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstrukcion i sallave të Rektoratit dhe çatisë së UMT”, të zhvilluar sipas urdhër prokurimit nr.307, datë 30.12.2022, me fond limit 18,059,998.7 lekë rezultoi se: Kjo procedurë prokurimi është anuluar 3 herë datat 14.10.2021 dhe 10.12.21, 11.05.2022. Herën e tretë është anuluar me vendim të KPP nr.404/2022, me nr. 713/6, datë 29.04.2022.

Në të tre herët, si dhe në procedurën me Urdhër Prokurimi nr. 307, datë 30.12.22, në asnjë rast nuk është kryer opoenca teknike për projektin që do të prokurohet, në kundërshtim me: ligjin nr. 120/2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, Neni 2. Nisur nga fakti që objekti ku do të bëhet investimi është monument i kategorisë së II-të, në dosje nuk ka asnjë dokumentacion që të vërtetojë zbatimin e ligjit nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”. Preventivi i hartuar paraqitet si përmbledhje e tre preventivave. Nuk ka një dokument që të vërtetojë se çfarë zërash janë hequr nga preventivat e zbatimit të punimeve të tenderuar më parë, për të cilët është bërë dhe pagesa, me efekt negativ, pasi detyrat e projektimit të prokuruar kanë dalë pa efektivitet në shumën totale 915,000 lekë. Nuk ka asnjë urdhër Titullari për bashkimin e këtyre preventivave, për zërat e hequr apo të shtuar. Për projektin dhe preventivin për punimet e h/izolim tarrace dhe punime rrufepritësi, rezulton të jenë kryer nga Drejtoria e shërbimeve. Nga auditimi rezulton se projekti nuk shoqërohet nga licencat e projektuesve me kategoritë përkatëse, në kundërshtim me VKM nr. 759, datë 12.11.2014, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”. Nuk ka dokument se kush ja ka dhënë njësisë së prokurimit dokumentacionin. Në procesverbalin e argumentimit të kriterëve për kualifikim është kërkuar paraqitja e dokumentacionit ligjor administrativ dhe jo me vet deklaram, kërkesë kjo e ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, neni 82, “Formulari përmbledhës i vetë deklaramit”. NJHDT nuk i ka argumentuar kriteret e cilat janë të paargumentuara dhe jo në lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit, në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 4.

Në fazën e vlerësimit KVO ka shpallur fitues BOE “I” SHPK & “K” SHPK & “S” SHPK me ofertë ekonomike 18,037,348.8 lekë, dhe ka s`kualifikuar me të padrejtë OE “2” SHPK me vlerë të ofertës 14,610,929 lekë, me një diferencë 3,426,419.80 lekë, duke mos konstatuar faktin se NJHDT nuk ka kërkuar vetëdeklarime por dokumentacion në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 75, “Komisioni i

vlerësimit të ofertave”, pika 4. KVO, nuk ka zbatuar aktet ligjore e nënligjore të prokurimit publik, duke mos i njohur ato.

Nga veprimet dhe mosveprimet e NJHDT dhe KVO është shpallur fitues BOE I” SHPK & “K” SHPK & “S” SHPK, me vlerë të ofertës 18,037,348.8 lekë në kushtet kur nuk plotëson kriteret dhe është s’kualifikuar OE “2” SHPK, me ofertë 14,610,929 lekë ose 3,426,419.80 lekë më pak, në kushtet kur NJHDT i ka kërkuar në kundërshtim me LPP vërtetimin e kriterëve dhe KVO ka vlerësuar pa njohur aktet ligjore dhe nënligjore të LPP, duke shkaktuar dëm me efekt negativ në **shumën 3,426,419.8 lekë**.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.14. faqe 146 -212 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, Universiteti i Mjekësisë Tiranë, të analizojë situatën e krijuar dhe të ndërmarre masat e duhura për zbatimin e procedurave të prokurimit publik, në të gjitha fazat që nga planifikimi e lidhjen e kontratës.

Menjëherë

E. MASA DISIPLINORE

E.1- PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHENIE PUNE

Mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12/07/1996, “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Urdhrin e Administratorit të UMT-së “Për emërim me kontratë me afat të pacaktuar të personelit administrativ në administratën e Rektoratit të UMT-së”, neni 10, “Masat disiplinore”, pika2/d, të kontratës individuale të punës, i kërkojmë Administratorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit të japë masën:

a- “Largim nga puna”, për punonjësit e mëposhtëm:

- 1-** **N.D.**, Anëtar e komisionit të vlerësimit të ofertave të tenderit “Rikonstruksion i sallave të Rektoratit dhe çatisë së UMT”, sipas urdhrit të Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr. 308, 30.12.2022.
- 2-** **M.C.**, Anëtar e komisionit të vlerësimit të ofertave të tenderit “Rikonstruksion i sallave të Rektoratit dhe çatisë së UMT”, sipas urdhrit të Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr. 308, 30.12.2022.
- 3-** **E.T.**, Anëtar e komisionit të vlerësimit të ofertave të tenderit “Rikonstruksion i sallave të Rektoratit dhe çatisë së UMT”, sipas urdhrit të Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr. 308, 30.12.2022.
- 4-** **P.L.**, Anëtar e njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit “Rikonstruksion i sallave të Rektoratit dhe çatisë së UMT”, sipas urdhër prokurimit nr. 307, datë 30.12.2022

b- “Vërejtje me paralajmërim” – deri në “Largim nga puna”

1- **E.H.**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Burimeve njerëzore. Pedagogët e jashtëm të kontraktuar nga Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, kanë dhënë mësim tek studentët përkatës sipas cikleve të studimit dhe njëkohësisht janë likuiduar për këto orë mësimi, pa pasur në fillim një kontratë pune me fakultetin përkatës. Miratimi dhe vendimi i shpalljes së fituesve për vendet vakante për pedagogë me kohë të pjesshme, është bërë në Muajin Maj 2020 kur pedagogët kanë qenë të domosdoshëm në Tetor 2019. Pedagogët e kontraktuar me vonesë nga Rekorati, rezultojnë ligjërisht të kenë dhënë orë mësimi dhe të kenë kryer vlerësimet

respektive për orët e mësimdhënies të zhvilluara, pa patur më parë një kontratë punësimi me Universitetin Mjekësor të Tiranës. Pedagogët e jashtëm, të kontraktuar nga UMT, kanë kryer punën e pedagogut dhe njëkohësisht kanë certifikuar studentët për lëndët mësimore të dhëna ndaj tyre, pa patur marrëdhënie pune ligjore (pasi kontratat rezultojnë të nënshkuara pas kryerjes së mësimdhënies ose me efekt prapaveprues) me Universitetin e Mjekësisë. Kjo gjë, përveç faktit që sjell parregullsi të karakterit ekonomiko-administrativ në Universitetin e Mjekësisë, njëkohësisht, mund të krijojë dhe probleme juridike në të ardhmen, lidhur me vlefshmërinë e shërbimit të mësimdhënies. Gjithashtu, ky shërbim, i ligjëruar pas kryerjes së tij, e bën të pamundur kontrollin në përputhje me legjislacionin në fuqi për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin si nga Auditimi i Brendshëm ashtu edhe nga ai i Jashtëm, në kohën e ofrimit të këtij shërbimi.

c- Për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e **përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar** dhe të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse.

E.2 PËR PUNONJËSIT E LARGUAR.

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre. Nga ana tjetër në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte:

“Largim nga puna” përkatësisht për:

- 1- **S.S.**, në cilësinë e ish Administratorit të UMT.
- 2- **L.L.**, Anëtar e njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit “Rikonstruksion i sallave të Rektoratit dhe çatisë së UMT”, sipas urdhër prokurimit nr. 307, datë 30.12.2022
- 3- **A.L.**, Anëtar e njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit “Rikonstruksion i sallave të Rektoratit dhe çatisë së UMT”, sipas urdhër prokurimit nr. 307, datë 30.12.2022
- 4- **F.Z.**, me detyrë ish Shef i Sektorit të shërbimeve, për përgatitjen e preventivave.

“Vërejtje me paralajmërim” përkatësisht

1. **E.D.**, me detyrë Specialiste, Drejtorja e Shërbimeve, për periudhën 01.06.2018-01.09.2023;
2. **G.N.**, me detyrë Përgjegjës, Sektori Prokurimeve për periudhën 23.08.2021-09.02.2022
3. **G.A.**, me detyrë Sekretare mësimore/Specialiste Finance, për periudhën 01.01.2016-20.12.2021
4. **L.K.**, me detyrë Drejtor, Drejtorja Shërbimeve, për periudhën 17. 04.2018-10.08.2022
5. **Z.D.**, me detyrë Administratore e FM, për periudhën 15.01.2015-10.11.2021

F. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë (Administratori), pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar

G- TË TJERA

Bazuar në gjetjet nga auditimi i ushtruar, gjatë faktit dhe referuar ankesës së ardhur nga një grup studentësh të Fakultetit të Mjekësisë, të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, e protokolluar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me nr. 738/1, datë 12.09.2023, rekomandojmë sa vijon:

1. Gjetje nga auditimi: UMT, për tarifafat e programeve të studimit, nuk ka kryer një metodologji për llogaritjen e tyre deri në shtator 2023 (periudhë e përfundimit të auditimit në terren). Bazuar në VKM nr. 288, datë 23.07.2018, i cili parashikon një tavan kufi për tarifafat e ciklit të parë dhe të dytë të integruar të studimit, UMT-ja, mjaftohet duke vendosur në kufijtë e këtij tavani, tarifafat për program studimi, pa i nxjerrë ato mbi bazën e një analize profesionale tekniko-ekonomike. Sipas parashikimeve të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH", Bordi i Administrimit duhet të vendosi tarifafat e shkollimit pasi të ketë ndjekur një metodologji të llogaritjes së tyre, duke respektuar kufirin maksimal të përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave. Tarifafat e aplikuara nga UMT dalin mbi bazën e një reference në lidhje me shpenzimet hipotetike të vitit koherent, duke marrë për bazë shpenzimet e vitit të mëparshëm. Këto tarifa në asnjë rast nuk janë rishikuar pas përfundimit të vitit akademik, nëse ato bazohen në një analizë reale të vitit koherent. Aktualisht me miratimin e VKM nr. 527, datë 07.09.2023 "Për caktimin e metodologjisë së kostos së studimeve për programin e integruar të studimit të ciklit të dytë 'Mjekësi e përgjithshme' në institucionet publike të arsimit të lartë dhe çdo mbështetje tjetër për studentët e këtij programi studimi", është dërguar dhe lista e zërave të përfshira në analizën e kostos, ku një nga zërat është dhe zëri "Shpenzime për bursa". Vlen të theksohet fakti se, vendosja e kësaj vlere në tabelën e kalkulimit të kostove direkte, **rrit riskun për një llogaritje jo reale të saj.**

Rritja e cilësisë së shërbimeve të ofruara nga UMT-ja dhe vlerësimi i tarifave mbi bazën e një analize kostoje reale, mund të ndikojnë pozitivisht në uljen e tarifave të studimit dhe rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të këtyre shërbimeve ndaj studentëve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.15. faqe 221 -232 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandim: Universiteti i Mjekësisë Tiranë dhe Bordi i Administrimit të tij, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, të marrin masa për rishikimin e tarifës së studimit për ta hartuar atë mbi bazën e një analize profesionale tekniko-ekonomike, duke pasur parasysh rritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj studentëve, të përcaktojnë tarifafat e studimit referuar kostove reale, pa përfshirë koston e studentëve ekselencë, e cila duhet të paguhet nga buxheti i shtetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.2 Rekomandim: Universiteti i Mjekësisë Tiranë dhe Bordi i Administrimit të tij, të marrin masa për dërgimin e propozimeve të nevojshme ligjore tek MAS, lidhur me tarifimin e studentëve për çdo vit akademik, pasi viti akademik të ketë përfunduar, me qëllim që tarifa që do të paguajnë studentët të jetë në përpjesëtim të drejtë me shpenzimet reale të kryera gjatë vitit akademik.

Menjëherë dhe në vijimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT